

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**  
**“Luigj Gurakuqi”**

**BULETIN SHKENCOR**

**Seria e shkencave shoqërore**

**Viti XLIV i botimit**

**Nr. 64**

Shkodër, 2014

## **REDAKSIA**

*Prof. dr. Fatbardha HOXHA (Kryeredaktor)*  
*Prof. dr. Tefë TOPALLI (Sekretar shkencor)*  
*Prof. dr. Tomor OSMANI, prof. as.dr. Paulina HOXHA,*  
*prof. as. dr. Mimoza PRIKU, prof. as. dr. Rajmonda Këçira,*  
*dr. Nevila DIBRA, dr. Meri GJELUCI (anëtarë)*

### **DREJTOR I REVISTËS**

*Prof. dr. Artan HAXHI*

**Korrektori dhe punoi në kompjuter: *Arta Bajrami***

---

#### ***Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***

---

Adresa e redaksisë:      Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Redaksia e Buletinit Shkencor  
Seria e Shkencave Shoqërore  
Tel/fax: ++399 22 43747

## PASQYRA E LËNDËS

### **Alfred ÇAPALIKU**

Tri poezi të Podrimjes

*Three poems by Podrimja*.....9

### **Nexhmi BUSHATI**

Shkrimet e pabotuara të Qemal Draçinit

(Shënime bibliografie e recensionit)

*Unpublished writings of Qemal Draçini*..... 13

### **Arben PRENDI**

Vepra letrare e Ridvan Dibrës/ kontribut për letërsinë shqiptare

*Literary works of Ridvan Dibra / contribution to the Albanian literature*.....31

### **Alva DANI**

Shkodra përmes shkrimeve të albanologes Luçia Nadin

*Shkodra through the Albanologue Lucia Nadin*.....39

### **Gëzim PUKA**

Loja dhe ironia përmes tekstit dramatik të Albri Brahushës

*The tease and dramatic irony through Albri Brahusa's text*.....47

### **Irma SOKOLI (BILALI)**

Reflektime mbi trajtimin e figurës së Naim Frashërit në

vëllimin “Historia e Letërsisë Shqipe”, 1983

*Reflections on the approach to the image of Naim Frasheri in the  
“History of Albanian Literature” in 1983*.....59

## **Orjeta BAJA**

Mbi shkrimet gjuhësore në revistën “Hylli i Dritës” (1913-1944)  
*Linguistic writings in the magazine "Hylli i Dritës" (1913 - 1944)*..... 69

## **Anisa KOSTERI**

Prania e sllavizmave në fjalorin e Gazullit  
*The presence of slavic words in the vocabulary of Gazulli*..... 81

## **Merita HYSA**

Struktura metrike dhe veçori të këmbëve fonetike në gjuhën shqipe  
*Metrical structure and phonetic features in albanian* ..... 95

## **Aida URUÇI**

Ngjyresat ligjërimore në krijimtarinë e M. Camajt  
(në fushë të sintaksës)  
*Discursive nuances on creativity of M. Camaj*  
(in field of  
syntax)..... 109

## **Mirela XHAFERRAJ (MITRO)**

E tashmja e lidhore së shqipes dhe greqishtes. Çështje të modalitetit,  
aspektit, përdorimit dhe përkthimit të saj  
*Present tense of subjunctive mood in Albanian and Greek. Some issues related to*  
*its modality, aspect, use and translation*..... 117

## **Alma GOLEMI**

Terminologji dhe dukuri krahinore me vlera etnolinguistike në dramat e  
Martin Camajt  
*Terminology and provincial phenomena with ethnolinguistic values in Martin*  
*Camaj's drama*..... 129

**Alma PINARI (KALLARI)**

Perfekti dhe perfektiviteti në gjuhën shqipe

*About the interpretation of some aspectual terms in Albanian language.....* 137

**Esmeralda PATOSHI (SEFA)**

Lidhëza: *se, që* te Pjetër Bogdani, krahasuar me Buzukun dhe me FSHS

*Conjunctions: For, because in Pjetër Bogdani, as compared to*

*Buzuku and FSHS.....* 145

**Aimir OSMANI**

Konsiderata gjuhësore të veprës së Arshi Pipës

*Linguistic considerations of Arshi Pipa's creativity.....* 155

**Tefta NUREDINI**

Terminologjia gjuhësore në Gramatikat e A. Xhuvanit (1919 – 1922 - 1938); e krahasuar me atë të përdorur nga I. D. Sheperi (1927) dhe Atë Justin Rrota (1943)

*Linguistic terminology in grammars of A. Xhuvani (1919-1922-1938); compared with that used by I. D. Sheperit (1927)*

*and Father Justin Rrota (1943).....* 171

**Arjola HOTI**

Vëzhgime leksikore në veprën “*Ditët e mbrame të Turqisë në Shkodër ase rrethimi i qytetit 1912-1913*” e Justin Rrotës

*The lexicol surveys in the work “Ditët e mbrame të Turqisë në Shkodër ase*

*rrethimi i qytetit 1912-1913” by author Justin Rrota.....* 181

**Sokol AXHEMI**

Tipare të lëvizjeve migrative në territoret ndërkufitare me Shqipërinë. Evolucioni i tyre

*Features migrative movements in the territories border with*

*Albania. Their Evolution*..... 193

**Nevila DIBRA**

Integrimi i turizmit natyror e atij kulturor në zonat pranë rrugës antike veriore Adriatik-Dardani

*The integration of cultural and natural tourism in areas near the Northern Antique Road Adriatic- Dardan* .....203

**Bresena KOPLIKU (DEMA)**

Integrimi i emigrantëve, fazë e rëndësishme e migrimit ndërkombëtar. Rast studimor nga emigrantët e qytetit të Shkodrës

*Migrants integration - An important phase of International Migration. Shkodra emigrants case study* .....211

**Nertila DILAVERI**

Zhvillimi i artizanatit në rrethin e Shkodrës

*The development of handicrafts in the district of Shkodra*.....225

**Ervis KRYMBI**

Evolucioni dhe transformimet urbane në qytetin e Shkodrës

*Evolution and urban transformations in Shkodra city*.....237

**Irena NDREU**

Marrëdhëniet e hershme tregtare të Shqipërisë me Venedikun

*Early trade relations between Albania and Venice*.....249

**Valbona KARAKAÇI**

Simbolet e angazhuara si akt komunikimi kulturor

*Symbols as cultural communication*.....257

**Isida HOXHA**

Etika në shtypin e shkruar të pavarur në pasqyrimin e fushatës elektorale

*Ethics in independent print media in the coverage of  
the electoral campaign*.....267

**Ardita REÇI**

Orientimet zyrtare dhe gazetarët shqiptarë të viteve 1945-1990  
*Official orientations and the Albanian journalists during the years  
1945-1990*.....279

**Romira MUKA**

Ligjërimi politik në Shqipërinë komuniste gjatë festave kombëtare  
*Political discourse in communist Albania during national holidays*.....285

**DISKUTIME DHE RENCENSIONE:**

**David LUKA:** Shënime për një artikull  
*Notes for an article*..... 95

**Evalda PACI:** Matteo Mandalà: Lekë Matranga: Njeriu, koha dhe  
vepra (me botimin kritik të varianteve dorëshkrim e  
të shtypur të veprës *E Mbësuarë e krështerë*, 1592).  
(Botime Ombra GVG, Tiranë, 2013).  
*Matteo Mandalà: Lekë Matranga: the Man, the time and  
the work (the critical edition of the printed manuscript  
variants of offense E Mbësuarë e krështerë,  
1592*.....337

**Tefë TOPALLI:** Arshi Pipa dhe vepra e tij “Trilogjia Albanika”  
(Shtypshkronja “West Print”, Tiranë, 2013)  
*Arshi Pipa and his work “Trilogjia Albanika”*.....342

**Zamira SHKRELI:** Zëri i Willy Kamsit në një libër albanologjie  
*Willy Kamsi’s Voice in an albanological book* .....351

**NEKROLOGJI**  
**Mentor Quku**  
**1939 - 2014**

**Fatbardha HOXHA:** Profil studiuesi  
*Researcher profile*.....357

**JETA SHKENCORE**

I. Veprimtari shkencore  
*Scientific activity*.....361

II. Promovim librash  
*Work promotions*.....365

III. Botime të pedagogëve jashtë shtetit  
*Publications abroad*.....376

III. Librat e botuar gjatë vitit 2013-2014  
*Books published during 2013-2014*.....378

IV. Jepet titulli “Profesor”, “Profesor i asociuar”, “docent”  
*Given the title “Profesor”* .....379



Alfred ÇAPALIKU

**TRI POEZI TË PODRIMJES**

"Ali Podrimja prin me inovacione. Herë rrëfyes lirik e herë lirik i pastër."  
Nehas Sopaj

"Ali Podrimja është poet i kursyer. Poezinë e ka të ngjeshur  
e të lidhur në strukturë, kurse figuracionin konkret, shprehës."  
Robert Elsie

**Dy antologji**

Në dy përfaqësime serioze, dinjitoze: në *"An elusive eagle soars"* (*"Një shqiponjë e pakapshme ngrihet lart"*), London & Boston, 1993, përkthyer nga Robert Elsie dhe në *"Antologji e poezisë së pastër shqipe"*, Kumanovë-Shkup, 2002, përzgjedhur nga Nehas Sopaj; Podrimja paraqitet me tri poezi të njëjta: *"Maca e zezë"*, *"Kali i Trojës"*, *"Baladë për njerinë"*. Përveç shijes së përfaqësimit të hartuesve mendoj se në zgjedhje ka ndikuar në radhë të parë vlera estetike në vetvete e tri krijimeve, vlera e kulluar që as më shumë e as më pak e bën Ali Podrimjen (Gjakovë 1942 - Lodeve, Francë, 2012) një poet antologjik, një zë të veçantë dhe të paanashkalueshëm në letërsinë shqipe.

Jo rastësisht, në sallën e bibliotekës së Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", edhe studiuesi i huaj Aleksandër Zotos, para dy vitesh, gjatë konferencës *"Duet zërash kosovarë"* i komentoi po këto tri poezi brilante në frëngjisht.<sup>1</sup>

**"Maca e zezë"**

*"...një macë e zezë më ndjek  
e shpirti më thotë  
në gjysmë rrugë ke për të mbetur"*

Ontologjia e poezisë "Maca e zezë", përmes procedimit të saj, të çon tek vepra e ndërprerë, e papërfunduar, që s'i thotë kurrë të gjitha; ngaqë poeti në garën për origjinalitet me krijuesit e tjerë, në radhë të parë duhet t'ia kalojë vetvetes:

*“... një mace e zezë më ndjek  
në udhëtimin tim”*

Ndeshja nuk është e rastit, por e përditshme, ndaj s’ke si t’i shmangesh:

*“orën e fatit ajo dikton”*

Duke përqeshur paranojën e duke tallur censurën, që i del para si një mace e zezë, Podrimja mbijeton pa e kthyer rrugën e tij të vjershërimit, përkundrazi ai shpik shenja e rregulla të reja qarkullimi.

### **“Kali i Trojës”**

Simbolikën e drunjtë të Kalit të klonuar të Trojës, poeti na e sjell përmes të tashmes historike. Fillimisht Podrimja lëviz formën e jashtme statike. Poezinë e ndan në pesë cikle, ku secili mbart vargun esencial:

1. *“... në një guackë mallkimi*
2. *“... ti s’i harrove asnjëherë”*
3. *“... ik prej dritës”*
4. *“... shfaqesh kur Bota humb çelësin”*
5. *“... ktheu në vargun e Homerit”*

Më pas Podrimja lëkund edhe strukturën e brendshme të ndjeshme, mbasi Kali pa moshë:

*“... ëndërron ndonjë tërmet të ri në botë”*

Fjala poetike si *“perpetuum mobilis”* ndryshon vetën dhe transformon modalitetin, në kolazhin kromatik të reales me surrealen, te vjersha – poemth “Kali i Trojës”.

### **“Baladë për njerinë”**

*“...në vend të kravatës  
gjarpërin lidh për qafe  
në vend të këmishës  
lëkurën e ujkut vesh”*

Akademiku Ali Aliu është shprehur për këtë krijim të Ali Podrimjes se “*Kemi një shqiptim të prerë...që kryesisht artikulohet përmes shkallëzimit të ironisë...*”<sup>2</sup>

Në fakt, ironia nis që nga titulli, në këtë pseudobaladë për të asimiluarin gjuhësisht e kulturalisht, për të mbeturin cullak nëpër botë:

“*...një njeri që humbi gjithçka  
ndjenja sy*”

Në këtë poezi, që vetëm baladë për njeriun nuk është, por veç epitaf, ndihet sa ndikimi i absurdit në tjetërsimin e gjenit, aq rreziku i globalizmit në zhdukjen e identitetit.

### **Shkollë poetike**

Duke e vështruar fenomenin Podrimja më gjerë e duke e zhbiruar letraritetin e tij më thellë; për pasojë duke ia përgjithësuar kumtet e fjalës mbasi ia ka prekur telat e shpirtit; studiuesi, shkrimtari, publicisti, profesori Emin Kabashi, shfaq portretin e poetit në telajo njëkohësisht me kornizën e çmuar, që ia mbron vlerat reale:

*"Ali Podrimja solli ndër të parët në poezinë shqipe në Kosovë gjuhën e Ezopit që flet për fatin dhe të ardhmen e fisit të vet përmes simbolit e alegorisë, paralelizmave dhe parabolave poetike. E çliruar nga konvencionet tradicionale, gjuhën poetike të Ali Podrimjes e karakterizon ekspresiviteti dhe figuracioni konkret."*<sup>3</sup>

Këto tri poezi lakmuar nga Elsie e Sopaj, por edhe nga lexuesi i gjerë, janë modele, mostra, etalone për të provuar se Ali Podrimja e ka krijuar me kohë shkollën e tij poetike; me platformën ideologjike dhe estetike, me institucionalizimin përmes botimeve në shqip e në gjuhë të huaja dhe me jehonën apo influencën artistike.

“*Maca e zezë*”, “*Kali i Trojës*”, “*Baladë për njerinë*” janë tre kënde të fatit njerëzor shtrirë nga mitologjia, në histori, tek 24 orëshi i sotëm. Me rrënjë tek tradita, Ali Podrimja e pjek frytin tek modernia.

Këto tri poezi janë thjesht tre gurë themeli të një shkolle të fortë poetike, e cila i ka të gjitha gjasat që të bëhet shekullore, duke mbetur e paimitueshme.

Një javë pas shuarjes së jetës së emblematikut Podrimja, poeti Visar Zhiti e vlerësoi në mënyrë konçize:

*“Ali Podrimja është një nga zërat më të fuqishëm të poezisë shqiptare, poeti modern hermetik në kuptimin estetik të kësaj fjale, një britme jete dhe një buzëqeshje triumfi të njeriut që në rastin e tij është populli i tij... Ai vendosi parime të tjera krijuese, efikase për të shprehur zona më të errëta apo më të fshehta të natyrës së njeriut.”<sup>4</sup>*

Ars longa, vita brevis.

#### REFERENCA:

1. Ambassade de France/Alliance Française: *“La Printemps de la Francophonie. Pranvera e Frankofonisë në Shqipëri, 17-27 mars 2012, Tiranë, 2012, f.9.*
2. Ali Aliu (Grup autorësh): *“Ali Podrimja. Poetika.”* Tek *“Letërsia bashkëkohore shqiptare”*, Tiranë-Tetovë, 2001, f.241.
3. Emin Kabashi: *“Ali Podrimja”*. Tek *“Fjalor enciklopedik shqiptar 3”*, Tiranë, 2009, f. 2049.
4. Visar Zhiti: *“Poezia shqipe ngushëllohet vetëm prej zërit të Podrimjes”*. Gaz. *“Koha jonë”*, Tiranë, 23.07.2012, f. 17.

### Three Poems by Podrimja

#### SUMMARY

The author of this study has analysed three emblematic poems by Ali Podrimja focusing on the poet's innovations as a lyrical narrator as well as on the structure of the stanzas, which are rich in their figurative expressiveness

The study concludes highlighting that Ali Podrimja founded an artful school of poetry of his own.

Nexhmi BUSHATI

## SHKRIMET E PABOTUARA TË QEMAL DRAÇINIT (SHËNIME BIBLIOGRAFIE E RECENSIONI)

Qemali, që në bankat e gjimnazit, do të shfaqte talentin e tij prej letrari të ndjeshëm e spontan, me një botë të pasur shpirtërore e me një prirje të lindur ndaj së bukurës në natyrë, ashtu edhe në jetën e përditshme, sikur dhe me një sens të mprehtë kritik ndaj asaj që e rrethonte.

Debutoi me sukses në shtypin e kohës, nën pseudonimet “Malseni” e “Imperitus”. Angazhimet e tij më të dukshme (pas një shkëputjeje dy vjeçare) qenë ato të vitit 1944, në revistën “Fryma”, ku ai do të konfirmonte, para një rrethi më të gjerë lexuesish e studiuesish, të vërtetën e madhe se, në orbitën e letrave shqipe, ishte i pranishëm tanimë dhe një “... zë i jashtëzakonshëm”, siç u vlerësua, më vonë, nga specialistët e fushës.

Botimi i librit “Era” (1995), përmbledhje e zgjedhur e krijimtarisë së Qemalit, bërë nën redaktimin cilësor të të vëllait, Enver Draçinit, shënoi një ngjarje me jehonë në jetën artistiko-kulturore të vendit. Falë këtij botimi, për herë të parë, u bë e mundur që të merrej kontakt me frymëmarrjen e gjerë të punës krijuese e studimore të Qemalit, si dhe i vlerave që mbarte me vete. Në lidhje me këtë botim dhe krijimtarinë e autorit, mendimi ynë kritik ka shprehur konsiderata të larta, për dimensionet e saj, meritat, mesazhet.

Është e kuptueshme se pavarësisht kontributit të botimit në fjalë, ndihej nevoja që dhe pjesa e mbetur e pabotuar e krijimtarisë së autorit, të shihte dritën e botimit. Këtë detyrë të lodhshme, ashtu si vite më parë, me përkushtimin e duhur, e mori përsipër i vëllai, por sëmundja e rëndë e mposhti, sapo filloi të vinte në jetë nismën fisnike. Detyrimi moral dhe njëheri qytetar, ishte për mua më i madh se sa vështirësitë e punës së filluar. Kjo më dha shtysë që t’i shkoja deri në fund asaj që kishte projektuar të kryhej së bashku, nga i ndjeri miku im.

Pas redaktimit dhe përgatitjes për botim të “Ditarë”-ve dhe Epistolarit, u pa e arsyeshme që, në mungesë të një botimi përkatës të pritshëm, prezantimi dhe përshkrimi i shkrimeve të pabotuara të Qemalit të vlente, për disa kohë, si eliminim i një mangësie dhe plotësim i një kërkese të të interesuarve. Ashtu si në botimin e njohur “Era”, edhe në

këto të pabotuarat, ndeshen larmi shkrimesh. Duke lënë mënjanë hartimet shkollore, punimet me karakter studimi, si dhe përkthimet, lëndë e një trajtimi tjetër, në vijim do të përqendrohemi vetëm te krijimtaria e mirëfilltë letrare. Janë respektuar gjatë shtjellimit, kriteret e mëparshme, tashmë të njohura, të grupimit në cikle të prozave dhe të poezive.

## I. “ÇASE”

### 1.- “Prendimi” (Malseni, gusht, 1938)

Një perëndim me ngjyra të ndezta e me reflekset e rrezeve të fundit mbi ujërat e qeta të liqenit të Shkodrës: një peizazh që të bën të ëndërrosh, që të bën ta duash natyrën deri në adhurim. Nga kjo skicë e shkurtër në trajtën e një proze poetike marrim mesazhin fisnik të atdhedashurisë, një mesazh i përsëritur shpesh nga Qemali, një mesazh shumë i dashur nga ai.

### 2.- “Të humbun” (vizatim, 23.XII. 1938 – Malseni)

Një skicim portretizimi. Ironizohet mentaliteti i dënueshëm i atyre që “të humbur”, quajnë ata që s’bëjnë si “dinamikët”, nuk tjetërsohen, nuk imitojnë të tjerët, kanë individualitet dhe paragjykojnë e s’vlerësojnë, ndonëse janë të pavarur

### 3.- “Malcori” (Mbreshtan, mars, 1939 - Malseni)

Atje, në mal, autori ka takuar malësorin, rrëfimin e të cilit e përdor si mjet për të përcjellë mesazhin e ditës: jeta e qyteteve po njihte zhvillimet kapitaliste, me të mirat e me të metat e veta; në ato rrethana duhet t’u ruhemi ndikimeve të këqija të botës së jashtme, duhet të mbahen të gjalla ato cilësi të larta që janë tiparet tona dalluese: burrëria, krenaria dhe dashuria për lirinë dhe atdheun. Vërehet se në këtë tregim, autori shpreh nostalgjinë e tij për traditat, një ndjenjë e fuqishme, të cilën e ka përjetuar deri në ditët e fundit të tij.

### 4.- “Letërsija” (prill, 1939 – Malseni)

“Perëndeshë hir –plote...të fola një lutje, Zojë hije –randë... Të falem, o Panteon mystik, kult mprojtës,... Nanë- ngushllimtare,...që nanurise Homerin, Virgjilin, Danten, Petrarken ...I dalldisun n’ekstazë, le të vë një kunorë të thjeshë, lulesh livadhi, lidhë nga unë! “*Kjo prozë poetike me karakter enfaze, e mbushur me apostrofa të njëpasnjëshme, ndjekur nga figura të shumta letrare, është një apoteozë që autori, adhuruesi i saj, i blaton shoqes e mikes së tij të pandarë, letërsisë*”.

### 5.- “Fëmija jetim” (gusht, 1939, Malseni)

Jeta u tregua shumë e ashpër me jetimin: nënës së vdekur iu shtua dhe vdekja e të atit. Kortezi do të përjetojë një trishtim të papërkthues kur jetimi përpiqet t’i bashkohet grupit. Vajtimi i tij shndërrohet në një britmë therëse, pastaj shuhet lehtë. Para këtij pikëllimi, autori përkulet me

dhimbje. Tregimi i mësipërm provon se problematika sociale që përherë e pranishme në shkrimet e Qemalit.

6.- “Lahuta” – Kujt ma frymëzoi - (25 maj 1939, Malseni)

Zanafilla e këtij shkrimi dhe e kushtimit që e shoqëron, bëhet e qartë përmes një shënimi të dt.24 shtatuer 1939, lënë nga vetë Qemali në “Ditarët”: “... *Po i siellsha syt nepër dhomë për me gjetun një subjekt... Erdhe ti, i solle syt magjishëm nepër dhomë e mbi lahutë, varun në mur, i ndale... më thae*” – *Shkruej mbi lahutë!... E shkrova. Kur sosa, bana kushtimin “Kujt ma frymëzoi”. E ta thashë kushtimin. S’të erdhi keq, s’u idhnove; përkundrazi, buzqeshe. Të falem nderës!*”

Lahuta “varun në mur” në asnjë mënyrë nuk të lë përshtypjen e një relikeje të zakonshme të një koleksioni antikuar. Për atë gjimnazist 17 vjeçar ajo ishte një emblemë, një përmendore që i ngjallte adhurim, mallëngjim, krenari. Jo vetëm tingujt e saj, por ishte dhe magjia e rapsodive tona që i krijonin atij mbresa të befta e të paharrueshme. Ato vargje i përcillnin fisnikërinë e burrave të maleve dhe lavdinë e bëmave të tyre për mbrojtjen e trojeve tona. Autori, për t’ia thurur këtë hymn lahutës, duke ia plotësuar dëshirën dhe frymëzueses, të zgjedhurës së zemrës, ka zgjedhur të përshtatshëm takimin me një malësor të zonës së Thethit.

7.- “Malli i vendlindjes” ( tetuer, Malseni)

Kemi arsye që të supozojmë se, përshkrimi i këtij mallëngjimi, rrjedhë e kujtimeve të së kaluarës, kur autori u pat gjendur si vizitor në një vend të huaj e të panjohur, për vetë arsyet e moshës, është kryesisht prodhim i imagjinatës së zhvilluar të një djaloshi plot ndjenja delikate e fisnike. Për të qenë sa më bindës, autori përdor kontrastin, duke vënë përballë pamjeve të reja e të shumta, të shoqëruar dhe me shpjegimet e “guidë”-s, vegimin mbizotërues të bukurive të mëmëdheut.

8.- “Ç a s” ( natë dheteri 1939, Malseni)

Në pak radhë jepet një e vërtetë e pakëndshme: pas dhjetë vitesh, zhvillohet takimi i dy ish-shokëve fëmijërie, me një të shkuar të përbashkët; deshën të ripërtërinin ndjenjat e kujtimet e hershme, por koha kishte bërë të vetën.

9.- “Sprov’e parë” ( qershuer, 1940 – Q.D.)

“ Së shpejti ka me qenë radha e ime”

Qemali që i lidhur shumë me rrethin familjar. Ai përjetoj thellësisht si gëzimet ashtu dhe hidhërimet. Për fatin e tij të keq, çaset e përzishme qenë më të shumta, ato s’iu ndanë asnjë herë. Në serinë e goditjeve të mëvonshme, vdekja e dajës (e atij që dhe e kishte punësuar), që fatkeqësia e parë e fortë. U varros në Itali. Të bën përshtypje ajo parandjenja e tij për “vdekjen e afërme” të veten (?!), një lajtmotiv i shumë shkrimeve të tij.

## 10.- “Vgjiniki”( korrik 1940- Imperitus)

- së panjoftunes -

Një portretizim sentimental nga një adhurues romantik ideal, të cilit, edhe bardhësia e fustanit të vashës së zemrës i shëmbëllen si element plotësues i bardhësisë së shpirtit të saj. Gjithçka harmonizohet në këtë përshkrim: shikimi i magjishëm i syve të saj të bruztë, “ sy Princeshe”, “shikim hyjneshe Venere e Minerve”, flokë të artë që rrisin bukurinë etj.

## 11.- “Kanga e Mines” (korrik, 1940)

Kjo “kangë e merakut, kang’e dashunis” e rrëmben autorin, më shumë se zëri i bukur i këngëtares, teksti i këngës, veçanërisht portretizimi i Mines së magjishme “më këmishë të hollë”. Një sensualizëm i dukshëm, spontan, i drejtpërdrejtë, por i shëndetshëm, ashtu siç e gjejmë të pranishëm në mbarë poezinë popullore të natyrës erotike. Ky afinitet i hershëm i Qemalit me lirikën popullore, do të bëhet më i dukshëm, kur ai vetë do të krijojë sipas këtyre modeleve, sipas kësaj fryme.

## 12. - “Dridhje” (tetuer, 1940)

Prozë fare e shkurtër që na transmeton çastet e dhimbjes së madhe që përjeton shpirti i autorit të zhgënjyer nga fundi i palumtur i ëndrrës së tij të bukur.

## 13.- “Kang’e mirëseardhjes” (korrik, 1941)

I kushtohet “Dashunisë së ridukun qiellore”. Një moment ngazëllimi të papërmbajtur, një ekstazë e mirëfilltë ku, si në gjendje deliri, thuren vargje në prozë. Të jepet përshtypja e një vargu të pambarim dithirambesh. Mbizotëron abstraktja, e përgjithshmja, e papërcaktuara. Asgjë konkrete.

## 14.- “Çase rruge” ( Nuros, prill, 1941)

Shoku i ngushtë i studimit, Nuroja, mbetet i shtangur, duke soditur ngultazi gruan e re, me tipare të bukura e me trup të zhdërvjelltë që, huret joshëse, fustani i kuq ia nxirrte në pah dukshëm. Ka një sfumaturë ironie të lehtë miqësore gjatë zhvillimit të dialogut mes dy shokëve ku, ndonëse ecin krah për krah, “ indiferentizmi” i dëgjuesit ( autorit) është i dukshëm. Duke njohur natyrën prej puritani të protagonistit, aq në kontrast me atë të autorit, ky alternim “i stisur” rolesh, krijon ndjenjën e humorit për “paradoksin” e çastit.

## 15. - “Çase” (Haxhiut, shtator, 1940)

--- Me rastin e ndarjes, alter-egos së vet --- Qemali

Në një libër të poeteshës italiane Ada Negri, është vënë një kushtim, në qendër të të cilit jepet qasja me shkëmbin që, në mes të lumit, përballet me furitë e lumit të egër. Në se shkëmbi, sipas figurës së huazuar, simbol i njërit apo i tjetrit, do t’u qëndrojë apo jo valëve të tërbuara, këtu të lumit



Kir, ka për të shërbyer si dëshmi e shkallës së qëndresës së tyre në jetë kundrejt dallgëve të saj.

16.- “Pavdeksi” (Kičos, qershor, 1943)

Nuk janë të shumta fjalët kushtuar rënies heroike të Kristaq Tutulanit e të së motrës, Margeritës, në ato ditë të përgjakura të asaj vere, por ato janë britma të një zemre të plagosur thellë nga humbja e një miku shumë të shtrenjtë, e ish-shokut të ngushtë të gjimnazit e të universitetit. Autori nuk vajton, sepse dëshmorët për lirinë e atdheut nuk qahen: akti i tyre gdhendet në kujtesën e mbarë kombit që lufton për të shporrur pushtuesin, shembulli i tyre bëhet burim frymëzimi, ata vetë kalojnë në amshim.

17.- “... për liri asht vramun” (Emin Durakut, janar, 1945)

Janë dy shkrime të Qemalit kushtuar këtij dëshmori:

Shkrimi i parë, një poezi në prozë, një apologji kushtuar ish-shokut gjimnazist, të vrarë tradhtisht. Me një lirisim të thellë e, me një gjuhë poetike të pasur e plot muzikalitet, ai përcjell dhimbjen e sinqertë të vetën, si dhe bindjen se emri dhe akti i tij do të mbeten të paharrueshme, se ai do t'i kalojë pavdekësisë.

Shkrimi i dytë, pa titull, përmban kujtime të mirëfillta të njohjes me të si bashkëstudentë e njëheri si shok i veprimtarisë klandestine. Ishte ndër të shumtë i trishtuar për ririnë plot vuajtje të këtij biri të Kosovës së martirizuar nga sundimi serb, sikurse ishte ndër të shumtë i kënaqur që kishte pasur pranë një shok më të pjekur e me shumë eksperiencë.

18.- “Në shtëpi tonë nuk këndon ma kush.” (2 nëntor 1945)

Shkrimi duhet të renditet ndër shkrimet e fundit të autorit. Tema dhe fryma e shkrimit të kujtojnë dhe shkrime të mëparshme të autorit, veçanërisht shkrimin “Sprov’e parë”, me të vetmin ndryshim se në qendër të tij nuk kemi vetë autorin me dhimbjen e tij: tani protagonistja kryesore është nëna e tij. Ajo është lodhur nga humbjet e njëpasnjëshme të njerëzve më të dashur, goditje që i sollën dëmtimin e vazhdueshëm të shëndetit, duke i afruar vdekjen. Autorit, ndonëse zemra nuk “i ndjente mirë” as për veten, në ato kohë të trazuara, nuk ia merrte mendja se e ëma, “nana e eme e shejtë” që kishte nevojë “për pagjë e për qetsi”, pikërisht pas 10 muajsh, do të përballlej me ankthin traumatizues të arrestimit të tij, që do të kulmonte me një martirizimin tragjik. Kontrasti me atmosferën e gëzimit të komshinjtë e bën më të dukshme e më të perceptueshme gjendjen shpirtërore të autorit, i cili vazhdimisht ka shprehur ndjeshmëri të madhe ndaj prindërve e veçanërisht ndaj së ëmës, për shkak të së cilës shkrimi i mësipërm është shumë i ngarkuar emocionalisht.

## II. LOTË T E TRISHTIMIT

### 1.- “Fjal’ e fundit “ ( gusht, 1939)

Në qendër të tregimit është vendosur një i ri në prag të vdekjes. Rrëfimi i tij ishte prekës, jo vetëm që po shuhej në lule të rinisë, por dhe pse jeta që dorështrënguar me të e nuk i dha veç mund e lodhje që e mposhtën. Lexuesi përjeton ankthin e fatkeqit që në varr e përtej do ta gllabërojë zbrastësia e errësira. Është i lexueshëm nënteksti i tregimit si një protestë e singertë dhe e ndjerë e autorit, e njeriut që e do jetën dhe që njëheri vuan shpëtërisht për viktimat e mjerimit në shoqërinë e kohës.

### 2.-“Deka”( 4 gusht 1939) – ditë zharritse –

Autori përjeton në mënyrë virtuale një përballje me vdekjen e personifikuar duke u përqendruar te monologu i saj. Përdoren një varg enumeracionesh, ku autori përdor ngjyrat më të errëta dhe skenat më tronditëse për të dhënë, në lakuriqësinë më vrastare, realitetin makabër të vdekjes.

### 3.- “Natë “ ( 9 gusht 1939 – Imperitus)

Autori ka zgjedhur, si gjini letrare, prozën poetike për të na përcjellë, përmes një figuracioni të ngjeshur, përjetimet e pashlyeshme dhe të fuqishme që i sjell nata. Esklamacione të njëpasnjëshme ndiqen nga attribute të ngarkuara stilistikisht e që jepen në një “crescendo” që, nga tone të ulta e të qeta, kalon në ato të larta dhe të ashpra si përkufizimet e tilla: “frigë – tmerr, syntezë hataje së re”, “natë – vdekje, dyshe e pandashme tragjike”. Zymtia e shkrimit është në sintoni të plotë me frymën e krejt ciklit.

### 4.- “S’kam vra “ ( 1939 – Imperitus) - Verë përvëluese, natë e terrshme –

Telajoja e shkrimit është thurur duke paraqitur shfaqjen e një fantazme, që justifikon pyetjet provokuese deri në absurd dhe përgjigjet negative të rastit. Në të vërtetë kemi të bëjme me një vetëhetim të stisur, të kërkuar me të vetmin qëllim që të krijohej atmosfera e duhur për të bërë rrëfimin e së vërtetës së madhe: zemra e tij është e plagosur, duke lënë të nënkuptohet se cilat janë shkaqet dhe... shkaktarja!

### 5.- “Ah, mos , pashë nj’atë vaj që t’grini!” (verë 1939- Imperitus)

Mes një dëshpërimi të thellë, në një mbrëmje vere, në orë të vona, autori u kërkon ndihmë dhe ngushullim netëve të heshtura, ndriçuar nga drita e hënës dhe e yjeve, si dhe të drurëve të kopshtit. Nuk ishte e thënë që ai të gjente prehje: me këngët e tij, kalimtari i vonuar ia shton dhimbjen dhe vajin. Vargjet e atyre këngëve evokonin vuajtjet e travajët që, ndër shekuj, pushtues të ndryshëm, ua kanë sjellë bashkatdhetarëve të tij. Shumë gjak e lotë është derdhur, shumë pezëm e urrejtje kanë mbushur shpirtërat e mbarë fisit. I vetmi shpëtim për autorin ishte që t’i lutej këngëtarit ta

pushonte atë këngë vajtuëse. Dy janë mesazhet: është i thellë helmi i këngëve popullore, sepse i tillë që kalvari shekullor i popullit; ato këngë mbeten të shtrënjta për ne.

6.- “Arsyetuesi” (gusht, 1939)

Autorit dhe bashkëmoshatarëve të tij, u duhej të përballoheshin me dilemat e jetës. Për ta bërë më të qartë këtë problematikë, autori ndërton një përrallë, me anë të së cilës kërkon të përcjellë idenë e qartë se jeta mund dhe duhet të përballohet vetëm kur njeriu udhëhiqet nga arsyeja, kur e kupton se tragjikja dhe komikja janë elementet e saj të përhershme që alternohen. Le të kujtojmë vargjet e pavdekshme: “Ridi pagliaccio!”.

7.- “Mëshirë” (gusht, 1939)

Shkrimi është hartuar nën ndikimin e vargjeve të njohura, prandaj silltet referenca “...nuk e dijshe se grushti yt i tmerrtë mbyt pa mëshirë”. Me këtë revoltë të brendshme ndaj një realiteti që e përbuz, e urren, ai s’do ta mbajë dufin që i ther në shpirt dhe prandaj shfren me një mllef të tillë: “Nën peshën e një name, e një kobi...përulet para – katileskobzezë, të pamëshirshmes jetë që ta mëshirojë ...”

8.-“Kontrast”( prill 1940 – Imperitus)

(S.-a K.-it )

Në pak radhë jepet ballafaqimi i një palë syve ziliqarë, të etshëm e hetues me një palë sysh të qeshur, shprehje lumturie e magjie, pasqyrë vetëkënaqësie. Ballafaqimi ndiqet dhe nga ai gjendjeve shpirtërore të dy vetjeve, atij dhe asaj: njëri – i pashpresë, i pangushëlluar, tjetra – shpirt i njomë, plot ëndrra. Është e qartë se përmes këtyre portretizimeve tepër konçize, dhënë në stil “telegrafik”, pasqyrohet gjendja emocionale e autorit të dashuruar që vuan në heshtje.

9.- “Një shikim” ( 15 maj 1940 ). Mesnatë, Tiranë

Portretizim me të vërtetë mbresëlënëse i një djaloshi 20 vjeçar, ulur në cepin e një tavoline kafeneje, me flokë mbi fytyrën e zbehtë, me kokën e turbulluar midis grushtave, shprehje e një dëshprimi të madh. Shikimi i syve të tij është domethënëse: “shikimi i habitun i një të harlisuni të praksuem, si i një fëmije të trembun në shtëpi të huej, plot pezëm e trishtim, si mllef e uzdajë e pashfaqun, një shikim i gjelbër si gjelbrim urrejtjeje sublime”. Përmes këtij portretizimi, autori pasqyron trishtimin e vërtetë të vetin, të cilin e përballoi gjatë ditëve që kaloi në kryeqytet, me pikësynimin e vetëm, të porealizuar, që të takonte S-ën.

10.- “Fortuna” ( maj 1940 – Imperitus)

Një përshkrim shumë realist i dhënë përmes një prozë poetike, frymëzim i autorit nga përjetimi i shpërthimit të një shtrëngate të furishme në një ditë maji. Stuhia jepet në dinamikën e saj, duke filluar që nga

shtëllungat e zeza që vijnë nga “gryka” midis Kalasë e Taraboshit dhe përgatitën përplasjen e elementeve natyrore, si dhe me atmosferën mbytëse të shkatërrimit, çorodisin jo vetëm shpendët por dhe njerëzit.

#### 11.- “Letra” ( korrik 1940 – Imperitus)

Një tregim ose një novelëz, në qendër të së cilës është vendosur Meli e mplakur që, pas njëzet vitesh, lexon përsëri letrën që djaloshi i zemrës i kishte dërguar asaj nga vendi ku studionte, që prej dy vitesh. Në letër kujtohej momenti i takimit, një buzëmbremje, kur ai e kishte shoqëruar pas një këmbënguljeje të fortë. Shtrëngimi i duarve pati shënuar fillimin e një idili, i cili vazhdoi deri në atë mbrëmjen me shi, kur Meli iu pat përgjigjur ftohtas: “Më lë të qetë!”. I zhgënjyer, ai u largua për studime, por letra që prova se ai nuk e kishte harruar ish-studenten e vitit të dytë. Melit i kujtohen dhe shkaqet e ftohjes: thashethemet, praku i fejesës së saj etj. Nisur nga “Ditarët” e Qemalit dhe letërkëmbimi, kuptohet se, tërthorazi, shkrimi i bën jehonë asaj gjendjeje të trazuar shpirtërore të tij, të atyre muajve, çka e dëshmuar dhe shkrimet që prinë nga pas.

#### 12- “Qaj, oh, qaj...” (gusht 1940- Imperitus)

Është kënga e trishtuar dhe e përvajshme e një këngëtarit kalimtar që i jep shkas autorit të shprehë reagimin e vet ndaj fatit të tij të palumtur. Është një mori emocionesh që i ngjallen dhe ai do t’i shfaqë me një vargëzim apostrofash, mbushur me epitete etribute të larmishme, pasuar nga enumeracione e përsëritje që shkojnë në ngjitje dhe që do t’ia drejtojnë këngëtarit.

### III. “ F L E T Ë T Ë S H P Ë R N D A M E ” ( proza)

#### 1. “ Lamtumirë ” ( nanduer 1938 – Malseni)

Përrshëndetja e fundit e një të sëmuri, në prak të vdekjes: monolog i gjatë, ku me një përshkrim shumë të hollësishëm, pa anashkaluar as detajin më të vogël, na përcillet kursi normal i një procesi tuberkular shumë të përparuar, madje përtej pikës kritike, mu në çastet e fundit të jetës. Detajet janë mbresëlënëse, sepse ecuria e keqësimit hap pas hapi e sëmundjes të sugjestionon me lakuriqësinë e saj, sikur ajo e një tablojeje veriste apo natyraliste. Vetvetiu të lind pyetja se si një i ri, pothuaj adoleshent, arrin të të përcjellë një realitet të tillë: eksperiencë vetiake nga ndonjë i sëmurë i afërt apo ndikim nga leximet?

#### 2.-“ Lotë dhimbe”(korrik, 1939, Malseni)

Kur bijnë viktimat!

Fabula, shumë e thjeshtë: një nënë shumë e varfër “shet” vajzën 16 vjeçare, Myneverin, e fejon me një burrë të pasur e në moshë të madhe. Vajza fatkeqe nuk e përballon dramën e saj dhe shuhet pa e shijuar jetën. Përmes fatit të keq të protagonistes, autori qan për fatin e keq të shoqeve të

saj “robina”, viktimë të padrejtësisë së një shoqërie, kulti i së cilës ishte paraja. Qëndrimin e vet kritik autori na e evidenton përmes kontrastit të madh midis shëmtisë fizike e morale të antagonistit me pafajsinë e freskinë virgjinore të viktimës, midis lakmisë epshore të poseduesit dhe pafajsisë së ëndrrave rinore të vajzës. Në diagnostikimin e kësaj plage shoqërore, ndonëse nuk i kursen qortimet për nënën e vajzës, ai është i ndërgjegjshëm se dhe ajo është viktimë. Antihumanizmi i kësaj shoqërie ku sundon paraja, me pjellën e saj, varfërinë, është i tillë sa çorodit ndjenjat e një nëne! Intensiteti i dhimbës së autorit është kaq i madh sa nuk e lan as rrebeshi i furishëm i një dite vere. Jehona e këtyre krimeve “ka për të mbetur pezull në ajr”, si një kujtesë tronditëse për ndërgjegjën e munguar të asaj shoqërie. Jo vetëm tema, por dhe tonet e larta emocionale të tregimit, ngarkuar stilistikisht me figuracion, janë provë e pozicionimit të përhershëm të prerë e dinjitoz të autorit në favor të emancipimit të femrës shqiptare.

*Shënim: E. Draçini ka lënë një përshtypje të tijën: “Ka gjasën e një fjalimi mortuer apo të një hartimi klase mbi vorrin e rinisë së...”*

### 3. “Idyle të shkyeme”( gusht, 1939 – Imperitus)

I. Përmes rrëfimit të protagonistit kryesor, student universitar, marrim vesh se si e kujtonte takimin e fundit me vashën e zemrës. Ai do të përsëriste me hollësi si e kishte përjetuar ajo atë ças tronditës, duke mos harruar gjakftohtësinë e kthjelltësinë e këshillave që i pat dhënë ajo në lidhje me sjelljen e tij larg vendit, pasi e pritnin situata e njohje të reja; njëkohësisht ai duhej të mos harronte njerëzit e tij, sikurse dhe atë vetë.

II. Në vazhdim të pjesës së parë, jepet “ana e tjetër e medaljes”: çfarë i solli jeta fatkeqes së harruar. Ajo tashmë është fejuar pa dashuri. E ardhmja e saj nuk është premtuese, por duke u gjendur në mes të një mjedisi natyror të qeshur e të magjishëm, ajo e ndjen veten të lirë të prehet në krahët e fantazisë. Nën efektin e kësaj klime me frymëmarrje jetëdhënëse, ajo do të jetojë çaste vegimesh të ëmbla që lidhen me të kaluarën e bukur. Sidoqoftë realiteti i pranishëm është ndryshe: i ftohtë, i ashpër, i hidhur.

### 4.-“Jetimi i vogël”( gusht, 1939 – Imperitus)

Protagonisti kryesor i skicës: Agimi, jetimi i vogël, i cili ka braktisur shkollën, i ati i ka vdekur, kurse e ëma është e sëmurë. Çdo ditë del heret në punë, në pazar. Sëmuret dhe vdes pas pak. Tronditëse skena e skicuar: nëna e sëmurë mbi kokën e djalit të vdekur! Nënteksti: jetimi, një viktimë më shumë në luftë për “bukën e përditshme”. Të nesërmën do të fillonte punën “Agimi” i ri: një fli e re e së ardhmes!

### 5.-“ Dënimi”( gusht, 1939 – Imperitus)

Protagonisti është prototipi i burrave imoralë që tradhetojnë gratë e tyre, njëkohësisht dhe prototipi i etërve amoralë që s’merakosen për fëmijët

e tyre, shëmbulltyra e njerëzve egoistë e të pandërgjegjshëm që janë njollë e zezë për shoqërinë. Dënimi i tyre është i merituar dhe në dobi të shoqërisë, sipas fjalës së urtë popullore, “korrën, ç’mbollën”. Paraqet interes fakti që autori, në një moshë kaq të re, nuk heziton të trajtojë dhe tema të tilla shoqërore me mesazhe edukuese.

6.-“ Prostituta“ (gusht, 1939 – Imperitus)

Autori rrëfen episodin: Natë e vonë. Në gjysmë errësirën e lulishtës të tërhiqte vemendjen veshja me të zeza dhe ecja e ngadaltë e një gruaje të vetmuar. Kishte një fytyrë të hijshme që të ngjallte dhimbje e mëshirë, sepse shoqëria dhe njerëzit dukej se e kishin keqtrajtuar. I lindi dëshira instinktive ta pyeste për hallin që kishte. Fytyra e saj ndërroi pamje. Zotëroi buzëqeshja, një buzëqeshje e stisur. Vetë ajo përshëndeti dhe ai u befasua. I a përsëriti pyetjen, por ajo prerazi i tha: “Nuk qenke si të tjerët” dhe iku. Më vonë u kthye çift duke qeshur pa pushim. U kuptua gjithçka!

7- “Vegime”( tetuer, 1939 – Malseni)

Përshkrimi i një ëndrrë të llahtarshme me ngjyrat më tronditëse: një ankth i papërshkrueshëm kur kërkohet dalje nga një labirint nëntokësor. Kulmi i skenës makabre është shfaqja e “Dekës”, në trajtën e skeletit klasik shoqëruar me kosën legjendare. Fjalët e “Dekës”, tejet arrogante e ku përzihen helmi e fodullëku, shprehin një realitet të hidhur, lakuriqësia e të cilit të kallë tmerr. Këto vegime të pakëndshme e të përzishme, të pranishme herë pas here dhe më vonë, e që përcjell ky djalosh 17vjeçar, tingëllojnë mjaft ogurzeza.

8.-“ Me rasë të një deke”( prill 1940 – q.d.)

Një lamtumirë e fundit te varri i një djaloshi të ri anonim, sportist i dalluar, pjesëtar i ekipit shkodran të futbollit. Qe viktimë e një vrasjeje mizore. Vajtohet shoku i dashur, vajtohet futbollisti i talentuar, vajtohet një djalë i nderuar i Shkodrës.

9. “Tok’e re” (qersht, 1940 - Imperitus)

Një prozë poetike ku përmes një figuracioni të ngjeshur artistik na përcillet drama e njeriut që lufta për jetën e detyron të kërkojë shtigje të reja për të mbijetuar, duke hedhur pas shpine çfarë e lidhte me familjen, të afërmit, vendin dhe pa menduar se dhe atje e priste e panjohura dhe...vetmia.

10.- “Kosovarja” (qersht, 1940 – Imperitus)

Që në fillim duhet të sqarohet se përkatësia krahinore e protagonistes është fare e rastësishme, sa për t’i dhënë tregimit dukuri të realizmit përmes hollësive konkrete. Jemi larg hamendësimit se ka aludime për fatin e kosovarëve si viktima të persekutimit etnik. Jo titulli por

nënteksti përmban mesazhin se këto “fatzeza”, pavarësisht përkatësisë, janë viktimat e një shoqërie me moral të diskutueshëm, ku paraja e padrejtësia bëjnë ligjin.

11.-“ Tue ndij – Il vero amore, il piu bello...-“( tetuer 1940 - Imperitus)

Në qendër të prozës është portretizimi ideal i një vashe me fytyrë engjëjlore, me sytë e kaltër e të magjishëm, me dy buzë të etshme, shija e të cilave ia kalon dhe nektarit të luleve. Një hymn kushtuar dashurisë, një vargëzim figurash, një alternim epitetesh, metaforash e krahasimesh që prozës i japin karakter poetik.

12.- Skeç- komedi (pa titull – 1944)

Skena: zyra e redaksisë së rev. “Fryma”

Personazhet kryesorë: një çift bashkëshortësh, një vizitore

Tema: Emancipimi i femrës, keqkuptimet

Ideja kryesore: Emancipimi nuk është zhvendosje rolesh në familje e në shoqëri.

Subjekti: gruaja bëhet prepotente dhe arrogante në familje: kërkon të ndryshojë rolet me burrin.

#### IV. NOVELA

1.-“Tek vorri i heshtun i kujtimeve të zbrazta të Rinis së Parë”

Nga ditari së kaluemes

*Shënimi ynë: Mungon data dhe nënshkrimi(Malseni ?!).Mbështetur te shënimi anësor i vetë autorit, te vetë natyra e shkrimit, madje dhe te vetë kaligrafia e përdorur, kemi të drejtë të supozojmë se kemi të bëjmë me një krijim të fillimit të ditarëve, pra fillimet e vitit 1938.*

Protagonisti kryesor është vetë autori, kështu që rrëfimi personalizohet. Në qendër të novelës është dashuria e zjarrtë mes dy të rinjve, fatkeqësisht e shkurtër dhe e pafat. Madje ajo ka një fund dramatik: e dashura përfundon në një spital psikiatrik për një gjendje depresioni, nga shkaku i largimit të të dashurit.

2.-“Pranë do vorreve të vetmueme”(nanduer 1938 –Malseni)

- Shokut S.T.,dëshmitar besnik i asaj sqeneje të vërtetë –

*Shënimi ynë: autori i kujton redaksisë( ?!) se ky është shkrimi i dytë për botim pas atij për Migjenin.*

Natë pranverore, shëtitje buzë një lumi të vogël, mbi sipërfaqen e të cilit reflektohej hëna. Befas një britmë e thekshme aty diku midis varreve. Ishte vaji shumë prekës i një nëne që çante heshtjen e natës. Papritmas, nga larg, një melodi e ëmbël. Kontrasti i fortë i trondit dy shokët: padashur u bënë dëshmitarë besnikë , por fatkeqë, të një skene dramatike, në fakt një tablo tragjikomike e jetës reale të shoqërisë.

## 3.- “Pendimi”(dhetuer 1938 – Malseni)

Në një qeli të lagështitur e të pistë ka përfunduar protagonistin, të cilit i dalin parasysh pamje tronditëse, ku alternohen çaset e bukura të dashurisë me Lenën, huret e së cilës e kishin tërhequr aq shumë, me skenën e tmerrshme të tradhtisë, nën efektin tronditës të së cilës, për shkak të “turpit” e të xhelozisë, do të vrasë gruan mëkatore. Tabllotë halucinante e shoqërojnë pandërprerje dhe në qendër të tyre janë tiparet e Lenës. Fillon ta vrasë ndërgjegjja aq shumë sa do të ulet në gjunjë për t’i kërkuar të falur hijes së fanitur të viktimës. Nga mungesa e një përgjigjeje, do të pësojë një krizë të fortë nervash: nga e qara do të kalojë në një të qeshur të madhe papushim dhe... do të çmendet. Tema është e qartë: brishtësia e ekuilibrit psikik të njeriut nën efektin e emocioneve të forta, ndërsa ideja që përcillet tingëllon si denoncim i normave primitive e konservatore të moralit patriarkal.

*Shënimi ynë: autori ka vënë një postscriptum ku shkruhet: “për t’u botue në numrin e të së djelës së të përditshmes(?!)”*

## 4.-“Gjuetarja”(qershuer, 1939 – Malseni)

Protagoniste: macja. I hollësishëm dhe plot dashamirësi përshkrimi i saj: shprehje e dashurisë për kafshët, provë delikatese shpirtërore që buron nga ndjenja fisnike që i kundërvihen egërsisë, brutalitetit, arrogancës që njerëzit shfaqin në jetën e përditshme .

## 5.-“Stuhi që ndan”(qershuer, 1940 – q.d.) Sp.Tr.-it

Tregimtari-protagonist, pas vdekjes së nënës, ndihet i vetmuar, i braktisur. Kur i kishte humbur shpresat, iu gjet vetja e adhuruar që do t’ sillte qetësinë dhe lumturinë. Janë çaste euforie ato të njohjes së shokut, me të cilin u lidh së tepërmi: u bënë miq e shokë, lidhën besën për të luftuar me trup e shpirt në përballje me sfidat e jetës. Kjo gjendje ekstaze s’do të zgjaste: shpërtheu “stuhia” e papritur, u shpërndanë, vetë iku, shoku jo, ngeli për t’u bërë pjesë e “stuhisë” së drejtësisë, “luftës së amshueme të shekullit të ri”. Vetë u përpoq ta përqafoje sërishmi shokun qëndrestar, i papajtueshëm ashtu si dhe “stuhia” që nuk zbutej. Novela mbyllet me tabllonë finale: shoku fitimtar, i rrethuar nga viktimat e stuhisë së jetës, ka përballë këtë të mundurin, të padenjtin si njeriu që iu shmang luftës. Rrugët e tyre u ndanë përfundimisht! Veprimi në novelë vendoset në rrafsh të ndryshme kohore si dhe në rrafsh të ndryshme të pasyrimit të jetës. Në rastin e parë kemi përballë një takim i kohëzgjatjes së duhur të reduktuar me “historinë” e miqësisë me hapësirën disa vjeçare; në rastin e dytë, takimi i dy ish-miqve është një shfaqje e zakonshme e jetës reale. Ndërkaq dukuria “stuhi” fsheh virtualisht dramën e vërtetë të një shpirti që e kërkon, e gjen dhe e humb miqësinë e ish-shokut të bankës. Nuk është



hera e vetme që autori përcjell të vërtetën e kësaj ndarjeje të papritur: veçanërisht janë mjaft data në “Ditarët”, ku shënime të hollësishme i referohen tronditjes së thellë të autorit për këtë humbje.

6.- “Foglia al vento” ( korrik, 1940 –q.d.)

Tema e femrës që bie viktimë e prostitucionit është trajtuar disa herësh nga autori. Kësaj radhe, në qendër të vëmendjes, është drama e një vajze të huaj, e një napolitaneje. Në një punim të mëparshëm të Qemalit me karakter studimor, u patën trajtuar dhe motivet e kësaj plage shoqërore. Njëra nga këto shkaqe kryesore, ishte dhe gjendja ekonomike e mjeruar e familjeve me shumë fëmijë dhe prindër invalidë. Pikërisht shkaqe të tilla e detyruan dhe protagonisten e novelës që t’i hynte kësaj rruge që në moshën 15 vjeçare. Flijimi i saj fiziko-moral qe kaq prekës sa “klienti”, një student universitar shqiptar, i ra në gjunjë, i mallëngjyer, për t’i lehtësuar dhimbjen, njëheri për ta mbështetur në këto momente. Përlulja e tij para Çekitës, të kujton përluljen e Raskolnikofit para Sonjas, “përlulje para vuajtjes njerëzore”.

7.-“ I ikuni”( korrik, 1940 – Imperitus)

Shtegtari, i lodhur nga udhëtimi i gjatë, u afrohet me kujdes varreve të fshatit të largët: kujtohet për një ngjarje të dhimbshme të hershme, kalon muret dhe shkon pranë një grumbulli dheu, pikërisht te varri i viktimës, të cilit po i humbisnin dhe shenjzat. Ka një takim të rastit me vëllanë e viktimës, shumë të mallëngjyer, me anë të të cilit u dërgon një “mesazh” njerëzve të viktimës. Fati i femrës shqiptare dhe trajtimi i saj sipas normave kanunore, është një temë e rrahur herëpashere prej autorit, kështu që dhe kjo novelë bën pjesë në këtë përpjekje të tij për shërimin e kësaj plage shoqërore. Për ta bërë më të kapshëm mesazhin e shkrimit, ai përdor kontrastin në mes mbrojtësve të verbër të kanunit që s’tërhiqen as para kriminit, si dhe dy viktimave: vajzës fatkeqe e jetëshkurtër dhe djalit të frikësuar që arratiset.

8.- “Çupi” (18 prill 1941 – Imperitus )

Takimi më shokun Xh.K. i krijoi shqetësim: ai u paraqit i ngrysur dhe i heshtur, nuk u përgjigjej as pyetjeve të njëpasnjëshme. Më në fund e prishi heshtjen me një përgjigje të prerë: “Çupi, po ikë!”. Fjalët ngushëlluese s’patën efekt. Më vonë, ai u zhgreh në një rrëfim të plotë për bukurinë trupore, po që po, por dhe për atë shpirtërore. Sytë e saj oblikë e ndiqnin në orët e mësimin, vegimi i tyre s’iu ndante, ashtu si nuk iu ndante jehona e zanit të saj të veçantë: një korçare e sinqertë. Kur u bind se e dashuronte me gjithë mend, do të martohej sa të mbaronte shkollën. Pikërisht në këto momente u muar vesh ikja e saj: një zbrastësirë e madhe për shokun, ishte dashuria e parë! E kuptonte brengën e shokut: pak ditë më

parë autori e kishte njohur personalisht protagonisten, e cila i kishte lënë përshtypje si për paraqitjen e jashtme, për mprehtësinë dhe spontanitetin e saj. Ngjarjet janë kaq reale sa që disponojmë dhe dy shënime të vetë autorit në lidhje me to.

Në një anëshkrim të mëvonshëm mbi fletën e novelës lexohet:

“Portretizim i shokut Xh.K., vdekun kallnuer 1943”. Në anën tjetër, në shënimin e dt.13 prill 1941,” Ditari 3 “, Qemali ka bërë një përshkrim të gjatë të takimit të vet me atë femër të pafat që pabesitë e pangopësitë e meshkujve e kishin detyruar të ushtronte prostitucionin. Autori i mbetet konseguent qëndrimit të tij të përparuar humanitar. Lexojmë disa fragmente:

“ Sot kam njoftë Çupin. Shumë simpatike, nga Korça, një të qeshun i kristaltë, dy sy të kulluet e të mrekullueshëm.... Ndiq zemrën plot dhimbë e simpati për të.... M’u lut që t i shkoj një ditë me ndejë e me ligjërue...Flet shumë mirë italishten. Ka një shqiptim të veçantë të tingullit “ s”...Do t’i çoj libra.”

9.- “Shoqeja”( korrik, 1941 – q.d.)

(Është novela më e gjatë: një fletore e tërë ku mungonjë disa faqe të fundit. – shënimi ynë)

Tema: Martesa e dy të rinjve me besime të ndryshme fetare dhe reagimi i mjedisit konservator e fanatik. Ideja kryesore: Dashuria e vërtetë mposht çdo vështirësi.

Personazhet kryesore: djali i një tregtari mysliman të pasur dhe Marija, normalistja katolike.

Subjekti: Djali, ndonëse ka përfunduar gjimnazin, nuk lejohet nga i ati të vazhdojë studimet jashtë, por e angazhon me drejtimin e dyqanit. Pasi ka ndjekur Normalen në Tiranë, Marija do të vazhdonte në Shkodër. Familjet e dy të rinjve ishin komshinj prej vitesh dhe ishte lidhur një miqësi e vërtetë. Djali befasohet nga takimi me Marijen pas 6 vitesh, e cila kishte pamjen e një zonjushë. Fillojnë ëndërrimet që kulmojnë me një afeksion të plotë të djalit, i cili do të bëjë hapat e para duke e shoqëruar. S’do të vonojnë dhe hapat më të guximshëm, deri te deklarimi i hapur i dashurisë. Pas hezitimeve të rastit, Marija mposhtet. Fillon konflikti babë – djalë, më në fund çifti martohet pa lejen e prindërve. Braktisen familjet e të dy palëve, fillohet jeta e re. Djali mbetet i papunë, jetohet me rrogën e vogël të Marijes. Thyhet vullneti i djalit, kërkohet divorci. Janë fjalët e Marijes që e prekin thellë djalin. Bëhet pajtimi. Fatmirësisht ai gjen punë në një komunë malësie. Përcillet nga Marija, e cila i jep dhe një letër, por që për fat të keq, fletët e fundit mungojnë. Trajtimi i një teme shoqërore në mënyrë realiste,

pavarësisht zgjidhjes së “gjetur”, duhet të vlerësohet si një kontribut i Qemalit në afirmimin e mëtejshëm të modernizimit të novelistikës sonë të re filluar me Koliqin.

10. “Tramë për një roman”( dhetuer 1943 – q.d.)

Personazhet:

Bardhyl Luzha, nga një qytet verior: ka mbaruar gjimnazin

Drita Krusheva, nga Voskopoja, normaliste e kl.X

Subjekti: dy të rinjtë dashurohen. Takimi premtues i djalit, dorëzimi i unazës. Studimet në Firence shoqërohen me joshjet e rastit. Njohja me Lizën piktores: puthjet e para, shëtitja në S.Gemignano, posedimi i Lizës. Jeta e natës kërkon shumë shpenzime, pengon studimin, humbën provimet. Kthimi në Shqipëri shoqërohet me zhgënjimet e Dritës. Përsëri në Itali por Liza është shkëputur. Çaste dëshpërimi. Me sugjerimet e një njohjeje të re, një “signora” e moshuar, ndjek fakultetin e drejtësisë, diplomohet e kthen në Shqipëri. Afrohet me Dritën, martohen. Në fillim nuk ka sukses në karrierë, i shmang “çështjet me probleme”. Fiton reputacion me fitimin e çështjes në “gjqin e gruas së divorcuar me një djalë pa babë”. E zotëron etja për para dhe për lavdi, ftohet me Dritën. Fillon relacionin me “zonjën e pasur” të gjyqit të fituar. Drita sëmuret dhe vdes. Rritja dhe edukimi i djalit pa nënë i nxjerr probleme: “lufta e brezave”. Djali njihet me një vajzë, lejen për fejesë i ati s’ia jep. E përcjell djalin për studime. Ndihet i vetmuar: kujtohet për Dritën, i dërgon një tufë lulesh te varri. Dy pika lotë dhe zbrastësi.

11.- “Trama për një novelë”(nanduer, 1944 – q.d.)

Tema: Femra shqiptare, viktimë e normave të kanunit

Ideja kryesore: E drejta e ligjshme e femrës për të qenë e lirë e për ta gëzuar jetën.

Protagonistët: vëlla e motër nga malësia, djali - i shkolluar jashtë, motra -ngelur shtatzënë; mësuesi i fshatit–i dashuri i saj, babai i foshnjës

Subjekti: mësuesi i fshatit u detyrua të dilte në mal për të luftuar kundër pushtuesve italianë, por “fëmijën” ia kishte lënë “amanet” së dashurës, me premtimin se kur të kthehej fitimtar, do të sqarohej situata me familjen. Ai u vra në luftë dhe kjo e komplikoi çështjen. Familja dhe i vëllai e kuptuan gjendjen e bijës së tyre. Robër të kanunit, ata s’mund ta duronin turpin e “çnderimit”. Kishte vetëm një zgjidhje: vrasjen e vajzës. U ngarkua i vëllai, i cili pas shumë dilemash e presionesh së gjithanshme, sidomos të së ëmës, e mori armën. Skena e përballjes me motrën është shumë dramatike: në gjuhë, ajo kap duart dhe i lutet ta shtyjë dënimin deri pas lindjes, sepse donte ta mbante fjalën e dhënë “ditë-shkurtit”. Mallëgjimi e mposhti vëllanë.

## V. POEZI ORIGJINALE

a.) reflekse :

1.- “Pritje – litani “ (pa datë – q.d.)

(Shënim: origjinali është në italisht, përkthyer në shqip nga E.Draçini.)

Ashtu si vetë terma fetare “litani”, vënë si nëntitull, edhe vetë pëmbajtja, të tingëllojnë si “paradoksale” për një ateist si autori, sepse për të pasur “litani” duhet të kemi dhe “zotin”, por këtu duket kemi ëndërrimtarin që e krijon vetë “zotin” sipas shijes së vet dhe larg traditës. Poezia shoqërohet me një shpjegim të gjatë të autorit dhe fillon kështu: “S’asht poezi, ma mirë me thanë asht dështimi i një poezie...Atë natë ...të ndoqa...derisa hija jote u zhduk...- I shkrova këto vargje për ty...Oh, sa shumë dëshirova të të kisha atë natë! Sikur ta kishe ditë ti!”. Një poezi homonime, po me të njëjtin titull, është botuar te përmbledhja ‘Era’ dhe mban datën 30.3.1944. Trajtojnë të njëjtën temë: trishtimin e poetit të vëtmuar. Ndryshimet janë dy: në gjuhë (njëra shqip, tjetra italisht) e në kohë (kjo e dyta duhet të jetë shkruar më parë, në Itali). Ndryshimet janë dhe në sasinë e vargjeve dhe në metrikë.

2.-“Lajmëtarët e stuhisë”(6 shtatuer 1943 – q.d.)

“Stuhia, stuhia, gërthet/ Lajmëtari tue sundue/oqeanin në dallgë.- M.Gorki”

Poezia jostrofike, vargu i përzierë, rima jo e rregullt. Ndihet qartë ndikimi i Gorkit, jo vetëm për analogjinë në titullin e poezisë, por për vetë frymëzimin poetik, katërcipërisht i romantizmit revolucionar “a la gorkian”. Me siguri motivohet nga klima shpërthyesë e atij viti, kur sapo kishte kapitulluar Italia, si dhe ndikimet e hershme nga literatura e majtë dhe ajo klandestine.

3.-“Veritas” (dhetuer 1943 – q.d.), - dy variante –

Poezia është në varg të lirë. Mbizotërojnë tonet e hirta të dëshpërimit, të zhgënjimit, të humbjes së shpresës. Refreni zotërues: “Jeta e njerëzve, shtegtarë n’mjerim, s’vlen mundin me e jetue “. Ky pesimizëm kushtëzohej jo vetëm nga shqetësimet vetjake të poetit, por edhe nga situata e trazuar që po kalonte vendi dhe bota.

b.) në frymën e poezisë popullore:

1.- “Natë me hanë” (pa datë) - e papërfunduar

Atmosferë sentimentale, psherëtima e lektisje shpirtërore nën rrezet e hënës.

2.- “M’dridhet buza” (pa datë)

Ndikime të lirikës erotike popullore jo vetëm në frymën e saj, por edhe në figuracion (apostrofa, metafora), por dhe në strukturë (vargu, rima): pesë strofa katërshe me varg tetërrrokësh, me rimë të alternuar. Në strofën e parë ka ndonjë pasaktësi metrike

3.- “Para ledheve të kalasë s’Ulqinit” (5 kallnuer 1943) – *e papërpunuar*

Duhet të jetë shkruar nën përshtypjet e drejtpërdrejta të ndonjë vizite të rastit në këtë qytet aq të lidhur tradicionalisht me Shkodrën, bashkimi i të cilit me shtetin amë i pat sjellë autorit një entuziazëm të veçantë (pasqyruar qartë te “Ditarët”), evokim i të kaluarës së lavdishme, e cila vihet në kontrast me harresën e pamerituar. Shkruar në varg tetë rrokësh, me rimë të alternuar.

### **Unpublished writings of Qemal Draçini**

#### ***SUMMARY***

Qemal Dracini’s book “Era”, published in 1995, is a collection of his best works, which were skillfully edited by his brother Enver Dracini. This publication had a strong impact on the cultural and artistic life of the country.

It is thanks to this book, that one can get a first insight into the research and creative work of Qemal Dracini. His work is held in high esteem for its dimensions and messages.

Arben PRENDI

## VEPRA LETRARE E RIDVAN DIBRËS/ KONTRIBUT PËR LETËRSINË SHQIPTARE

### Të dhëna mbi jetën e veprën letrare

Autori Ridvan Dibra ka lindur në Shkodër më 9 janar të vitit 1959. Është rritur dhe shkolluar në qytetin e lindjes. Pas diplomimit në degën Gjuhë - Letërsi, ka punuar si arsimtar në fshatrat e Kukësit në vitet 1982-1987; si gazetar në qytetin e Shkodrës në vitet 1988-1994. Prej vitesh është pedagog në departamentin e Letërsisë, të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Që nga viti 1989 kur boton vëllimin e parë poetik “Thjesht”, ai është i pranishëm në letërsinë shqiptare, si: poet, tregimtar, romancier, dramaturg, eseist dhe publicist. Veprat e tij letrare janë pritur me interes dhe kureshtje nga lexuesi dhe kritika letrare në Shqipëri, në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare. Disa prej këtyre veprave janë përkthyer edhe në gjuhë të huaja.

Veprat kryesore të këtij autori janë:

Poezi: “Thjesht” (1989), “Plagët e Moisiut” poemë (2010).

Tregime dhe novela: “Prostituta e virgjër” (1994), “Eklipsi i shpirtit” (1994), “Vetmia e diellit” (1995), Mjerimi i gjysmës” (1996), “Vëlla me centaurët” (2002), “Letra nga provinca” (2004), “Unë Franc Kafka dhe Karta e Bolonjës” (2008).

Romane: “Nudo” (1995), “Kurthet e dritës” (1997), “Stina e ujkut” (2000), “Të lirë e të burgosur” (2000), “Em@il” (2003), ribotim me titull “Kumte dashurie” (2004); “Sexonik dhe Sesilja” (2004), “Franc Kafka i shkruan të birit” (2006), “Stina e maceve” (2007), “Triumfi i Gjergj Elez Alisë” (1999), “Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë” (2002), “Në kërkim të fëmijës së humbur” (2010), “Kanuni i Lekës së vogël” (2011), “Legjenda e vetmisë” (2012).

Drama: “Varka e Abrasantit” (2001), “Na të birtë e shekullit të ri” (2010).

Eseistikë: “Dekalogu i turpit” (2004), “Një lojë me emrin postmodernizëm” (2007).

Vepra letrare e këtij autori është krijuar dhe botuar pas vitit 1990, dhe si e tillë asimilon përvojën më të mirë të letërsisë shqiptare të mëparshme, ndërsa kërkon dhe eksperimenton për mjete dhe nuanca të reja të shprehjes artistike letrare. Për mendimin e studiuesve dhe kritikëve letrarë (Agim Vinca, Adem Jakllari, Ardian Marashi, Ag Apolloni, Adil Olluri, Ali Aliu, Bashkim Shehu, Arben Prendi, Valbona Karakaçi, Sabina Osmanoviç, Arjeta Ferlushkaj, etj., ...), në veprën e tij letrare, veçanërisht tek tregimet, novelat dhe romanet, janë të pranishme elemente karakteristike të poetikës postmoderniste, që përbëjnë një risi në letërsinë tonë. Në veprën letrare të këtij autori janë edhe shenjat stilistike të fazës, në të cilën hyn letërsia shqiptare pas rënies së diktaturës komuniste. Ndërkaq R. Dibra është ndër autorët më prodhimtarë të kësaj periudhe, çka tregon përkushtimin dhe seriozitetin e autorit ndaj krijimit letrar. Pra, Ridvan Dibra “*është shkrimtar i frytshëm që e ka pasuruar letërsinë shqipe në planin sasior dhe cilësor, ideor dhe formal*”<sup>1</sup>.

### **Autori në kontekstin e brezit krijues, veçantia dhe origjinaliteti**

Autori Ridvan Dibra bën pjesë në brezin e shkrimtarëve të viteve 1990. Vepra e tij letrare sikundër edhe e autorëve të tjerë të këtij brezi shënon shkëputjen nga parimet e letërsisë së realizmit socialist, si dhe të gjitha skemat e krijuara prej tij, kërkimin e formave e mjeteve të reja shprehëse artistike. Përmes tyre synon afrimin me përvojat më të fundit të letërsisë bashkëkohore evropiane, theksimin e individualitetit dhe lirinë për të eksploruar dhe eksperimentuar, si me mjetet shprehëse ashtu edhe anën ideotematike. Autori dallon për individualitetin dhe origjinalitetin e tij, krahasuar me autorë të tjerë bashkëkohës shqiptarë. Mund të themi se ai e ka krijuar tashmë stilin e tij të dallueshëm, rekuzitën e tij artistike, shprehjen gjuhësore, artistike karakteristike, që mbështetet shpesh nga ana gjuhësore në shthurjen sintaksore të fjalisë dhe frazës dhe nga ana përmbajtësore në shthurjen e të menduarit të zakonshëm drejt një të menduari dhe të reflektuari filozofik, që kërkon nga lexuesi edhe një kërkesë më të lartë për kulturimin dhe formimin e tij.

Në veprën e tij letrare gjejmë rregullisht elemente të veprës letrare posmoderniste, si: parregullsitë kohore, copëtimi i rrëfimeve lineare, bashkëngjitja e formave dhe nga eksperimentimet me gjuhën, bashkimi i narcizimit me nihilizmin, dyshimet mbi nocionet klasike të së vërtetës, të arsyes, të identitetit dhe të objektivitetit, eklektizmi, relativizmi, digresioni,

---

<sup>1</sup> A. Apolloni, “Autoportreti i artistit si fëmijë” në R. Dibra, “Në kërkim të fëmijës së

kolazhi, pastishi, citati, ironia, ambiguiditeti, loja me ligjërimin dhe nivelet tematikë e narrativë, rrëfimi mikst, rrëfimi i ripërtrirë, enumeracioni, eseizmi, decentralizimi, mungesa e një boshti narrativ, shndërrimi tematik, paralelizmi tematik, fantastikja, lirizmi, biografizmi, metonimizmi, metateksti, enciklopedizmi, trivializmi, irracionaliteti, arkaizmi, naivizmi, retrospektiva, intertekstualiteti me vepra të tjera letrare dhe joletrare, citati, fragmentariteti, dokumentariteti, mitikja; shprishja e ndarjeve klasike mes gjinive, tejkalimin e strukturave e stileve klasike; teksti i hapur ndaj teksteve të tjera; pranimi i realitetit pa synuar ndikimin mbi të; preferenca ndaj “mininarracioneve” mbi ngjarje lokale, të “vogla” përkundër ngjarjeve “të mëdha”, shkrirja e kufirit mes autorit dhe personazhit letrar, etj..

Në veprën letrare të këtij autori mbizotëron ironia intertekstuale, alegoria, parodia dhe grotesku postmodern. Jeta dhe ekzistenca e personazheve përshkohet dhe këndvështrohet nga pozita e tyre, nga kjo pozitë lind edhe reflektimi apo filozofimi për njeriun dhe botën.

Vërtetë vepra letrare e këtij autori priret drejt eksperimentimit me formën artistike dhe me mënyrën e analizës së botës njerëzore, drejt të ashtuquajturës “letërsi laboratorike”; por tematika, problematika, semantika e kësaj vepre është e lidhur ngusht veçanërisht me botën e individit si qenie shpirtërore individuale; me ndjenjat, mendimet, dyshimet, etj., komplekset, pikëpyetjet, ankthet dhe paradokset e veta; gjithashtu edhe e lidhur ngusht me individin si pjesëtar i një shoqërie me të cilën ka marrëdhënie mosbesimi dhe dyshimi reciprok.

### **Autori dhe vepra - paraqitje antologjike**

Ridvan Dibra ka një kontribut me vlerë në lëvrimin e prozës, gjatë këtyre viteve, sidomos në lëvrimin e tregimit, parabolës dhe romanit. Për këtë arsye ky autor mund të përfaqësohet në një histori të ardhshme të letërsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë përmes pjesëve antologjike të përzgjedhura prej tyre.

Fragmentet janë përzgjedhur me këtë rast<sup>2</sup> janë marrë nga romani “Stina e ujkut”, Shkodër, 2000, f. 18-30; romani “Triumfi i Gjergj Elez Alisë”, Tiranë, 1999, f. 170-175; romani “Franc Kafka i shkruan të birit”, Tiranë, 2006, f. 5-11, tregimi “Me dorën e majtë”, te “Në kërkim të fëmijës së humbur”, përmbledhje me tregime që përbëjnë një roman, Tiranë, 2010, f. 239-246; “Në radhë për një”, te përmbledhja me proza “Unë Franc Kafka dhe Karta e Bolonjës”, Tiranë, 2008, f. 40-50.

<sup>2</sup> Për shkak të volumit të fragmenteve ato nuk janë botuar së bashku me artikullin.



Përmes këtyre fragmenteve mund të përfaqësohen simbolikisht edhe disa prej veçorive të prozës së këtij autori që më herët i cilësuam edhe si elemente postmoderniste, veçanërisht intertekstualiteti me tekste letrare dhe joletrare, intratekstualiteti, decentralizmi narrativ, shkrirja e kufijve mes llojeve letrare, poezi, prozë, dramë, rishikimi ironik i së kaluarës duke parodizuar dhe alegorizuar të tashmen, biografizmi i plasuar në botën e personazheve, laryshia tematike dhe problematike, citatizmi postmodern, fragmentariteti dhe kolazhi i narracionit, rrëfimi i dyfishtë asimetrik<sup>3</sup>, kërkimi i një sintakse vetjake në ndërtimin e fjalisë dhe frazës, duke shthurur sintaksën dhe narrativën e zakonshme, etj..

### **Interpretim i shkurtër mbi veçoritë narrative, kompozicionale e domethëniet filozofike.**

Në romanin “Stina e ujkut” (2000), kërkimi për mjete të tjera shprehëse artistike nxjerr në pah dy tipare të romanit postmodernist të këtij autori: prirjen për të mos dalluar qartë kufijtë mes gjinive dhe atë të përdorimit me një trajtë të re të konvencioneve sintaksore<sup>4</sup>, duke ndërthurur veçori që janë karakteristike për a) dramën, si: dialogu në ligjëratë të drejtë, monologu; b) tekstin eseistik: reflektimi i natyrës morale dhe filozofike i tipit eseistik; c) romanin: shtrirja e veprimit në kohë dhe hapësirë me gjithë subjektin e rrudhur deri në mosqenie. ç) tekstin poetik: përpunimi i shprehjes deri në nivel poetik. d) tregimin. Mjaft prej teksteve të ndërkallura kanë trajtën e tregimit të shkurtër. dh) parabola. Tema dhe problematika e veprës shtjellohen duke u nisur nga ironizimi i konceptit darvinian se njeriu e ka origjinën nga majmuni (kafsha, bisha), koncept të cilit autori i ikën në rrafshin e filozofimit duke e parë qenien njerëzore si qenie të dyzuar, por edhe në luftë me veten sipas konceptit frojdian se njeriu i qytetëruar për të qenë i tillë ka shtypur në rrjedhë të kohës instiktet primitive që e bashkojnë me kafshën, por ky çmim a e bën njeriun vetvetja apo një qenie problematike të dyzuar? ku ndërjegjija korrekton pavetëdijen, por jo rrallë instikti del nga pavetëdija dhe e afron njeriun me bishën.

Të dy romanet; “*Triumfi i Gjergj Elez Alisë*” (1999) dhe “*Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë*” (2002), i përshkon që në fillim çmitizimi i mitit

<sup>3</sup> Ardian Marashi, “Një triptik gërryes”, Parathënia tek: “Unë, franc Kafka dhe Karta e Bolonjës”, “Onufri”, Tiranë, 2008, f. 8.

<sup>4</sup> A. Jakllari, “Tipare të avangardës në romanin shqiptar të pas viteve ‘90” në “Fenomeni i avangardës në letërsinë shqiptare” Aktet e seminarit shkencor, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori- Filologji, “Arbëria”, f. 85.

folklorik, përmes “rivizimit” ironik të traditës. Ky “rivizim” shfaqet edhe në romanet në fjalë për çka mund të thuhet se, për një njeri të edukuar në frymën folklorike – mitologjike, trajtimi i tillë i mitit të Gjergj Elez Alisë, mund të duket një sakrilegj. Mirëpo Dibra, nisat nga premisa se hero i kohës sonë nuk është më personazhi tragjik, por përqeshësi spirituo<sup>5</sup>. Pra, Gjergj Elez Alia i Ridvan Dibrës është një antihero<sup>6</sup> po ashtu edhe motra e tij është një antiheroinë<sup>7</sup>. Nisur nga kënga legjendare e eposit shqiptar “Gjergj Elez Alia”, që lavdëron heroin popullor, i cili me nëntë plagë në shtat ngrihet nga shtrati ku lëngon prej nëntë vitesh dhe mund në duel Bajlozin; narratori përmes fantastikes, lirizmit, biografizmit, metonimizmit, enciklopedizmit, trivializmit, irracionalitetit, arkaizmit, naivizmit, retrospektivës, intertekstualitetit, fragmentaritetit, etj., ndërton mitin e tij, mitin e njeriut dhe krijuesit, “njeriut i cili është një hero i ditëve tona” në ambientin ku jeton, duke vuajtur për plagët e veta dhe plagët e gjithë njerëzimit. Gjergji e mund Balozin me forcën e fjalës. Gjuha romaneske mbështet në gjuhën e ironisë intertekstuale, parodizimit, groteskes.

Në romanin “Franc Kafka i shkruan të birit” (2006), shfrytëzohet gjerësisht teknika e intertekstualitetit, duke u mbështetur në modelin e “letrës” që shkrimtari Franc Kafka i shkruante të atit. Marrëdhënia ndërmjet këtyre teksteve nxjerr në pah problematikën e përjetshme të marrëdhënieve ndërmjet brezave njerëzorë, dialogun e realizuar apo të munguar ndërmjet etërve dhe bijve dhe anasjelltas. Ndërkaq teksti i ndërtuar në formën e letrës ndërthuret me disa tekste të tjera të pavarura në formë parabolash, të cilat alegorikisht lidhen me tekstin e parë, duke e pasuruar atë me kuptime të reja dhe duke ruajtur cilësinë estetike të tekstit në tërësi. Në tërësi procedohet me tre tipa të tekstit që ndërthuren me njëri-tjetrin: teksti që imiton letrën që babai i drejton birit, ku “flet” gjithnjë babai, teksti ku ndërhyt biografia e shkrimtarit Franc Kafka dhe tekstet në formë parabolash.

Në parabolën “NË RADHË PËR NJË” tek përmbledhja me proza “Unë Franc Kafka dhe Karta e Bolonjës” (2008), ironizohet jeta e mjerë e njeriut nën diktaturë, sistem në të cilin ekzistenca është gjithnjë e pasigurt, por edhe egërsia e marrëdhënieve shoqërore në nivelin e mbijetesës, ku “peshku i madh ha të voglin”. Një ditë prej ditësh babai i lodhur e i sëmurë që e kishte fituar bukën duke qëndruar në radha të gjata, i thotë të birit,

<sup>5</sup> A. Vinca, “Miti dhe çmitizimi” në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare” 25/2, Prishtinë, 2006, f. 120.

<sup>6</sup> A. Olluri, “Romani postmodern shqiptar”, vep. e cit. f. 130.

<sup>7</sup> A. Olluri, po aty, vep. e cit., f. 133.

tashmë të bërë burrë, se duhet të shkojë ai ta marrë bukën tani e mbrapa. Atij i duhet të qëndrojë në mesnatë në radhë për një në pritje të shitjes së bukës. Në dyqan mbërrinin vetëm dhjetë bukë dhe shpërndaheshin nëntë, ata që ia dilnin të qëndronin në radhë të parët mund të merrnin, të tjerët mbeteshin pa gjë. Kur gëzohet se është i pari në radhë pas mesnate zbulon se para tij janë katër gurë që do të thotë se ai është i pesti. E zë gjumi për pak çaste dhe kur zgjohet sheh se dikush kishte përfituar dhe kishte hyrë para tij. Më vonë dikush përfiton nga hutimi dhe hyn përsëri para tij, është një fëmijë dhe atij i dhimbset. Polici me kërbac duhet të ruajë radhën, por ai vetëm ruan sistemin në të cilin njerëzit shtyhen në radhë dhe gëzimi më i madh i ekzistencës së tyre është nëse arrijnë të marrin një bukë për të shuar urinë e familjes. Pas një keqkuptimi, në radhë dikush e godet dhe e gjakos, një vajzë ndien keqardhje për të dhe i afron ngushëllim me ngrohtësinë e trupit të saj, si mirënjohje ai e lejon atë të hyjë në radhë para tij. Ndërkohë duke përfituar nga rrethanat miku i tij më i mirë kishte hyrë para tij në radhë dhe merr bukën e nëntë. Buka e dhjetë nuk dihet ku përfundon dhe ai kthehet në shtëpi duarbosh dhe i mjerë përballë shikimit të të atit që i duket se e qesëndis për këtë dështim.

Ndërsa romani “Në kërkim të fëmijës së humbur”(2010), përmbledh 28 tregime të lidhura nga tema dhe personazhet e njëjtë, ndaj edhe libri mund të lexohet si një roman fragmentar, i ndërtuar sipas poetikës së kombinueshme<sup>8</sup>. E përbashkët e tregimeve, nga ana tematike- motivore është gëzimi dhe dëshira e fshehtë e fëmijës, por edhe e të rriturit për të kapërcyer *tabutë*<sup>9</sup>, “mos-et” e jetës së përditshme ose e kundërta: zhgënjimi dhe vuajtja në rastin e kundërt, kur tabutë mbrohen nga rregulla të forta, të caktuara nga më të rriturit, nga prindërit, nga shoqëria apo sistemi edukativ, apo sistemi politik. Pra, romani në tërësi na del si romani i ndeshjes së fëmijës me tabutë e vendosura nga të rriturit, ndjeshje prej së cilës fëmija ose e afirmon vlerat e veta ose në pamundësi ndrydhet e tkurret në vetvete; ndeshje prej së cilës fëmija i dikurshëm tani në moshë të pjekur, ruan ende gjurmë të forta e të pashlyeshme nga kujtesa. Romani mund të shihet edhe si një portret artistik i fëmijës që do të bëhet në të ardhmen artist, shkrimtar, por jo rrallë gjendet nën pushtetin dhe presionin e rregullave dhe të rriturve, me të cilët jo rrallë gjendja bëhet absurde dhe ndrydhëse si tek tregimi

<sup>8</sup> A. Apolloni, “Autoportreti i artistit si fëmijë” në Ridvan Dibra, “Në kërkim të fëmijës së humbur”, “Onufri”, 2010, f. 268-269.

<sup>9</sup> Sipas Frojdit, tabu nga njëra anë ka kuptimin e diçkaje të shenjtë ose të shenjtëruar, nga ana tjetër ka kuptimin e diçkaje të pashpjegueshme, të rrezikshme, të ndaluar, të papastër. (“Tabuja dhe ambivalenca emocionale” në “Totem dhe tabu”, “Dituria”, 2003, f. 25).

parabolik “Me dorën e majtë”. Personazhi, fëmija/autori në vegjëli, në një mjedis ideologjik dhe të ashpër vuan për një anomali të lindur, që s’ka të bëjë me vullnetin apo sjelljen e tij: për faktin se shkruan me dorën e majtë. Shkolla socialiste nuk e pranon këtë anomali; të shkruhet me dorën e majtë ishte e papranueshme prandaj duhej mësuar të shkruhej patjetër me dorën e djathtë, *si gjithë të tjerët*. Ndarja nga grupi për mentalitetin ideologjik është e papranueshme qoftë edhe atëherë kur kjo ndodh për një arsye të tillë bindëse siç është të lindurit sallak. “Gjyqi” që bëhet për të *ndryshuar dorën* i ngjason gjyqit ndaj kundërshtarëve të regjimit, sipas mentalitetit se institucioni ideologjik korrigjon edhe anomalitë e natyrës, por edhe për arsye se ideologjia nuk i pranon njerëzit e ndryshëm (jo vetëm në mendime e personalitet), por as nga pikëpamja fizike. Fëmija duhet të bëhej si gjithë të tjerët, domethënë të shkruante me dorën e djathtë, por jo vetëm kaq... .

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. Apolloni, Ag (2010): “Autoportreti i artistit si fëmijë” në Ridvan Dibra, “Në kërkim të fëmijës së humbur”, “Onufri”, Tiranë.
2. Ferlushkaj, Arjeta (2012): Pasqyrat e postmodernitetit, “Onufri”, Tiranë.
3. Marashi, Ardian (2008): “Një triptik gërryes”, në: “Unë, Franc Kafka dhe Karta e Bolonjës”, “Onufri”, Tiranë.
4. Jakllari, Adem: “Tipare të avangardës në romanin shqiptar të pas viteve ‘90” në “Fenomeni i avangardës në letërsinë shqiptare”, Aktet e seminarit shkencor, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori- Filologji, “Arbëria”.
5. Olluri, Adil (2011): “Romani postmodern shqiptar”, Prishtinë.
6. Prendi, Arben (2012): “Prije dhe dukuri të romanit bashkëkohor shqiptar”, temë doktorature, regjistrimi i temave: [www.qsa.edu.al](http://www.qsa.edu.al)
7. Prendi, Arben (2011): “Tekste në kontekste”, Tiranë.
8. Vinca, Agim (2006): “Miti dhe çmitizimi” në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare” 25/2, Prishtinë.

---

**Literary works of Ridvan Dibra / contribution to the  
of Albanian literature**

*SUMMARY*

Literary works of this author has been created and published after 1990, and as such assimilates the best experience of Albanian literature and previous experiments while looking for new tools and nuances of literary and artistic expression. In the opinion of literary criticism, in his literary work, especially stories, novels and novels are present postmodern poetry characteristic elements that constitute a novelty in our literature. In literary work of this author are also signs stylistic phase in which enters Albanian literature after the fall of the communist dictatorship. In this author's literary work prevails intertextual irony, allegory, parody and postmodern grotesque. Life and existence of the characters is scrolled and viewed from their position, this position arises from reflection or philosophizing about man and the world.

**Alva DANI**

## **SHKODRA PËRMES SHKRIMEVE TË ALBANOLOGES LUÇIA NADIN**

Albanologia 73 vjeçare, Luçia Nadin, është një nga emrat e gjallë që po investon vit pas viti kërkime të gjata prej murgu e një pasion të pazakontë mbi argumente që lidhen me Shqipërinë dhe shqiptarët. Ajo ka meritën e zbulimit të disa fakteve madhore që i takojnë historisë e kulturës shqiptare, të ruajtura me shekuj në bibliotekat e muzetë e qytetit të saj të lindjes Venecias, në arkivat apo në veprat monumentale të artit, siç janë edhe pikturat e Veronese-s. Kemi dëgjuar të flitet shumë vitet e fundit për këtë albanologe italiane dhe për interesat e saj kërkimore, për ecejaket e gjata në kërkim të pjesëzave të humbura të historisë sonë mesjetare. Po kush është Luçia Nadin? Pse kjo dashuri kaq e madhe për të kthyer memorien tonë të humbur?

Luçia Nadin lindi në vitin 1941 në Venezia të Italisë. Mbaron studimet e larta në Universitetin e Padova-s, për shkenca humane dhe fillon të merret me hulumtime dhe me mësimdhënie, po në këtë universitet, në mënyrë vullnetare. Këtë aktivitet e transferon në universitetin e Venecias, në degën Letërsi, ku veç të tjerash jep edhe lëndën e Filologjisë Mesjetare dhe Humaniste. Më 1987 përfundon studimet e Doktoraturës në Italianistikë. Në vitin 1995 Lucia Nadin vjen në Shqipëri, në Tiranë, si rezultat i një konkursi të fituar në Ministrinë e Jashtme Italiane. Jep mësim si pedagoge e Letërsisë Italiane, deri në vitin 1999, pranë Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Dega Italianistikë<sup>10</sup>. Punon pranë zyrës së kulturës së Ambasadës Italiane e pastaj edhe në Institutin Italian të Kulturës. Aktualisht duhet thënë se vazhdon kërkimet historiko-letrare në fushën veneto-adriatike, duke gjurmuar gjithnjë e më thellë prova e dëshmi që lidhin qytetin e saj me kulturat, qytetërimet e historitë e zonave përreth e në mënyrë të veçantë me Shqipërinë.

---

<sup>10</sup> Është kënaqësi të theksoj se kam qenë një nga studentet e saja, për katër vite me radhë, pranë këtij universiteti. I jam mirënjohëse për pasionin dhe energjinë e jashtëzakonshme me të cilën shpjegonte dhe analizonte veprat dhe autorët e mëdhenj të letërsisë italiane, i jam mirënjohëse për udhëheqjen e përkushtuar të temës sime të diplomës në letërsi italiane, edhe pse në një periudhë tepër të vështirë.

Fillimisht L.Nadin nuk kishte asnjë lidhje me Shqipërinë dhe aq më pak me Shkodrën. Para se të vinte në Tiranë kishte lexuar gjerë për historinë e shqiptarëve dhe kishte kuptuar se ishte një vend që mbarte shumë mistere e të fshehta. *“E kisha përkapur atëherë se sa zbrazëti kishte padija ime rreth vendit drejt të cilit po ia mbaja. Ja përse do të nisja të veja pareshtur në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin Shtetëror të Tiranës: mes botimesh të moçme dhe fondesh me dorëshkrime kuptova se hapësirat e mia të zakonshme të studimeve veneciane do të mund t’i zëvendësoja fort mirë me hapësirat përkatëse shqiptare”*<sup>11</sup>. Ajo mendonte se do të ishte më e vlefshme të sillte diçka me interes për shqiptarët e për Shqipërinë, vendin me të cilin po ndante tashmë eksperiencat e jetës dhe të profesionit. Marrëdhëniet intensive mes Venezas dhe Shkodrës ishin tepër joshëse për ambicien profesionale të profesoreshës italiane. Pas hulumtimesh të gjata, ecejakeve të shpeshta Tiranë-Venecia, do të fillonte të zbulonte shenjat e para të këtij raporti të ngushtë e të gjatë, me vlera tepër të rëndësishme për historinë mesjetare shqiptare dhe për Shkodrën në veçanti. Do të ishte Venecia, qyteti i saj i lindjes, që do t’i rrëfente që nga arkivat shekullore dhe raftet e kyçura e gati të harruara të bibliotekës “Marciane” se trashëgimia identitare dhe morale e shqiptarëve, gjendej aty, e gjitha e paprekur ende as nga dora dhe as nga kurioziteti ambicioz i ndonjë studiuesi shqiptar.

Që në fillimet e vitit 1995, albanologia italiane bie në gjurmët e para të marrëdhënieve mes qytetit të saj lagunar dhe Shkodrës. *“Nëse nga ajo ndërthurje e gjatë dhe shekullore ngjarjesh dhe miqësish midis shqiptarëve dhe venecianëve mbijeton akoma sot ndonjë gojëdhënë në memorien e më të vjetërve, nëse për këtë ndërthurje me përmasa të mëdha materialet e arkivave dhe të bibliotekave të qytetit presin të studjohen e të bëhen të njohura, është vetë Venecia që me fizionominë e saj na tregon për praninë e tyre...”*<sup>12</sup> Me gjithë modestinë që e karakterizon, ajo i bën të njohur publikut dhe gjithë botës akademike shqiptare një sërë zbulimesh, një sërë dokumentesh dhe hartash të vjetra, të cilat ushqyen botimet e para të saj, duke hedhur një dritë të re në marrëdhëniet e Shkodrës me Venedikun e asaj kohe. Pikërisht në vitin 1997, Lucia Nadin, bie në gjurmët e “Statuti di Scutari”, të cilat i gjeti më në fund në Bibliotekën e Muzeut “Correr”, aty ku askujt nuk i kishte shkuar në mend se kishte gjëra interesante për Shqipërinë. “Një “monument i vërtetë i Shqipërisë mesjetare”, sipas

<sup>11</sup> L. Nadin, *Shqiptarët në Venedik. Mërgim dhe integrim 1479 – 1552*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2008, f. 5.

<sup>12</sup> L. Nadin, *Venezia e Albania: tracce di antichi legami*, Venezia Mestre, 1995, f. 18

“formulimit të suksesshëm të Oliver Schmitt-it dhe diçka më shumë, për faktin se rëndësia e tij shkon shumë më tej realitetit specifik shqiptar...”<sup>13</sup>. Kjo ishte një vlerë shumë e madhe për Shkodrën dhe mbarë vendin, pasi këto statute të zbuluara pas gati shtatë shekujsh, do të na ndihmojnë të kuptojmë se neve nuk jemi vetëm “vendi i shqiptonjave” dhe i kulturave të malit, por “... një kryqëzim i jashtëzakonshëm kulturash dhe njerëzish, lidhjesh e mbizotërimesh; ... dëshmi e një shtresëzimi ngjarjesh e qytetërimesh që kanë kaluar përmes një përvoje shumëshekullore”<sup>14</sup>.

Zakonet dhe traditat e shumë zonave të thella malore, me strukturat patriarkale të familjeve që zgjeroheshin në fshatra e prej fshatrave përhapeshin në *bajrakë*, bashkë me traditat epike të këngëve të rapsodëve, sipas Nadin krijonin pamjen e një shoqërie baritore, të kristalizuar në kohë e të ndalur në kufirin e rrjedhës së historisë. “... sikurse vende të tjera të largëta, edhe Shqipëria, në mjaft letërsi perëndimore të dhjetëvjeçarit të fundit, bëhej objekt i një kërkimesh antropologjike më shumë se sa rast i një rekuperimi historik specifik...”<sup>15</sup>. Ne nuk mund të ishim vetëm frut i kanuneve, ne duhej të dëshmonim një tjetër traditë juridike, e cila krijonte një hendek të madh në historinë mesjetare shqiptare e për të cilën kishin studiuar më parë emra të njohur, si Fishta, Shuflaj e deri tek Valentini. Albanologia italiane në këto statute shikon një vizion tjetër, shumë të largët madje të pakrahasueshëm me atë që shpalosin ligjet kanunore. Me një dëshirë të madhe për të zbuluar të vërteta të reja, me një bujari të jashtëzakonshme për çdo vlerë të shtuar të qytetërimit mesjetar shkodran, ajo rreshton me shumë zell nene statutesh, njërin pas tjetrit.

Gjëja e parë që përsëritet vazhdimisht, duke filluar nga kapitujt e parë është se “*banorët e qytetit të Shkodrës, dallohen gjithnjë... si “qytetarë” nga “sllavët” e nga “shqiptarët” si dhe nga “stranieri o forestieri”*”. Pra njerëzit e vet, qytetarët e Shkodrës, dallohen nga njerëzit e tjerë, nga sllavët dhe nga shqiptarët, të cilët janë kategori më vete, në krahasim me qytetarët. Mbresë të jashtëzakonshme i lë pozita e gruas dhe trajtimi i gjakmarrjes. Për sa i përket gruas Nadin nënvizon si shumë me interes faktin se ajo ishte “... e mbrojtur nga abuzimet dhe nga dhuna, përfshirë edhe atë verbale (gojore) e lirë të bëjë një testament të saj; me mundësi për të dhënë dëshmi; e mbrojtur nga pretendime të paligjshme të bashkëshortit”. E gjitha në kundërshtim me personalitetin e paqenë juridik

<sup>13</sup> L. Nadin, *Statutet e Shkodrës*, në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469, “Onufri”, 2010, f. 12.

<sup>14</sup> Po aty, f. 12.

<sup>15</sup> L.Nadin, *Teksti i statutit*, f. 110.



të gruas në kanune, apo për rastin e gjakmarrjes, akoma e ndjeshme edhe sot, Nadin, tërheq vëmendjen mbi faktin se “*hakmarrja, si për vrasje apo dhe për plagosje, nuk ndërmerr asnjë revansh fizik mbi njerëzit, por vepron vetëm në kuadrin financiar*”<sup>16</sup>. Rast ky, që ashtu si edhe rasti i mësipërm përbën një ndryshim të pakrahasueshëm, e një distance të pamatë me atë çfarë ofronin ligjet zakonore. Disa prej tyre duket se trajtojnë probleme dhe shqetësime që mbeten të tilla edhe sot pas 7 shekujsh. Kështu për shembull mund të veçojmë nenin 228, që rezervon për krimin e tradhtisë dënimin më të rëndë, prerjen e kokës dhe konfiskimin e gjithë pasurive. Sipas nenit 141 dënohej me gjobë dhe me humbjen e çështjes qytetari që përdorte dokumente të falsifikuara, neni 12 përcakton se kush ndërton një shtëpi të re, nuk mund të hapë portë apo dritare përballë fqinjit, apo neni 24 që dënon me gjoba të rënda ata që hedhin plehrat nga dritarja.

Kjo do të përbënte edhe zbulimin më të rëndësishëm të saj dhe njëkohësisht argumentin e librit të saj të parë me vlerë të paçmuar, me të cilin do të nderohej nga vetë Shkodra me titullin më të lartë “Qytetare Nderi”. “*Kam punuar, - shprehet Nadin, - duke e ndier veten përnjëmend shqiptare në Venecie, duke ngjallur ndonjëherë edhe shpotinë dashamirëse të miqve që më padisnin se shikoja “albanesità” në çdo rrugë, në çdo rrudhë...*”<sup>17</sup>. Pëllumb Xhufi, historiani dhe përkthyesi i veprave të Luçia Nadin e vlerëson si një mike të rrallë të shqiptarëve dhe si një studiuese tejet të apasionuar, “*Kësaj zonje, Shqipëria dhe në mënyrë të veçantë Shkodra, i detyrohen një numër zbulimesh e botimesh të çmuara për historinë e kulturën shqiptare... Statutet e Shkodrës përfaqësojnë jo vetëm një fakt shkencor e kulturor, por edhe një moment të jashtëzakonshëm edukativ*”<sup>18</sup>.

Një element tejet i çmuar që tërheq vëmendjen e studiuses veneçiane ishte flamuri shqiptar, që ndodhej në kishën e Shën Sebastianit në Venezia, kishë e vitit 1555-1556. Ky flamur, me sfond të kuq e me një shqiponjë me dy krerë, e pikturuar nga Paolo Veronese në tavanin e navatës, ishte interpretuar “... si një flamur perandorak asburgas, i cili gjithashtu paraqet një shqiponjë me dy krerë, por mbi një sfond me ngjyrë të çelët, të verdhë. Asnjë nuk ka shkruar se mund të ketë pasur një sfond të kuq...”<sup>19</sup>, shprehet Luçia Nadin, në studimin e saj të botuar në buletin e

<sup>16</sup> Po aty, f.408.

<sup>17</sup> L. Nadin, *Shqiptarët në Venedik. Mërgim dhe integrim 1479 – 1552*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2008, f. 6.

<sup>18</sup> P.Xhufi, *Ju rrëfejt statutet e Shkodrës së vitit 1330*, Gazeta Shqiptare, 04,02,2010.

<sup>19</sup> Lucia Nadin, *Proposta di rilettura delle pitture di Paolo Veronese in San Sebastiano a Venezia*, Ateneo Veneto, seria III, 2011, f. 46.

universitetit të Venecia-s. Gjithashtu albanologia tregon se Paolo Kaliari, i njohur me emrin Veroneze, piktor i shquar i ‘500-tës italiane e ka për zemër temën shqiptare, madje “*Rrethimi i parë i Shkodrës*”, fiksohet në pikturën e njohur të Veronezes, e cila ndodhet në sallën e Këshillit të Madh, në Pallatin Dukal të Venedikut. Këtë Lucia Nadin na e bën të njohur në faqet e para të librit të saj të dytë: “*Shqiptarët në Venedik. Mërgim e integrim 1479-1552*”, përkthyer nga historiani i njohur Pëllumb Xhufi. Disa nga faqet më të bukura të këtij studimi i kushtohen gruas shkodrane, fisnikërisë dhe virtyteve të saj. Mes të tjerash albanologia shkruan: “*Besnike ndaj bashkëshortëve, por edhe të rezervuara, modeste, të matura, diskrete, me sjellje të rregullt: elozhi i të gjitha atyre vetive që morali i kohës ia vishte qenies grua*”.

Nuk po flasim këtu vetëm për të vejat, por edhe për bijat dhe motrat e burrave nga Shkodra e Drishti që ranë gjatë rrethimeve të qyteteve të tyre. Jo pa qëllim, vetëm pak vite më vonë piktori i madh Paolo Veronese do ta pikturonte gruan shkodrane me një profil fin dhe fisnik, në tavanin e Sallës së Këshillit të Madh të Pallatit Dukal. Në sfondin e Shkodrës së rrethuar, një grua shpëtohet nga duart e armikut (nga Antonio Loredan, mesa duket). “*Ajo vesh një kumash të çmuar, vathë, si dhe një varëse me perla*”<sup>20</sup>. Këto faqe libri lënë mbresa të jashtëzakonshme, pasi mbartin histori njerëzore tepër tronditëse, histori torturash e përdhunimesh, grash e vajzash gjatë rrethimit të Shkodrës. Me të mbërritur në Venedik ata u morën në mbrojtje dhe u sistemuan, madje edhe në familjet aristokrate, duke marrë edhe ndihmë ekonomike, gjë që pasqyrohet e qartë në listat e gjata të emrave të nxjerrë nga faqet e regjistrave të Senatit të vitit 1478-79.

Në lidhje me figurën e gruas shkodrane studiuesja e palodhur italiane kishte sjellë që herët elemente të tjera tepër interesante, që e radhisnin atë mes shumë grave fisnike të Venedikut. Aleanca Veneto – Shqiptare për mbrojtjen e Shkodrës do të hynte në historinë legjendare të Venecia-s, aq sa edhe pas dy shekujsh Xhovani Palaci, në një histori të tijën për Venecian të treguar nëpërmjet një palë letrash bixhozi me 52 karta “*nuk mungonte t’i kushtonte, ndër letrat që tregonin për gratë dukeshë e ato të familjeve fisnike, një kartë - nëntën e shkopinjeve – grave të Shkodrës duke u vënë atyre emblemën e ermelinut dhe të turtullës, respektivisht simbole të ruajtjes së zakoneve dhe të besnikërisë bashkëshortore*”<sup>21</sup>. Duket se figura femërore ishte tepër karizmatike dhe tërheqëse për vetë vlerat që mbarte,

<sup>20</sup> L.Nadin, *Gratë shqiptare të mërgatës, simboli i ajkës së Venedikut*, 10 mars 2014, ballkan.ëeb.

<sup>21</sup> L.Nadin, *Venezia e Albania: Tracce di antichi legami*, Venezia Mestre, 1995, f. 9.

ishte tejet interesante edhe për kuriozitetin e studiueses italiane, e cila është frut i kërkimeve të saj të para në nëntor të 1994-ës, e sjellë përsëri edhe më e zgjeruar në këtë vepër të dytë “Shqiptarët në Venedik. Mërgim e integrim 1479-1552”. Shkodra me gjithë personazhet e saj të kohës, me gjithë karakterin e saj fisnik, shtrihet gjerësisht dhe thellësisht pothuajse në të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e mesjetës shqiptare, të ruajtura me saktësi në institucionet venedikase.

Studimi i saj më i fundit sjell edhe librin dygjuhësh “Shqipëria e rigjetur”. Zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shek. XVI” (L’Albania ritrovata). Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell’arte del cinquecento veneto). Këtë studim të gjatë Luçia Nadin, ia kushton qytetit të Shkodrës, duke i qenë mirënjohëse këtij qyteti, ashtu si edhe qyteti u tregua me të. Në faqen e parë të librit lexojmë këtë përkushtim:

*Alla città di Scutari  
perché il recupero di storia é  
rinnovo di speranza*

*Kushtuar qytetit të Shkodrës  
sepse rizbulimi i historisë është  
përtëritje e shpresës*

Me mprehtësinë e një studiueseje profesioniste ajo rindërton figurat e disa emigrantëve shqiptarë që u bënë protagonistë të kulturës në tokën veneciane në vitet një mijë e pesëqind. Emrat më të spikatur janë Bernardino de Vitali, një emër i madh i botimeve veneciane të shek. XVI-të; Pal Kampsa, një bashkëkohës i de Vitali-t, i deklaruar venecian, por me një origjinë të pamohueshme familjare nga Shkodra, si edhe roli i familjes së Engjëllorëve, i Pjetër Engjëllit dhe djemve të tij, priftërinjve Andrea e Pali. Pjesa e fundit do të ngjallte përsëri interes sepse do të kishte në qendër *Mesharin* e Gjon Buzukut të vitit 1555. Libri është një tregues kuptimplotë mbi marrëdhëniet e ndërsjellëta mes venecianëve dhe shqiptarëve dhe veçanarisht i ndihmesës së çmuar të kësaj albanologeje për forcimin e lidhjeve kulturore dhe shpirtërore mes dy popujve dhe sidomos në mbushjen e një zbrazëtie jo të vogël në kujtesën historike mesjetare shqiptare. Megjithëse hulumtimet e studiueses veneciane, shkodrane, do të ngjallnin diskutime, ata përsëri do të mbeten një vlerë e shtuar studimeve të deritanishme shqiptare dhe një pikë e mirë referimi për hulumtime të mëtejshme. Mund të themi me bindje të plotë se “Ajo është një shkencëtare e lindur. Luçia nuk tjerr fraza, ... As nuk nxjerr nga arkivat një apo dy dokumente me ndonjë informacion të ri dhe rri e u gëzohet thërrimeve të tilla mbi tavolinë. Ajo zbulon gjëra të mëdha, të barazueshme me punën e njehershme të disa instituteve. Në pesë vite Luçia Nadin ka bartur në

*vendin tonë dëshmi vlerash sa për pesë dekada*<sup>22</sup>. Sigurisht që këto studime i kapërcejnë mundësitë e kufizuara të një studiuesi të vetëm, por do të jenë një pikënisje e fortë për studime të tjera, të mëtejshme edhe përtej Venecias.

Luçia Nadin mblodhi pjesëzat e humbura të kujtesës sonë, i rreshtoi me një përkushtim prej murgu, siç thotë ajo vetë, dhe i solli shqiptarëve një pjesë të identitetit dhe krenarisë të harruar shekujve. Sot kush do të dëshirojë të shkruajë histori “do të ketë si gur themeltar të saj, pikërisht statutet e Shkodrës: krenarinë e të qenit qytetar, që përçohet vazhdimisht në to, ... të qenit i hapur kundrejt kujdo që dëshiron të bëhet qytetar i saj, me kusht impenjimin për besnikëri...”<sup>23</sup>. Shkodra fiton një dimension tjetër, plotësohet në gjithë qytetërimin dhe fisnikërinë e saj, duke ndërë edhe një herë, thellë në shpirt, duke përlligjur edhe më shumë kënaqësinë që na jepte fakti i të qenit qytetarë të saj.

#### BIBLIOGRAFIA:

1. Lucia Nadin (2010): *Statutet e Shkodrës*, në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469, “Onufri”, f. 12.
2. Lucia Nadin (2008): *Shqiptarët në Venedik. Mërgim dhe integrim 1479 – 1552*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, f. 6.
3. Lucia Nadin (2012): *Shqipëria e rigjetur. Zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shek. XVI*, “Onufri”, Tiranë.
4. Lucia Nadin (2011): *Proposta di rilettura delle pitture di Paolo Veronese in San Sebastiano a Venezia*, Ateneo Veneto, seria III, f. 46.
5. L.Nadin, *Gratë shqiptare të mërgatës, simboli i ajkës së Venedikut*, 10 mars 2014, ballkan.web.
6. L.Nadin (1995): *Venezia e Albania: Tracce di antichi legami*, Venezia Mestre.
7. Y.Polovina: *Zbulimi i tretë mahnitës i albanaloges veneciane*, Lucia Nadin, 11 dhjetor 2012.
8. Shqiptari i Italisë: *Statutet e Shkodrës. Nga Venezia në Tiranë*, 28 shtator, 2011.

<sup>22</sup> Y. Polovina, *Zbulimi i tretë mahnitës i albanaloges veneciane*, Lucia Nadin, 11 dhjetor 2012.

<sup>23</sup> L. Nadin, *Statutet e Shkodrës*, në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469, “Onufri”, 2010, f. 144.

---

**Shkodra through the Albanologue Lucia Nadin*****SUMMARY***

The nun Lucia Nadin, is one of the people who has continuously and passionately been carrying out long-term research on arguments about Albania and Albanians. She has the merit of discovering several major facts belonging to Albanian history and culture. This evidence has been stored for centuries in libraries and museums of her home toën, Venice, in archives or monumental works of art, such as paintings of Veronese. Lucia Nadin collected lost snippets of our memory, put them away as a devoted nun, as she declares herself, and brought to Albanians one fragment of their identity and pride, which have been forgotten for centuries. Shkodra acquires another dimension: she is fulfilled in its civilization and nobility, by making us feel once again proud to be its citizens

Gëzim PUKA

## LOJA DHE IRONIA PËRMES TEKSTIT DRAMATIK TË ALBRI BRAHUSHËS

### Drama “Vizita e fundit” dhe tensioni i saj me lexuesin – spektator

Gjëja që të tërheq vëmendjen ndërsa kërkon të thellohesh në lëmin e dramës shqipe, është gjakimi i disa studiuesve për t’i dhënë asaj vazhdimisht jehonë për lexuesit apo për spektatorët. Në këtë kontekst nuk munguan kurrë interesimet për dramaturgjinë qysh në fillimet e saj. Në përpjekjen e përgjithshme dhe të përbashkët të studiuesve të dramës shqipe, në çdo kohë e gjithmonë, është ngulmuar që asaj t’i afrohet një lexues. Lexuesi i familjarizuar me receptimin e kësaj gjinie brenda kufijve të metodës së realizmit socialist, që pavarësisht disa arritjeve, iu imponua letërsisë shqipe, u gjend shpejt në një situatë ku krijuesit tjetërmendues iu shfaqën me një gjuhë dramatike tashmë të defamiljarizuar për ta. Ndër dramaturgë të tillë veçohet edhe Albri Brahuša, i cili erdhi për lexuesit dhe spektatorët e dramës në fillimet e viteve ‘90. Studiuesi Josif Papagjoni në librin “Teatri dhe dramaturgjia shqiptare”, duke iu referuar Albri Brahušës, e përcakton atë si një dramaturg që ndjek tipologjinë e dramës absurde dhe antidramës. *“Tërhoqi vëmendjen qysh me dramën e tij “Vizita e fundit”, e cila ishte një ironi e mprehtë dhe sarkazëm sfiduese ndaj vetëdijeve mitologjizuese të periudhës së diktaturës komuniste, duke u tallur me klishtë e ngurta morale dhe shëmbëlltyrat e rrejshme të kinse heroizmit dhe “njeriut-hero”, të fabrikua nga ideologjia sunduese e asaj kohe dhe interesat politike gjejëse të kastës drejtuese si pjesë e manipulimit të shpirtrave.”*<sup>24</sup>

Në qoftë se teksti “Vizita e fundit” i Albri Brahušës vështrohet si një fjali e madhe do të dallohet montazhi dhe kolazhi i disa sekuencave tekstore, i dhënë qoftë edhe me vetë emrat e personazheve vepruese, me anë të të cilave tentohet të jepet kuptimi. Montazhi në këtë vepër funksionon si bashkimi i elementeve të rrëfimeve të llojeve të ndryshme, kuptimi i të cilave është që të detyrojë lexuesin të gjejë funksionin e tyre

<sup>24</sup> Papagjoni, Josif: *Teatri dhe dramaturgjia shqiptare*, Tiranë, 2011, f. 211.

brenda atij uniteti tekstor. Futja në këtë tekst e një personazhi të quajtur **Historia** jep qartë anën referenciale ndaj një diçkaje që nuk mund t'i përkasë artit të fjalës ose letërsisë. **Historia** si *dramatis personae* është edhe fakt i veprimit të teknikës së kolazhit, e cila e detyron lexuesin-spektator që ta ndërtojë mendimin duke u nisur nga pyetja se ç'bën ai element i pazakontë në dramë. Nuk është vetëm emri Historia që i sjell këtë turbullirë kuptimore lexuesit të kësaj drame me një akt. Emrat e vetëve të tjerë veprues duken gjithashtu të pazakontë. **H1**- Heroi i punës me dru, **H2**- Heroi i popullit, **H3**- Heroi i luftës, **H5**- Heroi prej letre, **H7**- Heroina e grave, të gjendur në një vend që ngjan me një muze, duket se jetojnë nostalgjinë e veprave të tyre të kohës së shkuar. Të gjitha këto personazhe, qysh në emrat e tyre e kanë brenda rrëfimin për të shkuarën. Duke i futur në një dramë dhe duke i sjellë si figura artistike, autori luan me anën formale të dramës. Me ardhjen në skenë, **Historia** i lajmëron heronjtë që gjenden në këtë pavion muzeal, se për ta do të ndodhë një ngjarje e jashtëzakonshme.

*“H3- Heroi i luftës- (dëgjohen hapa plot zhurmë). Dëgjoni me kujdes, më duket Historia u kthye, i dalloj mirë hapat e saj gjithë potere. (Hyn Historia) Pse vonove kaq shumë, fjalët i patëm për një ditë, menduam se na kishe harruar.*

**Historia-** *E si mund t'ju harroja, e si unë dhe ju mund të harrohemi, ju kalorësit ... e mi; sot pas shumë kohësh u miratua vizita e një grupi njerëzish në pavionin tonë. Ishte e lodhshme, tepër e lodhshme kam biseduar me shumë njerëz, por askush nuk donte t'ia dinte, më në fund arrita t'i bind për të kryer këtë gjest sublim.*

**Të gjithë-** *Urra, urra, urra.*

**H7- Heroina e grave - (Pas një pauze të shkurtër) Kur do të vijnë?**

**Historia-** *Sot pasdite në orën 17.00.*

**H3- Heroi i luftës - Sot?!**

**H1- Heroi i punës me dru - Kaq shpejt?!”<sup>25</sup>**

Në fakt vizita e njerëzve në një muze është gjëja më normale, por për “muzeun” statik me personazhe stereotype në skenën e Brahushës dhe që funksionon si montazh ironik i kohëve të shkuara, vështirë se mund të ketë vizitorë. Autori operon me kundërvënien e kohës urgjente të ngjarjes që pritet të ndodhë, domethënë vizitës (sot pasdite në orën 17. 00) dhe kohën e pafund të pritjes nga ana e Historisë dhe të gjithë personazheve që

<sup>25</sup> Brahusha, Albri: *Vizita e fundit*, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1997, f. 3-4.

paraqesin të shkuarën aq “të lavdishme”. Kjo e shkuar është shpesh e pranishme gjatë dialogut. Madje me bëmat e së shkuarës heronjtë e pavionit fillojnë të maten me njëri-tjetrin:

**“H7- Heroina e grave** - *Kaq pak, kaq pak për ne heronjtë e pamposhtur, njëlloj si unë si ata të dy që kanë shekuj që hanë pluhur. Ta dija kështu nuk do të kisha luftuar fare për të hyrë në histori. Ej, o heronj kam luftuar krah për krah me burrat dhe shpërblehem njëlloj si dy figura që nuk dihet se kush janë! Këtu është ferr, këtu s'ka dialog, s'ka TV, s'ka asgjë. [...], gjithë jetën time jam sjellë si burrë, sepse ishte e vetmja mënyrë për të rënë në sy, por e shoh, e shoh që kam bërë gabim, duhet ta kisha shijuar jetën qoftë edhe për të vetmen arsye, për të mos qenë e pranishme në këtë vend me të çmendur. (Pauzë). Dua të fitoj kohën e humbur, dua të kërcej dhe të bëj dashuri (Sillet rrotull e kërcen dhe padashje thyen njërin nga bustet H6-ën). Lëvizni, shkunduni nga pluhuri mijëravjeçar... (Pauzë. Të gjithë mblidhen rreth bustit të thyer dhe shohin njëri-tjetrin gjithë frikë).*

**Historia-** *E shikon çfarë solli çmenduria jote, ky është krim, zhduke një figurë nga faqet e historisë, nuk ishte aspak i nevojshëm ky krim, e pse duhej të ndodhte kjo, por mos kujto se do ta kalosh lumin pa u lagur, ta mësoni një herë e mirë se çfarë ndodh kur lëvizni më shumë se e keni të lejuar. Nuk ishte aspak e nevojshme!*

**H7- Heroina e grave** - *Nuk e theva unë, ju betohem, ai plasi nga marazi, plasi se kishte mbi 500 vjet i mbuluar nga pluhuri, nuk është hera e parë që këtu bustet thyhen nga pesha e kohës, ai bust kishte kaluar tepër pushtime dhe beteja dhe tani nuk duroi as kërkesën time për të vallëzuar, ai e meritonte të zhdukej.*

Nga ana përmbajtësore këta janë disa personazhe klishe ose simbole të stereotipizuara, që janë marrë ironikisht nga paradigma kohore e **Historisë**, e cila vetë i ka prodhuar<sup>26</sup> dhe janë vendosur brenda sintagmës së një teksti dramatik ose më mirë në dialog me njëri-tjetrin. Përmes këtij dialogu, prodhohet konflikti me anë të të cilit strategjia autoriale bën të mundur asgjësimin e Historisë (si rrëfimtare ngjarjesh, faktesh dhe

<sup>26</sup> Shih: “Pa mua nuk do të ishit heronj, por njerëz të zakonshëm, të harruar në turma dhe në varret e pafund e të paemër të botës, do të përpëliteshit baltrave duke shërbyer si ushqim për barërat e këqia për të dalë prej tyre pastaj kështu siç jeni farë të këqia” Brahusha, Albri: *Vizita e fundit*, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1997, f. 12.



ndodhish) dhe të ekuivalentit të saj në kohërat më moderne TV-së, që shfaqet si një tjetër personazh në këtë dramë.

Mund të themi se teksti në vetvete të imponohet me kundërvënien e personave veprues, si metafora të paradigmës kohore (Historia, TV), brenda sintagmës metonimike të tekstit dramatik. Brenda kohës së kësaj sintagme tekstore dramatike, konvencionalisht e paraqitur si pavion muzeu, bartet dhe riciklohen historitë dhe ndodhitë e së shkuarës, përsëriten veprimet, në pritje të një vizite nga vizitorë që kurrë nuk vijnë. Pas lëvizjeve të shumta shkatërrimtare të Heronjve të dramës (ngrënia e Historisë, TV-së dhe thyerja e busteve të Heronjve të tjerë), duket se ndodh pendesa për atë që është bërë. Simbolikisht mund të themi se në këtë tekst duket se forma diskursive e dramës vajton për kohët e bukura të rrëfimit.<sup>27</sup> E gjithë kjo rrjedhë me kthesa e ngjarjes ndodh në sytë e një spektatori të palëvizshëm. Ngjarjet shkatërrimtare u përsëritën, por nuk ka asgjë për t'u shënuar. Gjithçka mbetet statike, madje edhe salla.

*“H5- Ndoshta Historia ka dashur të na bëjë qejfin si gjithmonë, ndoshta ajo historia e vizitës është sajuar thjesht për të na ngritur moralin.  
H3- Si nuk na shkoi nëpër mend më para kjo gjë, na duhet të pyesim historinë për këtë gjë dhe nuk kemi ku ta marrim.  
H2- Të shohim mirë mos janë këtu, ja atje (Bën me gisht nga salla) çfarë janë të gjithë ata që të hutuar, ulur në karrige, shohin që në fillim atë çka ne bëjmë?”<sup>28</sup>*

Ky tension i hapur i tekstit edhe me lexuesin-spektator kërkon t'i tregojë ironikisht këtij të fundit se tentativa për të shpëtuar dramën si

<sup>27</sup> Shih: *“H5- Unë nuk kujtoj asgjë, dhe as që dua të kujtoj më, unë them se jemi përçudnuar fare, na duhet dikush që të paktën të na thotë si dukemi, të paktën një pasqyrë, nuk*

*bëmë mirë që hëngrëm historinë, tani ajo mund të ishte shumë e vlefshme.*

*H3- Lëre, se u ngutëm, të them të drejtën në një farë mënyre më ka marrë malli.*

*H7- (Duke qarë) Dukemi si jetimë.*

*H2- Me vete e kemi, (i bie barkut) ja këtu na pastë bërë mirë.*

*H3- Më vjen për të vjellë, kam neveri.*

*H5- Ishte e majme, s'ke faj.*

*H7- Më vjen keq që u bëra shkaktare e gjithë kësaj ngjarjeje.*

*H3- Fliste aq bukur, sa të luante mendja, ishte pak e ashpër, por ia vlente, kot e hëngrëm.*

*H2- Ajo punë mori fund, historinë e hëngrëm ne, TV u prish dhe duhej të hahej.”*

Brahusha, Albri: *Vizita e fundit*, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1997, f. 22.

<sup>28</sup> Brahusha, Albri: *Vizita e fundit*, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1997, f. 23.

formë, duke përfshirë spektatorin tradicional brenda veprimit skenik dhe të kalojë përmes tij, nuk mund të ndodhë më.

### **Drama “Ishulli i Shitenit”**

Tek teksti “Ishulli i Shitenit”, Albri Brahusha parapëlqen dramën me situata të konvencionalizuara, që ngrihen mbi një metaforë të pastër dhe lëvizin në parabola veprimesh të shpenguara. Në këtë dramë me një akt rrjedhja e ngjarjes nuk është plotësisht racionale. Tek kjo dramë me një akt të vetëm, tensioni nuk vjen më nga ngjarja (ndodhia) ndërsujektive, por është brenda situatës, jo si tension i trilluar, që realizohet nga çdo batutë dramatike (siç është rasti i dramës tradicionale), por vetë situata duhet të shprehë tashmë gjithçka. Për këtë motiv, akti i vetëm, në qoftë se nuk do që të heqë dorë krejtësisht nga tensioni, zgjedh situatën në zgrip ose situatën që paraprin menjëherë katastrofën e afërt, e cila tashmë jepet që me ngritjen e siparit dhe që nuk mund të mënjanohet. Teksti në fjalë vë në dukje edhe njëherë dallimin esencial që filloi të shfaqë dramaturgjia moderne në letërsinë shqipe në raport me dramën e mëparshme. Dy sisteme dramatike ndodhen në kundërshti. Shiteni, ky emër i një ishulli të çuditshëm, të cilin autori e quan “ishulli i parapasvdekjes”, është vendi ku zhvillohen ngjarje ku nuk kuptohet fillimi, zhvillimi, fundi. Veprimi dramatik ka pushuar së qeni i vërejtshëm dhe i qartë. Autori kërkon një tip të ri veprimi, i cili është jologjik në dukje dhe në koherencë me situatën e njeriut në botën ku nuk dirigjon arsyeja, por absurdi. Sipas autorit në një situatë të tillë ndodhen edhe engjëjt. Në fillim të pjesës janë Gabrieli dhe Doktoru që dialogojnë ose më mirë rrëfejnë përvojat e tyre. Engjëlli Gabriel, si rrëmbyes i shpirtrave të njerëzve, është i pakënaqur që ka mbetur jashtë dyerve të parajsës. Ai paraqitet i mërzhitur me zanatin e tij.

*“Gabrieli - (Merr guximin) Dëgjo, unë kam vendosur të iki, do jap dorëheqjen, nuk do sjell më asnjëri këtu, njerëzit do jetojnë përjetësisht!”<sup>29</sup>*

Tipar i qenësishëm i këtij engjëlli të vdekjes duhet të jetë aksioni. Ai pa pushim duhet të vazhdojë misionin e tij. Mirëpo në dramë, ai paraqitet plotësisht i ndryshuar. Të gjithë të vdekurit në këtë dramë kthehen në miza, me përjashtim të Kinezit me Natashën. Ata vijnë të gjallë në këtë ishull, por vriten nga Doktoru, i cili në fund nxirret jashtë skenës. Në fakt, është kjo mungesë veprimi, e cila bën të mundur që engjëlli Gabriel të

<sup>29</sup> Brahusha, Albri: *Ishulli i Shitenit*, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 2000, f. 4.

ndihet si i burgosur. Në anën tjetër, është absurdi i kobshëm jetësor që e shndërron dalëngadalë këtë personazh në kundërshti të plotë me atë që ka qenë në fillim. Ai nga engjëll po kthehet në një njeri me dobësitë dhe frikat e veta. Veprimi konvencional i heroit tragjik në tragjedinë klasike ka një lëvizje nga jeta në vdekje ose nga lumturia në fatkeqësi, kurse në këtë tekst, heroi modern Gabriel kalon nga veprimi në pasivitet. Në vend të fazave zhvillimore të strukturës dramatike, në këtë tekst prodhohet vazhdimisht tensioni apo edhe enigmat. Ky tension është pjesë përbërëse dhe element i strukturës, sepse krijon mbresën e pritjes.

Lexuesi- spektator është vazhdimisht në ankth dhe pyet: “Kush është Gabrieli, engjëll apo njeri? Kush është Doktori? Cilët janë Kinezi dhe Natasha? Pse ata ndryshojnë rolet? Pse të vdekurit u shndërruan në miza?” Të gjitha këto enigma të cilat strategjia autoriale nuk i zgjidh, janë vendosur përgjatë tekstit dhe shtohen gjithnjë e më shumë drejt fundit të tij. Pakuptimësia e pranishme që në fillim rritet edhe më shumë, kur përmes dialogut autori përpiqet të luajë me idenë e teatrit në teatër.

Drama e Brahushës fillon me një hyrje jo të zakonshme dhe përfundon pa një fund. Zhvillimi nga kuptimi i caktuar drejt pakuptimësisë së përgjithshme është i pranishëm brenda këtij teksti letrar. Ky tip teksti ka një rrjedhë ritmike dhe emotive. Si përfundim, në lidhje me dramën “Ishulli i Shitenit” të këtij autori, mund të themi se zhvillimi dramatik varet nga një proces i dyfishtë: kuptimësi-pakuptimësi, si dhe nga shpejtimi i vrullshëm i ritmit që përcillet me rritjen e tensionit. Ja se çfarë shkruan autori në një fletëpalosje të shfaqjes “*Ishulli i Shitenit*”, përmes së cilës i uron mirëseardhjen spektatorëve: “*Hyrje në Ishull. Ishulli i Shitenit është një vend virtual. Banorët e tij po ju ftojnë të ndiqni një situatë, e cila ka ndodhur mijëra vjet përpara ose do të ndodhë mijëra vjet prapa. Ishulli nuk ndodhet në mes të detit, por në mes të fantazisë suaj, ku format, ngjyrat, tingujt dhe numrat përzihen për të krijuar idetë. Ishulli është krijuar bashkë me ju. Ai ka formën e një mase të palëvizshme, që quhet humanizëm. Ndaj idesë përpara se të shfaqet, i duhet të ndalet në Ishull, për të marrë trajtën përfundimtare. E gjithë kjo ndodh në harkun e disa sekondave dhe shpesh kur ju ndiheni të vetmuar. Ndërkohë po ju paraqitet një orë e gjysmë për efekt reflektimi. Mirë se erdhët në Ishull!*”

### **Risemantizim i mitit të perëndimit në një dramë me një akt**

Për këtë dramë Josif Papagjoni shprehet: “*Në dramën “Drejt perëndimit” (2006) operohet po me elementet e absurdit, me simbole të qarta dhe një gjuhë konvencionale, të cilat ndihmojnë që mesazhet mbi kaosin social të pas viteve '90 në Shqipëri të bëhen të kuptueshme;*

*gjithashtu, kritika mbi mungesën e referencave morale, mbi korrupsionin shpirtëror të shoqërisë postkomuniste, ku kahet politike konfliktuale e kanë gjymtuar rëndë ëndrrën dhe synimin e rinisë për prekjen e Evropës perëndimore si simbol të lirisë, progresit, pasurisë, mirëqenies. A. Brahusa priret dukshëm ndaj dramës së absurdit, me situata surreale, të përthyerë e të mbivendosura njëra përkundër tjetrës; me peripeci dhe bëma të konvertuara në simbole të rrokshme, duke gërshetuar nënshtresat dramatike e tragjike të dialogut (si nënkuptim) me formën e thukët komike, sarkastike e groteske. Mëtimi kah paradigmën postmoderniste ndonjëherë e bëjnë të vështirë kuptimësinë e teksteve të tij, po ashtu efemere kohën, vendin, sidomos rrethanën e zhvillimit të ndodhisë dramatike.”<sup>30</sup>*

Në këtë tekst kemi pranëvënien e mitit të perëndimit me ëndrrën mashtruese të lumturisë. Një burrë dhe një grua kanë ardhur si turistë në një hotel ku pretendojnë të shohin një eklips. Në atë hotel gjejnë një pronar dhe një hotelier, të cilëve i paguajnë një tufë me para, për të shijuar këtë moment magjik të eklipsit. Çiftit bujtës i shtohet një dyshe e pazakontë, një piktor dhe një ujk. Ky i fundit është krijesë e piktorit.

*“Piktori: I vetmi hotel në këtë zonë, sa kemi ecur.*

*Ujku: Pylli është i gjatë nganjëherë më i gjatë se pritja.*

*Piktori: Mjaft.*

*Hotelieri: Erdhën edhe dy të tjerë.*

*Burri: Pse i prisnit?*

*Hotelieri: Jo, jo ashtu kot, pastaj merruni me punët tuaja njëherë dreqi e mori.*

*Piktori: A keni një dhomë dyshe?”<sup>31</sup>*

Lexuesi mund të pyesë veten: “Ç’ne ujku këtu?!”

Ujku në tekstin “Drejt perëndimit” nuk të mërzi edhe pse e ngadalëson leximin. Është ajo shkapërdredhje që ai përfaqëson, ajo mungesë konsekuente, që na bën të hamendësojmë se aty po na thuhet diçka tjetër nga ajo që dimë rreth ujkut në letërsi. Kur shënon personat veprues në këtë tekst, autori nuk ngutet të vërë emra të përveçëm. Jurij Llotman<sup>32</sup> shprehet se shfaqja më e prerë e natyrës njerëzore del në përdorimin e emrave të përveçëm, që bëjnë të mundur spikatjen e individualitetit dhe origjinalitetin e personit, si bazë të vlerave të tij për “tjetrin” dhe “të tjerët”. “Unë” dhe

<sup>30</sup> Papagjoni, Josif: *Teatri dhe dramaturgjia shqiptare*, Tiranë, 2011, f. 212.

<sup>31</sup> Brahusa, Albi: *Drejt perëndimit*, Tiranë, 2005, f. 27.

<sup>32</sup> Llotman, Jurij: *Kultura dhe bumi*, Tiranë, 2004, f. 54.

“tjetri” janë dy anë të të njëjtit akt të vetëdijes dhe e kanë të pamundur pa njëri-tjetrin. “*Gjuha e kafshëve,- thekson Llotman, - me sa mund të gjykojmë, jashtë ndërhyrjes së njeriut, nuk zotëron emra të përveçëm. Ndërkaq, pikërisht ata e krijojnë atë tendosje ndërmjet individuale dhe së përgjithshmes, e cila qëndron në bazë të vetëdijes njerëzore.*”<sup>33</sup>

Teksti në fjalë ka karaktere pa emra të përveçëm. Ai që tërheq më shumë vëmendjen është Ujku, krijesë e Piktorit. Ujku si simbol, që në vetëdijen kolektive, është individualizuar përmes unitetit të tij të sjelljes, ndërsa në këtë rrafsh tekstual shprehimor, duket sikur veçohet. Në fakt ai nuk vjen si personazh i veçantë, por si prodhim i një personazhi tjetër brenda dramës. Ky simbol i vjetër i letërsisë dhe kuptimi i tij univok duket sikur thyhet në një replikë të personazhit Piktor. Teksti dramatik “Drejt perëndimit”, po tregon një ëndërr, në të cilën ngjet një kombinim i vendeve, i fillimit, i fundit dhe i drejtimit të lëvizjes. Ajo që e bën atë interesante për lexuesin-spektator, është tendenca për të lidhur hapësirën e emrave të përgjithshëm me një simbol të veçuar në letërsi, siç është Ujku.

“*Burri: Domethënë ju jeni i fiksuar pas ujqërve?*”

*Piktori: Ujku është shpirt njeriu*”<sup>34</sup>.

Ky imazh që rrëfen përmes paraqitjes së tij dhe që është animuar tek një tjetër personazh, është piktori i gjendur brenda një rrethane absurde. Ai sjell në tekst një ligjërim po aq absurd duke e lëkundur pritshmërinë e lexuesit. Vetëm dija se këto fjalë i referohen Ujku, na bën të mendojmë se kemi të bëjmë me ironi. Kështu ne jemi të detyruar ta trajtojmë prezencën e çuditshme të këtij personazhi-simbol edhe për funksionin e tij. Ironia dhe shpotia lidhen me faktin se ai Ujk, kërkon të veçohet, të trajtohet si rast specifik.

“*Burri: Ju dhemb plaga?*”

*Ujku: Jo shumë, jam mësuar atje në pyll. Luani dhe ariu na rrihnin përditë.*

*Nuk të lënë as të hash, as të flasësh, të gjithë lepujt janë trimëruar, sepse janë ushqimi i preferuar i luanit. Kur miku im piktor vendosi të më merrte me vete, nuk ngurrova, vendosa në çast, atje nuk rrihet më.*”<sup>35</sup>

<sup>33</sup> Llotman, Jurij: *Kultura dhe bumi*, Tiranë, 2004, f. 55.

<sup>34</sup> Brahusha, Albri: *Drejt perëndimit*, Tiranë, 2005, f. 31.

<sup>35</sup> Po aty, f. 34.

Hoteli rezulton të jetë diçka e rreme së bashku me pronarin dhe hotelierin, të cilët janë thjesht dy mashtrues që zhvasin klientët e tyre. Papritur klientët që kishin ardhur të bëhen pjesë e së jashtëzakonshmes, gjenden në një situatë absurde, si ekuipazh i një anijeje.

*“Ujku: Këtu jemi në një anije.*

*Të gjithë: Anijeeeeeeeeeeeeeeeeeeee!*

*Burri: A të thashë që ishte mashtrues. Ky nuk është hotel.*

*Piktori: Duhet menduar. Na duhet një kapiten dhe një timonier.*

*Burri: Po askush këtu nuk di të drejtojë një anije.*

*Gogoli: Sa kemi paguar për të hipur këtu?*

*Burri dhe Gruaja: Gjithë pasurinë tonë. Kemi shitur shtëpinë.”<sup>36</sup>*

Në qoftë se merret domethënia e mitit si një tërësi e ndërlikuar kuptimi dhe forme, do të kishim një kuptimësi të dyfishtë. Vetëm duke e kuptuar në këtë mënyrë si një mekanizëm të ndërlikuar dhe me dinamikën e vet, bëhet i mundur leximi i “mitit të perëndimit” të Albri Brahushës. Lexuesi model e jeton mitin e kësaj vepre duke u nisur nga ky pozicion i tretë. Miti i perëndimit i Brahushës është shumë i errët nga ana kuptimore për të qenë i vlefshëm ose shumë i qartë për të qenë i besueshëm. Në këtë dramë veprimi dramatik zëvendësohet nga narracioni skenik, rregullin e të cilit e mban Regjisori dhe Burri. Këtë të fundit e shohim si subjekt të vendosur në një ëndërr dhe kështu kemi një veprim skenik, në të cilin vetë vepruesit nuk janë subjektet e një drame, por janë disa subjekte të narracionit.

*“Burri: Mjaft, atje tej takova regjisorin. Ishte shumë i mërzhitur. Ju keni dalë fare nga kontrolli, mjaft më! Kjo është ëndërra ime dhe nuk ju jap më të drejtë të vazhdoni. Nuk mund ta duroj më këtë realitet, që ju me dëshirën e mirë për të vdekur krijoni në mendjen time. Unë nuk ju besoj më. Unë dua ta ndryshoj situatën ku ndodhem. Po detyrohem ta ndërpres ëndërrën time, sepse ju jeni impotentë dhe injorantë. Kjo karakterinë nuk ekziston në të vërtetë. Ju me çdo kusht kërkoni ta mbani gjallë për të përlijtur veset dhe mashtrimet tuaja.”<sup>37</sup>*

<sup>36</sup> Brahusha, Albri: *Drejt perëndimit*, Tiranë, 2005, f. 50.

<sup>37</sup> Po aty, f. 78.

Çdo gjë në këtë dramë njëaktëshe të bën të besosh se Burri si personazh me natyrën e tij paraqitëse të veprimit, mund të lutet me fjalë atje ku realizimi skenik nuk mbërrin të dalë.

Me rënien e ligjërimeve të mëdha në funksion të ideologjive, kanë rënë edhe ligjërimet apo kanotacionet e simboleve. Një nga këto simbole është edhe ai i ujkut të Brahushës, i cili kërkon të shtegtojë nga imagjinaria e zakonshme e lexuesit. Jepet ideja e ujkut që shkon drejt perëndimit duke lënë pas imazhin dhe prapambetjen e një pylli në dekadencë.

*“Ujku: Ah po, luani është diktator, ndërsa harusha është prepotente. Luani është daja i mizës dhe xhaxhai i një luani të vogël, kurse harusha është tezza e miut dhe halla e dhelprës. Ka plasur miqësia në pyll. Nepotizëm i gjallë. Aty ku luani dhe miza bëjnë aleancë, nuk ka vend për ujkun vetmitar.”<sup>38</sup>*

Replika alegorike e sipërcituar nga teksti “Drejt perëndimit”, është një shprehje simbolike e prishjes së rendit ciklik natyror në botën e egërsirave. Në këtë rast rënia e këtij rendi ciklik të gjërave në pyllin e egërsirave, është tregues për ndërtimin e një imazhi të ri për ujkun në syrin e lexuesit-spektator. Ujku nuk është më as grabitqar e as i pabesë. Ai është i gatshëm të kontaktojë me njeriun dhe të jetë i pandershëm me të.

*“Ujku: Po si kujton ti se u bëra ujk unë, ja kështu, duke ndenjtur vetëm. Megjithatë ty nuk do të kish ngrënë edhe sikur të vdisja uri. [...] Piktori: Unë nuk dua të drejtoj anijen dhe duartrokitjet e mia, do t’ia fal Ujku. Ju faleminderit për respektin e thellë që keni për pikturën time dhe për të gjitha veprat e mia. Ujku: Tani e kam radhën unë. Dua t’ju them vetëm një fjalë. Më besoni se unë di ta drejtoj anijen dhe do ta shihni se ku do t’ju çoj. Tani loja mbaroi. E zëmë se dikush nga salla vjen të na japë përgjigjen. Ja e zëmë se erdhi, ja edhe zarfi. Kam shumë emocione. E zëmë se këtu brenda këtij zarfi, janë të gjitha ato duartrokitje të fuqishme, të gjoja njerëzve. Më në fund kam fituar unë, Ujku. Një duartrokitje e fuqishme.”<sup>39</sup>*

Strategjia autoriale vendos të procedojë përmes ironisë tekstuale. Pika jonë e nisjes në këtë artikull ishin këto tekste dramatike të botuara apo të

<sup>38</sup> Brahusha, Albri: *Drejt perëndimit*, Tiranë, 2005, f. 35.

<sup>39</sup> Po aty, f. 53-54.

pabotuara, të cilat i ofrohet lexuesit – spektator duke sjellë një fryme të re, që në njërën anë i bie ndesh normave tradicionale të kësaj gjinie dhe në anën tjetër kërkojnë të ruajnë ekzistencën e saj përkrah gjinive të tjera.

## PËRFUNDIM

Dramat e autorit Albri Brahusha e tërheqin në hapësirën e përvojës lexuesin-spektator, i cili në disa raste mbetet i paqartë dhe në rrafshin sipërfaqësor të tekstit. Në këtë prizëm, këto krijime letrare janë akoma në kërkim të lexuesit model.

“Vizita e fundit”, kjo formë moderne e dramës e bën lexuesin-spektator një vëzhgues, i cili në një lexim të thellë të tekstit të Albri Brahushës konstaton se asnjë “lavdi” heronjsh nuk mund të qëndrojë jashtë kohës së rrëfimit.

Teksti “Drejt perëndimit”, me çmitizimin që i bën iluzionit të perëndimit, merr përsipër të kalojë një koncept qëllimor.

Brahusha tek “Ishulli i Shitenit”, si autor i dramës moderne dhe postmoderne e vendos absurditetin e jetës njerëzore në qendër të veprës së tij. Për këtë arsye, personazhet duken si qenie në ankth, pa qëllime, bosh, me shpresa të pakta për një rrugëdalje nga një univers, në të cilin nuk gjejnë një vend.

Këto janë disa nga veçoritë e strategjisë autoriale të Brahushës, e lojës dhe ironisë përmes tekstit të tij dramatik.

## BIBLIOGRAFI:

1. Brahusha, Albri (2005): *Drejt perëndimit*, Tiranë, f. 35.
2. Brahusha, Albri (2000): *Ishulli i Shitenit*, Teatri “Migjeni”, Shkodër, f. 24.
3. Brahusha, Albri (1997): *Vizita e fundit*, Teatri “Migjeni”, Shkodër, f. 23.
4. Llotman, Jurij (2004): *Kultura dhe bumi*, Tiranë, f. 55.
5. Papagjoni, Josif (2011): *Teatri dhe dramaturgjia shqiptare*, Tiranë, f. 212.



### **The tease and dramatic irony through Albri Brahusa's text**

#### ***ABSTRACT***

In course of the historic development, the dramatic genre, as a form or rational and controlled instrument, has had different types of changes. During the 90's the dramatic genre changed its course from realist drama towards a modern and postmodern one. Our thesis, through a method of surveying these artistic texts intends to analyze why the best efforts to save the dramatic genre from crisis are done exactly by these modern texts of this author. The dramas of Albri Brahusa came to know the success in different contests, but the impact on the reader-spectators was reduced. It is enough to remember the History, television in the texts of A. Brahusa, which by removing the thematic character, are transformed into formal constituent elements.

Some symbols have the function of stereotypical images, which are an index of the eternal social stagnation. Modern and postmodern works have thematic, stylistic and narrative elements in their composition, which change regarding to their peculiar way of organization to other classic or modern works.

Irma SOKOLI (BILALI)

**REFLEKTIME MBI TRAJTIMIN E FIGURËS SË  
NAIM FRASHËRIT NË VËLLIMIN  
“HISTORIA E LETËRSISË SHQIPE”, 1983**

Ky punim kërkon të tregojë dhe të argumentojë se si është hulumtuar mbi figurën e autorit, të quajtur poeti kombëtar i shqiptarëve, në vëllimin e “Historisë së Letërsisë” të vitit 1983. Studimi mbështetet mbi faktet, vërejtjet, reflektimet e shpalosura në vepër dhe veçanërisht tek pjesa mbi N. Frashërin në këtë vepër të historiografisë sonë. Vëllimi është vepër e Akademisë së Shkencave dhe puna për hartimin e tij u drejtua nga Dh.S.Shuteriqi. Kapitujt VII-XI, ku përfshihet romantizmi dhe analiza mbi jetën dhe veprën e Naim Frashërit, janë hartuar nga Razi Brahimi dhe redaktuar nga Vehbi Bala.

Historia e letrave shqipe njih zhvillimet e saj në ecurinë progresive të historisë së kulturës shqiptare. Nëpër shekuj, letërsia shqiptare, ka pasqyruar fatin e popullit shqiptar, fatin e një vendi të vogël në një rajon të Evropës, i cili për arsye politike, historike, ekonomike dhe gjeografike, ka mbetur i pazhvilluar në këtë kontinent. Në të dy dekadat e fundit, duhet të jetë rigjallëruar edhe një përpjekje e njerëzve të letrave, për të shfaqur një tjetër pamje të historisë së letërsisë shqipe.

Diferenca ndërmjet historiografisë letrare dhe historiografive të tjera, konsiston në faktin që, është e pamundur të fiksohet në të një lëvizje progresive (lëvizje e cila mund të takohet p.sh., në historinë e shkencës dhe të teknologjisë). Pavarësisht kësaj ekziston një kontinuitet evident në prodhimin letrar, që individualizohet në karakterin specifik të letërsisë si bashkësi *konvencionesh* (linguistike, strukturore, si llojet letrare, formale etj.), të organizuara si një *traditë*<sup>40</sup>, në të cilën secili shkrimtar ribëhet edhe kur i kundërvihet asaj në kërkim të së resë. Nga njëra anë, në traditën tonë, vepra letrare institucionalizon subjektivitetin, origjinalitetin e individit; nga ana tjetër imponohet si një tip i veçantë komunikimi që përballet me shoqërinë, pra me publikun, edhe ai si pjesëtar i traditës letrare.

---

<sup>40</sup> Pazzaglia Mario , Il novecento, Zanichelli, Bologna - Italia, 2005, f. 8.

Në një gjykim të përgjithshëm dhe besoj se më e pakta që mund të bëhet sot për të kuptuar dhe cilësuar vlerat e kombit, për të gjetur çelësin e veprimit dhe kundërveprimit drejt asaj (gjë që është më emergjente), duhet të arrijmë shkrimin e plotë, objektiv e të paanshëm të historisë së letërsisë shqipe, një detyrë kjo e konceptuar dhe e shtruar edhe nga autoritet e kësaj shkence në Shqipëri. I referohem në këtë rast autores F. Dado, kur pohon se “*Historia e letërsisë mbart funksionin themelor të rindërtimit të letërsisë në proceset e gjata të zhvillimit historik, duke zbuluar përmes hetimit të formave artistike, evolucionin shpirtëror dhe krijues të një populli*”<sup>41</sup>.

Duke u pozicionuar në hyrje të veprës, “Historia e Letërsisë Shqiptare”, vihet re se në parathënien e këtij vëllimi synohet të bëhet sinteza shkencore e rezultateve të arritura nga studimet e deriatëhershme historiko-letrare. Dhe gjithashtu sqarohet se kjo vepër mbështetet në vëllimin e mëparshëm “Historia e letërsisë shqipe”, 1959 dhe kërkohet që të pasurohet me arritjet e reja shkencore gjatë viteve në distancë.<sup>42</sup>

Sigurisht, duke qenë pjesë e një konteksti të caktuar, vepra lidhet me teorinë ideologjike dhe sublimon referencën tek metodologjia marksist-leniniste dhe në fjalimet e udhëheqësit të kohës. Ishin këta faktorë jashtëletrarë që ndikuan fuqishëm dhe negativisht në metodologjinë e kritikës së kohës dhe në mënyrë specifike në shkrimin e historisë së letërsisë shqipe.

Në përballjen që ka të bëjë me historinë e letërsisë shqipe, ky vëllim ka për qëllim të japë një përgjigje më të gjerë në aspektin e kuptimeve, interpretimeve dhe të vlerave për ata që dëshirojnë t’i drejtohen prodhimit letrar të shqiptarëve, duke rindërtuar kontekstin që ka drejtuar gjenezën e punimeve. Teksti zhvillohet sipas klasifikimeve për periudhat letrare, me të cilët kërkuesit operojnë. Ndarja në pjesë e kësaj vepre bëhet në bazë të ecurisë kronologjike nëpër të cilën ka ecur letërsia shqipe, pikërisht në tri etapa kryesore: 1) Letërsia e vjetër shqiptare; 2) Letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare; 3) Letërsia e periudhës së shtetit shqiptar të viteve (1912-1939). Nga studiuesit konfirmohet se është adoptuar periodizimi i etapave të historisë së popullit dhe theksohet se kjo nuk ka penguar trajtimin e dukurive edhe jashtë caqeve historiko-politike. Një formë e tillë studimi është ndjekur edhe në shumë studime të tilla të këtij lloji, duke qenë se është edhe më e njohura dhe më e përdorura nga historicienët e letërsisë në shumë vende të botës. Studiuesit e huaj pohojnë se ndarja e

<sup>41</sup> Dado Floresha, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2009, f. 16.

<sup>42</sup> ASHSH, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1983, f.4.

historisë së letërsisë sipas shekujve është një ndarje komode <sup>43</sup>(Pazzaglia 2005: 6).

Kjo ndarje shoqërohet me një analizë të detajuar të fenomeneve, faktorëve, përfaqësuesve e zhvillimeve të letërsisë në këto periudha, duke e parë procesin të lidhur ngusht me rrjedhën historike dhe politike të vendit. Janë dhënë të sistemuara në përputhje me një çelës interpretues, drejtimit kryesore, parimet e përgjithshme të kritikave letrare të shekullit të njëzetë.

Ky vëllim i kushtohet zhvillimeve komplekse që kanë karakterizuar fenomenin letrar shqiptar nga shek. XVI deri në fillim të shekullit të kaluar. Ngjarje shumë të larmishme dhe torturuese, pranëvihen në këto periudha. Kultura dhe letërsia jonë zhvillohej në sfondin e pushtimeve dhe luftërave me turqit për të kaluar në përpjekjet e gjithanshme drejt shpalljes së Pavarësisë. Në mënyrë të natyrshme dhe kontekstuale dinamizohet dialektika e vazhdueshme midis kulturës së traditës dhe të formave të reja artistike dhe letrare të qytetërimit modern.

Vepra e Naimit sigurisht nuk mund të shihet e ndarë nga sistemi letrar i romantizmit shqiptar dhe në këtë këndvështrim ajo është ndoshta kulmi më i lartësuar i kësaj periudhe. Kjo vepër sigurisht përfaqëson pjesën më të përparuar inteligjencës patriotike demokratike shqiptare. Këtë fakt e kanë vënë re pothuajse të gjithë kritikët, teoricienët dhe historianët e letërsisë shqipe që nga Mit'hat Frashëri, Çabej, Maloki, Konica, Bulka për të arritur si kulm me monografinë e Rexhep Qoses, i cili drejtoi edhe kolanën mbi veprat e Naimit të botuara vitet e fundit, pa lënë mënjanë një tjetër studim të hollësishëm si ai Dh.Shuteriqit, i pasuar nga Jorgo Bulo, Sabri Hamiti etj. Në tërësi shkrimi naimjan ka një rëndësi të dorës së parë për gjithë zhvillimin e letërsisë sonë.

Pjesa mbi Rilindjen Kombëtare, në librin "Historia e Letërsisë Shqipe", zë hapësirën më të gjerë. Ajo përbëhet prej shtatëmbëdhjetë krerësh dhe kreu XI i takon autorit më të studiuar e më të përmendur të historisë së letërsisë, kulturës e arsimit shqip. Kreu VIII i titulluar si hyrje përshkruan Rilindjen Kombëtare si një lëvizje e gjerë që zhvillohet brenda dhe jashtë vendit në kolonitë në të cilat ndodhen shqiptarët. Aty trajtohen kushtet historike, ideologjia dhe politika, veprimtaria kulturore, ajo artistike. Përcaktohen gjithashtu si ndarje më vete etapat nëpër të cilat u zhvillua kjo lëvizje. Një vend të rëndësishëm zënë përpjekjet e studiuesve për karakterizimin e përgjithshëm të letërsisë së Rilindjes, karakteristika të cilat u bënë edhe pjesë e gjithë teksteve mësimore të mësimin të letërsisë në

---

<sup>43</sup> Pazzaglia Mario , Il novecento, Zanichelli, Bologna, Italia, 2005, f.6.

shkollat e mesme dhe universitete. Pas viteve '90 studiuesit e shohin si kontradiktë më vete emërtimin e periudhës dhe drejtimin letrar të romantizmit që shoqëroi veprat artistike<sup>44</sup>.

Në konceptimin e studimit mbi romantizmin në tekstin "Historia e letërsisë Shqipe", jepen të dhëna gjithashtu dhe mbi tematikën në përgjithësi, e cila dallohet në veprat e autorëve përfaqësues, analizohen mjetet dhe gjinitë letrare dhe në përmbyllje të kreut lihet një vend i konsiderueshëm për mendimin estetik dhe kritik që shoqëroi këtë periudhë të rëndësishme të historiografisë letrare shqipe. Siç shprehet studiuesja F. Dado, historia e zhvillimeve letrare, ka qenë vazhdimisht proces specifik i zëvendësimit të rrymave të ndryshme<sup>45</sup> dhe si e tillë shihet letërsia e Rilindjes Kombëtare në kuadrin e procesit letrar shqiptar. Brenda disa viteve kjo letërsi pësoi një zhvillim të fuqishëm dhe u pasurua duke pasur një pikënisje tek vepra e De Radës, ndoshta dhe më herët, e duke vijuar me autorë të tjerë të rëndësishëm për romantizmin shqiptar si drejtim letrar.

Duke vërejtur këtë linjë studimore në vëllimin "Historia e letërsisë shqipe", 1983, sqarojmë se kjo mënyrë studimi lidhet me tipologjinë e teorisë letrare të pozitivizmit, e lidhur me studimin e zhvillimeve kryesore të historisë, sociologjisë dhe psikologjisë së kohës e të autorëve përkatës.

Studimi në tërësi, lidhet në mënyrë të qëllimshme dhe të njëanshme me modelin marksist të interpretimit të historisë letrare të një kombi, duke u instaluar dhe duke funksionuar me patjetër si kritikë ideologjike.

Në kapitullin mbi Naim Frashërin është ndjekur thaujse i njëjti proces. Në krye të kapitullit zë vend parësor një vlerësim përmbledhës mbi autorin duke e quajtur "apostull i shqiptarizms", një definicion referencial të cilin e gjejmë të përhapur ngado. Në këtë pikëpamje i jepet një rëndësi superiore faktit se vepra e Namit pasqyron gjendjen e lëvizjes kombëtare të kohës<sup>46</sup>.

Intinerari paraqitës fillon me jetëshkrimin për Naimin ku tregohen etapat jetësore të autorit në Frashër, Janinë e Stamboll, i plotësuar me fakte dhe detaje rreth kronologjisë jetësore të poetit duke e lidhur gjithmonë me kontributin esencial në shërbim të çështjes kombëtare. Vëmë re këtu se nga jeta në Turqi, vijnë vetëm detaje të lidhura më lëvizjen patriotike dhe mungojnë elemente nga biografia dhe lidhja e Naimit me vendin dhe

---

<sup>44</sup> Çapaliku, Stefan, *Paradokse historiko-estetike*(Çështja e Rilindjes Kombëtare shqiptare) në Studime Shqiptare 2 , Historia e letërsisë si grindje metodike, Botim i Universitetit të Shkodrës, 1995, f. 29.

<sup>45</sup> Dado, Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Tiranë, "Onufri", 2006, f.171.

<sup>46</sup> ASHSH, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1983, f.176.

kulturën orientale e cila është mjaft e rëndësishme për formimin e mendimtarit dhe pjekurinë artistike të poetit.

Sot korpusit të shkrimeve për Naimin po i shtohen gjithnjë e më shpesh studime mbi jetën dhe veprimtarinë e tij në Stamboll, si “*Naimi në Kostandinopojë*” nga Laurant Bica, apo pjesë nga “*Bioletra*” e Sabri Hamitit. Këto vepra e të tjera kërkime, kërkojnë të plotësojnë boshllëkun që ekziston në laboratorin studimor shqiptar mbi autorin.

Si faktor i rëndësishëm, botëkuptimi dhe pikëpamjet shoqërore e politike, analizohen hollësisht, duke vënë theksin në bindjet iluministe, ndërsa përse i takon botëkuptimit fetar, ai pasqyrohet në këndvështrimin nga ku filozofia panteiste, të cilën përqafon Naimi, ndërthuret me darvinizmin. Duke aluduar se Naimi shkroi “Qerbelanë” për t’i rënë ndesh sektit fetar (synizmi) që ekzistonte se fe zyrtare në Perandorinë Osmane, kërkohet të përcillet ideja se ai denonconte kështu rendin shtetëror. Në pikëpamje të ndryshme që në vitin 1936, një nga studiuesit simbol të gjuhësisë, por dhe letërsisë shqipe E.Çabej, në fillimet e tij pohon se tek Naimi, influencën perëndimore e gjejmë të përzier në mënyrë të çuditshme me influencën orientale.<sup>47</sup>

Shtrohet natyrshëm pyetja: Sa të sigurt mund të jemi për këto synime, kur ai për 18 vite ishte një nga punonjësit e nderuar të kësaj Perandorie? Edhe kur pranohet nga autori i këtij punimi, referimi i Naimit tek Zoti, në vargjet e poemave të tij, supozohet nga autorët e vëllimit historiografik letrar se ai shërben thjesht si element stili e forme artistike<sup>48</sup>. Pa dashur të hyjmë në analiza të thella filozofike dhe teologjike, konstatojmë vetëm se ky gjykim ka mospërputhje me teorinë dhe konceptet mirëfilli filozofike e fetare, duke i lënë kështu të paqartë nga ana shkencore lexuesit.

Lirikat e Naimit analizohen gjerësisht duke konstatuar që në fillim se ato zënë vendin kryesor në krijimtarinë e poetit. Shqyrtohet tema patriotike, e cila gjen përhapje të gjerë në poezitë naimjane nëpërmes ilustrimeve të vargjeve e komenteve të studiuesit. I kushtohet një vend i rëndësishëm interpretimit tematik dhe motiveve të veprës “Bagëti e bujqësi”. Sillet në vëmendje këtu se mund të ishte shumë me vlerë për lexuesit analiza strukturore e poemës, ku ndër të tjera mungon edhe një këndvështrim i rëndësishëm krahasues mes veprës në fjalë dhe “Gjeorgjiket” e “Bukoliket” e Virgjilit, për të cilat është pranuar se ekzistojnë elemente analogjike në aspektin tematik e strukturor.

<sup>47</sup> Çabej, Egerem, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Çabej, Tiranë, 2009, f. 48

<sup>48</sup> ASHSH, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1983, f.183.

Duke iu drejtuar vëllimit “Lulet e verës”, veçanërisht poemës “Bukuria”, pranohet një lloj ndikimi nga letërsia orientale, por ai cilësohet krejt anësor. Duke qëndruar këtu dhe në tiparet romantike të poezisë naimjane kthehem përsëri tek Çabej, kur arrin në konkluzione të tilla si “romantike është fryma religjioze që përshkon veprat e Naimit e përzier me ngjyrë mistike islamike”.<sup>49</sup> Në studimet e viteve `30 (kam parasysh këtu Krist Malokin, në veprën studimore *Oriental apo occidental*) si dhe Musine Kokalarin në studimin e saj të diplomës në Itali, ku theksohet vazhdimisht se ndikimi i letërsisë orientale perse dhe arabe, është mjaft i rëndësishëm në poezinë me motive erotike të Naimit. Nën këtë linjë po orientohen studimet e fundit. Ashtu si dhe në ato të viteve ‘30, njerëzit e letrave janë të mendimit se Naimi në krijimet e tij poetike, qoftë persisht ose në shqip, është ndikuar shumë nga poeti, mistiku dhe kolosi i letërsisë perse, Mevlana Xhelaledin Rumi.<sup>50</sup>

Gjithashtu, studiuesi J. Bulo, duke u përqendruar tek veçoritë e poetikës së Naimit, vë re fizionominë e lirikave persisht, duke veçuar karakterin kontemplativ, përsiatës në frymën sufite dhe stilin simbolik dekorativ. Motivet karakteristike, gjithashtu, meditimet filozofike, sipas Bulos, janë zhvilluar në shtratin e natyrshëm me një shqipe poetike të përpunuar.<sup>51</sup>

Referimet në këtë pjesë të tekstit i referohen udhëheqësit të atëhershëm dhe lihen mënjanë opinionet e studiuesve Çabej, Maloki etj., të cilat janë gur themeli për historinë e letërsisë shqipe. Shqipëria është gjendur kurdoherë mes lindjes dhe perëndimit, mes orientit dhe oksidentit e lidhjet ndërkulturore, janë të kudogjendura në historinë shumëshekullore të saj.

Një vijimësi e tillë ndiqet për pjesën tjetër të veprës së poetit, ku krejt përmbledhtazi dhe në mënyrë të përgjithshme trajtohet lirika e Naimit në gjuhë të huaj, e cila sot po rikthehet si objekt studimi për kritikët.

Jepen informacione dhe interpretime për vjershat didaskalike dhe fabulat. Nëndarja pasuese kalon në një paraqitje të përimitësuar për poemën epike-historike “Histori e Skënderbeut”. Kryesisht trajtohet tema dhe nëntemat dhe vetëm në një paragraf të shkurtër analizohet stili dhe struktura e veprës. Nuk lihet pa përmendur edhe proza naimjane si vlerë kryesisht në mesazhin moralist dhe didaskalik.

<sup>49</sup> Çabej, Eqerem, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Çabej, Tiranë, 2009, f. 48.

<sup>50</sup> Tamimdari, Ahmed, *Historia e letërsisë perse*, Përktheu: Abdullah Rexhepi, ShB, Naimi, Tiranë, 2008, f.4.

<sup>51</sup> Bulo, Jorgo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, “Dituria”, Tiranë, 1998, f.40.

Në fund të kreut nga historianët e atëhershëm të letërsisë, përmblihen karakteristikat dhe mjetet e poezisë së Naimit, si një trashëgimi e pasur letrare. Me të drejtë vihet theksi mbi ushqyerjen jetëdhënëse të poezisë naimiane në gurrën e pashtershme të folklorit shqiptar. Dëshmohet nga autorët ndonjë mangësi në teknikë, si: zgjatjet e panevojshme, përsëritje e moralizime të tepërta. Këto shihen në kontekst të gjendjes së letërsisë në Shqipëri gjatë shek.XIX. Me nota pezhorative përmendet Konica për gjykimin e tij mbi Naimin, të cilin e kritikonte pikërisht për moralizimin dhe faktin se përqendrimi te tematika, kishte dëmtuar formën artistike dhe vlerën estetike të poetikës së tij. Në përfundim vlerësohet Naimi si shkrimtar dhe ideolog novator për kohën, kryesisht në tematikë, duke iu referuar historisë së letërsisë shqipe të vitit 1959.

Përmbyllet kreu duke glorifikuar faktin se shteti i atëhershëm vlerësonte lart këtë figurë, duke dekoruar personalitetet e shquara me urdhrin që mbante emrin e autorit.

Ky lloj institucioni akademik universitar, ka peshën e vet sot në lëmin e studimeve historike letrare për letërsinë dhe kulturën shqiptare. Sigurisht flasim këtu për një angazhim të rëndësishëm në fushën e historiografisë letrare shqipe. Orvatjet e autorëve rrugëtojnë nëpër një udhë përmes së cilës ecën shkrimi dhe receptimi i veprës letrare sipas kohës, mjedisit dhe vendit. Një tablo e gjerë panoramike është sjellë në këtë vëllim nga studiuesit tanë, ku sigurisht shihet se letërsia lidhet historikisht me zhvillimet antropologjike dhe sociale të njerëzimit.

Aq më tepër çmohet kjo punë, kur akoma nuk është kapërcyer kjo relike me vlerë dhe nuk është arritur të formulohet një tjetër “Histori e Letërsisë Shqipe”.

Në përfundim gjykoj se hulumtimi drejt kësaj vepre në tërësi dhe qëmtimi mbi kapitullin kushtuar Naim Frashërit në veçanti, vlen të jetë në qendër të vëmendjes për dy arsye.

- E para, për të studiuar vëllimin “Historia e letërsisë shqipe” si të tillë, duke kërkuar aty evidentimin e problemeve të rëndësishme teorike të historiografisë letrare shqipe. Duhet shqyrtuar duke pranuar në mënyrë objektive arritjet dhe të përjashtohet çdo konceptim jashtë teorive letrare. Gjykimet e njëanshme të veprave të artit e veçanërisht të letërsisë sonë, kanë vënë në pikëpyetje për kohë të tëra vlerat kombëtare të kulturës shkencore albanologjike në Shqipëri dhe gjetkë.
- Besoj se objektivi tjetër duhet përqendruar në këndvështrimin krahasues mes studimeve të hershme historiko-letrare, vitet ‘30 të shek.XX,



veprës në fjalë dhe teksteve kritike që shkruhen sot mbi Naim Frashërin për të përcaktuar saktë vendin e tij në historinë e letërsisë shqiptare.

Njëra nga çështjet që paraqet më interes dhe gjithherë aktuale përse i takon artit letrar është se letërsia është dialog. Nëpërmjet analizës së këtij dialogu është e mundur të kuptojmë se si një tekst e mban të lartë vëmendjen e tij në publik.

Siç duket mendimi kritik i të gjitha kohërave, me të drejtë, ia prentoi Naimit vendin e përzgjedhur në rrethin letrar shqiptar. Në korpusin e studimeve letrare mbi autorin një vend të konsiderueshëm sigurisht e zënë historitë e letërsisë të botuara brenda apo jashtë vendit. Mos të harrojmë se të fundit histori të letërsisë shqipe e shkroi një studiues i huaj Robert Elsie, si për të na thënë se duhet të jemi më të vëmendshëm e këmbëngulës ndaj çështjeve themelore të shkencës e kulturës sonë.

Problemet e ekzistencës së një kombi lidhen me fuqinë dhe përshpejtimin e nismës për të ecur përpara, po aq sa me përngulitjen e fortë në karakterin e vet. Duke vlerësuar atë që na vjen si mesazh nga paraardhësit, duke ndryshuar në emër të përparimit e zhvillimit, do të ecim të sigurt në rrugën e progresit.

#### **BIBLIOGRAFIA:**

1. ASHSH (1983): *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë.
2. Bulo, Jorgo (1998): *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, "Dituria", Tiranë.
3. Çabej, Eqerem (2009): *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Çabej, Tiranë.
4. Çapaliku, Stefan (1995): *Paradokse historiko – estetike (Çështja e Rilindjes Kombëtare shqiptare)* në *Studime Shqiptare 2, Historia e letërsisë si grindje metodike*, Botim i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
5. Dado, Floresha (2006): *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Tiranë, "Onufri".
6. Dado, Floresha (2009): *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota Shqiptare, Tiranë.
7. Pazzaglia, Mario (2005): *Il novecento*, Zanichelli, Bologna.
8. Tamimdari, Ahmed (2008): *Historia e letërsisë perse*, Përktheu: Abdullah Rexhepi, ShB, "Naimi", Tiranë.

**Reflections on the approach to the image of Naim Frasheri in the  
“History of Albanian Literature in 1983”**

***SUMMARY***

This research aims to look in details in the Albanian literary historiography. Specifically, it represents, on scientific analysis, the life and work of Naim Frasheri reflected in this volume. The way this work is interpreted features various issues concerning the theoretical and methodological principles of literary science. Reference to works of Naimi makes us believe that it plays a crucial role in the development of the Albanian literary science especially in the discipline of the history of literature. This article draws attention to objective reviews of the literary study to contribute to the rewriting of the “History of the Albanian Literature” in an unbiased and scientific way.

Orjeta BAJA

**MBI SHKRIMET GJUHËSORE NË REVISTËN  
“HYLLI I DRITËS”  
(1913 – 1944)**

“Hylli i Dritës” është ndër revistat e para, botuar në Shqipëri, me një program të qartë kryesisht atdhetar, politik e kulturor, drejtuar nga themeluesi i saj At Gjergj Fishta. Fishta së bashku me përfaqësues e bashkëpunëtorë të tjerë të saj, me punën e tyre të vyer arritën të sjellin një revistë me larmi shkrimesh e studimesh.

Në këtë revistë trajtohen tema të ndryshme, *si nga ato* që kanë lidhje me formimin qytetar e atdhetar të shqiptarëve, me aftësinë e shqiptarëve për të organizuar shtetin e vet mbas pesë shekujsh pushtimi të huaj e shumë probleme të tjera, të cilat, në mënyrën se si trajtohen, kanë qëllimin kryesor që të nxisin, moralisht e në mënyrë vepruese, një mënyrë të re për të kuptuar marrëdhëniet në mes individit e shtetit, në mes shoqërisë e shtetit; *ashtu si edhe nga ato* me sfond historik, kulturor e në disa raste gjuhësor, ku tek të fundit edhe jemi ndalur me një vëmendje të posaçme.

Qëllimi ynë në këtë trajtesë është nxjerrja e materialit gjuhësor të trajtuar në këtë revistë prej vitit të themelimit të saj, më 1913, deri më 1944 (pa kaluar te shkrimet e revistës gjatë viteve 1993 e këndej), me synimin për të shquar natyrën që patën shkrimet gjuhësore gjatë kësaj periudhe.

Për realizimin e një qëllimi të tillë, së pari vrojtua materialin e larmishëm që përmban kjo revistë në 174 numrat e botuar gjatë periudhës së sipërpërmendur e më pas evidentimin e klasifikimin e atij gjuhësor sipas disiplinave përkatëse, ku rezultoi si më poshtë:

**Leksikografi:**

**Aleksandër Sirdani**, *Frazeologji*. – XVI/1940, nr. 10-11, f. 495-497.

**Aleksandër Sirdani**, *Frazeologji*. – XVII/1941, nr. 1-2, f. 70-78.

**Aleksandër Sirdani**, *Frazeologji*. – XVII/1941, nr. 3-5, f. 225-226.

**Aleksandër Sirdani**, *Frazeologji*. – XVII/1941, nr. 6-8, f. 332-342.

**Aleksandër Sirdani**, *Frazeologji*. – XVII/1941, nr. 9-10, f. 422-424.

**Aleksandër Sirdani**, *Frazeologji*. – XVIII/1942, nr. 5-10, f. 351-355.

**Aleksandër Sirdani**, *Frazeologji*. – XIX/1943, nr. 1-3, f. 63-68.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XV/1939, nr. 2, f. 120-129.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XV/1939, nr. 3-7, f. 333-341.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XV/1939, nr. 8-10, f. 408-416.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XV/1939, nr. 11-12, f. 565-573.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVI/1940, nr. 1-2, f. 47-53.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVI/1940, nr. 3-4, f. 135-144.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVI/1940, nr. 5-6, f. 240-244.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVI/1940, nr. 7-9, f. 354-361.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVI/1940, nr. 10-11, f. 516-522.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVII/1941, nr. 1-2, f. 31-40.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVII/1941, nr. 3-5, f. 178-190.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVII/1941, nr. 6-8, f. 260-278.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVII/1941, nr. 9-10, f. 410-417.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVII/1941, nr. 11-12, f. 527-531.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVIII/1942, nr. 1-2, f. 40-45.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVIII/1942, nr. 3-4, f. 176-180.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XIX/1942,

nr. 4-5, f. 170-178.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVIII/1942, nr. 5-10, f. 267-274.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XVIII/1942, nr. 11-12, f. 426-432.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XIX/1943, nr. 5-6, f. 170-178.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XIX/1943, nr. 6-8, f. 246-256.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Fjalori toponomastik*. – XIX/1943, nr. 9-12, f. 391-406.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 2, f. 102-107.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 3, f. 158-163.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 5, f. 253-259.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 6, f. 303-313.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 9, f. 461-467.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 10, f. 507-512.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 11, f. 557-560.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: "Fjalët e "Jungut të ri" në "Kritikën" e A. Xhuvanit*. – XI/1935, nr. 12, f. 597-599.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit*. – XII/1936, nr. 2, f. 73-76.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit*. – XII/1936, nr. 3, f. 145-147.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit*. – XII/1936, nr. 4, f. 194-196.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit*. – XII/1936, nr. 5, f. 241-245.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit*. – XII/1936, nr. 6, f. 241-294.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit*. – XII/1936, nr. 7-8, f. 360-372.

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit*. – XII/1936, nr. 9, f. 434-439.

#### Fonetikë:

**Pashko Bardhi** (pseud. *Vorf Dukagjini*), *Përdorimi i ë n'shkrim t'gjuhës shqype. I*. – I/1914, nr. 8, f. 242-246.

**Pashko Bardhi** (pseud. *Vorf Dukagjini*), *Përdorimi i ë n'shkrim t'gjuhës shqype. II*. – I/1914, nr. 9, f. 274-279.

**Gjergj Fishta**, *Prozodi latine, Rregulla të përgjithta mbi shkurtësi e gjatsi të rrokjevet*. (Përkthim prej latinishtes). – IV/1923, nr. 2, f. 71-75.

**Gjergj Fishta**, *Prozodi latine, Rregulla të përgjithta mbi shkurtësi e gjatsi të rrokjevet*. (Përkthim prej latinishtes). – IV/1923, nr. 3, f. 118-121.

**Gjergj Fishta**, *Prozodi latine, Rregulla të përgjithta mbi shkurtësi e gjatsi të rrokjevet*. (Përkthim prej latinishtes). – IV/1923, nr.7, f. 318-320.

\*\*\*, *Akcenti n'orthografi t'onë* (Itali, mbë 6 qershuer 1931), - VII/1931, nr. 7-8, f. 396-409.

**Jam**<sup>52</sup>, *Qellzoret e gjuhës shqype* (Milan 1943). – XIX/1943, nr. 4-5, f. 115-121.

<sup>52</sup> Sipas Palokë Dakës, në “Fjalor pseudonimesh” (1743-1944), Shtëpia botuese “Shkenca”, Tiranë, 1998, pseudonimi **Jam** i përdorur në “Hylli i Dritës” (Shkodër, 1943) është i një autori të paidentifikuar.

**Gramatikë****(Morfologji – Sintaksë):**

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Rreth gramatologjis shqype*. – IV/1923, nr. 11, f. 516-522.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Rreth gramatologjis shqype*. Verbi. (Infinitivi, Participi e emnat verborë). – V/1924, nr. 11, f. 467-473.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Rreth gramatologjis shqype*. – VII/1931, nr. 11, f. 616-620.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Rreth gramatologjis shqype*. *Prap mbi trajtat verbore*. – VIII/1932, nr. 12, f. 611-616.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Rreth gramatologjis shqype*. *Fonema e orthografia e verbit substantiv*. – IX/1933, nr. 7-8, f. 315-321.

**Justin Rrota**, *Analyzimi i rasavet t'emnit e zhvillimi historic i tynve*, - VII/ 1931, nr. 5, f. 252-267.

**Justin Rrota**, *Analyzimi i rasavet t'emnit e zhvillimi historik i tynve*, - VII/ 1931, nr. 6, f. 315-327.

**Donat Kurti**, *Sa ma pak rregulla ....* – VIII/1932, nr. 4, f. 175 – 180.

**Antonin Fishta**, *Kush po na e shemton giuhen?... - IX/1933*, nr. 1, f. 13-18.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Vrejtje mbas vrejtyesh ... Rreth njaj Studjimi Gjuhsuer: "Vrejtje mbi artikuj e premna pronës të giuhës shqipe"* prej D. Ndre Mjedës – Shkodër, Shtyp. "Zoja e Paperlyeme" 1934. – X/1934, nr. 5, f. 236-244.

**Drejtshkrim:**

**Ambroz Marlaskaj**, *Mbi ortografi të sotshme*. – II/1921, nr. 3, f. 112-118.

**Ambroz Marlaskaj**, *Mbi ortografi të sotshme*. – III/1922, nr. 2, f. 65-70.

*Mbi perdorimin e grupit "mb" n'orthografi*, -VIII/1932, nr. 2, f. 71-74.

**Histori gjuhe:**

**C. Caragata**, *Permbij marrdhanjet gjuhësore shqiptare-rumune*. – XV/1939, nr. 3-7, f. 283-296.

**Eqrem Çabej**, *Tekste italo-shqiptare në Hyllin e Dritës*. – XI/1935, nr. 4, f. 196-206.

**Gabriel Th. Panajoti-Meksi**, *Prej nga rrjedh ëmëri “shqiptar”*. – XI/1935, nr. 10, f. 483-486.

**Giulio Bertoni**, *Formimi i gjuhës letrare italyane*. – XVII/1941, nr. 1-2, f. 94-96.

**H. Bariq**, *Gjuha shqype në “Les langues du monde, par un groupe des linguists sous la direction de A. Meillet et Marcel Cohen”*, Paris, Champion XII, p. 813, 8. – VI/1930, nr. 2, f. 106-107.

**J. Schmetz**, *A kje ilirishtja një gjuhë kentum a por një gjuhë satem?*. – XVI/1940, nr. 5-6, f. 216-219.

**Kristo Floqi**, *Origjina e mbiemnet Shqyptarë, Shqypni, Albanoi, Albania*. – XI/1935, nr. 3, f. 135-141.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XI/1935, nr. 12, f. 605-607.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 1, f. 35-38.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 2, f. 84-88.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 3, f. 139-141.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 4, f. 188-191.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 6, f. 300-303.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 7-8, f. 383-388.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 9, f. 444-449.

**Kristo Floqi**, *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipes e hellenishtes*. – XII/1936, nr. 10, f. 495-500.



**Kristo Floqi**, *Pellaskë e Hellenë. Krahesim linguistik midis shqipes e hellenishtes.* – XII/1936, nr. 11, f. 556-560.

**Kristo Floqi**, *Pellaskë e Hellenë. Një krahesim midis gjuhës Greqishte e Shqipes* (Studim etnollogjik e linguistik). – IX/1933, nr. 5-6, f. 262-272.

**Kristo Floqi**, *Pellaskë e Hellenë. Një krahesim midis gjuhës Greqishte e Shqipes* (Studim etnollogjik e linguistik). – XI/1935, nr. 7-8, f. 390-400.

**Kristo Floqi**, *Etruskë e Turrenë* – XI/1935, nr. 9, f. 454-461.

**Kristo Floqi**, *Pellaskë e Hellenë.* – XI/1935, nr. 10, f. 499-507.

**Kristo Floqi**, *Pellaskë e Hellenë.* – XI/1935, nr. 11, f. 539-546.

**Norbert Jokl**, *Populli shqiptar dhe gjuha e tij.* – XIX/1943, nr. 9-12, f. 325-334.

**Norbert Jokl**, *Populli shqiptar dhe gjuha e tij.* – XX/1944, nr. 6-7, f. 53-62.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Rreth problemit të gjuhës letrare,* - VII/1931, nr. 3, f. 121-133.

**Justin Rrota**, *Monumenti ma i vjetri i gjuhës shqype (Buzuku – 1555).* – VI / 1930, nr. 1, f. 33-53.

**Justin Rrota**, *Rreth lavrimit të gjuhës.* – XX/1944, nr. 6-7, f. 45-52.

**Justin Rrota**, *Shkrimtari ma i vjetri i Italo-Shqypetarvet: Lukë Matranga (1592),* - VII/1931, nr. 9, f. 505-522.

Ndër shkrimet rreth *historisë së gjuhës* janë të shumta edhe ato **për alfabetin e gjuhës shqipe** gjatë kësaj periudhe:

*Kundrime letrare: Mbi çashtje t'alfabetit shqyp. Opinione.* – XVIII/1942, nr. 5-10, f. 363-368.

**Antonin Fishta**, *Nizetepesvjetori i Kongresit të Monastirit (1908-1933).* – IX /1933, nr. 11, f. 519-524.

**Gjon Shllaku**, *Rreth çashitjes s'Alfabetit të Monastirit*. Përgjigje Z. Lul Shkurti. – XIX/1943, nr. 4-5, f. 202-212.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – VIII/1932, nr. 5, f. 223-230.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – VIII/1932, nr. 7-8, f. 341-350.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – IX/1933, nr. 11, f. 514-518.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – X/1934, nr. 1, f. 15-21.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – X/1934, nr. 3, f. 140-147.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – X/1934, nr. 11, f. 529-535.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – XI/1935, nr. 1, f. 8-19.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – XII/1936, nr. 2, f. 61-67.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* – XII/1936, nr. 4, f. 171-176.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* Pasqyra e shenjime. – VII/1931, nr. 12, f. 676-684.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* Pasqyra e shenjime. – VIII/1932, nr. 3, f. 123-129.

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), *Per Historin e Alfabetit Shqyp.* Pasqyra e shenjime. – IX/1933, nr. 9-10, f. 455-463.

**Ndoc Nikaj**, *Alfabeti e polemika.* – XVIII/1942, nr. 11-12, f. 486-487.

### Dialektologji:

**Benedikt Dema**, *Per një "Atlant gjuhsuer" të shqypes.* XVI/1940, nr. 3-4, f. 110-130.

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), *Kundrime letrare: Dialektologji. Krahazime me gjuhë ballkanike.* – XVII/1941, nr. 9-10, f. 456-460.

\* \* \*

Dukë vëzhguar një klasifikim të tillë, kupton qartë se për cilat fusha të gjuhësisë u shfaq më tepër interesim gjatë kësaj periudhe, ku rezultuan: Leksikografia, Fonetika, Gramatika, Drejtshkrimi, Dialektologjia, Historia e gjuhës. Përkatësisht:

- Në fushën e **Leksikografisë** ndeshen **4 tema** të trajtuara;
- Në fushën e **Fonetikës** ndeshen **4 tema** të trajtuara, ku njëra prej tyre është përkthim prej latinishtes;
- Në fushën e **Gramatikës** ndeshen **5 tema** të trajtuara, me elemente kryesisht nga Morfologjia e shumë pak nga Sintaksa;
- Në fushën e **Drejtshkrimit** ndeshen **2 tema** të trajtuara, ku e dyta (pa autor) mund të pëfshihet shumë mirë edhe në fushë të Fonetikës;
- Në fushën e **Dialektologjisë** ndeshen **2 tema** të trajtuara;
- Në fushën e **Historisë së gjuhës** ndeshen **20 tema** të trajtuara, ndër të cilat 5 tema i përkasin çështjes së *alfabetit të gjuhës shqipe*.

Përveç fushave të sipërpërmendura, ndeshim edhe dy shkrime të tjera gjuhësore, që mund t'i etiketojmë nën emërtimet: **Kritikë gjuhësore**, nëpërmjet **1 teme** (*Çashtje gjuhësore*) të trajtuar në dy numra nga autori Mati Logoreci dhe **Opinion gjuhësor** nëpërmjet **1 teme** (*Bisedim gjuhe: Shënime të vogla*) të trajtuar nga një anonim:

#### **Kritikë gjuhësore:**

**Mati Logoreci**, *Çashtje gjuhësore*. – X/1934, nr.12, f. 589-595.

**Mati Logoreci**, *Çashtje gjuhësore*. – XI/1935, nr. 2, f. 86-91.

#### **Opinion gjuhësor:**

\*\*\*, *Bisedim gjuhe: Shënime të vogla* (Itali, 26.3.1931). – VII/1931, nr. 4, f. 205-208.

\* \* \*

Ajo çfarë karakterizon pjesën më të madhe të këtyre shkrimeve është trajtimi i tyre në vijimësi, duke përfshirë disa numra të revistës e duke bërë që disa prej tyre të konsiderohen si trajtime monografike apo hartime fjalorësh në vetvete. Kjo dukuri bie në sy sidomos në **shkrimet mbi historinë e gjuhës**, si dhe **ato leksikore**, ku, konkretisht kemi:

Në **shkrimet mbi historinë e gjuhës** veçojmë:

**Kristo Floqi**, punimin e tij *Pellagë e Hellenë. Krahesim lingvistik midis shqipës e hellenishtes* e trajton në 10 numra (XI/1935, nr. 12, f. 605-607; XII/1936, nr. 1, f. 35-38; XII/1936, nr. 2, f. 84-88; XII/1936, nr. 3, f. 139-141; XII/1936, nr. 4, f. 188-191; XII/1936, nr. 6, f. 300-303; XII/1936, nr. 7-8, f. 383-388; XII/1936, nr. 9, f. 444-449; XII/1936, nr. 10, f. 495-500; XII/1936, nr. 11, f. 556-560).

**Justin Rrota** (pseudo. *Iris*), punimin e tij *Per Historin e Alfabetit Shqyp* e trajton në 12 numra (VIII/1932, nr. 5, f. 223-230; VIII/1932, nr. 7-8, f. 341-350; IX/1933, nr. 11, f. 514-518; X/1934, nr. 1, f. 15-21; X/1934, nr. 3, f. 140-147; X/1934, nr. 11, f. 529-535; XI/1935, nr. 1, f. 8-19; XII/1936, nr. 2, f. 61-67; XII/1936, nr. 4, f. 171-176; VII/1931, nr. 12, f. 676-684; VIII/1932, nr. 3, f. 123-129; IX/1933, nr. 9-10, f. 455-463).

**Shkrimet leksikografike** i përshkon të gjitha kjo dukuri:

**Aleksander Sirdani**, punimin e tij me titull *Frazeologji* e trajton në 7 numra të revistës (XVI/1940, nr. 10-11, f. 495-497; XVII/1941, nr. 1-2, f. 70-78; XVII/1941, nr. 3-5, f. 225-226; XVII/1941, nr. 6-8, f. 332-342; XVII/1941, nr. 9-10, f. 422-424; XVIII/1942, nr. 5-10, f. 351-355; XIX/1943, nr. 1-3, f. 63-68).

**Nikollë Gazulli** (pseudo. *Gelasius*), punimin e tij me titull *Fjalori toponomastik* e trajton në 22 numra të revistës (XV/1939, nr.2, f. 120-129; XV/1939, nr. 3-7, f. 333-341; XV/1939, nr. 8-10, f. 408-416; XV/1939, nr. 11-12, f. 565-573; XVI/1940, nr. 1-2, f. 47-53; XVI/1940, nr. 3-4, f. 135-144; XVI/1940, nr. 5-6, f. 240-244; XVI/1940, nr. 7-9, f. 354-361;

XVI/1940, nr. 10-11, f. 516-522; XVII/1941, nr. 1-2, f. 31-40; XVII/1941, nr. 3-5, f. 178-190; XVII/1941, nr. 6-8, f. 260-278; XVII/1941, nr. 9-10, f. 410-417; XVII/1941, nr.11-12, f. 527-531; XVIII/1942, nr.1-2, f. 40-45; XVIII/1942, nr.3-4, f. 176-180; XIX/1942, nr. 4-5, f. 170-178; XVIII/1942, nr.5-10, f. 267-274; XVIII/1942, nr.11-12, f. 426-432; XIX/1943, nr. 5-6, f. 170-178; XIX/1943, nr. 6-8, f. 246-256; XIX/1943, nr. 9-12, f. 391-406).

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), punimin e tij me titull *Për Fjalorin Shqip: “Fjalët e “Jungut të ri” në “Kritikën” e A. Xhuvanit* e trajton në 8 numra (XI/1935, nr. 2, f. 102-107; XI/1935, nr. 3, f. 158-163; XI/1935, nr. 5, f. 253-259; XI/1935, nr. 6, f. 303-313; XI/1935, nr. 9, f. 461-467; XI/1935, nr. 10, f. 507-512; XI/1935, nr. 11, f. 557-560; XI/1935, nr. 12, f. 597-599).

**Mustafa Merlika-Kruja** (pseud. *Shpend Bardhi*), punimin tjetër leksikografik të tij me titull *Për Fjalorin Shqip: Grunët dhe egjra në Fjalorin e K. Tasit* e trajton në 7 numra (XII/1936, nr. 2, f. 73-76; XII/1936, nr. 3, f. 145-147; XII/1936, nr. 4, f. 194-196; XII/1936, nr. 5, f. 241-245; XII/1936, nr. 6, f. 241-294; XII/1936, nr. 7-8, f. 360-372; XII/1936, nr. 9, f. 434-439).

\* \* \*

Si përfundim: siç rezulton edhe nga shifrat më sipër, interesim më i madh në fushën e gjuhësisë gjatë periudhës së sipërpërmendur (1913 – 1944), referuar revistës “Hylli i Dritës”, u shfaq në drejtim të *Historisë së gjuhës* (20 tema nga 39 temat gjuhësore), me emra të tillë, si: C. Caragata, Eqrem Çabej, Gabriel Th. Panajoti-Meksi, Giulio Bertoni, H. Bariq, J. Schmetz, Kristo Floqi, Norbert Jokl, P. Antonin Fishta, P. Justin Rrota (pseudo. Iris), P. Gjon Shllaku e P. Ndoc Nikaj.

Nëse do të hidhnim një vështrim edhe nga gjuhëtari që pati kontributin më të madh në 39 shkrimet gjuhësore të trajtuara në këto 174 numra të revistës (nr. 1 tetor, I/1913 – nr. 6-7 qershor-korrik, XX/1944), bindemi për kontributin e konsiderueshëm të Justin Rrotës, me 8 tituj (të trajtuar në një shtrirje prej 24 numrash të revistës), që i përkasin fushës së *gramatikës dhe historisë së gjuhës*, kryesisht *çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe*, të cilën e trajton në 12 numra të revistës me përmasat e një studimi monografik.

\* \* \*

“Hylli i Dritës” me shkrimet e tij gjuhësore që përmban, mban në vetvete vlera të padiskutueshme gjuhësore për kohën kur u shkruan, si dhe për gjuhën shqipe sot, duke u kthyer në një bazë të mirë ndihmese për kërkuesit shkencorë.

### **Linguistic writings in the magazine “Hylli i Dritës” (1913 - 1944)**

#### *SUMMARY*

The author aims in this article to distinguish linguistic material presented in the magazine “Hylli i Dritës”, since its founding in 1913, until 1944. She has order to make a classification around him.

To accomplish this goal, firstly, the author observed with much attention diversified material contained in this magazine published in 174 numbers during that period and later noted and classified according to linguistic material relevant disciplines, which resulted: Lexicography, Phonetics, Grammar, Orthography, Dialectology, History of Language. The author claims that greater interest in the field of linguistics during this period (1913 - 1944), referred magazine "Hylli i Dritës", appeared in the direction of the History of Language (20 subjects from 39 linguistic threads).

Regarding linguist who had the biggest contribution in 39 language writings addressed in these 174 editions of the magazine, is Justin Rrota, with 8 titles, belonging to the field of Grammar and History of Language mainly the issue of the Albanian alphabet.

Anisa KOSTERI

## PRANIA E SLLAVIZMAVE NË FJALORIN E GAZULLIT

Marrëdhëniet që kanë pasur shqiptarët dhe sllavët gjatë historisë kanë lënë gjurmë edhe në gjuhën tonë. Ato fillojnë që me dyndjet e para sllave në Ballkan deri në ditët e sotme me kontaktet e ngushta që ekzistojnë mes shqiptarëve, kryesisht pjesës së gegërishtes veriore me popullsitë shqiptare në ish-Jugosllavi, Kosovë e Mal të Zi. Madje, siç shprehet Jorgji Gjinari,<sup>53</sup> ato kanë pasur marrëdhënie e kontakte fqinjësie, kryesisht me sllavët e jugut, të cilat kanë vazhduar gjatë dhe domosdo që kanë lënë gjurmë në të folmet shqipe. Më tepër kanë hyrë elemente sllave sesa anasjelltas, por kjo nuk do të thotë se shqipja nuk ka lënë gjurmë në gjuhën e tyre.

Karlo Taliavini për këtë dukuri shprehet se “*në është e vërtetë se dialektet shqiptare gegë-lindore të Dardanisë e Maqedonisë veriperëndimore kanë asimiluar një numër elementesh sllave jugore, të panjohura në krahina të tjera të Shqipërisë, është po aq e vërtetë se edhe dialektet sllave të këtyre krahinave kanë asimiluar elemente shqiptare dhe kanë pësuar ndikim gjuhësor të shqipes*”<sup>54</sup>.

I të njëjtit mendim është edhe studiuesja e sllavizmave në gjuhën shqipe, e cila shprehet për faktin se edhe shqipja ka lënë gjurmë në të folmet e serbishtes.

Problemi i huazimeve sllave është trajtuar nga shumë studiues shqiptarë e të huaj, si: Miklosiçi, Majeri, Jokli, Çabej, Desnickaja etj. Kohët e fundit ka dalë edhe studimi i bërë nga Anila Omari “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”<sup>55</sup>.

Në Fjalorin e Gazullit kemi një numër relativisht të madh të sllavizmave. Kemi bërë përjasje me Leksikun e gegërishtes të pasqyruar në vëllimet e “Dialektologjisë Shqiptare” (I,II,III,IV), leksikun e pasqyruar

<sup>53</sup> Jorgji Gjinari, *Mbi disa elemente slave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore*, “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” II, Tiranë, 1972, f. 267.

<sup>54</sup> Karlo Taliavini, *Le parlate albanesi di tipo ghegjo orientale (Dardania e Macedonia nordocidentale)*, “Le terre albanesi redenti”, I, Roma, 1942, f.70.

<sup>55</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012.

nga Anila Omari sa u takon sllavizmave të shqipes, si dhe Fjalorin e Mehmet Elezit. Gjithashtu jemi konsultuar për disa raste edhe me *Fjalorin Shqip - Serbokroatisht* të Mikel Ndrecës.

**arg-t** – *aëjkë-a, smojë-a, smollë* (slav) (G. f.48). Fjalën **smo:ll-a**<sup>56</sup> e ndeshim tek Gj.Shkurtaç (DSH, III) për “*rrëshirë pishe*”, e cila ndeshet në të folmen e Kelmendit. Gjithashtu mund të ketë lidhje me fjalën **smojë** “*llomi i sapunit, yndyra e leshit*”, që flitet në rrethinat e Shkodrës, huazim nga skr, **smola** “*rrëshirë*”.<sup>57</sup>

**bedatë** – *njeri i bedatun* (slav.? *mbaresa sigurisht*) *njeri i mârrun mênç* (G. f.57). Këtu kemi të bëjmë me një pasiguri të Gazullit, nëse është sllavizëm apo jo. Ndërsa Mehmet Elezi e pranon si sllavizëm **bedat**<sup>58</sup> – *budallosem, merrem mendsh*.

**bëzhure-ja** – *bazhure-ja; papaver* (slav), (G. f. 61). Kjo fjalë si sllave ndeshet vetëm tek Gazulli, përmes të cilit nuk kemi një shpjegim të saktë gjuhësor.

**capë-a** - *dhe a shtrat dheu i forcuem prej motesh si çemento, i gurzuem, peqinë* (slav) (G. f. 80). Gjovalin Shkurtaç, në të folmen e Hotit, jep këtë shpjegim të kësaj fjale, **peqin-a**<sup>59</sup> “*shkëmb, kërrboç që gjendet poshtë shtresës së dheut të punueshëm në arat joprodhuese me shumë zall*”.

**cokël-a** – 1. *shkurtica drush.2. cokla druni, krh. slav. cokla -nallat* (turq), (G. f.84). Si sllavizëm e përdor vetëm Gazulli, ndërkohë që nuk e gjejmë të përdorur tek leksiku dialektor i gegërishtes, ndërsa në ligjërimin bisedor gjen vend përdorimi.

Mehmet Elezi përdor trajtën **cokël-a**<sup>60</sup> – 1. *cingël, kaliqe, parakë. 2. droçkë hirre, droçkël* (*Malësi e Madhe*).

**qepel-i** – *qep-i, maja e ternakopit* (slav) *a tharakacit mâ e holla qi hyn si pyjkë në gurë* (G. f.91). Bahri Beci në të folmen e Shkrelit e përdor si të tillë, **tërrnagop-i**<sup>61</sup> “*kazmë, në Vrith ca:p-a*”. Gjithashtu edhe Anila Omari e jep **tërrnagop** “*kazmë*”.<sup>62</sup>

**çapër-a** – *rrëshiq, rrësheku, calik-u. slav. çapra* (G. f.98). Vërejmë se vetë Gazulli e përdor si sllavizëm, por edhe Mehmet Elezi jep një shpjegim të

<sup>56</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.87.

<sup>57</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 265.

<sup>58</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.193.

<sup>59</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 413.

<sup>60</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 281.

<sup>61</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 320.

<sup>62</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.289.



tillë, **capër-ra**<sup>63</sup> (prej sll.)- 1. rrëshek, zhabë calik lëkure me e mbajtë bulmetin, kryesisht mazën. 2. lëkura e lahutës. Tek Anila Omari e kemi, **çapër** “rrëshek, calik”.<sup>64</sup>

**dash-e** – lat. *amabilis* ( *dashë* slav), (G. f.117). E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm.

**dhaja** – Bash. 98, mbet e dhaja kres: u ndal e i a njiti kres; veshtrimi: me fuqi, lat. *vi*, prej *vis*, dhaja de, **mbëshoji** (slav), (G. f.118). E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm.

**fëmni-ja** – *igjam-i*, *ixhram(turq)*, **kotmar-i** (PK. slav), paska lisi femni, paska nisë m`u kalbë; mushkëni me femni (G. f.127). Ky sllavizëm **kotmar-i**, del vetëm tek Gazulli, ndërsa në leksikon dialektor të gegërishtes nuk e ndeshim në studimet e bëra rreth tij. Mehmet Elezi e përdor në këtë kuptim, **femni-a**<sup>65</sup> – (prej femën, ndoshta në kuptimin e plasave, çarjeve, ose në kuptimin që përdoret për tumoret femën a mashkull?). Sëmundje që prish përbërjen, kalbje.

**figullue** – 1. përtha, **kuritë** ( SP, slav.). 2. përflikë.3. mekë ( G. f.130). E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm. Elezi e përdor si të tillë, **figullohem**<sup>66</sup> – përfikem, mekem. Anila Omari e jep si **kuris** “thaj drutë te zjarri”.<sup>67</sup>

**firikac-i** – *shaterkaz-i*, *çaterkaz-i*; cape e madhe me çepel, slav. **ternakop**, *tharakac* ( G. f. 132). Shpjegimin për fjalën **ternakop** e kemi dhënë më sipër, shih **qepel-i**.

**fue-oni** – *hue-oni*, *nji hue mjalte*; *fashuell-olli*, **foshthinë-a** (slav.), (G. f. 139). E ndeshim të përdorur tek Xhabir Topalli për të folmen e Pukës, **foshthin-a**<sup>68</sup> “hojt me mjalt, voshtina”.

**gorrlë-a**- *birë*, **bigore** (slav.), ( G. f. 153). E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm. Ndërsa Mehmet Elezi e përdor si të tillë, **gorrlë-a**<sup>69</sup> – birë, vrimë, plasë.

**heqâme-ja** – *pometë* (slav) *dallkë e madhe: ra shi (borë, breshën)* ( G. f. 173). Xheladin Gosturani jep trajtën **ometë**, e cila përdoret në të folmen e Çeremit (DSH IV), ndërsa studiuesja Omari, jep trajtën **ometë** “dëbora e grumbulluar nga era, tog dëbore”. Pra, vërejmë se ka të njëjtin kuptim si

<sup>63</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 298.

<sup>64</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 117.

<sup>65</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 420.

<sup>66</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 426.

<sup>67</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.180.

<sup>68</sup> Xhabir Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 327.

<sup>69</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.500.

Gazulli. Sipas saj, është huazuar nga skr. **omèsti, omètem** “fshij me fshesë”.<sup>70</sup>

**ipësht-a** – 1. *ipësht ahash, imshiti ahash; lisni ahash së rij, vend me lisa të rij, imshtak*. 2. *lugu ku prej gurit të mullinit derdhet mielli i bluem, dishtë-a* (krh. slav. **diza**), (G. f.181). E ndeshim të përdorur tek Bahri Beci, **ipshtaku**<sup>71</sup> “*ah i ri*”; **i:sht-a**<sup>72</sup> “*pyll me aha të rinj*” e përdor Gjovalin Shkurtaj për të folmen e Kelmendit. Ndërsa trajtën **disht-a**<sup>73</sup> “*arka ku bie mielli nga guri kur bluhet*” e ndeshim në të folmen e Pukës nga Xhabir Topalli.

**jar-i** – *êdhi* (SHK), slav. **jarac, jarad** (G. f.182). Si fjalë e ndeshim tek Anila Omari, **jar** “*kec*”.<sup>74</sup>

**kapër-a** – *kapërr-a, mbajs hardhijash, gagjarrâ-ni* (MR), **grebenicë-a** (M.M) *fj. slave* (G. f.191). Ndonëse Gazulli e jep si fjalë të Malësisë së Madhe, ne nuk e ndeshim në leksikon e gegërishtes veriperëndimore, për të folmet përkatëse që janë bërë, aq më tepër si huazim sllav. Mehmet Elezi përdor të njëjtën formë të kësaj fjale, duke iu referuar Gazullit, **kapër-ra**<sup>75</sup> – *mbajtës hardhish*.

**këllânë-t** – *dita e mbrâm e motmotit; me lutë këllânat*, krh. *fj. shkodranishte:kudhânë-a*, krh. slav. **koleda?**, (G. f.197). Ndonëse gjen përdorim në ligjërimin bisedor, nuk e ndeshim të përdorur në fjalorët përkatës.

**kërrabë-a** – *ternakop-i*(slav), *shaterkaz-i*: (G. f.201). Kuptimin e fjalës **ternakopi-i** e kemi dhënë më sipër, shih **qepel-i**.

**kllaçë-a** – *ligatë* (slav.) **brraqinë**, (G. f.205). E përdor Gjovalin Shkurtaj për të folmen e Hotit, **brrakçinë-a**<sup>76</sup> “*gropë e vogël në rrugë ose në fushë që mbushet me ujë kur bie shumë shi*”. Gjithashtu i referohet Çabejit, si huazim sllav, **brrak** – *bërrakë* të zgjeruar në mënyrë sllave.

**kllap-i** – *gjumë i lehtë: më xuni kllapi* (slav. **klapa**), (G. f.206). Siç e vërejmë Gazulli ka dhënë origjinën e kësaj fjale si sllave, duke treguar mirëfilli edhe dijen e tij në fushë të etimologjisë. A.Omari e jep, si **kllapi** “*jerm*”.<sup>77</sup>

<sup>70</sup> Anila Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet veriore të shqipes*, “Studime filologjike”, 1-4, Tiranë, 1994, f. 123.

<sup>71</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 314.

<sup>72</sup> Gjovalin Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 84.

<sup>73</sup> Xhabir Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 326.

<sup>74</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 156.

<sup>75</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 661.

<sup>76</sup> Gjovalin Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 407.

<sup>77</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 165.

**komçë-a** – *komçar-i* slav. *kovçe, kovçar* (G. f.209). E përdor Shefqet Hoxha në të folmen e Vilë-Kalisit të Lumës **ko:mc-a**<sup>78</sup> “*kapse prej teli: përbëhet nga dy pjesë mashkull dhe femër, që përdoret sidomos në veshje të trasha prej zhguni*”. Gjithashtu Xheladin Gosturani në të folmen e Hasit, **komc-a**<sup>79</sup> “*mbërtheckë, komçë*”.

**kopaç-i** – *obluk-u* (slav.), (G. f.210). E kemi tek Bari Beci, në të folmen e Luznisë së Dibrës, **kopáçe-ja**<sup>80</sup> – “*kazëm,*” Xheladin Gosturani në Has, **kopaç**<sup>81</sup> “*kazmë*”, Shefqet Hoxha, Lumë jep **kopaç-i**<sup>82</sup> “*kazëm vetëm me sqepin e gjerë*”. Ndërsa Xheladin Gosturani në të folmen e Hasit përdor trajtën **obluk-i**<sup>83</sup> “*pjesa e përparme e samarit*”. Edhe Anila Omari e ka, **obluk** “*kaptelli i samarit; kërdhokull*”.<sup>84</sup>

**kopitë-a**- 1. *shpori i shpendit*. 2. *kopita e kalit: dallëndysha e thundrës së kalit; krh. slav. kopito: thundra e kalit, formë këpucësh* (G. f.210). E përdor Bari Beci për të folmen e Shkrelit **kopit-a**<sup>85</sup> “*fundi i thundrës së kafshëve*”. Anila Omari e ka, **kopitë** “*thundër*”.<sup>86</sup>

**kosaq-i** – *kostar-i: një kosaq livadh: kosë-a* (slav. **kosa: kosaq**), (G. f. 212). Si të tillë nuk e ndeshim, vetëm Shefqet Hoxha, për të folmen e Vilë-Kalisit, jep trajtën **kostar-i**<sup>87</sup> “*ai që kosit*”. Anila omari e përdor si, **kosë** “*vegël bujqësore*.”<sup>88</sup>

**kotar-i** – 1. *çarranik, strehë për bylmet*. 2. *thark thish* (krh. slav. **hotar, kotar**, fj. shqipe: kot-i), (G. f. 212). E takojmë tek A.Omari, **kotar** “*qymez pulash*.”<sup>89</sup>

<sup>78</sup> Shefqet Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 185.

<sup>79</sup> Xheladin Gosturani, *E folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 255.

<sup>80</sup> Bari Beci, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f. 263.

<sup>81</sup> Xheladin Gosturani, *E folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 255.

<sup>82</sup> Shefqet Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 185.

<sup>83</sup> Xheladin Gosturani, *E folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 255.

<sup>84</sup> A.Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Tiranë, 2012, f. 206.

<sup>85</sup> Bari Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 314.

<sup>86</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 170.

<sup>87</sup> Shefqet Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.186.

<sup>88</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 172.

<sup>89</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 174.

**kot-i** – *muq-i, kapuliq, pllastë* (slav): *grumbull i vogël gruni, sane, kashte* (G. f.212). Gjovalin Shkurtaç përdor trajtën **kapuliqe-ja**<sup>90</sup> “*grumbull misri më i vogël se kapa*”, por edhe **pllast-a**<sup>91</sup> “*grumbull i vogël sane të porsakositur*”. A.Omari e ka, **pllastë** “*grumbull bari i kositur*”<sup>92</sup>.

**kozholl-i** – *post-i, shtrojë lëkure dhensh* (krh. slav. *kozha, shqipen kozhuni, shtrosë-a* (G. f.213). Bahri Beci përdor trajtën **kozhun-i**<sup>93</sup> “*veshje e hershme e burrave të Shkrelit, lëkurë berash e bërë si setër*”.

**larë-a** – 1. *nafele-ja, nafe-ja, nafë-a, vidër, ngjollë (njollë) e bardhë në parzëm t’egërcinës*. 2. *larë qesh...slav ralj: parmendë-a* (G. f.229). E përdor Shefqet Hoxha për të folmen e Vilë-e-Kalisit **la:r-a**<sup>94</sup> “*dhi a lopë e larme m.larosh*”.

Gjithashtu edhe Xhabir Topalli për Pukë, **lar-a**<sup>95</sup> “*lopa e larme*”.

**lezar-i** – 1. *shkallë e vogël*. 2. *shelqënuer-ori, slv. lesa: trinë*, (G. f. 235). Gjovalin Shkurtaç në të folmen e Kelmendit përdor, **trin-a**<sup>96</sup> “*lesë*”. A.Omari e ka, **lesë** “*trinë*”<sup>97</sup>.

**mbrapshti-ja** – *hiejesinë, vend ku s’bjen dielli, osojnë-a* (slav), (G. f. 256). Këtë fjalë e ndeshim tek Anila Omari, **osojna** “*vend ku bie dielli me vonesë, vend i hijezuar, vend me hije*”<sup>98</sup>.

**meqave-ja** - *meqave bore* (fjal. slave) *mbledhajë, çfrë bore* (G. f. 258). Anila Omari e jep si të tillë, **meqave**<sup>99</sup> “*mbledhajë, çfre bore*” huazim nga skr. **mečava** “*stuhi me borë, llohë*”.

**meteh-i,-metef-i** 1. *kufi, shefi*. 2. *vend i nalcuem e në të lamslav. metohija*, (G. f.262).

**meti-ja** – *slav. (metil), kelbazë-a, kandërr si kaçamill qi jeton nder vende ujtake; bagtija e perdijne me bar e u shkon në zgrof, me gjak; kandrri(qi asht i vogël sa mosm’u veçue me sy), kalon ndër mushkëni, aty grin*

<sup>90</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 410.

<sup>91</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.79.

<sup>92</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 229.

<sup>93</sup> Bari Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 315.

<sup>94</sup> Shefqet Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 187.

<sup>95</sup> Xhabir Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f. 330.

<sup>96</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.79.

<sup>97</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 183.

<sup>98</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 213.

<sup>99</sup> Anila Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet veriore të shqipes*, “Studime Filologjike”1-4, Tiranë, 1994, f. 123.

*mushkënit e shndërrohet ndë flegulamishatake, qi quhen flutra* (G. f. 262). A.Omari eka, **meti-** “*këlbazë e dhenve*”.<sup>100</sup>

**murrfice-ja** – 1. *mbrapshti-ja, osojnë-a* (slav) *vend ku dimnit bjen pak a aspak dielli*. 2. *dheu i murrfices, krahi i murrfices; vende me akuj të pamemë e me diell të pakët a pa të krejt* (G. f. 274). Këtë fjalë e ndeshim tek Anila Omari, **osojna** “*vend ku bie dielli me vonesë, vend i hijezuar, vend me hije*”.<sup>101</sup>

**nipe-ja** – *ndikim slav për mbesë-a* (G. f. 279). E ndeshim tek Bahri Beci për të folmen e Shkrelit, **nipe-ja**<sup>102</sup> “*vajza e vëllaut (përdoret rrallë)*”.

**pamollë-a** – *shtyllat në ball t’urës, pomollë-a* (slav?), (G. f. 298). Nuk e ndeshim si fjalë, ndoshta sepse vetë Gazulli nuk jep siguri për burimin sllav të saj.

**përfiskë-** 1. *përfiktue, me përfiskë drûn, me tha*. 2. *përtha, kuritë, koritë* (fjalë slave) *me pshymë, pshtymë*, (G. f. 307). Siç shihet, Gazulli na ka dhënë dy kuptime të kësaj fjale. Me kuptimin e parë e ndeshim tek Bahri Beci në të folmen e Shkrelit, **korit (me u)**<sup>103</sup> “*thuhet për drutë e njoma, kur i venë afër zjarrit që të thahen*”. Gjithashtu e përdor edhe Shefqet Hoxha për të folmen e Vilë-e-Kalisit, në një kuptim krejtësisht të ndryshëm **korit-a**<sup>104</sup> “*enë për të larë rrobet, govatë*”. Me të njëjtin kuptim si Hoxha, Bahri Beci e përdor për të folmen e Dibrës **korit-a**<sup>105</sup> “*govatë*”. A. Omari e ka njëjloj, **koritë** “*govatë; lugu i mullirit*”.<sup>106</sup>

**përvanue** – *provanue, me radit, me bâ radin* (slav), (G. f. 315). Bahri Beci përdor trajtën **radit**<sup>107</sup> (me) “*sajoj: (a pa mun raditish nôj tjetër khâ° n’bjeshk.)*”. A. Omari e ka, **radit** “*ndreq, rregulloj*”.<sup>108</sup>

**pihë** – *me i ra mbë të... (sla. piehati, gulshue, shmue, shëmue)*, (G. f. 321). Bahri Beci përdor trajtën foljore **pihat (me u)**<sup>109</sup> “*lodhem*”. Edhe A. Omari e përdor me të njëjtin kuptim, **pihatem** “*këputem, lodhem shumë*”.<sup>110</sup>

**plotonicë-a** – *drûna të faqueme qi i vëjnë malsoret te veshet, vjerrëcat. Në Malësi të Madhe grat, me sa Tartareshat, s’barin vathë, fj.slave, krh.*

<sup>100</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 195.

<sup>101</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 213.

<sup>102</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 317.

<sup>103</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 314.

<sup>104</sup> Shefqet Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 185.

<sup>105</sup> Bahri Beci, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974.

<sup>106</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 171.

<sup>107</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 318.

<sup>108</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 248.

<sup>109</sup> Bahri Beci, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974.

<sup>110</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 223.

*pletenica, shikull, fregull* (G. f. 329). E përdor Bahri Beci në të folmen e Shkrelit duke dhënë edhe prejardhjen sllave, **plotonicë-a**<sup>111</sup> “një copë rubë që në të kaluarën veshin gratë e moshuara (krh. sll. *pletenica*). Gjovalin Shkurtaç e sjell në këtë formë në të folmen e Kelmendit, **plotoni:c-a**<sup>112</sup> “një farë shtojce prej druri që vinin gratë në kokë për të mbajtur flokët të ngritur anash; nuk përdoret më prej shumë vjetësh”. Të njëjtin shpjegim bën edhe Omari, **plotonicë** “një farë shtojce prej druri që vinin gratë në kokë për të mbajtur flokët të ngritur anash; nuk përdoret më prej shumë vjetësh”.<sup>113</sup>

**prologj-i** – **kerdi-ja**, *fj.slave?* (G. f. 338). Nuk e ndeshim të përdorur këtë fjalë.

**rabush-i** – *fj. slave rabosh* (G. f. 343). Mikel Ndreca e jep si të tillë, **rabush-i**<sup>114</sup> “*raboš, rovaš, urez, zarez*”.

**rogjâ-ni** – *degë lumi, kur uji dahet shumë krihësh para se m’u derdhë; rrogjâ-ni, rrozhâ-ni* (krh. slav. **rogja, brin-i?** (G. f. 346). Nuk e ndeshim si fjalë të shpjeguar në fjalorët e sipërpërmendur.

**samakres-i** – *fj.slave, cube-ja, take-jam pushkë fëmijsh* (G. f. 366). Mehmet Elezi jep trajtën **samakreshtë-a**<sup>115</sup> – 1. *pushkë e vjetër*. 2. *pushkë lodër prej shtogu prej shtogu me “fishekë” druri*.

**skylfer-i** – *skyfer-i, kaçubet-i, sokol-i* (slav), *shpend rrëmbyes* (G. f. 373). Tek Bahri Beci për Shkrel, ndeshim trajtën **kaçubet-a**<sup>116</sup> – *kaçubet-i, zogu i pashës, kaçirutan, çafkulan*. Ndërsa trajtën **sokol-i**<sup>117</sup> e përdor Gjovalin Shkurtaç, për të folmen e Kelmendit, “*skifter; del edhe me kuptimin: njeri i shkathët, i shpejtë*”. A. Omari e jep, **sokol** “*skifter*”.<sup>118</sup>

**sovajkë-a** – *meqik-u* (turq), *drugë-a, vegël vektorësh, për me pëshkue indin neper tymën, slav. sovilja, sovjelo* (G. f.374). Mehmet Elezi e përdor si të tillë, **sovajkë-a**<sup>119</sup> – *dërrasë mbi të cilën sitet miell në magje*.

**stërpi-ja** – *lëngatë qi mbaron trupin e njeriut tue i thithë gjakun... slav. trpija* (G. f. 378). Mehmet Elezi<sup>120</sup> jep të njëjtin shpjegim si Gazulli. A. Omari e ka, **tërpi** “*verem, kollë e keqe*”.<sup>121</sup>

<sup>111</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 318.

<sup>112</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 90.

<sup>113</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 228.

<sup>114</sup> Mikel Ndreca, “Fjalor shqip-serbokroatisht”, Prishtinë, 1980, f. 270.

<sup>115</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 1296.

<sup>116</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 314.

<sup>117</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, 1975, f. 92.

<sup>118</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 266.

<sup>119</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 1317.

<sup>120</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 1328.

**surmë-i-a** – *krh.slav. sur*, njeje e përhime në të mbyllun (të zi), (G. f. 381). A.Omari eka, **surmë (i)** “i përhimë i mbyllët, i murrmë”.<sup>122</sup>

**shiemëz-a** – *shkjesë-a, trine-a, vllaçë-a* (slav) trine thuprash me se imitojnë *bûcat qi çon parmenda* (G. f.391). Gjovalin Shkurtaj në të folmen e Kelmendit përdor dy rastet e fjalëve, **trin-a**<sup>123</sup> “lesë” dhe **trinoj** “punoj arën me trinë”, si dhe huazimin sllav, **vllaç-i**<sup>124</sup> “trinë, lesë” dhe **vllaçis** “trinoj, lesoj”. A. Omari e jep, **vllaç, vllaçë** “lesë, trinë”.<sup>125</sup>

**shnijue** – *çorodite* (slav. me dalë **rodit**) svetue, *shnjerzue* (G. f.403). Bahri Beci përdor trajtën **shnjerzue**<sup>126</sup> “bëhem i keq, prishem me dike” për në Shkrel. Xhabir Topalli përdor fjalën **rod-i**<sup>127</sup> “lloj, soj (zba asnji rod najet)”.

**shpneshë-a-zojë** shtëpije, *zojnore, stajanicë* (slav), (G. f. 408). Mehmet Elezi jep këtë shpjegim, **shpneshë-a**<sup>128</sup> - *sipas Çabejt prej shtëpan + eshë; apo prej shtëpineshë ose shpi + eshë? Në qoftë kështu n duhet të jetë shtuar si te thi: thineshë). shtëpineshë; shih edhe zojnore ( Plavë, Guci). A. Omari e ka, stajanicë “amvisë”.<sup>129</sup>*

**tirk-u-** 1. *cohë, zhgun, shajak*. 2. *tirqit*. 3. *tirqë cûj...slav. latica* (G. f. 426). Bahri Beci për Shkrel përdor shumësin e kësaj fjale, **tirq**<sup>130</sup> “të mbathura të malësorëve që vishen përmbi brekë; në Vrith çakçir”.

**toçë-a** – *m’u ndi me pije, me pi shum, me çue brrylin*; (krh. slav. **toçiti** (G. f. 427). Edhe Mehmet Elezi jep të njëjtin shpjegim si Gazulli, **toçi-a**<sup>131</sup> – *me toçë (prej sll.), ngop me të pirë*.

**traktue** – *me vû sheje, me shkruie, (krh. slav. trag, trak; shê, gjurmë)*, (G. f.429). Mehmet Elezi jep këtë shpjegim, **traktuj**<sup>132</sup> - *me traktue (prej trakt, sll.), bëj shenjë, shkruaj*. A. Omari eka, **trak** “gjurmë, shenjë”.<sup>133</sup>

**trellë-a** – *vathë-a* (krh. slav. **trlo**, *torishtë-a, slav. tor*), (G. f. 429). Xheladin Gosturani për të folmen e Hasit e përdor në gjininë mashkullore, **trell-**

<sup>121</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 290.

<sup>122</sup> A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 280.

<sup>123</sup> Gjovalin Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, 1975, f. 79.

<sup>124</sup> Po ai, po aty.

<sup>125</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 312.

<sup>126</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 320.

<sup>127</sup> Xhabir Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f. 332.

<sup>128</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 1411.

<sup>129</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 268.

<sup>130</sup> Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 320.

<sup>131</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 1476.

<sup>132</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f. 1482.

<sup>133</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 292.

**i**<sup>134</sup> “vend në të cilin bora është ngjeshur poshtë, për t’iu hedhur bagëtisë ushqim”. Xhabir Topalli përdor trajtën **torisht-i**<sup>135</sup> “vatha e deleve”. A. Omari e ka, **trellë** “vathë”.<sup>136</sup>

**trop-i** – undajë-a, **skrop**, fj.slave të dyja (?) krh. slav. trop, fundrri-ja, shkrob, niseshte, pulendër ( G. f.431). Gjovalin Shkurtaç, për të folmen e Kelmendit, përdor trajtën **skrop-bi**<sup>137</sup> “gjellë me miell si (qull), që përdornin banorët e këtyre anëve kur u mungonte buka”.

**tym-i** – të ftohtë-it...slav. **zima**, shqipen, **dimën-i** (G. f.435). A. Omari e ka, **trop** “bërsi, lënda që mbetet në kazan pas nxjerrjes së rakisë”<sup>138</sup>.

**ushtuer-ori-polak-u** (M.M fj.slave) begçi-ja (turq); vështrimi i pare: ushtar-i, tash: rojës arash e pyjesh (G. 447). Ndonëse Gazulli na jep dy kuptime të kësaj fjale, Bahri Beci e përdor në Luzni të Dibrës në një tjetër domethënie **polak-u**<sup>139</sup> “pjella e gomarit”. Me kuptimin e dytë të Gazullit e përdor Shefqet Hoxha për të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës, por në trajtën **polak-i**<sup>140</sup> “rojtar fushe; lajmëtar”, kjo sepse gegërishtja verilindore i shquan emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me **k,g,h**, me **i** (miki, zogi, krahi) ndryshe nga gegërishtja veriperëndimore, të cilat i shquan me **u** (miku, zogu, krahu).

**valanicë-a**- mangel me shkelë zhgunat, shajak etr. Ka këto pjesë: koritë, ku qiten zhgunat, majat, qi shkelin zhgunat, rrotën, boshtin e rrotës, fletët e rrotës, nkrejcat, bucelat e bushtit; fj.slave. krh. valjati: me shkelë zhgunin (G. f. 448). Bari Beci tek e folmja e Shkrelit e përdor **vajanice**<sup>141</sup> “vegël druri që shërben për të shkelur zhgunin në ujë”. Xhabir Topalli për Pukë përdor **vajanice**<sup>142</sup> “valanicë, derstil”. Anila Omari e ka, valanicë “dërstilë”.<sup>143</sup>

<sup>134</sup> Xheladin Gosturani, *E Folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 260.

<sup>135</sup> Xhabir Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f. 334.

<sup>136</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 294.

<sup>137</sup> Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, 1975, f. 87.

<sup>138</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 296.

<sup>139</sup> Bahri Beci, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 265.

<sup>140</sup> Shefqet Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 191.

<sup>141</sup> Bari Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare”, I, Tiranë, 1971, f. 321.

<sup>142</sup> Xhabir Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 334.

<sup>143</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, 304.



**vir-i** – *vijë uji, vende ku buron ujët bregut të liqenit të Shkodrës, (krh.fj.slav. navreda)*, (G. f. 457). Mikel Ndreca në Fjalorin e tij *shqip – serbokroatisht* e përdor me të njëjtin kuptim, **vir-i**<sup>144</sup> - *kanal za vodu (ku kalon uji), odvodni kanal*.

**vizit-i** – *trap vëllajsh, rrypinë toke me vëllaj, rasat (slav)*, (G. f. 459). E përdor edhe Mehmet Elezi, duke iu referuar Gazullit, **vizit-i**<sup>145</sup> – *rrypinë toke e ndarë në lehë*.

**vred-i** – *gjak i çartun, gjak i helmatuem qi kullon prej së zgrapmes së gjarpnit, krh. slav. vried = dhunë, varrë, mullâ, lingarthë-a* (G. f. 462). E ndeshim tek Mehmet Elezi si një fjalë sllave me këto kuptime, **vred-i**<sup>146</sup> – *(prej sll. lidhet me varrë; apo kryqëzim i të dyjave? Kuptimet 2,3,4 i largohen fjalës sllave e i afrohen varrës)*. 1. *mavi, nxirje rreth një plage ose për shkak të një goditjeje, lodhjeje etj.* 2. *lëng i errët, gjak i përzier me qelb, që del prej një plage të infektuar; të keq, shtratëz, ujerk, vrujerk.* 3. *helmi i gjarprit.* 4. *gjak i çartur.* 5. *si mb. i vreditur.* 6. *si nd. me vred.* A. Omari eka, **vred** “*helmi i gjarprit*”.<sup>147</sup>

**vrem-i** - *mend-i, ças-i (krh. slav. vreme; kohë)*, (G. f. 462). E kemi në Kartotekën e leksikut të shqipes të Institutit të Gjuhësisë, për Pukë, si ndajfolje **vremë-vremë** “*nganjëherë*”.<sup>148</sup> Gjithashtu edhe Omari e ka, **vrêm** “*çast*”.<sup>149</sup>

**zavorr-i** – 1. *shtonë nëpër dhe; gjiriz-i (turq) ulluk-u (turq).* 2. *gjavorr-i (krh. slav. zavor, shul hekuri)*, (G. f.464). Në këtë trajtë nuk e ndeshim të përdorur gjëkund.

**zumbçi** - *femëz-a, biz-i (turq), krh. fjalën thumbull-thumbullë, sumbullë, krh. slav. zumba, turjelë e vogël = thumb-i* (G. f.472). Gjovalin Shkurtaj në të folmen e Hotit jep trajtën **zumç-i**<sup>150</sup> “*biz*”, Bari Beci për të folmen e Shkrelit, jep trajtën **zumc-i**<sup>151</sup> “*biz*”. Ndërkohë që Gazulli jep trajtën **zumbçi**, kemi kalimin e grupit të bashkëtingëlloreve *mb – b*.

**zhugë-a** – 1. *kromë berresh.* 2. *bimë drujçe (krh. slav. zhukva, zungth, gjineshtër)*, (G. f. 475). Anila Omari jep mendimin se, si fjalë e gegërishtes

<sup>144</sup> Mikel Ndreca, “Fjalor shqip-serbokroatisht”, Prishtinë, 1980, f. 356.

<sup>145</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe,” Tiranë, 2006, f. 1579.

<sup>146</sup> Mehmet Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe,” Tiranë, 2006, f. 1592.

<sup>147</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f. 318.

<sup>148</sup> Anila Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet e shqipes*, “Studime Filologjike I-IV”, Tiranë, 1994, f. 128.

<sup>149</sup> Anila Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe,” Tiranë, 2012, f. 319.

<sup>150</sup> Gjovalin Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 415.

<sup>151</sup> Bari Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare”, I, Tiranë, 1971, f. 321.

verilindore ka shumë gjasa të vijë nga skr. **šuga** “zgjebe”, **šugav** “i zgjebosur, qeros”.<sup>152</sup>

Numërojmë rreth 70 sllavizma në Fjalorin e Gazullit, të cilat i kemi marrë në shqyrtim. Autori është munduar të bëjë përjasjen e fjalës shqipe me sllavishten, madje në shumë prej rasteve ka pasqyruar edhe afrinë që kanë me njëra-tjetrën këto fjalë, duke i marrë si huazime të mirëfillta sllave, gjithmonë duke iu referuar etimologjikisht prejardhjes së tyre. Kjo dukuri nxjerr në pah se sa njeri i plotësuar ishte Gazulli si gjuhëtar, ku përveç anës leksikore, ai merret edhe me etimologjinë e fjalës, duke na dhënë ne një pasqyrë të saktë të huazimeve turke, italiane e sllave në Fjalor.

Nuk duhet lënë pa përmendur se lemat sllave janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren edhe sot në pjesën e gegërishtes veriore, kryesisht të folmes veriperëndimore, zonat e Malësisë së Madhe. Janë pjesë e ligjërimit të përditshëm, pse jo dhe disa nga ato, janë përfshirë edhe në fjalorët normativë të shqipes.

#### BIBLIOGRAFI:

1. Omari, A.: “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, Jorgji Gjinari, *Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore*, “Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” II, Tiranë, 1972.
2. Omari, A. (1994): *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet veriore të shqipes*, “Studime filologjike”, 1-4, Tiranë.
3. Beci, B. (1971): *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë.
4. Beci, B. (1974): *E folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë.
5. Shkurtaj, Gj. (1975): *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë.
6. Shkurtaj, Gj. (1974): *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë.
7. Taliavini, K. (1942): *Le parlate albanesi di tipo ghegjo orientale (Dardania e Macedonia nordocidentale)*, “Le terre albanesi redenti”, I, Roma.
8. Elezi, M. (2006): “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë.
9. Ndreca, M. (1980): “Fjalor shqip - serbokroatisht”, Prishtinë.
10. Hoxha, Sh. (1975): *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë.
11. Topalli, Xh. (1974): *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë.
12. Gosturani, Xh. (1975): *E folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë.

<sup>152</sup> Anila Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet e shqipes*, “Studime Filologjike I-IV”, Tiranë, 1994, f. 128.

## **The presence of slavic words in the vocabulary of Gazulli**

### ***SUMMARY***

The relations between Albanians and Slavs in our history have left traces in our language. They begin with the first invasions by Slavs in the Balkans even nowadays with close contacts relations between Albanians, mainly the northern part of Gheg Albanian populations in the former Yugoslavia, Kosovo and Montenegro. Furthermore, they have the contacts neighborly relations, mainly with the South Slavs, and necessarily have left traces in the Albanian dialects. Moreover entered Slavic elements than vice versa, but this does not mean that the albanian language does not leave traces in their language. Slavic borrowings problem is treated by many Albanian and foreign researchers, as Miklosiç Mayer, Jokli, Çabej, Desnickaja etc. In the dictionary of Gazulli have a relatively large number of slavic words. We made gheg lexicon approach reflected in the volumes of albanian dialectology (I.II.III, IV), lexic by Anila Omari regard slavic words, and Mehmet Elezi dictionary. Are also consulted on several occasions with English-Serbo-Croatian Dictionary of Mikel Ndreca. We count about 70 slavic words in the dictionary of Gazulli, which we have to consider. The author has tried to do with the alignment of the albanian slavic words, and in many cases reflected the closeness they have with each other These words are taken as genuine slavic borrowings, always referring to their origin etymologically. This phenomenon reveals Gazulli as a linguist, where except lexical side, it deals with the etymology of the word, helping to give us an accurate picture of borrowings turkish, italian and slavic in the Glossary. Should not fail to mention, that slavic words are used continue to be used even today in the northern gheg, mainly dialect northwestern areas. Are part of daily discourse, why not, some of them are also involved in normative albanian dictionaries.

Merita HYSA

## STRUKTURA METRIKE DHE VEÇORI TË KËMBËVE FONETIKE NË GJUHËN SHQIPE

Struktura fonologjike është një tip organizimi mendor që dallohet nga veprimet mekanike që realizon aparati i të folurit, si dhe nga konfigurimet auditive që përcillen në qendrat motore. Përcaktimi i kufijve të fjalëve nuk ndodh në lëvizjet motore, as në prurjet auditive. Artikulimet e tingujve realizohen nga informacioni që u përcillet organeve të fonacionit përmes impulseve nervore, proces ky që realizohet pas kodifikimit të informacionit tingullor.

Në gjuhën e folur, ne vërejmë njësi të organizuara në mënyrë hierarkike, të cilat përcaktojnë interpretimin fonetik të strukturave sipërfaqësore. Duke studiuar mënyrat e shfaqjes, si dhe veçoritë e segmenteve më të vogla, që janë fonemat, duhet të kemi parasysh se ato nuk funksionojnë të veçuara, por shfaqen si përbërës themelorë në kombinimet gjuhësore.

Vëzhgimi i brendshëm i këtyre segmenteve si dhe mënyra e organizimit të tipareve brenda strukturave fonologjike, na paraqet një lloj hierarkie brenda së cilës konkretizohen një sërë procesesh fonologjike.

Në vitet '70 të shekullit XX, përmes analizës së disa tipareve mbisegmentore (rregullsive gjuhësore të vëzhguara mbi nivelin e segmenteve), u vu re se sfera e ndikimit të një tipari nuk përkonte domosdoshmërisht vetëm me segmentin të cilit i referohej, por mund ta shtrinte ndikimin e tij edhe mbi segmentet e tjera, apo mbi të gjithë strukturën ku përfshihej.

Si rrjedhojë, modelet fonologjike lineare, filluan dalëngadalë të zëvendësoheshin nga ato mbisegmentore, të cilat mbështeteshin në struktura më komplekse që ndërtoheshin mbi bazat tingullore.

Duke përmendur termin hierarki, natyrisht që i referohemi renditjes së shkallëzuar të përbërësve fonologjikë, që erdhi si rezultat i një këndvështrimi të ri në studimet gjuhësore, i cili kaloi nga renditja lineare e elementeve, në atë mbisegmentore. Me kalimin nga fonologjia lineare në atë multilineare, u përhap ideja se gjuhët përfaqësohen me forma fonologjike më të mëdha se fonema.

Fonologjia prozodike, një degëzim i vonë i teorisë fonologjike, e kanalizon studimin e këtyre sferave të zbatimit, duke e lidhur me njësitë e

hierarkisë prozodike<sup>153</sup>, të cilat fillojnë me *morën*, njësinë më të vogël ritmike, e përfundojnë me *frazën fonologjike*. Kjo strukturë është si më poshtë:

∞	Fraza fonologjike
I	Sintagma fonetike (ose grupi kuptimor)
∞	Fjala prozodike
φ	Këmbe
σ	Rrokja
μ	Mora

Secili prej niveleve të dhëna në skemën më sipër, përshkruan përdorimin e modeleve të ndryshme fonologjike. Ndërsa rrokja është njësi qendrore për shumë procese fonotaktike, këmba fonetike formon nivelin e kombinimeve metrike, si dhe veçoritë e tjera të ndërkëmbimeve rrokjesore brenda kësaj strukture ritmike.

Struktura metrike e një gjuhe përftohet duke kombinuar elemente të ndryshme të strukturës prozodike: rrokjet dhe përbërësit e tyre, këmbët fonetike, si dhe njësi të niveleve të tjera të hierarkisë prozodike, si fjalët fonetike, frazat etj. Pa një organizim metrik të dhënë, një përbërës nuk mund të spikasë në një rrjedhë të caktuar tingullore. Kjo spikatje realizohet përmes theksit, i cili zë një vend qendror ndër elementet prozodike. Në këtë konceptim theksi, nuk shihet vetëm si një tipar fonetik, por ai është një mjet për shënimin e disa dukurive të rëndësishme brenda organizimeve të njësisive metrike.


Rrokjet, si struktura minimale, nuk lidhen drejtëpërdrejt me fjalët. Ato kombinohen në struktura të ndërmjetme, të një niveli më të lartë në hierarkinë prozodike, që quhen këmbë fonetike.

Këmbe fonetike është përbërësi i dytë i hierarkisë fonologjike dhe përbëhet nga një ose më shumë rrokje. Kryesisht ekzistenca e këmbëve lidhet me praninë e theksit në këto struktura, si dhe me pozicionin që ai zë në rrokje të ndryshme.

<sup>153</sup> Për më tepër shih (Selkirk 1980, 1984, Nespor & Vogel).

Koncepti i këmbës fonetike, vjen nga strukturimi i vargjeve në metrin poetik. Ideja e alternimit të rrokjeve të theksuara dhe rrokjeve të patheksuara, sikurse ndodh në rimën poetike, lidhet me përcaktimin e llojeve të këmbëve metrike, si p.sh.: jambike, trokaike, anapestike, amfibrake. Dy llojet e para të këmbëve metrike përfshijnë alternimin e rregullt të dy rrokjeve (e patheksuar, e theksuar, jambiku, dhe e theksuar, e patheksuar, trokaiku). Brenda strukturës së këmbëve fonetike, rrokjet nuk kanë të njëjtën spikatje, vetëm njëra prej tyre është e theksuar, ndërsa të tjerat janë të patheksuara. Kështu, tre tipat e tjerë të vargjeve dallohen nga pozicioni i rrokjes së theksuar, kundrejt rrokjeve të patheksuara. Arsyeja e përvetësimit të këtij koncepti të metrikës klasike, ka të bëjë me faktin se ritëm nuk kanë vetëm strukturat poetike. Edhe në fjalë të thjeshta, ne mund të vërejmë kombinime nga më të ndryshmet sa i takon pozicionit të rrokjeve, mjafton që identifikimi i tyre të bëhet duke u nisur nga struktura theksore.

Në fonologjinë metrike, një rrokje quhet e fortë nëse është e theksuar dhe e dobët, nëse është e patheksuara. Rrokja e theksuar shërben si kulm spikatjeje, rreth të cilës renditen satelitët e tjerë që ndërtojnë strukturat e këmbëve rrokjesore. Në strukturimin e këtij përbërësi fonologjik, duhet t'i referohemi pozicionit të theksit, si atij parësor, ashtu edhe atij dytësor, në konfigurime të ndryshme fjalësh. Le të shohim tani disa struktura bazë, të cilat shfaqin pozicionet kohore të elementeve që marrin pjesë në strukturën e këmbës fonetike, duke i përqsuar disi edhe me këmbët metrike, për të vënë në pah të përbashkëtat dhe të veçantat mes tyre.



Një përbërës i tillë, nuk është i rëndësishëm vetëm për të përfaqësuar ritmin në poezi, siç është parë zakonisht, por edhe për të specifikuar theksin si dukuri gjuhësore. Prania e kontureve theksore, që brenda një sistemi gjuhësor ka një rol të veçantë, ka qenë një prej arsyeve që këmba të bëhej pjesë e përfaqësimeve fonologjike<sup>154</sup>. Sikurse rrokja, edhe këmba përbën një sferë zbatimi të rregullave fonologjike.


<sup>154</sup> Po aty, f.164.

Në skemat e paraqitura më sipër, një këmbë është e përbërë nga një rrokje e fortë, që ose paraprihet, ose ndiqet nga rrokje të dobëta. Ky përfaqësim tregon se theksi është një mjet spikatjeje mes rrokjeve, i cili diferencon nga pikëpamja fonetike fjalët. P.sh.: te fjalët [bári] dhe [barí], krijohet një kontrast force mes rrokjes së parë dhe të dytë, të cilat spikasin në mënyrë të ndryshme në të dy fjalët. Në këtë këndvështrim, një lloj risie që solli fonologjia metrike, ishte kundrimi i theksit si një dukuri prozodike, që lidhej me rrokjen, jo më me zanoren, sikurse ishte parë qoftë në fonologjinë tradicionale, qoftë edhe në atë gjenerative (të periudhës së SPE), tek të cilat theksi ishte një karakteristikë dalluese e zanoreve, që paraqitej përmes një sistemi numerik. Gjatë dukurisë së shkallëzimit të theksit, në fonologjinë lineare, shënoheshin me numra si zanorja e theksuar, ashtu edhe ato të patheksuara. Vlera numerike e zanoreve të patheksuara, varej nga pozicioni i tyre në lidhje me theksin e fjalës. Kështu, zanorja e theksuar shënohej me 1, të patheksuarat me 0, dhe më pas, sipas jehonës së theksit, ato zanore që ishin më larg bërthamës së theksuar kishin vlera më të mëdha numerike (0, 2 etj). P.sh.: në një fjalë si [arkëtare], do të kishim këtë paraqitje numerike, ku me 1, shënojmë zanoren e theksuar, 0, ato të patheksuara dhe me 2, zanoren që qëndron 2 rrokje larg kulmit të spikatjes.

**ar kë tá re**

2 0 1 0

Në fonologjinë metrike, përkundrazi, përfaqësimi i konturit theksor të fjalës së mësipërme do të ishte:



Rrokjet janë të grupuara në dy këmbë fonetike, siç e vëmë re, pasi fjala ka 4 rrokje dhe struktura maksimale e Kf është me tri rrokje. Përgjithësisht, ndarja në këmbë fonetike, sidomos në fjalët e prejardhura, përkon me ndarjen në morfema, si në rastin më sipër, ku veçohet morfema rrënjore, nga ato prapashtesore (fjalë dhe trajtëformuese). Më pas, ato grupohen në përbërës të një rendi më të lartë që janë këmbët fonetike (Kf), e para e dobët (Kfd), sepse mbart theksin dytësor (shënohet me -rf-, rrokja

që bart zanoren që ka qenë e theksuar në temën fjalëformuese) dhe këmba fonetike e fortë ( Kff), që mbart theksin kryesor të fjalës.

Përbërësi tjetër, i një niveli më të lartë në të cilin grupohen këmbët fonetike, është fjala fonetike (∞), në gjirin e së cilës konkretizohen këta përbërës minimalë.

Edhe këmba, sikurse rrokja, ka një përmasë të përgjithshme, universale në përkufizimin e saj. Fakti që ajo ka një element qendror, të theksuar (kokë), i cili paraprihet ose ndiqet nga elemente me të dobëta, shpeshherë edhe fakultative, bën që ky përbërës fonologjik, të jetë universal, dhe t'i kalojë kufijtë e një sistemi të vetëm gjuhësor.

Duke e krahasuar përsëri me rrokjen, ndalemi paksa te numri i elementeve që mund të përmbajë një këmbë. Natyrisht që mënyra e strukturimit të rrokjeve, brenda kontureve të këmbës fonetike, varion nga gjuha në gjuhë. Sikurse thamë për rrokjen, numri i segmenteve që dalin brenda strukturës së saj dhe mënyra e kombinimit të tyre, varet nga veçoritë fonologjike të gjuhës, ashtu dhe për këmbët fonetike, përbërja e tyre u referohet strukturës së gjuhës. Ka gjuhë që kanë një numër të kufizuar rrokjesh brenda një strukture metrike (të këmbës), sikurse janë shqipja, italishtja etj., por ka edhe gjuhë, ku sekuencat rrokjesore janë më të gjata dhe ku vihet re më qartë alternimi i rregullt i theksit parësor dhe atij dytësor.<sup>155</sup>

Ne do të marrim parasysh tipin e parë të këmbëve fonetike, të cilat degëzohen maksimalisht në tri përbërës rrokjesorë, sikurse i pamë më lart, me një alternim të rregullt të rrokjeve të theksuara dhe të patheksuara. Në qoftë se do të vërenim tipat e këmbëve fonetike, duke përgjithësuar pozicionin e rrokjes së theksuar, kundrejt atyre të patheksuara, do të ndaleshim në paraqitjen e këtyre strukturave, duke iu referuar skemave theksore të shqipes.

Studimi i theksit të fjalëve lidhet sigurisht me pozicionin e rrokjeve të theksuara, si rezultat edhe me strukturën ritmike, si dhe me faktorët morfologjikë që ndikojnë mbi formësimin e strukturave rrokjesore. Në qoftë se do t'u referoheshim skemave theksore, mund të përgjithësojmë një rregull:

*Së pari*, theksi i fjalës në shqipe është kulminativ, kjo do të thotë se në një fjalë njëra prej rrokjeve është e theksuar, p.sh.: *bá-ri*.

*Së dyti*, struktura theksore paraqitet hierarkike, dmth, si rezultat i jehonës së theksit<sup>156</sup>, kemi një rritje dhe rënie graduale të tij para dhe pas

<sup>155</sup> J. Goldsmith, *Autosegmental and metrical fonology*, Cambridge, 1993, f. 172.

<sup>156</sup> R. Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Tiranë, 2010.



rrokjes së theksuar. Këtu mund të veçojmë strukturat theksore në fjalët jo të parme (të prejardhura dhe të përbëra), tek të cilat, krahas theksit parësor mund të veçohet dukshëm edhe theksi dytësor, sidomos te kompozitat (p.sh.: *këpucëbë'rës*, *hëkurpunúes*, *zëvëndësredaktór* etj).

Përgjithësisht rrokjet e theksuara spikasin edhe përmes parametrave të tjerë fonetikë siç janë gjatësia ose lartësia e zërit, përveç intensitetit që është tipar themelor i theksit. Zgjatja në kohë duket se i bën rrokjet e theksuara në trup të fjalëve më të hapura, edhe kur këto të fundit mund ta kenë strukturën e kodës (bishtit).

Tradicionalisht, sistemet theksore të gjuhëve janë trajtuar sipas dy këndvështrimeve: gjuhë me theks të ngulitur, në të cilat vendi i theksit është i parashikueshëm dhe ku strukturat theksore të këmbëve metrike sundohen nga ligjësi të brendshme më tepër gramatikore; dhe gjuhë me theks të lirë<sup>157</sup>, ku vendi i theksit lidhet me identitetin e fjalës si njësi fonoleksikore. Në këtë kategori hyn edhe gjuha shqipe, në të cilën pozicionimi i theksit ka funksion dallues (tipar qenësor distinktiv).

Një dallim i dytë bëhet për gjuhët në të cilat, natyra e theksit dominohet nga faktorë të pastër fonologjikë, si p.sh., distanca mes kufijve të fjalëve, nga natyra dhe pesha e rrokjes, faktorët ritmikë etj., dhe sistemet ku pozicionimi i theksit dominohet nga faktorë morfologjikë<sup>158</sup>, si p.sh., dallimi mes rrënjëve dhe ndajshesave.

Në shqipe, strukturat e theksit janë të lira, në kuptimin që theksi mund të bjerë në rrokje të ndryshme të fjalëve, (këtë e vërteton edhe prania e katër skemave theksore: fundore: *punoj*, *liri*; parafundore: *flutur*, *këngë*; tejfundore: *kumbulla*; dhe theks në rrokjen e katërt nga fundi: *dëgjuakemi* etj).

Përgjithësisht në shqipe mbizotëron theksimi parafundor i fjalëve, sidomos kur i shohim ato si njësi leksikore, pra të zhveshura nga formantet trajtëformuese. Duke përjashtuar rastet e lëvizshmërisë fonetike dhe gramatikore të theksit të fjalëve, në shqipe kjo dukuri prozodike mund të shihet në aspektin morfologjik të saj, pasi në gjuhën tonë nuk theksohen mbaresat<sup>159</sup> dhe në kufijtë e fjalëve morfologjike, si rrjedhojë në formantet gramatikore (që zakonisht janë njërrrokëshe), vërehet ndryshimi i skemës theksore të leksemës bazë: p.sh., *lul(e)-ja*, *lule-ve*, pra nga parafundor në tejfundor, megjithëse në të gjitha format paradigmatiche theksi bie mbi të njëjtën rrokje të fjalës. Ky pozicion i ngulitur i theksit të fjalëve në shqipe

<sup>157</sup> R. Kager, *The metrical theory of word stress*, f. 2.

<sup>158</sup> Po aty, f. 8.

<sup>159</sup> K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 66.

lidhet me ekzistencën e saj si njësi leksiko-gramatikore dhe jo thjesht fonetike.


U ndalëm paksa në këtë panoramë teorike të veçorive theksore të fjalëve, për të hyrë në analizën e skemave të këmbëve fonetike në gjuhën shqipe.


### - Veçoritë e strukturës së këmbëve fonetike në shqipe

Duke iu referuar skemava theksore, ne mund të bëjmë një parashtrim të hollësishëm të alternimeve rrokjesore, brenda skemave metrike të këmbëve, duke veçuar modelet e ndryshme që na ofron shqipja. Duhet të theksojmë se në studimin e modeleve të këmbëve fonetike do t'u referohemi kryesisht temave të fjalëve, të zhveshura nga ndajshtesat trajtëformuese. Në këtë mënyrë shfaqen më qartë veçoritë e strukturave ritmike të tyre, sidomos pozicioni i theksit, i cili megjithëse është i ngulitur mbi njërin prej rrokjeve të fjalës, ndryshon nga vendosja e formanteve trajtëformuese (mund të përmendim këtu disa ndajshtesa foljore, p.sh., *dëgjua-kemi*, ku theksi nga fundor tek forma përfaqësuese [dëgjoj], bie në rrokjen e katërt nga fundi ose disa prapashtesa shumësi tek emrat p.sh.: parafundor tek *lule* dhe tejfundor te *luleve*).

Në strukturat dyrrokëshe (binare), mundësitë janë të përcaktuara, mes trokaikut dhe jambit, pra pozicioni i rrokjes së theksuar në fillim ose në fund të fjalëve. Të dyja këto skema theksimi janë të përhapura, por më shpesh vërehet e para, dmth, theksimi parafundor mbizotëron mbi atë fundor në këtë strukturë fjalësh.

Le të shohim skemat e mëposhtme:






Pemët metrike na krijojnë një imazh të qartë të strukturimit të rrokjeve brenda strukturës së këmbës fonetike, sipas organizimit theksor. Rrokjet e theksuara krijojnë një kulm spikatjeje, duke formuar një element bërthamë, i cili mund të paraprihet ose ndiqet nga njësi (rrokje) të patheksuara. Sikurse rima që përlligj ekzistencën e rrokjes, ashtu edhe rrokja e theksuar organizon strukturën metrike të fjalës, pasi fjalë pa theks nuk ka. Megjithëse thuhet që theksi lidhet me fjalën, e identifikon atë si njësi fono-leksikore me një funksion të caktuar gramatikor<sup>160</sup>, siç e pamë edhe nga shembujt e mësipërm, ai më tepër lidhet me rrokjen dhe pozicioni që zë një dukuri e tillë prozodike brenda këtij përbërësi. Më saktë ai bartet nga zanoret dhe del si rezultat i spikatjes së parametrave fonetikë në shqiptimin e tyre.

Rrokjet nga ana tjetër, mund të copëzohen në segmentet përbërëse, që përkon me ndarjen e fjalëve në rrokje, sipas ligjësive fonologjike të gjuhës, e cila lejon përfshirjen e segmenteve konsonatike në strukturat nistore apo fundore të tyre.

Në fjalët me tri rrokje, vërejmë tri lloje strukturash, *anapestike*, *amfibrake* dhe *daktilike*. Në fjalët tri rrokëshe, pa nivele prejardhjeje, veçoritë e skemës theksore lidhen me ekzistencën e saj si njësi fono-leksikore, prandaj rrokja e theksuar mund të jetë në fillim, në mes ose në fund të fjalës. Në fjalët që kanë të paktën një prapashtesë fjalëformuese, skema paraqitet gati e ngulitur, pasi këto ndajshitesa e bartin gjithmone theksin mbi vete duke na dhënë këmbë amfibrake, si p.sh.: *flamurtar*, *biskotë*, *bukuri*:



<sup>160</sup> R. Memushaj, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010.

Një situatë e ngjashme shfaqet edhe me prapashtesat trajtëformuese, të cilat i shndërrojnë skemat trokaike në amfibrake, duke theksuar natyrën e ngulët të theksit në format paradigmatiche, p.sh.: *mál-i*, *mál-e-ve*, *lúle-ja*, *lúle-ve* etj.


Sipas Halle & Vergnaud (1987), Hayes (1995), kufijtë e këmbëve fonetike janë binarë, dhe theksi parësor duhet të gjenerohet prej strukturave bazë jambike ose trokaike (e thënë ndryshe, nga skemat bazë fundore dhe parafundore). Pra sipas kësaj teorie, në thelb, pjesa më e madhe e strukturave universale të fjalëve, kanë bazë binare. Skemat theksore tri dhe më shumë rrokëshe, gjenerohen nga këto struktura.

Në thelb, kjo teori qëndron për një pjesë të konsiderueshme të inventarit leksikor, megjithatë sikurse për çdo strukturë të brendshme, gjuhët u referohen veçorive të sistemit fonologjik.

Në fjalët me më shumë se tri rrokje natyrisht duhen vërejtur veçoritë e formimit të fjalëve. Në fjalët e prejardhura dhe të përbëra kufijtë e këmbëve fonetike janë të qartë: dmth., në fjalët e prejardhura këmbët fonetike përkojnë me kufijtë temë+ndajshesë, {*punë+tor*, *aktiv+itet*, *ëndërrim +tar* etj.}, ndërsa në fjalët e përbëra në hierarkinë e vendosur mes temave të kompozitës si një strukturë binare, ku theksi parësor bie gjithmonë mbi temën e dytë të saj: {*hekur+punues*, *krye+ mjeshtër*}.

Në ndërtimin e këmbëve fonetike të fjalëve të prejardhura, shihet gjithmonë numri i rrokjeve. Në qoftë se numri i rrokjeve nuk është më i madh se tre, struktura metrike e fjalëve fonetike përputhet me atë të këmbëve fonetike (me strukturë maksimale, trinare), siç ishte në shembujt që pamë më sipër. Në këto fjalë, pozicioni i rrokjes së theksuar ndryshon, pasi lidhet me veçoritë e saj si njësi fono-leksikore.


Atëherë kur numri i rrokjeve në fjalë është më i madh se tre, pra nuk mund të përfshihen në një këmbë të vetme fonetike, do t'u referohemi strukturave të fjalëve me disa këmbë fonetike, ku termat *Kff* e *Kfd* do t'u përgjigjen këmbëve fonetike që mbartin theksin parësor dhe dytësor, ose tek të cilat vërehet një jehonë e dobët theksi. Kështu p.sh.: këmbët rrokjesore të fjalëve që pamë më sipër, me një ose më shumë nivele prejardhjeje do të jenë:



Te kompozitat konfigurimi është më i qartë, pasi respektohen kufijtë e temave fjalëformuese dhe pozicionimi i theksave është i rregullt, gjymtyra e dytë e kompozitës mbart gjithmonë theksin parësor, ndërsa theksi dytësor bie mbi rrokjen e theksuar të temës së parë që ka dhënë kompozitën.

Niveli bazë përkon me ndarjen e fjalëve në rrokje, duke u mbështetur në ligjësitë fonetike të grupimit të segmenteve konsonantike dhe vokalike brenda strukturave të rrokjeve, qofshin ato të forta (rrokje të theksuara), apo të dobëta (rrokje të patheksuara)

Konfigurimi i pemëve metrike të kompozitave që dhamë pak më sipër do të jetë:



Këmbët fonetike janë të përbëra nga një rrokje (qoftë ajo e theksuar ose e patheksuar), me strukturë binare, pra me dy rrokje dhe me strukturë trinare (treshe) me tri rrokje.

Skematikisht, lidhjen e rrokjeve brenda këmbëve fonetike mund ta paraqesim:

$$Kf = \sigma + \sigma$$


$$Kf = \sigma + \sigma + \sigma$$

Një prej çështjeve themelore të teorisë metrike lidhej me rolin që luan rrokja për caktimin e theksit brenda strukturës së fjalës. Sidoqoftë,


organizimi rrokjesor nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar bindshëm skemat theksore. Për këtë arsye doli në pah një organizim më i lartë metrik, që lidhej pikërisht me grupimin e rrokjeve, qoftë brenda morfemave rrënjore, qoftë edhe në marrëdhëniet temë-ndajshitesë. Rrokjet në këtë mënyrë janë të grupuara në këmbë metrike, të cilat paraqesin kombinimin e rrokjeve të forta dhe të dobëta, sipas pozicionit që zënë në fjalë.

Një koncept interesant, i ndikuar nga sintaksa gjenerative është ai i kokës së këmbës metrike, koncept ky që lidhet me pozicionin e rrokjes së theksuar përkundrejt rrokjeve të patheksuara. Kështu, llojet e njohura të këmbëve metrike, qoftë dy rrokëshe, qoftë trirrokëshe mund t'i karakterizojmë duke u nisur nga elementi qendror (rrokja e fortë). Në këtë mënyrë do të përftonim këto karakterizime:


Një këmbë metrike e kulmuar majtas (do ta shënojmë me M), është trokaike, pra rrokja e fortë pozicionohet në kulmin e majtë.



Një këmbë metrike e kulmuar djathtas (do ta shënojmë me D), është jambike, që do të thotë se rrokja e fortë qendron në krahun e djathtë.



Ndryshe shtrohet çështja në këmbët trirrokëshe, në të cilat pozicionimi i rrokjes së theksuar, vërehet jo vetëm majtas apo djathtas, por edhe në qendër.



Skemat theksore nuk shihen më në renditjen lineare të segmenteve, por në hierarkizimin dhe pozicionimin e elementeve silabike.

Mënyra e organizimit të këmbëve metrike brenda strukturës së fjalës, është shpesh e lidhur me disa procese fonologjike që veprojnë si brenda saj, ashtu edhe në skajet e fjalës. Ato mund të shërbejnë si nivele për procese të ndryshme fonologjike dhe paraqesin kushtet e mundshme për formimin e fjalëve minimale që ndikojnë në proceset morfologjike. Mund të flasim për fjalë minimale në qoftë se u referohemi këmbëve jambike ose trokaike, ose në një analizë më të hollësishme edhe këmbëve njërrokëshe, të cilat në kontakt me ndajshesat trajtëformuese formojnë jambe ose këmbët trokaike. P.sh., te fjalët *mal* (*ma-li*), *gur* (*gu-ri*) etj.

Koncepti i rrokjes është parë për një kohë të gjatë si element qendror në përbërësit e strukturës fonologjike dhe ka qenë i domosdoshëm për analizat fonologjike. Koncepti i rrokjeve, të hapura dhe të mbyllura, të rënda dhe të lehta, ka luajtur një rol të veçantë në zhvillimin e strukturës tingullore dhe proceseve fonologjike si te neogramatikanët ashtu edhe në gjuhësinë strukturaliste.

Trajtimi i gjerë i këtij koncepti konsolidoi bazat e fonologjisë metrike dhe asaj prozodike, duke e pozicionuar këtë përbërës në hierarkinë e njësive fonetike të rrjedhës së të folurit, pasi përmes saj mund të paraqiteshin lehtësisht të gjitha strukturat e tjera të përbëra, duke filluar me këmbën fonetike, e më tej.

Përcaktimi i njësive kufitare, të cilat orientonin kalimin nga një nivel në tjetrin brenda strukturës së fjalëve fonetike, qartësoi pozicionin e këmbëve fonetike si njësi komplekse, që funksiononin jo vetëm si kombinime fonetike, por edhe si organizime prozodike.

Struktura e këmbëve fonetike në shqipe paraqitet si një organizim hierarkik, i cili varet jo vetëm nga faktorë fonetikë (segmentorë ose prozodikë), por edhe nga kombinimet morfemore në kufjtë tematikë. Kështu, ne pamë se si njësitë minimale të përfaqësimit fonologjik, që ishin segmentet, organizohen në struktura maksimale, prania e të cilave përlligj një tërësi procesesh me karakter fono-morfologjik.

Ekzistenca e këmbëve fonetike si njësi bazë e përshkrimeve fonologjike, na krijon një kuadër të qartë mbi të cilin mund të orientojmë analizat metrike të strukturave të fjalëve në shqipe.

**BIBLIOGRAFIA:**

1. Blevins, J., *The syllable in phonological theory*, in "The handbook of phonological theory", Oxford, Blackwell, 1995.
2. C.J. Ewen, H. van der Hulst, *The phonological structure of words*, Cambridge, 2009.
3. Goldsmith, J., *Autosegmental and metrical phonology*, Cambridge, 1993.
4. Goldsmith, J., (ed.) *The handbook of phonological theory*, Cambridge, MA., Blackwell, 1995.
5. Gussmann, E., *Studies in abstract phonology*. Cambridge: MIT Press, 1980.
6. Hadaj, G., *Shpërndarja e theksave në leksikon e shqipes*, SF, 1991, Nr. 1, f. 99–106.
7. Halle, M., Mohanan, K. P., *Segmental phonology of Modern English*, Linguistic Inquiry 16, 1985.
8. Kager, R., *The metrical theory of word stress*, 1993.
9. Klements, G.N., *The geometry of phonological features*, Cambridge University Press, 1985.
10. McCarthy, J., *Phonological features and morphological structure*, University of Massachusetts - Amherst, 1983.
12. Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2009.
13. Memushaj, R., *Fonetikë e shqipes standarde*, Tiranë, 2009.
14. Nespor, M., *Fonologia*, Bologna, 1993.
15. Norval Smith (eds.) "The Structure of Phonological Representations", vol. 1, 16. Dordrecht, Foris, 1982.
17. Odden, D., *Introducing Phonology*, Cambridge University Press, 2005.
18. Pulleyblank, D., *Underlying mora structure*, Linguistic Inquiry, vol. 25, 1994, MIT Press.
19. Trask R. L., *A Dictionary of Grammatical Terms in Linguistics*, Routledge Publishers, New York, 1993.
20. Trubeckoi, N. S., *Parimet e fonologjisë*, Prishtinë, 1985.
21. Topalli, K., *Theksi i fjalës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995.

**Metrical structure and phonetic features in albanian****SUMMARY**

In this paper, we consider the role of prosodic structure in providing an adequate account of not only phonological phenomena, but also the phonetic realization of these patterns. We are most interested here in the role of prosodic structure internal to the word, focusing on the role of the phonetic root and the nature of the interface between prosodic and segmental structure.

One major contribution of non-linear phonology to the general phonological theory has been the



introduction of the skeleton as an intermediate level between syllabic constituents and melodic segments. The phonetic implementation *acts* on the phonological structure.

While there is some debate in the literature, it is fairly widely assumed that there is prosodic structure organized hierarchically within the word as well, including: the prosodic word which may or may not be isomorphic with the morphological word; metrical feet which account for metrical prominence and some other phonological phenomena; syllables which allow us to capture patterns of phonotactics and also condition the domain of rule or constraint application.

Root nodes are segmental and moras prosodic, there is not necessarily expected to be a one-to-one correspondence between root nodes and moras.

Aida URUÇI

## NGJYRESAT LIGJËRIMORE NË KRIJIMTARINË E MARTIN CAMAJT (NË FUSHË TË SINTAKSËS)

*“Sistemi gjuhësor në krijimtarinë letrare të Camajt mbeti i gjallë, - shprehet studiuesi i parë i veprave të tij, A. Klosi, - sistem që s’mund të shkatërrohet përgjatë një breznie. Dhe gegnishtja është një sistem që shprehet me morfologjinë e fjalës, në sintaksën e fjalisë e fort dukshëm në fonetikën, në tingëllimin e gjuhës.”<sup>161</sup>*

Martin Camaj është një emër i veçantë në letrat shqipe, ku bashkohen shkrimtari e gjuhëtari – madje ai lëvroi: historinë e gjuhës, dialektet sociale, etnografinë e të folurit etj. Krijimtaria letrare e këtij shkrimtari përbën një pasuri të madhe gjuhësore në mjaft rrafshë, që nga leksiku i rrallë, frazeologjia, formimi i fjalëve me brumë të shqipes dhe sidomos për mënyrat e veçanta të ndërtimeve sintaksore, për valencën stilistikore e sintagmatike në përbërje tekstore e kontekstuale. Vepra letrare e Camajt shquhet edhe për ngjyresat ligjërimore, ku autori operon në korpusin e përgjithshëm të veprave të veta me idiomën e variantit të shkrimtarëve më të përparuar të Veriut. Gjatë këndvështrimit stilistikor të tekstit gjuhësor të Camajt, kemi pasur parasysht thënien e njohur të psikolinguistit Wittgenstein<sup>162</sup>, i cili shkruante që *fjalën të mos e shohim nga kuptimi, por nga përdorimi...* Në këtë punim ne do të paraqesim vlerat e tekstit të veprës së Camajt nga aspekti sintaksor, duke u ndalur më pas te përftesat që krijohen tek fragmentet e paraqitura.

Teksti dhe hiperteksti i Camajt, sa i ngjyruar, hermetik dhe me oshëtimë, siç është në poezi, vjen i shtruar në prozë, me fjalën e gjetur e të qëlluar; me kombinime të përshkrimit të veprimit, me peizazhe të këndshme të përshkrimit e të veprimit, të gjitha këto autori i realizon me ndërtimet e drejta, ndjekur ose nga fjali të tjera drejtuese apo vargje fjalish të varura, të cilat mund të dalin ose me parataksë, ose me hipotaksë apo me alternime. Kemi vërejtur gjithashtu se në strukturën frazale të Camajt mbizotërojnë ndërtimet e drejta, siç quhen në sintaksë nisjet e periudhave me fjali drejtuese (për ndryshe QOS=qendër e organizimit sintaksor),

<sup>161</sup> A. Klosi, M. Camaj, *Vepra letrare 1*, Apollonia, Tiranë, 1996, f. 17.

<sup>162</sup> L. Wittgenstein, *Filozofska istraživanja*, “Nolit”, Beograd, 1980, f. 56.

ndjekur ose nga fjali të tjera drejtuese apo vargje fjalish të varura, të cilat mund të dalin ose me parataksë, ose me hipotaksë apo me alternime të bashkimeve të para e të dyta.

*(... Në bjeshkë e kan ndalë, e shtina në një tban, i hoqa armët, e lidha, kapa një hu të fortë dhe e kam rrahë mirë e mirë. Mandej e kam zgjidhë e i kam dhanë armët...*

*Edhe i kam thanë qi mos t'i thojë njeriut të gjallë se as u s'i thom kuj për mos me shti në ngatrrresa as ai njerzit e vet as u njerzit e mij. Tue ecë rrugës, më suell pushkën me më vra.....)* (“Bestytinia” në *Vepra 10*, Tiranë, 2010, f. 83).

Po kështu, nuk janë të dendura ndërtimet sintaksore në veprat e Camajt strukturat me ndërkalje, që sa u takon përbërësve kallzuesorë, dalin me relacione të largëta lidhjeje mediate (të ndërmjetuara), si në rastin e mëposhtëm:

*(...Zoga megjithëse e lirë, nuk iu dha të largohej: e ndiente veten si një copë dru, si njeriu që andërron se asht në rrezik dhe prap se prap s'mund të ndrrojë asnjë hap... )* (“Bestytinia”, në *Vepra 10*, Tiranë, 2010, f. 85).

Në veprën e Camajt kryesisht në prozë shpesh përbërësit frazalë vijnë e ngarkohen me rend gjymtyrësh, të cilat, edhe kur nuk janë funksionalisht homogjene, janë të një rendi si gjymtyrë të dyta.

*(... Ditën e mërkurë prej malevet të thata të veri-lindjes zbritnin malësorët tue ngrehë për laku lopë e dele, dhi e mushq të ngarkuem me djathë e tëlyen, lesh e lëkura, arra e lejthia, si dhe dru e qymyr, secili si mbas mundësisë e gjindjes së vet prodhuese...)* (“Jesminë”, në *Vepra 10*, Tiranë, 2010, f. 94).

Në një masë të caktueme ligjërimi i shkruar i Camajt vjen e ndërpritet nga dukuria e veçimit gjymtyror ose me fjalë të shkëputura, por edhe me fjalë e grupe fjalësh që kanë praninë e determinantëve (caktuesorëve), si p.sh.:

*(... Ata pesëdhjetë veta që ushtronin tregtinë edhe me katunde rreth kësaj qendre të vogël, si dhe hoxha në një anë e prifti në anën tjetër, bashkë me njëzet apo tridhjetë nëpunës, pjesa ma e madhe mësuese dhe edukatorë të shkollës fillore dhe të gjysmë-gjimnazit, vendosun në*

*kazermën e vjetër të ushtrisë, sikur edhe tarikati i zejtarëve e quenin me andje këtë grumbull banesash qytet... ) (“Jesminë”, në *Vepra10*, Tiranë, 2010, f. 94).*

Proza narrative (tregimtare) e Camajt karakterizohet nga ndërtime të shkurtra sintaksore, ndeshim raste kur bërthamat kallëzuesore dalin me marrëdhënie kushtore, bashkuar me mjetin lidhës jo aq karakteristik për të folmen e Temalit (Dushmanit) “nëse”, më tepër bie në sy përdorimi i lidhëzës “po”, që i përket sintaksës popullore. Gjejmë në këtë pasazh shprehjet: me dalë nuse (me u martue), oksimoronin “tue folë si me vete të madhe”, i kandet të mburret (i pëlqen me u lavdue), ara nën ujë (ara që vaditen), pyeste tue heshtue (pyeste dhe heshte), të vijne punët për dore (të jepet mbarë, i vijne punët për mbarë) e të tjera, që dëshmojnë pasurinë dhe shprehësinë e të folmeve të krahinës nga ishte shkrimtari ynë.

*(... Ndër këso raste takimesh familjare, sidomos kur u rritën djemtë dhe e bija përgatitej me dalë nuse, Nika ia gjeti shtegun të bëjë plane, tue fole si me vete të madhe, për shtimin ose mëngimin e berreve e të gjedheve, për mbjellje e korrje. U kujtuen të gjithë se i kandet të mburret tue thanë se në Fundinë, në një rrabe toke, prodhonte ma tepër misër e patate, qepë e duhan se të bijtë ndër arat nën ujë, te shtëpia e vendit, në verri. "Si kështu kjo punë?" Pyeste tue heshtue për një copë here, në pritje të një lavdate ose njohje të punës së tij. Pyetja "si kështu kjo punë?" u tingëllonte të gjithëve në veshë si shprehje retorike, pyetje që ai ia vente vetes e jo atyne. Nëse ai të njëjtën pyetje e përsëriste edhe një herë, ajo i tingëllonte Lenës e djemve si qortim se ata punuekan pak. Vetëm me një rast Lena i tha atij: "Mos me iau zanë kryet femijëve se punojnë pak ose ma pak se ti vetëm. U muer vesh se ty të vijne punët ma mirë për dore!" ...)*  
 (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 27).

Na bie në sy në këtë pasazh gjuhësor endja e 5 frazave me disa përbërës predikativë të shkallëshkallshëm, ndër të cilët fjalia drejtuese është në fillim (ndërtim i drejtë i strukturës), që, nga ana e stilit, përtakojnë me sekuenca narrative përshkruese, dallojnë midis tyre krijimet e marrëdhënieve qëllimore me trajta të pashtjella foljore (me paskajoren me “me”), njësitë kallëzuesore me formën e përcjellores gege me “tue”; por na bien në sy plotësorë të ndryshëm si në strukturën e tretë: “Atje nalt, përmbi kasolle, në rrasë të gjallë...”. Në leksik na tërheqin vëmendjen bashkime të tilla sintagmatike, me vlerë shprehëse, të cilat, me burim nga kjo e folme, mund

të përfshihen edhe në thesarin e normës gjuhësore, si: feksi i rrezeve (fluksi i rrezeve, tufa e rrezeve), djeg flakë (djeg zhari, djeg fort), ujit tash e parë (ujit shpesh e shpesh), lëvroi nga padija (e lëroi nga mungesa e njohurive), (e la) të marrë shtat ( të rritet më).

*(... Duhanin e Fundinës, këtë fjalë e shqiptonin me tingull pshertues të gjithë ata që kishin mbështjellë ndonjë cigare nga qesja lëkure dhie e Nikës. Në vjetët e para ndër Gurra, ai pruni nga vërrini fidana duhani dhe, për të mos ia ngranë dhitë, i mbolli në midis të qetës, në një rogë midis të shkambijve ku mund të ngjitej vetëm nepër një shkallë druni. Atje nalt, përmbi kasolle, në rrasë të gjallë, dielli e feksi i rrezeve në shkamb do ta kishin djegë bimën flakë, sikur Nika të mos e kishte ujitë tash e parë me ujë kroni, tue e bartë me kusi deri atje. S`dihet si qe puna si ai nxori një lloj duhani; dihet vetëm se ai e lëvroi nga padija në një mënyre tjetër: e mbolli farën e nxjerrun prej lules, ashtu tue e hjedhë si misrin në tokën e plehnueme me kakërdhi berresh. Mbasi u rrit bima, nuk e hoqi andej si rasat për ta ngulë fidan tjetërkund, por e la aty ku ishte, e rralloi dhe e la të marrin shtat filizat ma të shëndoshë...)* (“Pishtarët e natës”, në Vëllimi 3, Tiranë, 2010, f. 38).

*(...Qetësia e paturbullueme prej asnjë tingulli rrezatonte prapim, as me pasë Flora njëqind duer shtymëse, po aq sa kish rremba e gjethe përmbas karriges të cilës i kish ndërrue vend e vu gati në gjysmë të kopshtit për të kapë ma afër freskinë e tij. Sa ma tepër që avitej muzgu, aq ngjante se largohet, thellë e ma thellë mbrenda vetmisë. Jo vetëm ai, por kushdo në atë fill do ta kishte krahasue Florën me bimësinë e atij dheu e cila prej perëndimit e mbas merrte frymë e kërthnesej në jetë po si mushmolla dhe kurpnat rranzë murit, tue çue kryet me u ngjitë edhe ma nalt, deri në maje. Habitej si ajo nuk ngutej me i thanë se ishte ba vonë...)* (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në Vëllimi 3, Tiranë, 2010, f. 286).

Në këtë sekuencë përshkruese (deskriptive) na shfaqen vargje gjymtyrësh funksionale, karakterizuese si caktuesorë të fjalëve që përbëjnë grupe të ndryshme sintagmatike, siç ngjet në frazën e parë (nënvizuar prej nesh), ashtu si krijon shprehësi përdorimi i formave të pashtjelluara gege me paskajoren me “me” (nënvizuar më lart), në funksion të marrëdhënieve kushtore dhe qëllimore me vlerë predikative.

(... *Ishte fundi i shtatorit, koha ma e bukur e vjetit anëmbanë malësisë, vendosë mes dy lumenjve dhe me rrjedhën e Drinit përfund. Ata që e vërenin trevën e Fundinës bashkë me dhenat e Gurrave, vendosë mes dy shkambijve, nga larg, tue qëndrue kundruell mbi Vile, shihnin si me pasë dy pashë larg sysh avullina të lehta gjithfare ngjyrash: në agim, deri kah mjesdita, visi mes shkambijve mbulohej prej një mjegullaze të ndezun; ma vonë kthjellej gjithnjë e ma tepër prej fekseve të rrezeve të diellit qe vareshin e kryqëzoheshin si fije pejsh të hollë mendafshi në avlimend, një herë për skithi e mandej drejtpërdrejt prej majeve e krepave. Vetëm për nja disa orë të masdites, mjegulla zbardhej në sytë e vëzhguesve të largët që dallonin silueta përbindëse lisash e sendesh të gjalla, bagëti apo njerëz. Prej perëndimit të diellit deri në muzg, avullina ndërronte dukje prej minuti në minut, derisa Fundina e mbarë Gurrat merrnin pamjen e ishullit te pambërritshëm mes ujnave...*) (“Pishtarët e natës”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 46).

Përshkrimi i Camajt nis me një folje - kallëzues emëror (me këpujën “jam”), ku pjesa emërore përbëhet nga një SN, e cila ndiqet prej dy vargjeve të gjata gjymtyrësh të veçuara: ndajshtimore dhe plotësore - vendore (nënvizuar prej nesh). Fraza vijuese vjen shumë “e ngarkuar”, që është realizuar me lidhje të largëta sintaksore, ose të ndërmjetuara në masë të madhe prej gjymtyrësh funksionale, midis subjektit e predikatit (nënvizuar më sipër): Ata – shihnin. Vijimi i frazës bëhet me lidhje të dobëta sintaksore, me tregues kohorë e vendorë. Stilemat me dy përbërës silueta përbindëse (që të hutojnë, që janë të përbindëse, të habitshme) dhe ishullit të pambërritshëm (që nuk mund të arrihet, që vjen i largët, ose s’ të lënë dallgatë a erërat t’i afrohesh), ka mbiemrin e formuar nga folja “mbërrij/arrij” i pambërritshëm (pa + mbërrij + shëm).

(... *I acaruem, trokëlloi në çdo portë me flegra të trasha dypalëshe druni të shtrëngueme me bullona çeliku dhe askush nuk ia hapi, as që doli në dritare për të pyetë se çfarë kushtrimi qenka...*) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 287).

Ka tri njësi kallëzuesore radhazi të bashkuara me parataksë në mënyrë sindete, të cilat e mbyllin frazën me njësinë kundrinore se çfarë kushtrimi qenka. Fjalja nr. 1 nis me një gjymtyrë funksionale të veçuar (determinant mbiemëror), kurse plotësori i dyfishtë “në çdo portë” (SP), karakterizohet tepër gjatë: me rende fjalësh që plotësojnë njëra-tjetrën në përshtatje

gramatikore (me flegra të trasha dypalëshe druni të shtrëngueme me bullona çeliku), të cilat tregojnë se autori është përshkrues i hollë, deri në detaje të imëta.

*(... Si gjithnjë, në shtator, mbrendë, në restorantin e hotelit, pritnin njerëz me tesha banje mbi tryezë apo në rrjeta, varë për krahë karrigesh, që të ulej era jashtë për t'u la në det. Mbrendë, mbas banaqeve, hapi sytë kah i hueji gjellëbamësi, një burrë i shëndoshë e shegan në fytyrë. Ky ngriti duert e përrjarguna me peshk e i thirri me za të shterrun: “Mirëse keni ardhë! ...”) (“Katundi me gjuhë të fshehtë”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 289).*

Jemi para një ndërtimi interesant sintaksor: fraza e parë ka në përbërje, në mënyrë simetrike, dy plotësorë kohe dhe dy të tillë vendi – radhazi – po kështu, pas qendrës së foljes së njësisë predikative, vijnë karakterizimet e subjektit-kryefjalë (S) me tesha banje mbi tryezë apo në rrjeta, varë për krahë karrigesh, të cilat bëjnë që marrëdhëniet n/r qëllimore të dalin në mënyrë të ndërmjetuar, jo drejtpërdrejt. Po kështu, vijon struktura jo e zakonshme: folja e bërthamës predikative të mëvetësishme “rrethohet” nga dy plotësorë para dhe pas saj ndiqet prej një ndajshtimi me dy përcaktues homogjenë (Mbrendë, mbas banaqeve ... një burrë i shëndoshë e shegan në fytyrë). Janë stilema sintagmat me duer të përrjarguna (SP) dhe me za të shterrun (SP) – duar të lyera me lëngun vikoze të lëkurës së peshkur dhe me zë të marrë, me zë të ngjirur.

*(... Humanisti nga Përteqafa e Alpeve përcillte çdo mbramje Gjon Gazullin, tue u endë nalt e poshtë nëpër sheshe e portale pothuej të zbrazëta të Padovës. Së paku një gjysmë metri ma i gjatë se humanisti ynë, ai i leshonte Gazullit gjithnjë me nderim anën e djathtë, dhe, tue i ndejë një hap mbas tij, e thirrte tash e parë mjeshtër ose fort i nderuemi Gasulius, ashtu si emnohej prej të gjithë dijetarëve të vjetëve 1450 ky shqiptar i fisit të Mirëditës, lindë në Raguzë. Teutonasi vente pyetje dhe ndëgjonte, tue luejtë në mënyrë të përsosun rolin e dishepullit dhe nuk e hapte kurrë gojën maparë, edhe nëse mjeshtri heshtonte, të mos ia prishte këtij fillin e thellimit në mendime... (“Gjon Gazulli”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 298).*

Janë gjithë mbarë 3 fraza, të tria me strukturë të drejtë, por shprehësinë formale në rrafshin sintaksor e sjell periudha II, e cila nis me një varg të gjatë si përcaktues të subjektit (S) – ai (Së paku një gjysmë

metri ma i gjatë se humanisti ynë...) – kurse fraza I dhe III kanë në nisje të tyre kryefjalët emërore (humanisti, Teutonasi). Ngjyresa e kohës e qytetit të vjetër universitar, Padova, jepet me fjalët “sheshe, “portale”, “Përteqafa e Alpeve” (hapësirë e dominuar nga gjermano-austriakët deri në fillim të shekullit XX); kurse heroi kryesor, humanisti ynë, paraqitet me karakterizime atributive, që i takojnë vetëm atij, si: humanisti, nderim, ana e djathtë, mjeshtër, Gazulus, dijetarë të kohës, shqiptar i fisit të Mirditës, filli i thellimit të mendimit (një varg emëror) – ndërsa shoqëruesi nga Alpet mban fjalët caktuesore teutonas, dishepull (në analogji me 12 apostujt që ndoqen Jezusin deri në kryqëzim).

Si përfundim mund të themi që proza narrative (tregimtare) e Camajt karakterizohet nga ndërtime të shkurtra sintaksore, autori nuk shquan për struktura disashkallëshe parataktike e hipotaktike, por përshkrimi vjen i shtruar dhe me fraza me disa përbërës predikativë, që për sintaksën janë ndërtime që nisin me fjali drejtuese ose kryesore.

Ne bashkohemi me idenë e studiuesit R. Ismajli, i cili pohon, se “*Sintaksa thellësisht shqipe, saktësia në përdorimin e fjalëve, eufonia në vjershat, janë elemente që e shquajnë këtë vepër*”.<sup>163</sup>

#### **BIBLOGRAFIA:**

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2006): *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002): *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa, Tiranë,
3. A. Klosi, M. Camaj (1996): *Vepra letrare I*, “Apollonia”, Tiranë.
4. Ismajli, R. (1991): *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë.
5. Lloshi, Xh. (2012): *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë.
6. Wittengstein L., (1980): *Filozofska istraživanja*, “Nolit”, Beograd.

#### **Letërsi e vjelë**

1. Camaj, M. (2010): *Vëllimi I*, “Onufri”, Tiranë.
2. Camaj, M. (2010): *Vëllimi II*, “Onufri”, Tiranë.
3. Camaj, M. (2010): *Vëllimi III*, “Onufri”, Tiranë.
4. Camaj, M. (2010): *Vëllimi IV*, “Onufri”, Tiranë.
5. Camaj, M. (2010): *Vëllimi X*, “Onufri”, Tiranë.

<sup>163</sup> R. Ismajli, *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë, 1991, f. 32.



**Discursive nuances on creativity of M. Camaj (in field of syntax)*****SUMMARY***

Martin Camaj is a special name in Albanian letters, where the writer joins the linguist - he even disburged: the history of language, social dialects, ethnography of speaking, etc.

This writer's literar is a great language treasure in many directions, from rare vocabulary, phraseology, the formation of words with Albanian dough and especially for specific ways syntactic constructions, for stylistic valenc and sintagmatik in textual and contextual composes. Camaj literary work is well known also for nuances discourses, in which the author operates in total corpus of his works with the idiom of advanced writers of North.

The text and hypertext of Camaj, as hermetic and resounding, such is in poetry, in prose comes paved with founded wordes; with combinations of action descriptions, with nice landscapes and action descriptions, all these the author realizes with the right constructions, followed or by other leading sentences or dependent strings of sentences that may arise with parataksë or hipotaksë or alterations.

Mirela XHAFERRAJ (MITRO)

## E TASHMJA E LIDHORES SË SHQIPES DHE GREQISHTES. ÇËSHTJE TË MODALITETIT, ASPEKTIT, PËRDORIMIT DHE PËRKTHIMIT TË SAJ

Lidhorja është një prej mënyrave të foljes që haset si në gjuhën shqipe edhe në atë greke, por trajtat kohore të saj përveç tipareve të njëjtja paraqesin edhe karakteristika specifike, studimi i të cilave në plan përqasës, përveç vlerës gjuhësore kontribuon edhe në fushën e përkthimit. Objekt i këtij punimi është vetëm koha e tashme e mënyrës lidhore.

Mënyra lidhore në gjuhën shqipe shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, por ka raste kur ajo mund të shprehë edhe modalitetin e dëshirës apo të detyrimit<sup>164</sup>. Kjo është një nga mënyrat e trashëguara, e cila ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë evolucionit të gjuhëve indoevropiane, në disa prej të cilave ajo është përzier me mënyrën dëshirore<sup>165</sup>. Sipas Brugmann-it<sup>166</sup> dallohen tri kuptime të lidhores: kuptimi volitiv ose voluntativ, kuptimi deliberativ dhe kuptimi prospektiv. Demiraj<sup>167</sup> është i mendimit se kuptimi në zanafillë i mënyrës lidhore duket të ketë qenë ai volitiv a voluntativ, ndërsa kuptimet e tjera modale të kësaj mënyre, si edhe përdorimi i saj me kuptimin e mënyrave dëshirore e urdhërore duhet të jenë diakronikisht dytësore. Në shqipen e dokumentuar lidhorja përdoret më shumë në fjali të nënrenditura, por edhe në fjali kryesore, kryesisht format e së tashmes së lidhores<sup>168</sup> dhe ky përdorim, po sipas Demirajt, ka marrë shkas edhe nga mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike. Edhe foljet *mund* e *duhet* në shqip shoqërohen nga lidhorja, madje Mansaku<sup>169</sup> e vëren këtë që te Buzuku, ku sipas tij, kur folja *mund*

<sup>164</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995.

<sup>165</sup> Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.

<sup>166</sup> Brugmann K. – Delbrück B., *Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*, cituar sipas Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.

<sup>167</sup> Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.

<sup>168</sup> Po aty.

<sup>169</sup> S. Mansaku, *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet*, SF, 1979/3.

përdoret si folje modale, ajo shoqërohet nga lidhorja në 136 raste, përkundrajt 38 rasteve kur shoqërohet me paskajore, nga 226 rastet ku folja *mund* del si folje modale. Të gjitha format kohore të mënyrës lidhore të gjuhës shqipe kanë të paravendosur pjesëzën *të*<sup>170</sup>, ashtu si edhe ato të greqishtes pjesëzën *va*. Mënyra lidhore e gjuhës shqipe ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të shkuarën*, ku e shkuara ka tri nënndarje, *të pakryerën*, *të kryerën* dhe *më se të kryerën*<sup>171</sup>.

Në gjuhën greke, mënyra lidhore është mënyra, e cila e paraqet veprimin e foljes si diçka që duam ose presim që të ndodhë<sup>172</sup>. Mënyra lidhore është një nga mënyrat e foljes, e cila ka evoluar që nga greqishtja e lashtë, ku folja në këtë mënyrë paraqiste veprimin si diçka të dëshirueshme apo të pritshme<sup>173</sup>. Folja në mënyrën lidhore mund të përdoret me ose pa pjesëzat *va (të)*, *aç (le të)* (pa këto pjesëza përdoret lidhorja e thjeshtë ose aoristi i lidhores)<sup>174</sup>. Treguesi i lidhores së greqishtes së re *va*, kishte fillimisht formën *iva* dhe kishte funksionin e një lidhëze nënrenditëse dhe në periudhën e koinesë e hasim të shoqëruar me lidhoren e greqishtes së vjetër. Në vazhdim ndryshon mënyra e shqiptimit dhe vendi i theksit dhe bëhet *ivá*, duke arritur në greqishten e re në formën *va*, i cili është treguesi i lidhores<sup>175</sup>. Në rastet kur lidhorja nuk shoqërohet me këto pjesëza prihet nga ndajfolja *ίσως (ndoshta)*, apo nga lidhëza ose pjesë të tjera të ligjëratës që kanë funksionin e tyre: *άμα, μόλις, μήπως, πριν, όποτε, αφού, όποιος, όπου, ό,τι, ωστόσο*. Por ka raste kur folja në lidhore përdoret vetëm pa iu paravendosur asnjë nga elementet e mësipërme gramatikore, si p.sh.: *Έρθεις δεν έρθεις, εμείς θα πάμε*. - *Vjen apo nuk vjen ti, ne do të shkojmë*. Edhe në gjuhën shqipe ndeshen forma të lidhores pa pjesëzën *të* te Buzuku e te Matrënga<sup>176</sup>.

Gjuhëtarë si Anrdhrioti<sup>177</sup>, kanë vënë në dyshim ekzistencën e lidhores si mënyrë më vete duke qenë se në shumicën e tyre tipologjia e

<sup>170</sup> Pjesëza *të*, sipas Sh.Demirajt, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, 372, ka qenë burimisht një lidhës nënrenditëse që shërbente për të lidhur një fjali të nënrenditur, ku folja ishte në mënyrën lidhore dhe me kalimin e kohës u bë pjesë e pandashme e formave foljore të lidhores.

<sup>171</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995.

<sup>172</sup> M. Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*, Θεσσαλονίκη, 2005.

<sup>173</sup> Αχιλλ. Τζάρτζανος, *Γραμματική της αρχαίας ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα, 1967.

<sup>174</sup> Αχιλλ. Τζάρτζανος, *Νεοελληνική σύνταξις*, Τόμος Α, Εκδοτικός Οίκος Αδελφών Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη, 1991.

<sup>175</sup> R. Browning, *Η ελληνική γλώσσα μεσαιωνική και νέα*, μετάφρ. Μ. Κονόμη, Αθήνα, 1991, 63.

<sup>176</sup> Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002.

<sup>177</sup> Ν.Π. Ανδριώτης, *Υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική*; NE 15, 445 – 50, 1934.

formave kohore është e njëjtë si për dëftoren ashtu edhe për lidhoren, por Tzartanos<sup>178</sup> i përgjigjet me dy shkrime të tij Andriotit duke mbrojtur idenë se në greqishten e re lidhorja është mënyrë më vete. Sipas Mackridge termat “dëftore” dhe “lidhore” nuk përdoren për të treguar kategori morfologjike, sepse nuk ekzistojnë ndërmjet tyre ndryshime në paradigmën e foljes, por ato dallohen vetëm nga ana sintaksore në bazë të mjedisit leksikor në të cilin gjenden. Ndryshimi i vetëm nga ana morfologjike që dallon dëftoren dhe lidhoren si mënyra më vete, është pamundësia e përdorimit në dëftore e forms, që tradicionalisht është emërtuar aoristi i lidhores<sup>179</sup>. Për sa u përket kohëve të mënyrës lidhore të gjuhës greke, emërtimi i tyre nuk shpreh momentin kohor në të cilin kryhet veprimi. Ato shprehin zakonisht aspektin, pra nëse veprimi që shpreh folja është në aspektin e pakryer (imprefektiv), apo në aspektin e kryer. Kohët gramatikore të mënyrës lidhore janë: e tashmja ose lidhorja e vazhduar, aoristi, ose lidhorja e thjeshtë dhe e kryera. E tashmja dhe aoristi i lidhores, ndryshe nga shqipja kanë vetëm dallime aspektore midis tyre. Përsa i përket momentit kohor që i përgjigjet kryerjes së veprimit, ai del zakonisht nga situata ligjërimore në të cilën përdoren këto kohë<sup>180</sup>. Kohët e lidhores për gjuhën greke dhe shqipe mund t’i paraqesim si më poshtë:



Vërejmë se në gjuhën greke mënyra lidhore ka vetëm tri kohë, ndërsa lidhorja e shqipes ka katër, nga të cilat janë të përbashkëta vetëm e tashmja dhe e kryera, greqishtja nuk ka të pakryerën dhe më se të kryerën e lidhores, ndërsa shqipja nuk ka aoristin (të kryerën e thjeshtë).

<sup>178</sup> A. Τζάρτζανος, *Δεν υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική*; NE 12, 826-7, 1932, *Κι όμως υπάρχει!* NE 15, 515-516 (Απάντηση στον Ανδριώτη 1934).

<sup>179</sup> P. Mackridge, *Η νεοελληνική γλώσσα*, μετάφρ. Κ.Ν. Πετρόπουλος, Εκδόσεις Πατάκη, 1990, 172-3.

<sup>180</sup> Μ. Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*, Θεσσαλονίκη, 2005.

### Koha e tashme e lidhore në gjuhën shqipe

Koha e tashme e lidhore në gjuhën shqipe tregon një veprim, kryerjen e së cilit folësi e paraqet si të mundshme apo të detyrueshme<sup>181</sup>. Sipas Demirajt<sup>182</sup> e “tashmja” është e vetmja “kohë” e mirëfilltë e lidhore së shqipes, e cila ka pësuar ndryshime të rëndësishme si në temën ashtu edhe në mbaresat e saj vetore. Tema foljore e kohës së tashme të lidhore për të gjitha foljet, përveç foljeve *kam* dhe *jam*, është e njëjtë me temën e së tashmes së dëftores.

Folja në kohën e tashme të lidhore në shqip mund të përdoret si në fjali të varura ashtu edhe në fjali të pavarura ose kryesore. Në rastet kur e tashmja e lidhore përdoret në fjali të nënrenditura ajo shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, i cili mund të përforcohet duke i paravendosur asaj, foljen me vlerë modale *mund*<sup>183</sup>, shembulli (1). Edhe në gjuhën greke, në këtë rast foljes në të tashmen e lidhore, e tashme e cila në këtë rast është e përligjur me faktin se folja *είμαι* (*jam*) nuk mund të formojë aoristin e lidhore, i paravendoset folja *μπορεί* (*mund*). Në shembullin (2) folja *mund*, nuk luan rolin e një foljeje me vlerë modale, madje është edhe ajo në mënyrën lidhore. Edhe në këtë rast e tashmja e lidhore tregon modalitetin e mundësisë. Në gjuhën greke lidhoreja e foljes *mund*, jepet në shembullin konkret po me lidhoren e së tashmes, por duke i paravendosur treguesin *av* dhe jo pjesëzën *va* (*të*) si në gjuhën shqipe, ndërsa folja në lidhore, *të nxirrni*, jepet në greqisht me aoristin e lidhore së foljes *ξεθάβω*, *va ξεθάψετε*. Kjo folje, kuptimi i së cilës është *zhvarros*, është përdorur në këtë rast për të dhënë shprehjen *nxjerr nga toka*. Vëmë re gjithashtu se në të dyja gjuhët struktura e lidhore nuk është hermetike, ajo mund të lejojë që ndërmjet pjesëzës *të – va* dhe foljes të vendoset një trajtë e shkurtër. Trajta e shkurtër *e*, në këtë rast në gjuhën shqipe është shkrirë me pjesëzën *të*, duke formuar treguesin *ta*, ndërsa në gjuhën greke, trajta e shkurtër *τον*, thjesht i është paravendosur foljes *ξεθάψετε* duke pasuar pjesëzën *va*.

- 1) *Mendoni se edhe skeletet e tjera mund të jenë të infektuara? (Gj.U.V. 172) – Νομίζεται πως μπορεί να είναι μολυσμένοι κι άλλοι σκελετοί. (Σ.Ν.Σ. 204).*
- 2) *Varrin e tij nuk e di asnjëri, dhe prandaj unë erdha te ju, që, kur t’ju **bjerë** rruga nga ato anë, **të mundni ta nxirrni** nga toka edhe*

<sup>181</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995.

<sup>182</sup> Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, 372.

<sup>183</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995.

*atë bashkë me të tjerët. (Gj.U.V. 41) – Τον τάφο του δεν τον ζέρει κανείς και γι' αυτό ήρθα σε σας. Όταν **θα βρεθείτε** σ' εκείνα τα μέρει, **αν μπορείτε, να τον ξεθάψετε** και αυτόν μαζί με τους άλλους. (Σ.Ν.Σ. 50).*

3) *Atëherë, përpara se të ikim, **duhet t'u japim** një përgjigje. (Gj.U.V. 210) - Τότε, πριν φύγουμε, **πρέπει να τους δώσουμε** μια απάντηση. (Σ.Ν.Σ. 248).*

4) *Po gërmojmë në dy vende të tjera anash. Diku **duhet të jetë** këndeje rrotull. (Gj.U.V. 178)- Θα σκάψουμε σε δύο μέρη ακόμη, από την κάθε πλευρά. **Πρέπει να είναι** κάπου εδώ γύρω. (Σ.Ν.Σ. 210)*

Foljes në lidhoren e së tashmes mund t'i paravendoset edhe folja me vlerë modale *duhet* e atëherë folja në të tashmen e lidhores shpreh diçka të detyrueshme, apo të domosdoshme, shembulli (3). Në gjuhën greke kjo formë jepet me foljen pavetore *πρέπει* plus lidhoren e thjeshtë. Në shembullin (4) paravendosja e foljes modale *duhet* nuk tregon domosdoshmëri se sa modalitetin e mundësisë.

Foljet në lidhoren e së tashmes kur përdoren në fjali të varura, mund të prihen nga lidhëza nënrenditëse, por mund të përdoren edhe pa lidhëza. Në shembullin (5) folja në të tashmen e lidhores prihet nga lidhëza nënrenditëse qëllimore *që*. Në gjuhën greke kjo folje transmetohet me aoristin e lidhores, por e prirë nga një lidhëz nënrenditëse qëllimore, lidhëza *για*. Në rastin kur kemi disa fjali të varura të lidhura në mënyrë bashkërenditëse ndërmjet tyre, atëherë ndodh që lidhëza nënrenditëse t'i paravendoset vetëm foljes së parë në lidhore. Në shembullin (6) lidhëza nënrenditëse *që*, i paravendoset vetëm foljes së fjalisë së parë të nënrenditur, *të sulesh*, ndërsa *të djegësh*, *të pjekësh* e *të vrasësh*, lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhëzës bashkërenditëse *dhe*.

Në gjuhën greke të gjitha foljet në të tashmen e lidhores janë përcjellë nëpërmjet të ardhmes së thjeshtë, e cila formohet nga e njëjta temë, si edhe aoristi i lidhores së greqishtes. Në fakt në shqip në këtë rast i referohemi një veprimi që pritet të ndodhë në të ardhmen, por kjo është shprehur nëpërmjet së tashmes së lidhores. Për sa i përket strukturës së periudhës, edhe në gjuhën greke ndodh e njëjta gjë, fjalia e parë e nënrenditur lidhet me lidhëzën nënrenditëse *που*, ndërsa foljet e tjera lidhen me njëra - tjetrën me lidhëzën bashkërenditëse *και*. Siç vumë re edhe më sipër, ndërmjet pjesëzës *të* dhe foljes mund vendoset trajta e shkurtër, dhe në këtë rast edhe në gjuhën shqipe trajta e shkurtër *na* nuk bashkohet me pjesëzën *të*, por ndërfitet në strukturën e foljes në lidhore.

5) *Si një shpend krenar e i vetmuar ti do të fluturosh mbi ato male tragjike, **që të shkëpusësh** nga grykat dhe kthetrat e tyre djemtë*

*tanë të mjerë. (Gj.U.V. 15) – Σαν περήφανο και μοναχικό πουλί πάνω απ' αυτά τα τραγικά βουνά, για να ξεχωρίσεις απ' τις χαράδρες και τα γαμψά τους νύχια τα κακότυχα παιδιά μας. (Σ.Ν.Σ. 17)*

- 6) *Ti mendon se do të vijë dita që të sulesh në anët tona me ushtri dhe të na djegësh e të na pjekësh e të na vrasësh siç bënë shokët e tu. (Gj.U.V. 206).- Σκέφτεσαι πως θα 'ρθει μια μέρα που θα ριχτείς στα μέρη μας με το στρατό σου και θα μας κάψεις και θα μας ψήσεις και θα μας σκοτώσεις όπως έκαναν κι οι σύντροφοί σου. (Σ.Ν.Σ. 243).*

Në fjalitë e varura kundrinore folja përdoret detyrimisht në të tashmen e lidhores kur folja e fjalisë drejtuese shpreh vullnet, dëshirë apo qëndrimin e një njeriu<sup>184</sup>, shembulli (7). Edhe në greqisht e tashmja e lidhores të bëj, në këtë rast jepet me të tashmen e lidhores να κάνω. Ndërsa në shembullin (8) e tashmja lidhores së foljes jepet me aoristin e lidhores. Përkthyesja ka zgjedhur gjithashtu që folja të vendoset në vetën e parë shumës, në vend të vetës së parë të numrit njëjës, në të cilën folja ndodhet në gjuhën shqipe, por kjo nuk lidhet me mënyrën lidhore të foljes.

- 7) *Ç' më këshilloni të bëj? (Gj.U.V. 32) – Τι με συμβουλεύεται δηλαδή εσείς να κάνω; (Σ.Ν.Σ. 39)*

- 8) *Një mendje më thotë t'i lë për verën e vitit që vjen. (Gj.U.V. 83) – Μερικές φορές σκέφτομαι να το αφήσουμε για το καλοκαίρι της επόμενης χρονιάς. (Σ.Ν.Σ. 101)*

E tashmja e lidhores së foljes në fjalinë e varur, mund të ndiqet nga fjali të pavarura, ku folja është në lidhore, shembulli (9). Në gjuhën greke folja në të tashmen e lidhores, të fle, jepet me aoristin e lidhores, να κοιμηθώ, ndërsa folja të jem, jepet me të tashmen e lidhores së greqishtes να είμαι. Kur folja e fjalisë kryesore është folja filloj në të tashmen e dëftores në gjuhën greke, kjo folje mund të vendoset në aoristin e dëftores, ndërsa folja në lidhore të jetë në të tashmen, shembulli (10).

- 9) *Dua të fle, mendoj. Të fle. Të fle. Të jem i heshtur si kamioni që është përjashta. (Gj.U.V. 218) – Θέλω να κοιμηθώ, σκέφτηκε. Να κοιμηθώ. Να κοιμηθώ. Να είμαι ήσυχος σαν το φορτηγό που είναι έξω. (Σ.Ν.Σ. 257)*

- 10) *Megjithatë çuditësesi nuk filloni të pini. (Gj.U.V. 32) – Κι όμως μένω κατάπληκτος που δεν αρχίσατε να πίνετε τώρα. (Σ.Ν.Σ. 39)*

Foljet në të tashmen e lidhores përdoren, siç përmendëm edhe më sipër, përveç fjalive të varura edhe në fjali të pavarura, ose kryesore. Kur këto fjali janë fjali pyetëse të drejta, shprehet nëpërmjet këtyre foljeve

<sup>184</sup> Po aty.

modaliteti i mundësisë, shembulli (11). Në këtë rast fjalia pyetëse nis me ndajfoljen pyetëse *ku*, dhe me të njëjtën ndajfolje, *πού*, përcillet edhe në gjuhën greke. Po ashtu e tashmja e lidhore *të çon*, përcillet në greqisht me të tashmen e lidhore *va οδηγεί*, madje në gjuhën greke modaliteti i mundësisë përforcohet nëpërmjet përdorimit të ndajfoljes *τάχα* (*vallë*, në këtë rast).

- 11) *Ku të çon kjo rrugë fushe?* (Gj.U.V. 26)- *Πού va οδηγεί τάχα αυτός ο αγροτικός δρόμος;* (Σ.Ν.Σ.)
- 12) – *Ç’ të jetë?* – pyeti gjenerali. (Gj.U.V. 171) – *Τι va είναι; ρώτησε ο στρατηγός.* (Σ.Ν.Σ. 203)
- 13)- *Ç’ të ketë vallë?*- pyeti ai. (Gj.U.V. 171) – *Τι va έχει άραγε; ρώτησε.* (Σ.Ν.Σ. 203)<sup>31</sup>
- 14) *Përse të shqetësoheni?* - *tha prifti.* (Gj.U.V. 21) - *Γιατί ανησυχείτε; είπε ο ιερέας.* (Σ.Ν.Σ. 26)

Në shembujt (12), (13) fjalia fillon me përemrin pyetës *ç’*, dhe me të njëjtin përemër pyetës (*τι*) jepen edhe në greqisht, dhe foljet në lidhoren e së tashmes *të jetë*, e *të ketë* jepen përkatësisht me të tashmen e lidhore së këtyre foljeve në gjuhën greke *va είναι*, *va έχει*. Por mund të ndodhë, si në shembullin (14), që e tashmja lidhore së shqipes *të shqetësoheni*, jepet me të tashmen e dëftores së greqishtes *ανησυχείτε*.

Në rastet kur fjalitë kryesore nuk janë pyetëse, atëherë folja në të tashmen e lidhore mund të shprehë nxitje, si në shembujt (15), (16). Në këtë rast e tashmja e lidhore së shqipes jepet me aoristin e lidhore së greqishtes. E njëjta gjë ndodh edhe në shembullin (17).

- 15) *U ngatërruam, tha, - hymë në shteg të verbër. – Të shohim edhe një herë hartat.* (Gj.U.V. 26) - *Χάσαμε τον προσανατολισμό, είπε, μπήκαμε σε αδιέξοδο μονοπάτι. – Να ξαναδούμε το χάρτη.* (Σ.Ν.Σ. 31)
- 16) *Pa ta provojmë njëherë nga e djathta.* (Gj.U.V. 26) – *Ας δοκιμάσουμε μια φορά ακόμα κι απ’ τα δεξιά.* (Σ.Ν.Σ. 31)
- 17) *-Të ikim, - tha papritur. – Të ikim menjëherë.* (Gj.U.V. 210)- *Πάμε να φύγουμε, είπε ζαφνικά. Να φύγουμε αμέσως.* (Σ.Ν.Σ. 249)

E tashmja e lidhore së shqipes mund të përdoret gjithashtu edhe me vlerën e mënyrës urdhërore, shembulli (18) dhe asaj dëshirore shembulli (19).

- 18) *Të jini krenar. Të mos e ulni kokën para tyre.* (Gj.U.V. 45) – *Να είστε περήφανος. Να μην σκύψετε το κεφάλι μπροστά τους.* (Σ.Ν.Σ. 54).



19)-*Udha e mbarë!* - *i tha plaku specialistit. Të veni me shëndet.*  
(Gj.U.V. 101) – *Καλό δρόμο! Του είπε ο μωλωνάς. Να ‘στε καλά.*  
(Σ.Ν.Σ. 123)

### **Koha e tashme e lidhore në gjuhën greke**

Siç e përmendëm edhe më sipër, për lidhoren e greqishtes kohët gramatikore nuk shprehin një moment të caktuar kohor, por shprehin modalitete dhe aspektin e foljes<sup>185</sup>. Në rastin e së tashmes së lidhore, folja ka të njëjtën formë me të tashmen e dëftores dhe gjatë përdorimit në ligjërim i paravendoset zakonisht pjesëza *να*, ose pjesëza të tjera.

E tashmja e lidhore apo lidhorja e vazhduar siç shprehet ndryshe karakterizohet nga aspekti imperfektiv, pra tregon vazhdimësi të veprimit. Sipas Bakker-it, i cili studioi konceptin e përkatësisë kohore, aspekti i vazhduar i një foljeje në lidhore në një fjali të nënrenditur tregon se veprimi i foljes përkon nga ana kohore me veprimin e foljes së fjalisë kryesore, pra të dyja veprimet kryhen njëkohësisht, gjë që nuk ndodh kur aspekti i foljes është perfektiv<sup>186</sup>. Kështu foljet *filloj*, *vazhdoj*, *mbaroj* ndiqen nga lidhorja e vazhduar, sepse fillimi, vazhdimi, apo përfundimi i një veprimi konsiderohet se përkon me çastin kohor, qoftë edhe minimalisht, me veprimin e foljes e cila ndjek foljen kryesore<sup>187</sup>, shembulli (1). Në këtë rast folja *ἀρχισε* (*filloi*) është në të kryerën e thjeshtë të dëftores dhe si në gjuhën greke ashtu edhe në shqip folja e cila e ndjek ndodhet në të tashmen e lidhore. Për gjuhën greke në çfarëdo kohe që të ndodhet folja *αρχίζω* (*filloj*) kur folja që e pason është në lidhore, atëherë ajo vendoset gjithmonë në të tashmen e lidhore. Kjo gjë nuk ndodh në gjuhën shqipe, por në varësi të kohës në të cilën ndodhet folja *filloj*, vendoset edhe folja në lidhore e cila e pason. Pra, ndërsa në greqisht kemi: *αρχίζω να τρώω*, *άρχισα να τρώω*, *θα αρχίσω να τρώω*, *έχω αρχίσει να τρώω*, *είχα αρχίσει να τρώω*, ndërsa folja *αρχίζω* (*filloj*) gjendet përkatësisht në kohën e tashme, aorist, të ardhmen, të kryerën, më se të kryerën, folja (*të ha*) në të gjitha rastet ndodhet në të tashmen e lidhore. Në gjuhën shqipe do të thoshim: *filloj të ha*, *filloja të haja*, *fillova të haja*, *do të filloj të ha*, *kam filluar të ha*, *kisha filluar të haja*, *do të filloja të haja*, *do të kem filluar të ha*. Vërejmë se kur folja *filloj* ndodhet në të tashmen, të ardhmen, të kryerën dhe të ardhmen e përparme folja që vijon është në të tashmen e lidhore, ndërsa kur folja *filloj* ndodhet në kohët e tjera të dëftores, folja që vijon është në të

<sup>185</sup> Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *Γραμματική της νέας ελληνικής*, 10<sup>η</sup> έκδοση, 2004.

<sup>186</sup> W.F.Bakker, *The aspectual differences between the present and aorist subjunctives in Modern Greek*, *Ελληνικά* 23, 78 – 108, 1970.

<sup>187</sup> P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 180.

pakryerën e lidhores. Në shembullin (1) vërejmë se gjatë përkthimit në gjuhën shqipe folja *filloj* ndodhet në të kryerën e thjeshtë, ndërsa folja që e pason në të tashmen e lidhores. Ndërsa në shembullin (2) folja *αρχίζω* në gjuhën greke ndodhet në aoristin e dëftores dhe është përcjellë në shqip me të kryerën e thjeshtë të dëftores *fillova*, ndërsa e tashmja e lidhores të greqishtes *να ξεμολογιέται*, është përcjellë me të pakryerën e lidhores së shqipes *t'i rrëfente*. Në shembullin (3) përkthyesi ka zgjedhur që të mos e përkthejë fare foljen *άρχισα* (*fillova*) dhe të përcjellë të tashmen e lidhores së foljes *κατεβαίνω* me të kryerën e thjeshtë të dëftores së foljes *zbres*, *zbrita*, ndërkohë që në gjuhën shqipe mund të përdoret forma *fillova të zbrisja*, që do të ishte analogja e *άρχισα να κατεβαίνω*.

- 1) *Πείνασε ο Γιαννακός, έβγαλε από το ταγάρι του ένα μεγάλο κομμάτι ψωμί, μια φούχτα ελιές κι ένα κρεμμύδι κι άρχισε να τρώει, ευτυχισμένος. (X.Ξ. 59)- Janakon e mori uria, nxori nga trasta një copë të madhe buke, një grusht ullinj me një kokërr qepë dhe filloi të hajë me shije. (K.K.P. 58)*
- 2) *Κι άρχισε βιαστικά με κομμένη ανάσα να του ξεμολογιέται γιατί ήρθε στη Σαρακήνα, τι συμφωνία είχε κάμει με το γερο-Λαδά και για τις τρεις λίρες που πήρε καπάρο ....(X.Ξ. 95)- Dhe filloi t'i rrëfente me nxitim, me një frymë për ç'ka erdhi në Saraqinë, se ç'marrëveshje kishte bërë me plakun Lladha si dhe për tri lirat që pat marrë si kapar..... (K.K.P. 99)*
- 3) *Πήρα άλλο δρόμο, άρχισα να κατεβαίνω κατά το περιγιάλι. (B.Π. 178)- Ktheva në një rrugë tjetër, zbrita teposhtë bregut të detit. (Z. 160)*

E tashmja e lidhores së greqishtes jepet në gjuhën shqipe edhe me të pakryerën e lidhores së shqipes, trajtë kohore kjo që nuk ekziston në gjuhën greke. Në shembullin (4) foljet *να τρώει*, *ν'αφομοιώνει*, *να δένει*, të cilat plotësojnë foljen e fjalisë kryesore, e cila gjendet në të pakryerën e dëftores jepen në shqip përkatësisht e foljet *të rritej*, *hante*, *përvetësonte*, *shtinte*, të cilat janë në lidhje bashkërenditëse asindetike ndërmjet tyre. Në shembullin (5) e tashmja e lidhores *να ῥχεται*, ose lidhorja e vazhduar jepet në gjuhën shqipe me të pakryerën e dëftores *vinte*, e cila gjithashtu karakterizohet nga aspekti imperfektiv. Hasim edhe raste kur e tashmja e lidhores së greqishtes, që është një formë foljore e eptueshme jepet në gjuhën shqipe me një formë të pashtjelluar si në shembullin (6) me përcjellore. Në këtë rast folja në të tashmen e lidhores *να του ζεσταίνει* jepet me përcjelloren *për t'i ngrohur*, ndërkohë që përkthyesi ka zgjedhur që të mos e përdorë në versionin shqip të tashmen e lidhores *να κατεβαίνει*. Me të pakryerën e dëftores jepet e tashmja e lidhores së greqishtes edhe në shembullin (7).

- 4) *Το ένιωθα ακατάπαυστα μέσα μου να τρώει, ν'αφομοιώνει, να δένει.* (B.Π. 20) - *E ndjeja natë e ditë brenda meje të rritej, hante, përvetësonte ç'ka kish ngrënë, shtinte lastarë.* (Z. 16)
- 5) *Είδα εγώ απ' αλάργα το Λεινίο να 'ρχεται, ανάθεμά το·* (X.Ξ. 110) – *Që për së largu dallova Lenjoin që vinte, ta kish marrë dreqi;* (K.K.P. 115)
- 6) *Ηπие το ρούμι ρουφιά ρουφιά: το κρατούσε πολλήν ώρα στο στόμα του να το χαρεί, κι έπειτα το άφηνε αγάλια να κατεβαίνει και να του ζεσταίνει τα σωθικά.* (B.Π. 22)- *E rrëkëlleu rumin gllënjka – gllënjka. Çdo gllënjkë e shkonte nëpër gojë një copë të gjatë here për t'ia ndjerë më shumë lezetin e pastaj e lëshonte me gurgullimë, lehtë – lehtë nëpër grykë për t'i ngrohur mushkëritë.* (Z. 18).
- 7) *Μα αυτός έπεσε απάνω μου και δώστου να με φιλάει και να κλαίει σα μωρό παιδί.* (B.Π. 35)- *Por ai m'u lëshua i tëri përsipër dhe s'i pushonte gulçi. Më puthte si fëmijë.* (Z. 30)
- 8) *Αυτό θα πει ελευθερία, συλλογιζόμουν. Να 'χεις ένα πάθος, να μαζεύεις χρυσές λίρες, και ζαφνικά να νικάς το πάθος και να σκορπάς όλο το έχει σου στον αέρα.* (B.Π. 35) – *Kësaj i them liri! Thoshja me mendje. Të kesh një pasion, të kesh bërë verdhushka me okë dhe vjen befaz një ditë e ti e mund pasionin: merr gjënë e katandinë dhe e flak poshtë e përprjetë.* (Z. 31)

Foljet *να 'χεις, να μαζεύεις, να νικάς, να σκορπάς* në shembullin (8) janë në të tashmen e lidhore dhe lidhen ndërmjet tyre në mënyrë bashkërenditëse, ndërsa në gjuhën shqipe e para jepet me të tashmen e lidhore *të kesh*, e dyta me të kryerën e lidhore *të kesh bërë* dhe dy të tjerat me të tashmen e dëftores *mund* dhe *flak*. Kjo është një zgjedhje përkthyesit, pasi të katërta këto folje mund të jepen në shqip me të tashmen e lidhore: *Kësaj i thonë liri, mendoja. Të kesh një pasion, të grumbullosh verdhushka dhe papritur të mundësh pasionin e të hedhësh në erë gjithë pasurinë tënde.*

Lidhorja e vazhduar, si edhe ajo thjeshtë e greqishtes mund të përdoren në vlerën e mënyrave të tjera foljore si p.sh., urdhërores shembulli (9) apo dëshirores shembulli (10).

- 9) *Να με συμπαθάτε, είπε· θα πάω σπίτι.* (B.Π. 110) – *Më falni – tha. – Po shkoj në shtëpi.* (Z. 98)
- 10) *Ε, η Παναγία να σου δίνει καλά κέρδητα.* (B.Π. 180) - *E Shën Mëria ta shpërbleftë.* (Z. 162)

Si përfundim mund të themi se e tashmja e lidhore së shqipes dhe e greqishtes paraqesin ngjashmëri përsa i përket formimit: paravendosja e pjesëzave *të* dhe *va* përkatësisht për secilën gjuhë, dhe përdorimit: mund të përdoren si në fjali të varura ashtu edhe në fjali të pavarura ose kryesore, si edhe mund të përdoren edhe me vlerën e mënyrës urdhërore dhe dëshirores. E tashmja e lidhore së greqishtes, apo lidhorja e vazhduar siç shprehet ndryshe, karakterizohet nga aspekti imperfektiv, ndërsa trajta e së tashmes së lidhore së shqipes nuk shpreh kuptim aspektor.

Gjatë përkthimit e tashmja e lidhore së greqishtes jepet në gjuhën shqipe kryesisht me të tashmen e lidhore, por mund të jepet edhe me të pakryerën e lidhore së shqipes, trajtë kohore kjo që nuk ekziston në gjuhën greke, ndërsa lidhorja e vazhduar e greqishtes mund të jepet në gjuhën shqipe me të tashmen e lidhore, por gjithashtu me të pakryerën e dëftores ose me një formë të pashtjelluar përcjellore

#### BIBLIOGRAFIA:

1. AKADEMIA E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (1995): *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë.
2. ΑΝΔΡΙΩΤΗΣ, Ν.Π. (1934): *Υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική*; NE 15, 445 – 50.
3. BAKKER, W.F.(1970): *The aspectual differences between the present and aorist subjunctives in Modern Greek*, Ελληνικά 23, 78 – 108.
4. BARRI, N. (1981): *Aoristic present, "subjunctive" and converters in Modern Greek*, Studies presented to Hans Jakov Polotsky, 1-20.
5. BROWNING, R. (1991): *Η ελληνική γλώσσα μεσαιωνική και νέα*, μετάφρ. Μ. Κονόμη, Αθήνα.
6. DEMIRAJ, Sh. (2002): *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.  
- (1977) *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF 3.
7. HOLTON, D. – MACKRIDGE, P. – WARBURTON – ΦΙΛΙΠΠΑΚΗ, ΕΙΡ. (1999): *Γραμματική της ελληνικής γλώσσας*, μετάφρ. Β. Σπυρόπουλος, Αθήνα.
8. ΚΛΑΙΡΗΣ, ΧΡ.-ΜΠΑΜΠΙΝΙΟΤΗΣ, Γ.(2004): *Γραμματική της νέας ελληνικής*, 10<sup>η</sup> έκδοση.
9. MACKRIDGE, P. (1990): *Η νεοελληνική γλώσσα*, μετάφρ. Κ.Ν. Πετρόπουλος, Εκδόσεις Πατάκη.
10. MANSAKU, S. (1979): *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku*, SF 3.
11. TOPALLI, K. (2010): *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
12. ΤΡΙΑΝΤΑΦΥΛΛΙΔΗΣ, Μ. (2005): *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*, Θεσσαλονίκη.
13. ΤΖΑΡΤΖΑΝΟΣ, Α. (1932): *Δεν υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική*; NE 12, 826-7.  
- (1934) *Κι όμως υπάρχει!* NE 15, 515-516 (Απάντηση στον Ανδριώτη 1934)  
- (1991) *Νεοελληνική σύνταξις*, Τόμος Α, Εκδοτικός Οίκος Αδελφών Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη.

**BURIME**

1. (Gj.U.V.) *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Ismail Kadare.
2. (Σ.Ν.Σ.) *Ο Στρατηγός της νεκρής στρατιάς*, Ισμαήλ Κανταρέ, μετάφραση από το πρωτότυπο Κωνσταντίνα Ευαγγέλου.
3. (B.Π.) *Βίος και πολιτεία του Αλέξη Ζορμπά*, Νίκος Καζαντζάκης.
4. (Z.) *Zorba*, Kazanxaqis, përkthyer nga origjinali nga Stavri Dajo.
5. (X.Ξ.) *Ο Χριστός ξανασταυρώνεται*, Νίκος Καζαντζάκης.
6. (K.K.P.) *Krishti kryqëzohet përsëri*, Kazanxaqis, përkthyer nga origjinali nga Harallamb Qesko.

**Present tense of subjunctive mood in Albanian and Greek. Some issues related to its modality, aspect, use and translation.****SUMMARY**

The present tense of subjunctive mood is one of the tense and mood forms of the verbs in the verbal system of Albanian and Greek as well. The object of this paper is focused on its formation, usage, and translation, aiming at highlighting the common features of this tense in both languages as well as its peculiarities in each language. Some of the questions, which we will try to answer in this paper, are: What is the structure of this tense form in each language and is there any similarity between them? Which is the modality expressed by this verb form in each language? Is this tense form characterized by the verb aspect? How are translated the verbs in present tense of subjunctive mood from Albanian to Greek and vice versa.

**Keywords:** subjunctive, present tense, verb, translation, Albanian, Greek.

Alma GOLEMI

## TERMINOLOGJI DHE DUKURI KRAHINORE ME VLERA ETNOLINGUISTIKE NË DRAMAT E MARTIN CAMAJT

Gjuha e shkruar, është konsideruar gjithnjë si ruajtëse e vlerave e kulturës së një populli, duke fituar kështu një dimension të ri, jo vetëm në rrafshin artistik, por edhe në atë gjuhësor e etnolingistik. Një ndër këto figura, në veprat e të cilit, gjejmë shprehje të traditës dhe mendësisë shqiptare, është dhe Martin Camaj. Kjo duket mjaft qartë në dramat e tij “Loja e mbasdrekës” dhe “Kandili i argjandit”, të cilat përveç vlerave letrare e gjuhësore, janë mjaft interesante dhe në planin etnolingistik, duke i parë të lidhura ngusht me kulturën e popullit, me shprehjen gjuhësore dhe përcjelljen e kësaj përvoje në gjuhën e letërsisë.

Kështu në dramën “Loja e mbasdrekës”, autori trajton disa probleme të rëndësishme të mendësisë shqiptare, si gjakmarrjen, duke zbërthyer natyrshëm ballafaqimin e zakoneve të vjetra me qytetërimin e ri shqiptar.

Ndërsa në dramën e dytë “Kandili i argjandit”, Martin Camaj bën objekt trajtimi artistik çështje të realitetit shqiptar e në rastin konkret rrethanat e mbledhjes së arit në Shqipëri, në fillim të sistemit komunist. Në mënyrë të veçantë këtu është gjurmuar bota e brendshme e individit, lidhur me atmosferën e vdekjes dhe të pikëllimit, me ritet e saj, të vajtimit dhe të mbajtjes së zisë nga ana e grave.

Nëse do t’i shikonim këto drama në planin gjuhësor, shohim se ato kanë një gjuhë të pasur dhe një sintaksë të natyrshme, nëpërmjet një sistemi frazeologjish e shprehjesh idiomatike, që i japin veprës një ngjyrim të veçantë. Sipas studiuesve “*Krahasimet popullore dhe frazeologjizmat, si dhe një variant i pasur gjuhësor i gegërishtes, fjalori i zgjedhur, janë karakteristike për gjuhën që Martin Camaj ka përdorur në veprën e tij*”.<sup>188</sup> Këtë të vërtetë që ekzistonte në realitetin objektiv, të shtjelluar artistikisht nga dramaturgu Camaj, do ta shohim më poshtë përmes pasqyrimin të dukurive të ndryshme krahinore me vlera etnolingvistike, si gjakmarrja, vdekja e ritualet e saj.

---

<sup>188</sup> Gjeta Z., “*Trajtimi i vendlindjes në veprën e Martin Camajt*”, në Martin Camaj për kulturën shqiptare, St. shqiptare 17, Shkodër, 2011, f. 57.

## Gjakmarrja

Kanuni i gjakmarrjes ishte bërë pjesë e ndërgjegjes së shqiptarit, një dukuri ku i thurej këngë trimërie gjakmarrësit, duke e ngritur atë në mit. Hakmarrja pranohej si mënyra kryesore për të kërkuar drejtësi e kjo sillte përjetësimin e gjakmarrjes, e cila ishte një problem ekzistencial në Veri.

Libri X titullohet Kanuni kundra Mbrapshtivet, ku hyjnë hjeksia, vjedhja, grabitja, vrasja etj., dhe dënimet për to. Me rëndësi është kapitulli kushtuar vrasjes ku gjejmë edhe fenomenin e hakmarrjes: “*Pushka e çon gjakun te shpija*” thotë Kanuni dhe “*Gjaku shkon për gisht*”<sup>189</sup>.

Kështu nëpërmjet këtyre kodeve të pashkruara kontrollohej sjellja e shoqërisë, autonomia e mënyrës së jetesës. Këto rregulla erdhën deri në ditët e sotme, madje në disa zona të thella malore ruhen ende me rreptësi. Kjo temë preket dhe nga Martin Camaj në dramën e tij “Loja e mbasdrekës”.

*“Këtu kemi dy ligjë, një të Maleve, don me thanë Kanunin e Lekës, e një të pushtetit, e paçim me jetë!”*<sup>190</sup>

*“... këtu ndër male sundonte vetëm Kanuni”.*<sup>191</sup>

Kjo plagë është aq e fuqishme saqë çon në vdekjen e personazhit kryesor Zekës. Ky është një personazh sa realist aq edhe absurd. Gjyqi që zhvillohet ndaj tij nuk është një gjyq ndaj Zekës, por ndaj pjesës më të keqe të tij, gjakmarrjes, ku Zeka është viktimë e saj.

*“E në sy të secilit kam shikue etjen për gjak”*<sup>192</sup>.

*“Unë lyp gjak prej tij”*<sup>193</sup>.

Ndërsa në prologun e dramës “Loja e mbasdrekës” pranohet amaneti i një të vdekuri që në ceremoninë mortore të tij, të pihej raki e të piqej mish në hell, çka e ndalonte Kanuni.

Gjyqtari: *“pimja e rakisë ishte kundër dokes së vjetër, si dhe pjekja e mishit në hell: atëherë gjamatarët kanë shkue kundër dokes!*

Zeka: *I vdekuri e ka lanë me gojë me u thye dokja... ”*<sup>194</sup>.

<sup>189</sup> Gjeçovi Sh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1993, Paragrafi 148, f. 147.

<sup>190</sup> Camaj, M., *Loja e mbasdrekës*, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 41.

<sup>191</sup> Po ai, po aty, f. 41.

<sup>192</sup> Po ai, po aty, f. 55.

<sup>193</sup> Po ai, po aty, f. 16.

Kjo e çon në zezone. Në këtë mordie u grumbulluan gjakësit e gjakmarrësit, të ftuar e të paftuar. Pasi hëngrën e pinë dhe u dehën u desh një krismë, që të vriten e të plagosen njëzet e katër vetë për dhjetë minuta. Një tragjedi e vërtetë.

Këtë dëshmon edhe **Gjormi** (kandidat për jurist):

*“teza ime ashtë: degjenerimi i Kanunit çon në zezonë.”*<sup>195</sup>

Sipas Kanunit nuk lejohej: *“Me grani të dorasit s’ka punë shpija e të vramit, sepse grueja e prifti nuk bien kurrë në gjak”*<sup>196</sup>.

Këtë e gjejmë të shprehur dhe në dramat e Martin Camajt:

*“Ato, simbas kanunit, s’kanë të drejtë as me vdekë si burrat prej një arme zjarmi”*<sup>197</sup>

Por Camaj shfaq modernizmin e tij në gojën e të rinjve në një tjetër paragraf:

*“S’ka ma gjakmarrje këndeje, por shpagim. Në vend të vriten burrat e malësisë, i djegin arën anmikut të vet, natën për hanë...Këtu ashtë mënia, këtu ashtë plaga që po thue ti e jo në grykë të pushkës.”*<sup>198</sup>

Këtë e shpreh edhe **Gjormi** kur thotë: *“Unë dëshiroj të zbuloj rranjë të së keqes, për t’u çelë sytë të gjithëve se gjakmarrja ashtë plagë, zezonë e përhershme.”*<sup>199</sup>

Vetëndërgjegjësimi për këtë është një mesazh. Fenomeni i vetëgjyqjesisë që shfaqet edhe sot në shoqëri, është prurja më e keqe e barazisë, e cila shfaqet pikërisht atëherë kur nuk vepron Ligji. Në këtë kontekst Camaj përmes dramës së tij jep një mesazh të fuqishëm aktual.

Këtë madhështi shkrimtari ynë arrin ta realizojë mjaft bukur edhe nga ana gjuhësore, me gegërishten e tij letrare, duke sjellë risi në sistemin foljor: si afrimin ndërdialektor si p.sh.:

<sup>194</sup> Po ai, po aty, f. 49.

<sup>195</sup> Camaj, M., *Loja e mbasdrekës*, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 50.

<sup>196</sup> Gjeçovi Sh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1993, Paragrafi 897, f. 147.

<sup>197</sup> Camaj, M., *Loja e mbasdrekës*, “Apollonia”, Tiranë, 1996, f. 43.

<sup>198</sup> Po ai, po aty, f. 21.

<sup>199</sup> Po ai, po aty, f. 21.



- ruajtjen e zanores **ë** në të gjitha pozicionet në fjalë të ndryshme, si: *ashtë* (e jo *asht* si formë gege) apo *ndëgjoj* (e jo *ndigjoj* si formë gege);  
 - përdorimin e dy trajtave të paskajores p.sh.: *me thye, për tu çel*, duke i zëvendësuar ndonjëherë dhe me folje në mënyrën lidhore, e cila përdoret dendur në dialektin e toskërishtes, si :

“Unë dëshiroj të zbuloj rrënjët e së keqes, për tu çel sytë të gjithëve”.

Pra ai na sjell përmes krijimtarisë së tij, jo vetëm vlera artistike, por edhe gjuhësore, në trajtimin e gegërishtes drejt standardizimit të saj.

### **Vdekja dhe vajet**

Vdekja është një ngjarje tronditëse për njeriun. Përpara misterit të saj, njeriu e ndjen veten të pafuqishëm dhe instinktivisht përpiqet të “zbusë” ashpërsinë e saj, duke përdorur në vend të fjalës *vdekje* fjalën *morde - mordja*, ndërsa për lajm për vdekjen e dikujt përdoret dendur *kumt-i* (M. Madhe): *mjeri u për ty, e për kumt t'zi tandin!*<sup>200</sup>

Mund të themi se vdekja si një nga dukuritë më prekëse të jetës së njeriut, ka qenë kurdoherë një gurrë e pashtershme për krahasimet e simbolikën e disa poetëve shqiptarë. Ndër ta për zonën e Dukagjinit mund të përmendim Martin Camajn, në dramën e të cilit ndeshim mjaft shpesh fjalën *vdekje*, gjatë praktikave të ceremonive mortore, karakteristike për Malësinë e Veriut.

*Mbyllni sytë, njerëzi! Mendoni vdekjen: ajo ashtë kërcimtare e pashoqe. Dallgat e jetës bien mbas ritmit të lëvizjeve të saj; sa herë që dora e saj përkulet kah toka, këputet një bimë njerëzore dhe kalon mandej e qetë dhe e madhnueshme si ta kishte ujitë e shpëtue nga thatia e përjetshme.*<sup>201</sup>

Zakonet që lidhen me vdekjen kanë të bëjnë me zakone tepër të vjetra. Kështu te malësorët e krishterë të Veriut, ishte zakon që në gojë të të vdekurit të vihej një monedhë. Ky zakon duket qartë se ka të bëjë me besimin se i vdekuri në “botën tjetër” duhet të kapërcejë një lum (lumi Lete i antikitetit) me anë të një barke të ngarë nga Karonti, i cili për ta kryer këtë shërbim kërkonte një shpërblim me anë të monedhës.<sup>202</sup>

Sipas Kanunit, i vdekuri varrosej, por drekët ua kishte borxh katundit e miqësisë. Aty nuk pihej as verë as raki. Për çdo njeri të thirur në drekë, duhej llogaritur një okë (një kg e gjysmë) mish.<sup>203</sup>

Këtë zakon të vdekjes në Malësi e gjejmë edhe te Camaj, ku ai shprehet:

<sup>200</sup> Shkurtaj Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2010, f. 63.

<sup>201</sup> Martin Camaj, *Kandili i argjandit*, Tiranë, 1996, f. 85.

<sup>202</sup> Zheji Gj., *Hyrje në folklor*, vëll. I, 1994, f. 59.

<sup>203</sup> Shkurtaj Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2010, f. 65.

*Mjeku: simbas dokes së vjetër nuk pihet venë e raki në drekë mortore.  
Gjyqtari “pimja e rakisë ishte kundër dokes, si edhe pjekja e mishit në hell:  
atëherë gjamatarët kanë shkue kundër dokes!”<sup>204</sup>*

Gjithashtu te malësorët e Veriut përmendet shpesh parandjenja për diçka të keqe që i kanosej. Kështu duke qenë se vdekja ishte ndër dukuritë më prekëse të jetës së njeriut, Camaj na mëson se njerëzit merrnin si pararendëse të vdekjes një parandjenjë që ato kishin apo një ëndërr të keqe:

*Edhe unë një andërr të keqe e kam pa!<sup>205</sup>  
Duket se ia ndien zemra se sot këndeji pari do të ndodhë diçka e papritun.<sup>206</sup>  
Më ndjell zemra keq.<sup>207</sup>*

Zakonet e vjetra kanë qenë që i vdekuri të vajtohej me zë me një lloj të kënduari të përvajshëm. Është e kuptueshme se dhembja që shkakton vdekja të kërkojë shfryrje, lehtësim shpirtëror dhe këtë shqiptari e ka arritur me anë të “gjamave” në Veri.

Gjamat janë improvizime që shprehin dhimbjen, por edhe japin një pikturë të cilësive të të vdekurit, një portret herë fizik e herë shpirtëror të tij. Tek Camaj gjejmë këto fjalë për një përshkrim të tillë: “Im atë, pastë dritë ka qenë burrë me fije të mira..”<sup>208</sup>

Në Dukagjin burrat lëshojnë gja:m, pra dalin në një kodër në afërsi të shtëpisë ku ka ndodhur fatkeqësia dhe lëshojnë një britmë thumbuese që dëgjohej mal më mal.<sup>209</sup>

Martin Camaj, i cili na flet mbi zakonet e vdekjes duke na dhënë një tipar etnografik të gjamës së maleve tona: *të çjerrunin në fytyrë të burrave e grave që vajtojnë.*<sup>210</sup>

Në lidhje me këtë zakon prof. Gjovalin Shkurtaj na dëshmon se “kam dëgjuar nga burra të moçëm të Kastratit se brimtarët (vajtuesit) dikur mbanin në xhep ndonjë copë gastare “qelq” dhe me të gërvishtnin veten në tëmthat e kokës, pikërisht aty ku edhe gjaku rrjedh rrëke dhe ua

<sup>204</sup> Camaj M., *Loja e mbasdrekës*, Tiranë, 1996, f. 49.

<sup>205</sup> Po ai, po aty, f. 25.

<sup>206</sup> Po ai, po aty, f. 14.

<sup>207</sup> Po ai, po aty, f. 47.

<sup>208</sup> Po ai, po aty, f. 40.

<sup>209</sup> Shkurtaj Gj., *Etnografi e të folurit*, Tiranë, 2010, f. 66.

<sup>210</sup> Po ai, po aty, f. 67.

*mbulonte krejt faqet. Kështu shkulinin flokët dhe gërvishteshin me thonj në fytyrë derisa u dilte gjak edhe gratë e vajzat që kishin bjerrë të afërmit*<sup>211</sup>.

Por në dramën e tij na jepen të përshkruara edhe zakone të tjera të malësorëve me rastin e vdekjes. Kështu njerëzve u jepej për të pirë kafe dhe kjo duhej të ishte doemos e idhët.

*Kam harrue me i thanë Besës që mos t'u qesë kafeve sheqer: në mort pihen kafet të idhta!*<sup>212</sup>

Martin Camaj na tregon edhe për rubën e zezë që duhej të mbanin gratë:

*“Bjeshka: hjek futën e zezë prej kresë.”*<sup>213</sup>

Por shpesh vëmë re përpjekje të brezit të ri, i cili nuk i zbaton rreptësisht rregullat që i diktonte Kanuni dhe kjo çon në një revoltë të brendshme të brezit të vjetër, të cilët ruajnë me fanatizëm ligjet e Kanunit.

*Bjeshka: Kush na shliron prej ngjyrës së zezë?*<sup>214</sup>

*Nana: As këta të rijtë tanë mos m'i përmend e aq ma pak dhandrrin. A e sheh? Askush nuk ashtë veshë mâ në zi”.*

*Prendi: ke të drejtë me i qortu për pakujdesi ndaj dokeve të jashtme... ”*<sup>215</sup>

Po ashtu formulat mortore që kryhen nga dhënësi, ndryshojnë në varësitë moshës së të ndjerit, rrethanave e motiveve të tjera. Kështu, nëse i vdekuri ishte i moshuar që ka vuajtur shumë, para se të vdesë, familja ngushëllohet me fjalët:

*“I shprehë përdhimbtime” ...*<sup>216</sup>

Por nëse ai që ka vdekur ishte më i ri në moshë atëherë familjes i drejtohej me formula të tjera, duke shprehur njëkohësisht dhimbjen, keqardhjen dhe dëshirën që familja ta kalojë sa më parë këtë si p.sh.:

---

<sup>211</sup> Po ai, po aty, f.67.

<sup>212</sup> Camaj M., *Kandili i argjandit*, Tiranë, 1996, f. 84.

<sup>213</sup> Camaj M., *Loja e mbasdrekës*, Tiranë, 1996, f. 70.

<sup>214</sup> Po ai, po aty, f. 9.

<sup>215</sup> Camaj M., *Kandili i argjandit*, Tiranë, 1996, f. 111.

<sup>216</sup> Camaj M., *Loja e mbasdrekës*, Tiranë, 1996, f. 71.

“(Shkoftë) në qiell me ëngjaj të muzikës”.<sup>217</sup>  
 “Na vijmë me nda dhimbën me ty”.<sup>218</sup>  
 Gjindet në pagjë shpirti i vëllait tuej”.<sup>219</sup>

Por nëse i vdekuri ishte një person, i cili jetonte vetëm prej kohësh, nuk përdorehin shprehjet e mësipërme, por shprehje të tilla, si: “*Ai ka pushue në gji të Perëndisë*”<sup>220</sup>

Ndërsa për t’i përkujtuar përdoren shprehjet si: “*Im atë, pastë dritë*”<sup>221</sup>

Por shpesh herë duke qenë vdekja një moment shumë i hidhur, radhëherë zihet në gojë, por vishet me një ngjyrim eufemistik.<sup>222</sup> Kështu tek drama e Camajt gjejmë të përdorura shprehje të tilla eufemistike si: “*Tata ka pushue*”<sup>223</sup>.

Tek Camaj nga pikëpamja gjuhësore, shprehjet dhe formula të tilla, që shprehin dhimbje apo keqardhje janë të ndërtuara kryesisht me fjali që mund të jenë të pavarura ose periudha me një fjali të varur. Ndërtimi strukturor këtu është i tillë, duke filluar nga më të thjeshtat deri tek strukturat më të ndërlikuara. Kështu dallojmë shprehje të tilla të ndërtuara nga:

- Një fjali dëftore: *I shprehim përdhimbtimen; Na vijmë me nda dhimben me ty.*
- Një fjali dëshirore, e ndërtuar kryesisht nga folja jam, por edhe folje të tjera në mënyrën dëshirore apo lidhore: *Qoftë larg nesh; Shkoftë në qiell me ëngjaj e muzikës; Të gjindet në pagjë shpirti; Të pushojë në gji të perëndisë;*

Këto janë vetëm disa elemente me karakter etnolinguistik, por një studim më i thelluar i krijimtarisë së Camajt, mund të shërbente për një njohje më të mirë të vlerave dhe të traditave kulturore të popullit tonë, të cilat sot kanë filluar edhe të zbehen në sajë të zhvillimit të shkencës e të teknologjisë. Ndaj në kuadër të këtij studimi në fushën e “etnografisë së të folurit” mendoj se kjo meriton një studim gjithnjë e më të madh, sepse ka ende shumëçka që mund të mblidhet e të ruhet si diçka mjaft me vlerë, jo vetëm në fushën e gjuhësisë, por dhe për mbarë kombin shqiptar.

<sup>217</sup> Camaj M., *Kandili i argjandit*, Tiranë, 1996, f. 92.

<sup>218</sup> Po ai, po aty, f. 114.

<sup>219</sup> Po ai, po aty, f. 91.

<sup>220</sup> Po ai, po aty, f. 85.

<sup>221</sup> Camaj M., *Loja e mbasdrekës*, Tiranë, 1996, f. 40.

<sup>222</sup> Osmani T., Pepa S., *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2000, f. 89.

<sup>223</sup> Camaj M., *Kandili i argjandit*, Tiranë, 1996, f. 85.

**BIBLIOGRAFIA:**

1. Camaj, M. (1996): *Loja e mbasdrekës - Kandili i argjendit*, "Apolonia", Tiranë.
2. Cordona, G. (1976): *Introduzione all etnolinguistica*, Il Mulino, Bologna.
3. Gjeçovi, Sh. (1993): *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Tiranë.
4. Meçi, Sh. (2002): *Kanuni i Lekë Dukagjinit në variantin e Mirëditës*, Tiranë.
5. Osmani, T – Pepa, S.(2000): *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër.
6. Studime shqiptare 1. (1994): *Martin Camaj - Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër.
7. Studime shqiptare 17. (2011): *Martin Camaj për kulturën shqiptare*, Shkodër.
8. Shkurtaj, Gj. (2010): *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë.
9. Shkurtaj, Gj. (2011): *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë.
10. Shkurtaj, Gj. (2009): *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë.
11. Velca, K. (1996): *Dramaturgjia e Martin Camajt në Letërsia si e tillë*, Tiranë.
12. Zheji, Gj. (1994): *Hyrje në folklor I*, Tiranë.

**Terminology and provincial phenomena with ethnolinguistic values in Martin Camaj's drama****SUMMARY**

Written language is always considered as a preservative of the values and culture of people, gaining in such a way a new dimension, not only on the linguistic level, but also on the artistic and ethnolinguistic one. One of these figures, whose dramas consist of expressions of Albanian tradition and mentality, is Martin Camaj with his drama "Loja e mbasdrekës" (*Afternoon game*) and "Kandili i argjandit" (*Silver candle*) where the author addresses some of the issues important to the Albanian mentality, such as: blood feud, or death and its rites of mourning, through which could be drawn significance indications about the Albanian society and the mentality of our people in centuries.

Our writer succeeds to realize this splendor quite nicely in his dramas, even from the linguistic side with his literary Geg, bringing innovation in the verbal system with such expressions and formulas that express sorrow or regret, constructed mainly with sentences that can be independent or periods with a subordinate sentence.

But these are only some elements with ethnolinguistic character, but a more thorough study of the creativity of Camaj may serve for a better understanding of the customs and traditions of the oldest times because there is still a lot that may be collected and stored as a valuable thing, not only in the linguistic field but also for the entire Albanian nation.

Alma PINARI (KALLARI)

## PERFEKTI DHE PERFEKTIVITETI NË GJUHËN SHQIPE

Termet gjuhësorë *perfekt* (*perfektor*) dhe *perfektivitet* (*perfektiv*) me temë të përbashkët nga latinishtja (*perfect-um*), edhe pse i lidh ngusht ideja e kohës, ngërthejnë në vetvete semantikë të ndryshme.

Termi *perfekt* përdoret në gramatikë për të emërtuar një nga format foljore të së shkuarës, që në gjuhën shqipe njihet si *koha e kryer* (*kam/jam larë*). Në fakt, përdorimi i termit *kohë e kryer*, sipas nesh, është jo shumë korrekt. Kuptimi i gjymtyrës së dytë të këtij togfjalëshi (*e kryer*) perceptohet si semantikë temporale, por ajo nuk është e tillë. E njëjta gjë vërehet edhe tek nëndarjet e tjera të së shkuarës: *e kryera e thjeshtë, më se e kryera, e pakryera*.

Ka pjesërisht të drejtë prof. S. Riza kur shkruan se “t’ashtuquajturat kohë të **pakryeme** dhe të **kryeme**... në fakt janë: e para – kohë e kaluar e aspektit **pakryemjor** p.sh., **mbanja** prkt. **kapnja**, e dyta – kohë e kaluar e aspektit **kryemjor**: **mbajta** prkt. **kapa**<sup>224</sup>”. /Nënvizimet janë të autorit/.

Nëse do ta përditësonim me terminologjinë e sotme, citimi i mësipërm do të tingëllonte kështu: “të ashtuquajturat kohë e **pakryer** dhe e **kryer**... në fakt janë: e para – kohë e shkuar e aspektit të **pakryer** (imperfektiv), p.sh., **mbaja**, prkt. **kapja**, e dyta – kohë e shkuar e aspektit të **kryer** (perfektiv): **mbajta**, prkt. **kapa**”.

Me konstatimin e mësipërm biem dakord vetëm për pjesën e parë të tij: koha e veprimeve të kryera para çastit të ligjërimit, duhet quajtur më së pari *kohë e shkuar* dhe jo *kohë e pakryer, kohë e kryer e thjeshtë* etj. Koha s’mund të jetë as e kryer e as e pakryer, as e kryer e thjeshtë e as e kryer e përbërë. Kohët gramatikore janë vetëm tri: e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja, nëpërmjet të cilave realizohet vendosja a lokalizimi kronologjik i ngjarjeve, fakteve (veprimeve) në boshtin kohor në raport me çastin e ligjërimit. Çasti i ligjërimit shërben si e vetmja qendër deiktike për ndarjen e kohëve gramatikore. Emërtimet *i kryer, i pakryer* etj., nuk lidhen me

<sup>224</sup> Riza, S., *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1994, f.119.

lokalizimin kohor të veprimit në raport me çastin e ligjërit. Një veprim i pakryer, p.sh., është karakteristik jo vetëm për kohën e shkuar, por edhe për të tashmen, edhe për të ardhmen. Si i kryer ose i pakryer veprimi foljor mund të perceptohet edhe në të ardhmen. Për të shmangur këtë pështjellim semantikash të rrafshëve të ndryshme gjuhësore, për format kohore të së shkuarës, ne do të parapëlqenim përdorimin e termave *e shkuar imperfektore, e shkuar aoristike, e shkuar perfektore, e shkuar pluskuamperfektore*.

Në disa studime a gramatika të shqipes qarkullojnë aty-këtu edhe termat *perfektiv/imperfektiv*<sup>225</sup>, me të cilët kuptohet kundërvënia veprim *perfektiv/veprim imperfektiv* ose aspekt *i kryer/aspekt i pakryer*. Duke iu referuar aspektit të gjuhëve sllave prof. Riza i ndan foljet në dy klasa “gramatikore” të ndryshme: folje perfektive a kryemjore dhe folje imperfektive a pakryemjore. Ai shkruan: “Kështu p.sh., ruseshtja aspektin e dytipshëm e njuh për që të gjitha kohët të të gjitha mënyrëve, kurse të njëjtin aspekt shqipja e njuh vetëm për dy nga tri shkallët e kohës së kaluar të mënyrës dëftore, e pikërisht për t’ ashtuquajturat kohë **të pakryeme** dhe **të kryeme**” /*nënvizimet janë të autorit*/<sup>226</sup>.

Termet *perfektiv/imperfektiv (i kryer/i pakryer)* i gjejmë të përdorura edhe nga prof. Sh. Demiraj, prof. A. Dharmo, por edhe te disa autorë të tjerë<sup>227</sup>.

Përdorimi i termave *perfektiv/imperfektiv (e kryer perfektive, e pakryer imperfektive)* kushtëzohet edhe nga taftologjia që krijohet nga përdorimi i termave shqip *i kryer/i pakryer (e kryer e aspektit të kryer/e pakryer e aspektit të pakryer)*. Në fakt edhe në rastin e parë, edhe në rastin e dytë përdorimi i termave të mësipërm, përfshirë këtu edhe termet e S. Rizës të formuar nga varianti i gegërishtes (kryemjor/pakryemjor) nuk i qëndrojnë kritikës.

Duke i perceptuar si forma kohore format e *perfektit /imperfektit/aoristit (kohës së kryer/kohës së pakryer/kohës së kryer të thjeshtë)*, ne lëmë jashtë vëmendjes kuptimin *perfektor/imperfektor/aoristik* të tyre. Dallimin midis tyre autorët e sipërcituar, por edhe të tjerë, e shohin te kuptimet a ngjyrimet aspektore që ato mbartin. Sa për ilustrim po citojmë Gramatikën e gjuhës shqipe 1 të vitit 2002. Në të pohohet se kategoria gramatikore aspektit që mbështetet në kundërvënien *veprim i kryer/veprim i*

<sup>225</sup> Dharmo, A., *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Libri Universitar, Tiranë, 1996.

<sup>226</sup> Riza, S., *vepër e cituar*, f.118.

<sup>227</sup> Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985, Dharmo, A. *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1996.

*pakryer*, “nuk është zhvilluar në sistemin foljor të gjuhës shqipe, i cili karakterizohet nga kategoria gramatikore e kohës, por disa forma kohore të këtij sistemi foljor dallohen midis tyre për nga ngjyrimet aspektore”<sup>228</sup>. Me termin aspekt në këtë gramatikë është kuptuar mënyra e paraqitjes së zhvillimit të veprimit të emërtuar nga folja. Por kur autorët e kësaj gramatike përkufizojnë format kohore të së shkuarës nxjerrin në pah vetëm nuancat aspektore pa veçuar tek to kuptimin perfektor, imperfektor dhe aoristik të tyre.

Le të sjellim në vëmendje të ashtuquajturat kuptime themelore të së pakryerës, të së kryerës së thjeshtë dhe të së kryerës në gramatikën e sipërcituar. Për to gjejmë përkufizimet e mëposhtme<sup>229</sup>:

- a) Kuptimi themelor i së pakryerës, “është të tregojë një veprim në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës”;
- b) Kuptimi themelor i së kryerës së thjeshtë, “është të tregojë një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës”;
- c) Kuptimi themelor i së kryerës, “është të tregojë një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit”.

Po i shqyrtojmë këto përkufizime më nga afër.

1. Nëse i përmbahemi tezës se sistemi foljor i shqipes karakterizohet nga kategoria gramatikore e kohës, së cilës i përmbahemi edhe ne, asnjë nga përkufizimet e mësipërme nuk i përket semantikës kohore të mirëfilltë. Sema e përbashkët kohore për të gjitha nëndarjet e së shkuarës është kryerja e veprimit para çastit të ligjërimit dhe jo ato që janë renditur në këtë gramatikë.
2. Përkufizimi i së ashtuquajturës *kohë e pakryer* (kupto: e shkuar imperfektore), duhet të ishte si për të tashmen<sup>230</sup>. Si kohë e shkuar ajo tregon se veprimi është bashkërënës me një çast të së shkuarës.
3. Karakteristika e veprimit “në zhvillim e sipër”, në të shkuarën i përkasin semantikës aspektuale dhe jo asaj temporale.
4. Edhe kuptimi “veprimi i përfunduar në një çast të caktuar”, që njihet si kuptim themelor i së ashtuquajturës *kohë e kryer e thjeshtë* (kupto: e shkuar aoristike), është aspektual dhe jo temporal.
5. Sa i takon së ashtuquajturës *kohë e kryer* (kupto: e shkuar perfektore), përkufizimi i saj ngërthen dy semantika jo të njëjta: a) tregon një

<sup>228</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1: botim i ASHSH, Tiranë, 2002, f. 274.

<sup>229</sup> Po aty.

<sup>230</sup> Shih. Pinari (Kallari), A., “Rreth kategorizimit të potencialit semantik të së tashmes në gjuhën shqipe”, botuar në revistën shkencore ALBANOHELLENICA, Philological series I, Athinë, 2012, f. 99-113.



veprim të përfunduar; b) nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërit. Semantika e parë është kuptim aspektual, ndërsa e dyta është kuptim perfektor.

Nga sa u parashtrua mund të arrijmë në disa përfundime:

1. E shkuara imperfektore, e shkuara aoristike dhe e shkuara perfekte kanë të përbashkët vetëm semën e kohës. Brenda rrafshit kohor të së shkuarës këto forma nuk formojnë kundërvënien midis tyre.
2. E shkuara perfekte i kundërvihet së shkuarës aoristike dhe së shkuarës imperfektore për nga tipari i pranisë/mospranisë në të tashmen (çastin e ligjërit) të gjendjes a pasojave të përfutura nga veprimi që ka përfunduar në të shkuarën. Në raport me dy format e tjera, e shkuara perfekte për nga pikëpamja e pranisë së lidhjeve me të tashmen mund të përkufizohet pozitivisht, pra si gjymtyrë e shenjuar e kundërvënies *e shkuar perfekte/e shkuar aoristike, e shkuar imperfektore*. E shkuara aoristike dhe e shkuara imperfektore janë plotësisht të shkëputura nga plani kohor i së tashmes. Ky dallim nuk ka të bëjë me kuptimet gramatikore të aspektit.

Termet *perfektor/imperfektor* - (*perfekt/imperfekt*) nuk duhen ngatërruar me termet aspektorë *perfektiv(i kryer)/imperfektiv(i pakryer)*, të cilët janë karakteristikë për gjuhët sllave. Në këto gjuhë kategoria morfologjike e aspektit mbështetet në kundërvënien formale *aspekt i kryer (perfektiv)/aspekt i pakryer (imperfektiv)* dhe përbën një veçori specifike të tyre. Foljet e aspektit të kryer e paraqesin veprimin si të tërësishtëm, jo në rrjedhën e tij, tipar ky që u mungon formave të aspektit të pakryer.

Gjatë zhvillimit historik format kohore të së shkuarës në disa nga gjuhët sllave u bënë të panevojshme nga shtimi gradual i formimeve parashtesore prejfoljore. Në gjuhën ruse, p.sh., u ruajt vetëm forma e perfektit. Perfekti i vjetër mbeti përfaqësuesi i vetëm i trajtave kohore, i cili me rënien e foljes ndihmëse fitoi aftësinë të shprehë kuptimin e aspektit të kryer, kur folja ishte formim parashtesor (*принёс, увёл*) dhe atë të aspektit të pakryer kur folja ishte e thjeshtë, pa parashtesë (*нёс, вёл*). Në disa gjuhë sllave të Ballkanit (bullgarishtja e ndonjë tjetër) kategoria e aspektit është zhvilluar duke ruajtur format e së shkuarës<sup>231</sup>: imperfektin, aoristin, perfektin e pluskuamperfektin. Këto forma i kanë të dy aspektet, të kryerit dhe të pakryerit. Kjo do të thotë që kuptimi aspektor dhe kuptimet e perfektit, imperfektit, aoristit nuk i përkasin të njëjtit rrafsh semantik. Edhe në gjuhën ruse ku e shkuara përfaqësohet vetëm nga forma e aspektit të

<sup>231</sup> Masllov, J.S. *Izbraniye trudi, Aspektologija, Obshee jazikoznanie*, Jaziki Sllavjanskoj Kulturi, Moskva, 2004 .

kryer dhe forma e aspektit të pakryer, kuptimet e perfektit, pluskuamperfektit, aoristit dhe imperfektit janë të pranishme tek ato dhe realizohen në kontekst. Kjo do të thotë se kuptimet perfektor/imperfektor dhe perfektiv/imperfektiv edhe për gjuhët sllave nuk janë e njëjta gjë.

Për format e së shkuarës aoristike dhe imperfektore të shqipes kuptimet aspektore *perfektiv/imperfektiv* janë të paqena. Mbështetja në tiparin *veprim i përfunduar* për aoristin dhe *veprim i papërfunduar* për imperfektin, edhe pse këto dy kohë formohen nga të gjitha foljet, jo të gjitha ato shënojnë veprim të përfunduar. Përfundimi i veprimit është kryesisht karakteristik për foljet “objektore”, veprimi i të cilave përfshin një objekt. Por ka një numër foljesh që veprimi nuk mund të perceptohet si i përfunduar. Po krahasojmë shembujt:

- 1) *Fëmija e theu gotën e qumështit.*      2) *Era e fortë e rrëzoi pemën.*  
 3) *Më pëlqeu kënga sapo e dëgjova.*      4) *E respektova atë njeri që ditën e parë.*

Foljet *theu* në fjalinë e parë dhe *rrëzoi* në fjalinë e dytë tregojnë se veprimi i emërtuar prej tyre ka përfunduar dhe ai nuk mund të vazhdojë më tej. Nuk mund të themi, p.sh., *Fëmija e theu gotën e qumështit dhe vazhdon ta thyejë edhe tani*, ose *Era e fortë e rrëzoi pemën dhe vazhdon ta rrëzojë atë*. Përkundrazi, në shembujt (3) dhe (4) kjo është e mundur, sepse veprimi s’ka përfunduar. *Më pëlqeu kënga sapo e dëgjova dhe vazhdoj ta pëlqej edhe sot e kësaj dite* dhe *E respektova atë njeri që ditën e parë dhe vazhdoj ta respektoj edhe sot si më parë*. Nëse veprimi i foljeve *pëlqeva* dhe *respektova* do të tregonin veprim të përfunduar, dy ndërtimet e fundit do të ishin të pamundura. Kjo do të thotë se kuptimi i përfundimit të veprimit tek e shkuara aoristike është karakteristikë për një grup të caktuar foljesh dhe jo për gjithë klasën e tyre. Nga ana tjetër veprim të përfundur mund të tregojnë edhe format imperfektore, p.sh., *Ai lexonte disa gazeta në mëngjes; Pas dreke ajo pinte disa filxhanë me çaj*. Në këta shembuj foljet imperfektore *lexonte*, *pinte* tregojnë veprime me disa akte, ku secili akt veçmas ka përfunduar.

Këto fakte gjuhësore na çojnë në përfundimin se, përderisa i njëjti tipar është i pranishëm edhe tek e shkuara aoristike, edhe tek e shkuara imperfektore, mbështetja në të bëhet e pavlefshme për të pohuar se në gjuhën shqipe kundërvënja *veprim i përfunduar/veprim i papërfunduar* është kundërvënje aspektore, duke shtuar këtu edhe faktin që në themel të

kategorisë gramatikore të aspektit nuk qëndron tipari i përfundimit /mospërfundimit të veprimit<sup>232</sup>.

Ne mendojmë se do të ishte më e drejtë të flitej jo për aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv, përderisa gjuhës shqipe i mungojnë mjetet formale të perfektivimit/imperfektivimit si në gjuhët sllave. Për shqipen mund të bëhet fjalë për disa kuptime aspektuale me të cilat kuptojmë edhe përfundimin/mospërfundimin e veprimit, edhe tiparin e veprimit në zhvillim e sipër, por edhe karakteristika të tjera të veprimit foljor, si: përsëritjen, intensitetin, përshkallëzimin sasior, çastësinë, të cilat realizohen në kontekste të ndryshme.

#### BIBLIOGRAFIA:

1. Bondarko, A.V. (1975): “*O Vidah russkogo gllagolla*”, Moskva.
2. Comrie, B. (1976): *Aspect: An introduction to the study of verbal aspect and related problems*, Cambridge University Press, Cambridge.
3. Demiraj, Sh. (1971): «Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe», *Studime filologjike* 4, Tiranë;
4. Demiraj, Sh. (2002): *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
5. Duchâcec O. (1966): “Sur le problème de l'aspect et du caractère de l'action verbale en français”, *Le Français modern*, № 3. - P. 161-184.
6. Dhrimo, A. (1996): *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Shtëpia Botuese “Libri Universitar”, Tiranë.
7. *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. (2002): Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
8. Pinari (Kallari), A.(2012): “Rreth kategorizimit të potencialit semantik të së tashmes në gjuhën shqipe”, botuar në revistën shkencore *ALBANOHELENICA*, Philological series, Athinë, f. 99-113.
9. Topalli, K. (2010): *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
10. Thelin, Nils B.(1980): “Aspekt und Aktionalität im Russischen”, *Die Welt der Slawen, Halbjahresschrift für Slawistik*, XXV, 2; N. F. IV, 2, f. 428-440. Verlag Otto Sagner, München;
11. Riza, S. (1994): *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

<sup>232</sup> Bondarko, A.V. *O “Vidah russkogo gllagolla”*, Russkij Jazik za rubjezhom, № 5, Moskva, 1975, f. 63-65; Nils B. Thelin. “*Aspekt und Aktionalität im Russischen*”, *Die Welt der Slawen, Halbjahresschrift für Slawistik*, XXV, 2; N. F. IV, 2, f.428-440. Verlag Otto Sagner, München, 1980.

Comrie, B., *Aspect An Introduction to the Study of Verbal Aspect and Related Problems*, Cambridge: Cambridge univ. press, 1976.

Duchâcec, O., “*Sur le problème de l'aspect et du caractère de l'action verbale en français*”, *Le Français modern*, 1966, № 3. - P. 161-184.

**About the interpretation of some aspectual terms  
in Albanian language**

***SUMMARY***

Different characteristics of verbal action that do not refer to the moment of speaking cannot be categorized as pure temporal semantics. The manner of presentation of development (course) of action or its distribution in time comprises the aspectual semantics, which stands on a language level other than temporal semantics.

In the studies on Albanian verbal system, linguists do not share the same opinion about semantic differences among verbal forms of the past. In some juxtaposition of verbal forms of the past, they distinguish aspect meanings or nuances, which, according to them, characterize the action by its feature of finiteness/infiniteness. In the following article efforts argue the view that the distinction among forms of Albanian past has nothing to do with the aspect as a morphologic category, present in the Slavic languages. It elaborates the idea that the meanings or nuances acquired by forms of indicative past interacting with some context elements characterize not only realization of tense categorical meanings, but also several other meanings of aspectual but not aspect character. Aspectual phenomena (meanings) stand out in the functional level by interaction linguistic means of different levels. With aspectual meanings or connotations is generally understood the opposition perfect aspect /imperfect aspect.

**Key words:** perfect aspect/imperfect aspect, aspectual shades, aspectual meanings, aspectual context, aspectual semantics etc.

Esmeralda PATOSHI (SEFA)

## LIDHËZA: SE, QË TE PJETËR BOGDANI, KRAHASUAR ME BUZUKUN DHE ME FSHS

### *Hyrje*

Nga ana gramatikore lidhëzat janë studiuar pak, por ka edhe punime për lidhëzat siç është punimi i Emil Lafes<sup>233</sup>, ndërsa për lidhëzat sot mund të përmendim Spiro Floqin dhe Mahir Domin. Tekstet e vjetra kanë rëndësi, pasi janë visari i gjuhës së shkruar. Çdo tekst i vjetër është një gur mbi themelin e gjuhësisë shqipe. Është e domosdoshme studimi i tyre, pasi me to nis dokumentimi i gjuhës sonë. Nga pikëpamja e historisë së gjuhës shqipe, e periodizimit të saj, qoftë mbi kritere gjuhësore, qoftë mbi kritere historiko-gjuhësore, tekstet e vjetra shqipe, letërsia e vjetër shqiptare, do të shënojnë gjithmonë hapjen e një epoke të re me rëndësi të jashtëzakonshme për gjuhën dhe kulturën tonë. Me veprat e letërsisë së vjetër shqiptare hapet epoka e gjuhës letrare shqipe. Mosnjohja e një tradite më të hershme (dëshmia e vonë) sjell paqartësi, mangësi në gjuhësi, prandaj duhet studiuar çdo tekst i letërsisë së vjetër. Letërsia e vjetër shqiptare duhet vështruar jo vetëm si një pikënisje e sigurt për të ndjekur evolucionin e brendshëm të dukurive të ndryshme gjuhësore që nga shekulli XVI deri në ditët tona, por edhe si pikëmbërritje e fazave më të hershme, si një bazë e njohur për t'u ngjitur e depërtuar në fazat më të hershme më pak të ndriçuara të gjuhës. “Çeta e Profetëve” me karakterin origjinal që ka, me zhvillimin që shënoi në fushën e gjuhës së shkruar shqipe dhe me gjithë materialin e shumanshëm që përmban, shënoi një kthesë me rëndësi në fushën e gjuhës e të letërsisë sonë. Ajo shënoi fillimin e një etape të re, të etapës së krijimtarisë origjinale shqipe.<sup>234</sup>

Për herë të parë në historinë e letërsisë sonë në këtë vepër, arti i fjalës gjeti një shtrat të ngrohtë njerëzor me përmasa të gjera dhe bëri një hap të ri cilësor përpara drejt horizonteve evropiane. Risia e përmbajtjes dhe e formës ndërthuren në veprën e Pjetër Bogdanit në mënyrë organike e në marrëdhënie dialektike. Për prozën e vet tregimtare e shkencore, për trajtimet historiografike e filozofike dhe për lirikën poetike, ai zbulon me guxim mjete të reja kumtuese e shprehëse dhe i zgjeron shumë kufijtë e

<sup>233</sup> E.Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, Tiranë, 1971, Nr.4.

<sup>234</sup> Xh.Lloshi, *Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1989, Nr.4.

gjuhës letrare, duke shkrirë në një sistem të harmonishëm mjetet e lashta të shqipes, arsenalin e saj bashkëkohor dhe mundësitë e vlerat potenciale të strukturës së saj leksiko-gramatikore e fjalëformuese. Një sistem i tillë në një vepër krijuese origjinale që u ballafaqua me nder edhe me italishten, me gjuhën letrare kombëtare më të përpunuar të Evropës së atëhershme, jo vetëm e ngriti shqipen e shkruar në një shkallë të re, por tregoi edhe ç'mundësi të pashtershme kishte kjo gjuhë po të lëvrohej ashtu si motrat e saj indoevropiane letrarisht më të zhvilluara.

*Kjo vepër, që mund të quhet laborator i madh i përpunimit të vetëdijshëm e mjeshtëror “të gjuhës së t'Arbëneshëve” në shek XVI-XVII,*<sup>235</sup> është një gur themeli në këtë ndërtim dhe studimi i saj nga këndvështrimi i formimit të gjuhës sonë letrare ka rëndësi të dorës së parë.

Mbështetja te gjuha e folur e popullit, është burimi i parë e vendimtar objektiv, që i jep gjuhës së “Çetës së Profetëve” karakterin origjinal. Ky karakter, në përgjithësi, përforcohet dhe nuk priset nga puna kërkimore e lëvruese e vet Bogdanit, si faktor subjektiv.

Për të mbyllur vlerësimin e përgjithshëm për tekstet e letërsisë së vjetër shqiptare, do të thoja se rëndësia e tyre për historinë e gjuhës shqipe të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi, është e pazëvendësueshme. Të njohësh të shkuarën është kurdoherë e dobishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë të tashmen edhe në fushën e studimeve gramatikore. Një nga detyrat që duhet përmbushur për të zhvilluar më tej studimin sistematik të gjuhës shqipe në përgjithësi e të gjuhës letrare në veçanti, në këto vite është studimi i gjithanshëm i gjuhës. Një studim i tillë i duhet bërë veprës së Pjetër Bogdanit, si një nga veprat e vjetra të letërsisë shqipe. Për gjuhën në veprën e Bogdanit nuk është shkruar pak, por struktura morfologjike e sintaksore e saj, nuk është përshkruar ende në një mënyrë të plotë dhe sistematike. Një nga çështjet që meriton të trajtohet e të studiohet më me imtësi është edhe ndërtimi e funksioni i lidhëzave. Edhe pse që prej kohës së prof. Aleksandër Xhuvanit, i cili la një punim të plotë për parafjalët<sup>236</sup>, studimi për pjesët shërbyese të ligjëratës ka ecur, mbetet akoma për të studiuar. Duke ditur si paraqitet kjo pjesë e ligjëratës, lidhëza, te libri i Bogdanit, mund të kuptojmë më mirë se si është zhvilluar sistemi i pasur e i zhdërvjelltë i mjeteve lidhëzore që ka gjuha e sotme letrare. Në veprën e Bogdanit hasim një lëndë të pasur për të

<sup>235</sup> A. Kostallari, *Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe*, “Studime filologjike” Tiranë, 1989, Nr. 4.

<sup>236</sup> A. Xhuvani, *Parafjalët*, *Studime filologjike*, nr.1, 1964, f. 7-59.

hetuar mënyrën dhe fazat e formimit të lidhëzave të përngjitura e të lokucioneve, gjithashtu edhe për të parë zhvillimin e kuptimeve të tyre në shekujt e mëpastajmë. Në 367 faqet e veprës së Bogdanit dalin 84 lidhëza (të thjeshta, të përngjitura e lokucione), ku disa prej tyre përdoren me dy a më shumë kuptime. Po t'i numërojmë këto të fundit si fjalë të veçanta për çdo kuptim që mund të kenë, atëherë numri i përgjithshëm i lidhëzave arrin në 97, por disa prej tyre përdoren vetëm nga njëherë, ndërsa të tjera nga më shumë se dy herë. Mendoj se punime të këtij lloji duhet të bëhen për të gjithë autorët e vjetër në mënyrë që gjuha të studiohet hap pas hapi në mënyrë sinkronike e diakronike. Studimet gjuhësore në çdo gjuhë nisin nga faza e dokumentuar e saj, prandaj është e rëndësishme të bëhet studimi i çdo veprë të letërsisë së vjetër, duke nxjerrë veçoritë gjuhësore të tyre, e duke njohur traditën e hershme shkrimore të gjuhës së shkruar shqipe, në mënyrë që të kuptojmë evoluimin që ka ardhur deri në ditët tona.

Autori ndjek në ndërtimin e periudhës shtjellimin e periudhës latine, pa arritur gjithmonë ta realizoj. Megjithatë, s'mund të mohohet, hapi i madh përpara, që bën me veprën e tij gjuha letrare shqipe dhe nga ana e strukturës sintaksore. Periudha e Bogdanit është më mirë e ndërtuar, më e lidhur, më e shkathët se ajo e parardhësve të tij, Budit e Bardhit. Zotëron, sidomos në pjesën e parë, periudha e gjatë shprehje e një mendimi kompleks. Bogdani arrin të shprehet me përpikmëri e hijeshi, me figura të goditura. Pra "Çeta e Profetëve" shënon pasurimin e letërsisë shqipe me vlera të reja letrare reale të shumta.<sup>237</sup> Sipas përkthimit të Justin Rrotës "Çeta e profetëve" është një nga veprat rëndësishme të trashëgmisë sonë të vjetër letrare. Sipas Çabejt fillimet e nënrenditjes në gjuhët e dëshmuara herët janë modeste. E vetmja fjali e dëshmuar herët është fjalia lidhore, fjalia relative<sup>238</sup>. Fjalia lidhore, si një ndër fjalitë me nënrenditje që del në dokumentet më të lashta të indishtes, greqishtes e latinishtes, lidhej me një përemër lidhor.<sup>239</sup> Kjo fjali lidhet me përemrin lidhor *që*, në veprë ai shfaqet me trajtën *qi*. Për lidhëzën *që(qi)* edhe pse jo si lidhore, por të përdorur si fthilluese dhe lidhëzën *se* si fthilluese do të flasim më poshtë, këto lidhëza tregojnë vetëm një lidhje sintaksore varësie midis dy fjalish.

<sup>237</sup> Mbështetur te M.Domi, *Pjetër Bogdani dhe letërsia e vjetër shqipe*, "Studime filologjike", Tiranë, 1989, Nr.4.

<sup>238</sup> E Çabej, *Hyrje në indoeuropianistikë*, Leksionet e Prishtinës, 2008, f.228.

<sup>239</sup> K.Topalli, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011, f. 1182.

### Lidhëzat ffilluese

Kjo kategori përfaqësohet prej lidhëzave: **se, qi**. Këto lidhëza nuk shprehin kurrfarë marrëdhënie të caktuara, ato vetëm lidhin një fjali kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore, ose përcaktore me fjalinë drejtuese. Fjalitë përcaktore që lidhen me lidhëzat ffilluese, përbëjnë një grup më vete te sintaksa e M. Domit, i cili i emërton, *fjali caktuese*.<sup>240</sup> Pra, ato tregojnë vetëm një lidhje sintaksore varësie midis dy fjalish.

1- Lidhëza ffilluese **se** është përdorur 1166 herë gjithsej, ku në gjysmën prej tyre është ffilluese e në gjysmën tjetër është përdorur si shkakore e krahasore, p.sh.: ... *ndonëse e vërteta kje këjo, se aj tue u rrëzuem d'ujët e shkuep ndë det, kje ngranë peshqish....., përse vetëhej mugullojinë, e thonë se kan'atë vërtyt vetëhej, e jo s;jetër aneje. I S. Agostini thotë se romajtë mbajnë 12 Hyj e Hyjënësia.... Vetë ani Platón na mson se shumica e krenëvet aspsk e mirë s'ashtë për të governuem shekullinë... Plini kallëzon se ata qi gjëlljnë nd atë pjesë dheu të Misirit... e ndë mos paça rrëfyem e thanë se urtija e nierit ashtë foro e ligë për të vum roe lijnë tande*<sup>241</sup> etj. Fjalitë që ndërtohen me këtë lidhëz, siç shihet edhe nga shembujt, janë zakonisht kundrinore e kryefjalore. Në pak raste me lidhëzën **se** ndërtohen edhe fjali kallëzuesore. Lidhëzën **se** e gjejmë në disa raste edhe në fjali të varur përcaktore, ka raste kur kjo lidhëz përdoret me kuptimin e lidhëzës së sotme **nëse** p.sh.: ... *Përse ndë pak fjalë kallëzon se ka me ardhunë prej qiellshit një djalë n'vergjineje ... Ndë thashtë kurrë kush Bnjëmë nierinë etç. se nukë flet Ati Birit, ... përse me mos kjanë ashtu nukë kish thanë se emënitë tinaj ashtë ashtu. Salomoni çap.30 ndë Proverb. për të na kallëzuem se Hyji nukë ashtë pq Bir, ... Kush nukë shef se këru Hyji po dërgon e i biri i tij i vetëmi ashtë dërguem. Aqa sa ende ata rrëfyjnë se Zotynë ashtë ndë tre vetë nja i vetëmi Hyj.*<sup>242</sup>

2- Lidhëza **qi** është përdorur gjithsej 1487 herë, ku në shumicën e tyre ajo shfaqet si **ftilluese**, edhe pse na del në shumë raste si **qëllimore, shkakore e rrjedhimore**. Në disa raste këtë lidhëz e gjejmë të përdorur me një fjali kundrinore që varet nga folja **bëj**<sup>243</sup>, p.sh.: *Këso koheje ende, qi kje Noe profeta et Abrami, ... Sa të mërztunë e mëni ka Zotynë përmbi këtë mpakt të magjivet, qi të pafetë mbanë për shejtëni e nder të madhe, kallëzon ndë lib. Sap.12. Mu goditë mue ndëshkimi posi një kërthini, qi tue pasunë*

<sup>240</sup> M. Domi, *Gramatikë e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1957, f.167.

<sup>241</sup> P. Bogdani, *Çeta e Profetëve*, I, f. 4-9.

<sup>242</sup> P. Bogdani, I, *Çeta e Profetëve*, f. 6-16.

<sup>243</sup> Edhe në shqipen e sotme fjalia kundrinore që varet prej kësaj foljeje mund të ndërtohet vetëm me lidhëzën që(qi)e jo me se.



*nevojë gjiut së amësë, e të jepinë kuen'e bukësë. Dojnë me thanë qi ndë punë të hyjënueshime nukë duhetë me pasë tjerë sy jashtë asish së shejtesë fe... Përse kujtimi i mendsë ashtë mbë gasë të mendsë, qi ashtë Hyj .i thonë Bir, ... Njofta nja qi bani gjithë, e tjetërënë me të sijët gjithë kafsha u ba.<sup>244</sup>*

Përse u takon fjalive kryefjalore dhe përcaktore nuk dalin shumë qartë, pasi më shumë duket si një përemër a si një ndajfolje lidhore. Kjo lidhëz na del në këto shëmbuj: *Përse aso fjalësh bukurë mpose dukenë tre vetë ndë Tenëzonë, njani qi dërgon e tjetri qi ashtë dërguem. Aj qi ashtë dërguem ashtë aj qi po flet, e se ashtë Zotynë, përse ndë çast flet: Këto punë po thotë Zotynë shëlbuesi yt Israel. Aj qi po dërgon ende ashtë Zotynë, përse thotë aj qi shoë dërguem. Rabini Jeuda Khajat kallëzon me këto fjalë qi ndjekënë:...*

*Po përse guia jonë e arbëneshe ashtë e vobekë për fjalë qi duheshinë për t'i çtjellë ndërë ndë skajt, ... .. , ... .. Mbë qiellit nuk'ishte as yll as diell, qi me dritë të vet zbardhën dritë të re... ishte shembëlltyra e atyne kafshëve qi po baheshinë ndë shekulli të shpirtit. Përse po doj i nalti Zot, qi aj ngushëllim, ...<sup>245</sup>.*

Lidhëza **Qi** kundrinore:

*Mbas shtatë vjetsh dviq Herodi e Zotynë dërgoj engjëllin'e vet S.Jozefit, tue i urdhënuem **qi** të kthenjë me djalit e me t'amët ndë dhe të vet të Naxaretit, ..... (P. Bogdani.CP. II, f. 32-5). Për qish më shkruen e dëshëron **qi** unë të vinj me tëp am, duhe të me dijtunë, se për të gjithë sa jam dërguem, duhe të me u vërtetunë ndë këtë pjedë dheu ku po gjëllinj unë. (P.Bogdani.CP.II, f. 50-20). Ndërkaqa votnë qefalij'te priftënet jevrejet, muftitë me gjetunë Krishnë; tue pëvetunë përse bante ato punë, tue pasunë Zotynë urdhënuem, **qi** nieri të apë një shenj kur ta adhëronte. (P.Bogdani.CP.II, f. 52-15).<sup>246</sup>*

2-Lidhëza se si shkakore është përdorur rreth 40 herë nga përdorimi i saj i përgjithshëm, p.sh.: *Tue kjanë ndë të parët ligjëratë mejaft çelë e me arrësenje të forta kallëzuem se Zotynë ashtë ndë tre vetë nja i vetëm Hyj ,e se ndryshej nukë mundëtë me kjanë, tash me të Shkruemit Sent., ...;Thotë Izaia ndë çap.6 se pa Hyjn'e madh të qiellit se po rrij mbë seli foro të naltë e me qish kishndënë vetëhe mbushke kishënë.Në Deum .çap.6 na kallëzon Mojzesi me këto fjalë se Zotynë ashtë ndë tre vetë nja i vetëmindë të kjanë.Nji përrallë të fortë o andërrë të lëngueshime flasënë të pafet e thonë*

<sup>244</sup> P. Bogdani Çeta e Profetëve I, f. 5-23.

<sup>245</sup> P. Bogdani, Çeta e Profetëve I, f. 15-23.

<sup>246</sup> P. Bogdani. ÇP.II, f. 7-52.

*se dielli rri me bujtunë ndë një gurrë o krue foro të njetë nd'ujë.*<sup>247</sup> Fjalja shkakore e ndërtuar me lidhëzës **se**, rri gjithmonë pas fjalisë kryesore.

- Lidhëza **se**. Fjalitë krahasore me këtë lidhëz i referohen zakonisht një gjymtyre të fjalisë kryesore, të shprehur me një mbiemër ose ndajfolje në shkallën krahasore, p.sh.: *I pari qiell tue zanë fill prej ma së afërit neve, ashtë qiellja e Hanësë e thonë se ashtë e madhe sa e treta pjesë e shekullit, e mbahetë se ashtë më e vogëla ndër gjithë pjanetët. I gjashti i qiell ashtë i Jovit e thonë se ky yll ashtë 91 ma i madh se dheu, ashtë i ndriçim e i bardhë si kjumështë, ... I shtati qiell ashtë qiellja e Saturnit ashtu emënuem ndëpër ata pjanetë kësi emëni , e thonë ashtë 95 herë ma i madh se dheu.*<sup>248</sup>

### **Lidhëzat në Fjalorin e Shqipes së Sotme**

43 - Lidhëza **se** përdoret për të lidhur një fjali kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore ose përcaktore me fjalinë drejtuese, për të lidhur një fjali të varur shkakore me fjalinë drejtuese, përdoret para një fjalie të varur shkakore, e cila shpreh një veprim që do të ketë pasoja të padëshirueshme në rast se nuk plotësohet veprimi i shprehur nga fjalja drejtuese, për të lidhur një fjali krahasore ose gjymtyrën e dytë të një krahasimi, kur kemi mbiemra ose ndajfolje, përdoret e përsëritur dhe në disa togje fjalësh me kuptim shkaku, kohe, krahasimi, lejimi.<sup>249</sup>

Lidhëza **që** përdoret në fillim të një fjalie kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore, përcaktore ose të një fjalie të varur kohore, shkakore, qëllimore e rrjedhimore për ta lidhur me fjalinë drejtuese, përdoret edhe në togje fjalësh të ndërtuara me folje që përsëriten për të theksuar një veprim a një gjendje të kryer, si dhe në disa lokucione lidhëzore, të cilat vihen në krye të fjalive të varura vendore, kohore, kushtore etj. Përdoret në pjesën e parë të lidhëzave të shkallëzimit të cilat pjesa e dytë nis me lidhëzën kushtore “**por**” për të theksuar fjalinë ose gjymtyrën e dytë që lidhin.<sup>250</sup> Disa lidhëza përdoren si tek **Buzuku**, si tek **Bogdani**, por disa kategori të tjera gjenden vetëm te Bogdani e nuk i hasim te Buzuku dhe anasjelltas.

<sup>247</sup> P. Bogdani, *Çeta e Profetëve I*, f. 12-31.

<sup>248</sup> P. Bogdani, *Çeta e Profetëve I*, f. 25-26.

<sup>249</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Fjalori i shqipes së sotme”, Tiranë, 2002, f. 1167.

<sup>250</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Fjalori i shqipes së sotme”, Tiranë, 2002, f. 1075.

Sa për lidhëzat nënrenditëse, shohim që lidhëzat ffilluese përdoren te të dy autorët p.sh.: lidhëza *se* te **Buzuku** del në këto raste: *Ma ata kujtonjinë se anshtë ndër shoqënit; tue përutë të sëmunë ndë shtretënat n gjithë viseshit qi gjegjunë kishnë se Krishti ish ardhunë.Gruoja kur pjell, ka të dhimtonë, përse i vjen hera;e mbassi ka lem djalëtë, ma nukë i bie ndë mend anso dojesh për gazëment se leu një nieri mbë shekullit.*<sup>251</sup>

Te **Bogdani** e gjejmë: *ndonëse e vërteta kje këjo, se aj tue u rrëzuem d'ujët e shkuem ndë det, kje ngranë peshqish..., përse vetëhej mugullojinë,e thonë se kan'atë vërtyt vetëhej,e jo s; jetër aneje. I S.Agostini thotë se romajtë mbajnë 12 Hyj e Hyjënesha...*

*Vetë ani Platón na mson se shumica e krenëvet aspsk e mirë s'ashtë për të governuem shekullinë... Plini kallëzon se ata qi gjëllinë nd atë pjesë dheu të Misirit...e ndë mos paça rrëfyem e thanë se urtija e nierit ashtë foro e ligë për të vum roe lijnë tande, ... Esaia 6 thotë se engjijtë me sy mbëshelë thojnë ato fjalë:Shejt,Shejt,Shejt.Feja katolike na mpson se Hyji krijues i gjithë shekuulit ashtë nja ndë natyrë,... Aqa ma tepër se gjithëkush për natyrë dëshëron shoqëni mbë gasë të vet ... andaj thomi se ashtë njaj së kjanë së dëlirë me Hyjt,... E sikundërse nuk'ashtë mrekullë se shpirti ynë ashtë n'trish ndë pushtetet , ... Aqa para sa,për qish kemi thanë, detuer jemi me rrëfyem se Hyji ashtë ndë tre vetë një ndë natyrë.*<sup>252</sup>

*Ecë se yt bir ashtë gjall e shëndosh. (P. Bogdani. CP. II, f. 54-5). E ka ardhunë fjala se po ndritën të verbëtitë. (P. Bogdani. CP. II, f. 50-5). Doe të më thojtë, a pattë gjegjunë mbas katërdhjetë ditsh, se erdh një vajzëzë me një kërthi ngrykë, e ndë kishë u fal; .....(P. Bogdani. CP. II, f. 35-10). E kur kje dymbëdhjetë vjetsh u godit ditën e Pashkësë se e lumeja Virgjinë tue kthiem prej kishë, vote ndë Naxaret udhësë gravet,...(P.Bogdanu. CP. II, f. 33-5). Patriarka Jakob kur ngënjej t'atënë Isak, tue u shtim se ashtë Ezau, veshi duertë ndë lëkurë të edhit,...(P. Bogdani. CP.II, f. 25-25).*<sup>253</sup>

*Tue kjanë ndë të parët ligjëratë mejaft çelë e me arrësenje të forta kallëzuem se Zotynë ashtë ndë tre vetë nja i vetëm Hyj, e se ndryshej nukë mundëtë me kjanë, tash me të Shkruemit Sent.,...;Thotë Izaia ndë çap.6 se pa Hyjn'e madh të qiullet se po rrij mbë seli fort të naltë e me qish kishndënë vetëhe mbushke kishënë. Në Deum .çap.6 na kallëzon Mojzesi me këto fjalë se Zotynë ashtë ndë tre vetë nja i vetëmindë të kjanë. Nji përrallë*

<sup>251</sup> E.Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, "Studime filologjike", Tiranë, 1971, Nr.4.

<sup>252</sup> P.Bogdani, ÇP.I. f. 5-36.

<sup>253</sup> P.Bogdani. ÇP.I, f. 3-12.

*të fortë o andërrë të lëngueshime flasënë të pafet e thonë se dielli rri me bujtunë ndë një gurrë o krue foro të njetë nd'ujë.*<sup>254</sup>

*Prashtu njimend ashtë parë se kje krijuem shekulli,nukë kje ndonji kusht jashtë shembëlltyret së fort së lumesë Virgjinë,... ..(P.Bogdani.CP.II, f. 1-15).; ...*

*po mirëfilli ndë shtëpi të vet ,me dyer mbëshelë,për të na bam me dijtunë se kush do të dëlirëtë të zemërësë vet e të shpirtit,fort të ruhetë me dalë jashtë ndër nierëzi të kësaj jetë.(P.Bogdani.CP.II, f.12-10). Duhetë me thanë se Hyji mundetë gjakafshë me bam,qi na të rrëfyjmë se nukë mundemi me e shqyrëtuem. (P.Bogdani.CP.II, f.14-5). Thonë shumë dotorë se lumeja Virgjinë kje shejtënuem për të gjall të vet ,andaj i S.Jaku i madh i trajtoj një kishë ndë gjyte të Caesar..... (P.Bogdani.CP.II, f.16-15). Kështu urdhënon Zoti i pushtueshim i qiellët vepërat 'e tinaj të mrekullueshimetë ,qi nieri mirëfilli të marrë vesh, se ndë një kafshë kaqa të re e madhe mrekulli zihetë filli me u bam.(P.Bogdani.CP.II, f. 18-15).*<sup>255</sup>

## PËRFUNDIME:

Duke e krahasuar sistemin lidhëzor të Bogdanit me sistemin lidhëzor të Buzukut e të gjuhës së sotme, duket qartë se që në shek.XVII, gjuha shqipe ka qenë e formuar në të gjitha rrafshet gjuhësore, por ka qenë në zhvillim e sipër, duke ardhur deri në ditët tona më e plotë. Nëse do të duhej të bëhej një studim mbi gjuhën, është tepër e rëndësishme të shihet evolucioni i saj në planin sinkronik e diakronik të gjuhës. Nga libri i Bogdanit mund të nxirren të dhëna me interes për të hetuar kushtet e mënyrën e formimit të disa lidhëzave. Nëse do të kemi studime të tilla për të gjithë autorët e vjetër, studime në planin morfosintaktik, do të ndiqet hap pas hapi zhvillimi i strukturës së periudhës dhe i mjeteve lidhëse të shqipes, që nga periudha e shkrimeve të para e deri më sot. Një detyrë e tillë është me rëndësi si për sintaksën historike, ashtu edhe për historinë e zhvillimit të gjuhës letrare. Te periudhat me fjali të varur **kryefjalore, kundrinore, përcaktore fthilluese lidhëzore**, mënyra e foljes-kallëzues e fjalisë së varur, mund të varet nga modaliteti leksikor i fjalisë me të cilën ka të bëjë fjalia e varur. Kur një fjali kundrinore ka të bëjë me një folje, e cila për nga kuptimi leksikor tregon dëshirë a shprehje të vullnetit, folja-kallëzues e saj vihet në mënyrë lidhore. Po kështu edhe te fjalitë kryefjalore dhe përcaktore. Lidhëza se përdoret zakonisht pas foljeve joveprore, pas

<sup>254</sup> P.Bogdani.ÇP.II, f. 25-54.

<sup>255</sup> P.Bogdani.ÇP.II, f.1-20.

ndërtimeve jam+emër (ose mbiemër) dhe pas fjalive kryefjalore që fillojnë me fjalë pyetëse. Veçori nga ana sintaksore ngelet përdorimi i disa lidhëzave, të cilat më themeloret janë trashëguar edhe sot, e disa të tjera që dalin vetëm të ky autor, si një veçori gjuhësore e tij. Kategoria e lidhëzave filluese na paraqitet e pasur qysh herët që nga Buzuku, Bogdani në trajtat që u fol më sipër. Shohim që lidhëzat *që* dhe *se* kanë një përdorim të dendur në veprën “Çeta e Profetëve”, duke na dëshmuar kështu sa të larmishme kanë qenë ato. Foljet që tregojnë qëndrimin e folësit në lidhje me saktësinë e thënies janë: *betohem, premtoj, zotohem, siguroj etj.*<sup>256</sup> Këto folje dalin po me të njëjtën vlerë edhe tek Bogdani. Megjithatë është me interes të thuhet se këto lidhëza, që mund të duken pak a shumë si të reja, na dokumentohen shumë më herët. Po ta vështrojmë edhe me Fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe vëmë re se shumë lidhëza janë edhe sot ashtu si në veprën e Bogdanit. Lidhëzën *se* e gjejmë në disa raste edhe në fjali të varur përcaktore, ka raste kur kjo lidhëz përdoret me kuptimin e lidhëzës së sotme *nëse*. Këto dy lidhëza mund të kenë ndryshuar formën e jashtme, por mbetem po aq të rëndësishme dhe të përdorshme edhe sot në sintaksën e gjuhës shqipe.

### SUMMARY

#### **Conjunctions: for, because in Pjetër Bogdani, as compared to Buzuku and FSHS**

From the of view of the Albanian language, its dating, be it on linguistic criteria or historical-linguistic criteria, old Albanian texts, old Albanian literature will always mark the opening of a new era of extraordinary importance for our language and culture. With the works of old Albanian literature, the era of the literary Albanian language is opened. A lot has been written on the work of Bogdani, but its morphological and syntactic structure has not yet been described in a full and systematic manner. Knowing how the conjunction is represented in Bogdani's book, we can better understand how the rich and intricate system of conjunctive tools of today's literary Albanian has developed. In Bogdani's work, we find a rich material to investigate on the manner and phases of the formation of compound conjunctions and locutions, as well as to see the

---

<sup>256</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe II*, ASHSH, Tiranë, 2002, f.517.

development of their meanings in the following centuries. The author follows in the building of the period the explication of the Latin period, not always achieving to realise it.

However, the great step forward literary Albanian takes cannot be denied, from the perspective of syntactic structure. Bogdani's period is better constructed, better connected, more agile than that of his predecessors Budi and Bardhi. Especially in the first part, the long period of the expression of a complex thought prevails. Bogdani is able to express himself with precision and grace, with impactful figures of speech. During my work, I will stop on the category of explanatory conjunctions *se, që (qi)* (*for, because*), observing how they appear in Bogdani's period and how they appear in Buzuku and The Dictionary of Albanian Language Today, how old these conjunctions are and if they have undergone any changes in their way, stopping on examples from the work.

**Key words: period, conjunction, literary language.**

Aimir OSMANI

## KONSIDERATA GJUHËSORE TË VEPRËS SË ARSHI PIPËS

**Nga jeta...**

Poeti, përkthyesi, studiuesi Arshi Pipa, lindi në Shkodër, më 28 korrik 1920 dhe vdiq në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 20 korrik të vitit 1997, duke lënë si amanet që hirin e të ndjerit ta hidhnin në detin Adriatik (amanet që e kreu shoqata “Durrësi”, në nëntor të atij viti në plazhin e atij qyteti).

Arshiu ishte i biri i Mustafa Pipës (1871-1948) avokat, që e ushtroi profesionin për disa kohë në Shkodër, i vendosur në këtë qytet në vitin 1925, pas disa ecejakeve në Libohovë, Turqi dhe së fundi në Shqipëri. U martua me Hatixhen një vajzë shkodrane pas dy martesave të tjera. Lindi me të katër vajza dhe një djalë Arshiun, ndërsa Myzaferin e kishte vëlla nga babai.

Arshiu ishte një fëmijë shumë simpatik, inteligjent. Këtë zgjuarsia e ai e manifestoi gjatë gjithë jetës. Shkollën fillore e kreu te Jezuitët në Shkodër. Më pas ndoqi gjimnazin e shtetit po në këtë qytet, të cilin e përfundoi me rezultate të larta. Më pas do të ndjekë universitetin e Firencës në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë. Ndonëse në këtë fakultet mësimet zgjasnin katër vjet, ai e përfundoi për tre vjet dhe në vitin 1941 kthehet në atdhe, duke u përfshirë në armatën e arsimitarëve të vendit tonë. Kështu në vitin shkollor 1941-1942, kur Shqipëria ishte e pushtuar nga Italia fashiste, emërohet pedagog në gjimnazin e Tiranës. Arshiu ishte një antifashist i flakët. Kjo situatë bëri që Arshiun ta transferojnë në Shkodër. Kështu viti shkollor 1942-1943, e gjeti si mësimdhënës në gjimnazin e Shkodrës, pranë familjes së tij. Qëndroi vetëm një vit në qytetin e lindjes, pasi familja e Mustafa Pipës transferohet në Tiranë. Ai emërohet si mësues në shkollën femërore “*Donika Kastrioti*”, ku do të japë letërsi dhe italisht. Do të qëndrojë këtu deri në vitin 1945, vit që do të transferohet në gjimnazin e Durrësit (1945-1946).

Arshiu do të botojë në vitin 1944 vëllimin poetik “*Lundërtarë*”, që për autorin është libri i parë i një vargu tri unazash që përfshin, sipas autorit “*Hî dashunije*” dhe “*Libri i fatit*”. Vëllimi poetik “*Lundërtarë*” dhe “*Libri i dashunisë dhe i fatit*” (dorëshkrim), u përfshi në vëllimin e parë të veprës

së Arshi Pipës, botuar, pas vdekjes, nga shtëpia botuese “*Plejad*”, Tiranë, 2010, 142 f.

Pas botimit të vëllimit poetik “*Lundërtarë*”, në mars të vitit 1944 nisi botimin e revistës së tij të përmuejshme “*Kritika*”. Qarkulluan vetëm katër numra deri në qershorin e atij viti.

Revista pati jehonë, pasi morën pjesë si bashkëpunëtorë shumë personalitete me emër të kulturës shqiptare, si: Selman Riza, Mitrush Koteli, Myzafer Xhaxhiu etj. Ndërsa më pas i vëllai Myzafer Pipa nxori revistën tjetër të përmuejshme “*Fryma*”, e cila edhe kjo pati një jetë të shkurtër duke qarkulluar vetëm pak numra gjatë vitit 1944.

Arshi Pipa nuk e pranoi regjimin e ri monist, duke dalë hapur si kundërshtar i tij. Për idetë e tij politike, ai u burgos në vitin 1946, ku u dënua me 10 vjet burg, ndërsa i vëllai vdiq në burg. Pasi kreu dënimin e plotë, më 26 prill 1956 lirohet nga burgu. Ai vazhdonte të ishte kundërshtar i shtetit komunist, prandaj kërkoi një jetë të lirë dhe menjëherë u arratis në Jugosllavi bashkë me të motrën. Pak muaj qëndroi në hetuesi në Mal të Zi dhe pastaj në Sarajevë ku kaloi këtu më shumë se një vit. Dy vjet më vonë e lejojnë të largohet nga Jugosllavia dhe të vendoset në Itali dhe prej andej emigron në SHBA.

Fillimisht aktivizohet në mërgatën shqiptare. Ai boton në këtë kohë disa shkrime në shtypin shqiptar të Amerikës, si në gazetën “*Dielli*” dhe “*Flamuri*”. Amerika nuk ia hapi dyert menjëherë, prandaj Arshiu u detyrua të punojë si kasier në një hotel-restorant të Nju-Jorkut. U deshën tre vjet që Arshiu të përfshihet në radhën e pedagogëve të atij shteti të madh, duke u emëruar në një kolegji amerikan. Por pa nisur mirë punën në këtë kolegji, miq e dashamirës të Arshiut, e sponsorizuan që të botojë në Itali, në vitin 1959 “*Libri i burgut*”. Më pas Arshiu do të aktivizohet si pedagog në disa universitete amerikane dhe së fundi në Universitetin e Minnesotës në Minneapolis, si pedagog i italishtes. Këtu në këtë universitet doli në pension me titullin “*Profesor emeritus*”. Tashmë lë këtë qytet dhe vendoset në Uashington.

Për dy vjet (1991-1992), zgjidhet kryetar i federatës “*Vatra*” dhe drejtor i gazetës “*Dielli*” në SHBA.

Vizitën e parë në Shqipëri e bëri në vitin 1992 pas përmbysjes së regjimit monist, ku qëndroi në Shkodër pranë shokëve dhe kolegëve të tij. Gjatë kësaj kohe bëri takime me intelektualë, zhvilloi biseda, organizoi konferenca, si në Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Lezhë. Vjen në Shqipëri edhe dy herë të tjera.

Vdiq në moshën 77 vjeçare.

Është përfshirë në FESH, Vëll.III, Tiranë, 2009.



**Veprimtaria letrare dhe studimore.**

**Arshi Pipa ka** botuar shumë vepra, përkthime dhe studime në italisht dhe anglisht. Në shqip trashëgojmë këto vepra letrare:

1. *Lundërtarë*, Tiranë, 1944, ribotim Tiranë, 2010;
2. *Libri i burgut*, Romë, 1959, italisht, Tiranë, 1994 shqip;
3. *Rusha*, Mynih, 1968, Tiranë, 1995 shqip;

Përmbledhje e veprës letrare në shqip nga shtëpia botuese “*Plejad*” në katër vëllime:

Vëllimi I: *Lundërtarë dhe Libri i dashunis dhe i fatit*, Tiranë, 2010, 142 f.

Vëllimi II: *Autobiographia*, 1998, Tiranë, 2010, 101 f. anglisht. Ka në anglisht, por edhe në shqip poezinë “*Veneriada*”.

Vëllimi III: *Lyrika latine* (përkthyer në shqip dhe paraqitur nga Arshi Pipa). Është shkruar në Sarajevë në vitin 1958, Tiranë, 2010, 296 f.

Vëllimi IV: *Lyrika evropiane moderne* (përkthyer në shqip nga autori), Tiranë, 2010, 148 f. (Tekstet e poezive në origjinal në disa gjuhë dhe në shqip).

Pas vdekjes:

- *Albanian Stalinizm: Ideo-Poletikal Aspects* (Stalinizmi shqiptar anatomia e një patologjie politike, anglisht, 1990, përktheu nga origjinali Çapajev Zera, Tiranë, 2007, 331 f. Në faqen e brendshme: Stalinizmi shqiptar aspekte ideo-politike.
- *The politics of Language in Socialist Albania*, New-York, 1989, përkthyer në shqip nga Primo Shllaku me titull “*Politika e gjuhës në Shqipninë socialiste*”, Tiranë, 2010. Kundërshton zgjidhjet e Konsultës së Prishtinës, 1968 dhe Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, 1972.
- *Subvension drejt konformizmit, fenomeni Kadare*, New-York, 1987, përktheu në shqip Bardhyl Shehu, Tiranë, 1999.

Themeloi dhe drejtoi revistën “*Albanica*” (1900-1992). Ka bashkëpunuar në revistën “*Telos*”.

Ka botuar një radhë studimesh, si: *Montale and Dante*, 1968 (Montalja dhe Dantja).

*Contemporary Albanian Literatura* 1991 (Letërsia bashkëkohore shqiptare).

Në fushën e historiografisë letrare shqipe përmendet triologjia:

1. “*Albanian Folk Verse structura and genre*”, 1978 (Poezia folklorike Shqiptare. Struktura dhe gjinitë) 2. *Hironymus de Rada* (Jeronim de Rada)

3. *Albanian Literature: Social Perspectives* (Letërsia shqiptare. Perspektivat shoqërore).

Kjo triologji u përkthye në shqip dhe u botua në Tiranë, më 1914 në tri vëllime me titull “Triologjia Albanica”.

### *Disa veçori të gjuhës së tij*

#### **Si hyrje.**

E gjithë veprimtaria letrare dhe publicistike e Arshi Pipës është shkruar kryesisht në gegërisht, por na duket më arsyeshme që këtë veprimtari ta shohim në dy etapa kryesore: shkrimet e botuara para burgosjes së tij, më 1946, etapa e dytë pas vitit 1956, kur del nga burgu dhe arratiset dhe do të lidhet me vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972). Kështu ne do të shohim se sa ka evoluar gjuha e përdorur nga Pipa gjatë këtyre dy periudhave.

Siç e theksuam më sipër, vepra e parë e botuar e Arshi Pipës është “*Lundërtarë*”, e cila i përket periudhës së rinisë (1936-1940) dhe botuar në vitin 1944, ku janë përmbledhur vjershat e rinisë (1936-1940), Tiranë, 1944, ndërsa Shtëpia botuese “*Plejad*” botoi në katër vëllime krijimtarinë e Arshi Pipës. Vëllimi i parë i ribotuar në vitin 2010 nga kjo shtëpi botuese përfshin jo vetëm “*Lundërtarë*”, por edhe “*Libri i dashunisë dhe i fatit*”. “*Lundërtarët*” që qarkulloi 70 vjet më parë (përfshirë edhe dorëshkrimin “*Libri i dashurisë dhe i fatit*”), besojmë se do të na japin material dhe do të na shërbejnë më pas edhe për krahasim me veprat e mëvonshme të autorit, ndonëse gjysmën e dytë të shekullit XX e ka kaluar në burg ose larg shqipfolësve. Ndryshimet nuk do të jenë të mëdha, pasi ai ishte një njeri me kulturë të gjerë dhe kur botoi veprën e parë, kishte përfunduar Universitetin në Itali, ku patjetër do ta ketë ndikimin e tij edhe në përgatitjen gjuhësore të përgjithshme, jo thjesht për gjuhën shqipe.

Kur e botoi veprën e parë Arshi Pipa, në vendin tonë gegërishtja kishte përparësi ndaj toskërishtes, pasi Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918), një çerek shekulli para botimit të veprës së Pipës, kishte miratuar si bazë për gjuhën e përbashkët shqipe të folmen e Elbasanit, me përmirësimet që mund t’i bëheshin. Edhe vendimi i Qeverisë së Ahmet Zogut i vitit 1923, detyronte që e gjithë administrata dhe shkolla të përdorte elbasanishten, ndonëse nuk mund të mohohet fakti se edhe në këtë periudhë u përdor toskërishtja. I përmendëm këto dy evenimente, pasi Arshi Pipa ecën në gjurmët e tyre. Sa ka qenë koherent për zbatimin e tyre, do të përpiqemi t’i evidentojmë edhe në këtë shkrim.

Mendimi ynë është se Arshi Pipa nuk ka pasur si qëllim të shkruajë një gegërishte me prirje afruese, por qëllimi i tij i tij ka qenë të përdorë një gegërishte letrare, ndonëse e nuk i ka mohuar vlerat e toskërishtes në atë drejtim që ajo i ka. Në një aspekt, mund të konsiderohet tedencioz dhe jo tolerant nga njëra anë, por nga ana tjetër, kur vjen në letërsi si përkthyes, ka konsiderata të tjera. Në veprën “*Lyrrika latine*”, përkthyer në Sarajevë në vitin 1958 dhe ribotuar nga Shtëpia botuese “Plejad” në vitin 2010, në parathënien e tij, që ai e quan *paraqitje*, sqaron se përkthimet e lirakave janë bërë në dy dialekte dhe ekzistencën e tyre e quan me fat për shqipen. Gegërishtja me toskërishten përplasen në fushën letrare në mënyrë fatlume. Kështu disa autorë u përkthyen në gegërisht, sipas autorit, pasi, në mes të tjerash gegërishtja ka forcën e duhur, kurse disa autorë të tjerë në toskërisht, si Virgjili se, poezia e tyre shtrihet më mirë në atë dialekt.

Ndonëse Arshi Pipa ishte mik dhe shok i ngushtë i Martin Camajt, ai i qëndroi pranë edhe kur vdiq, por kjo miqësi nuk u pasqyrua në gjuhën e shkrimeve të tyre, pasi Camaj shkroi një gegërishte letrare më shumë me prirje afruese, ndërsa Pipës nuk i shkonte ndër mend një ide e tillë.

Arshi Pipa ka qenë kundër vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, duke parë vendimet e këtij kuvendi për gjuhën letrare si zgjidhje politike, të cilat do t'i trajtojë në disa shkrime dhe në veçanti në monografinë “*Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste*.”

Në këtë shkrim do të vështrojmë gjuhën e autorit në rrafshin leksikor. Veprën “*Lundërtarët*” do ta veçojmë nga veprat e tjera, pasi ajo i përket gjysmës së parë të shekullit XX, kur vendi ynë ishte i pushtuar nga fashistët italianë dhe nazistët gjermanë. Për mendimin tim, gjuha e kësaj periudhe ka veçoritë e veta, pasi zhvillimi i saj varej edhe nga vetë zhvillimi arsimor dhe kulturor i vendit tonë.

Duke ditur se autori është poet dhe krijimtaria letrare i përket poezisë, për të parë më mirë veçoritë gjuhësore të kësaj periudhe kemi shfrytëzuar edhe ndonjë studim të autorit, si ai për Migjenin, botuar në revistën “*Bota e re*” (1945), apo artikuj të tjerë në revistën “*Kritika*” (1944) dhe “*Fryma*.”

### ***Leksiku i veprës “Lundërtarët” dhe i shkrimeve të tjera të kësaj kohe.***

Veprimtaria botuese në gjuhën shqipe e Arshi Pipës, siç e theksuam që në fillim, nuk është e madhe, pasi ai gjysmën e jetës e kaloi jashtë Shqipërisë.

Është në sistem të autorit që në vazhdimësi të përdorë një leksik të pasur, kryesisht me fjalë të së folmes së vendlindjes, që disa burimin mund ta kenë këtu, por me kalimin e viteve disa prej tyre kanë hyrë në fondin

aktiv të shqipes, ndërsa disa të tjera mbeten si pasuri leksikore, diku të njohura nga lexuesi përmes letërsisë së shkruar geqe ose përmes kontakteve njerëzore. Disa i ndeshim në Fjalorët e shqipes së sotme, të shënuara jo gjithnjë si fjalë krahinore. Edhe në fjalorët krahinorë të Bashkimit, Gazullit, B. Demës etj., ndeshen shumë pak. Gjithashtu denduria e fjalëve nuk është gjithnjë e barabartë.

Leksiku është vjelë nga dy vepra “Lundërtarë” dhe “Libri i dashunisë dhe i fatit”, si dhe nga artikujt studimorë të kësaj periudhe, të cilat i kemi grupuar në këtë mënyrë:

1. **Fjalë që nuk i ndeshim në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006;**
2. **Fjalë që i ndeshim edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006, me pak ndryshime fonetike;**
3. **Dialektizma, krahinorizma-gegizma që disa i ndeshim edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006;**
4. **Disa krijime të autorit (Neologjizma);**
5. **Fjalë të huaja.**

Me interes për t’u theksuar është se shumë fjalë krahinore janë përfshirë në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 apo 2006, por shumë pak janë shënuar si krahinorizma. Akad. Jani Thomai thekson se në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980 nga 40.800 fjalë, 1076 njësi leksiko-semantike janë shënuar si krahinorizma, ndërsa për gjuhëtarin Thanas Feka, numri i fjalëve me burim krahinor të përfshira në këtë fjalor është më i madh, po të kemi parasysh se shumë njësi të tilla nuk janë shënuar si krahinorizma.

### **Fjalë që nuk i ndeshim në Fjalorin e gjuhës së shqipes, 2006**

**Amsuem ( i )= me erë e këndshme.** *Lshue flok’t e gjatë t’amsuem qi umshehin gjinin( L.65), Gazulli e 2006 nuke ka.*

**Aviset= shpellë e madhe (Dema)...** *tue krisun ndër gjiret e avisevet të nëndheshme L.F.121*

**Banash= kasollë** ... *m’sa hyjnë e dalin pa pushim prej banash e fmi e gra e plaka...(L.40)*

**Buluritje = pëllitje.** *Një buluritje kau, një lehje qeni.../mandej asht heshtje e thellë. (L.41) Nuk e ndeshim në fjalorë me këtë trajtë, por bulurimë. Kështu e përdor Fishta dhe të tjerë. E t’u dha gjama e ulurima/vërrima , britma e bulurima . (Fishta, Lahuta...). E ka edhe B.Dema bulurimë, za, ushtimë. Fjalori i vitit 2006 bulurimë=pëllitje, buçimë dhe buluron.*

**Bleror= i blertë, i gjelbërt ...do t'kem mbi krye t'përvajshme një konorë gemash e gjethsh blerorë (L.10).** E ndeshim edhe te Koliqi livadhe blerore, e ka edhe M.Elezi.

**Diçkahi = diçka, asgjë...krijim prej diçkahi qi nuk kishte kuptim...(F.7-8,301).**

**Dnesë = me ngashërim ...luftari nuk ka mujtë me qindrue ma: ka dnesë për herën e parë. (K.3, 118)**

**falisun(i) = i çmendur, jo në rregull. Do tjerë, m'shpotitën, m'quejtën fmi t'falisun . (L.30)** Në fjalorin e vitit 1954 – i çmendur, i shkalluar

**Ftisija= sëmundje. Ftisija e përgjumur për do kohë, kish nisë t'i çfaqej atëherë. (K.3, 112)**

**Gjallnore = të gjalla . E tillë ti je që kur sendet të tana gjallnore binden ndër shkretina e rana...(L.F.129)**

**hajme(e) = e zbetë, e dobët, delikat ... nga të zbetit e faqeve të hajme. (L.82),Gazulli –pa yndyrë**

**Fashë=qetësi. O natë! E tash kurrjâ s'asht mâ në fashë! (L.43).**

**Kallë(me)= fus, djeg ...shpres'n e fundit n'dhe me e kallë! (L.50).**

**Krajata= breng, hall ... zdrypi trishtimi i t'errtave krajata.(L.14).**

**lafit = luan mendsh. Asht pijaniku i lagjes...ka lafitun. (L.45)..**

**Ndëni = shtroj, zgjat, pushtoj... Pa zhurmë flatrat e randa i ndëni heshtija...L.14**

**nusore = të reja Lule t'bardha qielli reshte/lule t'pastra nusore. (L.46).** E ndeshim te disa autorë verior në trajtën nusere. Elezi=nusere=nuse e re. Pipa e ka nusore.

**njajëzue- njësuar. ... tue njajëzue Zotin me Natyrën ( F.7-8, 305).**

**pafajni = pafajësi. O pafanija e eme, ti kërkon me m'mbytë ngadalë!...(L.76)** E ka Fishta. E jep edhe M.Elezi me këtë kuptim.

**pavdarshëm(i)= i pandarshëm. Me pasë mësue mjetin e mënyrën e shprehjes: ky asht lavdi I pavdarshëm i Faik Konicës (K.2, 46).**

**përgjasohet = ngjan, krahasohet. Kurgjâ sa "Shqipëria si m'u duk" nuk përgjasohet me "Reisebilder".(K.2,45)**

**Përgjim = vëzhgim. E nëse një ânktë i vijueshëm e mban në përgjim , një djenjë e thellë e gëzueshme...(L.F. 97)**

**plir= përgjak, shkriftoj. Nepër inde pandeha se u plira. (L.F.110).**

**Poní= respekt. Kujtojmë me poní e adhurim datat e të mëdhejve (B.R.5, 51)**

**Ravgues = endje pa drejtim...kur hijet ravguese, hijet e mjerimit... L.F.139**

**Práj = pusho. Tash flejë e pusho. Ke nevojë të prâhesh n'errsinat... L.F.110**

**Shkardh = asgjë** . *Të bën shkardh, servil.* ( B.R.3, 37).

**Shklas = shkel** ...*qi çdo kambë mund ta shklasë.* (K.4, 129)

**vdirë (e) = e përdalur, e vuajtur ...mërgova edhe un, grua e vdirë nga hyjneshë u bâme lavirë. (L. F.123).**

### **Fjalë që i ndeshim edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006, me pak ndryshime fonetike**

**Besnikisht= besnikërisht.** *Migjeni nuk ka shprehë ma besnikisht fundin e shpirtit...*(B.R.3, 45)

**Bujtun (me) = me fjetë** ...*kur shkoni me bujtun iambël g jumi...* L.21

**Burueme (e) = që buron** ...*por e burueme aty për aty nën frëmyzimin e çastit.* (K.4,122).

2006 e ka si emër : burues = burim i diçkaje

**drithësoj = dridhem** ...*në flagë të luftës që të na drithësohet trupi nga dehja e barutit...*

(K.4,123), 2006 drithëroj=drithërohem, dridhem, rrënoqthem.

**Fisniki= fisnikëri** ... *përkundrazi e ka hijeshue ma tepër, I ka shtue fisnikí e hir.* (K.4, 121)

Fjalori i 2006-ës Fisnikëri.

**Gjason = ngjan** *Letërsija e jonë e Rilindjes i gjason një trolli t'ashpër.* (K.4/121) 2006- ngjasoj=ngjan, ka ngjashmëri

**heshtija –heshtja.** *Pa zhurmë flatrat e randa i ndëni heshtija...*(L.14)

**Idhnije =hidhërim.** *Me çfarë idhnije u-mbush atherë e sa e mallkoi kureshtjen!* (L.29).

**Krenarisht = me krenari** ...t 'vijne edhe kyknat me qafat e nalta *qi krenarisht vozisin...* (L.65).

**Llastueshëm = përkëdhelje me tepri...** *tue u-përkundun llastueshëm mbi vala!*. (L.65) Fjalori i 2006-ës e ka folje llastoj, emër, llastim, mbiemër i llastuar.

**Mbarsun (e)= e ngarkuar.** *Por asht një fakt se poezija fringe u- ba gjithnji ma e mbarsun me Metafizikë.* (F.6 300).

**Mëkatnore = që bën mëkat.** T' shikojë lote t'vrana ndër qepalla , o motër mëkatnore! , (L.68 ).

Fjalori i 2006-ës e ka si emër mëkatar dhe mbiemër i mëkatshtëm. Gazulli nuk e ka.

**naltohet- lartësohet** ... *naltohet me vërtik shqyponje...* (K.3,116) 2006 e ka lartësohet- e bëj më të lartë.

**njathershëm (i)= athershëm.** *Por rrëzimi asht i njathershëm.* (K.3,120) 2006 – i athershëm-që ka qenë atëherë, i asaj kohe.

**njishme(e)=i njëjtë.** *Kam përbuzë të vërtetën e njishme.* (L. F.119). 2006 =i njëshëm = i njëjtë.

**Ngushllimtar= ai që të ngushëllon** ...edhe prej lotvet ngushllimtarë t'zakonshëm. (L.29).

2006 ngushëllimtar=ngushëllues.

**Pandishëm(i)=që nuk dëgjon** *Njerzija asht si një mal i pandishëm* (K.3,115). 2006 – i pandjeshëm-që nuk ndihet.

**pangjaje (i)= që nuk ka ndodhur.** *Dridheshe n'amull te hija, send i pangjaje, avull i lanë nga puhija.* (L.F.108). 2006 i pangjarë- që nuk i ka ngjarë ndonjëherë, , i padëgjuar, i paparë, i jashtëzakonshëm.

**përçudun(i)= i shfytyruar në pamje, i shëmtuar** ...ma nuk shof veç një shembullim të përçudun të vetes, (L. F.140), 2006 përçudnues –që të përçudnon , i përçudnuar-që është i përçudnuar.

**përgjumun (i)= fig. i fjetur.** *Ftisija e përgjumur për do kohë, kish nisë t'i çfaqej...* (K.3,112)

2006- i përgjumshëm=i përgjumur, që i vjen gjumë.

**përunjin(të)=të përunin** ...kalorës të cilët të mprojnë të dhe të përunjin kryelartët... (K.4,126),

2006 – i përunur=i nënshtruar, qësillet dhe vepron me përunin.

**përvajme (e)= e pezmatuar, e prekur,** ...s'e lanë me u-pa as buzën e përvajme që ka përgjakun epshi... (L.67) E ka edhe Elezi. Një variant të kësaj fjale jep Fjalori i 1954 dhe i 2006, i përvajshëm = që shpreh hidhërim të thellë, i trishtuar.

**Pijaniku= pijanec** *Asht pijaniku i lagjes,* (L.45), 2006 =pijanec.

**Qetë = qetësi.** *Aty un linda e aty u-rrita n'qetë e n'paje për rreth te votra...*(L.17). 2006=qetësi

**rrke= uji që rrjedh me shpejtësi...**e i njomte ato me lote t'nxeha rrkë.- L.32

**shprehimtare-shprehëse...** *janë përmbledhë disa nga ligjeratat e tija ma shprehimtare...* (K.4,122) 2006-shprehës, që e shpreh a që e jep di çka qartë, bukur, fort e me gjallëri.

**Shqipnoje=shqipëroj.** *Aj qi shqipnoje Kajamin në valen e përpjekjevet politike ma të vështira...*(K.4, 129).2006- shqipëroj =përkthej

**Tinzak=tinzar** ...t'namit tinzak L.129

**Ujnore= me ujë** ...*prirret kah një vorrezë ujnore.* (L.F.122) .2006 –ujnajë-vend i gjerë me ujë, i ujuar- i ujitur.

**Vallueshëm=me valle, duke kërcyer** ...prej lvores ti ringjallesh e del vallueshëm me shetitun brigjet (L.66) 2006-e ka emër vallëzim dhe vallëzoh-kërcim, kërcëj.

**Veçansi** = veçanti...do të jetë mjaft e bukur, por ndër veçansina e pakryeme.(K.1, 1).

**Vetmitar= i vetmuar** ... e i'kange vetmitare... L.21

**Zgërdhimje= përqeshje** Në këtë fantasmagori zgërdhimjesh dhe vajesh aj cakton vendin e vet: (K.3 115). 2006 zgërdhirje. – qeshje duke shtrembëruar fytyrën

**Ziliare=fshehur**...ato t'kanë strukë ziliare te foleja ku s'pari ti m'je dukë. (L.83) 2006-ziliqar= që i ka zili të tjerët, smirëzi.

**Zverdhamë (i) - i zverdhur** ... zhgulë gjethet e zverdhamë... (L.11) 2006- i zverdhemë- i verdhemë, i zbehtë.

**zhyem(i)- i lyer me ngjyrë** ... ju duert e vrazhda të zhyeme me pluhun thëngjilli... (L.F.135)

**Dialektizma, krahinorizma-gegizma që disa i ndeshim edhe në Fjalor e gjuhës shqipe, 2006**

**Afshoj- lëshon afsh** –Afshonte pëma ime, fryhej ndën kore...(L.F.109)

**Amull = pellg me ujë të ëmbël**, Dridhesh n'amull te hija, send i pangjaje...; ( L.F.108)

**Bardhullore = e bardha**. ...nder kopshtijet e fëminis, n'agimet bardhullore. (L.23). E ndeshim edhe te Koliqi, avuj bardhullore, por e ka edhe M. Elezi, 2006 bardhëllor – i bardhë i shndritshë.

**Brishtë(i)= i dobët, i parregullt që thermohet lehtë...** n'lundra t'brishta si gastare (L.63).

**Bzâj =them , bëj zë** ...ndejun pa lëvizje pa bzâ...L.71.

**cik = prek** ...humshe sa here qi mendja t'cikte nder maje. (L.F.108)

**Currash= shkëmb** Përzi me jone e shushurime gurrash/ n'at gem dallova ca jehona currash (L.54),

**çmerit=habit** Vdesin njerzit me qindra mija/ çmeritun v'rejnë si qeshë pranvera (L.F.133).

**davarit= largohet, shpërndahet...** kur mjegulla e kijtesës davaritet... (L.F. 101)

**dvar= bjerr, humb**. Sa shpejt u-dvarë aj parajs lumnije(L.25)

**farfurit= vezullon, shkëlqen, ndriçon**. Na këndojsim. Xhixhillojat farfuritshin (L.64).

**Flijë= flijim, dëshmor** Do të vijë dita e flijes së fundme... (L.F.118).

**Floknajë= flokë të shumtë , të dendur**. Këtu flokët në përgjithësi – ...thirrja ime çan qiellin, i zhgul floknajen/kufomës së Zotit të vjetër...(L.F.117)

**Foltare= gojtar**. Mjeshtrijsja e rrallë foltare e Nolit asht botnisht i njoftun... (K.4, 122)



**Fshâj= psherëtij** ...i u-dhimt e fshâni thellë: *Oh zemra e eme / si mund t' durojë pa fshâ...L.10*

**Gand= rastësisht, pa dashur** ...mos janë ata qi zëmrën e pa -roje / *gand t'a shituene ndër tekje prilli?* (L.39).

**Gandoj= lëndoj** *E tue i matë,tue i peshue kështu, veç do t'i gandojë do t'i prishi...* (K.1,3)

**Gastare = qelq** ...n 'lundra t brishta si gastare...L.63

**Gem=-degë** ...ku zogjt pa reshtë cicrojnë prej gemi n'gem. (L.39)

**Golle= grope, boshllëk, zgavër.** *Truni e zëmra janë golle, edhe jeta asht si ata.* (L.58)

**Gjethnajë= kunorë e gjetheve të një peme, gjethishtë.** *Shpejt do t' bjeri errësina mbi gjethnajt e heshtueme.* (L.80).

**Gjimues= që gjimon** ...ti qi gjimues me zanin ajrin e trandë e peshë i çon tallazet. (L.72)

**Hir= sjellje e mirë, dashamirësi.** *Koha nuk e ka prishë...e ka hijeshue ma tepër, i ka shtue fisnikí e hír;* (K.4,1 121)

**Hiroshe= me hir, e bukur** ... ndër shtrojet qi veshë lmashku i butë, hiroshe shtojzavallja me flok't e farfurishme...(L.57).

**Hirplotë= që ka mjaft bukuri** ... te magjia hirplotë ku je ti shembulltyrë. (L. F.104)

**Hov= vrull, lëvizje të shpejta**...vepra e tij... e ndërpreme prej hovesh të flakta për me i shpëtue ktij mjerimi fatal.; (K.3,113)

**Idhujtari= ai që adhuron idhujt.** *Derdhni ju mbi idhujtarin dashuninat e kohnavet qi u -fikën me aq shkëlqime.* (L.65).

**Imtaz= imtësisht** ...tue u-kumtue imtaz ndër zemrat e atyne qi e ndiejnë...(K.1,1)

**Jone= jehonë, melodi, tingull i bukur** ... e merr me vehte jonet e nji kange plot dashuni e uzdajë. ; me kuptim tjetër (L.41)

**Këndir= përballoj, ia marr frymën dikujt.** *Epshi im është gjarpën e-zile nxûna prej tij me këndirë.* (L.F.123).

**Kllapi= kur flet përçart nga temperatura** ...m'lên ta ndrydhi kujtimin me kllapinë e gjumit. (L.F.103).

**Kqyr = vështroj shikoj** . *Sonte qi un nuk mund ta kqyri veten pa neveritje* (L.F.), 103)

**Kryen-ulun = kokulur.** *Kryen-ulun vijshe, e zyrtë e pa u-ngutë.* (L.F.107)

**Ledhatare=përkdhelës** *Prej shpresash ledhatare i mjeri u- rrëjta.* (L.10)

**L(ë)byrë=i mbulon sytë me një cipë, e verbon; perde syri.** ...aj rrokë gjithçka i del përpara dhe ma fort çka e lbyrë e ndezë. (L.F.97).

**Lënurë= e bëj fije -fije, kreh, shkriftoj-Ândra, fije lënurë nga nji pëlhurë endun me dridhje e shpresa.** (L. F.113)

**Llasa**=përkëdhelje e tepëruar, **llastim** ...dëshirat me i mashtruar me rrethje lotesh o për me i ndezun me t'zakonshmet llasa. (L.67)

**Llastueshëm**= përkëdhelje e tepruar ... tue u-përkundun llastueshëm mbi vala.(L.65)

**Llomishtë**= vend i mbushur me lym Ashtu përplasësh ndër llomishta, zhgabë e plagosun...(L.F.120)

**Mbarsun (e)**= e ngarkuar. Por asht një fakt se poezija fringe u-bâ gjithnjë ma e mbarsun me metafizikë. (F.7-8, 300)

**Mërtisur(i)**= i mbuluar, i mshehur me mbulesë,i shtrembëruar. E mertisun , por jo e harrueme, fëtyra e Fan Nolit po merr në kohën tonë|... (K.4, 121)

**Miradishëm(i)**=mirënjohës. Kush do të gjindet edhe për këtë pun të pamiradishme? K.1,2)

**Mrizoj** = çoj bagëtinë në mriz... dergonte me mrizue grigjen bardhoshe...(L.57)

**Mungulloj** = mbin ... përmbi vorrin u- ndalova, mungullonte prej tij bari. (L.48).

**ndajnate**= buzë mbrëmjes. Kur befaz më rrëmbei ndajnate një ktheter... (L.38)

**Ndryme (e)**= e mbyllur , e fshehur ...i rrëjten andrat e ndryme nën lvore...(L.13)

**Ngashërej=qaj me dënësë** ...përpara disa sqenave natyrore ngashërehej...(K.2,44)

**Nguti**= nxitim i madh. Ndoshta prej nguti nuk janë botue këto këngë në rendin e tyre... (K.3.112)

**Ngjyeme(e)**= që i jep ngjyrë ... bukën e përditshme të ngjyeme me gjak ... (K.4,123)

**Ninëz**=bebe e synit. ...ma shuaj afshin e gjakut, ma fik dritën e ninëzavet, m'i qep qepallat. L.F.128

**Pandishëm(i)**= që nuk ndjehet. Njerzija asht si një mal, i pandishëm. (K.3,115)

**Përfalem**= përshëndetem, ...një dallnyshë me t'kuqe 'i gushë e me vashen u përfal. (L.48).

**Përunjim(të)**= e poshtëroj ... kalorës të cilët të mprojnë të vegjëlit dhe të përunjin kryelartët...(K.4,126)

**Picak**= lakuriq. Due me u çveshun picak, me lbyrë (L.F.118).

**plleshëm(i)**= i bollshëm, pjellor. ...gjinjt e plleshëm ku toka nënë e butë kullon ... (L.F.129).

**Praroj**= shkëlqej ...ku një rreze hane praronte kohë mbas kohe mes gjithnajes...(L.64)

**Puhí= erë e lehtë, fllad** ... avull i lânë nga puhija/ varë mbi gjithnjë.  
(L.F.108).

**Rendim= radhit.** Edhe rendimi i ktyne asht bâ mbas një plani . (K.3, 113).

**Rimtë(i)= i vërenjtur, i kzaltër.** Nuk më trêmbin kupat e rimta të qiellit...  
(L.F.117).

**Rysun(i)= i sprovuar, i kalitur.** Por ndofta hapi i rysun t'udhzone pa gabim... (L.F.105).

**Rrekem= përpiqem** po kot rrekesh me prekë (L.F.114).

**Rrëshqan= zvarë.** Njeri qi ngrehesh rreshqânë gjatë udhvet t'shkreta...  
L.F.105.

**Skamnor= varfër(1), ...nepër fëtyra të skamnorvet vetvetiu, si me dhunë...**(K.3, 115).

**Shkimen= shuhen....Nën bore shpresat t'gjitha shkimen.** (L.47).

**Tandë=pjergull Veç sot dij çka mendojshe kur e heshtun/tanden e lulevîles kqyrshë vjerrun.** (L.23).

**Tekemramja= ma në fund.** Tekemramja çka ka pa të meta? (K.1. 5).

**Ter= zhdruk** ...mandej një lot i heshtun qi një fëmën duhet t'a teri.  
(L.F.120)

**Tollovitun(i)= i çrregullt** (F.101) kur shpirti i tollovitun ndër tallazet 2006-i çrregulluar , ngatërruar

**Turrshëm= vrullshëm.** Shpaloj thirrjen turrshëm n'erë,thirrja ime çan qiellin...(L. F.117)

**Vetmitar= i vetmuar.** Nga dritareja e çelun vijnë jehonat e i' kange vetmitare...(L.21)

**Verim= kaloj verën** ...kështu qi njëkohsisht me mësimin bahej dhe verim.  
(K.3, 112)

**Vërtik= vrull, hov, shpjetësi.** ...naltohet me vërtik shqiponje ... (K.3,116).

**Vigma= britma, klithmë.** Un ndij mallkimin n'zanin tand pa vigma, pa lajka... (L.67)

**Vrragë= gjurmë, vazhdë,** (F.101) qi la një vrragë të thellë

**Zgrip= buzë diçkaje** (F.114) ti sillesh nepër zgripa 2006 po

**Zhele=leckë, njeri pa vlerë** ...tue lanun te çdo gjemb një zhele shprese.  
(L.F.105)

**Zhumhurë= potere, zhurmë e zgjatur.** Ndini ç'zhumhurë e harmonishme valash! (L.66).

### Disa krijime të autorit (Neologjizma)

Autori ka bërë përpjekje (ndonëse në atë kohë ishte i ri) për të krijuar fjalë të reja, për të cilat, me sa kemi vëzhguar, nuk i kemi ndeshur më parë. Mendoj se janë krijime të Arshi Pipës.

**Arnautishte (arnaut+ishte)-...***me vue në satire mbeturinat anadollake arnautishte, e largoi Konicën nga ...*(K.2,45)

**Artistizoj (artist +izo(j) ... tue bâ jeten e tynë poezi, tue e artistizue.** (K.2,43)

**Kundërvendosun(të) (kundër+të vendoasur) = të vendosur kundër** ...*mund të jetë te artist dy anë të ndryshme të kundravendosuna.* K.2, 42.

**Larkjehues= që jehon nga larg.** *Zakonisht e mbyti tingulli i ashpër e larkjehues i satires.* (K.2,44)

**Migjenike=** të Migjenit ...*që sajojnë lumin e poezis migjenike.* (B.R.3, 34)

**Pupla-shkruem-** (kompozitë: emër + mbiemër foljor)... *me folena zogjsh pupla-shkruem.*(L.81) **Shpirti-pëllumb-**(kompozitë: emër +emër). *Edhe shpirti-pëllumb asht plagosun* (K.3, 120).

**Shpirti-shqyponjë**(kompozitë: emër +emër) *Shpirti-shqyponjë i ka njimend krahët e thyem.* (K.3,120)

**Thoj-këputuna** (kompozitë: emër +mbiemër)...*me sodën e enëve , ju duer thoj-këputuna.* (L.F.135)

### Fjalë të huaja

**Affluentit=-i begatë, degë lumi (ital)** ...*tash si një lum i ushqyem prej afluentash të ndryshëm...* (L.F.98)

**Ajmë= Oh, mjerisht , për fat të keq (ital)**, (K.4,126) Politikë humanisti ajmë!

**Elementaritet=thjeshtoj (ital.)...***na çojnë gjithherë në një elementaritet primitiv të dheshëm...*(K.4, 121)

**Emotive= i prekshëm, shumë i ndjeshëm (ital.)**, *Historiani i aftë do të çmojë pra veçanrisht pjesën emotive dhe do të mundohet të kapi ado fije themelore ...* (K.4,122}

**Grazhda=stallë** (sllav.), *Blegrojnë e dhen e dhi ndër grazhda kcejnë kingjat...*(L.40)

**Grigjë=tufë dhensh**(latin.)

**Salvoj= ndjek, përsekutoj (ital.)** ... *idealet e tija tallen e salvohen.* (B.R.3,41)

**Gjergjef-i=** një kornizë ku qendiset në pëlhurë.(turq.) E ka edhe "Bashkimi"

**Huj-i = ves, inade** (turq). *A mujte me i shkrue një njerí me kto huje?* (K.2,42)

**Pezëm=acarim pezmatim** (sllav). *Atëherë në vend qi të ligshtohet, ka marrë pezëm e ka qitun kushtrimin.* (K.3,120)

**Prozhme= pyll i vogël** (sllav), ... kur binte nata ndër prozhme e ndër e n'çerdhen teme... (L.37)

**Shandan=-mbajtëse qirinjs**(turq). ...aj ka me u-frue me dritën e kaltër të nji shandani (K.1,3)

**Uzdajë= shpresë** (sllav.) N 'zemër uzdaja lén n'kët gaz pranvere e buzët pëshpërisin : dashuni!(L.39)

**Veriga=pranga** (sllav.) ...janë liri qi u shpëton verigavet të vijavet të përpikta... (F.6,301)

Nga kjo analizë e leksikut të veprës së A. Pipës, vëmë re se ka një fjalor relativisht të pasur, në ato pak krijime të periudhës së hershme krijuese të autorit. Janë shumë fjalë të leksikut autokton dhe disa dialektizma dhe krahinorizma. Analiza e gjithmbarshme e leksikut të veprës së plotë të A. Pipës do të na çojë në rezultate më të sakta.

Shkurtesat:

**Vepra dhe artikuj të shfrytëzuar të A.Pipës:**

1. A. Pipa, *Lundërtarë*, Tiranë, 1944 (Më pas : L.).
2. A. Pipa, *Lundërtarë dhe Libri i dashunËs dhe i Fatit*, Tiranë, 2010 (Më pas : L.F.).
3. Revista "Kritika", Tiranë, 1944, nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr.4.( Më pas: K.1. K.2, K.3, K.4.).
4. Revista "Fryma", Tiranë, 1944, nr.2, nr.7-8 (Më pas: F.2, F.7-8).
5. Revista "Bota e RE", Tiranë, 1945, nr.3 dhe nr.5.(Më pas: B.R.3, B.R.5).

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. Kalakulla, U. (1999): *Arshi Pipa, njeriu dhe vepra*, Tiranë.
2. Gjinari, J., Shkurtaç, Gj. (1997): *Dialektologjia*, Tiranë.
3. Thomai, J. (2001): *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë.
4. Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.
5. Fjalori i "Bashkimit", Shkodër, 1908.
6. D. N.Gazulli (1941): *Fjalorth i ri fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnisë*, Tiranë.
7. Dema, B.(2005): *Fjalori fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, Tiranë.
8. Elezi, M. (2007): *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
9. Feka, Th. (2004): *Rreth fjalorëve krahinorë të gjuhës shqipe*, në "Leksikografia shqipe-trashëgimi e perspektivë", Tiranë, f. 204.

### **Linguistic considerations of Arshi Pipa's creativity**

#### ***SUMMARY***

A.Osmani author of the article, as it gives some data for short literary life and work of Arshi Pipa analyzes the vocabulary of the author's early creativity, focusing on these issues:

- Words that are not encountered in the Albanian language vocabulary of the year 2006.
- Words that we encounter in the Albanian language dictionary, 2006, with little phonetic changes.
- Dialektalisms - gegisms that some of them you encounter in the Albanian vocabulary of the year 2006.
- Some creations (Neologisms).
- Foreign words.

From this analysis of the vocabulary of Arshi Pipa, the author of the article is of the opinion that Arshi Pipa has a relatively rich vocabulary. There are many indigenous vocabulary words and not less than dialektalisms and regionalisms.

Tefta NUREDINI

**TERMINOLOGJIA GJUHËSORE NË GRAMATIKAT E  
A. XHUVANIT (1919 – 1922 - 1938);  
E KRAHASUAR ME ATË TË PËRDORUR NGA  
I. D. SHEPERI (1927) DHE ATË JUSTIN RROTA (1943)**

Synimi i këtij kumtimi, qëndron te pasqyrimi i gamës së gjerë të terminologjisë gjuhësore që trashëgojmë nga sintaksologu i parë i gjuhës shqipe prof. dr. A. Xhuvani, i cili së bashku me Kristoforidhin e Sami Frashërin, hodhën bazat e terminologjisë së shqipes. Kjo terminologji do të trajtohet e krahasuar me atë gramatikave të I. D. Sheperit, At J. Rrotës, si dhe atë të Gramatikat e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Metoda e përdorur në këtë punim është analitike-sintetike, duke përfshirë edhe krahasimin.

Do të vëmë në dukje, se ai si pjesëmarrës aktiv edhe i Komisionit Letrar të Shkodrës, vazhdoi t'u përmbahej vendimeve të kësaj Komisioni. Nuk do të lëmë jashtë vëmendjes edhe ato terma, të cilat i kanë qëndruar kohës, duke u bërë më vonë pjesë e Gramatikave të shqipes të botuara nga gjuhëtarë të ndryshëm, madje të përfshira edhe në Gramatikat e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Pikërisht atë kështjellë të sintaksës që:

***“Kur në sulm hodhën turqit  
Hordhitë e pambaruara,  
Kështjellat e sintaksës  
S'i muar, qe s'i muar.”***

e ndërtoi prof. A. Xhuvani, Kristoforidhi, S. Frashëri, I. D. Sheperi, J. Rrota, K. Cipo e gjuhëtarë të tjerë të mëvonshëm. (Aliu, Sinani, Çapaliku, Çobani, 2002; 172).

*“Në sintaksë roli i Aleksandër Xhuvanit është edhe më i madh... aty ai hapi një tokë pothuajse të re. Përpara tij s'kemi një sintaksë të shqipes...”*

*Sintaksa shqipe në tërësinë e saj u trajtua për herë të parë në “Njohunit e para të syndaksës shqype. Pjesë e parë”, botuar nga Aleksandër Xhuvani më 1922.” (Xhuvani, 1980; f. XXVII, M. Domi)*

Në visaret e gjuhës shqipe me një kontribut të padiskutueshëm para dhe pas Pavarësisë së Shqipërisë, shquhet padyshim prof. dr Aleksandër

Xhuvani, një ndër themelvënësit e gramatikave të gjuhës sonë amtare. Veprimtaria e tij studimore gjuhësore shqipe është e lidhur ngusht me Rilindjen, duke e çuar më tej atë. Edhe për Xhuvanin, ashtu si edhe për rilindasit, “*gjuha ishte dalloja kryesore e kombit, hallka e bashkimit kombëtar, mjeti më efikas i përhapjes së diturisë dhe ideve kombëtare*” (Xhuvani, 1980; fq.XXVII), prandaj ai i’u përkushtua asaj me gjithë shpirt, gjatë gjithë jetës së tij.

Konkretisht synimi i këtij punimi lidhet me dhënien (sado pak), të një kontributi në sintaksën shqipe, asesi shterues, në lidhje me veprimtarinë studimore gjuhësore të një gjuhëtari të madh si A. Xhuvani, në fushë të terminologjisë gjuhësore shqipe. Qëllimi i këtij punimi lidhet me përshkrimin e terminologjisë gramatikore (sintaksore), të përdorur nga ky gjuhëtar, për të vënë në dukje vlerat e vyera të tij, si hedhës i bazave të mirrëfillta të sintaksës shqipe në përgjithësi e të terminologjisë gramatikore në veçanti. Padyshim do të ndalemi edhe në faktin, se ai si pjesëmarrës aktiv edhe i Komisionit Letrues të Shkodrës, vazhdoi t’u përmbahej vendimeve të kësaj Komisioni. Nuk do të lëmë jashtë vëmendjes edhe ato terma që i kanë qëndruar kohës, duke u bërë më vonë pjesë e gramatikave të shqipes të botuara nga gjuhëtarë të ndryshëm, madje të përfshira edhe në Gramatikat e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Tekset e sintaksës së shqipes u trajtuan vonë si libra më vete. Edhe pse disiplina e sintaksës (megjithëse e lindur si shkencë më vete, që në shekullin II pas Krishtit), përgjithësisht është shtjelluar në gji të logjikës dhe gramatikës. Gjithsesi në gjuhën shqipe librat e parë të sintaksës filluan të hartoheshin kryesisht kur arsimit dhe shkollat shqipe njohën një zhvillim të rëndësishëm sidomos në 10-vjeçarët e parë të shekullit të kaluar. I pari në këtë lëmë ka hedhur themelet prof. Aleksandër Xhuvani me botimin e vitit 1922 “**Njohurit e Para të Sintaksës Shqipe. Pjesë e Parë**”, e cila do të pasohet me botime të tjera, si: “**Gramatika dhe Sindaksa e Gjuhës Shqipe sidomos e toskërishtes**” e I. D. Sheperit botuar në vitin 1927; “**Syntaxa e Gjuhës Shqipe**” e At Justin Rrotës botuar më 1943 (ribotim 1944), “**Sintaksa**” e K. Cipos botuar më 1950; “**Gramatika dhe Sintaksa e Gjuhës Shqipe**” e M. Domit botuar më 1954 (ribotuar 1957); “**Sintaksa e Gjuhës Shqipe**” e S. Priftit botuar më 1959-1960 etj., për të ardhur te “**Gramatika 2**” e ASHSH.

Fillimet e përkushtimit të profesorit tonë të madh në fushë të gjuhësisë i përkasin vitit 1905, kur ai botoi në revistën Albania studimin “*Për themelimit të një gjuhe letrare*”, e cila do të pasohet më vonë me gamën e gjerë të botimeve në këtë fushë. Qysh në zanafillë të studimeve të tij qartësohen idetë e një gjuhëtari me dhunti të veçanta të dhëna nga vetë



Zoti. Ai parashtroi idenë e domosdoshmërisë së formimit të një gjuhe të përbashkët kombëtare, duke e vënë theksin se “*Njësia e gjuhës është njësia e kombit*” (Xhuvani, 1956; f. 6). Lidhur me problemin e gjuhës letrare, edhe pse gegë, siç thotë vetë Xhuvani, ishte i mendimit se ajo duhet t’i kishte bazat në dialektin e toskërishtes. Tezën e tij ai e mbron me argumente bindëse një prej të cilave është “*variant dialektor i Jugut mund të zotërohej më shpejt jo vetëm prej shqipfolësve bashkëkombas, por edhe prej të huajve.*” (Mulaku, 2004; 50). Një tjetër argument, siç thekson ai, është, se pavarësisht faktit që, “*toskërishtja lypset me e marrë për themel, mbi të cilin të ndërtojmë gjuhën tonë letrare. Atje ku toskënishtja nuk e mbush dot qëllimin, le t’i vijë në ndihmë gegënishtja.*” (Xhuvani, 1956; 6)

Në formimin e personalitetit shkencor të prof. Xhuvanit patën padiskutim ndikimin e tyre Kongresi i Elbasanit me orientimet e vendimet e tij, përmendim këtu: “*shqiptarët kudo të përpiqen, me sa të mundet, të fusin gjuhën shqipe në çdo shkollë të huaj që gjendet në Shqipëri dhe klubit qendror ngarkimin të kërkojë që gjuha shqipe të jetë gjuha e mësimimit ndë shkollat e para [filllore] dhe të dyta [qytetëse] të qeverisë, që gjenden në Shqipëri.*” (Myzerizi, 2004; 111), si dhe Komisia Letrare e Shkodrës, drejtuesit e së cilës e ftuan si “*ekspert gjuhësor dhe njohës i Elbasanishtes, i cili do të ndihmonte për të përmirësuar gjuhën letrare të zgjedhur*” (Osmani, 2004; 46). Në librat e sintaksës së Xhuvanit vazhdohet tradita e KLSH, duke u zbatuar vendimet e saj, përmendim këtu: a) shenjat diakritike për hundorësinë dhe theksin, si: *është, vëhet, nxânësit etj.*; b) shkruan të plota togjet e zanoreve: *ie, ue, ye*, si: *dyzanuer, due, diell etj.*; c) si dhe grupet e bashkëtingëlloreve: *mb, nd, ngj*, si: *të mbushin, ndritshme, prëndverë etj.*; d) përdorimin e *ë-së* në pozicionin fundor në fjalët parafundore dhe e theksuar në trup të fjalës, por *ë-ja* përdoret edhe për arsye të gjatësisë së zanores së theksuar, si: *bajnë, të bajë etj.*

Kontributi i A.Xhuvanit në lëmë të gjuhësisë është i jashtëzakonshëm. Trajtesat shkencore të tij përfshijnë fusha të ndryshme në lëmë të gjuhësisë. Për këtë flasin 4 tekste gramatike, dy për fonologji - morfologji dhe dy për sintaksën, për klasat e ulëta dhe të nalta të filllores. Pavarësisht se prof. A. Xhuvani i’u referua shumë gramatikave të gjuhëve të huaja, si: frëngjisht, italisht, gjermanisht e rumanisht; gramatikat e tij shqipe nuk qenë një përkthim i tyre, pasi siç thekson ai: “*çdo gjuhë ka rregullat e ligjet e veta, e gramatika, qi dëftën mënyrën e të shkruemit të një gjuhe, nuk mund të futet në kallëp të gramatikavet të huaja.*” (Akademia, 1980; 200)

Në parathëniet e këtyre librave gjuhëtari ynë paraqet me modesti vështirësitë që ka ndeshur për arsye se “*gjuha e jonë nënë s’u ka ngjeshun e*

*gatuem mirë e ortografija e sajë veç disa gjanave të pakta nuk ka marrë ende një trajtë të qindrueshme e të rregullueshme...*” (Akademia, 1980; 200).

Po ashtu në fund të kësaj parathanie jepet edhe qëllimi i tij: “*Uroj, qi librat e mi të mbushin një mungesë nëpër shkollat e të bâhen shkak qi të tjerë... të hartisin libra gjuhe mâ mësimtarë se të mitë.*” (Akademia, 1980; 201).

Nëpërmjet këtyre librave dhe punës që bëri si anëtar e kryetar komisionesh, pa lënë më pas edhe veprimtarinë mësimore në Shkollën Normale të Elbasanit, ai i dha gjuhësisë shqiptare një ndihmesë të vyer edhe sa i takon terminologjisë gjuhësore, “*baza e të cilave u hodhën në Kongresin Arsimor të Lushnjes (1920), ku Xhuvani qe kryetar i komisionit që u ngarkua me përpunimin e saj*” (Akademia, 1980; XXIV).

Prof. A. Xhuvani në përdorim të terminologjisë huazoi mjaft terma të përdorura nga K. Kristoforidhi dhe S. Frashëri. Gjithsesi larmishmëria dhe pasuria terminologjike gramatikore që ne kemi trashëguar prej tij është tejet e madhe, përmendim këtu termat në fushë të fonologjisë: *zanore, bashkëtingëllore, dyzanuer*; morfologjisë: *para-fjalë, lidhëz, gjini, dhanore, përemër dëftor, i pakufishëm e pronor, trajtë veprorë e pësorë, kohë e thjeshtë, e kryeme e plotë, e kryeme e tejshkuar, zgjedhoj, zgjedhim etj.*; sintaksës: *kryefjalë, kallzues, emnuer, foljuer, cilësor, kundrinë, plotës e plotësor, etj.* Pikërisht tek terminologjia sintaksore do të përqendrohet edhe punimi ynë, duke e parë në plan krahasues me gjuhëtarët pararendës dhe pasardhës të Xhuvanit.

Kategoritë sintaksore ai i ndan në:

- a) gjymtyrët e para të fjalisë: kryefjalë & kallzues;
- c) gjymtyrët të dyta të fjalisë: kundrinor (i drejtë e zhdrejtë), cilësori, ndajshtimi, plotësori;
- d) fjalia;
- e) periudha (*fjali të rendituna & fjali të lidhuna*)

Dy termat kryesorë të sintaksës *kryefjalë dhe kallzues*, prof. Xhuvani në librin “**Njohunit` e Para të Sitaksës Shqipe. Pjes` e Parë**”, botuar në vitin 1922, i emërton si, “*dy pjesët e para të fjalisë*”, duke na dhënë edhe përkufizimet përkatëse, respektivisht: “*Kryefjala dëften njeriun, kafshën a gjân, për të cilën flasim në fjali, ndërsa kallzuesi dëften çka thohet për kryefjalën...*” (Xhuvani, 1938; 5). Siç e shohim nga përkufizimet, autori nuk i jep epërsi asnjërës prej kryegjymtyrëve, duke i parë ato si të barasvlershme në strukturën e fjalisë. Nuk do të lëmë pa përmendur edhe trajtimin që i bën Xhuvani *këpujës*, si pjesë përbërëse të predikatit, përndryshe e kallzuesit emnuer. Gjuhëtari jep përkufizimet

përkatëse për kallëzuesin foljor dhe për atë emëror: “*Kallzuesi është foljues, kur dëfthehet me anë të njëj folje dhe është emnuer, kur kallzohet me anë të njëj emni, të njëj mbiemni a përemni që lidhet me kryefjalën me anë të foljes me qenë*”. (Xhuvani, 1938; 8). Xhuvani sa i takon kryefjalës shpjegon se në vetën e parë dhe të dytë, zakonisht mungon, këtu bashkohet edhe Sheperi: “*Kryefjala e vetës së parë dhe e së dytës, zakonisht mungon, se prapashitimet e foljevet të shqipes meaftojnë që t`a tregojnë.p.sh Ku veni? Vemi në treg.*” (Sheperi, 1927; 141). Po ashtu prof. Xhuvani dallon një grup foljesh, si: *thonë, thuhet, flitet, gjimon* etj., për të cilat kryefjala nënkuptohet.

Këto terma do të përdoren edhe nga Ilia Dilo Sheperi në veprën e tij “**Gramatika dhe Syndaksa e Gjuhës Shqipe sidomos e toskërishtes**” botuar në vitin 1927, si *kryefjalë dhe kallëzues*, e për këtë të fundit ai përdor edhe termin *atribut*. Edhe ky gjuhëtar jep përkufizimin e tij (i ngjajshëm me atë të Xhuvanit) për secilin term të përfshirë në përkufizimin e fjalisë së thjeshtë, “*Fjalìa më e thjeshtë ka të paktën dy fjalë, prej të cilave, njëra tregon vetën ose gjënë për të cilën bëhet fjalë, dhe quhet kryefjalë, dhe tjetra tregon se ç`thuhet për kryefjalën, dhe quhet kallëzuesit.*” (Sheperi, 1927;139).

Sheperi vështron edhe transformata të ndryshme nga kryefjala te kundrinori, nëpërmjet ndërrimit të diatezave foljore (*letra shkruhet ~ shkruaj letrën*), apo edhe të shndërrimit të kallëzuesve të kryefjalës e të kundrinorit të drejtë (*letrën e shkrova ~ letra u shkrua*). Është për t`u theksuar se edhe Sheperi pavarësisht se shkruan në dialektin toskë, në emërtimin e kallëzuesit foljor dhe emëror përdor grupin *ue* tipik i dialektit gegë, pra ai emërton farët e kallëzuesit, “*kallëzues foljues dhe kallëzues emnuer*”.

Më vonë, në librin “**Syntaksa e Gjuhës Shqipe**” botuar në vitin 1943 (ribotim, 1944), At Justin Rrota i quan ato “*dy kryegjymtyrët e fjalis: frymori ase ndi për të cillin flasim, thirret kryefjalë (subjekt) dhe shka thomi për të quehet kallxoje (predikat)*”. (Rrota, 1944; 2).

Emërtimi që u bën At J. Rrota është i njëjtë me atë që bëhet edhe në **Gramatikën e Gjuhës Shqipe 2**, të ASHSH, kryegjymtyrë ose gjymtyrë kryesore.

Siç e shohim ky term e ka origjinën te emërtimi që i bën A. Xhuvani, sepse të ashtëquajturat “*pjesë të para*” logjikisht janë “*pjesë kryesore*”. Pjesët ose gjymtyrët kryejnë të njëjtin funksion, pra janë ekuivalente të njëra-tjetrës. Kështu mendojmë se, ky emërtim e ka zanafillën te emërtimi i Xhuvanit. Edhe përkufizimet e lartpërmendura për këto dy kryegjymtyrë janë shumë të përafërta me ato që jepen në

**Gramatikën 2 të ASHSH**, “*Kryefjala dëftën njeriun, kafshën a gjân, për të cilën flasim në fjali, mund të jetë një emën, një mbiemën, një përemën, çdo tjetër pjesë e ligjëratës e vëhet në rasë emnore, (që hyn në marrëdhënie me kallëzuesin dhe shprehet me emër, përemër, numëror e çdo pjesë të ligjëratës të emëruar; Gramatika 2, f. 167), “ndërsa kallzuesi dëftën cka thohet për kryefjalën, është foljuer e emnuer, ky i fundit me foljen me qenë quhet këpujë (që hyn në marrëdhënie me kryefjalën – një emër, mbiemër, përemër, numëror, pjesë e pandryshueshme e ligjëratës; Gramatika 2, f. 173)...”, gjë e cila flet qartë se, edhe gjuhëtarët e sotëm qoftë në terminologji, qoftë në përkufizime janë mbështetur te Gramatikat e Xhuvanit.*

Termi *kundrinor* është përdorur në Gramatikën e ASHSH, por nga ndonjë autor përdoret termi objekt. Këtë term e përdor për herë të parë A. Xhuvani, i cili i ndikuar nga Komisia Letrare e Shkodrës përdor *skaj* në vend të *term*. Në Gramatikën e tij Xhuvani jep përkufizimin për *kundrinorin* dhe me çfarë shprehet ai, [këtu vlen të përmendim se, Xhuvani vë në dukje: “*kundrina mund të dalë edhe me folje në mënyrë të pashqueshme, (Xhuvani, 1938;13), (paskajore)] “Kundrinë quhet fjala që dëftën njerin` a gjân, mbi të cilën bie veprimi i foljes a të kazuesit foljuer, është dy farësh: e drejtë(në rasën dëshmore), e e shdrejtë(në rasën dhânore) e mund të jetë një emën, një mbiemën, një përemën, një fjali e tanë.” (Xhuvani, 1938;13). Ky përkufizim është i përafërt me përkufizimin e Gramatikës 2 të ASHSH “...*kundrina shënon objektin (fjala që dëftën njerin` a gjân, e veprimit që shpreh folja*”. (Akademia, 2002; 251). Sheperi ndryshe nga Xhuvani i rendit *kundranorët* te plotësorët, (*shkruaj mësimin – plotës me kallëzore*), (Sheperi, 1927; 150). Myderizi si *kundranë* pranon vetëm atë gjymtyrë që të tjerët e quajnë *kundrinor* të drejtë, kurse atë gjymtyrë që të tjerët e quajnë *kundrinor* të zhdrejtë ai e quan plotës të zhdrejtë. K. Cipo e pranon që *kundrinori* bën pjesë te plotësit dhe nga ana tjetër pohon se *kundranori i drejtë* është element kryesor i fjalisë si *nënanori* (krefjala) e *predikati* (kallëzuesi). Në Sintaksën e At J. Rrotës ndeshim një trajtim më të gjerë sa i takon *kundrinës a objektit*. Vështrimi i tij lidhur me këtë gjymtyrë është i strukturuar në disa nënndarje: *Kundrina në Kallxore / në Dhanore / në rrjedhore / Parafjalore (risia e sjellë në Sintaksën tonë)*. Ai shpjegon edhe transformat me ndryshime funksionale të kalimit të *kundrinave* tek njëra – tjetra: *me e ndihmue shoqin ~ me i ndihmue shoqit* (Rrota, 1944; 32). Mjaft tërheqëse është pjesa të cilën e emërton *Folje frazeologjike*, ku ndikimi i *kundrinës* i jep një kuptim të ri duke e larguar foljen nga kuptimi i parë, (*bâj ball; çoj krye;lëshoj shtat; marr erë etj.*). (Rrota, 1944;38)*

*Ndajshtimi*, një tjetër term që i ka ardhur terminologjisë gramatikore shqipe ashtu siç është përdorur nga prof. Xhuvani. Përkundrejt këtij emërtimi Sheperi dhe Rrotë përdorin edhe emërtimin përkatësisht: “*apozisioni dhe apozicjoni*”. Përkufizimet e këtyre gjuhëtarëve janë të ngjashëm me njëri – tjetrin, por edhe me atë që bëhet në Gramatikën e sotme. Përkufizohet ndajshtimi si një emër që i shtohet një emri tjetër “*për të diftue mjeshtërinë a cilësi të tij*” (Xhuvani, 1938; 12); “*emëri që i shtohet një emëri tjetër që t`a plotësojë, si një cilësor, ose që t`a shpjegojë*” (Sheperi, 1927; 152); “*emni ase përemni mund të sqarohen ma mirë me një tjetër emën a përemën, ky cillsuer thirret ndajshtim (ndajshtim)*” (Rrota, 1944; 17); “*një lloj përcaktori i shprehur me një emër të pashquar që përshtatet në numër me gjymtyrën e përcaktuar*”. (Akademia, 2002; 237)

Skaji *Cilësori* i përdorur nga Xhuvani është rimarrë si term edhe nga studiuesit pasardhës të gjuhës shqipe si: Sheperi, Rrota (e quan *atribut* dhe në klasën e attributeve përfshin edhe *atributin predikativ ~ përcaktorin kallëzuesor*) e Cipo. Në Gramatikën 2 të ASHSH, cilësori është konvertuar me termin përcaktor. Ashtu siç Xhuvani e klasifikon cilësorin te gjymtyrët e dyta, ashtu e klasifikon edhe **Gramatika e Gjuhës Shqipe 2**, e ASHSH. Edhe pse emërtimi i tij është i ndryshëm, përkufizimi i Xhuvanit: “*Cillsuer quhet mbiemni që vëhet përpara e prapa një emni për t`i kallzue cilsinë a për t`ja kufizue mâ mirë kuptimin.*” (Rrota, 1944; 11), është i ngjajshëm me atë të Gramatikës 2 të ASHSH: “*Përcaktor është ajo gjymtyrë e dytë e fjalisë që është në marrëdhënie përcaktore me gjymtyrën prej së cilës varet e që bashkohet me të me lidhje përshtatje, drejtim a bashkim.*” (Akademia, 2002; 221)

*Plotësori*. Në analizën funksionale të gjymtyrëve të fjalisë, rendin e plotësorëve autori e nis në pjesën e parë të gramatikës së tij, ku i mësohet më shumë studimit mbi *plotësorët e vendit, kohës, mënyrës dhe shkakut* (rrethanojë e sotme), si dhe në të dytën, ku trajtimi i tij zgjerohet me: *plotësori i pronës; i mjetit a i veglës; i lëndës; i bashkimit; i çfarësisë* (i cili trajtohet cektësisht në pjesën e parë); *i cilësisë; i sasisë; i mirësisë; i qëllimit; i kufizimit; i krahasimit; i emnimit; i plotnisë e i mungesës; i pjesës; i të ndamit; i rranjës; i agentit; kundrinuer*. Një pjesë e plotësve të pjesës së dytë janë rrethanojë e sotëm (*plotësori i sasisë, qëllimit*), e një pjesë përcaktorë (*plotësori i çfarësisë, mjetit, pronës, veglës*). Është mjaft interesant fakti se përmes tyre trajtohen dukuri sintaksore që ndoshta nuk kanë qenë objekt studimi për gjuhëtarët e asokohe, përmendim këtu *plotësorin e agentit*, përmes të cilit ndeshim dukurinë e transformës (dukuri e sintaksës gjenerative), kthimin e foljes nga forma veprorë në pësore, si dhe kthimin e kryefjalës në kundrinë dhe anasjelltas. Pikërisht

emri  $E_1$  transformohet në  $E_5$ , i cili quhet *plotësuer i agjentit p.sh., Mësuesi mëson nxanësin. Nxañesi mësohet prej mësuesit.* (Akademia, 1980; 221).

Kjo gjymtyrë trajtohet edhe nga gjuhëtarët e lartpërmendur. Sheperi i klasifikon ato sipas: a) rasës: *plotës në gjëndore, në dhënore, në kallëzore, në rrjedhore, në thirrore*; b) mbi bazë logjike: *plotës prone, lënde, foljuer*; c) plotës ndajfoljorë: *vendi, kohe, mënyre, sasi, shkaku, krahasimi*. Ky term në Gramatikat e sotme është zëvendësuar me termat *rrethanor* dhe *përcaktor*.

Siç e shohim, sa u takon gjymtyrëve të para dhe të dyta të fjalisë, termat: *kryefjalë, kallëzues, kundrinë e ndajshim*, janë trashëguar nga gjuhëtari ynë i madh prof. Aleksandër Xhuvani.

Kontributi i Xhuvanit në fushën e terminologjisë është shtrirë edhe te kategoritë sintaksore: *fjalìa dhe periudha*. Në trajtimin që u bëhet fjalive në kapitullin/sythin: *Farët e fjalisë* shohim se terminologjia e përdorur prej Xhuvanit ka ardhur deri në ditët tona. Kështu emërtimet: fjali e thjeshtë (*kryefjalë + kallëzues*); fjali e përzieme (*kryefjalë + kallëzues + 1 gjymtyrë*); fjali mungesore (*dukuria e elipsës*), janë përdorur nga të gjithë gjuhëtarët e mëvonshëm, me pak ndryshime, për të arritur deri në ditët tona. Pothuajse të njëjtat emërtime përdor edhe Gramatika e Gjuhës Shqipe 2 e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kështu atë fjali që Xhuvani e quan *Fjali të thjeshtë* në Gramatikën e sotme quhet *Fjali e pazgjeruar*; atë që e quan *Fjali të zgjeruar* njëjtë e quan edhe Gramatika: po ashtu ndodh edhe me *Fjalinë mungesore*. Te trajtimi që autori i bën kësaj të fundit zgjerohet koncepti i fjalisë njëkryegjymtyrëshe, kur ai shpjegon: “*Kryefjala përemën e fjalisë mungon thujse gjithherë në Shqipet, por kjo nuk mund të quhet mungesore, pse mungesa e kryefjalës përemën është një gja e rregullshme në Shqipet.*” (Xhuvani, 1938; 20)

Tek kategoria sintaksore e periudhës, studiuesi pasi jep përkufizimin e saj dhe dallimin me fjalinë, e klasifikon në: *periudhë me fjali të rendituna bashkë dhe periudhë me fjali të lidhuna bashkë*. Sa i takon parataksës ai e strukturon në mënyrë të tillë: *fjali e parë e palidhun + fjali e parë e renditun bashkë*, ndërsa për hipotaksën strukturimi i tij është i tillë: *fjali e parë + fjali e varrme*. Në fjalitë me hipotaksë ai përfshin: *fjalitë kryefjalore; kundrinore; kohore; mënyrore; vendore; shkajkore; lidhore; qëllimore; ndërmjetëse; krahasore; kushtore; rrjedhore e konçesive*. (Akademia; 1980; 225). Edhe Sheperi do të përdorë termat fjali me *bashkërenditje dhe fjali të bashkëlidhuna* (Sheperi, 1927; 172-173). Ndërsa At J. Rrota përdor termin *Fjali të përbame* (Rrota, 1944; 60), dhe te *farët e fjalive të dyta* shton fjalitë *kallëzore; përcaktore*. Këto emërtime, duke përjashtuar ndonjërin prej tyre, përfshihen në tekstet e gjuhës shqipe të

cikleve të ndryshme, madje ato i gjejmë edhe në Gramatikën e Gjuhës Shqipe 2 e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Terminologjia e përfshirë në tekstet e përgatitura nga Aleksandër Xhuvani, ka qenë themelvënëse e terminologjisë gramatikore shqipe, sidomos asaj sintaksore dhe ka shërbyer si bazë e sigurt për gjuhëtarët e mëvonshëm. Siç e kemi theksuar, shumica e emërtimeve të tij i kanë rezistuar kohës dhe vazhdojnë të jetojnë në gramatikat e shqipes.

#### **BIBLIOGRAFIA:**

1. Xhuvani, A. (1956): *Studime gjuhësore*, Tiranë.
2. Xhuvani, A. (1938): *Njohurit` e Para të Sintaksës Shqipe. Pjes` e Parë*, Tiranë.
3. Akademia e Shkenca e RPSSH (1980): *Aleksandër Xhuvani*, vepra 1, Tiranë.
4. ASHSH (2002): *Gramatikës 2*, Tiranë.
5. Myzeri, Hysni (2004): *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë.
6. I. D. Sheperi (1927): *Gramatika dhe Syndaksa e Gjuhës Shqipe sidomos e toskërishtes*, Vlorë.
7. Rrota, J. (1944): *Syntaksa e Gjuhës Shqipe*, Shkodër.
8. Rrota, J. (1944): *Syntaksa e Gjuhës Shqipe*, Shkodër.
9. Mulaku, R. : *Gjuha shqipe 2/ 2004*, Prishtinë.
10. Osmani, T. (2004): *KLSH në Shkodër*, Shkodër.

#### **Linguistic terminology in grammars of A. Xhuvani (1919 - 1922 - 1938); compared with that used by I. D. Sheperit (1927) and Father Justin Rrota (1943)**

#### **SUMMARY**

Alexander Xhuvani, one of visars of Albanian language, became the initiator of the unification of Albanian standart language, setting forth the necessity of forming a common national language. But what mostly will distinguish professor Xhuvani is the fact of being the Founder of the Albanian Grammars. It is just the work “*Njohunit e para të syntaksës shqipe. Pjes` e parë*” published by Xhuvani in 1922, where is treated for the first time the syntax of Albanian language in its entirety which will be followed by numerous studies and publications.

The purpose of this proclamation lies in the broad range of coverage of linguistic terminology we inherit from our first Albanian language syntaxlogiest Prof. dr. A. Xhuvani, who together with Kristoforidhi, Sami

Frasheri set the Albanian language terminology bases. This terminology will be treated as compared with the grammars of I. D. Sheperit, Father J. Rrota and the grammars of the Albanian Academy of Sciences. The method used in this paper is analytical -synthetic, including comparison.

We will note that he as active participants of Literary Commission of Shkodra abode by the decisions of this Commission. We will not let out of the spotlight even those terms that have resisted time becoming later part of Albanian grammars published by different linguists, some of whom are included in the grammars of the Albanian Academy of Sciences.

The castle of syntax, which none invaders failed to take, was built by Prof. A. Xhuvani , Kristoforidhi, S. Frasheri , I. D. Sheperi, J.Rrota, K. Cipo and other later linguists.

**Key words: Subject (subject), Predicate (predicate), quality (circumstantial) compliment (determinant).**



Arjola HOTI

**VËZHGIME LEKSIKORE NË VEPRËN “DITËT E  
MBRAME TË TURQISË NË SHKODËR ASE RRETHIMI I  
QYTETIT 1912-1913” E JUSTIN RROTËS**

Ashtu si çdo gjuhë, edhe shqipja ka qenë një gjuhë e gjallë, e cila është zhvilluar, zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Kjo edhe nëpërmjet punës së palodhur të shkrimtarëve shqiptarë që lëvruan me shkrimet e tyre në periudha të ndryshme letrare. Mes kolosëve të autorëve shkodranë veçojmë për arsye studimi Atë Justin Rrotën, një ndër intelektualët më të shquar shqiptarë, lindur me 17 nëntor 1889 në një familje shqiptare me tradita. Studimet e para i kreu në shkollën e françeskanëve, ku kreu pesë klasë fillore. Fakti që ky autor rridhte nga një familje me tradita të thella fetare, bëri që ai të ndiqte këtë rrugë, si dhe me dëshirën dhe vullnetin e tij, ai filloi të mësonte latinishten, gjë që ndikoi fuqimisht në përgatitjen e tij intelektuale. Justin Rrotën do ta shohim të përkushtuar në detyrat që ai i kishte kushtuar vetes, fillimisht në Rubik e më vonë në Troshan, vend në të cilin kreu kursin e filozofisë.

Ai dërgohet në Austri për të studiuar teologji, por për arsye shëndetësore ky personalitet i zellshëm, detyrohet të kthehet në Shqipëri, për t'i vazhduar më pas këto studime në Shqipëri dhe pikërisht në Rubik nën udhëheqjen e Gj. Fishtës, Z. Lochmann dhe A. Marlaskaj.<sup>257</sup>

I theksojmë të gjitha këto, që të vëmë në dukje se kultura dhe përgatitja e tij filologjike ishte në atë shkallë të lartë, sa të ndërmerre një mision kaq të lartë, siç ishte paraqitja e ideve në botimet e tij dhe larmishmëria e pasurisë leksikore që vihet re gjatë studimit.

Gjatë punës së tij shumëvjeçare Atë Justin Rrota na la shumë botime me karakter gjuhësor, por dhe letrar. Mes tyre, ky shkrimtar la dorëshkrim edhe mjaft vepra letrare, por që mbeten të pabotuara, dorëshkrime midis të cilave përmendim edhe “*Ditët e mbrame të Turqisë në Shkodër ase Rrethimi i qytetit 1912-1913*” (nga kujtimet e një të ngujumi 1963), një vepër historike-letrare, në formën e një ditari, e cila rrëfen ngjarjet e jetuara gjatë rrethimit të Shkodrës dhe që do të shfrytëzohet edhe si literaturë e studimit në fjalë.

---

<sup>257</sup> D. Kurti, *At Justin Rrota, biografi*, Botime Françeskane, Shkodër, 1964.

Kjo vepër ka karakter historik, pasi përshkruan luftën serbo-malazeze kundër turqve, luftë në të cilën përfshihen edhe rezervistët shqiptarë dhe qytetarët shkodranë, një përleshje kundër armiqve sllavë, të cilët tentonin të pushtonin Shkodrën. Por pavarësisht trajtimit historik që ndeshim në këtë vepër, *qëllimi* i punimit konsiston në konstatimin dhe identifikimin e disa veçorive të leksikut të gjuhës së përdorur në veprën e Justin Rrotës.

Gjatë këtij punimi do të ndalemi në çështje të tilla, si:

1. Shtresëzimin e leksikut të gjuhës në veprën e Rrotës:

- shtresa vetjake ose fjalë që i takojnë fondit themelor të gjuhës shqipe,
- shtresa e huazuar.

2. Fjalësin e rrallë në përjasje me fjalorin e sotëm aktiv.

3. Pasurinë leksikore fetare (kishtare).

### 1.1. Shtresa vetjake e leksikut

Në shtresën vetjake të leksikut të një gjuhe, për rrjedhojë dhe në atë të gjuhës shqipe dallojmë dy nëngrupe fjalësh:

- a. *Fjalë të gjuhës shqipe por që i përkasin edhe një burimi të hershëm indoevropian (gjuha shqipe i ka klasifikuar si të shtresës vetjake).*

Dihet se gjuha shqipe ka burim si një ndër gjuhët indoevropiane dhe është pasardhëse e ilirishtes. Kështu që shumë fjalë që kjo gjuhë mbart i takojnë fondit të trashëguar, por që shqipja tashmë i ka përfshirë pjesë të fondit të vet. Në këtë grup fjalësh listojmë fjalë që janë ndeshur në vepër dhe që shumica u përkasin koncepteve themelore. Klasifikojmë si më poshtë:

- a. **Emra:** arë, bir, darkë, dele, lopë, derr, djathë, burrë, dorë, derë, detyrë, dhjamë, elb, emër, ëndërr, gji, hudhër, kohë, mal, mjegull, mjekër, mot, veri, zë-ri, zog, gjak, gjel, kafshë, kodër, paqe, punë, qytet, sy, vaj, terr, e shumë të tjera.

- b. **Folje:** dal, djeg, mbush, çel, blej, dal, duroj, kafshoj, luaj, etj..

- c. **Mbiemra:** i egër, i poshtër, i rëndë, i sëmure, i varfër, i vogël, rrezikzi, fatkeq etj..

- d. **Përemra:** që, e/i cili, cila, kështu, ky, kjo, cili, cila, ata, etj..

- e. **Ndajfolje:** Aty, këtu, atje, ngado, rreth, etj..

Në këtë grup të madh të shtresës vetjake, siç vihet re, e përbëjnë fjalë të parme të vetë gjuhës, si dhe fjalët e formuara me *prejardhje*, *me përbërje*, *me përngjijtje*, *me parnyjëzim* si dhe *me konversion*, duke përdorur *brumin vendës*, si: bërje, dimarak, burrëror, rrugëtim, keqbërës, mirësi, nëpunës, i papunë, punëdhënës, punëtor, punoj, pjesëtar, zemërmirë etj.

Të shtresës vetjake klasifikohen edhe një grup fjalësh të formuara nga pasthirmat ose nga onomatopetë, por që janë shumë rrallë të ndeshura në vepër, si: *bubullin*, *gurgullon*, *hingëllin*, *kakarit*, *mjaullit*.

### 1.2. Shtresa e huazuar e leksikut.

Populli shqiptar ashtu si shumë popuj të tjerë, karakterizohet nga një histori marëdhëniesh me popuj të tjerë. Kjo si pasojë ka dhënë ndikim të gjerë, jo vetëm në aspektin kulturor, por mbi të gjitha në leksikun e një gjuhe. Fjalët e huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe në kushtet e kontaktet shekullore të shqipes me gjuhët pushtuese ose të vendeve fqinje, duke u përzier me leksikun vendas, e duke formuar shtresa të ndryshme leksikore, si: sillavizmat, latinizmat, turqizmat, të cilat do të vëzhgohen gjatë studimit.

Këto marrëdhënie janë realizuar sipas dy faktorëve parësorë:

a) Marrëdhënie tregtare

b) Luftërat e shumta me popuj të tjerë pushtues

Populli shqiptar, ka qenë në kontakte të vazhdueshme tregtare me vendet fqinje. Zakonisht në këto raste janë huazuar terma të tillë që emërtojnë sendin dhe që kanë hyrë në shqip bashkë me konceptin. Fjalë të tilla ndeshim: oborr, kosh, kovë, daulle, çardak e shumë të tjera që do t'i analizojmë me shembuj më poshtë.

Shtirja dhe ndikimi i fjalëve të huazuara nuk ka të njëjtën përndarje në krahinat e Shqipërisë. Shkodra identifikohet si një ndër vendet më të ndikuara. Kjo vërtetohet edhe me larminë e fjalëve të huazuara që ndeshim në veprat e autorëve shkodranë dhe veçanërisht në veprën e këtij shkrimtari. Duke pasur parasysh dendurinë e fjalëve latine që kemi hasur në këtë vepër, po e nisim klasifikimin që këtu.

#### 1.2.1 Huazimet latine

Gjurmët më të thella që i kemi hasur në leksikun e studiuar në veprat e Justin Rrotës u përkasin huazimeve latine. Ndikimin më të madh të këtyre fjalëve në latinisht e lidhim me pushtimin e gjatë prej rreth 7 shekujsh, ndikim që në gjuhën tonë (që është i dukshëm edhe në vepër), ka qenë tepër i madh, si dhe nisur nga kultura intelektuale e këtij autori. E ndeshim në fjalë që i përkasin sferës së jetës, si:

Emërtime të shtëpisë: shtëpi, furrë, tjegull, mur, etj..

(...për me i marrë **tjegullat** u rrenojshin... f.175; /...ndërsa ndihen tue ra **pullazet** e shpiavet...f. 33; / ...banorët e ktyneve **lagjevet** i lejshin **shpiat**... f.37; / ...për rreth **furrave** të qytetit...f.37; / ...janë mbyll sod edhe 5 **furra** të tjera...f.54; /...kado të shkojsh rrugës sheh njeriu **mure** të rrexueme...f. 144).

Emra kafshësh: qen, pulë, kalë, kafshë, lepur, pëllumb etj..

(... për me i marrë katundarëve do krenë **lopë**...(f. 159) / ...me hanger mish **qejsh**, **kuajsh** e **mijsh**...(f.100) \ ...kalon nje kal ngarkue me kova e kosha. (f. 157).

Emra farefisnie: mashkull, femën, prind, njerjë, kunat, fëmijë etj.  
(... edhe *grat* me *fëmijët* e vegjël ngrykë a për doret...f.33 / ... shumica e *mashkujve* muslimanë...shkojshin të armatosun...f. 34).

Duke pasur parasysh, se kemi të bëjmë me veprën e një kleriku, që si bazë të studimit ka pasur latinishten, vetvetiu biem në gjurmët e një numri të konsiderueshëm fjalësh të burimit latin, të cilat i përkasin sferës kishtare.

Emra që i përkasin sferës kishtare: prift, lter, djall, kreshmë, mëkat, etj  
(... *kleri* asht marrë me sy prej qeveriet...disa prej *fretnësh* e *priftnësh*...f.182 / ...pullazi e *lterët* shumica kjenë qartë...f.150 )

### 2.2.Huazimet turke.

Sundimi i Perandorisë Osmane ka qenë shumë i gjatë, rreth V shekuj. Si rezultat, ndikimet e fjalëve të burimit turk, të cilat kanë zënë vend në gjuhën tonë dhe që pasqyrohen edhe në vepër, janë të konsiderueshme. Shumë nga këto fjalë janë përfshirë në leksikun e gjuhës sonë bashkë me sendin a dukurinë e emërtuar, si: xhami, pasha, xhandar, vezir, etj.

Shumë fjalë kanë pasur një kohështrirje dhe kohëzgjatje të përdorimit, duke kaluar në një stad ku këto fjalë përdoren rëndom si pjesë e shqipes. Ndeshim fjalë të tilla: çati, çardak, fishek, hajat, kazan, tepsi, themel, xhep etj.

Këto fjalë të huazuara nga turqishtja përfshijnë në vepër fjalë nga sfera nga më të ndryshme të jetës. Shumë nga këto fjalë janë bërë pjesë e leksikut, nisur nga fakti se turqishtja për një kohë të gjatë u përdor si gjuhë e administratës. Pavarësisht kësaj, në veprën e Justin Rrotës, dallojmë një shmangie të turqizimave, krahasuar me dyndjen e përdorimit të këtyre turqizimave në shkrimet e autorëve të shekullit IX. Kështu gjurmohen në vepra fjalë të tilla, si: vakt (kohë), mejdan (shesh), bahçe(kopsht),uzdajë, kazane, amanet, pasha, vezir, redif, temel, tullë, hesap, terezi etj.

(... shkaku i *uzdajës* së madhe për të mujtë me marrë...f. 25 / ...kish vu vetë çadra, , shtroje, *kazana*...f.168 / ... poshtë rrijshin *gjindja* gati me i pritë...f.36 / ...kush tue u fal a tue marrë *avdes*. f.138 / ... ishte *redif* që me të zi po ecte...f.135, /...mbas *akshamit* tue vijue...(f.33) /...por *xhandari* i shkretë...(f. 39) / ...veç të tjerash *kazani* asht tue vlue.(f.182)

Gjatë studimit konstatoam se shumë fjalë të burimit turk i gjejmë si forma të ngurosura si shprehje: bëj derman, s'ka gajle etj., dhe shumë fjalë turke sot kanë gjejëset e tyre në shqip.

### 2.3.Huazimet sllave

Pozicioni i sllavëve në gadishullin e Ballkanit afër trojeve shqipe, si dhe kontaktet e vazhdueshme të popullit shqiptar në këto troje, flet vetvetiu për një ndikim historiko-gjuhësor, sllave-shqiptare, që është i dukshëm por jo dominues në vepër. Ashtu siç thekson edhe Jorgji Gjinari : “...ato kanë pasur marrëdhënie e kontakte fqinjësie kryesisht me sllavët e jugut dhe që kanë lënë gjurmë të thella në të folmet shqipe.”<sup>258</sup>

Gjatë leximit të vepërës hasim fjalë të tilla që kanë ndikuar në leksikun e gjuhës së përdorur në vepër nga Justin Rrota. Janë hasur pikërisht këto fjalë: prak, oborr, rrafsh, breg, kosh, lopatë, zakon, strehë, kotec, sanë, pleh, patkua, grusht, trup, kockë etj..

(... ky suell me i ra atij *fëtyrës*...f.132 / ...përposë *trupit* të shëndetsis ... f. 137 / ...me i lanë *oborret* e veta. f. 57 / ... kanë zdrypë deri në *breg* të lumit. f. 138. / ... kalon një kal ngarkue me *kova* e *kosha* plot.... f. 157) / ...tue i ra fajtorit *shpines* e nder *shpatulla*.(f.69) / sa për *shtroje* e mobilje...(f.49) / kinse me gjetë *strehë* e shpëtim. (f.28)

### 3.Fjalësi i rrallë në përqsje me fjalorin e sotëm aktiv.

Sapo merr në dorë këtë krijim të Justin Rrotës, ajo që të bie menjëherë në sy, është pasuria e madhe e leksikut dhe larmia e tij. Ai e ka arritur këtë, duke përdorur *fjalë të vjetra (ose të huazuara)*, por që kanë kaluar në fjalorin pasiv, apo edhe në fjalë krahinore, pra që sot nuk kanë një përdorim në të folurin aktiv ose janë zevëndësuar me fjalë të tjera. Më poshtë po listojmë një listë emrash sipas rendit alfabetik, shoqëruar kjo edhe me një shpjegim që jepet nga fjalori.

#### B.

**Berr** –i m.sh.a, -at bagëti e imët.

...berrat e imta kahë s’kishin mujt me i a marrë...( f. 29)

**Britm** -ë–A.f.sh –a, -at Zë i fortë që nxjerr njeriu kur bërtet,thirrme e fortë.

...shumë kishin ngrykë foshnjat të cilat britshin. (f. 98)

**Batar**|e-ja f.sh ~ të. E shtënë me disa armë zjarri njëherësh.

...nga qyteti ndihej batarja e pushkëvet...(f.43)

**Blerës**i m.sh. ~it. Ai që blen diçka.( Në vepër haset në fjalën blesi)

**Binish**i m.sh. ~e, -et.--Xhybe e gjërë që vishnin hoxhallarët, pallto e gjërë prej xohe të mirë etj., binish lëkure.

<sup>258</sup> J.Gjinari, *Mbi disa elemente slave në të folmet veriore të Shqipërisë*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, Tiranë, 1972, f. 267.

... shiheshin gra me japanxe e me binish.(f. 98)

**C**

**Cofitin**\ë-a.f.sh. ~-a,~ -at. Ngordhësirë, kërmë. Ushqehet me cofëtina.

...lëshohen mbë ndonjë cofinë...(f. 36)

**Cokël**, ~la f.sh. ~la, ~lat. Copë e vogël druni;ashkël.

... kishin kenë shtupa e cokla e kalbsina. (f. 101)

**Ç**

**Çinar**\i .m.sh. ë(t) - rrap

... prej asaj lame luftimit me nga një degë çinarit mbi shpinë...(f. 56)

**Çikrrimtar**\i.m.sh.~ ë, ~ët.1.Ai që shiste çikërrima, tregtar a shitës çikërrimash.

2. Ai që merret me gjëra të vogla të parëndësishme.  
... e zuni me dorë te një çikrrimtar...(f. 56)

**D**

**Degam**\e-ja f - grindje me të bërtitura, shamatë, poterë.

...krisi fjala e degama e mësynë me i a nxjerrë...(f. 37)

**Dritësor**\e -ja, f.sh. ~-e(t) - dritare.

...kanë shkue sod nën dritësoret e bashkis...(f. 54)

**Dugajë**\ ja, f.sh. – vend ku tregtohet mall, dyqan.

...mos me u ble ndër dugajë as voj të mirë...(f. 35)

**G**

**Gapërr**. ndajf. - me sy të zgurdulluar e të ngulur në një pikë.

...sytë hapë gaper, këqyrin thik në një vend...(f.160)

**GJ**

**GJykator**\e, -ja,f.sh. -e(t) vjet. –ndërtesa e gjykatës.

...me u ra mbrapa punëvet në gjykatore. (f. 197)

**H**

**Handrak**\u .m.sh. ~-qe,-qet.Qelb.Handraku i plagës.

...pot a tham edhe vetë handrak ky e handrak ai...(f.24)

**k-**

**Kapicë**, ~a .f.sh. ~a, ~at.Grumbull i madh sendesh të hedhura në mënyrë të çrregullt;

këmesë

...gjatë parrucës kapicat e qendisuna n'ari...(f. 23)

**Korcullë** ~-eshë. f .sh. ~-a,~-at.Cumri, qefulli i verës pasi ka lëshuar vezët.

## J

**jepanxhe** - ( nuk shpjegohet në fjalor)

...kishin ardhë deri gra me jepanxha...(f. 98)

**Jamullia** .f.sh.-të. Mbulesë e leshtë, flokëse; batanije.

...bashkë me çarçafa...jamullia e faqe jestekësh.(f. 49)

## M

**Magazin**ë ~-a .f.sh. ~-a, ~-at. Ndërtesë e veçantë a depo ku mbahen mallra a sende të ndryshme që shpërndahen e tregtohen në dyqane, vend i veçantë a depo pranë një ndërmarrjeje, një qendër pune etj. ( Në vepër kemi të përdorur fjalën në formën “magaze”.)

...kanë msye gazet e pazarit të vjetër...(f. 34)

**O Ok**ë, -a f.sh. ~-ë, -ët. Njësi e vjetër peshe rreth një kilogram e gjysmë.

...një here të verdhë...oka e grunit...(f. 98)

## P

**Pre**ja.f. - Kafshë, shpend që e zë dhe e ha një tjetër; ajo që zëmë e vrasim kur dalim për gjah

ose kur peshkojmë, gjah.

...preja e plaçka zanë në këtë rasë...(f. 50)

**Ploj**ë, -a .f.bised. - gjakderdhje, kërdi.

...në t'ikun të tmeruenë nga gjaku e ploja. (f. 51)

**Përrosk**ë f.sh.-a,-at.Përrua i vogël; rrëke uji; përrua që zakonisht thahet në verë' përrua i tharë ose lug që formohet nga shirat në rrepirën e një kodre a të një malli.

... mbet n'atë rasë dekun atyne përroskavet...(f. 32)

## S

**Skutul**oj.kal.-ova, -uar - vë në një skutë, fsheh.

(Në vepër dëshmohet përdorur në fjalën skutuliqe.)

**Smundtore**- f.-e, -ja.sh.-e(t).( Në kuptimin spital, por që nuk shpjegohet në fjalor).

...gatuen në smundtoret së varruemish...(f. 49)

## Sh

**SHkapërda**j.kal. ~-va, ~-rë. Shpërndaj andej – këtej.

...ram bi të ngratë Shkodër topa që i shkapërdanë sa andej-kedej.(f. 149)

**T**

**Tag\ër~ri**.m.sh.~**ra,~rat**. E drejtë që ka një njeri për diçka.

...reklamue secili ato tagret e veta.(f.51)

**Tërshër\ë,~A**.f.sh. ~**a,~at**. Bimë e ngjashme me grurin, me kërcellë të hollë, të drejtë e të gjatë rreth një metër, me fara të mbledhura tufë të veshura me dy hala ose në trajtë dhëmbëzash që përdoren kryesisht për ushqim për fëmijë.

**U**

**Uzdaj\ë** ~A f.sh. ~**a,~at**. Shpresoj.E mban uzdaja.

...shkaku i uzdajës së madhe për me mujtë me marrë...  
(f. 25)

**V**

**Vad\ë, -ja**.f. Afat kohe. i ka shkue vadj.

...vadj e armëpushimit tashma kishte kalue. (f. 120)

**3. Pasuri leksikore fetare (kishtare).**

Atë Justin Rrota, duke qënë një klerik i devotshëm, përdori në leksikun e tij, shumë fjalë që i përkasin fjalorit aktiv klerik. Në këtë çështje vendosëm të ofrojmë një pasqyrim të terminologjisë fetare që kemi ndeshur gjatë hulumtimit leksikor të kësaj vepre me karakter historiko-letrar.

**Besimtar-i, em**<sup>259</sup> - Njeriu që beson në Zot, perëndi, fe, në dokmat e një feje të caktuar, dhe i zbaton ato.

...ti nderojmë të gjithë *besimtarët*...(f. 181)

**Bekoj**<sup>260</sup> - I jap dikujt ose më jep dikush hirin e perëndisë et ë Zotit, me kryq e me fjalë, jap bekim; spërkas me ujë të bekuar dhe them lutje drejtuar Zotit.

**Dioqezë**<sup>261</sup> - a, ef, geg .dioçez - juridiksion, krahinë në të cilën kryen funksionet e veta shpirtërore

një ipeshkv a një prelat.

...u ndikue nga propaganda e *dioqezës*...(f.12)

**Ëngjëll-i,**<sup>262</sup> em - lajmëtar

...fëmija e njomë...të këputshin shpirtin...*engjej* të shuplakës së luftës. (f. 31)

<sup>259</sup> F. Luli, *Fjalor biblik dhe i termave kishtare*, "Camaj-Pipa", Shkodër, 2004 f. 91.

<sup>260</sup> Po ai, po aty, f. 87.

<sup>261</sup> Po ai, po aty, f. 112.

<sup>262</sup> Po ai, po aty, f. 135.



**Famulli-a**, em<sup>263</sup> - Juridiksion kishtar i një famulltari; njësia më e vogël administrative e organizimit kishtar në një krahinë të caktuar.

...kishte zanë mbrendë në qytetin e rrethuem në *famullin* e Lezhës.  
(f. 118)

**Fe-ja, ef.**<sup>264</sup> - Besim në Zot dhe në mësimet e tij, në atë mënyrë që gjithçka drejtohet e caktohet nga forca e tij dhe ajo hyjnore.

...sa për punë të *fesë* e të besimit...(f.181)

**Juridiksion-i, em**<sup>265</sup> - Sfera brenda së cilës ushtrohet veprimtaria fetare e një kleiku, vendi, rrethi

Nuk mbeti kush pa kja ndër katolik në *juridiksion*...(f.150)

**Kishë-a, ef.**<sup>266</sup> - Ndërtesa ku zhvillohen shërbesa fetare.

...tue shkatërrue e tue shkretue banesa...*kisha* e institucione.(f.143)

**Kleri**<sup>267</sup>, **em** - Tërësia e personave që marrin pjesë në një urdhër meshtarie.

... tue u përshkue ndonjë pjesëtar i *klerit*... (f.66)

**Lterit**<sup>268</sup>, **em** - Vendi ku adhurohet e flijohet; vend ku çohet mesha, altar.

...pullazi e *lteret* shumica kjenë çartë.(f.150)

**Lutje**<sup>269</sup>-**a, ef.** - Fjalë a shprehje që i drejtohet Zotit e shenjtëve për ndihmë.

...mos me e prekë ma as *lutjet*, as ankimet...(f.38)

**Paqe**<sup>270</sup>-**ja, ef.** - Qetësia shpirtërore e besimtarit kristian në relacion dhe në raport me Zotin; i besimtarit me të gjithë njerëzit, pajtim midis njerëzve.

...ka vu me ta armëpushim e një fare *paqet*.(f.72)

**Uratë**<sup>271</sup>-**a, ef** - Lutje në të cilën prifti shpreh disa dëshira për besimtarët e vet, lutje që shprehin vetë besimtarët drejtuar Zotit, Krishtit, shenjtëve për t'i ndihmuar, për t'i lehtësuar mëkatet e tyre.

...shumë priftën u detyruan të largohen *me uratë*...(f.10)

**Zot**<sup>272</sup>-**i, em.** - Qenia superior më e lartë, e madhërishme, e mbinatyrshme, hyjnore që ka krijuar gjithësinë, botën e qëndron mbi të gjitha e mbi gjithçka, drejtuesi dhe rrejtesë i gjithësisë.

Ndërtesa shkatërrue...ndihmoi *Zot!* (f. 57)

<sup>263</sup> Po ai, po aty, f. 144.

<sup>264</sup> Po ai, po aty, f.144.

<sup>265</sup> Po ai, po aty, f.177.

<sup>266</sup> Po ai, po aty, f.192.

<sup>267</sup> F.Luli, *Fjalor biblik dhe i termave kishtare*, "Camaj-Pipa", Shkodër, 2004, f. 194.

<sup>268</sup> Po ai, po aty, f.194.

<sup>269</sup> Po ai, po aty, f. 242.

<sup>270</sup> Po ai, po aty, f. 316.

<sup>271</sup> Po ai, po aty, f. 482-483.

<sup>272</sup> Po ai, po aty, f. 488.

**PËRFUNDIME:**

Punimi në fjalë synoi të trajtojë çështje gjuhësore që dalin gjatë studimit të veprës së intelektualit të mirënjohur Justin Rrota. Siç u vu re ky trajtim është bërë në funksion të studimit të veçorive leksikore. Justin Rrota paraqitet si një personalitet i fuqishëm i letrave shqipe, që dha një shembull të shkëlqyer të punës së shkrimtarit me atë të historianit.

Gjallëria e shprehjeve, përshtatshmëria e fjalëve, gjallëria e fjalorit të tërheqin vëmendjen. Gjuha e tij, është gjuha e një shkrimtari, i cili jetoi me dëshirën e një kleri që të pasuronte leksikun e gjuhës shqipe. Çuditërisht nga materiali kemi nxjerrë edhe disa fjalë, të cilat nuk shpjegoheshin në fjalorin e gjuhës shqipe. Rrota shkroi një gegërishte, siç e shohim në përdorimin e disa fjalëve të leksikut.

E rëndësishme është të pohohet se Rrota kontribuoi edhe për pasurimin e fjalorit, me rigjallërimin edhe të disa fjalëve dialektore dhe të frazeologjisë.

Me materialin që patëm në përdorim arritëm jo vetëm të përfshihemi në ngjarjet e tmerrshme dhe makabre që përjetoi populli shkodran, por patëm edhe kënaqësinë të afrohemi dhe të studionim stilin e shkrimit që përdori Justin Rrota në këtë ditar, duke dëshmuar edhe një herë se ai radhitet në një nga perlat më të çmuara të kolanës së shkrimtarëve shqiptarë e veçanërisht shkodranë.

**BIBLIOGRAFI:**

1. Akademia e shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë 1980, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe 1980*.
2. D.Kurti, *At Justin Rrota, biografi*, Botime Françeskane, Shkodër, 1964.
3. J.Gjinari, *Mbi disa elemente slave në të folmet veriore të Shqipërisë*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, Tiranë, 1972 .
4. F. Luli, *Fjalor bibliik dhe i termave kishtare*, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2004  
VEPRA  
Botime françeskane, *Ditët e mbrame të turqisë në Shkodër ase rrethimi i qytetit 1912-1913, Botimi I, Shkodër 2010*.

**The lexicol surveys in the work “ Ditët e mbrame të Turqisë në Shkodër ase rrethimi i qytetit 1912-1913” by author Justin Rrota**

***SUMMARY***

J. Rrota's literary work is a historical testimony of his native dialect.

The paper will focus at the treatment of on occurrence of linguistic character, about lexicol\_surveys in the historical work “*Ditët e mbrame të turqisë në Shkodër ase rrethimi i qytetit 1912-1913, Botimi I, Shkodër 2010*” writer by Justin Rrota a geg clerical. It will be the analysis of the words in this work. In this scientific special study we have tried to show up specially special cases of the words. The words of interest are divided into two group:

a-native words b-words of foreing sources

At the some time, in this work we well focus on the use of some clerical religious words and of some words that nowadays are not used anymore in geg dialect,which have passed to the passive language or are substituted with other words or terms. The used methodology is based on observation, research and identification of the analyzed of the words in this work. Such this study is intendet to serve not only to the Albanology researchers but also to the other linguistic disciplines.

Sokol AXHEMI

## TIPARE TË LËVIZJEVE MIGRATIVE NË TERRITORET NDËRKUFITARE ME SHQIPËRINË. EVOLUCIONI I TYRE

### *Hyrje*

Popullsia dhe tiparet e saj në kuadrin e zhvillimit të hapësirave të ndryshme sociogjeografike, kanë tërhequr në vazhdimësi interesin e studiuesve të ndryshëm dhe të shkollave gjeografike evropiane dhe më gjerë. Në mënyrë të veçantë, elemente të spikatura të veprimtarisë dhe aktivitetit të popullsisë, kanë ndikuar në krijimin e impakteve të rëndësishme demografike, ku një ndër tematikat e veçanta të studimeve të popullsisë, është ajo që lidhet me zhvendosjet e popullsisë nga një hapësirë në tjetrën. Ajo sot është mjaft e evidente dhe në qendër të vëmendjes të gjeografëve, përfaqësues të këtyre shkollave gjeografike.

Migrimi dhe lëvizjet migrative përfaqësojnë sot në tërësinë e lëvrimit të tyre, një ndër çështjet studimore më interesante në disa drejtime.

*Së pari*, për larminë e shfaqjes së tyre në lloje, përmasa e forma të ndryshme. Njëkohësisht për rolin e shumë faktorëve pjesëmarrës dhe ndikues në këto lëvizje migrative të popullsisë.

*Së dyti*, për ndikimin e madh që luajnë migrimet në zhvillimet e popullsisë të vendeve të origjinës dhe ato të vendeve destinacion. Këto ndikime janë mjaft të dukshme, sidomos në numrin e popullsisë, strukturat moshore e gjinore të popullsisë, në strukturat urbane dhe rurale të hapësirave të ndryshme sociogjeografike, në vendet dhe funksionet sociale, etj.

*Së treti*, në domosdoshmërinë e njohjes dhe të marrjes së politikave të ndryshme, që lidhen me lëvizjet migruese të popullsisë dhe me migrantët. Në mënyrë të veçantë, një domosdoshmëri e tillë po bëhet gjithnjë e më shumë e nevojshme me situatat aktuale të ndikimeve të lëvizjeve migruese të popullsisë së vendeve të ndryshme, drejt vendeve të BE-së.

Krahas tyre evidentojmë edhe natyra të tjera të lëvizjeve migruese. Një lloj i veçantë migrimi, është ai i shprehur me lëvizjet e popullsisë ndërmjet vendeve fqinje dhe territoreve ndërkufitare. Përmasat dhe

dimensionet e këtij lloji migrimi, janë nga më të ndryshmet në regjione të ndryshme të Evropës dhe më gjerë. Ne jemi ndalur në analizën e këtij lloji migrimi, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje me të. Fokusi i analizës sonë, është orientuar drejt vendeve fqinje të Shqipërisë, si: Greqia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova. Analizat tregojnë të dhëna mjaft interesante në lidhje me format e shfaqjes së këtyre lëvizjeve migrative, faktorëve ndikues, rolit që ato luajnë në popullsitë respektive të origjinës së tyre dhe të vendeve ku ata migrojnë.

Materiali i paraqitur përfshin një numër të konsiderueshëm të dhënash të përftuara nga studimet dhe anketimet e ndryshme të realizuara. Njëkohësisht në material përfshihen një numër tabelash që evidentojnë të dhëna interesante të lëvizjeve migruese në territoret ndërkufitare me Shqipërinë. Në përfundim të punimit jepen edhe disa konkluzione lidhur ngusht me politikën migratore, fryt i studimeve të realizuara.

### **Tiparet migrative të lëvizjes ndërkufitare të popullsisë shqiptare**

Lëvizjet ndërkufitare të shqiptarëve drejt territoreve fqinje, kanë njohur një evolucion të gjatë zhvillimi dhe janë prezente në vite të ndryshme, pjesë e periudhave të zhvillimit të historisë së marrëdhënieve ndërshtetërore, të cilat kanë ekzistuar ndërmjet vendit tonë dhe vendeve fqinje. Gjatë periudhës së viteve 1945-1990, nën petkun e “etiketimit” i paligjshëm, duhet theksuar se shpeshherë ky lloj migrimi, për disa familje shqiptare, solli ngjarje të trishtueshme e tragjedi mjaft të rënda. Megjithatë, popullsia ndërkufitare me vendet fqinje, gjatë tërësisë së zhvillimeve ndërkufitare, ka pasur edhe tendencë të marrëdhënieve të “fshehta” në drejtime të ndryshme, por spikasin më shumë elementet ekonomike dhe sociale (kryesisht shëndetësore). Elemente të këtij bashkëpunimi ndërkufitar i gjejmë në mjaft shënime udhëtimi dhe historike të autorëve të ndryshëm, kryesisht, historianë, të cilët janë marrë me analiza historike të këtyre marrëdhënieve ndërkufitare.

Por në mënyrë të veçantë ato kanë qenë më të shprehura pas viteve ‘90, lidhur ngusht me situatat e reja të zhvillimeve politike të pranishme në këtë periudhë tranzicioni demokratik në Shqipëri. Duhet evidentuar fakti se gjatë periudhës së viteve 1945-1990, lëvizjet e popullsisë shqiptare drejt territoreve fqinje, kanë qenë tërësisht të limituara lidhur ngusht me problematikat e shfaqura në marrëdhëniet ndërshtetërore që kemi pasur me vendet fqinje. Marrëdhëniet e tensionuara dhe mjaft konfliktuale me to, krijojnë pengesa të rëndësishme për një lëvizje të lirë të shqiptarëve (madje edhe në trojet shqiptare përtej kufirit).

Gjithsesi vlerësojmë se në mënyrë sporadike ekzistonin kontakte të karakterit zyrtar, diplomatik. Pas viteve '70, kemi edhe njëfarë gjallërimi të marrëdhënieve kulturore e sportive me disa prej këtyre vendeve. Lidhjet e krijuara ishin të shfaqura kryesisht në shkëmbime të ndërsjellta në fusha të caktuara, siç ishin arsimi, arti, kultura, sporti, etj. Përmendim me këtë rast shkëmbimet akademike me ish-Jugosllavinë e dikurshme, shkëmbimet kulturore të ansambleve artistike me Kosovën, Greqinë, të aktiviteteve të ndryshme sportive, siç ishin Ballkaniadat, apo aktivitete sportive ndërshtetërore, etj.

Pas vitit 1990, në periudhën e tranzicionit, me ndryshimin e sistemit ekonomik e politik në Shqipëri, padyshim ashtu si edhe në drejtime të tjera të jetës dhe veprimtarisë së grupeve të ndryshme sociale në vendin tonë, kemi risi në drejtim të lëvizjes së tyre edhe jashtë kufijve të vendit. Përtej një izolimi shumëvjeçar, tendencat e lëvizjes së popullsisë, u orientuan kryesisht drejt vendeve të zhvilluara evropiane dhe më gjerë. Mesa duket një orientim i tillë ishte i ndikuar jo vetëm nga fakti i pranisë së mundësive ekonomike më të favorshme për shqiptarët dhe familjet e tyre, por edhe me simbolikën politike e gjeopolitike të këtyre vendeve në mentalitetin dhe formimin e deriatëhershëm të popullsisë shqiptare. Këto vende përfaqësonin "idhuhdin" e demokracisë e të jetës së re, që ato synonin të ndërtonin.

Statistikat dhe të dhënat e ndryshme të përfutuara nga studimet e lëvizjeve migrative të popullsisë shqiptare pas viteve '90, tregojnë edhe për një lloj tjetër migrimi të shfaqur në këtë periudhë, pavarësisht se është tëpër e vështirë për të përcaktuar fluksin migrator në përgjithësi, apo elemente të sakta që lidhen me të. Studiuesit vlerësojnë dhe identifikojnë faktin e migrimit ndërkuftar, të shprehur me një tendencë migrative në vendet fqinje, kryesisht me Greqinë, Maqedoninë, Malin e Zi, si dhe vitet e fundit në drejtim të Kosovës. Njëkohësisht vlen të përmendet, se tipari kryesor i këtij lloji migrimi, është ai tranzitor ose i përkohshëm. Në përcaktimin e tij, janë marrë në konsideratë fusha e veprimtarisë dhe e shfaqjes së tij, periudha që bart ky tip migrimi, etj. Në tërësinë e vet ky lloj migrimi është i shfaqur në lëvizjen e popullsisë shqiptare, kryesisht të organizuar në grupe, por edhe në mënyrë individuale drejt territoreve të Greqisë, Malit të Zi dhe të Maqedonisë. Periudha e lëvizjes së tyre është e lidhur ngusht me periudha të caktuara gjatë vitit. Këtu një rol të rëndësishëm luan vendi ku orientohet kjo lëvizje migruese dhe periudha e lëvizjes. Të dy këto elemente janë të ndikuara nga faktori ekonomik, nevoja për krahë pune, sidomos në sektorë të tillë, si: bujqësia, blegtoaria, ndërtimi, shërbimet dhe turizmi.

Ky tip migrimi, në mënyrë të veçantë, më i përhapur, është pas vitit 1997, i lidhur ngusht edhe me rritjen dhe intensifikimin e lëvizjes së popullsisë shqiptare në drejtim të këtyre vendeve, ndikuar nga situatat ekonomike dhe politike që po kalonte edhe vendi në atë kohë. Kjo lëvizje e popullsisë shqiptare e orientuar gjatë këtyre viteve, ka ndjekur trende të ndryshme zhvillimi. Me sa duket një gjë e tillë ka qenë e lidhur ngusht edhe me zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve, nevojave të shfaqura nga ana e tyre për krahun e punës, etj. Pra kryesisht faktori ekonomik ka qenë evident dhe prioritet. Nevojat e fqinjëve tanë, kryesisht të Greqisë, kanë qenë të lidhura me punët e ditës në bujqësi, gjë që kërkonte krahë pune të lirë (që atyre u vinte kryesisht nga migracioni shqiptar), përtej kufirit. Duhet vlerësuar, se një rol të rëndësishëm kanë luajtur në këtë valë migrative tranzitore të përkohshme edhe migracioni shqiptar i vendosur në Greqi (menjëherë pas fillimit të migracionit shqiptar masiv pas vitit 1990). Familjarë të ndryshëm shqiptarë, pjesë të këtij emigracioni, tërhiqnin migrantë të tjerë nga Shqipëria, si në kuadrin e migrimit të përhershëm, ashtu edhe atij të përkohshëm. Një situatë e tillë migrative, më e përhapur ka qenë kryesisht në territoret ndërkufitare me Shqipërinë.

Në territoret kufitare me Maqedoninë, ashtu si edhe në rastin me Greqinë, këto lëvizje tranzitore të përkohshme më shumë janë të lidhura me sektorin e bujqësisë dhe të ndërtimitarisë. Duhet të theksojmë, që statistikisht tregojnë, se pjesë të popullsisë shqiptare kufitare me territoret me Maqedoninë, rezultojnë si migrantë të këtij tipi, duke punuar kryesisht në zonat rurale përtej kufirit. Ndërsa në territorin e Malit të Zi, oferta për krahë pune është e lidhur ngusht me sferën e ndërtimitarisë dhe sidomos me fushën e shërbimeve turistike, si pasojë edhe e fluksit të lartë turistik me të cilin përballen territoret e Malit të Zi. Për fushën e bujqësisë, një gjë e tillë mbart shifra sporadike dhe të kufizuara. Në tërësinë e kësaj marrëdhënieje ndërkufitare migrative, ka gjetur një shprehje të veçante edhe migracioni tranzitor ndërkufitar me Kosovën, si rrjedhojë e ndryshimit të situatës politike në Kosovë, sidomos pas vitit 1999. Gjithashtu, kanë luajtur një rol të rëndësishëm për marrjen e krahut të punës nga Shqipëria, nevojat dhe kërkesat e shumta në fushën e ndërtimit dhe të bujqësisë në vendet fqinje. Këtu është e përfshirë edhe një pjesë e popullsisë kufitare me Kosovën.

Në kuadrin e shpërndarjes gjeografike të migracionit ndërkufitar vlerësojmë se ndeshim disa tipare dhe karakteristika mjaft interesante. Popullsia në këto lëvizje migrative kryesisht është popullsi banuese kufitare me vendin kufitar migrues. Kështu në rastin e popullsisë migratore tranzitore drejt Greqisë, janë pjesë e popullsisë kufitare me territoret greke përtej kufirit. Kryesisht është popullsia rurale e Devollit, Gjirokastrës,

Libohovës, Sarandës dhe në pozita mjaft të ulëta nga pikëpamja e numrit, është popullsia e fshatrave apo qyteteve të tjera të vendit. Këto të fundit janë përthithur vetëm në rastet kur ato përfshihen në lëvizje migrative, nga migracioni i hershëm i fillimviteve '90, i cili është i vendosur në territoret kufitare greke dhe që ju krijon mundësi punësimi në situatë “piku” ekonomik (agrimet, ndërtimtaria turistike, etj.).

Popullsia migrative e orientuar drejt territoreve maqedonase, më shumë përfshin popullsinë kufitare me të, atë të Pogradecit e deri diku atë të Korçës, si dhe të zonave rurale të Dibrës. Shpeshherë popullsia rurale e këtyre zonave orientohet të lëvizë në trajtën e grupeve sociale, nën emërtimin migrantë, me drejtim të përcaktuar në territorin e Maqedonisë. Madje një pjesë e mirë e tyre vendosën të punojnë në territoret shqiptare përtej kufirit. Me përjashtime të rralla mund të hasen në këto grupe sociale, popullsi migrante të ardhura nga territore të tjera të Shqipërisë.

Popullsia migratore drejt Malit të Zi, si orientim njih origjinën e saj nga popullsia rurale e territoreve të Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe. Karakteristikë e tyre është përfshirja në punët e ditës në bujqësi blegtori, ndërtimtari e shërbime turistike, kryesisht në popullsinë shqiptare të Malit të Zi, ku vendet me frekuencë më të madhe migratore janë ato të Tuzit dhe të Ulqinit e deri diku të Tivarit (apo Barit, siç quhet sot). Një përhapje sporadike e tyre dhe mjaft e kufizuar evidentohet edhe në territoret e Plavës dhe të Gucisë, kryesisht me popullsinë e zonës së Këlmendit.

Frekuenca migratore e popullsisë së Shqipërisë drejt Kosovës më shumë është e përqendruar në territoret kufitare rurale të Tropojës dhe të Kukësit. Në dallim nga popullsia migratore që orientohet drejt vendeve kufitare me popullsinë shqiptare të origjinës, popullsia migratore shqiptare drejt Kosoves, ndjek një trajektore të gjerë migrimi. Ajo nuk vihet re vetëm në territoret kufitare të tilla, si: Prizreni apo Gjakova, por është e pranishme edhe në territore të tjera të Kosovës, ndonëse si fluks migrativ është tranzitor. Ndikim të konsiderueshëm në këtë drejtim, luan fakti i migrimit të madh kosovar drejt vendeve evropiane, gjë që sjell detyrimisht nevojën për krahë pune në bujqësi, blegtori e deri diku në ndërtimtari.

### **Efektet e lëvizjeve migrative ndërkufitare**

Si rezultat i këtyre lëvizjeve migrative të grupeve të ndryshme sociale në drejtim të vendeve fqinje, kemi praninë e një sërë efektesh të shfaqura në drejtime të ndryshme në tërësinë e grupeve sociale të migrantëve ndërkufitarë shqiptarë. Drejtimet kryesore më të spikatura janë ato të karakterit kryesisht demografik, social e ekonomik dhe bashkëpunimet ndërmjet tyre e bëjnë më interesant, jo vetëm faktin e



pranisë së këtyre efekteve në këtë popullsi migratore, por edhe si një domosdoshmëri për ta njohur dhe analizuar nga pikëpamja shkencore.

Drejtimi demografik i efekteve të lëvizjeve migrative ndërkufitare të popullsisë shqiptare drejt vendeve fqinje gjen shprehjen e vet kryesisht në raportet strukturore të popullsisë, pjesë përbërëse e këtyre lëvizjeve migrative. Në mënyrë të veçantë ajo është mjaft e ndjeshme dhe prezente në tërësinë e strukturave të popullsisë, pavarësisht ndryshimeve të vërejtura në peshën specifike të tyre që paraqitet e larmishme. Kështu vërejmë ndikimet e tyre në strukturat gjinore, moshore, profesionale dhe të strukturës së vendbanimeve të kësaj popullsie migratore.

Rastet e studiuara në kuadrin e strukturës moshore të popullsisë migratore ndërkufitare janë mjaft të qarta. Në këto tipe migrimesh më të prekura janë moshat e reja dhe të mesme të popullsisë. Në këtë mënyrë ruhet trendi i përgjithshëm tashmë i njohur në studimet ndërkombëtare migrative se këto lloj moshash janë më të prekura nga lëvizja migrative. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim me sa duket luan edhe situata socialekonomike e vendit tonë, e ndikuar nga problematikat e shfaqura në papunësinë dhe varfërinë e kësaj kategorie moshore të popullsisë. Më të prekura nga papunësia në vendin tonë, janë grupet sociale të rinisë dhe shtresa e mesme e popullsisë. Njëkohësisht një gjë e tillë është mjaft pranishme edhe në zonat rurale. Madje në këto zona, nisur edhe nga fakti i një jorentabiliteti financiar pozitiv në drejtim të të ardhurave që përfitohen nga puna në bujqësi e blegtori në zonat e tyre rurale, tentojnë migrimin ndërkufitar, aty ku mundësitë dhe përfitimi është më i madh.

Njëkohësisht kemi edhe linja të qarta edhe përsa i përket elementeve të strukturës gjinore, pjesëmarrëse në këto migrime ndërkufitare. Prania më e madhe evidentohet në kuadrin e pranisë së lëvizjes migrative të popullsisë mashkullore. Sidomos mjaft e shprehur kjo mënyrë e një raporti të tillë gjinor vihet re në popullsitë ndërkufitare të Shkodrës, Malësisë së Madhe, Dibrës, etj. Vlerësojmë se në këtë tip të migrimit ndërkufitar, ndonëse në mënyrë sporadike aty-këtu, vihet re edhe prania e strukturës gjinore femërore. Kjo është e dukshme sidomos në zonat rurale të Pogradecit dhe të Gjirokastrës, ku migrimi ndërkufitar shfaqet si mënyrë e migrimit familjar për punët e ditës në bujqësi dhe blegtori. Kryesisht një bashkëpunim i tillë i migrimit ndërkufitar me atë familjar vihet re në fshatrat matanë kufirit të Maqedonisë dhe të Greqisë.

Mjaft interesante nga pikëpamja studimore shkencore paraqitet analiza e strukturës profesionale të popullsisë migratore ndërkufitare. Vlerësojmë se në përgjithësi kjo popullsi migratore shoqërohet me një shkallë kualifikimi të kufizuar. Njëkohësisht nga pikëpamja profesionale,

ajo ndonëse jo e profilizuar nga pikëpamja e ndjekjes së shkollave të veçanta profesionale, dallohet për mundësinë e realizimit të kërkesave nga ana e strukturave private matanë kufirit, të cilat kërkojnë krahë pune. Gjithashtu ndonëse profilizimi i përcaktuar i tyre që ofrohet nga ato vetë është bujqësia e blegtoria, kemi edhe praninë e një numri apo spektri profesional më të gjerë, ku shprehen aftësitë e kësaj popullsie migratore. Në këtë mënyrë shpeshherë këtë popullsi migratore ndërkufitare e shohim në realizimin e punëve të tilla, të cilat nuk kanë lidhje me bujqësinë e blegtorinë. Profesionet e tjera ku ato ushtrohen, janë të lidhura me mirëmbajtjen e shtëpive dhe të punëve shtëpiake, ndërtimtarinë, fushën e shërbimeve, etj.

Struktura e popullsisë migratore ndërkufitare në aspektin e strukturës së vendbanimeve, dallon për mbizotërimin e popullsisë rurale. Një mbizotërim i tillë është thuajse i pranishëm në tërësinë e territoreve ndërkufitare, ku ky tip migrimi është i pranishëm. Përjashtim deri diku paraqet në këtë rast zona e Devollit, ku një pjesë thuajse e papërfillshme e popullsisë qytetare të Bilishtit, është e përfshirë në këtë lëvizje migratore ndërkufitare.

Një drejtim tjetër mjaft i rëndësishëm i efekteve të lëvizjes migratore ndërkufitare, është ai ekonomik. Sidomos efekti ekonomik është mjaft i rëndësishëm dhe i ndjeshëm në hapësirën socio-gjeografike ku banon kjo popullsi migratore, ose siç quhet ndryshe në vendin e origjinës. Pamundësia ekonomike, mungesa e vendeve të punës dhe mos sigurimi i të ardhurave për jetesë, siç e përmendëm më sipër, përfaqëson faktorin kryesor të lëvizjes migratore ndërkufitare të kësaj popullsie, që migron në mënyrë tranzitore.

Nëpërmjet punësimit në territoret ndërkufitare, matanë kufirit shqiptar, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe të shërbimeve, krijohen të ardhura deri diku të mjaftueshme dhe tepër të nevojshme për ekonominë individuale dhe familjare. Në këtë mënyrë një gjë e tillë ka ndikuar dukshëm në rritjen e mundësive ekonomike të një pjese të familjeve shqiptare, të përfshira në këtë lëvizje migratore ndërkufitare. Tregues të rëndësishëm të një situatë të tillë, janë edhe ndryshimet e pranishme të rëndësishme në vendet sociale të banimit, ku evidentohen përmirësime dhe ndërtime vendbanimesh të reja nga ana e tyre. Një gjë e tillë është mjaft e dukshme në zonën e Malësisë së Madhe, të Muriqanit e Anës së Malit në Shkodër, të Maqellarës në Dibër, në disa fshatra të Libohovës në Gjirokastrë, në territoret rurale ndërkufitare të Pogradecit e Korçës, etj.

Efektet sociale të migrameve ndërkufitare janë multidimensionale. Në tërësinë e zhvillimit të tyre duhet vlerësuar rritja dhe pasurimi i grupeve

sociale, pjesëmarrëse në këto lëvizje migrative. Kështu krahas grupit social të migrantëve të përhershëm krijohet dhe zhvillohet grupi social i migrantëve të përkohshëm. Lidhur ngusht me zhvillimin dhe evolucionin e këtij grupi social, pasurohen edhe veprimtaria dhe aktiviteti i tyre social. Një gjë e tillë çon në lindjen dhe zhvillimin e funksioneve të reja sociale, siç janë ato të prodhimit, shkëmbimit dhe të argëtimit. Individët përfaqësues të këtyre grupeve sociale të migrantëve, mësojnë dhe përsosin aftësitë e tyre profesionale. Ata përfitojnë njohuri të reja profesionale dhe profesione të reja, të cilat mbarten nga vendi ku ata migrojnë, si pjesë e zhvillimit social e kulturor të tyre për në vendin e origjinës, etj.

### **PËRFUNDIME:**

Nga materiali i analizuar më sipër për migrimin ndërkufitar të popullsisë shqiptare, mund të arrijmë në disa përfundime të rëndësishme:

- Migrimi ndërkufitar përfaqëson një tip të ri migrimi për popullsinë shqiptare. Kryesisht është i përhapur në popullsinë ndërkufitare shqiptare pranë kufirit me Malin e Zi, Maqedoninë, Greqinë dhe Kosovën.
- Nga pikëpamja e shpërndarjes gjeografike, territoret shqiptare që shërbejnë si vend i origjinës së kësaj popullsie migratore, janë popullsitë ndërkufitare me Malin e Zi (në zonat rurale të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe), pranë kufirit me Greqinë (në territoret rurale të Devollit, Korçës, Gjirokastrës e Sarandës), pranë kufirit me Maqedoninë (në territoret e Dibrës, Pogradecit), me Kosovën (në territoret e Kukësit dhe Tropojës), etj.
- Faktorë kryesorë ndikues në lindjen dhe zhvillimin e lëvizjes migratore ndërkufitare, paraqitën faktorët ekonomikë dhe socialë. Në mënyrë prioritare më prezent është faktori ekonomik, ndikuar nga mungesa e vendeve të punës dhe situata mjaft e shprehur e pamundësisë për të realizuar të ardhura ekonomike individuale dhe familjare.
- Migrimi ndërkufitar i popullsisë shqiptare drejt territoreve ndërkufitare fqinj (Greqi, Maqedoni, Mali i Zi, Kosovë), shoqërohet me mjaft efekte të rëndësishme për këtë popullsi migratore. Ndër efektet më të spikatura janë ato demografike, ekonomike dhe sociale. Në efektet demografike ndikimi është më i dukshëm në tërësinë e strukturave moshore, gjinore, profesionale dhe të vendbanimeve të popullsisë. Studimet dhe analizat migrative të kësaj popullsie migratore ndërkufitare, përcaktojnë se pjesë e këtij procesi, janë kryesisht moshat e reja dhe të mesme të popullsisë, pjesë e gjinisë mashkullore në

kuadrin e strukturës gjinore. Njëkohësisht struktura profesionale mbizotëruese është bujqësia, blegtoria, ndërtimtaria dhe shermet, të cilat i mbart në pjesën dominuese popullsia rurale që përfaqëson edhe furnizuesen kryesore të popullsisë migratore ndërkufitare.

- Efektet ekonomike janë të lidhura ngusht me rritjen e të ardhurave ekonomike të familjeve të këtyre migrantëve ndërkufitarë, që njëkohësisht krijojnë mundësi evidente të efekteve sociale në jetën e tyre. Sidomos këto efekte sociale transmetohen si pjesë e lindjes së grupit të ri social të migrantëve ndërkufitarë të përkohshëm, pasurojnë vendet dhe funksionet e tyre sociale.

#### LITERATURA:

1. Axhemi, Sokol *Aspekte ekonomike, sociale e demografike të territoreve kufitare të rajonit të Shkodrës*. Studime Gjeografike, nr.15, 2005.
2. Banka e Shqipërisë, Buletini indekseve [www.bsh.gov.al](http://www.bsh.gov.al)  
[www.bankofalbania.org/web/Statistika\\_Hyrje\\_230\\_1.php?](http://www.bankofalbania.org/web/Statistika_Hyrje_230_1.php?)
3. Barjaba Kosta, Dervishi Zydi, *Emigracioni shqiptar. Hapësira, koha dhe shkaqet e migrimit*.
4. Perrone Luigi (1992): *Studime-Etudes Migrim* 29 (107) 513-537.
5. Bufon, Milan (2013): *The Slovenian borderlands between integration and marginality* University of Lodz: Region and regionalism, nr.11. vol. 2.
6. Jano, Doria: *Rishqyrtimi i politikave imigratore të BE-së ndaj Shqipërisë. Zbutja e asimetrive*. ACFR. Botim i Soros 2010.
7. Gintare, P. & Daugirdas, V. (2013): *The border's influence on peripherality. Case study of the Lituianian - Belarussian border regions*. University of Lodz: Region and regionalism, nr.11. vol. 2.
8. Grup autorësh: *Shqipëria. Zhvillimi urban, migrimi dhe ulja e varfërisë* Raporti nr. 40071 - AL 19 qershor, 2007, Banka Botërore.
9. Sjoberg, O & Wyzan, M. L (1991): *Economic change in the Balkan States: Albania, Bulgaria, Romania and Yugoslavia* Pinter, Londër.
10. Ulqini, Kahreman (1995): *Organizimi i vjetër shoqëror te shqiptarët*. Monografi, Shkodër.
11. Rrotani, P, Rrotani, L.(1998): *Kelmendi dhe kelmendasit*. Botim “Shkodra në Shekuj”. Vëll II, 1998.

---

**Features migrative movements in the territories border with Albania.  
Their Evolution**

***SUMMARY***

In the following article attempts have been made by the author to present the migrative situation at cross-Albanian population. Its main purpose is to record this migrative movement, as an integral part of the entire Albanian migration in the period of transition. The paper focuses primarily on cross-border migrative movements period after 1990. The article is divided into three main parts, in which the author presents the factors influencing the movement ktyre migrative, their geographical distribution, the main features and effects incurred as a result of migration. Simultaneously at the end of the article presented some important conclusions, as a result of analysis conducted for cross-border migrative movements Albanian population.

Nevila DIBRA

## INTEGRIMI I TURIZMIT NATYROR E ATIJ KULTUROR NË ZONAT PRANE RRUGËS ANTIKE VERIORE ADRIATIK - DARDANI

Aktiviteti turistik përgjithësisht përfaqëson një forcë zhvillimi për rajonet ku ai funksionon. Ky efekt merr një vlerë akoma më të madhe kur realizohet në zona të pazhvilluara, apo që janë në krizë ekonomike, siç është edhe rasti i një zone rurale apo malore, e cila sot është e përfshirë nga një krizë e përgjithshme bujqësore, tipike për mbarë botën.

Ekonomitë rurale sot ndeshen me problemin e çvalorizimit të tyre dhe roli i zonave rurale ka ndryshuar nga prodhues të produkteve bujqësore, në kujdestarë të stilit të jetesës, peizazheve e traditave të tyre. Turizmi dhe rekreacioni kanë luajtur një rol të rëndësishëm në transformimin e ekonomive rurale nga sektori privat në atë të shërbimeve. Në rastin e zonave e komuniteteve malore me natyrë të virgjër, por me dobësi të theksuara ekonomike e infrastrukturore, politikat e zhvillimit duhet të përfaqësojnë gjetje origjinale, në funksion të ofertës, por edhe ruajtjes së saj. Zona të tilla nuk përballojnë lëvizje masive në territorin e tyre, me pasoja negative natyrore e kulturore, të cilat çojnë deri në asimilim të shpejtë të resursit e humbje të vlerës origjinale<sup>273</sup>.

*Si kundërshtohet fenomeni i marginalizimit në zonat rurale? Sot është koha që të njihen potenciali i turizmit dhe i rekreacionit, si elemente kyç të zhvillimit rural, gjithmonë brenda limiteve të zhvillimit të qëndrueshëm.*

Nisur nga kjo, turizmi nuk përbën vetëm një qëllim afatshkurtër tregu, por gjithashtu një përgjigje ndaj nevojave të konsiderueshme të zonave rurale të privuara, si dhe një impakt afatgjatë në peizazhin rural e komunitetin.

Për “resurs turistik”, kuptohet çdo element territorial, qoftë natyral apo human, në gjendje që të tërheqë një fluks turistik.

<sup>273</sup> Dibra, N., Dema, B. – “Valorizimi i zonave malore nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm”, Studime albanologjike, IV – Tiranë, 2011, f. 2.


*Turizmi prodhon e modifikon territore, nëpërmjet shfrytëzimit të mundësive territoriale e faktorëve të tij të zhvillimit.*

Në një këndvështrim praktik, rrethi i Pukës, përfaqëson një pozicion tranzit në rrugët kryesore që kalojnë nga Shkodra drejt Kukësit e Prizrenit, si dhe rrugës që vjen nga Tirana; një gjë e tillë e favorizon në takimin me një fluks të rëndësishëm turistik që lëviz në këtë drejtim.

Sipas një këndvështrimi historik, një ndër vlerat e perandorive të mëdha, e sidomos asaj romake, është ndërtimi i rrugëve që lidhnin rajone të rëndësishme urbane apo ushtarake, rrugë që në mjaft raste funksionojnë akoma, veçanërisht për lëvizje ekoturistike apo *trekking*.

Nën pushtimin romak, në shek.I PK, Dardania (Kosova e sotme), kishte një pozicion të rëndësishëm mes rrugëve që lidhnin Egjeun, Pellgun e Danubit dhe detin Adriatik. Një pjesë e rrugës së vjetër për në rajonin dardan e më gjerë kalonte në peizazhet natyrore të Pukës, me stacionin rrugor *Ad Picarium*<sup>274</sup>.

Në këtë kuadër, rast të mirë për zhvillimin turistik e më gjerë përfaqëson dhe aktivizimi i Rrugës antike të veriut Adriatik-Dardani, e cila kap zonat Lezhë - Shkodër- Vau i Dejës – Pukë - Fushë Arrëz - Va Spas - Gjakovë. Rajonet në të cilat kalon kjo rrugë mund të rivlerësohen edhe në kuadër të ofertës së tyre natyrore e humane, në ndihmë të zhvillimit.



<sup>274</sup> . Constantin Băjenaru - [Minor Fortifications in the Balkan-Danubian Area from Diocletian to Justinian](#) / NATIONAL MUSEUM OF ROMANIAN HISTORY / The Center for Roman Military Studies – 8, 2010 f. 25.

(*Lissus-Naissus-Ratiaria* – e cila përfaqëson rrugën më të shkurtër mes detit Adriatik e Danubit)

Sipas Tabula Peutingeriana, në këto rrugë ekzistojnë disa stacione: *Lissus-Ad Picarias – Creveni-Gabuleum-Teranda-Viciano(Ulpiana?) - Vindenis - Ad Fines-Hammeum-Ad Herculem-Naissus-Timacum Maius-Timacum Minus-Combustica-Ratiaria*.

Kjo zonë malore karakterizohet nga elemente të favorshme, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm për zgjerimin e sektorit turistik, duke u bazuar mbi:

- Trashëgiminë e fuqishme historike, arkeologjike, artistike (kisha monumentale, banesa historike, muze e zona muzeale).

- Trashëgiminë natyralistike (pasuri orografike, pedologjike e morfologjike). Këto janë mundësitë e krijuara, për t'iu ofruar vizitorëve, peizazhe shumë variable, brenda disa dhjetëra km.

- Së fundi, “bukuritë antropologjike” të lidhura me zakonet e traditat e zonës, të përpunuara me kalimin e kohës.

Në këto zona, kështu mund të hapet një hapësirë e gjerë për promovimin e turizmit të vogël (minor) e për valorizimin e traditave kulturore lokale.

Popullsia e zonës tashmë është e ndërgjegjësuar mbi resursin lokal dhe mundohet ta promovojë atë edhe me nisma tipike akomodimi e shërbimesh, siç është rasti i ndërtimit të ambienteve të vogla pritëse me shërbim e gastronomi të zonës, që nganjëherë quhen dhe *hane*, duke evokuar origjinalitetin e hershëm, mjaft tërheqës për vizitorët.



Përveç traditës e historisë të përfaqësuara më së miri nga elemente arkeologjike, si ato të të famshmes “kultura e Komanit”, apo me fortesat apo kalatë e mesjetës e objektet e kultit, motiveve kulturore nxitëse, u shtohen edhe elemente të traditës popullore, të përfaqësuara nga punime qeramike, punime të drurit, veshje popullore apo elemente të folkut të zonës.

Promovimi, organizimi, aftësia konkurruese e territorit, mbeten akoma çelësi për të kuptuar se, në ç’masë zgjerimi i sektorit turistik, mund të kontribuojë për të ardhmen.

Por, aktivizimi i mëtejshëm i rrugëve tranzite, nxit flukse që vijnë dhe nga zonat përreth, si: Shkodra apo Lezha, të futura tashmë në rrjedhën turistike aktuale.

Një fakt për t’u përmendur është izolimi pak a shumë i dukshëm tashmë për rajonin, si rezultat i ndërtimit të rrugës Durrës-Kukës, e cila ka tërhequr fluksin e lëvizjeve drejt Kosovës apo zonave përreth, duke



zvogëluar lëvizjet në aksin rrugor drejt Pukës e malësisë përreth; megjithatë, një lëvizje e konsiderueshme kohët e fundit tenton të vizitojë peizazhet e luginës së Drinit, me liqenin e Komanit e Vau-Dejës, për të kaluar pastaj në zonën e Valbonës. Në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me një fluks turistik, shpeshherë të organizuar, i cili domosdoshmërisht kërkon të shfrytëzojë territorin në fjalë.

Pra, dy gjëra duhet të identifikohen: fluksi dhe qëndrimi. Këto nuk lidhen thjesht me dimensionin fizik të zonës, por dhe me karakteristikat historike dhe me interesin që zona ngjall.

Është e rëndësishme të përcaktohet tipi i vizitës, duke llogaritur kërkesën e shprehur nga çdo kategori të veçantë vizituesi (tipi “tranzit”, i apasionuari i kulturës, eksperti, kërkuesi shkencor), në mënyrë që të ofrohet një produkt sa më i afërt me aspiratat e secilit.

Kështu, mund të programohen itinerare e qëndrime të ndryshme, sipas segmenteve të ndryshme të vizitorëve.

- Me diversitetin kulturor e natyror, si aseti kryesor për turizmin, mund të promovohet natyra e kultura, si produkti kryesor i zonës.

Një formë e integritit të mundshëm në zhvillimin pozitiv, mund të quhen dhe “shërbimet e kohës së lirë”, që zona malore mund të ofrojë për popullsinë rajonale e ekstrarajonale.

Shërbimet janë nga më të ndryshmet; nga shtëpitë e dyta për pushime me prezencën e përkohshme turistike që ato sjellin, deri tek ato aktivitete të lidhura me ruajtjen ambientale, si organizimi i parqeve natyrore e konservimi i florës e faunës, valorizimi i të mirave turistike, të vendbanimeve tipike, etj.

Dëshira për përvetësimin dhe njohjen e eksperiencave të ndryshme, sjell fraksionimin e pushimeve në disa periudha më të shkurtra, të shpërndara në harkun e vitit. Kështu, fluksi turistik mund të jetë sa veror aq dhe dimëror, nxitur dhe nga veçoritë klimatike të përshtatshme me verën e freskët, apo dimrin me dëborë.

Ekzistojnë forma të tërheqjes turistike që, megjithëse anësore, krijojnë nganjëherë lokalizime turistike origjinale.

Sipas mjaft kriteresh sasiore apo cilësore, vegjetacioni përbën pak a shumë një faktor tërheqës turistik. Vegjetacioni si objekt dhe qëllim turistik ka të bëjë vetëm me disa forma të aktivitetit turistik: shëtitjen përmes bimësisë pyjore (parqet natyrore) ose qëndrimin e veruesve të



apasionuar pas turizmit të gjelbër në masivet pyjore.

Mund të themi se rajoni i Pukës po integrohet gradualisht në aktivitetin turistik, kryesisht nën efektin e pasurisë natyrore e sidomos asaj të gjelbër; kjo ka bërë që të vizitohet nga vendas e të huaj për motive kryesisht natyralistike. (Malet, luginat, pyjet e ahut e pishës, lëndinat, burimet e krojet, freskia e verës etj.).



Një fluks turistik origjinal e në rritje të vazhdueshme, përfaqëson lëvizja përmes kësaj rruge tipike e grupeve të motoçiklistëve të apasionuar pas sportit e natyrës. Ato gjejnë aty itinerarin perfekt për të përmbushur kërkesat bazë të kësaj lëvizjeje, rrugë panoramike e mbulesë bimore të mrekullueshme. Oferta rurale e qëndrimit përmbush dhe kuadrin modest të shpenzimeve të tyre.



Nga ana tjetër, duke qenë se kryesisht kemi të bëjmë me një fluks turistik të huaj, një nga përfitimet e zonës lidhet dhe me promovimin e përshtatshëm kundrejt një kërkese turistike të re e të mirëpritur. Një vlerë e shtuar e këtij fluksi, është fakti se efektet negative të përdorimit mjedisor nga një aktivitet i tillë, janë pothuajse minimale.

Turizmi i gjelbër është një nga format kryesore të shfrytëzimit aktual të ambientit natyror në rrethin e Pukës. Por, në kushtet e një zgjerimi të kërkesës turistike dhe sidomos specifikave të reja të kësaj kërkese, sot nxitet dhe turizmi familjar e ai (aventuresk), nëpërmjet shëtitjeve në ajër të pastër, pranë liqeneve e ujëvarave (Tërbun, Livadh - Kabash) apo pranë rrjedhjeve ujore përmes grykave e shpellave. Në të tilla ambiente mund të

vendosen mjaft mirë dhe kampinge të përkohshme të vizitorëve apo eskursionistëve.

Zhvillimi i blegtorisë në zonë mund të nxisë dhe një formë të agriturizmit, të shërbyer nga fermerë lokalë, të cilët krijojnë dhe mundësinë e akomodimit pranë pronës së tyre, duke ofruar njëkohësisht dhe prodhimet tipike blegtorale të fermës apo elemente rekreacioni, siç janë p.sh., shëtitjet me kalë në ambiente të gjelbra, gjueti etj.

Zona pyjore është një simbol i Pukës, meqenëse kjo bimësi mbulon rreth 80% të sipërfaqes së saj, si në Krrabë, Munellë, Tërbun apo Kunorë Dardhë, të njohura edhe për livadhet e kullotat verore<sup>275</sup>.

Duke nxjerrë profilin e përdorimit shumëfish të pyjeve, të cilat kanë të bëjnë me potencialin ekonomik, impaktin ambietal e social të turizmit e rekreacionit në pyje, mund të kosiderohen alternativat e përdorimit shumëfish të tyre.

Kjo gjë mund të kontribuojë në disa drejtime:

- **Ekonomik:** duke ruajtur pyjet sipas gjetjes së burimeve alternative të të ardhurave më tepër se nga prodhimi drusor.
- **Punësim e pjesëmarrje:** turizmi e rekreacioni dallohen për një punësim potencial të grave e të rinjve, tradicionalisht jo të prezantuar në industrinë e pyjeve.
- **Ambient:** futjen e rekreacionit e turizmit në menaxhimin e pyjeve, për lejjimin e zotëruesve të këtyre zonave që të ruajnë një mbulesë pyjore permanente, biodiversitetin pyjor, të mbrojnë speciet e rrezikuara, cilësinë e ajrit e burimeve ujore, të cilat janë thelbësore për cilësinë ambientale të fshatit. Rritja e numrit të vizitorëve në pyll do të inkurajojë një menaxhim më racional të resurseve pyjore.
- **Social:** aftësinë që kanë zonat pyjore, për tërheqjen e një numri më të madh vizitorësh (në krahasim me një zonë fshatare e zakonshme).

Të mirat ambientale, monumentale, historike e të natyrave të tjera prezente në vend, shpesh nuk çmohen për vlerën e tyre nga vetë popullsitë lokale.

Por ekziston mundësia që popullsia lokale të përfshihet në mënyrë aktive në procesin turistik. Nuk mund të harrohet që shpesh janë aspektet etnologjike e kulturore, të cilat përbëjnë motivin e tërheqjes (atraksionit), ashtu si dhe prodhimi artizanal e lokal mund të nxisin kuriozitetin e vizitorit.

---

<sup>275</sup> Hoti, M. Alia, GJ. - "Puka – Vështim i përgjithshëm gjeografik e turistik", 1998.

Megjithatë, mund të themi se kohët e fundit, dallohet një ndërgjegjësim i popullsisë lokale mbi vlerat që territori i tyre mbart, gjë që ka bërë të investohet dukshëm në drejtim të zhvillimit turistik e ristoracionit, duke ndërtuar mjaft hotele apo njësi të tjera akomodimi, në varësi edhe të klientelës turistike që ato presin.

Me aktivizimin tashmë dhe të rrugëve tranzite përmes këtij rajoni, klientela turistike pritet të rritet si në sasi dhe në cilësi. Kjo është detyrë e enteve publike e private që operojnë aty, të marrin masa për t'u shërbyer sa më mirë.

#### LITERATURA E PËRDORUR:

1. Băjenaru Constantin -Minor Fortifications in the Balkan-Danubian Area from Diocletian to Justinian /National Museum of Romanian history/ The Center for Roman Military Studies -8, 2010.
2. Saraceno, E. (1993): *Il problema della montagna*, Milano.
3. W.Strasdas: *Sustainable Tourism*, Guidelines for PAs, january 2004.
4. C.Michael Hall, Stephen J. Page: "The Geography of tourism and recreation".
5. Hoti, M. Alia, GJ. (1998): "Puka – Vështrim i përgjithshëm gjeografik e turistik".
6. Dibra, N. Dema, B. (2011): "Valorizimi i zonave malore nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm", Studime albanologjike, IV, Tiranë.
7. Qarku i Shkodrës: "... Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet objektivave të Mijëvjeçarit", Shkodër, 2005.
8. Alfred Frashëri (2012): "Gjeomonumente", shblsh e re.

### **The integration of cultural and natural tourism in areas near the Northern Antique Road Adriatic- Dardan**

#### **SUMMARY**

Tourism activity generally represents a force for the development of the regions where it operates; This effect takes an even greater value when implemented in weak areas or in economic crisis, as is the case in a rural or mountain area.

In the case of areas of mountainous communities, with virgin nature but with strong economic weaknesses of the infrastructure, development policies must represent original findings, in order to offer but also its preservation.

---

In a practical standpoint, the district of Puka transit represents a position on the main road to the north northeast; In this framework, the best case for the wider tourism development and activation of the road represents the northern Adriatic ancient Dardania. Regions in which passes this path may also reassessed in the context of their natural supply of humanities. In these areas, it may open a wider space for the promotion of tourism small (minor) for the valorisation of local cultural traditions. For further activation promotes transit routes and flows that come from surrounding areas, already embedded in current tourist flow. With the natural and cultural diversity, as the main asset for tourism, nature can be promoted as the main product of the culture of the area.

**Bresena KOPLIKU (DEMA)**

**INTEGRIMI I EMIGRANTËVE, FAZË E  
RËNDËSISHME E MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR. RAST  
STUDIMOR NGA EMIGRANTËT E QYTETIT  
TË SHKODRËS**

*“Shqiptarët sot përfaqësohen si shembull i integritit virtuozy”*

(Dr. Nicola Mai)

**Migrimi ndërkombëtar në Rajonin e Shkodrës**

Gjurmët e shkëndijës së parë të emigracionit nga Rajoni i Shkodrës (që do të përfshihet më vonë nga emigrimi masiv), i gjejmë në një episod të fillimit të vitit 1991. Konkretisht, më 6 Janar të këtij viti, ndërkohë që shqiptarët u ishin drejtuar mjeteve të lundrimit të të gjitha llojeve nga portet e Shqipërisë ose nëpërmjet kufirit tokësor me Greqinë, më në veri të Shqipërisë, një grup prej 70 shqiptarësh, improvizuan mjete transporti e ia dolën të kalonin lumin Buna dhe të arrinin në Ulqin në jug të Malit të Zi<sup>276</sup>. Ngjarjet e forta politike që pasuan, i dhanë impulse të tjera largimeve të popullsisë, të cilat patën luhatjet e veta, sikurse i gjithë emigrimi shqiptar. Rrethi i Shkodrës ka pasur një shkallë të lartë emigrimi gjatë periudhës së viteve 1989-2001 dhe renditet i pesti në të gjitha prefekturat e Shqipërisë për sa i përket numrit absolut të migrantëve të jashtëm, me 37197 të tillë gjatë kësaj periudhe<sup>277</sup>. Shkalla më e madhe e të larguarve i përket dekadës së parë të tranzicionit. 82% e tyre kanë më tepër se 10 vjet që janë larguar nga Shqipëria. Në terma vlerash absolute, Shkodra, si zonë urbane zë një vend të rëndësishëm në përfshirjen e saj në migrimin ndërkombëtar në shkallë vendi. Ky qytet përfshihet në vendet origjinë më të rëndësishme të emigruesve ndërkombëtarë nga zonat urbane të përqendruara në brigjet detare dhe rrugët e transportit drej Greqisë, Italisë dhe më tej. Së bashku të pesë rrethet kryesore, Tirana, Durrësi, Vlora, Korça dhe Shkodra numërojnë

<sup>276</sup> Barjaba K, King R, (2005), *Introducing and theorizing Albanian migration*, The new Albanian Migration, Sussex Academic Press, f. 4.

<sup>277</sup> Carletto C, Davis B, Stampini M, Trento S dhe Zezza A (2004) *Internal mobility and international migration in Albania*, ESA Working Paper No. 04-13.

rreth 40% të totalit të të emigruarve<sup>278</sup>. Të dhënat tregojnë se familjet nga zonat rurale janë më të predispozura për të emigruar se sa familjet nga zonat urbane, respektivisht 46% kundrejt 38%<sup>279</sup>.

Pas një periudhe të gjatë izolimi nga bota e përtej kufijve, rishfaqja emigracionit pati ndikim të madh në numrin e popullsisë dhe në proceset e tjera demografike në nivel rajonal dhe në shkallë vendi. Shumica e këtyre emigrantëve kanë qenë meshkuj dhe në moshë të re (Atlasi Gjeografik i Popullsisë, Piperno, 2002). Këtë fakt e theksojnë shumë studiues të emigrimit shqiptar, sepse bëhet fjalë për një hemoragji të vërtetë të forcës më aktive të vendit, aq sa përcaktohet se numri i të rinjve të moshës 20 deri në 35 vjeç të gjinisë mashkullore është përgjysmuar si pasojë e emigrimit. Në vitin 1998 llogaritej që 83% e emigrantëve ishin meshkuj, 71% të moshës 20-34 vjeç, 75% ishin me arsim të mesëm dhe të lartë, 24% ishin intelektualë<sup>280</sup>. Ky trend vërtetohet edhe për qytetin e Shkodrës, ku sipas një anketimi të vitit 2002, përqindjen më të lartë të emigrantëve e zinte grupmosha 20-25 vjeç dhe gjinia mashkullore<sup>281</sup>.

Anketimi ynë vërteton të njëjtën gjë, mosha mesatare e të emigruarve në momentin e largimit ishte 25 vjeç për meshkujt dhe 27 për femrat. Mosha pak më e lartë e femrave argumentohet me largimin e tyre kryesisht për arsye martesore në vitet '90. Gjithashtu nga rezultatet e anketimit, shihet qartë numri më i lartë i meshkujve në emigrim, kryesisht në vitet e para. Mungesa e tyre në familjet shqiptare (në bazë të studimeve mbi emigracionin shqiptar në përgjithësi). Sipas pyetësorit, rezultojnë 54% meshkuj të emigruar kundrejt 46% femra. Këtë e shpjegojmë me faktin se në fillim të viteve '90, migrimi ishte qartësisht i orientuar drejt punësimit, prandaj u përfshinë më tepër meshkujt e rinj. Në fund të viteve '90, bashkimi familjar kthehet në një ndër udhëheqësit kryesorë të emigrimit, gjë që solli edhe feminizimin e tij. Kjo u favorizua edhe nga programet rregulluese të bashkimit familjar të ndërmarra sidomos nga qeveria italiane. Emigrimin e femrave të vetme (beqare), e shohim kryesisht me qëllimin e

---

<sup>278</sup> King, R, Mai, N (2008): *Out of Albania, From crisis migration to social inclusion in Italy*, Brehahn Books, f. 81.

<sup>279</sup> Institute of Statistics, Institute of Public Health [Albania] and ICF Macro (2010), *Albania Demographic and Health Survey, 2008-2009*, Tirana, Albania: Institute of Statistics, Institute of Public Health and ICF Macro, f. 281.

<sup>280</sup> UNFPA cit. nga Piperno F, (2002): *From Albania to Italy Formation and basic features of a binational migration system*, Background paper for the CEME-CeSPI research mission in Italy and Albania, f. 6.

<sup>281</sup> Bushati, B, (2002): *Profili demografik i Shkodrës dhe lëvizjet migruese*, Seminari V Ndërkombëtar Shkodra në Shekuj, Shkodër, f. 379.

studimit në vende të BE-së ose të SHBA-së më tepër pas vitit 2000. Femrat shqiptare që emigrojnë jashtë nëpërmjet rrugëve ligjore janë të pakta dhe më së shumti përfshihen gra të kualifikuara kryesisht nga familjet e pasura<sup>282</sup>. Vitet e fundit është rritur numri i studentëve që studiojnë në vendet e Evropës Perëndimore (që mund të përbëjnë emigrantë potencialë), përderisa pak prej tyre kthehen në Shkodër, të tjerë i drejtohen kryeqytetit dhe të tjerë qëndrojnë përfundimisht në vendin e studimit.

### Destinacionet e emigrimit

Destinacioni i emigrimit është i lidhur me moshën e emigrantëve, sepse shpërndarja moshore e tyre varion sipas destinacionit. Migrantët më të rinj u drejtohen vendeve të Evropës (në shkallë kombëtare 62% e emigrantëve drejt Evropës ishin në moshën 15-24 vjeç, 23% në moshën 25-34 dhe 8% ishin mbi 35 vjeç), ndërsa emigrantët që i drejtohen SHBA-së dhe Kanadasë janë mbi 30 apo 35 vjeç. Emigrimi drejt SHBA-së dhe Kanadasë bazohet në një proces aplikimi, ku arsimit është një ndër kriteret kryesore për pranim, kështu që detyrimisht mosha e tyre është më e lartë. Individët dhe familjet që emigrojnë jashtë Evropës, kryesisht drejt SHBA-së dhe Kanadasë, kalojnë një kohë më të gjatë për të marrë vendimin për të emigruar. Ata përgatiten më mirë financiarisht, meqenëse shpenzimet për të emigruar dhe për t'u vendosur janë më të larta dhe zakonisht ata janë më të informuar për të ardhmen dhe mundësitë e vendosjes në vendin pritës. Për rrjedhojë, emigrantët e këtij fluksi, rezultojnë në një moshë më të madhe. Nga ana tjetër, shpenzimet e udhëtimit dhe të vendosjes në vendet fqinje nuk janë aq të larta dhe ligjet e emigrimit nuk janë aq të forta, fakte që favorizojnë më të rinjtë. Emigrantët në vendet fqinje dhe kudo në Evropë nganjëherë emigrojnë pa dokumentet e përshtatshme, ndërmarrin rreziqe më të mëdha dhe përpiqen disa herë që të emigrojnë<sup>283</sup>.

Studimet tregojnë se ka një sërë faktorësh që përcaktojnë drejtimin e migrimit ndërkombëtar të shqiptarëve. Një ndër kriteret kryesore është afërsia gjeografike. Kjo afërsi dhe aksesit relativisht i lehtë në kalimin e kufirit ilegalisht, i ka ndihmuar shqiptarët të udhëtojnë drejt vendeve fqinje relativisht të pasura, si Greqia dhe Italia<sup>284</sup>. Një nga gjetjet kryesore të

<sup>282</sup> Vullnetari, J. (2007): *Albanian Migration and Development: State of the art review*, Working Paper No. 18, IMISCOE, f. 43, 44.

<sup>283</sup> Institute of Statistics, Institute of Public Health [Albania] and ICF Macro (2010), *Albania Demographic and Health Survey 2008-09*. Tirana, Albania: Institute of Statistics, Institute of Public Health and ICF Macro, f. 294.

<sup>284</sup> Gedeshi, I., Jorgon, E. (2012): *Social Impact of Emigration and Rural - Urban Migration in Central and Eastern Europe*, Final Country Report, Albania, f. 8.



analizës së migrimit ndërkombëtar në shekuj është se migrantët ndjekin rrugët ekzistuese<sup>285</sup> dhe ky trend vërtetohet për rajonin e Shkodrës, sidomos në dhjetëvjeçarin e parë të tranzicionit. Sipas INSTAT (2010), në bazë të ndarjes së emigrantëve sipas vendit të origjinës dhe të destinacionit, ka një ndryshim kryesor në përqindjen që zënë emigrantët në Greqi dhe Itali për gjithë Shqipërinë dhe për Rrethin e Shkodrës. Në shkallë vendi pothuajse 50% e emigrantëve kanë pasur si pikësynimin kryesor Greqinë dhe 35.3% e tyre i janë drejtuar Italisë, kurse në shkallë rrethi, më tepër se gjysma e emigrantëve nga Shkodra, 57,6% janë vendosur në Itali (kështu Shkodra është ndër rastet tipike, ku emigrimi drejt Italisë është mëse i zakonshëm), kurse 23,7% e tyre në Greqi. Kjo shpërndarje e emigrantëve, vihet re edhe në shkallë prefekturë (Grafiku 1). Ky tipar është karakteristik kryesisht për zonat urbane bregdetare dhe veriun e Shqipërisë, ku kanë pasur ndikim nga disa faktorë nga të cilët mund të përmendim:

- afërsinë gjeografike dhe lidhjet më të shpeshta të komunikimit,
- besimin fetar, pjesa më e madhe e banorëve të besimit katolik shqiptar, që kanë emigruar më tepër në Itali gjenden në veri,
- njohjen e gjuhës që është arritur kryesisht nëpërmjet mësimin informal gjatë viteve 1945-1990, si pasojë e aksesit më të madh ndaj televizionit italian
- njohjen dhe influencimin nga tiparet kulturore italiane, si pasojë e këtij aksesit<sup>286</sup>

Përveç Italisë dhe Greqisë, edhe drejt Britanisë së Madhe, vëmë re një përqindje më të lartë të të emigruarve nga veriu i Shqipërisë, përveç Shkodrës me 3.8% të emigrantëve, edhe nga Kukësi dhe Puka dhe më pak nga jugu i saj. Studiuesit përcaktojnë ndarjen e emigrantëve drejt Britanisë në dy grupe:


- migrantët punëtorë dhe refugjatët ekonomikë që përfaqësohen dukshëm nga meshkujt, ndërsa femrat janë bashkuar me ta gjatë procesit të bashkimit familjar.<sup>287</sup>

<sup>285</sup> Lutz, W., Prinz, C. (1993): *Modeling future immigration and integration in Western Europe*, The new geography of European Migrations, Great Britain, Belhaven Press, f. 84.

<sup>286</sup> King, R, Mai, N. (2008): *Out of Albania, From crisis migration to social inclusion in Italy*, Brehahn Books, f. 81.

<sup>287</sup> Vullnetari, J. (2007): *Albanian Migration and Development: State of the art review*, Working Paper No. 18, IMISCOE, f. 57.

- studentët që po e vlerësojnë gjithnjë e më tepër edukimin e tyre në Britaninë e Madhe dhe që më pas vendosin të qëndrojnë përfundimisht aty.



**Grafiku 1: Shpërndarja në përqindje e emigrantëve sipas vendit destinacion dhe origjinë Rrethi Shkodër 2008-2009<sup>288</sup>**

Duke filluar nga dhjetori i vitit 2010, hiqet regjimi i vizave mes Shqipërisë dhe vendeve të BE-së, për të ashtuquajturën zonë “Schengen”<sup>289</sup>. Kjo mundësoi që mijëra shqiptarë të lëvizin lirshëm drejt vendeve të Evropës Perëndimore, pa pasur nevojë për kalim të paligjshëm apo ilegal të kufirit, radhë të gjata dhe procedura burokratike nëpër ambasada apo zyra konsullore. Sipas burimeve të Policisë së Shtetit<sup>290</sup>, vetëm për vitin e parë të liberalizimit të vizave “... janë mbi 2.600.000 shtetas shqiptarë që kanë lëvizur të lirë dhe rreth 400.000 shtetas shqiptarë që lëvizin për herë të parë në zonën “Schengen”, ndërkohë që deri në mars, 2013, “... ka qenë

<sup>288</sup> Burimi: *Albania Demographic Health Survey*, 2008-2009, f. 296.

<sup>289</sup> Zona Shengen dhe bashkëpunimi janë themeluar mbi Marrëveshjen e Shengenit të vitit 1985. Zona Shengen paraqet një territor ku lëvizja e lirë e personave është e garantuar. Ajo përfshin 25 prej shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe 3 shtete të tjera joanëtare të BE-së.

<sup>290</sup> Intervistë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, z. Hysni Burgaj, për gazetën “Shqip”, dt.21.11.2011.

rreth 75 mijë numri i personave të cilët kanë qenë të padëshirueshëm në hapësirën Shengen, pra, 75 mijë persona të cilët ishin kandidatë për emigracion ilegal, 75 mijë persona që nuk plotësonin më kushtet për të hyrë në zonën Schengen<sup>291</sup> ...”. Pjesën më të madhe të kësaj kategorie, që tashmë e kanë të ndaluar zonën Schengen për të lëvizur lirshëm, e përbëjnë shqiptarët që përdorin dokumente false, karta identiteti, etj., për të përfituar, për të jetuar, apo për të punuar kryesisht në vendet e Evropës Veriore. Një pjesë e madhe e tyre janë edhe nga Rajoni i Shkodrës. Duke iu referuar shtypit të përditshëm, disa herë kanë ardhur në Shqipëri, gjithashtu dhe në Shkodër, drejtues të policive të vendeve të BE-së, për të diskutuar me homologët e tyre për ndalimin e fenomenit të kërkimit të azilit për shkak të gjakmarrjes. Sipas shifrave të publikuara nga Zyra e Komisionierit të Përgjithshëm për Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi (CGRA), në vitin 2008, aplikuan për azil 172 shqiptarë, në 2009 ishin 256, në 2010 ishin 204 dhe në 2011 (deri në tetor) ishin 662, plus 105 në tri javët e para të nëntorit. Kulmi ishte kur brenda një dite, në zyrat e aplikimit për azil në Belgjikë, u paraqitën 50 kërkesa, që të gjitha nga zona e Shkodrës (duke u bazuar në fenomenin e gjakmarrjes). Drejtori i Përgjithshëm i Emigracionit dhe Azilit, Fredy Rosemont, erdhi urgjentisht në Shkodër dhe apeloj për frenim të fenomenit<sup>292</sup>.

### Migrimi dhe integrimi

Procesi i integritimit përfshin rregullimin e emigrantëve në vendin e zgjedhur si destinacion në të gjitha fushat, ekonomike, sociale, kulturore, politike dhe hapësinore. Ky proces nënkupton riorganizimin e njëkohshëm nga migrantët të secilit prej këtyre aspekteve gjatë përpjekjes për t'u vendosur në vendin e destinacionit dhe përfshin disa sfera të ndara si më poshtë<sup>293</sup>:

- *Integrimin strukturor – fitimin e të drejtave dhe të statusit brenda institucioneve kore të shoqërisë pritëse, veçanërisht akses ndaj punësimit, strehimit, shërbimeve shëndetësore, dhe të drejtave politike dhe të qytetarisë.*

<sup>291</sup> Deklaratë e z. Pëllumb Nako, Drejtor i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, në Ministrinë e Brendshme, dhënë për BalkanWeb dt.16.03.2013.

<sup>292</sup> Publikuar me dt.28.11.2011 në www.shqiptarja.com

<sup>293</sup> Heckamann, 2005: 13-15, cituar nga King R, Skeldon, R., Vullnetari, J. (2008): *Internal and International Migration: Bridging the Theoretical Divide*, Working Paper No 52, Sussex Centre for Migration Research, f. 22.

- *Integrimin kulturor (ose akulturimin), pë referimin e ndryshimeve të sjelljeve dhe njohjeve të imigrantëve dhe pasardhësve të tyre konform normave të shoqërisë pritëse.*
- *Integrimin interaktiv, marrëdhëniet sociale, miqësinë, martesën dhe antarësimin në organizata të ndryshme*
- *Integrimin identifikues - për tregimin e ndjenjave të përkatësisë të shprehura në terma të besnikërisë ndaj identitetit etnik, rajonal, lokal dhe kombëtar.*

Vendosja dhe integrimi i shqiptarëve në Itali dhe Greqi, ka pasur luhajat e veta, sidomos në dhjetëvjeçarin e parë 1990-2000. Pamje rrënqethëse, të dokumentuara në media, dokumentarë dhe përgjithësisht në artin e shtatë, vijjnë nga të emigruarit në brigjet e Italisë në gusht të vitit 1991 (Foto 1).



**Foto 1: Shqiptarë në përpjekje për t'u arratisur nëpërmjet mjeteve të të gjitha llojeve nga kriza e tranzicionit në vitet 1990-1992<sup>294</sup>**

Në fillim migrantët në Itali dhe Greqi, paraqiteshin në pozicione të marginalizuara në shoqëritë pritëse; trajtoheshin nga popullsia pritëse si një grup që ishte më i keq se çdo grup tjetër migrantësh; kishte mungesë organizimi të jetës në vendet pritëse; mungesë të çdo rikthimi të mundshëm në Shqipëri<sup>295</sup>. Ata u detyruan të përballen me ngjarje diskriminuese dhe në përgjithësi me të ashtuquaturën *albanofobi*, që përfaqësonte nga njëra anë përfshirjen, por edhe shfrytëzimin ekonomik, dhe nga ana tjetër

<sup>294</sup> *Burimi: AP, European Stability Initiative.*

<sup>295</sup> Barjaba, 2000, cituar nga Vullnetari, J. (2007): *Albanian Migration and Development: State of the art review*, Working Paper No. 18, IMISCOE, f. 48.

përfundimisht në nivel social dhe publik<sup>296</sup>. Më vonë ata u integruan gradualisht dhe fituan vend të rëndësishëm në shoqëritë pritëse, saqë ky fenomen duket se i përket më tepër së kaluarës sesa të tashmes. Integrimi i suksesshëm i shqiptarëve në Itali, tregohet edhe në zgjedhjen e saj, si strehimi dhe vendbanimi përfundimtar nga shumë emigrantë, kryesisht nga zonat urbane bregdetare dhe veriu i Shqipërisë. Sipas të dhënave të ISTAT 2011, në Itali gjenden 491.000 shqiptarë, duke përfaqësuar grupin e dytë të imigrantëve, pas rumunëve<sup>297</sup>.

Meqenëse pjesa më e madhe e emigrantëve të rajonit të Shkodrës janë vendosur në Itali, atëherë e gjejmë me vlera studimin e autorëve King dhe Mai, të cilët kanë studiuar hollësisht vendosjen dhe integrimin e shqiptarëve të Italisë (King dhe Mai 2002, 2004). Sipas tyre, shqiptarët janë grupi më i shpërndarë nga gjithë grupet e tjera imigrante në Itali, pra *ata janë kombësia e imigrantëve, shpërndarja hapësinore e të cilëve i afrohet më së shumti asaj të popullsisë vendase*. Gjithashtu shqiptarët janë vazhdimisht në kërkim të kushteve më të mira, pas vendosjes fillestare në vendet e mbërritjes, që shpesh është në Italinë e Jugut, ata i drejtohen Italisë Veriore. Pra shqiptarët kanë një shkallë të lartë të lëvizjes së brendshme nga rajonet jugore (sidomos Apulia që është pika e mbërritjes së shumë prej tyre) drejt rajoneve më të pasura veriore, si: Emilia Romanja, Toskana dhe Veneto, që janë më dinamike ekonomikisht në Itali dhe që ofrojnë mundësitë më të mira të punësimit<sup>298</sup>.

Duke studiuar migrimin ndërkombëtar në Shkodër, vëmë re se, 57,6% emigrantëve në shkallë rrethi, kanë zgjedhur si vend pritës, kryesisht Italinë, përkundrajt 23,7% të vendosur në Greqi. Ky trend u vërtetua edhe më tepër nga të anketuarit tanë, 44% e të cilëve rezultojnë rezident në Itali. Përgjigjet e tyre janë reflektim i *rëndësisë që ka vendi i zgjedhur për të emigruar në procesin e integrimit*. Kjo sepse integrimi është një proces interaktiv në mes migrantëve dhe shoqërisë pritëse, në të cilin gjithsesi, shoqëria pritëse ka shumë më tepër fuqi dhe prestigj<sup>299</sup>.

Në këtë aspekt, për një integrim të shpejtë dhe të suksesshëm, ***njohja e gjuhës*** është element shumë i rëndësishëm. Sipas Martin, migrantët e vendeve të zhvilluara, nuk duken më të gatshëm të presin tri

<sup>296</sup> Mai, N., *Integrazione, Ritorno e Migrazione Circolare tra Albania e Italia*, Metroikos Project.

<sup>297</sup> Po aty.

<sup>298</sup> King, R., Skeldon, R., Vullnetari, J. (2008): *Internal and International Migration: Bridging the Theoretical Divide*, Working Paper No 52, Sussex Centre for Migration Research, f. 8.

<sup>299</sup> Heckmann 2005:15, cituar poaty.

breza që të ardhurve të mëparshëm iu deshën për t'u integruar, kështu që rriten përpjekjet e tyre për të mësuar gjuhën e vendit që i pret, përderisa mosnjohja e gjuhës në vendin destinacion, është pengesa kryesore më e rëndësishme që pengon integrimin e tyre në atë vend<sup>300</sup>. Një pjesë e mirë e shkodranëve të larguar tashmë e kishin pothuajse të kaluar këtë fazë të parë të integritimit për shkak të njohjes paraprake të gjuhës italiane, 26% e të anketuarve e kanë zgjedhur vendin pritës sepse kishin njohuri të gjuhës. Në këtë këndvështrim, shkalla e lartë e integritimit përforcohet edhe nga fakti që 94% e migrantëve flasin rrjedhshëm ose mirë gjuhën e vendit ku ato migrojnë<sup>301</sup>.

**Aspekti ligjor**, është gjithashtu shumë i rëndësishëm. Integrimi i shqiptarëve në vendet fqinje, Itali dhe Greqi, është ndihmuar nga rregullimet ligjore të ndërmarra nga këto vende përkatësisht në vitet 1995, 1998 dhe 2002 në Itali dhe 1998 dhe 2001 në Greqi<sup>302</sup>. Këtu përfshihen aministrat apo forma të tjera të rregullimit të statusit që kanë mundësuar pajisjen e imigrantëve me leje qëndrimi dhe për rrjedhojë edhe stabilizimin e tyre në këto vende. Edhe liberalizimi i vizave në vitin 2010, e ndryshoi konfiguracionin e tipareve të të gjitha fazave të migrimit.

**Rëndësia e marrëdhënieve familjare**, shihet shumë qartë në procesin e integritimit. Literatura mbështet faktin se migrimi ndërkombëtar ka kosto shumë më të lartë se migrimi i brendshëm<sup>303</sup> dhe distancat janë më të gjata, ashtu sikurse janë edhe pengesat për të hyrë në një vend, sidomos kur migranti nuk ka të drejta ligjore për të kaluar kufirin dhe për të punuar. Këto kosto nuk janë vetëm financiare, por edhe humane dhe psikologjike, dhe përfshijnë koston e të lënit të një kulture dhe përshtatjes së një kulture të re, me ndarje të gjata në kohë nga familja dhe shokët, me jetë në arratisje etj. Kjo është arsyeja që edhe rrjetet dhe lidhjet sociale janë më të forta në migrimin ndërkombëtar sesa atë të brendshëm, sepse kërkohet mbështetja e njerëzve që të duken më të afërt nga ana kulturore. Gjithsesi, kjo kosto e lartë balancohet nga pritshmëria se fitimet jashtë do të jenë më të kënaqshme, jo vetëm për të justifikuar dhe për të mbuluar këto kosto, por edhe për të arritur qëllime më të larta. P.sh., remitancat nga jashtë janë më

<sup>300</sup> Martin, P. (1993): *The migration issue*, The new Geography of European Migrations, Belhaven Press, Londër, f. 13.

<sup>301</sup> Gedeshi, I., Jorgon, E., (2012): *Social Impact of Emigration and Rural - Urban Migration in Central and Eastern Europe*, Final Country Report, Albania, f. 11.

<sup>302</sup> Po aty, f. 20.

<sup>303</sup> Massey, D., Arango, J., Hugo, G., Kouaouci, A. & Pellegrino, A., Taylor, E. (1993): *Theories of International Migration: A Review and Appraisal* Population and Development Review, Vol. 19, No. 3, 1993, f. 461.

të larta se remitancat e brendshme, kështu që impakti i tyre mund të jetë më i rëndësishëm<sup>304</sup>.

Rreth 58% e të anketuarve kanë zgjedhur vendin pritës, sepse aty kishin miq dhe të afërm. Migrimi drejt vendeve të largëta bazohet kryesisht mbi baza familjare, modeli i migrimit drejt Greqisë, Italisë dhe vendeve të tjera të BE-së, është kryesisht i udhëhequr nga meshkujt, me bashkimin e mëvonshëm familjar, pasi migranti mashkull rregullohet dhe fiton ndjenjën e sigurisë në vendin pritës (Vullnetari, 2007). Rreth 32% e të anketuarve kanë pasur arsye kryesore të migrimit *bashkimin familjar* dhe këtu përfshihen sidomos femrat. 75% e tyre janë larguar pas martesës, madje pyetjes se cila ka qenë arsyeja e zgjedhjes së vendit të destinacionit njëra prej tyre i përgjigjet: “*për këtë duhet të pyesni bashkëshortin, sepse ai ka ardhur më parë këtu*”. Numri i lartë i femrave të larguara për t’iu bashkuar bashkëshortëve të tyre, është tregues i shkallës së lartë të integritit dhe i stabilizimit të këtyre të fundit.

Rëndësia e marrëdhënieve familjare të forta shprehet edhe në emigrimin e konsiderueshëm të të moshuarve në ndjekje të fëmijëve dhe të nipërve të tyre. Ata janë të përfshirë në ndihmesën për të mbajtur fëmijët dhe punë të tjera shtëpiake në familje, ose nganjëherë përfshihen në tregun informal të punës, duke ndihmuar kështu sadopak të ardhurat e familjes. Pra, *struktura e orientuar drejt familjes e migrimit shqiptar, ka qenë shumë e rëndësishme në integrimin socialekonomik të migrantëve*.

**Punësimi** është një ndër treguesit kryesorë të shkallës së integritit. Evidencat nga integrimi socialekonomik i shqiptarëve në Itali, tregojnë një pikturë shumë pozitive (King dhe Mai 2004; Barjaba dhe King 2005, Vullnetari, 2007)<sup>305</sup>:

*Së pari*, shkalla e papunësisë tek shqiptarët, është më e ulët sesa e komuniteteve të tjera të emigrantëve.

*Së dyti*, shqiptarët janë të punësuar në një varietet sektorësh.

Sektorët kryesorë të punësimit të migrantëve shqiptarë janë ndërtimi (35%), shërbimet (21%), fabrika/industri (17%), ndihmë në shtëpi (15%) dhe bujqësi (10%). Ekziston një ndarje e punës në mes të migrantëve. Burrat punojnë kryesisht në ndërtim (49%), shërbime (19%) dhe industri (18%). Gratë punojnë kryesisht në ndihmë në shtëpi (53%), sikurse shërbime (26%) dhe industri (13%) (Gedeshi, 2010, Vullnetari, 2007). Integrimi në aspektin e punësimit tregohet edhe nga përvoja e fituar; shumë

<sup>304</sup> King, R., Mai, N. (2008): *Out of Albania, From crisis migration to social inclusion in Italy*, Brehahn Books, f. 26.

<sup>305</sup> Vullnetari, J. (2007), *Albanian Migration and Development: State of the art review*, Working Paper No. 18, IMISCOE, f. 54.

migrantë shkodranë kanë rritur edhe kapitalin njerëzor, duke krijuar një mentalitet të ri dhe duke u përballur me eksperiencë të reja. Nga anketimet vëmë re që shumë prej tyre gradualisht janë rritur në statusin e punës. Për meshkujt marrim shembuj të kalimit nga kamarier në menaxher hoteli ose restoranti, nga ambalazhues në kuzhinierë, apo edhe nga elektrikistë në drejtorë finance në të njëjtën ndërmarrje. Nga të anketuarat femra veçojmë rastet e kalimit nga kamarierë në menaxhere biznesi, apo nga babysitter (kujdestare fëmijësh), ose pastrimin e shtëpive, në infermiere apo llogaritare. Këto lëvizje të të anketuarve përputhen me trendin që vihet re në përgjithësi për migrantët shqiptarë: *Në një periudhë prej tre apo katër vitesh ata lëvizin nga punë më pak të kualifikuara drejt punëve të një niveli më të lartë në të njëjtën linjë me shkallën e arsimimit/kualifikimit të tyre dhe nivelin e integritit*<sup>306</sup>.

Shumë më e vështirë është rruga e migrantëve me arsim të lartë drejt punësimit në fushën e tyre të studimit, disa prej tyre arrijnë të gjejnë punë në zyrë ose nivele më të larta, por jo në përputhje të plotë me nivelin e tyre të kualifikimit. Shumë pak e arrijnë këtë qëllim. Ndërkohë që analizohet migrimi i shqiptarëve të kualifikuar, duhet të kihet parasysh fakti se një pjesë e mirë e tyre i nënshtrohen deaftësimit profesional kur migrojnë. P.sh., ish -inxhinierë, ekonomistë, mësues ose artistë, shpesh punësohen, si: kopshtarë, pastrues, kujdestarë, shërbëtorë, bojaxhi etj. (ETF 2007). Sipas Glytsos (2006), rrjedhja e trurit nga Shqipëria nuk kthehet në një fitim truri nga vendet pritëse, por më tepër në një rrjedhje truri. Ky është rasti i 74% të arsimuarve shqiptarë në Greqi, 67% në Itali, 58% në Austri dhe 70% në SHBA<sup>307</sup>.

### **KONKLUSIONE:**

Migrimi ndërkombëtar nga Rajoni i Shkodrës ka shërbyer si element mbijetese për shumë familje shqiptare në minimum të jetesës gjatë periudhës së tranzicionit. Procesi i emigrimit është pasuar nga faza e integritit që për një pjesë të mirë të shqiptarëve ka qenë e suksesshme. Mund të argumentojmë se ky proces ka qenë relativisht më i thjeshtë në vendet fqinje, në Greqi dhe Itali (kjo e fundit më tepër për emigrantët nga Shkodra), për shkak të afërsisë gjeografike, njohjes së gjuhës, afërsisë së tipareve kulturore dhe ekzistencës së emigrantëve më të hershëm, banesat e të cilëve kanë shërbyer si vend ankorimi për të afërmit dhe miqtë e tyre.

<sup>306</sup> Gedeshi, I., Jorgon, E. (2012): *Social Impact of Emigration and Rural - Urban Migration in Central and Eastern Europe*, Final Country Report, Albania, f. 17.

<sup>307</sup> Barjaba, 2004, Gedeshi, I., Jorgon, E. (2012): *Social Impact of Emigration and Rural - Urban Migration in Central and Eastern Europe*, Final Country Report, Albania, f. 15.



Përderisa në fund të viteve '90 dhe fillimin e mijëvjeçarit të ri, është rritur numri i bashkimeve familjare, kjo do të thotë që të larguarit e parë nga rajoni, janë përshtatur mjaft mirë dhe kanë pasur sukses në integrimin e tyre, pavarësisht vështirësive dhe paragjykimeve nga shoqëritë pritëse. Emigrantët e mirintegruar përbëjnë sot një komunitet të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare dhe disa prej tyre përfaqësojnë migrantët potencialë që në të ardhmen mund të kthehen në vendin e origjinës, si dhe të investojnë eksperiencat dhe kapacitetet e fituara në vendin e tyre të lindjes. Hartimi i politikave të migrimit duhet të orientohet drejt ndihmës së migrantëve të kthyer dhe përfitimit nga eksperiencat e tyre profesionale, gjithashtu dhe drejt motivimit të migrantëve të kualifikuar për t'u kthyer dhe për të investuar në vendin e tyre.

#### LITERATURA:

1. Barjaba, K., King, R. (2005): *Introducing and theorizing Albanian migration*, The new Albanian Migration, Sussex Academic Press.
2. Bushati, B. (2002): *Profili demografik i Shkodrës dhe lëvizjet migruese*, Seminari V Ndërkombëtar Shkodra në Shekuj, Shkodër.
3. Carletto, C., Davis, B., Stampini, M., Trento, S. & Zezza, A. (2004): *Internal mobility and international migration in Albania*, ESA Working Paper No. 04-13
4. Gedeshi, I., Jorgon, E. (2012): *Social Impact of Emigration and Rural - Urban Migration in Central and Eastern Europe*, Final Country Report, Albania.
5. Institute of Statistics, Institute of Public Health [Albania] and ICF Macro (2010): *Albania Demographic and Health Survey 2008-09*, Tirana, Albania: Institute of Statistics, Institute of Public Health and ICF Macro.
6. King, R., Mai, N. (2008): *Out of Albania, From crisis migration to social inclusion in Italy*, Breghahn Books,
7. King, R., Skeldon, R., Vullnetari, J. (2008): *Internal and International Migration: Bridging the Theoretical Divide*, Working Paper No 52, Sussex Centre for Migration Research.
8. Lutz, W., Prinz, C. (1993): *Modeling future immigration and integration in Western Europe*, The new geography of European Migrations, Great Britain, Belhaven Press
9. Mai, N., *Integrazione, Ritorno e Migrazione Circolare tra Albania e Italia*, Metoikos Project.
10. Martin, P. (1993): *The migration issue*, The new Geography of European Migrations, Belhaven Press, Londër.
11. Massey, D., Arango, J., Hugo, G., Kouaouci, A. & Pellegrino, A., Taylor, E. (1993): *Theories of International Migration: A Review and Appraisal* Population and Development Review, Vol. 19, No. 3 , 1993.
12. Piperno, F. (2002): *From Albania to Italy Formation and basic features of a binational migration system*, Background paper for the CEME-CeSPI research mission in Italy and Albania.

13. Vullnetari, J. (2007): *Albanian Migration and Development: State of the art review*, Working Paper No. 18, IMISCOE.

**Migrants integration - An important phase of International Migration.  
Shkodra emigrants case study**

***SUMMARY***

Migration is a phenomena that includes some stages of the population movement, from the decision to migrate, to the journey itself and then the permanent or the return migration. This article tends to analyze the stage of integration in the host country, as a less studied one. It has been consulted a foreign and Albanian literature concerning the Albanian migrants integration in the western countries which has been focused more on their settlement in Italy and Greece as the main destinations of Albanian out-migration. In the same time, the article tends to analyze also the integration of the migrants from Shkodra city, which is a new and unexplored aspect of migration in the field of social studies in Albania. The used methodology is mainly a qualitative one, based on the questionnaires realized with emigrants from Shkodra city. They were asked about the reasons that made them to leave the home country, how they choosed the destination, if they were employed before they left and the work they are doing nowadays in the host country.

This is also the structure in which this article is organised. It introduces first the countries chosen as destination ones, the reasons and then the integration itself. It argues the fact that Albanian migrants are an example of virtuous integration.

Nertila DILAVERI

## ZHVILLIMI I ARTIZANATIT NË RRETHIN E SHKODRËS

### 1. Zhvillimi dhe struktura e artizanatit në Shkodër

Shkodra është e njohur për traditën e hershme të artizanatit. Kjo traditë, me vlera të çmuara, e krijuar prej shekujsh nga mjeshtrat e kësaj krahine, shprehëse e karakteristikave dhe specifikave të këtij rajoni, ka spikatur me shumëllojshmërinë, numrin e madh dhe paraqitjen estetike të objekteve. Rajoni i Shkodrës është shquar në punimet prej guri, druri, bakri, ari, argjendi, lëkure, leshi, pëlhure etj., si pjesë e një trashëgimie kulturore unike me vlera të mëdha mbi identitetin rajonal dhe kombëtar.

Zejtaria artistike ka ekzistuar që në kohët e lashta, por zhvillim të madh mori në periudhën e mesjetës me organizimin esnafor të prodhimit. Madje, konkurrenca mes esnafëve zejtaro-tregtare, lokale dhe më gjerë *“bëri që prodhimet shqiptare të arrinin deri në atë shkallë cilësie sa të pëlqeheshin shumë dhe të shiteshin gjithënjë e më tepër si brenda ashtu edhe jashtë vendit”*<sup>308</sup>.

Brenda këtij organizimi ekzistonin prodhime të ndryshme artizanale. *“Puna e hollë dhe aftësia krijuese e këtyre zejtarëve, siç ishin mjeshtrit e kostumeve kombëtare, argjendarët, skalitësit e gurit dhe dyfekçinjët, tërhoqi kaq shumë admirimin e të huajve sa ata jo vetëm i blinin me ëndje për të zbukuruar dhomat e tyre, ose për t’u veshur me to, por edhe i reklamonin duke i paraqitur në ekspozita ndërkombëtare, si modele të rralla të një pune me shije të hollë artistike”*<sup>309</sup>. Një rast i tillë është ekspozimi i pushkëve dhe pistoletave me gdhendje dhe qëndisje nga Shqipëria, të prodhuara në Shkodër. Këto janë të prezantuara nga Perandoria Osmane në dy ekspozita ndërkombëtare të organizuara në vitin 1867 në Paris dhe në vitin 1894 në Çikago.

Zejtaria artistike mori hov dhe arriti kulmin e zhvillimit të saj gjatë shekullit XVIII dhe fillimin e shekullit XIX. Nën nxitjen e kërkesave për

<sup>308</sup> Shkodra, Z., *Esnafet shqiptare*, Tiranë, 1973, f. 223.

<sup>309</sup> Po aty, f. 224.

artikuj luksi nga ana e shtresave të pasura shoqërore, sidomos të aristokracisë feudale dhe të borgjezisë qytetare lulëzuan një sërë zejtarish artistike, si: punimi i kostumeve kombëtare, argjendaria, zbukurimi në ar dhe argjend i armëve të gjata e të brezit, punimi i enëve prej bakri e tunxhi, punimi i gëzofave etj. Risi e kësaj periudhe dhe dëshmi e lulëzimit të forcave prodhuese në fushën e artizanatit, ishte edhe kërkesa për ndërtimin e shtëpive luksoze. Kjo modë e re bëri që të aktivizoheshin një sërë mjeshtërisht artistike, si: daltimi i gurit, gdhendja e drurit, pikturat murale etj., të cilat shkëlqenin në dorën e mjeshtërive shkodranë që të zbukuronin mjediset e brendshme të dhomave shkodrane, si dhe ato të jashtme të këtyre shtëpive.

Daltimi i gurit është një lloj i zejtarisë artistike që lulëzoi gjatë shekullit XVIII, duke u bërë një art i fuqishëm popullor në dorën e mjeshtërive të krahinës së Shkodrës. Ky lloj artizanati ka gjurmë të hershme. Rrënojat e kështjellës së lashtë të “Rozafës”, një monument i rrallë arkitektonik që daton në shek. IV, p.e.s, “janë dëshmi e gjallë e dorës së shkathët të ustallarëve shkodranë”<sup>310</sup>.

“Relikja tjetër e vetme nga kohët e shkuara, aty rrotull, është ura e hijshme prej guri me harqe pranë Mesit, nja shtatë kilometra përtej fushës”<sup>311</sup>. Ura është ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XVIII nga Mehmet Pashë Bushatliu, në kohën e venedikasve, por “nuk ka të bëjë me venedikasit”<sup>312</sup>. Duke mbetur në të njëjtin kontekst, është e rëndësishme të theksojmë se “Nga tradita popullore kujtojmë se kalldrëmi Tophanë-Rus asht vepër e Kara-Mahmut Pashës, i cili kur lajmëroi popullin e Shkodrës për një mobilizim të përgjithshëm, njëherit ai lajmëroi edhe malësitë të uleshin në ditën e caktueme”<sup>313</sup>. Po kështu, zbukurimi i portave, mureve rrethuese të shtëpive, dritareve, oxhakëve etj., dëshmojnë për nivelin artistik të shprehur me një larmi formash dhe idesh autentike të mjeshtërive të këtij rajoni.

Siç dihet, deri në fillim të shekullit XX, petku kombëtar vazhdoi të përfaqësonte veshjen karakteristike të popullsisë së krahinës së Shkodrës. Prandaj, një vend të rëndësishëm në strukturën artizanale të kësaj krahine, zënë edhe punimi i pëlhurave të leshta dhe të pambukta, si dhe zbukurimi i tyre. Petku kombëtar, i kategorizuar sipas zonës dhe besimit fetar, zbukurohej nga terzinjtë myslimanë dhe katolikë në mënyrë krejtësisht artizanale. Madje, zbukurimi i kostumeve kombëtare në Shkodër, ishte i

<sup>310</sup> Leka, A., Dibra, M., *Artizanati*, f.11, Tiranë, 2007.

<sup>311</sup> Durham, E., *Brenga e Ballkanit*, f. 567, Tiranë, 1990.

<sup>312</sup> Po aty.

<sup>313</sup> Bushati, H., *Shkodra dhe motet*, f. 107, Shkodër, 1998.

ndarë në tri kategori: “Në kategorinë e parë kishin caktuar punimet artistike të ngarkuara rëndë me shiritë e gajtanë mëndafshi ngjyrë ari dhe argjendi, në të dytën punimet e lehta e më pak të ngarkuara dhe në të tretën rrobat e thjeshta pa zbukurime fare”<sup>314</sup>.

Në zgjerimin e strukturës së prodhimeve artizanale ndikoi gjithashtu edhe aktivizimi i zejtarive shtëpiake. Me rëndësi në këtë drejtim ishte lindja e degës së prodhimeve prej zhuge apo thupre, të cilat punoheshin prej banorëve të fushës së Shkodrës, kryesisht në Bushat, duke i bërë ata të njohur në tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Mbi zhvillimin e kësaj dege është e rëndësishme të citojmë se mjeshtërit shkodranë “*ushtronin tri zanate në kohën e Republikës, tri mjeshtëri karakteristike: 1. punimin e shajakut, 2. punimin e qelesheve dhe të shportave, dhe 3. mjeshtërinë e ngjyrosjes*”<sup>315</sup>. Bëhej fjalë për shkodranët që emigruan në Venedik pas pushtimit të Shkodrës nga ushtritë osmane.

Një tjetër veprimtari e rëndësishme në fushën e artizanateve ishte gdhendja e drurit. Tavanet dhe trapazanet e zbukuruara me motive orientale dhe vendase në shtëpitë e aristokracisë feudale dhe të borgjezisë qytetare, janë dëshmi e lulëzimit të këtij aktiviteti.

Kërkesat e mëdha për prodhimet e këtij artizanati sollën që shumë shpejt ai të integrohej brenda qendrës më të madhe zejtaro-tregtare të qytetit, Pazarit të Vjetër, ku një ndër sokaqet kryesore të tij ishte ai i arkaxhinjve. “*Tue hy brendë në Pazar të Madh prej Kryepazarit ka qenë “Sokaku i arkaxhinjve”*”, të cilët punonin arka të ndryshme, sidomos arka nusesh për qytetarë dhe fshatarë. “*Këto lloje arkash nuk përdoren ma prej qytetarëve, sepse janë tepër kabahe, zanë shumë vend ndër dhoma dhe janë të randa me u pezullue. Në vend të tyne sot nuset marrin në “pajë” mobilje moderne; ... Arkaxhinjtë punonin dhe djepe për fëmijë, shkopinj ramazani etj., punime dërrase*”<sup>316</sup>.

Në fakt, në sokaqet e Pazarit të Madh me mbi 1000 dyqane, ushtronin aktivitetin e tyre zejtaro-tregtar jo vetëm arkaxhinjtë, por një numër i shumtë artizanësh shkodranë, si: rrobaqepës, këpucarë, tabakë, kazazë, marangozë, kovaçë, jorganëpunues, leshpunues, samarxhinj, bakërpunues, argjendarë, poçarë, saraçë, berberë etj.

Lulëzimi i artizanatit dhe struktura e shumëllojshme e tij deri në fillim të shekullit XX, lidhej me fizionominë e prapambetur ekonomiko-shoqërore të shkaktuar nga robëria osmane.

<sup>314</sup> Shkodra, Z., *Esnafet shqiptare*, f. 225, Tiranë, 1973.

<sup>315</sup> Bushati, H., *Shkodra dhe Motet*, f. 310, Shkodër, 1998.

<sup>316</sup> Bushati, H., *Shkodra dhe Motet*, f. 231-232, Shkodër, 1998.

Fillimi i shekullit XX u shoqërua me ndryshime jo vetëm në situatën politiko-territoriale, por edhe në atë ekonomike. Në këtë periudhë “...përparimi industrial botnor i dha shkas ramjes së punimeve të dorës në vendin tonë. Kështu të punuemit e mëndafshit që një burim i mirë të ardhunash për ekonominë dhe artizanët shqiptarë. Importimi i mëndafshit nga Japonia në Itali e konkuroi mëndafshin e Shkodrës e që në atë kohë nisi ramja e artizanantit shkodran ...<sup>317</sup>”.

Rënia e artizanatit u thellua akoma më shumë në vitet e krizës ekonomike botërore. Shtrirja e krizës në të gjitha degët e ekonomisë krijoi një gjendje të rëndë edhe në artizanat. Kjo dukej nga fakti “që deri edhe qeleshet, prodhimi i të cilave kishte traditë shekullore në vendin tonë, po importoheshin nga vende të tjera”<sup>318</sup>, situatë kjo që erdhi duke u përkeqësuar akoma më shumë gjatë viteve 1939-1944, me ekspansionin e kapitalit italian në ekonominë shqiptare.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u fut në një periudhë të re, gjatë së cilës u ndërmorën një sërë reformash ekonomike e politike, që synonin kthimin e ekonomisë së vendit në një ekonomi të centralizuar shtetërore. Megjithëse theksi vihej në industrializimin e ekonomisë, me përparësi të industrisë së rëndë, me qëllim që ekonomia të çlirohej nga importimi i sendeve të domosdoshme të konsumit të gjerë, mori zhvillim edhe industria e lehtë dhe artizanati. Në këtë kuadër e gjithë veprimtaria artizanale u shndërrua në industri shtetërore e përfaqësuar fillimisht nga kooperativat e artizanatit, prej të cilave më vonë u ngritën ndërmarrjet e artizanatit artistik në disa rrethe të vendit. Një ndër to ishte edhe Ndërmarrja e Prodhimeve Artistike në Shkodër. Kjo ndërmarrje prodhonte në seri një gamë të gjerë prodhimesh artistike prej sermi, bakri, druri, kashte, metali, lulesh të thata, puplash, si dhe sixhade e qilima etj., kryesisht për të mbuluar nevojat e eksportit. E tillë ishte edhe Fabrika e Zhugës e cila “Asht vepër e re artizanati për punimin e zhugës dhe të kashtës. Para se të ngrihej kjo ndërmarrje, industrializimi i zhugës bahej në mënyrë primitive. Kjo ndërmarrje nisi të ndërtohej me 1962 dhe përfundoi në 1964. U hapi punë shumë punëtorëve”<sup>319</sup>. Më vonë kjo ndërmarrje u zgjerua me disa reparte të prodhimeve prej zunkth-kashte, prodhime që kanë konkurruar vazhdimisht me sukses në tregun e jashtëm.

Pas viteve '90 ekonomia shqiptare u fut në një periudhë tranzicioni, në atë të kalimit nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu.

<sup>317</sup> Po aty, f. 310.

<sup>318</sup> Fishta, I., Toçi, V., *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, f. 100, Tiranë, 1983.

<sup>319</sup> Bushati, H., *Shkodra dhe Motet*, f. 96-97, Shkodër, 1998.

Transformimet e mëdha në strukturën ekonomike përfshinë edhe degën tradicionale të artizanatit. Por rruga drejt reformave nuk ishte e lehtë, sepse alternativa e zgjedhur, “fillimi nga “zero” dhe lënia në shkatërrim e ndërmarrjeve të mëparshme shtetërore”<sup>320</sup>, krijoi vështirësi të mëdha edhe në këtë degë të prodhimit. Në themel të reformave qëndronte procesi i privatizimit të ekonomisë, i cili i dha mundësi ekonomisë shkodrane të rifitojë tiparet e një ekonomie kapitaliste të prerë në mes rreth gjysmës së shekullit XX. Operimi brenda një ekonomie të lirë, me zgjedhje të lira dhe barazi oportunitetesh, nxori si aktorë kryesorë ekonomikë SME-të, të cilat u përhapën me shpejtësi edhe në prodhimin artizanal. Kjo degë tradicionale e ekonomisë së rajonit të Shkodrës, u reformua brenda sistemit të ri ekonomik, i cili jo vetëm që mundësoi zhvillimin e degëve të mëparshme, por nxiti edhe lindjen e disa prodhimeve të reja, duke e pasuruar edhe më tej strukturën e prodhimeve artizanale të rajonit të Shkodrës me objekte me vlera funksionale dhe dekorative, në përshtatje me kërkesat e kohës. Ndër SME-të ose NVM-të më të rëndësishme artizanale dallohen: Gjino Mjeda, *Punime artizanale me tezgjah* (1880), *Angjo decor- punime hekuri dhe mermeri*, *Arlecchino-prodhim artizanal maskash për karnavale*, Zef Gjini, *Punime artizanale me dru*. Krahas tyre, në Shkodër e rrethinat e saj, ekziston një rrjet i gjerë punishtesh artizanale të profileve të ndryshme që operojnë në kuadrin e zejtarisë artistike shtëpiake. Panoramën e qartë mbi strukturën e shumëllojshme të punimeve artizanale sot në qytetin e Shkodrës dhe rrethinat e tij na e jep tabela e mëposhtme.




Fusha e veprimtarisë artizanale	Subjekti prodhues	Lloji i punimeve	Vendndodhja
Punime prej guri	Ridvan Meti	Ndërtime me gurë	Shkodër
	Fran Larushku	Veshje me gurë, ndërtim shatërvanesh, pusesh	Grudë e Re
Punime prej metali	Angjo sh.p.k.	Punime hekuri dhe mermeri	Shkodër
	Astrit Baca	Kangjella, dyer, ballkone, karriga, shalldan	Shkodër
	Fric Barbullushi	Punime filigrani	Shkodër
	Donald Satber Kruja	Punime filigrani Punime filigrani	Shkodër Shkodër

<sup>320</sup> Laçi, S., Sheme, S., *Gjeografia humane e Shqipërisë*, f. 91, Tiranë, 2005.

	Marin Gjonej Tonin Palushi Erzen Skuqaj	Punime ari dhe argjendi Punime bakri Punime bakri e llamarine	Shkodër Shkodër Shkodër
Punime prej druri	Adnan Komi Iilir Grishaj Astrit Kolë Mitaj Pjetër Vukaj Kasem Uruçi Eda Sh.P.K. Dafinor Sabahet Domni Sadetin Alivoda Zija Karini Zef Gjini	Punime dhe dekoracione Punime dhe dekoracione Punime dhe dekoracione Punime dhe dekoracione Vegla muzikore Punime me dru ulliri Punime dhe dekoracione Dekoracione Punime dhe dekoracione Punime dhe dekoracione Punime dhe dekoracione Punime dhe dekoracione	Shkodër Vermosh Selcë, M. e Madhe Selcë, M. e Madhe Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër
Punime prej tekstili	Hyrije Hasa Roza Ndoci Liza Ndreka Nebije Qotaj Tonine Mjeda Xhemalije Hasaj Artenca Kruja Vjollca Nishani Xhevdet Grezda	Punime tezgjahi Endje dhe tezgjah Punime tezgjahi Qilima Punime tezgjahi Punime tezgjahi Qëndisje Punime me grep Punim i qelesheve	Myselim, Shkodër Juban, Shkodër Juban, Shkodër Zogaj, Shkodër Shkodër Dragoç, Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër
Punime prej lëkure	Esat Haki Rama Fatmir Shpuza	Saraç Punim këpucësh	Shkodër Shkodër
Punime porcelani, mermeri, allçie	Adela Gjoka Dea Dekoracion Hilmi Tafa Andrea Daka	Punime porcelani Dekoracione prej mermeri Punime me allçi Punime porcelani	Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër
Punime prej xunkthi	“Sidrit” company Mensur Myftia Sami Anamali Ymer Mesi dhe Agim Buçi	Punime thupre Punime thupre Punime thupre	Shkodër Shkodër Shkodër Shkodër



	Xhavit Jubani	Punime thupre	Shkodër
Punime maskash	Edmond Angoni	Maska karnavalesh	Shkodër



## 2. Impakti i artizanatit në disa problematika sociale

Nga shqyrtimi i historikut dhe strukturës së prodhimit artizanal del qartë se, artizanati ndër vite ka qenë një degë prezente në ekonominë shkodrane. Madje, ka pasur periudha shkëlqimi, siç është ajo nga mesi i shekullit XVIII deri në vitet '50-'60 të shekullit XIX, kur Shkodra mbizotëronte ndaj qendrave të tjera të vendit. Karakteri zejtari i prodhimit dhe prania e një tregu shumë të rëndësishëm ndërkrahinor e më gjerë, Pazarit të Madh, kanë qenë faktorë të rëndësishëm për ekzistencën e vazhdueshme të tij, si mjeshtri, art dhe si mënyrë jetese.

Format e ndryshme të organizimit të prodhimit artizanal, esnafor apo si zejtari artistike shëpiake, i kanë dhënë vazhdimisht impulse pozitive punësimit në Shkodër e rrethinat e saj. Në fakt, të dhëna të sakta mbi numrin e të punësuarve në këtë degë të ekonomisë shkodrane deri pas çlirimit të vendit nuk ka. Por, fakti që në Pazarin e Shkodrës ekzistonin sipas radhës dyqanet e 80 zejeve të ndryshme, disa prej të cilave u shndërruan në artizanat, tregon impaktin pozitiv të tij mbi punësimin: "*Çdo ditë në pazar është interesante, sepse pothuaj të gjithë dyqanxhinjtë i bëjnë vetë, si zanatçinj, mallrat ...*".

Këta artizanë tregtarë, të Shkodrës, janë një bashkësi e ndershme dhe e sjellshme<sup>321</sup>. Madje, pavarësisht nga pozicioni shoqëror i gruas në këtë periudhë, artizanati ishte e vetmja degë e prodhimit material që nxiste punësimin e femrave. Në gamën e gjerë të prodhimeve artizanale, sidomos në prodhimin e pëlhurave të leshta, të pambukta e të mëndafshita, në qepjen dhe zbukurimin e veshjeve kombëtare, gratë ishin fuqia kryesore punëtore. "*Simbas të dhanave të pleqve, ndër kohë të vjetra, shumë nga zonjat e Shkodrës punonin vetë pëlhurën, kishin tezgjahet e ngrehuna ndër shtëpitë e tyre. Ata përgatitnin pëlhurë të ndryshme mëndafshi dhe pambuku*"<sup>322</sup>.

Në fakt, kjo situatë lidhej me një periudhë të caktuar, mesi i shekullit XVIII, deri në fillim të shekullit XX, kur artizanati nxitej nga sistemi zejtari i organizimit të ekonomisë shqiptare dhe ishte një degë e lulëzuar. Megjithatë, kur kriza ekonomike botërore përfshiu edhe ekonominë shqiptare, artizanati nuk mundi t'u shmangej pasojave të realitetit ekonomik ku ekzistonte. Prandaj, duke filluar nga vitet '30 të shekullit të kaluar e deri pas Luftës së Dytë Botërore, për shkak të krizës dhe konkurrencës së prodhimeve të huaja, në Shkodër, si në shumë qytete të tjera shqiptare, vihet re rrënimi i shumë artizanëve: "*Në palcë e ndien krizën prodhuesit artizanë, të cilët zhvillonin veprimtari prodhuese e*

<sup>321</sup> Durham, E., *Brenga e Ballkanit*, f. 558, Tiranë, 1990.

<sup>322</sup> Bushati, H., *Shkodra dhe motet*, f. 330, Shkodër, 1998.

*shërbimi nga më të ndryshmet: ..., pa përmendur artizanatin shtëpiak, i cili vepronte gjerësisht në qytet e në fshat. Me këtë veprimtari jetonin mijëra familje*<sup>323</sup>.

Duke filluar nga mesi i viteve '40 të shekullit të kaluar, kur ekonomia shqiptare u organizua sipas modelit të ekonomisë së centralizuar, edhe prodhimi artizanal u përfshi në strukturat e reja prodhuese. Fillimisht me kooperativat e artizanatit e më pas me ndërmarrjet artistike, prodhimi artizanal shërbeu për punësimin, qoftë të artizanëve të vjetër, qoftë të artizanëve të rinj, të cilët u arsimuan enkas në shkollat profesionale. “*Këto kooperativa ishin shndërruar në punëtori të mëdha*”<sup>324</sup>. Në Shkodër, ndërmarrje të tilla ishin: ndërmarrja e prodhimeve prej xunkthi dhe kashte, e cila në vitin 1989 kishte 2600 punëtorë, si dhe ndërmarrja e artizanatit artistik me 1300 punëtorë. Në të dyja këto ndërmarrje 80% e të punësuarve ishin femra. Këto ndërmarrje ishin të pranishme deri në fillimin e viteve '90 të shekullit të kaluar, kohë kur ekonomia shqiptare u fut në rrugën e transformimeve të thella politike dhe ekonomike. Procesi i privatizimit, si elementi më thelbësor i tranzicionit nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu, pa dyshim që u shoqërua me pasoja mbi situatën e punësimit edhe në këtë degë të ekonomisë. Shkatërrimi i ndërmarrjeve të mëdha shtetërore u shoqërua me rënien e prodhimit artizanal dhe të të punësuarve në të. Megjithatë, liria ekonomike dhe ristrukturimi i prodhimit mbi bazën e NVM-ve, nxiti prodhimin edhe në artizanat. Tradita e grumbulluar, kualifikimi i fuqisë punëtore, krijimi i vendeve të punës dhe nxitja e punësimit të grave, ishin premisa për mbijetesën e kësaj dege në vitet e tranzicionit. Gjithashtu, bizneset sociale, sipërmarrje të lindura kohët e fundit, kanë pasur impakt pozitiv mbi prodhimin dhe punësimin, sidomos punësimin e femrave në këtë degë tradicionale të ekonomisë së rajonit të Shkodrës, rajon ky me një nivel të lartë papunësie dhe varfërie.

Subjekti	Nr. total i të punësuarve	Nr. i të punësuarve femra	Viti
Angjo sh.p.k.	7	0	2013
Arlecchino	58	52	2014

<sup>323</sup> Fishta, I., Toçi V., *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, f. 99, Tiranë, 1983.

<sup>324</sup>Toçi, V., *Zhvillimi i industrisë në Shqipëri në vitet 1960-1980*, f. 95, Tiranë, 1989.

Fric Barbullushi & Co	9	6	2013
Dafinor	56	22	2013
Gjino Mjeda	4-6	4-6	2013
Zef Gjini	4	1	2014
Dea Dekoracion	12	6	2014
Nebije Qotaj	15	15	2014

Tabela e mësipërme tregon numrin total të të punësuarve në disa nga bizneset kryesore në fushën e artizanateve në Shkodër, si dhe të punësuarit sipas gjinive (në tabelë është paraqitur vetëm nga një sipërmarrje artizanale përfaqësuese në një fushë të caktuar të prodhimit artizanal). Të dhënat nuk pasqyrojnë impaktin real të artizanatit mbi punësimin dhe punësimin gjinor, pasi shumë biznese nuk janë të deklaruar ose të regjistruara dhe disa nuk deklarohen numrin real të të punësuarve me qëllim shmangien e detyrimeve shtetërore. Prandaj, mund të konkludojmë se, impakti i artizanatit mbi problematika të tilla, është shumë më pozitiv nga ajo që deklarohet zyrtarisht. Të dhënat në tabelë janë marrë nga Zyra e Punësimit Shkodër dhe direkt nga disa administratorë të biznesit artizanal.

#### BIBLIOGRAFIA:

1. Bushati, H. (1998): *Shkodra dhe Motet*, Shkodër.
2. Durham, E. (1990): *Brenga e Ballkanit*, Tiranë.
3. Fishta, I., Toçi, V. (1983): *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, Tiranë.
4. Laçi, S., Sheme, S. (2005): *Gjeografia humane e Shqipërisë*, Tiranë.
5. Leka, A., Dibra, M. (2007): *Artizanati*, Tiranë.
6. *Studime Albanologjike 4*, Tiranë, 2009.
7. Sheme, S. (2012): *Gjeografi e industrisë*, Tiranë.
8. *Shkodra në Shekuj*, Seminari V Ndërkombëtar, Shkodër, 2006.
9. Shkodra Z. (1973): *Esnafet shqiptare*, Tiranë.
10. Të dhëna nga Zyra e Punësimit Shkodër.
11. Toçi, V. (1989): *Zhvillimi i industrisë në Shqipëri në vitet 1960-1980*, Tiranë.

## **The development of handicrafts in the district of Shkodra**

### ***SUMMARY***

This article presents an overview on the development of handicrafts in the district of Shkodra. The article examines chronologically the ancient tradition of craft production in Shkodra as one of the most developed economic centers of our country.

Another important aspect that is treated here is the incredibly complex structure of craft production and the changes to the structure suffered during the historical evolution in accordance with the needs and requirements of economic development in Shkodra and beyond.

The article also treats the impact that had and has the handicraft on some social issues in the district of Shkodra, where specifically is treated the impact on employment and employment gender (female) as a proper orientation in the policies of economic and social integration.

Ervis KRYMBI

## EVOLUCIONI DHE TRANSFORMIMET URBANE NË QYTETIN E SHKODRËS

### 1. Vështrim mbi profilin urban të qytetit të Shkodrës

Urbanizimi i Shkodrës ka filluar shumë kohë më përpara se periudha kontemporane dhe aq larg sa periudha iliriane e prehistorike. Megjithatë, në kontekstin prezent ne jemi të interesuar kryesisht me zhvillimin e tij nga periudha Otomane, dhe me së shumti gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, kur ndryshime të thella zunë vend në qytet si pasoja të impaktit politik dhe atij rajonal. Është interesante të shënohet nga dokumentet e mëposhtme, që territori urban fillestar për Shkodrën, ishte organizuar në formën e një sistemi të gjerë fshatrash të vogla, të cilat janë të lokalizuara përgjatë bregut të liqenit, në të dy pikat, si Shiroka dhe Zogaj, të cilat sot janë përfshirë nga qyteti.

Qyteti i Shkodrës, me pozicionin e tij të favorshëm gjeografik, i ndodhur në mes një zone të begatshme, në afërsi, i rrethuar prej ujërave, në kryqëzim të disa rrugëve tokësore dhe ujore, me klimë të mirë dhe reliev shumë të përshtatshëm nga ana topografike e strategjike, ka pasuri kushte natyrore lehtësuese për ngritjen e një vendbanimi urban, të rëndësishëm që nga prehistoria. Shkodra antike përfaqësonte një ndër qytetet më të rëndësishme me tipare urbane në rajonin jugor të Ilirisë.<sup>325</sup> Ndërtimi i saj e ka zanafillën që nga ndërtimi i kalasë, si element i parë urbanistik që u krye nga të parët tanë, fisi ilir i Labeatëve.<sup>326</sup> Ky qe një fortifikim dinjtoz për natyrën e ndërtimit, prandaj edhe ndërtimet e mëvonshme për një periudhë kohore u përqendruan rreth saj. Si kryeqendër Sanxhanku, qyteti i Shkodrës arriti kulmin e zhvillimit gjatë Dinastisë së Bushatlinjve, me Mehmet Beg Plakun, vazhduar me lavdi me Kara Mahmut Pashën në vitin 1831. Në periudhën e Bushatlinjve Shkodra numëronte 40.000 banorë të shpërndarë në *mahalla* (lagje), të ndara në tri distrikte, Tophanë, Terzihane, Tabak.<sup>327</sup> Qyteti kishte 8.000 shtëpi të banuara nga myslimanë, ndërsa numri i

<sup>325</sup> Prendi, F., "Le Néolithique et l'Énéolithique en Albanie". Iliria 6, 49-99.1976.

<sup>326</sup> Ippen, Th., "Skutari und die nordalbanische Küstenebene" (Sarajevo, 1907), p. 27-32.

<sup>327</sup> Naci, S., "Pashallëku i Shkodrës nën Sundimin e Bushatllijve", Tiranë, 1964, f. 127.

shtëpive të banuara nga katolikët arrinte në 600, të cilët në qytet kishin edhe rezidencën e Peshkopit dhe Kishën e tyre.<sup>328</sup>



Harta nr.1 Trajta e zhvillimit urban të qytetit të Shkodrës

Vërshimet e vrullshme të lumit Drin e Kir, gjatë vjeshtës e dimrit të 1770, shkaktonin shumë vështirësi për banorët e lagjeve rrëzë Rozafatit, Qyteti i vjetër me lagjet Tabak, Ajasmë dhe Tepe, ishte i ndarë një pjesë myslimane që ndodhej në perëndim përgjatë liqenit dhe në lagje katolike në lindje.<sup>329</sup> Qyteti i vjetër me kalimin e kohës po zbrazej për të mbushur të riun, i cili ndodhej jo larg pazarit. Administrata otomane u largua prej Kështjellës së Rozafatit më 1865 dhe qyteti i ri filloi jetën e tij urbane. Rugë dhe lagje të reja filluan të ndërtoheshin, me to edhe godina të reja publike, shtëpi private dhe objekte kulturi.<sup>330</sup> Përveç stilit tradicional të shtëpive me çardak, në qytetin e ri filluan edhe ndërtimi i shtëpive dhe ndërtesave publike me stile që i përngjanin teknikave të ndërtimit të Evropës Qendrore. Lagjet e reja që u ngritën vazhduan traditën e vjetër në

<sup>328</sup> (Papa) Pandejmoni Enriketa., “Shkodra: household, family and urban life: 1918-1939”: dissert zur Erlangung des Doktorgrades. Graz, 2013.

<sup>329</sup> Migliorini, E., “Terra e Nazione Penisola Balcanica”, Milano, 1939.

<sup>330</sup> Cuni, Z., “Banesa popullore në Shkodër”. Tek Seminari I Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër, 1994.

bazë religjioni sipas modelit urban oriental, qytetarët myslimanë jetonin në lagjet myslimane dhe ato katolikë në lagjet respektive.

Krijimi i qytetit të ri nuk u krye pa ndonjë kriter apo mendim urbanistik. Zona e re e banimit, lagjet e reja, u shtrinë përgjatë tri rrugëve ekzistuese të karavaneve, duke ardhur nga thellësia e territorit të Sanxhakut, madje me drejtim sa më të shkurtër, sipas mundësive, për në pazarin vjetër të Shkodrës. Pra kemi të bëjmë me një sistem rrezor urbanistik, me nyje kompozicional pazarin qendrën ekonomike të qytetit. Ky rrjet rrugor ishte racional, meqënëse lidhte mjaft shkurt qendrën e re të banimit me atë të punës, pazarin. Formulimi i këtij sistemi rrezor drejt atij gjysmëunazor dhe pjesërisht këndrejtë, në disa zona të qytetit të ri, na pasqyronte edhe faktin që ky rrjet është prirë nga disa koncepte e kritere urbanistike, megjithëse nuk u parapri nga një plan i mirëfilltë urbanistik. Zgjerimi i Shkodrës së re u krye përgjatë tri rrugëve kryesore të karavaneve, ku lagje të reja u krijuan që në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII dhe kryesisht nëpër rrugën që kalonte në bregun lindor të liqenit të Shkodrës, në drejtim të Tuzit e Podgoricës, ku u krijua lagjja “Ndocaj“, në atë të bregut të lumit Kir, për në Malësi të Madhe, lagjet u shtrinë deri në Rus dhe më vonë u vendos lagjja Perash.<sup>331</sup>

Lidhja e qendrës së banuar me tregun me rrugë sa më të shkurtër, ka krijuar disa rrugë kryesore, që fillojnë prej pazarit të vjetër dhe përshkojnë qytetin në drejtim të verilindjes. Rrugë të tjera të dorës së dytë e të tretë, shumë prej këtyre të fundit pa krye, ndërldhin qytetin. Krijimi i qendrës së re të banuar, duket se nuk u parapri, pra nga ndonjë përkujdesjeje urbanistike. Siç duket, së pari, çdo ndërtues rrethonte si mundte parcela të mëdha toke me mure të larta avllish dhe brenda saj ndërtonte banesën e tij. Me dendësimin e ndërtimeve u krijuan shkallë-shkallë konturet e një sërë rrugësh dytësore, që lidheshin me arteriet kryesore që të çonin në Pazar, dhe një mori rrugicash pa krye, anash rrugëve dytësore, madje dhe arterieve kryesore.<sup>332</sup> Të bien në sy emërtimet e rrugicave pa krye, të cila pa përjashtim mbanin mbiemrat e familjeve që kishin ndërtuar banesat e tyre me dalje në këto rrugica. Madje dhe shumica e rrugëve dytësore, gjithashtu emërtoheshin në të njëjtën mënyrë. Këto ishin reflekse të spontanitetit në formulimin urbanistik të qytetit të Shkodrës. Qyteti i Shkodrës si gjithë qytetet e tjera shqiptare gjatë viteve 1921-1930, njohu disa zhvillime nga pikëpamja urbanistike, ndonëse

<sup>331</sup> Luzati S., “Qyteti i Shkodrës: urbanistika dhe arkitektura gjatë Rilindjes e Pavarësisë Kombëtare”, Tiranë, 2012.

<sup>332</sup> Riza, E., “Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek. XV-XIX”, Tiranë, 2009.



ritmet e përparimit në këtë fushë ishin të ngadalta. Në këto kushte, menjëherë pas Kongresit të Lushnjës, qeveritë shqiptare që erdhën në pushtet, përgatitën dhe miratuan një sërë ligjesh që kishin të bënin me sistemin urbanistik të qyteteve. Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave, me 4 shtator 1922, miratoi ligjin për rregullimin e sistemin e rrugëve dhe ndërtesave të çdo qyteti, duke u përshtatur me planin e përgjithshëm të tyre.<sup>333</sup> Qyteti i Shkodrës, përta i përket pamjes së përgjithshme urbanistiko-arkitektonike, në këto vite nuk pësoi ndryshime rrënjësore. Ajo që e dallonte atë në këtë periudhë ishte nga njëra anë, konsolidimi, përmirësimi dhe çuarja përpara e shumë zgjidhjeve të zbatuara më parë në urbanistikë, ndërsa nga ana tjetër, si rezultat i kushteve të reja historike, lindën dhe u zhvilluan këtu disa procese të reja. Qyteti i Shkodrës në këtë periudhë ruan po atë skemë urbanistike që në shekullin XIX, me përjashtim të disa ndërtimeve, si dogana, spitali, apo ndonjë ndërtesë tjetër e ngritur nga austro-hungarezët gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore.<sup>334</sup> Gjatë viteve 1921-1925, në qytetin e Shkodrës u ndërtuan disa godina dyqanesh moderne për kohën të vendosura në “Rrugën e Madhe”, në “Dugajt e Reja”, në fushën “Hasan Riza”. Gjithashtu u morën masa për asfaltimin e rrugëve të qytetit, megjithëse sistemimi i tyre mbeti një problem shqetësues si për këto vite, ashtu edhe për të ardhmen.<sup>335</sup> Në kohën e shirave, për shkak të mungesës së kanalizimeve, rrugët e qytetit mbusheshin me ujë si pasojë e vërshimit të lumenjve të Kirit e të Bunës. Madje, në situata të tilla, njerëzit ishin të detyruar të përdornin lundra për të kaluar nga një shtëpi tek tjetra, sepse kishte raste që thellësia e ujit shkonte më shumë se 1 metër. Dëme të mëdha i kishin shkaktuar qytetit shirat e shumta të nëntorit të vitit 1922, kur lumi Buna mbuloi krejt pazarin e Shkodrës, si dhe lagjet Parrucë, “Arra e Madhe”, “Perash” etj.

## **2.Trajta urbane e qytetit të Shkodrës mes sistemeve e ndryshimeve politike**

Gjatë periudhës fillestare pas luftës, modeli hapësinor i qytetit ndryshoi rrënjësisht. Megjithatë, pas viteve të një pushtimi ushtarak italian të shkurtër gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1943), pasuar nga instalimi i regjimit komunist, qyteti ndoqi modelin e qyteteve të tjera “socialiste

<sup>333</sup> AQSH, Fondi 246, 06.08.1923, dosje 6.dok.11.


<sup>334</sup> “Shqypnia e ilustrueme”, Shkodër, 1928.

<sup>335</sup> Duka. V., “Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924”, Tiranë, 1997, 166.

bashkëkohore”. Vendi kishte mbyllur kufijtë me botën e jashtme dhe ndryshime të reja në modelin urban filluan të zënë vend. Qyteti u bë një “makinë në lëvizje”, duke u zgjeruar drejt Veriut. Zona industriale ishte krijuar në Veri. Në rripin e djathtë të lumit Kir, ishte pozicionuar hapësira e manufaktureve dhe lidhja me hekurudhën e zhvilluar rishtazi, kishte kthyer qytetin në një qendër të rëndësishme të prodhimit dhe përqendrimit të popullsisë së vendit.

Po ashtu zona qendrore e qytetit në këtë periudhë, u përfshi dhe iu nënshtua ndryshimeve radikale. Godinat e banimit në formën e habitatit kolektiv, ishin zhvilluar më shumë mbi bazën e modelit të arkitekturës së re socialiste, duke zëvendësuar shtëpitë individuale tradicionale me kopshtet e tyre. Pazari i vjetër, një prej vendeve me atraktive të qytetit që përbënte një trashëgimi unike të zhvillimit urban shqiptar gjatë periudhës Otomane, bashkë me një numër të madh të ndërtimeve fetare me vlera historike, u dëmtuan seriozisht nga një lëvizje e modernizimit të ri të modelit socialist. Gjatë intervalit kohor 1955-1960, ekosistemi i qytetit rritet në sipërfaqe (600 ha), ku krahas mjediseve të banimit rritet sipërfaqja ekonomike. Qyteti i Shkodrës kufizohet nga liqeni në perëndim, nga lumi i Kirit në juglindje, nga Drini në jug e jugperëndim. Në veri e verilindje arrin deri në Stom Golem, si dhe në ish-tokat eksperimentale të Institutit të Misrit. Në fillim të viteve 1990 kishte një sipërfaqe prej 13,3 km<sup>2</sup>, prej të cilave 9,2 km<sup>2</sup> sipërfaqe urbane dhe 4,1 km<sup>2</sup> rururbane. Në vitin 2000 sipërfaqja e qytetit arriti 24,2 km<sup>2</sup> prej të cilave 13,3 km<sup>2</sup> sipërfaqe e mirëfillte urbane dhe 5,9 km<sup>2</sup> sipërfaqe rururbane. Sipërfaqja e territorit të qytetit ka pjerrësi 0,5° dhe lartësia nivelin e detit, minimale 6 metra dhe maksimale 16 metra, ndërsa lartësia mesatare është 11 metra. Në vitin 2004 sipërfaqja e përgjithshme ka arritur 27.4 km<sup>2</sup>. Në rritjen e sipërfaqes së qytetit kanë ndikuar krijimi i lagjeve të reja në breg të liqenit të Shkodrës (Shiroka dhe Zogaj), në veri të qytetit, në lindje e juglindje, kjo nga të ardhurit gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Kjo e fundit vazhdon të rritet dhe në fund të vitit 1990 sipërfaqja e qytetit arrin në 13.3 km<sup>2</sup> (1330 ha), ku sipërfaqja e mirëfillte urbane zinte 9.2 km<sup>2</sup> dhe ajo suburbane (ose më mirë rururbane) zinte 4.2 km<sup>2</sup>. Në vitin 2002, sipërfaqja e përgjithshme e qytetit të Shkodrës ka arritur mbi 27.4 km<sup>2</sup>. Në rritjen e sipërfaqes së qytetit, kanë ndikuar krijimi i lagjeve të reja në breg të liqenit, në veri të qytetit, në lindje e juglindje, nga të ardhurit gjatë këtyre 20 vjetëve të fundit. Trualli ku është vendosur sot qyteti i Shkodrës ndërtohet prej depozitimeve proluviale e aluvionale të kuatemarit, të përbëra nga zhavore të rrumbullakosura të formuara nga copëzat karbonatike, si dhe nga rërat, argjilat etj. Trashësia e tyre luhetet

nga 50 në 80 m. Këto depozitime janë të mbivendosura mbi një bazament rrënjësor karbonatikësh, të njëjtë me ata që shohim në Tarabosh, në kodrën e kalasë. Ky truall i ndërtuar nga këto depozitime zotëron aftësi të vogla antisizmike, për shkak të lëvizshmërisë dhe të mbajtjes së ujërave të shumta nëntokësore dhe dobësisë së çimentimit natyror. Prandaj lëvizjet sizmike (tërmetet), pasqyrohen me lëkundshmëri të lartë, të shoqëruara shpesh me dëme të konsiderueshme. Mund të përmenden si tërmete shumë dëmtuese, ai i vitit 1905, i vitit 1979, etj., që janë shoqëruar jo vetëm me dëme të mëdha materiale në ndërtesa, por edhe në çarje të thella të truallit dhe shpërthim ujërash nëntokësorë, me shembje gjatë brigjeve të lumenjve. Për sa i përket ujërave nëntokësore të truallit të qytetit, duhet të themi se, ashtu si gjithë territori përreth edhe territori i qytetit përbëhet nga zhavoret të përziera mjaft nga depozitimet argjilore që janë të lidhura mes tjerash edhe me veprimtarinë rreth 350 vjeçare të njeriut që kur qyteti u shtri në fushën ku është sot. Kështu pra, rrjedhin nga lindja drejt perëndimit ujëra natyrorë, të cilët shkarkohen në liqen. Niveli i këtyre ujërave ndryshon sipas stinëve. Qyteti i Shkodrës përshkohet nga një sistem i dendur dhe i ndërlikuar rrugësh. Rrugët kryesore arrijnë një gjerësi maksimale deri 18 m dhe gjatësi mbi 1 km. Gjerësia minimale e rrugëve të qytetit arrin 3,5 m dhe gjatësia minimale nga disa dhjetëra metra në disa qindra. Gjatësia e përgjithshme e rrugëve të qytetit arrin në 110 km. Rrugët janë të ngarkuara me një rrjet inxhinierik nëntokësor, përfaqësuar nga kanalizimet e ujërave të zeza, ujërave të bardha, ujit të pijshëm, kablllove elektike etj.



*Harta nr.2 Shtirirja aktuale e qytetit të Shkodrës dhe e dy lagjeve të reja të tij Shirokë e Zogaj*

Nëse para viteve 1990, përmes një plani të centralizuar të përdorimit të tokës, shteti si politikëbërësi dhe kontrolluesi i vetëm i burimeve përcaktonte se ku dhe si do të organizohej ofrimi i shërbimeve, banimi etj., me adoptimin e ekonomisë së tregut ai humbi monopolin e ofruesit të vetëm të produkteve dhe shërbimeve. Por nëse tërheqja e shtetit si ofrues në treg, edhe pse e debatueshme për disa shërbime, ishte një zgjedhje logjike në funksion të fuqizimit të ekonomisë së tregut, tërheqja *de facto nga roli rregullator në fushën* e zhvillimit urban ishte një inerci e pamenduar që jo vetëm nuk mundësoi një zhvillim urban eficient, por mbi të gjitha, korruptoi sistemin dhe ekstremizoi pragmatizmin individualist në raport me qytetin. Aktualisht, pavarësisht kontributit që ka dhënë urbanizimi në zbutjen e varfërisë, në mungesë të një planifikimi urban efektiv, ky proces është shoqëruar dhe me mjaft probleme, si përjashtimi social, segregimi urban, dhe dëmtimet në mjedis.<sup>336</sup> Qyteti i Shkodrës, filloi të ndryshojë me ritme mjaft të shpejta, si rezultat i hapjes së kufijve me botën e jashtme.

### 3. Fenomenet e qytetit modern gjatë tranzicionit të dy dekadave të fundit

Në fund të regjimit komunist në fillimet e viteve 1990, me hapjen e kufijve me botën e jashtme dhe lejimin e lëvizjes së lirë të popullsisë brenda dhe jashtë kufijve, qyteti i Shkodrës (ashtu si të gjitha qytetet e mëdha të vendit në atë periudhë tranzicioni), pësoi një transformim mjaft të shpejtë, përta i përket procesit të zgjerimit hapësinor, duke mos ndjekur një formë urbane të organizuar dhe të konsoliduar mirë. Qyteti hyri në një vërshim të pakontrolluar të zhvillimit, provokuar nga mbërritja e popullsisë së re, inkurajimi i perspektivës për ndërtim banesash, mundësitë e emigrimit ndërkombëtar, mundësitë e reja të punëve në aktivitetet ekonomike informale.

Qyteti i Shkodrës në këtë mënyrë pati rritje si në numrin e popullsisë, ashtu edhe në atë të ndërtimeve. Rregullat e ndërtimit ishin reduktuar drejt një uniformiteti, pa ndonjë respektim të mjedisit, ose të vlerësimit të peizazhit.<sup>337</sup> Ky zhvillim është i përqendruar, në mënyrë të veçantë, në pjesën perëndimore të qytetit, në drejtim të liqenit, ku një numër i madh objektesh banimi janë ndërtuar. Urbanizimi në qytetin e Shkodrës nuk shoqërohet me mbipopullim, sepse popullsia e ardhur

<sup>336</sup> Gjika, A, Shutina, D; “Sfidat e pushtetit vendor mbi zhvillimet urbane dhe sektorin e strehimit në Shqipëri”, gjendet online në format pdf në web page <http://www.co-plan.org/>

<sup>337</sup> Krymbi, E., “Aplikimi i GiS për studimin e rreziqeve natyrore në qytetin e Shkodrës”. Studime Albanologjike Nr.IV, Tiranë, 2010.


balancohet deri në njëfarë mase nga ajo që shpërngulet. Por, pavarësisht nga kjo, qyteti përballet me një sërë problemesh të reja sociale, ekonomike dhe të mjedisit. Në shtypin e përditshëm ndeshemi edhe me fjalën “urbanicid”, e cila i referohet ‘përçudnimit’ të qyteteve shqiptare gjatë këtyre 20 viteve të fundit nga zhvendosjet pa kriter të të ardhurve nga zonat e thella malore, si dhe nga ndërhyrjet në infrastrukturën e qytetit edhe të vendasve, të cilët marrin ku me të drejtë e ku pa të drejtë tokat që u janë konfiskuar nga shteti gjatë viteve të regjimit komunist. Në pjesën më të madhe të rasteve, të ardhurit po vendosen në shtëpi, të cilat janë ndërtuar pa kriter dhe pa një planifikim të caktuar urbanistik, ose në ndërtesa publike që janë në pronësi të shtetit apo të pronarëve privatë dhe nuk pranojnë të dalin që andej. Sipas PPV të qytetit të Shkodrës, përgatitur në dhjetor të vitit 2009, popullsia e planifikuar për 10 vitet e ardhshme është 141.008 banorë, kundrejt 113.781 banorëve në vitin 2009. Sipërfaqja e ndërtimit e planifikuar për banorët e rinj është 3.755.766 m<sup>2</sup>, rreth 863.510 m<sup>2</sup> më shumë se ajo ekzistuese. Plani parashikon që për 10 vitet e ardhshme, zhvillimi të fokusohet në qendër të qytetit, ndërsa jashtë saj do të zhvillohen banime me dendësi të ulët.

Me hapjen e kufijve me botën e jashtme dhe lejimin e levizjës së lirë të popullsisë brenda dhe jashtë kufijve (si rezultat edhe i zgjerimit hapësinor, duke mos ndjekur një formë urbane të organizuar dhe të konsoliduar), qyteti i Shkodrës hyri në një vërshim të pakontrolluar të zhvillimit, provokuar nga: *1.mbërritja e popullsisë së re*, *2.lehtësirat nga lëvizja e re*, *3.mundësitë e reja për aktivitetet ekonomik informal*. Qyteti i Shkodrës u rrit virtualisht në çdo drejtim, përveçse ku pengesë u bënë shkaqet e ndryshme natyrore, të cilat ishin të pakapërcyeshme. Rregullat e ndërtimit ishin reduktuar drejt një uniformiteti, pa ndonjë respektim të mjedisit, ose të vlerësimit të peizazhit. Ky zhvillim u përqendrua, në mënyrë te veçantë, në pjesën perëndimore të qytetit, në drejtim të liqenit, ku një numër i madh i shtëpish banimi u ndërtuan shpejt. Proces i konstruksionit për banim mbuloi gjithashtu, zonat brenda periferisë së qytetit, siç ishin zonat rreth stacionit të trenit, ish-zona industriale, ndërmjet qytetit dhe lumit Drin, rreth kodrave dhe në hyrje të qytetit, rrëzë Kështjellës “Rozafa”. Qyteti i Shkodrës gjithashtu, rritet vertikalisht, veçanërisht vitet e fundit, me ndërtimin e komplekseve të mëdha rezidenciale, të përqendruara përgjatë akseve urbane kryesore, duke ndryshuar në këtë mënyrë disa nga perspektivat historike dhe natyrore të qytetit.

Zhvillimet demokratike u shoqëruan me lëvizje të fuqishme demografike, të cilat së bashku me nevojën për strehim, sollën me vete



zëvendësohen, duke përdorur kryesisht materiale druri. Lyerja e fasadave duhet t'u referohet ngjyrave të ngrohta tradicionale të Shkodrës.



Harta nr.4 Zona informale nr.2, lagjia Livade (ish- zooteknika) Burimi :  
ALUIZNI, Shkodër

## KONKLUZIONE:

Qyteti i Shkodrës ka pësuar ndryshime në hapësirën e tij territoriale, si në qendër ashtu edhe në periferi me përhapjen e zonave informale. Dëmtime të shumta ka pasur edhe në mjedis, prandaj kërkohet një rishikim organizativ dhe angazhim i të gjithë elementeve potenciale të shoqërisë, që mund të ndikojnë e të ndihmojnë për mënjanimin ose rigjenerimin e dëmtimeve të shkaktuara. Gjatë procesit të tranzicionit nuk i është dhënë shumë rëndësi iniciativave të planifikimit urban. Në fakt, qyteti i Shkodrës dhe periferia e tij u ballafaquan me përvojën e tranzicionit në territor, ku nuk udhëhiqnin rregullat dhe udhëzimet. Një pjesë e madhe e popullatës deri në vitet 1990 që banonte në zonat malore rurale, i lëshoi këto vendbanime duke i'u drejtuar qytetit, në kërkim të jetës më të mirë, punësimit dhe mundësive për arsimim. Procesi i urbanizimit dinamik dhe pa një strategji të caktuar u shoqërua me një mospërfillje totale ndaj planifikimit të territorit dhe mbrojtjes së mjedisit. Zonat periferike, ajo e bregut të liqenit të Shkodrës dhe e bregut të Bunës, janë vlerësuar shumë shpesh, si zona me vlera të larta zhvillimi, por realisht i janë nënshtruar zhvillimit spekulativ. Grumbullimi i pakontrolluar i mbeturinave, që

përbëhen kryesisht prej plastikës dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme në sipërfaqe të hapura, por sidomos në brigjet e lumenjve dhe liqenit, gjë që çon në ndërtim ose ngritja e objekteve pa respektuar peizazhet dhe stabilitetin e tokës. Të gjitha këto veprime në hapësirë dhe në mjedis, kanë një reaksion zinxhir në gjendjen e përgjithshme të territorit në qytetin e Shkodrës, në formën e erozionit të tokës, bllokimit të kapacitetit natyror të drenazhit të lumenjve dhe kanaleve, ndotjen e dherave, ujërave të lumenjve e liqenit, përfshi, këtu dhe akuiferet me efekte negative mbi biodiversitetin dhe ekosistemet që varen prej tyre.

Por, është pikërisht ky vend i ndryshimit të lidhjeve urbane, mbi të cilin këmbëngulet edhe gjatë këtij punimi, për të realizuar një imazh të ri të qytetit nëpërmjet marrjes së masave dhe politikave të duhura territoriale. Dinamizmi ekologjik i liqenit, që në periudha të ndryshme të vitit vendos kufirin midis tokës dhe ujit, është elementi që shërben për t'i dhënë jetë një imazhi të ri me mjaft ndikime pozitive zhvillimit të territorit në qytetin e Shkodrës.

#### LITERATURA:

1. Aluizni: Agjencia e Legalizimit Uurbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale.
2. Duka. V. (1997): “Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924”, Tiranë, f. 166.
3. Gjika. A, Shutina. D.: “Sfidat e pushtetit vendor mbi Zhvillimet Urbane dhe Sektorin e Strehimit në Shqipëri”, gjendet online në format pdf në web page <http://www.coplan.org/>
4. Krymbi, E. (2010): “Aplikimi i GiS për studimin e rrezeve natyrore në qytetin e Shkodrës”. Studime Albanologjike nr. IV, Tiranë.
5. Bertaud A, Bertrand R. (1997): “*Socialist cities without land markets*”, Journal of Urban Economics. 1(1):137-51.
6. Prendi, F. (1976): “Le Néolithique et l’Énéolithique en Albanie”, Iliria 6, 49-99.
7. Ippen, Th., “Skutari und die nordalbanische Küstenebene”, (Sarajevo, 1907), p. 27-32.
8. Naci, S. (1964): “Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve”, Tiranë, f. 127.
9. (Papa) Pandelejmoni Enriketa, “Shkodra: household, family and urban life: 1918-1939”: dissert zur Erlangung des Doktorgrades. Graz, 2013.
10. Migliorini, E. (1939): “Terra e Nazione Penisola Balcanica”, Milano.
11. Cuni, Z. (1994): “Banesa popullore në Shkodër”. Tek Seminari I Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër.
12. Luzati, S. (2012): “Qyteti i Shkodrës: urbanistika dhe arkitektura gjatë Rilindjes e Pavarësisë Kombëtare”, Tiranë.
13. Riza, E. (2009): “Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek. XV-XIX”, Tiranë.



---

**Evolution and urban transformations in Shkodra city*****SUMMARY***

The article aims to analyze and present the urban characteristics of Shkodra, the evidence of past and actual and shape its development. Natural conditions of Shkodra, in which was born and developed throughout its historic step, do nothing but highlight the key factors and elements for centuries. Urbanization in the city of Shkodra, as a form of civic life, has its roots in the city's unique static spaces, which are developed historically, have their own definition of architectural and embody the culture from which they were born. This paper will examine and impact of the recent political changes, which have left deep traces on the latest developments of urbanization processes. In the paper mainly analyzes the development of the city during the Ottoman period and up to the present day, when profound changes taking place as a result of the impact of political, economic, and regional.

Irena NDREU

## MARRËDHËNIET E HERSHME TREGTARE TË SHQIPËRISË ME VENEDIKUN

Giovani Grevembrok, me shprehjen e tij sugjestionuese “Frut paqeje”, shoqëronte imazhin e tregtarëve shqiptarë në Venedik, në repertorin e tij të çmuar të jetës dhe të zakoneve, ruajtur në dorëshkrimin pranë muzeumit “Correr” të Venecias<sup>339</sup>.

Në atë kohë, tregtarët shqiptarë ishin shtetas të Perandorisë Otomane dhe përbënin ndërmjetësin në tregtinë e Venedikut me Lindjen. Në Venedik prania e tyre ishte e vazhdueshme, kurse në San Marco, kujton Grevembrok, ishte e pamundur të mos ndalonin, sidomos përballë mozaikëve të bazilikatës që aludonin “*ceremoni dhe vegla orientale.*”

Edhe prania e tyre ishte sigurisht frut i asaj peme të politikës venedikase me rrënjë shekullore, që kishte bërë të bashkëjetonin në qytetin pazar, në qytetin udhëkryq të tregtisë, të gjuhëve, të racave me zakone nga më të ndryshmet, duke siguruar një bashkëjetesë paqësore midis çifutëve dhe armenëve, gjermanëve dhe grekëve, dalmatëve dhe persianëve.

Venedikasit përshkonin detin për të sjellë fitime, edhe deri në fillimet e viteve 1400, fitime që nuk mund të ofronte pasiguria e tipografisë lagunare.

Qëllimi kryesor i politikës venedikase në vendet e Juglindjes evropiane, të pasur me drithëra, verëra, vaj, dru dhe metal, ishte për të mbajtur dhe ruajtur hyrje të lirë me këto territore kaq të çmuara<sup>340</sup>.

Tregtia dhe qarkullimi, ashtu si dhe në shekullin XIV, në Arbëri zotëroheshin nga të huajt. Por venedikasit ishin ata që zotëronin pjesën më të madhe të tregtisë.

Kështu, Arbëria Venedike, duke pasur marrëdhënie të vazhdueshme tregtare me venedikasit, nuk përbënte një hapësirë të mbyllur ekonomike që frekuentohej vetëm nga këta tregtarë lagunarë. Kjo provincë ishte më tepër pjesë e një madhësie ekonomike që shtrihej nga grykat e Kotorit deri në Gjirin e Patras, e që kishte si porte kryesore: Kotorin, Shën Shirgjin,

<sup>339</sup> L. Nadin *Venezia e Albania: tracce di antichi legami*, Agfol, 1995, f. 3.

<sup>340</sup> *Maggior Consiglio*, Magnus, c. 13v, 1300.

Lezhën, Durrësin, Vlorën, Arten dhe Vonicën<sup>341</sup>. Ajo frekuentohej gjithashtu nga raguzanët dhe, sidomos, nga fiorentinët, në një masë më të vogël nga tregtarët të tjerë italianë.

Në shekullin XV venedikasit dhe osmanët përcaktuan në thelb ecurinë e tregtisë së arbrit. Kështu, në fillim të këtij shekulli, në Arbërinë Veriore, zotëronte monopoli venedikas. Ky shtet u përpoq qysh me marrjen e qyteteve të arbrit që t'i lidhte ato në qerthullin ekonomik venedikas. Ishte e natyrshme që tregtarët venedikas të josheshin nga mundësitë e reja në Arbëri dhe kushteve që krijoheshin, për tregtinë venedike në Arbëri, kushte më të mira për qytetarët venedikas sesa në shekullin XIV, në kohën e princërve të vegjël e të paqëndrueshem arbër.

Rreth vitit 1400, nën sundimet e reja të Sinjorisë, tregtarët venedikas filluan të ndjekin gjurmët e bashkatdhetarëve të tyre, të cilët kishin bërë tregti me Arbërinë edhe në kohët e mëparshme. Ata sillnin në Arbëri stofra italiane dhe merrnin në shkëmbin drithin dhe kripën e arbrit. Kështu, Nicolo Giustinian-i, solli në vitin 1430 në Venedik një "*magnam quantitatem frumenti*". Në vitin 1424 Catarina Baffo, kishte blerë në Venedik për 45 dukate drithë "*dal Zustignan*"<sup>342</sup>.

Strategjinë tregtare venedike e përshkruan në mënyrë domethënëse porosia që i jep tregtari Jacobo Faxolo përfaqësuesit të tij në Arbëri: "*ia albania ivestisse in formenti ouer altre merchandtie*"<sup>343</sup>.

Mallra të tjerë, si: lënda drusore, mishi pastërma, putarga dhe vera, thuajse nuk shfaqen në burimet e kohës. Ishte Arbëria Jugore ajo që furnizonte me materialin regjis për manifakturën e tekstilit, dhe jo Venediku i Veriut. Nuk ndryshoi asgjë gjatë gjithë sundimit venedikas në këmbimin e thjeshtë të produkteve të gatshme me prodhimet bujqësore.

Më pak i dukshëm nga burimet, ishte lundrimi privat me anije. Tregtarët venedikas, që merrnin pjesë në to përdornin strategji të ndryshme. Kështu, disa tregtarë venedikas i zhvillonin lidhjet e tyre tregtare me Arbërinë nëpërmjet Kotorit dhe Korfuzit, pa shkuar vetë në Arbëri.

Ndër shkëmbimet kryesore midis këtyre dy vendeve, ishte dhe tregtia e drithrave dhe e kripës.

Durrësi zotëronte portin më të mirë të Arbërisë dhe me shumë fortifikime; si sundimi i vetëm venedik në Arbërinë e Mesme, ai ishte tregu i natyrshëm për drithin e zotërve arbër aq të lakmueshëm nga ultësirat e Arbërisë së Ulët. Mundësia e fitimit në tregtinë e drithit ishte kaq tunduese,

<sup>341</sup> Oliver.J. Schmitt , *Das venezianische Albanien 1392-1479*, Munchen: Oldenbourg, 2001, f. 556.

<sup>342</sup> ASV Giudici di Peticion. Sentenze a giustizia LXXVI 24v.

<sup>343</sup> ASV Giudici di Peticion. Sentenze a giustizia CXXII 48v.

saqë tregtarët venedikas vinin në këtë port me gjithë rreziqet. Edhe pse është e pamohueshme rënia e dalëngadaltë e Durrësit, përgjatë shekullit XV, do të ishte gabim sikur të flitej për një shkatërrim të tregtisë. Nga marrëdhënia venedike-osmane, varej fort tregtia e Durrësit. Si “qytet fronti”, ai e ndiente i pari krizën politike midis dy fuqive të mëdha.

Tregtarët venedikas e paguanin drithin e Arbërisë jo vetëm me të holla, por përpiqen të ndërpusin në biznes edhe produkte të vetat si stof ose sapun. Nuk zgjedhin si vend të tregtisë vetëm Arbërinë Venedike, por përfshinin aty edhe sanxhakun osman në jug të hapësirës së arbrit.

Venediku, së paku në gjysmën e parë të shekullit XV, mbajti me sa duket edhe në kohë të vështira pozicionet e veta jo vetëm në Durrës, po edhe në Vlorë, të ngritura nga Kontarinët në shekullin XIV. Blerës, transportues e ndërmjetës dalin qartë nëpërmjet dokumenteve. Prodhuesit dhe shitësit, pra biznesi i arbrit, mund të rrokot vetëm në vija të trasha. Kjo dëshmon se në kontaktet e tyre me ofruerit arbër, tregtarët venedikas mbështeteshin kryesisht tek ndërmjetës vendas, shpesh hebrenj dhe grekë, të cilët e mbajtën gjallë tregtinë edhe gjatë luftërave midis Venediut dhe Perandorisë Osmane<sup>344</sup>.

Krejt ndryshe paraqitej gjendja në Arbërinë e Jugut. Aty mbisundonte qartë elementi raguzan, sidomos me marrjen e Vlorës nga osmanët. Tregtarët raguzanë sillnin stofra dhe blinin drithëra, kripë, peshk, pastërma, lëndë regjëse e deri dhe indigo për të mbuluar nevojat raguzane. Ashtu sikurse venedikasit në veri, raguzanët përpiqeshin në jug të hapësirës së arbrit të ngrenin një monopol të kripës, çka edhe e arritën në një masë të madhe.

Megjithatë, fakti që karvanet e përshkonin Arbërinë e Veriut edhe në kohë krizash, flet për një vijimësi mbresëlënëse të shkëmbimit rajonal të mallrave, e cila kënaqte nevojat e banorëve të malësisë që vareshin shumë nga furnizimi me kripë e drithë prej Arbërisë së Ulët. Dihet shumë pak për produktet që sillnin në bregdet karvanët. Sido që të ishte, tregtia me metale, para së gjithash me plumb, të cilin e blinin venedikasit, raguzanët dhe fiorentinët në Lezhë, kishte rëndësi të kufizuar, por, përveç tregtisë që venedikasit bënin në Shqipëri, e rëndësishme ishte edhe tregtia që shqiptarët bënin në Venedik.

Një vend të rëndësishëm zinin tekstilet që lidheshin me industrinë e lulëzuar të leshit në Venedik. Tregtia e berretave mori një rëndësi të

---

<sup>344</sup> Oliver.J. Schmitt , *Das venezianische Albanien 1392-1479*, Munchen: Oldenbourg, 2001, f. 556.

veçantë. U krijuan marrëdhënie tregtare mjaft intensive nga prodhuesit e berretave, me vendet e Bosnjes, Greqisë dhe Dalmacisë.

Molmeti tërheq vëmendjen se akoma në 800-ën, mund të shiheshin shumë shqiptarë duke shitur nëpër rrugët e Venecias berretat e tyre me nam, madje përmend edhe emrin e shitësit të fundit shqiptar, një farë Marco Pena, dhe lokalizon tregtinë e trashëgimtarëve të tij në një shtëpi në afërsi të San Giacomo dall'Orio dhe përveç këtyre edhe prodhuesit e qivureve. Tregtarët shqiptarë në Venedik, mund të ushtronin profesionet e tyre dhe të shkëmbenin mallra, pa pasur asnjë shqetësim në vendin mikpritës.

Një ligj i ri venedikas parashikonte se çdo i huaj, i natyralizuar qytetar venedikas, mund të punonte në *“veluta, camoca, panni damasceni, brocati, et cuiscumque sortis laboreria sete auri et sete argente cuiscumque latitudinis mensura...”*<sup>345</sup>

Që nga viti 1350, konsujt e tregtarëve gjykonin jo të domosdoshëm të rrisnin numrin e artizanëve<sup>346</sup>. Deri në atë kohë, të huajt nuk kishin të drejtë të ushtronin disa zanate<sup>347</sup>, Ata para se të bënin përdorimin e disa materialeve të caktuara, duhej të kërkonin lejen e qeverisë.

Për të tërhequr artizanët, një vendim i Konsujve të Tregtarëve vendosi, më 1358, se *“çdo mjeshtër person ose nxënës i të dy gjinive, të cilët dëshirojnë të vijnë në Venedik për t'u bashkuar me një trup të zanateve, mund të bënte pa paguar asgjë, si dhe ata që ishin të vendosur tashmë në “Venedik”*”.

Përveç shumë marinarëve nuk mungonin tregtarë stofi, muratorë, argjendarë, prodhues kordelesh, skalitës guri, teknikë për matjen e vëllimit të varkave dhe akoma berberë dhe furrtarë.

Gjithashtu në Venedik numëroheshin shumë shqiptarë, mjeshtër të xhamit, siç është dëshmia e fundit të 400-ës e Nicolo di Biagio, shqiptar në Murano, i cili vazhdonte suksesin e fabrikës së hamit “Alla Pigna”, i cili drejtohej pikërisht nga një familje shqiptare që nga dekadat e para të 400-es; si dhe tregtarë shqiptarë shumë aktivë në tregtinë e vajit<sup>348</sup>.

Nga kërkimet e bëra mësojmë se nga marrëdhëniet tregtare që Venediku ka pasur me Shqipërinë që në kohën e Republikës, në Venedik kanë qenë themeluar rreth njëqind e tridhjetë kompani tregtare të krishtera, turke dhe shqiptarët nga qyteti i Shkodrës, merreshin me

<sup>345</sup> Senato misti, Reg. 48, c. 15v, 1410.

<sup>346</sup> Consoli dei mercanti, Capitolare, b. 55, 1350. Maggior consiglio, Novella, c.5.

<sup>347</sup> Comune, I, c.143, 1251-1382.

<sup>348</sup> L. Nadin, *Venezia e Albania: tracce di antichi legami*, Agfol, 1995 f. 3.

shkëmbimin e prodhimeve ndërmjet këtyre vendeve, ruanin aktiv dhe fitimprurës tregun.

Lëvizja vjetore e këtij tregu, prodhonte vlerën e rreth 100,000,000 lira veneto, siç provohej atëherë nga statistikat konsullore dhe doganore.

Në atë kohë Venediku shkëlqente me prodhimin e pëlhurave dhe kapeleve të leshta për t'u përdorur në Levante; kadife, brokadë si dhe prodhime të tjera të mëndafshit; shkëlqente në prodhimet e shumta dhe të ndryshme të industrisë indigjene, të cilët e përbënin materialin nga spekulimet e tregtarëve shkodranë për Turqinë, që blinin gjithashtu mallra të tjerë nga jashtë, ku depozitat e Venedikut furnizoheshin nga mallra me bollëk.

Ndërkohë, përveç tregtisë së materialeve dhe tekstileve të ndryshme, mund të themi se një vend të veçantë gjatë gjithë kësaj periudhe zuri edhe tregtia me shqiptarët e ikur nga pushtimi osman dhe nga varfëria ku ata ndodheshin drejt brigjeve të Italisë, në veçanti drejt Venedikut. Për disa funksionarë, mjerimi i shqiptarëve që largoheshin nga trojet e tyre, ishte një mundësi e shkëlqyer për fitim. Autoritete të korruptuara punonin krah për krah me trafikantët. Arkëtari i Lezhës arriti të kalonte rreth 10.000 refugjatë nëpërmjet portit të Durrësit, ku nga secili prej tyre, ai mori nga dy groshë, pavarësisht nëse udhëtimi shkonte për në Venedik ose drejt Puljës. Gjithashtu, nxirrnin fitim prej mjerimit, edhe kapitenët e anijeve të vogla tregtare. Njihen prej dosjeve gjyqësore emrat e disave, si për shembull, Polo Luzia, i cili pruri në dy udhëtime 150 arbër në Itali; Stefani nga Lezha dhe pronari i anijeve Piero Bianco, që transportuan 100 refugjatë; Latoty, i cili transportoi për në Venedik 150 arbër për një grosh.

Por megjithatë nuk kishte shumë anije dhe çmimi për një udhëtim u ngjiti në tri lira *di piçojl* për person<sup>349</sup>.

Siç u përmend edhe më lart, mallrat e importuara në Venedik, ishin nga më të ndryshmet, si për shembull: prodhimet prej leshi të Shkodrës, të cilat edhe në ditët e sotme, janë të njohura në të gjithë Italinë për përdorimin e tyre në dyshekë; produkte leshi të tjera më cilësore (që përdorshin në fabrika), ku prodhoheshin qirinjtë; lëkurët e kafshëve të llojeve të ndryshme (si lëkurë lepuri, etj.); mëndafsh i përpunuar, si dhe shumë artikuj të ndryshëm të prodhimit shqiptar; dhe në fund, importimet më të shquara që binin më shumë në sy ishin shumat e parave në flori dhe argjend, kështu kishte ngelur proverbiale sasia e madhe e monedhave veneto që në atë kohë silleshin nga Shkodra në

<sup>349</sup> Oliver.J. Schmitt, *Das venezianische Albanien 1392-1479*, Munchen: Oldenbourg, 2001.

Venedik. Tregtari i pasur turko- shkodran, Roi, nuk nisej nga vendi i tij për të hyrë në Venedik, ku brenda 6 muajsh përmbushte xhiron e vet të pazareve dhe sillte përveç sasive të mëdha të mallrave të ndryshme, shumën e spikatur e njëqindmijë *zecchini* dukati. Kështu shitësi tjetër i pasur dhe kristian, Melgusci, gjithashtu nga Shkodra, gjashtëdhjetëmijë; dhe pastaj vinin të tjerë, me shuma më të vogla. Kjo quhej edhe koha e floririt për të dy vendet<sup>350</sup>.

Fatkeqësisht, fitimet e shumta që sillte ky treg njëherësh në sheshin e Venecias (ishte dhe pasuria e Shqipërisë), filluan të pakësoheshin gradualisht, por marrëdhëniet tregtare kanë vazhduar deri në ditët e sotme.

Sidoqoftë, ne duhet të kujtojmë se, Venediku kërkonte të ishte pronar mbizotërues i brigjeve dalmate dhe shqiptare, për arsye të dukshme strategjike, të cilat lidhen me politikën e saj ekonomike, pra shkaqet e shtrirjeve veneciane, në shekullin e katërbëdhjetë, janë motivuar nga shkaqe të rendit ekonomik<sup>351</sup>.

#### BIBLIOGRAFIA:

1. Bettini Sergio (1933): *Orme d'Italia e di Venezia nell'alta Albania*, in "Rivista di Venezia" XII.
2. Consoli dei mercanti, Capitolare, b. 55, 1350. MAGGIOR CONSIGLIO, Novella, c.5.
3. Comune, I, c.143, 1251-1382 "Quod nullus forensis sit passator".
4. F. Thiriet (1968): Quelques réflexions sur le entreprises vénitiennes dans les pays du Sud-Est Européen, "R.E.S.E.E.", 3, f. 395-400.
5. G. Fedalto (1977): *Le minoranze straniere a Venezia tra politica e legislazione* Firenze.
6. L. Nadin (1995): *Venezia e Albania: tracce di antichi legami*, Agfol, f. 3.
7. G. Fedalto (1967): *Ricerche storiche sulla posizione giuridica ed ecclesiastica dei greci a Venezia nei secoli XV e XVI*, Firenze.
8. Oliver. J. Schmitt (2001): *Das venezianische Albanien 1392-1479*, Munchen: Oldenbourg, f. 556.
9. Senato misti, Reg. 48, c. 15v, 1410. Maggior consiglio, Magnus, c. 13v, 1300.
10. L. Nadin (2008): *Migrazioni e integrazione: il caso degli albanesi a Venezia (1479-1552)*, Roma, Bulzoni.

<sup>350</sup> Archivio, G.Cav. Jubani, Il Comercio di Venezia coll'Albania, Venezia, 1887, f. 1

<sup>351</sup> F. Thiriet, Quelques réflexions sur le entreprises vénitiennes dans les pays du Sud-Est Européen, "R.E.S.E.E.", 3, 1968, f. 395-400.

## **Early trade relations between Albania and Venice**

### ***SUMMARY***

My research work is of an historic and cultural character and it focuses on the venetian trade links with Albania. Since the Medieval Times, Venice had become very rich due to its trade control with Levante and its coastal line in the Adriatic Ocean and elsewhere. It was actually well-organized at the institutional and trade level, and many indications of oriental culture were present in the artistic, architectonic, and even gastronomic area, such as: different spices, which give the city its reputation as the first marine trade city. Around one hundred and thirty christian, turkish and albanian (from the city of Shkodra) trade enterprises, were kept active in the venetian city. At that time Venice competed through the production of fabrics, woollen hats, where wool was imported from Shkodra to the rest of Italy and was used in the production of mattresses and other silk manufacture. Trade exchanges between Shkodra and Venice, contributed to the economic growth of these two countries, and according to different sources it has been referred to as the golden age. But from different research works, these riches between these two countries gradually started to be reduced.

***Key-words:*** Venice, Albania, trade, exchanges, problems.



Valbona KARAKAÇI

## SIMBOLET E ANGAZHUARA SI AKT KOMUNIKIMI KULTUROR

**Studime empirike, cilësore dhe sasiore, kanë vërtetuar se simbole të ndryshme kombëtare (specifikisht himnet) shkaktojnë shoqërizime të njëjta psiko-emocionale, të cilat kanë si rezultante KOMBIN apo IDENTITETIN KOMBËTAR.**

Kështu eksperimenti i Gilboa dhe Bodner (Universiteti i BAR-ILAN në Izrael, 2009), vërtetoi se *Hativa*<sup>352</sup> – himni kombëtar i Izraelit – në 78.6% të kampionit të intervistuar ngjallte ndjesi të tilla, si: **krenaria, shpresa dhe patriotizmi**. 91% të pjesëmarrësve në eksperiment pavarësisht ndryshimeve kulturore u përgjigjën, se himni kombëtar (ndryshe nga tri këngët e tjera që kishin dëgjuar si pjesë e eksperimentit), u sillte ndër mend “kombin hebre”, “popullin e Izraelit”, apo faktin se kjo “këngë u përkiste të gjithëve”.

Analiza e sit-it<sup>353</sup> për njohjen e historisë së flamurit, që frymëzoi himnin kombëtar amerikan *Flamur i stolisur me yje*<sup>354</sup>, ku amerikanët ftohen në mënyrë ndëraktive të ndajnë historitë mbi ndjenjat dhe mendimet, që u zgjon flamuri kombëtar, dëshmon si më poshtë:

---


<sup>352</sup> *As long as the Jewish spirit is yearning deep in the heart,  
With eyes turned toward the East, looking toward Zion,  
Then our hope - the two-thousand-year-old hope - will not be lost:  
To be a free people in our land,  
The land of Zion and Jerusalem*

Himni Izraelit titullohet *Shpresë*, është shkruar më 1886 nga një poet me origjinë angleze.

<sup>353</sup> <http://amhistory.si.edu/starspangledbanner/symbols-of-a-new-nation.aspx>

<sup>354</sup> Administruar nga Instituti Smithsonian

*Oh, say can you see by the dawn's early light  
What so proudly we hailed at the twilight's last gleaming?  
Whose broad stripes and bright stars thru the perilous fight,  
O'er the ramparts we watched were so gallantly streaming?  
And the rocket's red glare, the bombs bursting in air,  
Gave proof thru the night that our flag was still there.  
Oh, say does that star-spangled banner yet wave  
O'er the land of the free and the home of the brave?  
Etj.*



Përndryshe mund të themi që ndjenja e mendime, si: **krenaria**, **patriotizmi** dhe **liria**, bëjnë pjesë në ndërgjegjen kombëtare të popullit amerikan, sikundër dhe të atij Izraelit (tashmë ndërgjegjësimi vjen nga simboli tjetër kombëtar FLAMURI).

Analiza e tekstit të himnit tonë kombëtar (*Himni i Flamurit*) na parashtron të njëjtat gjetje: *Për të, për të luftojmë ne!* (kupto liria), *...pënder' edhe lavdimn e tu* (krenaria), *Me një dëshir' e një qëllim* (patriotizmi), *Të gjith' atij duke iu betuar* (kënga u përket të gjithëve). Sikundër, nëse veçojmë cilësitë përmes të cilave është interpretuar poetikisht flamuri ynë kombëtar, përmes teksteve të prezantuara në konkursin e vitit 1936, na rezultojnë gjithashtu që nocionet KOMB, LIRI, KRENARI të jenë të pranishme:

Veçori të cilësuar >10 herë	Veçori të cilësuar > 6 herë	Veçori të cilësuar >3 herë
1. I shenjtë 2. Simbol 3. Me shkabë 4. Kuq e zi 5. Shenjë 6. Dritë 7. <u>Gjak</u> 8. <b><u>Komb</u></b> 9. <u>Burrni</u>	1. Shqipëri, Atdhe, Arbëri 2. <u>Nder</u> 3. I Skënderbeut, Kastriotit 4. I t'parëve 5. <b><u>I lirë</u></b>	1. I përparimit 2. I besës 3. <u>Trim</u> 4. I fisit 5. Mburojë 6. Shembull 7. <b><u>Mburrye, famë, bota</u></b> 8. I vjetër 9. <u>Bashkim</u> 10. Bota 11. Orë

Mirëpo himnet (sikundër edhe në disa raste flamurët) përpara se të transformoheshin në simbole kombëtare, kanë ekzistuar si tekste letrare

(apo arte-fakte në rastin e flamurëve) me funksion estetik. Kështu *Himni i Lirisë*, shkruar nga babai i poezisë greke Dionisos Solomos (1823), u pat recituar për herë të parë në vdekjen e Bajronit më 1824-ën, rreth dyzet vjet përpara se të përshtatej si himn i Mbretërisë Greke (1864) dhe i shtetit grek (1865) apo dhe rreth 140 vjet përpara se të përshtatej si simbol kombëtar nga Qiproja (1966). Nëse konsiderojmë kohën kur janë shkruar vargjet e Solomos, ato tingëllojnë të bukura edhe sot:

*Të njoh për të mprehtin,/ e dalë nga të shejtët,/*  
*Teh të shpatës sate,/ Eshtra të grekëve,/*  
*Të njoh për shikimin,/ Trima si në të kaluarën,/*  
*Që trimërisht e mat tokën,/ Përshëndetje, përshëndetj, Liri!*

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për disa prej flamurëve (apo vulave/stemave) si simbole, që kontribuojnë në formimin e identitetit nga njëra anë, por janë edhe mbartëse të funksioneve estetike nga ana tjetër. Figurat e stilizuara më poshtë janë të bukura, pavarësisht përvetësimit të tyre nga mburojat me funksion utilitar, por të dizenuara me shije.



Figure 22. Hyghalmen Roll of Arms, 15th century (Wikimedia Commons)

Sikundër edhe flamurët e mëposhtëm heraldikë, të paraardhësve të Elizabetës I, që patën shoqëruar eskortën e funeralit të saj.



Nëse nuk e anashkalojmë funksionin parësor estetik (pavarësisht bashkëjetesës së tij me funksione të tjera shoqërore dhe utilitare) dhe kujtojmë fjalët e Stendal, të cituara nga Alain de Botton në një prej librave të tij mbi arkitekturën “*E bukura është premtimi për lumturi*” dhe “*ka po aq stile të së bukurës, sa vizione mbi lumturinë*”, mund të dakordësohemi, se **lindja e himneve kombëtare (por edhe flamurëve) e më pas pranimi i tyre si simbole, përfaqëson një moment lumturie e konsensusi kolektiv, unik për secilin prej kombeve/shteteve.** Për rrjedhojë mund të themi që ka një marrëdhënie të brendshme mes të bukurës dhe lumturisë, e cila tek himnet ekziston që në krye të herës.

Por nëse **momenti i lumturisë dhe konsensusit** mund të përgjithësohet, nuk mund të themi me siguri, që të gjitha tekstet letrare (sikundër as të gjitha modelimet e flamurëve) të përshtatura si himne kombëtare, kanë qenë pranuar edhe si tekste letrare të arrira. Kështu himni i Amerikës, ndryshe nga ai grek, është shkruar nga një poet amator, i cili e kujton kështu atë moment unik:

*“ Në atë orë shpëtimi dhe gëzimi për triumfin, zemra ime foli”,*

Francis Scott Key, duke kujtuar mëngjesin e 14 Shtatorit, 1814

për të përshkruar një kontekst të tillë:

*Në mëngjesin e 14 Shtatorit, 1814 Francis Scott Key, që ndodhej në bordin e një anijeje disa milje larg, mundi të shikojë një flamur amerikan*

*që valvitej mbi fortesën McHenry. Anijet britanike po tërhiqeshin nga Baltimorja. ShBA kishte arritur të mbijetonte dhe zbrapsur armikun.*

I frymëzuar nga pamja, Key shkruan tekstin që u gëzohej “yjeve që stolisnin flamurin”, si simbol i triumfit dhe rezistencës amerikane.

Kurse tradita heraldike baroke e përdorur nga flamurët e mbretërive, për arsye të interpretimit aristokratik të realitetit, u zëvendësua në Evropën moderne me **flamurin tri ngjyrësh, që bashkonte në një të vetme ngjyrat kombëtare, pa i kushtuar rëndësi shijeve të ndërlikuara estetike.**

Flamuri tri ngjyrësh, zëvendësoi një model më të avancuar estetik, duke synuar të shpallte besnikërinë ndaj republikës, në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, përndryshe edhe më gjithëpërfshirëse.

Karen Cerulo na bën me dije se ekziston një marrëdhënie e brendshme mes pozicionit të një kombi në sistemin botëror dhe strukturës së simboleve të tij. Udhëheqësit e kombeve qendrore kanë përshtatur himne dhe flamurë më bazikë, sesa homologët e tyre periferikë dhe gjysmëperiferikë. Kësisoj himnet, sikundër edhe flamurët, kanë shkëmbyer me modelet parësore duke u **uniformëzuar në përmbajtje dhe nxitur kësioj përshtypje të njësuara** (sikundër e vërtetojnë edhe studimet empirike).

Përkundër uniformizimit përpjekje janë bërë për të ruajtur cilësi autentike dalluese për një komb, por **pavarësisht varjimeve forca unifikuere ka dominuar. Ky moment shënjon rënien e funksionit estetik, në favor të funksioneve të tjera (politike, shoqërore etj.).**

Le ta ilustrojmë këtë dinamikë: flamuri italian zëvendësoi shiritin blu të Francës, me të gjelbrin. Ndërsa irlandezët bashkuan të gjelbrën e katolikëve me portokallinë e protestantëve, për të dhënë mesazhin e bashkëjetesës në një republikë të vetme. Por në të gjitha rastet, flamuri me shirita ngelet.



Figure 31. Flag of Italy  
(Wikimedia Commons)



Figure 32. Flag of Ireland (Wikimedia Commons)

**Po si kanë arritur simbolet të vijnë të shkaktajnë përshtypje të natyrshme për artin, si: mobilizim, dëshirë për veprim, hapësirë për**

*reflektim e vetidentifikim etj., në kushtet e zbehjes së funksionit të tyre estetik (rasti i himnit grek apo flamurëve heraldikë), apo në disa raste të pamjaftueshmërisë së tij që në krye të herës (rasti i himnit amerikan apo flamurëve me shirita)?*

Fotot e mëposhtme tregojnë se pavarësisht funksionit të zbehtë estetik, ndikimi i të kënduarit të himnit apo ngritjes së flamurit është elektrizues për protagonistët:



Më gjasë himnet e kanë plotësuar zbehjen apo pamjaftueshmërinë e funksionit estetik (e njëjta gjë mund të thuhet edhe për flamurët) me **transformimin e tyre nga tekste letrare** (apo arte fakte në rastin e flamurëve) **në simbole kombëtare**. Simbolet kombëtare performohen/prezantohen/artikuloohen në një **mjedis komunikativ të ndryshëm nga ai artistik**. Për rrjedhojë, zbehja e funksionit estetik zëvendësohet me vëmendjen apo kujdesin ndaj **aktit komunikativ të simbolit** (fillimisht tekst letrar). Vendimtarë për **krijimin e përshtypjes** bëhet **kanali i komunikimit** (emetimit të tekstit letrar p.sh., *volumi i lartë*), që ndodh të përfshijë në disa raste edhe vetë **marrës-in** (p.sh., *vendosja e dorës në zemër kur këndohet himni*) dmth, konteksti jashtë tekstit, i cili mund të çojë deri në *transformime të pjesshme të vetë tekstit* origjinal (p.sh., himnet e interpretuara nuk janë më të gjata se dy strofa), apo *uniformizimin* e tij.

Rënia e peshës së funksionit të pastër estetik bëhet edhe më e dukshme kur i tërë **akti komunikativ rregullohet e normohet me protokoll**. Zbatimi i ceremonialit rrit solemnitetin duke thelluar natyrën uniforme, përkundër të qenit unik dmth thjesht tekst letrar. Ai që “humb” është autori dmth individi, krijuesi i funksionit parësor estetik apo **dhënësi në skemën e komunikimit**. Rolin e tij e merr grupi dhe e rregullon politika, kështu **teksti bëhet i angazhuar dhe uniform sepse rregullat, të cilave u nënshtrohet, kanë ndryshuar**. Më shumë se ligjësive të artit, ai duhet t’i përshtatet kontekstit.

Ajo që nuk duhet harruar në këtë mes është se *potenciali për ta përshtatur tekstin me kontekstin*, qëndron në instrumente që në origjinë i ka zhvilluar arti: natyra burimore sinkretike apo ceremoniale e himnit, përpara



se ai të shndërrohej në simbol kombëtar.

Pasrendësit, qofshin këta “baballarët e kombit” apo “themeluesit e shtetit modern”, kuptuan dhe shfrytëzuan këtë potencial, për të nxitur të njëjtin ndikim, por për arsye krejt të ndryshme nga ato të artit.

**Nëse tekste të ndryshme letrare na shpjen drejt kumtit të njëjtë KOMB (me të gjitha varjimet që ai përfaqëson), si arrijnë himni (simboli kombëtar) të sigurojë qëndrueshmërinë e tij në kushtet e dialektikës së vetë kumtit dmth ripërkufizimit të vazhdueshëm të nocionit KOMB?**

Pasi kemi sqaruar natyrën uniforme dhe (a) estetike të simboleve kombëtare (himne, flamur), që buron nga gjetja se simbole të ndryshme shkaktojnë ndjenja të njëjta, le të ndalemi tek e dyta që duket më e ndërlikuar: *shoqërizimet që ndjenjat e njëjta shkaktojnë, na shpjen tek ideja e KOMBIT.*

Nëse faktorizimi i simbolit (qoftë ky himn apo flamur) qëndron tek **rëndësia e kumtit KOMB**, në momentin që bie REZULTANTIA (kombi=ndjesia/shoqërizimi i përbashkët), hipotetikusht duhet të “bjerë” edhe simboli. Një fenomen i tillë ka ndodhur p.sh., me vendet anëtare të bllokut të lindjes, që në shumicën e rasteve mënjanuan himnin kombëtar në favor të *Internacionales*. Ngelet për t’u parë nëse *Himni i BE* do të ketë në kohë, të njëjtin ndikim.

Duke iu larguar këtij skenari ekstrem, rreziku tjetër për “rënien e himnit” qëndron tek dialektika e vetë rezultantes KOMB. Fillimisht KOMBI na shfaqet si etni, pastaj si njësi apo vullnet politik ndërsa në kohët moderne flitet më shumë për identitetin kombëtar sesa për vetë burimin e tij KOMBIN, ngase ai gëzon mundësinë për t’u bartuar pavarësisht nga vendndodhja e bartësit të tij (rëndësia e mobilitetit në kohët globale).

Mirëpo edhe teoritë e identitetit kombëtar na shfaqen me një numër varjimesh, duke e bërë thjesht të paqëndrueshëm rezultanten. Në këto kushte, hipoteza se **zbehja e funksionit estetik balancohet me rritjen e peshës së funksionit social dhe politik të simbolit (himnit)** nuk na duket shumë e qëndrueshme, sepse vetë këto funksione i nënshtrohen erozionit dhe transformimit në kohë. Kësisoj nëse ka himne si ai shqiptar, ku dialektika etni (shprehur p.sh., përmes *betimit*), vullnet politik dmth kombshitet (shprehur p.sh., përmes *bashkimit*) është reflektuar, falë kohës relativisht të vonë të përshtatjes së himnit, ngelet e hapur pyetja se si himnet do u përgjigjen formave të reja, që potencialisht mund të marrë kombi në kohë.

Konstatimi i Gellner-it, që kombet nuk janë produkt i një kulture, por krijuan në të vërtetë një kulturë të re të veten e çon një hap më tutje diskursin mbi qëndrueshmërinë e himnit si simbol kombëtar duke e vendosur në një udhëkryq kritik çështjen dialektikë e kumtit-simbol. Shpesh herë vetë kultura e re mori formën e rrezikshme të nacionalizimit.

Por sidoqoftë produkt i një kulture të maturuar apo krijuar i një kulture të re, natyra politike e kombit ka nevojë për të disatribute që të vetëpërmbushet si p.sh., solidariteti dhe mobilizimi. Gellner do ta quante atë “vullnet i përbashkët”. Ndërsa sipas Smith identiteti kombëtar s’është asgjë tjetër veçse vijim i natyrshëm (kupto i etnisë=kombi si produkt i një kulture) dhe manipulim i ndërgjegjes (përmes simbolit dhe ideologjisë-kombi si kulturë e re).

Në të vërtetë, simbolet kombëtare bazuar tek disa modele parësore na udhëheqin drejt KOMBIT si produkt i një kulture, ndërsa modelet e unifikuara që nxisin mobilizim (përgjithësisht të përshtatura nga kombet periferike apo gjysmëperiferike) drejt KOMBIT si kulturë e re.

Kësisoj mund të themi se ato veçori që e bëjnë himnin të paqëndrueshëm si realitet artistik (Uniformiteti=Zbehja e funksionit estetik), sigurojnë suksesin e tij si simbol politik (Mobilizim=Funksioni social dhe politik). Mesa duket krijimi i marrëdhënieve mes të kundërtave ka mundësuar si përfundim vetë qëndrueshmërinë e simbolit kombëtar (garantuar nga vijimësia e të njëjtave veçori) pavarësisht prej rifunksionalizimit të tyre në kushtet e ripërkufizimit të KOMBIT.

### ... në vijim mbi artin e angazhuar...

Arti mundëson mobilizim. Ndonëse zanafilla e tij nuk është sociale, ai është përdorur nga shoqëria për të ripozicionuar vetveten. Arti mbijeton përmes rikontesktualizimit. Në rastin e himnit kombëtar, rikontesktualizimi është bërë kryesisht përmes elementeve jashta-letrare (politiko-social), jo



rrallë me qëllim manipulimin e kolektivit përmes forcës mobilizuese të artit p.sh., diversifikimi i mjediseve ku këndohet himni kombëtar (shkollë, rrugë, stadium, radio etj.), mund të interpretohet si zgjerim i hapësirës komunikative, ku himni nuk ndryshon në përmbajtje, por janë kanali dhe marrësi ata që janë transformuar duke e rikontesktualizuar vetë himnin. Arsyet e diversifikimit kanë të bëjnë me rifitimimin e terrenit të nevojshëm kolektiv të kumteve KOMBËTARE (herë-herë edhe nacionaliste) në kushtet kur jo vetëm rezultatia KOMB, por edhe kolektivi që identifikohet me të ndryshon.

Ajo që njohim prej të tjerëve/është vetëm memorizimi i momenteve/kur i kemi njohur ata. Por që atëherë ata kanë ndryshuar, - thoshte Eliot.

E njëjta gjë ndodh edhe me himnin, brezat e hershëm kanë njohur autorët e tyre, të mëvonshmit humbjen e autorëve përmes proceseve rikontesktualizuese historike.

Kësisoj, arti, kolektivi dhe politika (të dyja këto të fundit mund t'i shohim si rezultat i zhvillimeve historike), krijojnë një lloj sinergjie ku nuk ka të humbur: arti angazhohet, por bashkë me të edhe politika dhe shoqëria. Për skeptikët e artit të angazhuar, që ankohen se cilësitë letrare do të shkatërrohen nga ekspozimi i vazhdueshëm ndaj realitetit, mjafton t'u kujtojmë fjalët e Sartrit *“Doni apo nuk doni, edhe shkrintari me sytë në hapësirat e së përjetshmes, i adresohet bashkëkohësve të vet, vëllezërve të së njëjtës klasë dhe race..., e njëjta gjë mund të thuhet edhe për lexuesit: njerëzit e komunitet e së njëjtës periudhë, që kanë jetuar të njëjtat ngjarje, që kanë shmangur apo u janë përgjigjur të njëjtave pyetje, kanë të njëjtën shije, të njëjtin nivel sofistikimi. Autorët gjithashtu janë historik, është pikërisht kjo arsyeja se përse kërkojnë t'i shpëtojnë historisë e të bëhen të përjetshëm...”*. Rasti i himneve kombëtare është ai i “të bërit të përjetshëm”, nëse jo të tillë, të paktën i mbijetesës përmes angazhimit.

Teza se është veç arti që i shërben politikës, nuk na duket me vend: në të vërtetë jo rrallë arti gjithashtu fiton nga politika, se cili lloj arti e ka këtë potencial për t'u funksionalizuar dhe funksionalizuar politikën, ky ngelet një debat me vend për t'u thelluar më tej. Gjithsesi organikja e zhvillimit të simboleve kombëtare na e vërteton këtë hipotezë, për aq sa hipoteza ngelet tek artet e aplikuara (nëse mund t'i quajmë kështu edhe himnet).

**LITERATURA:**

1. Alain de Botton, *The Architecture of Happiness*, Pantheon Books USA 2006.
2. Avi Gilboa dhe Ehud Bodner, *What are your thoughts when the national anthem is playing?*, *Psychology of Music* October 2009 vol. 37 no. 4 459-484.
3. Ernest Gellner, *Kombet dhe nacionalizmat* (f. 35), Kosovë, 2009.
4. Karen A. Cerulo, *Symbols and the world system: National anthems and flags*(pp 243-271), *Journal of Politics & International Affairs*, Volume II, Issue I, Summer, 2008.
5. Jonathan Webber, *The Existentialism of Jean-Paul Sartre (Routledge Studies in Twentieth Century Philosophy)*, New York, 2009.
6. Valbona Karakaçi, *Bashkëjetesa fatlume e dy simboleve: flamurit dhe himnit kombëtar të shqiptarëve*, ALBSHKENCA, 2011.

**Symbols as cultural communication****SUMMARY**

The organics of committed symbols (anthem and flag) is an effort to prove sustainability of national symbols by considering them as "artifacts". The paper gives an answer to the following research questions: do national symbols represent an esthetic work; are they art; how have symbols managed to continue to trigger esthetic impressions (mobilization, desire for action, space for reflection and self-identification, etc.) in the conditions of their aesthetic function being faded; how does the anthem (national symbol) ensure its sustainability while its key messages are reinterpreted based on context changes, i.e. the continuous redefinition of the notion Nation and National Identity; what do national symbols (anthem, flag) suggest to us on committed literature?

Through primary and secondary literature, analysis of texts and heraldry, the paper outlines arguments and conclusions on how the symbols have survived thanks to their nature as "artifacts".

**Isida HOXHA**

**ETIKA NË SHTYPIN E SHKRUAR TË PAVARUR NË  
PASQYRIMIN E FUSHATËS ELEKTORALE  
(QERSHOR, 2009)**

*Hyrje*

Një nga problematikat më të mëdha që has jo vetëm media shqiptare, por edhe ajo e huaj janë problemet etike. Këndvështrime të ndryshme në lidhje me etikën e medias herë favorizojnë dhe herë janë kritike ndaj masave që duhen marrë për një kontroll të medias. Mungesa e legjislacionit përkatës të detajuar herë shihet si akt demokratik dhe herë si burim problematikash në media. Sot në kohën e medias sociale mund të duket një temë e kaluar etika në shtypin e shkruar të pavarur, por nëse do t'i referohemi kontekstit historik të medias të marrë në studim, media shqiptare akoma sot performon më së shumti përmes medias së shkruar, prandaj dhe ky studim ndalet tek analiza e saj. Megjithëse për zgjedhjet elektorale të vitit 2013, rrjetet sociale luajtën një rol shumë të rëndësishëm në shpалosjen e platformave dhe krijimin e imazhit të partive politike, nuk mund të themi të njëjtën gjë për zgjedhjet e vitit 2009, ku aktorët politikë u angazhuan shumë pak në rrjete sociale, dhe ku “tweeter” u përdor pothuajse vetëm nga Rama. Gjithashtu besueshmëria e audiencës ndaj shtypit tradicional shihet gjatë kohës së fushatave, ku gazetashitësit kanë kulmin e tyre të shitjes së gazetës. Nisur nga kjo rëndësi që shtypi i shkruar ruan ende sot, por edhe nga debatet e mëdha në botë, ku një prej qasjeve shtron mendime se, shtypi i shkruar do të jetë arma më e fortë, e cila do të mbrojë gazetarinë në botë, ky punim merr një rëndësi më të veçantë.

Ky studim analizon përmbajtjen e shtypit të shkruar të pavarur gjatë fushatës elektorale në vitin 2009. Studimi u realizua duke studiuar përmbajtjen e shkrimeve të publikuara gjatë muajit qershor, përzgjedhje kjo e mbështetur në funksion të objektit të studimit, i cili mbështetet në identifikimin e thyerjeve etike, problemet që shkaktojnë çështjet etike, si dhe në strategji për përmirësimin e situatës.

Për këtë janë përzgjedhur këto gazeta: “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Tema” dhe “Koha Jonë”. Aplikimi i saktë i kodeve etike është një ndër elementet më të rëndësishme që media të ruajë funksionet e saj,

është. Hipoteza e këtij punimi është, përmbajtja e shtypit të shkruar prodhon thyerje etike, të cilat influencojnë negativisht në funksionet që duhet të kryejë media. Duke u bazuar në pyetjen kërkimore, se cilat janë thyerjet etike që evidentohen në shtypin e shkruar në pasqyrimin e fushatës elektorale, studimi synon të analizojë se si “Kodi i Etikës” nuk zbatohet. Prandaj në këtë studim janë përdorur “Kodi i Etikës” dhe “Teoria e Përgjegjësisë Shoqërore”, për të na ndihmuar të tregojmë, mënyrën e duhur se si media duhet të pasqyrojë fushatën elektorale dhe si realisht e ka pasqyruar atë.

### **Modeli teorik**

Modeli teorik ndërtohet duke u mbështetur tek teoria e Përgjegjësisë shoqërore të shtypit dhe Kodit Etik, të cilat bashkëshoqërojnë njëra-tjetrën duke shërbyer si teori gjatë këtij studimi. Si pjesë e modelit teorik shfrytëzohet përcaktimi i Hansen (2009), i bazuar në ndarjen në dy mënyra të shkrimeve të botuara mbi fushatën elektorale, në gazetari procesi dhe gazetari përmbajtjeje.

*Përgjegjësia shoqërore* sipas Siebert dhe të tjerë (1956), mbështetet tek specifikat e medias, të cilat e detyrojnë të jetë shoqërisht e përgjegjshme, duke bërë një prezantim të drejtë të asaj çfarë pasqyron dhe të asaj që transmeton për publikun, një informacion të mjaftueshëm në mënyrë që ai të vendosë. Pjesë e modelit teorik janë Kodi i Etikës dhe gazetaria e procesit dhe e përmbajtjes. Hipoteza e ngritur bazohet në këto teori dhe testimi i saj është edhe testim i vetë teorive.

### **Metodologjia e përdorur**

Analiza e përmbajtjes shërben si metodologji në shkencat sociale për të kuptuar përmbajtjen e komunikimit. Harold Lasswell, formuloi pyetjen thelbësore të analizës së përmbajtjes: Kush thotë çfarë, kujt, pse, me çfarë qëllimi dhe me cilin efekt? Ky punim ka një ndërthurje mes metodës cilësore dhe asaj sasiore. Metoda sasiore shërben vetëm për të nxjerrë në pah rëndësinë e disa aspekteve shumë specifike siç janë përqindja e opinionëve pro dhe kundër aktorëve politikë. (Bryman 2004, f. 392), deklaroi se analiza cilësore e përmbajtjes është qasja më e përhapur për të analizuar dokumentet në mënyrë cilësore. Për të përforcuar këtë mendim ai shton që analiza cilësore e përmbajtjes është “një qasje për dokumentet, e cila vë theksin tek roli i investiguesit për të ndërtuar kuptimin e teksit” (Bryman, 2004, f. 542).

Duke iu referuar analizës së përmbajtjes janë përdorur këto qasje. Është përdorur qasja konvencionale për të krijuar kategoritë e çështjeve etike, që rrjedhin direkt nga teksti, gazetata. Është përdorur qasja drejtuese, duke iu referuar modelit teorik. Qasja përmbledhëse është përdorur për të

mbledhur të dhënat e kategorive të njëjta dhe të bëjë një krahasim mes gazetave.

Në analizën e përmbajtjes janë studiuar kryeartikujt, editorialet, opinionet dhe shkrimet që lidhen me politikën.

### **Shkrimet mbi politikën**

Axhenda e aktorëve të politikanëve është vënë në shërbim të shqetësimeve të publikut. Për këtë mund t'i referohemi ndryshimit të axhendës së tyre pas rezultateve të sondazhit "Zogby", të realizuar para fillimit të fushatës elektorale, në janar. Pas publikimit të rezultateve aktorët politikë transformuan axhendën e tyre, duke kaluar nga standardet e shoqërisë së lirë, institucionet tek një gamë tjetër problematikash, si: papunësia, ekonomia, infraqstruktura, shëndeti, arsimit etj. Po media a e bëri diçka të tillë? A e vendosi axhendën e vet, në funksion të shqetësimeve dhe problematikave që janë të rëndësishme për audiencën? Apo në axhendën e saj transmetoi axhendën e politikanëve?

Për të studiuar shkrimet që kanë në fokus politikën janë përdorur dy ndarje kryesore, ku përfshijmë shkrimet që lidhen me procesin zgjedhor (si element i fushatës elektorale, duke e lidhur me mënyrën se si trajtohet) dhe shkrime që lidhen me fushatën elektorale të aktorëve politikë. Shkrimet që lidhen me problemet e procesit zgjedhor, si pajisja me kartat e identitetit, listat e votuesve, rastet e incidenteve pasqyrohen në funksion të rolit që duhet të luajë media, atë të informimit. Media transmeton, përpunon, prodhon informacion. Problemi qëndron se shpesh këto shkrime, shkruhen duke u mbështetur tek anshmëria, tek titujt sensacionalë etj., të cilët prodhojnë thyerje etike.

### **Mbi fushatën elektorale të aktorëve politikë. Gazetari procesi apo gazetari përmbajtjeje?**

*"Gazetaria e procesit përqendrohet te taktikat politike, manipulimet dhe beteja për pushtet në prapaskenë"*(Hansen, 2009, f. 42).

Rolin kryesor e luajnë liderët e dy forcave politike më të mëdha të PD dhe PS, dhe Meta që përfaqëson një parti të tretë, që mendohet se do të luajë një rol kyç për krijimin e qeverisë së ardhshme. Në kuadër të kësaj, ka shkrime që zënë një hapësirë të madhe, për strategjitë që Berisha dhe Rama për zgjedhin, për refuzimin e Metës nga kryetari i PS për të krijuar koalicionin me të, përdorimin e sondazheve si referencë për të ndërtuar taktikat e duhura politike. Aktorët politikë ndërtuan platformat e tyre elektorale, duke e njohur mirë axhendën e votuesve dhe një funksion të tillë duhet ta kryente edhe media. Duke mos u përqendruar tek problematikat që shqetësojnë

elektoratin (tek studimi, analizimi i premtimeve elektorale), por duke e pasqyruar si një garë mes liderëve kryesorë, duke u fokusuar tek strategjitë e tyre, media rrezikon të largohet nga audienca. *“Fatkeqësisht mediat nuk po luajnë ndonjë rol të lavdërueshëm. Me përjashtim të pak rasteve të veçara, shumica e mediave shqiptare i janë dorëzuar tundimit të spektaklit. ... Në vend që të orientojnë bisedën dhe debatin drejt programit dhe ideve, shumica e gazetarëve dhe e analistëve merren mjeshtërisht me strategjitë elektorale dhe personale të individëve. Ky sistem i mbyllur mediatik duket sikur funksionon në mënyrë të pavarur nga nevojat e qytetarëve.”* (Hasimja.E, 08.06.2009, 21)

Kjo shoqërohet me efekte negative dhe tek audienca, tek e cila aktivizohet ndjenja e cinizmit, si rezultat i kornizave strategjike të mbulimit të zgjedhjeve.

Ndërsa *“Gazetaria e përmbajtjes përqendrohet te pasojat e vendimeve politike dhe te dallimet politike dhe ideologjike”*(Hansen, 2009, f. 42).

Me ndryshimin e sistemit electoral, duke kaluar në rajonal proporcional, logjikisht duhet të ulet konflikti mes kandidatëve përkatës dhe të shtohet përplasja mes liderëve dhe vizioneve të tyre për politikën. Këtë problematikë mund ta shohim në aspektin se audienca merr shumë pak informacion nga partitë politike, në lidhje me programet e tyre, aq sa ndonjëherë është vënë në dyshim dhe ekzistenca e tyre dhe është detyrë e medias që të transmetojë më tepër informacion. *“Transparency International Albania i kërkon partive politike të bëjnë publike fondet që shpenzojnë për fushatë si dhe të shpalojnë programet elektorale... Shoqata vëren se publiku është njohur në mënyrë krejt sipërfaqësore me programet elektorale...”* (“Panorama”, 10.06.2009, f. 10).

Përveç kësaj liderët gjatë fushatës u bashkuan në shumë pika të përbashkëta, të cilat i bënë pjesë të programeve të tyre, si: papunësia, ekonomia, shëndetësia, arsimit, infrastruktura etj. Prandaj roli i medias do të ishte dhe më i rëndësishëm, në kërkimin se si do të mund të realizoheshin këto premtime elektorale të ngjashme. Në këtë rast, roli i ekspertëve të pavarur, është i pazëvendësueshëm. Përveç kësaj janë të rëndësishme dhe shkrimet mbi përmbushjen, arritjet, dështimet e premtimeve elektorale, kur qeveria në pushtet ka marrë mandatin, në vitin 2005. Por edhe kur shkrime të tilla realizohen, pavarësisht zhanrit të përdorur, karakterizohen nga anshmëria si p.sh., shkrimi: *“Skandalet e Berishës ngriu Ngjelën, ... për Ballën, seks për Pangon”*(Gazeta Shqiptare 07.06.2009, f. 2-5), ku shkruan: *“... si ka qeverisur kryeministri, dhe si duhet të zgjedhin shqiptarët, përveç spoteve elektorale duhet të njihen dhe*

*me anën ende të pathënë të kësaj qeverie*”(Gazeta Shqiptare, 07.06.2009, f. 2).

Duke mos u përfshirë, ose duke u përfshirë minimalisht, shkrime analitike mbi arritjet, dështimet, ndryshimet, mundësitë nëse janë të realizueshme premtimet elektorale të aktorëve politikë, gjithçka mbetet brenda një rrethi ku dominojnë liderët që përforcojnë “kultin e unit”. Fokusimi i liderëve te vetvetja (dhe këtu i referohemi kryetarëve të dy forcave kryesore politike) dhe tek negativja për kundërshtarin politik. Për ta ilustruar këtë mund t’i referohemi mjaft mirë analizës së ligjërimit politik të Ramës dhe Berishës:

*“Teksa ligjërimit negativ në formën e kritikave për arritjet dhe punën e qeverisë dhe të opozitës janë të domosdoshme në një shoqëri të lirë dhe demokratike, ai përbën problem kur nuk është konstruktiv, por personal, agresiv dhe emocional. Ky studim tregon se 45% e ligjërimit të secilit prej këtyre aktorëve politikë në periudhën e studiuar e që i kushtohet tjetrit i përkasin pikërisht kësaj kategorie të dytë: ato janë fyerje të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta personale karakteri, akuza pa bazë dhe krahasim apo asocim i kundërshtarit me tipare politike të së kaluarës ose figura politike botërore me imazh negativ”*(Raporti Nr. 1, 2012).

Beteja elektorale që normalisht duhet të lidhet me vizionet, ofertat, alternativat, etj., është eklipsuar nga betejat e krijimit të imazhit, tek “kulti i kryetarit” që na shpie tek antagonizmi. Duke u fokusuar në mënyrë dominuese tek këto lidera dhe gazeta do të prodhojë thyerje etike.

### **Titujt në raport me përmbajtjen. A ka sensacion? – thyerje etike**

Shpeshherë vendosen tituj sensacionalë, të cilët i identifikojmë si të tillë në raport me përmbajtjen e shkrimit, si dhe tituj që reflektojnë anshmërinë e gazetës si p.sh.: Incident në Durrës, digjet zyra elektorale e PS-së ndërsa në përmbajtje të shkrimit: *“Rreth orës 2.00 duke u gdhirë dita e martë, persona ende të pidentifikuar kanë tentuar të djegin zyrën elektorale të PS-së”*(Gazeta Shqiptare, 03.06.2009, f. 2).

Kemi dhe përdorimin e titujve, të ngjashëm si *“Rama: Enveristi Berisha po mban peng Shqipërinë”* (Tema 11.06.2009, f. 3), *“Berisha: Edi Rama, një Enver i Dytë”* (Gazeta Shqiptare, 05.06.2009 f. 6.), etj. Tituj, nëntituj, mbitituj të tillë të mbështetur në akuzat që liderët politikë i bëjnë njëri-tjetrit, dominojnë në shtypin e shkruar, si arsye e komercializimit dhe nevojës organizative për lajme, por që duke u përdorur kaq masivisht, mund të themi që na shpien drejt një uniformiteti, e cila mbështetet në retorikën boshe dhe që nuk sjell ndonjë informacion të rëndësishëm për audiencën.

### Kryeartikulli

Kryeartikulli lejon mundësinë për një analizë më në detaje të çështjeve politike se sa është e mundshme për një lajm të rregullt.

Pasqyrimi i kryeartikujve lidhet me tematikën e procesit zgjedhor, duke u fokusuar tek pajisja e qytetarëve me kartat e identitetit. Një tematikë e rëndësishme, që merr nota politike, në varësi të anshmërisë politike të gazetave. “Gazeta Shqiptare”, përdor tituj të tillë që tregojnë se zgjedhjet janë në rrezik, kaosi dhe alarmi për ecurinë e tyre dominojnë në këtë kategori shkrimesh. Edhe gazeta “Tema” pasqyron tituj pothuaj të ngjashëm, si: dështon procesi, standardet kanë rënë, por edhe që zgjedhjet duhen shpëtuar. “Panorama” përdor tituj më të ekuilibruar, duke përfshirë aktorët politikë të rëndësishëm, për këtë proces. Përmend Partinë Socialiste, e cila kërkon plotësimin e tri kushteve për njohjen e zgjedhjeve, qëndrimin e ambasadorit të SHBA-së nëse zgjedhjet duhet të shtyhen apo jo, vendim i cili duhet të merret nga partitë politike. Gazeta “Koha Jonë”, përveç qëndrimeve të Metës, që është kundra shtyrjeve të zgjedhjeve, fokusohet dhe tek procesi se si votuesve duhet t’u verifikohen kartat dhe shkruhet se opozita nuk duhet t’i shfrytëzojë kartat politikisht. Duke iu referuar përdorimit të titujve të përzgjedhur, mund të arrijmë në përfundimin që gazeta “Tema” dhe “Gazeta Shqiptare”, përdorin tituj që mund të ndikojnë negativisht tek audienca, në perceptimin e situatës që lidhet me procesin zgjedhor. E kundërta ndodh te gazeta “Koha Jonë”, e cila mundohet që të bëjë përgjegjëse të dyja forcat politike, për ecurinë e zgjedhjeve dhe jo të përjashtojë PS, e cila mund të përfitojë politikisht nga kjo situatë.

Titujt e kryeartikujve në pasqyrimin e incidenteve që ndodhën gjatë fushatës elektorale, duke iu referuar rastit të dy vrasjeve trajtohen në mënyra të ndryshme. Në incidentin e parë paraqitet vrasja e Artan Zekës, i cili ishte militant i PD-së. Tek gazeta “Koha Jonë” janë dy numra, të datës 13 dhe 14, që dalin me titujt e përcaktimit të përkatësisë politike, ku theksohet se socialisti ka vrarë aktivistin e PD-së dhe më pas shkruhet se kjo vrasje është kryer nga një ekstremist. “Gazeta Shqiptare”, përcakton bindjet politike të viktimës, por jo të autorit (Ballës) dhe në vend të kësaj paraqet arsyet e dhëna nga ai për ngjarjen, duke theksuar se nuk kishte grisur flamurin e PD-së dhe se është rrahur pa asnjë shkak në sy të gruas. Ndërsa për një incident me pasoja më të lehta të botuara disa ditë më parë, ka këtë kryeartikull: “*Rrihet kryetari i PS. Kryeplaku i PD e masakron për parullën shkruar në mur*”(Çollaku.A, 03.06.2009, f. 2). Gazeta “Tema” e pasqyron ngjarjen pa përdorur bindjet politike, të asnjërit prej personave të përfshirë, por shkruan se sherri për vendosjen e posterave, sjell vdekjen e një 25 vjeçari.



Ndërsa për incidentin e dytë, për vrasjen e Kekës, përdoren kryeartikuj që lidhen me funksionin e tij si kreu demokristian. Tek “Gazeta Shqiptare” kemi dhe qëndrimin e Ndokës, sipas të cilit vrasja është ekzekutim politik. Ai duke iu referuar dhe ligjërimin të Topallit disa ditë më parë, e cilëson atë si monstër. Tek “Panorama” shkruhet për vrasjen e kreut të PDK dhe se është një ngjarje që trondit fushatën. Ndërsa “Koha Jonë” në këtë numër del me kryeartikullin që i referohet sondazheve të bëra, të cilat nxjerrin fituese PD.

Sondazhet nuk janë vetëm një metodë që mat qëndrimet politike të opinionit publik në një moment të caktuar në kohë. Shumë vëzhgues e pranojnë se ato mund të përmbajnë një faktor rastësor në sjelljen gjatë votimit. Është argumentuar gjithashtu se sondazhet mund të ndikojnë tek audienca e pavendosur, për t’u bashkuar me partinë që ka më shumë shanse për të fituar. Edhe pse këto hipoteza variojnë nëse me të vërtetë ndodh kështu dhe në çfarë përqindjeje, mund të themi se sondazhet e opinionit publik, bëhen pjesë e mjedisit politik. “Gazeta Shqiptare” dhe “Tema” nuk kanë në asnjë kryeartikull, element sondazhin. Gazeta “Panorama” pasqyron tre kryeartikuj që i referohen përdorimit të rezultateve të sondazheve, por duke i paraqitur me tituj të ekuilibruar. Ndryshe vepron “Koha Jonë”, e cila gjatë periudhës së marrë në studim, përdor pesë kryeartikuj që kanë në fokus përdorimin e rezultateve të nxjerra nga sondazhet, duke i interpretuar dhe në tituj se të gjitha sondazhet nxjerrin fitues Berishën, madje dhe në qytete që tradicionalisht ka fituar e majta. Këto rezultate interpretohen në mënyra të ndryshme (në qoftë se u referohemi dhe artikujve të tjerë të botuar në këto gazeta), duke u fokusuar tek elementët që përshtaten më shumë me anshmërinë që mban gazeta.

### **Editorialet**

Editoriali është shkrimi kryesor i numrit të gazetës, i cili personifikon identitetin e saj politik. Linja editoriale e gazetës “Tema”, është kundra Berishës, një linjë e cila ndiqet gjatë tërë periudhës së marrë në studim, ndërsa gazetat e tjera nuk botojnë editoriale që kanë në fokus elementë të këtij studimi.

### **Opinionet**

Duke qenë se japin opinione, komente mbi ngjarjet dhe bëjnë interpretimin e çështjeve nga një pikëpamje subjektive, opinionistët, komentatorët, janë më pak të kufizuar nga kontrollet hierarkike, apo nga shtrëngimet korporative në krahasim me të tjerët, të cilët punojnë për gazetën, duke mos iu përmbajtur detyrimisht linjës editoriale. Ky zhanër

është i hapur si ndaj një përqsasjeje kritike, ashtu dhe ndaj një përqendrimi tek politikatat. Tek gazeta “Panorama” ka një pluralitet mendimesh dhe qëndrimesh në lidhje me tematikat, që trajtohen nga emra të tillë, si: Henri Çili, Blendi Kajsio, Mentor Nazarko, Ermal Hasimja, Skënder Minxhozi etj. Trajtohen problematika të tilla, si analiza e modelit ekonomik dhe politik shqiptar, duke e analizuar dhe me problematikat përkatëse, domosdoshmëria e publikimit të programeve të partive, kartat e identitetit, përse mungon lajmi në fushatë, strategjitë e liderëve etj. E rëndësishme është që të trajtohet edhe gazetaria e përmbajtjes, përveç asaj të procesit. Pluraliteti i mendimeve, është një element i pranishëm, i cili reflektohet mjaft mirë, po t’i referohemi kritikave për liderët. Kështu dy liderët kryesorë kanë pak a shumë të njëjtën përqindje në lidhje me kritikën, që kanë marrë në këtë zhanër, rreth 30% secili prej tyre. Ndërsa përqindja e shkrimeve që lidhet me kritikën për të dy, shkon rreth 40%. Rezulton ndryshe studimi i këtij zhanri në gazetatat e tjera të studiuara, si nga sasia dhe nga analiza e përmbajtjes. Te “Tema” dhe “Gazeta Shqiptare”, pjesa më e madhe e shkrimeve janë kundra Berishës, të cilat dominojnë pothuajse gjatë tërë periudhës së marrë në studim. Në disa raste, botohen te “Tema”, opinionet e Bashkim Balës, të botuara më parë te “Gazeta Shqiptare”. Ndërsa tek “Koha Jonë”, po t’i referohemi sasisë botohet një numër shumë i vogël opinionesh, që janë në fokus të këtij studimi. Tematikat e trajtuara lidhen me qëndrimin pro të ndërtimit të tunelit të Kalimashit, lëvdata për qeverinë, kritikë për Ramën, kritikë për partitë politike.

### **Thyerje të tjera etike**

*“Gazetarët kanë të drejtë të marrin informacion, ta botojnë atë dhe ta kritikojnë. Informacioni duhet të jetë i saktë, i balancuar dhe i verifikuar”*(Kodi Etik i Medias Shqiptare, 2006, f.4).

Informacioni që merret duke pasur si burim edhe liderët kryesorë, balancohet duke përdorur kundërshtarët politikë, sepse shpesh është e vështirë të verifikohet për vetë natyrën e ligjërimit politik të tyre, ku dominon konflikti. Megjithatë kjo metodë nuk e zëvendëson gazetarinë investigative.

Duke iu referuar “Kodit të Etikës”, media duhet të bëjë publik një korrigjim në mënyrë të qartë dhe në një vend të dukshëm. Edhe pse ka raste kur informacioni i publikuar nuk është i saktë, në studimin e kryer nuk rezulton që kjo normë etike respektohet.

Gazetarët jo vetëm në zhanret që lejojnë më tepër hapësirë në interpretim, por edhe në gruplojin informativ, shpesh shfaqin anshmëri.

Një thyerje etike tjetër, evidentohet në gazetën “Tema”, ku stafi editorial lejon që nxitjet personale, politike të ndikojnë për një raportim që nuk mbështetet në saktësi dhe paanshmëri.

### **Problematikat dhe strategjitë**

Transparenca e medias është një domosdoshmëri për funksionimin e tregut mediatik. Pronësia e medias shpesh lidhet me emra pronarësh, që zakonisht kanë edhe biznese të tjera paralele. Të ardhurat nga këto biznese përdoren për mbijetesën e medias dhe media përdoret për të mbrojtur interesat e tyre. Transparenca e financimit të medias ka qenë një tjetër problematikë e evidentuar, edhe pse me kalimin e kohës ka ardhur në rritje, është shoqëruar dhe me raste spekulimi. Kjo situatë e krijuar influencon në informacionin që i transmetohet publikut, pasi prioritetet kryesore janë interesat e pronarëve dhe jo interesi publik. “*Për pasojë, transparenca e pronësisë së medias, aktiviteti i saj, dhe ndikimi që ka te publiku mbeten nevoja thelbësore për zhvillimin e pluralizmit të medias dhe sidomos forcimit të pavarësisë së saj*” (Media dhe Shoqëria e Informacionit në Shqipëri, f. 37).

Një tjetër problematikë janë dhe marrëdhëniet e punës për gazetarët, pasi një pjesë e madhe e tyre punojnë pa kontratë, dukuri që shoqërohet me efekte negative si censura dhe vetëcensura. Mbrojtja formale e garantuar nga Kodi i Punës, si dhe bashkëpunimi mes gazetarëve në shoqatat kryesore dhe sindikatën e gazetarëve, do të bëjnë që gazetarët të ndihen më të mbrojtur nga interesat personale të pronarëve dhe nga vetëcensurimi.

Vetërregullimi lidhet me lirinë e medias, e cila është e rëndësishme në qoftë se i referohemi funksioneve që media luan në një shoqëri demokratike. “*Ai synon të vendosë standardet minimale të saktësisë, etikës profesionale, mbrojtjes së privatësisë dhe të tjera të drejta personale, duke ruajtur lirinë editoriale dhe lirinë e fjalës, si edhe shumëllojshmërinë e pikëpamjeve dhe opinioneve*” (Gazetaria Profesionale dhe Vetërregullimi, 2011, f. 18).

Planifikimi i pasqyrimin të zgjedhjeve është një strategji e rëndësishme, sepse në rast të kundërt raportimi mund të jetë sipërfaqësor, i zakonshëm dhe nën kontrollin e burimeve nga të cilët merren informacione. Planifikimi i pasqyrimin lidhet me përcaktimin e roleve (redaktorë, gazetarë), nëse do të specializohen profilet apo jo, vendosja e qëllimeve pasi i detyron redaktorët dhe gazetarët të reflektojnë për mënyrën se si do të pasqyrojnë, duke shërbyer dhe si një udhëzues për drejtimin e pasqyrimin, dhe jo fokusimin vetëm tek konferencat e shtypit. Një element tjetër i rëndësishëm është përpjekja për të zbuluar nevojat e publikut, çëshjet më

shqetësuese. Respektimi i kriterëve klasike të lajmit, si dhe pasqyrimi i çështjeve kryesore, duke u bazuar tek ekspertët e pavarur, shqyrtimi se çfarë ka bërë qeveria në raport me atë që ka premtuar se do të bënte, si dhe eksplorimi se çfarë do të bëjnë partitë në opozitë, duke kërkuar dhe mendimin e ekspertit për zgjidhje të mundshme. Para se të fillojë fushata, një strategji e mirë është zhvillimi i disa ideve për artikuj, që mund të botohen.

### **PËRFUNDIME:**

Roli i medias është akoma më i rëndësishëm gjatë fushatës elektorale, ku media ka detyrën e rëndësishme që t'i ndihmojë votuesit të kuptojnë çështjet kyçe të zgjedhjes, me qëllim që të marrin vendimin më të mirë së për kë do votojnë. Për këtë arsye është i domosdoshëm respektimi i Kodit të Etikës.

Nga studimi arrijmë në përfundime që media e shkruar e pavarur në mbulimin e fushatës elektorale, përmban dhe prodhon thyerje etike, si: anshmëria, mungesa e verifikimit, përdorimi i titujve sensacionalë, mungesa e korrigjimeve etj.

Analiza mbi fushatën elektorale të aktorëve politikë mbështetet në dy qasje: në gazetarinë e procesit dhe të përmbajtjes. Gazetaria e procesit është e rëndësishme, por përqendrimi i tepruar në këtë qasje influencën negativisht, sepse aktivizon cinizmin e audiencës.

Mediat duhet të ndihmojnë votuesit të bëjnë zgjedhje të informuara. Nevoja e votuesve është që të jenë të informuar për aktorët politikë, vizionet, politikat dhe pasojat e këtyre politikave. Media duhet të përqendrohet tek përmbajtja dhe jo te shfaqja e aktorëve kryesorë. Të fokusohet te faktet dhe zgjidhjet dhe jo tek deklaratat e pafundme të liderëve. Premtimet elektorale duhet të analizohen dhe për këtë rol i ekspertëve të pavarur është shumë i rëndësishëm.

### **REFERENCA:**

1. Bryman, A. (2004): *Social research methods* (2nd ed.). New York: Oxford University Press.
2. Hansen, H. (2009): *Raportimi i Drejtë dhe i Balancuar i zgjedhjeve*, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë.
3. *Gazetaria Profesionale dhe Vetërregullimi* (2011): Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, Paris (shtypur nga Maluka, në Shqipëri)
4. Mc Nair, B (2009): *Hyrje në Komunikimin Politik*, Maluka, Tiranë.
5. *Media dhe Shoqëria e Informacionit në Shqipëri*, Instituti Shqiptar i Medias.
6. Kuhn & Neveu (2002): *Gazetaria Politike*, Instituti Shqiptar i medias, Tiranë.

7. Siebert, F. dhe të tjerë (1956): *The Four Theories of the Press*. Urbana, Illinois: University of Illinois Press.
  8. “Berisha: Edi Rama, një Enver i Dytë” (2009, Qershor 05). *Gazeta Shqiptare*, f. 6.
  9. Çollaku, A. “Rrihet kryetari i PS. Kryeplaku i PD e masakron për parullën shkruar në mur” (2009, Qershor 03). *Gazeta Shqiptare*, f. 2.
  10. Hasimja, E.: “Spektakël në vend të programeve” (2009, Qershor 08). *Panorama*, f. 21.
  11. “Incident në Durrës, digjet zyra elektorale e PS-së” (2009, Qershor 03). *Gazeta Shqiptare*, f. 2.
  12. “Rama: Enveristi Berisha po mban peng Shqipërinë” (2009, Qershor 11). *Tema*, f. 3
  13. “Skandalet e Berishës ngriu Ngjelën,...për Ballën, seks për Pangon”(2009, Qershor 07). *Gazeta Shqiptare*, f. 2-5.
  14. “TIA: Fushata, partitë të publikojnë fondet” (2009, Qershor 10). *Panorama*, f. 10.
- [http://www.academia.edu/2411311/Raporti\\_i\\_Ligjërimit\\_Politik\\_në\\_Shqipëri](http://www.academia.edu/2411311/Raporti_i_Ligjërimit_Politik_në_Shqipëri)  
[http://ëëë.osce.org/sq/albania/21235/Kodi\\_Etik\\_i\\_Medias\\_Shqiptare](http://ëëë.osce.org/sq/albania/21235/Kodi_Etik_i_Medias_Shqiptare)

### **Ethics in independent print media in the coverage of the electoral campaign**

#### **SUMMARY**

This study analyzes the content of printed media during the election campaign in year 2009. One of the most important elements and functions of media is the right application of ethical codes. Relying on the research question; is there any ethical issue in the coverage of the election campaign in the print media, the study aimed to put on evidence the ethics violations made by printed media. The Code of Ethics (2006) was the theory of this study which helped showing the right way of how media should reflect the elections. It was used the methodology of qualitative content analyses choosing major newspapers (with the highest circulation of sales) as main text and comparing them with the ethical code. The study was realized studying the content of articles published during the month of June. The date was chosen because the elections took place during this month. This study beside the identification of problems that can cause ethical issues such as , transparency of media ownership and funding, censorship, self-censorship, media relations and business policy, also suggests strategies for improvement of the situation.

**Keywords:** *ethics, printed media, content analyses, media strategy, ethical issues*

Ardita REÇI

## ORIENTIMET ZYRTARE DHE GAZETARËT SHQIPTARË TË VITEVE 1945-1990

### Hyrje

Shteti komunist shqiptar, që në muajt e parë të qeverisjes së tij, shprehu publikisht dhe krejt haptazi, nevojën e menjëhershme për përhapjen e shtypit, e me anë të tij propagandën, në sa më shumë skaje të mundshme të vendit, duke nxitur dhe ndihmuar hapjen e periodikëve për çdo formë organizimi shoqëror (kryesisht si organe të organizatave të masave), që do të thotë, jo vetëm shumëfishim i numrit të lexuesve, por edhe i shkruesve të këtyre mediave. Studiuesi Hamit Boriçi thekson se “*Në atë periudhë një nga problemet e rëndësishme ishte edhe sigurimi i kuadrit për shtypin, përgatitja dhe kualifikimi i tij, - duke sjellë në kujtesë faktin se gazetarët e pasqirimit ishin vijuesit e shtypit ilegal të Luftës së Dytë Botërore, “kuadro të ardhur nga rreshtat partizane, letrarë te rinj, etj ... që përqaftuan idetë e Partisë, ... disa prej të cilëve ose kishin shkruar rrallë, disa vetëm hartime shkollore e një pjesë as që e kishin zënë penën për gazetari”*<sup>355</sup>. Formimi i punonjësve të shtypit vijoi më vonë me hapjen e një **paraleleje në shkollën e Partisë**, prej së cilës kuptohej se do të dilnin përcjellës “të mirë” të fjalës së udhëheqjes. Dhe “udhëheqësi” nuk vonoi shumë të kthente vëmendjen nga shtypi, pas marrjes së pushtetit. Të parin fjalim zyrtar të publikuar me kujdes në një përmbledhje të PPSH-së, Enver Hoxha, e mban në Kongresin e dytë të Rinisë, më 16 prill 1945, ku thoshte se “... Në lëmin e kulturës dhe të propagandës, në një kohë shumë të shkurtër qeveria jonë ka bërë një punë të madhe. Një rrjet i gjerë gazetash ka mbuluar Shqipërinë. S’ka sot prefekturë pa tipografi dhe pa gazetë. **Froni, rinia, pionierët, gruaja antifashiste, ushtria, të gjithë kanë gazetat e tyre... Radioja funksionon më së miri.**”<sup>356</sup> E në këtë rrjet të krijuar shtypi, deri në vitin 1948 (kur rifillon botimi i “Zërit të popullit”), organi më i rëndësishëm ishte e përditshmja “Bashkimi”, që “në fillim kishte një **redaksi politike, që përbëhej nga funksionarë të Frontit Demokratik**

<sup>355</sup> Boriçi, Hamit (1986): *Redaksia dhe puna e gazetarit, Teoria dhe praktika e shtypit popullor*, Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha”, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Tiranë, f. 9.

<sup>356</sup> “*Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin*”, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1980, f.. 71.

(Artikujt me rëndësi të kësaj gazete, ashtu si edhe të “Zëri i populli”, më vonë punoheshin nga organizatat e Partisë)<sup>357</sup>,..., - shkruan Boriçi duke theksuar se, - *vështirësia qëndronte se për sektorët operativë të redaksisë duheshin jo vetëm njerëz të përgatitur nga ana profesionale, por edhe të ngritur ideologjikisht. ... Për këtë, shpejt Partia dërgoi në redaksi kuadro të rinj. Në gjysmën e dytë të vitit 1945 u vendos në gazetën “Bashkimi”, kryeredaktori, e nisi organizimin e sektorëve të ndryshëm.”*<sup>358</sup>

Qveria komuniste nuk humbiste fare kohë në përpjekjet e saj, për ta forcuar propagandën dhe strukturat e përcimit të vijës ideologjike të partisë-shtet. Vetëm pesë vjet pas përfundimit të luftës, në Vendimin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, të datës 22 prill 1949, konstatohej se **shtypi tashmë ishte i orientuar drejt për nga pikëpamja politike**, si për sa u përket problemeve të brendshme, ashtu edhe atyre ndërkombëtare, megjithëse vazhdimisht kërkohet përsosmëria e përmbajtjes agjitative dhe propagandistike të gazetave dhe revistave dhe kontaktet e shpeshta me masat. Tashmë shtypi ishte etiketuar nga udhëheqësi si **“organizatori kolektiv i masave”**<sup>359</sup>, ndaj dhe gazetarëve u binte barra e rëndë që të organizoheshin në mënyrë të tillë që **masat të përfaqësoheshin sa më shumë në shtyp**. Në funksion të kësaj ideje u vendos të organizohet **rrjeti i korrespondentëve vullnetarë punëtorë e fshatarë**, ideja e krijimit të të cilit, tashmë është **larg kërkesave për gazetarë profesionistë**, siç shihet edhe më poshtë: *“Rrjeti i korrespondentëve vullnetarë të shtrihen në çdo qendër prodhimi e pune, në kooperativë, administratë, shkollë, lagje, fshat dhe repart ushtarak. Korrespondentët vullnetarë të jenë të organizuar në bazë grupesh për çdo qendër rrethi, lokaliteti, fshati dhe reparti, sipas numrit të tyre. Organizimi i rrjetit të korrespondentëve vullnetarë të bëhet në baza krejtësisht vullnetare dhe çdo njeri ka të drejtë të zgjedhë lirishit organin për të cilin dëshiron të jetë korrespondent”*<sup>360</sup>.

### **Privilegjet e korrespondentëve vullnetarë punëtorë e fshatarë.**

Nën drejtimin e organeve të partisë-shtet, korrespondentët (njerëz për të cilët nuk kishte asnjë lloj pretendimi, përveç dëshirës për ta bërë “punën”), që kishin për detyrë: *a) Të informojnë organet e shtypit mbi jetën, aktivitetin dhe problemet e masave punonjëse dhe të reparteve ushtarake, të vënë në dukje të metat dhe sukseset në punë; dhe b) Të ndihmojnë për përhapjen sa më të gjerë të gazetës dhe revistës),*

<sup>357</sup> Po aty, f. 81.

<sup>358</sup> “Historiku i gazetës “Bashkimi”, f. 7-8.

<sup>359</sup> “PPSH për shtypin”, T. 1981, f. 123.

<sup>360</sup> Po aty.

toleroheshin deri në masën sa që shkrimet e tyre kishin **imunitet ndaj censurimeve** të organizatave e Partisë ose organizatave të masave. “Çdo korrespondent të lidhet direkt me redaksinë e organit përkatës dhe secila redaksi të drejtojë punën e korrespondentëve duke i shkruar secilit veçanërisht dhe duke i mbledhur në grupe herë pas here me anë të të dërguarve të saj”<sup>361</sup>.

Peshorja e rëndësës ndërkaq anonte nga gazetarët e qendrës dhe redaktorët e shtypit<sup>362</sup>, të cilët, edhe pse përpiqeshin të përmbushnin sa më mirë kërkesat arsimore e profesionale, duke u plotësuar vit mbas viti me kuadro me arsim të lartë, fillimisht në degë të përafërta e më pas me profilizim në gazetari, mbulonin jo vetëm terrenin, por edhe përpunonin shkrimet kryesisht amatore të korrespondentëve, duke përfshirë në to edhe vijën e udhëzimit e kohëpaskohshme të Partisë. Siç përmend studiuesi Colin Sparks: “Në shoqëritë totalitare, gjithë grupet e elitës i nënshtrohen elitës politike”<sup>363</sup>. Edhe elita e gazetarëve, ose redaktorët shqiptarë, kishin të njëjtin fat. U duhej të përmbushin të gjitha kërkesat e elitës politike, e tani edhe me një detyrë të re: trajnimit të herëpashershëm të korrespondentëve në zonën ku ata banonin, ashtu siç trajnoheshin herë pas here edhe vetë nga agjitorët e organeve të Agjitpropit. “Nga ana e redaksive përkatëse të gazetave të zhvillohet një punë politike instruktuese me korrespondentët vullnetarë, në mënyrë që ata të kryejnë sa më mirë rolin e tyre.”<sup>364</sup>

**Por edhe korrespondentët kishin pjesën e tyre të ngarkesës.** Ata nuk duhej të harronin detyrën për **popullarizimin e shtypit** të partisë, ushtrisë, të shtetit dhe të organizatave të masave. Korrespondentët, duke qenë edhe propaganduesit më të afërt të fjalës së partisë tek masat, duhej të ndihmonin në organizimin në shkallë të gjerë të leximeve kolektive, së bashku me agjitorët politikë... “Gazeta duhet të ketë një plan të kësaj natyre me qëllim që nëpërmjet artikujve të fusë në kokat e njerëzve, të kuadrove të Partisë, të shtetit dhe të masave të popullit idetë shkencore, disiplinën

<sup>361</sup> “Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin”, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981, f. 98.

<sup>362</sup> Në një klasifikim që u bën gazetarëve të asaj periudhe studiuesi Hamit Boriçi në librin e tij “Redaksia dhe puna e gazetarit” (1986), vërejmë se, gazetarë janë të gjithë punonjësit e shtypit e të radiotelevizionit, që merren me “veprimtari publicistike”, sipas rolit e funksionit të kryejnë në gazetë a në revistë, në radio, në televizion apo në ATSH, ata emërtohen: **redaktorë** dhe **korrespondentë**.

<sup>363</sup> Colin Sparks (2001): *Komunizmi, kapitalizmi dhe mass-media*, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë, f. 56.

<sup>364</sup> *Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981, f. 98.



shkencore (ideologjia komuniste, sipas pikëpamjeve të udhëheqësit ishte shkencore - shënimi im A. R)”<sup>365</sup>. **Syrin vigjilent**, si një aftësi profesionale që duhet të gëzonin gazetarët, korrespondentëve ua ushqente Partia, duke u imponuar që “të jenë të papajtueshëm e objektivë kundrejt të metave, lëshimeve dhe gabimeve në punë. Ata duhet të zbulojnë dhe të kritikojnë ashpër pa ndrojtje të gjitha veprimet që janë në kundërshtim me politikën e Partisë e të qeverisë, shkelësit e ligjeve të shtetit, burokratët, shpërdoruesit e pasurisë shtetërore e shoqërore, arrogantët e dembelët. ... Përkrah kësaj, korrespondentët punëtorë e fshatarë duhet të popullarizojnë në shkallë të gjerë sukseset e arritura në ndërtimin socialist, duke njoftuar organet e shtypit mbi ndërmarrjet, kooperativat, repartet, brigadat e individët që punojnë mirë dhe që janë shembull për të tjerët.”<sup>366</sup>. Udhëheqja, kështu impononte tek punonjësit e medias edhe tematikat për të cilat do të shkruanin. Shohim se objekt lajmi, propozohet të trajtoheshin sjelljet e personave të caktuar, të cilat ishin “negative”, sipas moralit të pjesës tjetër të shoqërisë dhe se të gjitha hallkat e shtetit punonin mirë, sipas politikës në fuqi, e kështu që po të ndiqej parimi se “Lajmi i keq është lajm i mirë”, nga institucionet shtetërore nuk do të kishte kurrë lajme, përveç goditjes së personave të caktuar, e kështu sërish lajmi zbret në nivel individ, ose maksimumi organizate. Gazetarëve u imponohej autocensura dhe ata e dinin mirë se për çfarë temash duhej të shkruanin, e çfarë temash nuk duhej as menduar, e kështu, sipas teorieciënëve të propagandës ushtrohej më së mirë kontrolli shtetëror. “Mënyra kryesore e ushtrimit të kontrollit ishte autocensura e vetë gazetarëve”, thotë Downing.<sup>367</sup>

### KONKLUSIONE:

Shteti totalitar shqiptar ka ditur të përdorë mirë armën e tij propagandistike: shtypin, duke mirëmenduar balancën e informacioneve që shkonin në redaksi. Kur bëhej fjalë për përçimin e drejtë të vijës së Partisë tek masat, artikujt dërgoheshin të përpunuar në redaksi, dhe qëndiseshin që më parë në formën më të mirë të mundshme. Burimet shtetërore dhe në parti, të gazetarëve shqiptarë, në fakt nuk ishin burime, por porositiës. Shkrimet e anëtarëve të partisë dhe të komiteteve në rrethe e qarqe gëzonin “imunitet”, ato nuk mund të prekeshin nga redaksia, por do të botoheshin

<sup>365</sup> “Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin”, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981, f.266.

<sup>366</sup> “Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin”, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981, f.112.

<sup>367</sup> Downing (1995: 194) cituar tek Colin Sparks, (2001): *Komunizmi, kapitalizmi dhe mass-media*, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë, f. 68.

siç ishin, edhe për arsyen, se në to, bëhej zbërthimi i direktivave të partisë. Partia nuk kishte besim ta linte zbërthimin dhe interpretimin e fjalës së saj në duart e gazetarëve, ndaj dhe të gjitha orientimet duheshin shkruar nga njerëzit e saj besnikë të provuar. Por nga ana tjetër, puna e gazetarit siç thotë Sparks<sup>368</sup>, ishte që të shpjegonin, të edukonin e të ndihmonin me shkrimet e tyre (*partinë-shtet*) për të fituar mbështetje për ndërtimin e botës socialiste.

Orientimet për gazetarët jepeshin gjithmonë për lidhje sa më të ngushtë me “realitetin e masave” e me vetë masat, larg nga mendimet profesionale për të parë me syrin kritik realitetin shtetëror, e për të goditur publikisht problemet e tij, fillimisht ekonomike, e më pas politike. Ndaj dhe fakti se informacioni nga baza merrej kryesisht nga njerëz jo profesionistë, nuk përbënte ndonjë problem të madh, për sa kohë që nga hallkat e shtetit, nuk do të kishte kurrë lajme, përveç goditjes së personave të caktuar, duke e zbritur gjithnjë lajmin në nivel individual, për të fshehur pas kësaj fasade të metat e sistemit.

### **Official orientations and the Albanian journalists during the years 1945-1990**

#### **SUMMARY**

Albanian communist state the years 1944-1990, as whole totalitarian states, considered the media and especially the press, as a powerful weapon to conveying its propaganda. And in this regard, it seems that Albanian journalist of the past few years there has been a privileged character within this system, as interpreter, mediator, and the conductor of the Party-State speech, but in fact has not always been so. Although the system was dictatorial throughout its existence, social positions, political, economic and cultural, that have occupied the journalists during the years of his life have been different. During the treatment of this theme study, I will try to deploy the figure of the Albanian journalist within the society of the time, placed in that status predetermined by political line of the party-state. The methodology to be used during the preparation of the theme will be qualitative analysis of archival documents and publications of the Party

---

<sup>368</sup> Colin Sparks, (2001): *Komunizmi, kapitalizmi dhe mass-media*, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë, f. 81.

---

of Labor of Albania and dictator Enver Hoxha, related press and journalists. It will also analyze the time press articles. This article is part of my doctoral studies, and therefore theoretical support be made according to the literature that I'm using the realization of my dissertation in the field of sociology of journalism.

**Keywords:** status of journalists, the directives of the Party-state, the architect of the opinion, collective organizer of the masses, etc.

**Romira MUKA**

## **LIGJËRIMI POLITIK NË SHQIPËRINË KOMUNISTE GJATË FESTAVE KOMBËTARE**

### *Hyrje*

Gjuha është një mjet, e cila përveçse lejon komunikimin, shërben për ta formuar atë dhe gjithashtu për të ndërtuar nëpërmjet tij struktura shoqërore. Këto struktura nuk e kanë gjithë burimin e tyre tek gjuha e folur, por më së shumti tek gjuha e komunikuar. Por veç kësaj janë edhe dinamika të tjera, sikurse aspekti social, ekonomik, kulturor dhe politik i një vendi, të cilët ndikojnë në formulimin e strukturave bazë të një shoqërie. Me termin strukturë do të nënkuptojmë shtylla të ngritura në formën e koncepteve, me anë të të cilave një shoqëri njeh dhe prezanton vetveten. Strukturat i sheh si shtylla për vetë faktin se janë pika referimi, ku shoqëria mbështetet për të kuptuar një realitet dhe për të qenë pjesë e tij. Autorë të ndryshëm e shohin çështjen e gjuhës në mënyra të ndryshme. Disa mendojnë që gjuha është ndërtuese e realitetit social. Autorë të tjerë argumentojnë që realiteti social prodhon gjuhë. Këndvështrimi që ndjek ky punim e sheh gjuhën si një ndërtuese të realitetit social dhe si e tillë studimi i saj përbën një rëndësi të madhe. Siç thamë edhe më lart, kuptimi i realitetit nuk ndodhet vetëm në gjuhën e folur, por edhe në gjuhën e shkruar, në tekste të ndryshme, të cilat shërbejnë për shpërndarjen e mesazheve. Një nga këto tekste janë edhe gazetat. Gazeta është mediumi i cili transmeton, prodhon dhe shpërndan mesazhe. Nisur nga fakti që mediat janë një mjet propagandues në sistemet totalitare, ato i përmbahen dhe i binden vijës ideologjike të sistemit. Burimi kryesor i informacionit për mediat është vija ideologjike nën mbikëqyrjen politike. Roli parësor i medias është të zhvillojë komunikimin me një kah, i cili shërben si informues, por edhe si përforcues i bindjeve politike. Në të njëjtën kohë mediat kryejnë edhe funksionin e tyre të krijimit të një perceptimi mbi realitetin. Ky perceptim është i kontrolluar dhe i strukturuar mirë nga vetë strukturat partiake. Sipas Fugës, i gjithë informacioni që ofrohet nga media, është kurdoherë “brenda kufijve të një vizioni global mbi botën”(2010: 195). Ky globalizëm nënkupton edukimin e masave mbi çdo gjë që ndodh brenda dhe jashtë kufijve. Edhe sipas Lloshit, funksioni ndikues i mediave do të thotë që “... jo vetëm paraqiten mendime, qëndrime e vlerësime, por

*edhe synohet të ndikohet mbi mendimet, qëndrimet e vlerësimet e lexuesve ose dëgjuesve, të ndryshohen ato në drejtim të caktuar, të nguliten bindjet politike, të nxirren reagimet shoqërore e deri të përftohen te njerëzit paragjykime, shije e prirje sipas një orientimi të caktuar. Përgjithësisht funksionet shoqërore të kësaj veprimtarie janë informues dhe formues, organizues e propagandues, njohës dhe edukues” (1999:216). Duke u nisur nga këto qëndrime teorike mbi mediat, gazeta që kam zgjedhur për studim është “Zëri i Popullit”. Për të kuptuar atë çfarë prodhon teksti i kësaj gazete në shoqëri, na duhet të ndalemi më parë tek konteksti nga ku del kjo gazetë dhe funksionet e saj. Sipas Bertrand (1997), ka katër regjime shtypi, të cilat përkohën me sistemet politike nga ku prodhohet ky shtyp. Rasti i këtij punimi i përket regjimit komunist të shtypit, në të cilin mediat nuk mund të kuptohen jashtë shtetit totalitar. Bertrand (1997: 16-17), shpjegon që në regjimin totalitar shteti “i përdor mediat për të përhapur ideologjinë zyrtare, për t’ua mësuar atë njerëzve, për të nxitur popullin që ta ndjekë këtë ideologji dhe më në fund, për ta imponuar atë”. Gjithashtu ai shton që mediat e botës së tretë pretendonin të kishin një rol të veçantë që “t’i shërbenin zhvillimit, të edukonin popullin, të ngjiznin në një komb grupe heterogjene dhe të ruanin kulturën lokale” (Bertrand, 1997: 17). Nëse ky është funksioni i mediave, lind pyetja: “Me cilat mjete dhe strategji e realizon media e kohës, në rastin tonë shtypi i shkruar, këtë funksion?”. Hipoteza e këtij punimi, është një prej mjeteve të krijimit të identitetit të “njeriut të ri”, antagonizmi, ku historia shërben si strategji për të krijuar kampe antagoniste. Pyetja kërkimore që do t’i japë përgjigje kësaj hipoteze është: “Cilat janë strategjitë që përdor historia për të ndërtuar antagonizmin”? Para se t’i japim përgjigje kësaj pyetjeje na duhet të shpjegojmë se çfarë është antagonizmi dhe cila është lidhja mes antagonizmit dhe ligjërimit.*

### **Antagonizmi dhe ligjërimit**

Chantal & Mouffe (1985), shpjegojnë se, koncepti i hegjemonisë nuk vjen për të mbushur një koncept të ri, por më shumë ajo është shpërbërja e koncepteve, sepse “për karakterin relational të çdo identiteti, implikohet një thyerje e diferencimit të planeve, të disproporcionit mes artikuluesit dhe të artikuluarës, ku gjenden edhe lidhjet e hegjemonisë” (1985:91). Kjo do të thotë që koncepti i hegjemonisë presupozon fushën teorike ku dominon artikulimi ose thënë ndryshe ligjërimit. Ndërtimi teorik i kategorisë të hegjemonisë kërkon specifikën e momenteve që përmban ligjërimit, sepse kuptimi i identiteteve nuk është thelbësor. Identitetet nuk shihen si copëza të një mekanizmi, por si pjesë të ndërtuara nga njëra-tjetra,

ku nuk kemi kurrë një konstrukt përfundimtar. Këto copëza vijnë herë si pjesë plotësuese dhe herë si pjesë kundërshtuese. Në momentet e përplasjes mes ligjërimeve lind antagonizmi, i cili lejon krijimin e identitetit duke e ruajtur atë nga “pozitiviteti i plotë”(1985:125).

Por është e qartë që antagonizmi nuk vepron në një pikë të vetme sepse “*çdo pozicion në një sistem diferencash .... mund të kthehet në vendin gjeometrik të një antagonizmi*” (Chantal & Mouffe 1985:131). Prandaj, krijimin e identitetit përmes antagonizmit do ta gjejmë tek ligjërimet, të cilat ndryshojnë në varësi të kohës që prodhohen dhe ndryshojnë po me kohën.

### **Metodologjia**

Paragrafët e mësipërm japin shpjegimin e kontekstit teorik ku mbështetet ligjërimi i këtij punimi. Ndërsa për sa i përket metodologjisë do të përdorim qasjen historike të ligjërimet, si metodologji e përshtatshme për të ndërtuar analizën e tekstit të marrë në shqyrtim.

Hapi i parë i qasjes historike të ligjërimet është identifikimi i temave të përmbajtjes. Sipas Wodak, ky identifikim bëhet përmes leximeve të rastësishme të të dhënave empirike, të cilat do të lidhen me teoritë përkatëse të fushës së studimit (Wodak et al 1999:30). Në të njëjtën kohë, ai udhëzon katër makrostrategji ligjërimore, të përmbledhura si më poshtë:

#### *Strategjia ndërtuese*

Strategjia ndërtuese shërben për të strukturuar ose ndërtuar strategji, të cilat shërbejnë për të ndërtuar identitete të veçanta. Imazhet e unitetit dhe të qenit njësoj, shërbejnë për të formuar grupe, ku të ndryshmet e këtij identiteti, sipas teorisë të ligjërimet do të quhen antagonizëm ose të tjerët (Wodak et al 1999).

#### *Strategjia e vazhdimësisë, justifikimit dhe legjitimitimit*

Strategjia e vazhdimësisë përkon me objektivin e riprodhimit ose ruajtjen e një identiteti specifik, por edhe të kërcënuar. Ideja e vazhdimësisë është themelore në strategjinë e vazhdimësisë, ashtu sikurse është edhe ndërtimi i kërcënimit ndaj kësaj vazhdimësie dhe e gjithë identitetit si i tërë (Wodak et al 1999). Strategjia e vazhdimësisë shpesh ndërtohet mbi parashikimin e fatkeqësisë, referencave historike dhe krijimit të kontrastit përmes strategjive “të asimilimit dhe disimilimit” për realizimin e tij (Wodak et al 1999: 39-40).

#### *Strategjia e transformimit*

Strategjia e transformimit shërben për të transformuar identitetet e vendosura mirë në identitete të tjera (De Cillia et al 1999: 161). Strategjia e transformimit realizohet duke përdorur bindjen rreth skemave të ndryshme të argumentimit ose *topoi* (Wodak et al 1999: 33-34). Skema të tilla

argumentimi që përfshijnë strategjinë e transformimit janë *topos të kërcënimit* dhe *topos të historisë si mësuese* (Wodak et al 1999: 33).

#### *Strategjitë e zbërthimit dhe shkatërrimit*

Strategjitë e zbërthimit dhe të shkatërrimit shërbejnë për të demitizuar ose për të shembur identitetet ekzistuese ose pjesë të këtyre identiteteve, megjithatë, shpesh nuk zëvendësojnë pjesët e identitetit të shpërbërë (Wodak et al 1999).

#### **Analiza e tekstit**

Përveç artikulimeve të shumta siç janë klasat, ideologjia, shtetet mike, arsimi dhe kultura do të shohim që edhe artikulli i historisë do të luajë një rol vendimtar në krijimin e identitetit. Historia do të jetë një instrument i rëndësishëm për të përforcuar edhe më shumë antagonizmin mes poleve. Shtimi i antagonizmit do të shtojë hegjemoninë dhe kjo situatë do t'i shërbejë përherë e më shumë legjitimitetit të pushtetit.

#### **Dy pole**

Bazuar në tekstin e shtypit të shkruar do të shohim se në shoqërinë shqiptare gjatë vitit 1945 do të formohen dy pole, të cilat do të ruajnë ekuivalencën brenda vetes dhe do të kundërshtojnë njëri-tjetrin. Poli i parë formohet nga fjalët: populli, partia, klasa punonjëse, fshatarësia dhe do të ketë pol kundërshtar çdo nëpunësi zyrtar të regjimit Zogist, pronarët e tokës të quajtur feudalë, çdo anëtarë të organizatave ose partive të tjera që gjatë Luftës Nacional Çlirimtare nuk luftuan përkrah Partisë Komuniste.

Të para në këndvështrimin e histories, i cili është edhe subjekti i këtij punimi, këto dy pole do të ngrihen përmes strategjisë së ndërtimit, ku polit të parë i atribuohen prezantime pozitive dhe të dytit negative. Gjithashtu gjatë analizës vërehet ndarja mes poleve me anë të përemrave. Përemri pronor shumës veta e parë “ne” i përket polit të parë dhe përemri pronor veta e tretë shumës “ata”, përfaqëson polin e dytë. Në editorialin e datës 28 nëntor të vitit 1950, do të shohim se si përmes strategjisë ndërtuese do të shprehen tiparet e polit “ata”.

*“... kur frutin e përpykëve dhe të gjakut të popullit e rrëmbyen bastardhë, spiunë e tradhëtarë të shitur, përfaqësonjës të feodalëve, të bejlerëve dhe të pasanikëve.”( Zëri i Popullit, 28.11.1950)*

Kjo strategji ndihmon në ndërtimin e imazhit negativ të “tjetrit” duke e ndarë atë përherë e më shumë nga “ne”. Gjithashtu gjatë analizës së tekstit do të hasim ndërtimin e koncepteve antagoniste siç janë “çlirues”/“

robërues” dhe “fitues”/ “humbës”. Në këtë rast, kemi një përdorim të drejtëpërdrejtë të histories, për të përcaktuar tiparet e secilit pol dhe për të vendosur qartë kufijtë ndarës mes tyre.

### *Forcimi i polit “ne”*

Gjatë krijimit të kampeve antagonistë përveç përcaktimit të elementeve të secilit kamp, është e rëndësishme edhe forcimi i kampeve përmes strategjive të ndryshme. Më poshtë do të rendisim strategji përmes të cilave forcohet poli “ne”.

#### *Asimilimi*

Mikro-strategji të strategjisë ndërtuese janë “asimilimi” dhe “disimilimi” (Wodak, 2000). Në tekstin e marrë në studim do të shohim një asimilim ideologjik me të gjitha vendet komuniste, siç janë Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia, Kina dhe vende të tjera, të cilat kanë të njëjtin sistem politik. Asimilimi del përmes fjalëve “popull mik”, “vëllezërit tanë”, “jemi një popull i madh”, “partia mëmë e Bashkimit Sovjetik”. Gjithashtu Bashkimi Sovjetik do të shihet si udhërrëfyesi ideologjik i Shqipërisë dhe i gjithë botës. Në vitet e para të ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste deri në vitet 1960, Bashkimit Sovjetik do t’i atribuohet edhe fitorja e 29 Nëntorit, këtë mund ta ilustrojmë si më poshtë;

*“Bashkimi Sovjetik dhe lufta e lavdishme e Ushtrisë Sovjetike e udhëhequr nga gjenia e Stalinit të madh ishte faktori kryesor dhe determinues i fitorjes së popullit t’onë.” (Zëri i Popullit, 29.11.1948)*

#### *Miq të fuqishëm*

Duke përmendur fakte dhe të dhëna historike, Bashkimi Sovjetik dhe Kina, do të shihen jo vetëm si shtete mike, por edhe si shtete shumë të mëdha në numër dhe të fuqishme në aspektin e politikëbërjes dhe strategjisë luftarake. Një strategji e tillë shërben për të prezantuar një tjetër aspekt të polit “ne”, i cili përveç cilësive të tjera është i fuqishëm. Të qenit i fuqishëm shërben në legjitimimin e pushtetit. Një shembull ilustrues për këtë sa thamë më sipër, është një pjesë e marrë nga një fjalim i Mehmet Shehut i mbajtur me 29 nëntor;

*“Miqësi e ngushtë vëllazërore dhe e përjetshme e lidh popullin tonë ,,,, me popullin 800 milionësh të Kinës së kuqe të Mao Ce Dunit.” (Zëri i Popullit, 28.11.1970)*

#### *Përdorimi i së kaluarës- Historia është me “ne”*

Megjithëse historia në më të shumtën e rasteve përdoret si një mjet për të parë përpara dhe kemi një ndarje të theksuar mes të kaluarës dhe të tashmes, ku e kaluara është problematike, do të shohim një përdorim të së kaluarës për të legjitimuar të tashmen. Figura e Haxhi Qamilit është një



element i cili përdoret për të bërë lidhje më të vjetra mes partisë dhe popullit. Në citimin e mëposhtëm;

*“Por fshatarësia shqiptare me trimëri të pashoqë, me Haxhi Qamilin në krye, më 1914, luftoi kundër feudalëve.”* (Zëri i Popullit, 28.11.1952)

Haxhi Qamili shihet si një personazh model, i cili vjen nga populli për të luftuar që atëherë borgjezinë. Haxhi Qamili personifikon popullin dhe me anë të tij ndërtohet një klasë antagoniste, që daton qysh prej viteve 1912, pas shpalljes së pavarësisë.

*28 nëntori një fitore e papërfunduar*

Ndonëse në kokat e artikujve të cilët flasin për ditën e 28 Nëntorit, do ta shohim këtë ditë, si të madhe dhe shumë të rëndësishme, për historinë e popullit shqiptar. 28 Nëntori mbetet një ditë fitoreje e papërfunduar. Përmes strategjisë të zbërthimit dita e 28 Nëntorit do të demitizohet pak duke i dhënë vlera më të mëdha datës 29 nëntor. Në shumë artikuj gjejmë që me datën 28 Nëntor flitet për datën 29 nëntor. Për shembull:

*“Populli ynë feston nesër me gëzim 29 Nëntorin...”* (Zëri i Popullit, 28.11.1959)

Një nënstrategji e strategjisë së justifikimit është viktimizimi. Duke justifikuar plotësisht luftën e popullit shqiptar për pavarësi e viktimizojmë popullin shqiptar, duke treguar që ai nuk mundi të arrinte fitoren e dëshiruar.

*“...me shpalljen e independencës populli ynë në të vërtetë nuk u çlirua...”* (Zëri i Popullit, 29.11.1951)

Sepse 28 Nëntori shihet si një,

*“Një etapë e parë që pati kurorëzimin e saj të plotë më 29 nëntor 1944, kur populli shqiptar i udhëhequr nga Partia Komuniste me shokun Enver Hoxha në krye...”* (Zëri i Popullit, 28.11.1965)

Kjo do të thotë poli “ne” forcohet duke rritur ekuivalencën brenda vetes, duke ngritur lart vlerat e elementëve përbërës të këtij polit, që në këtë rast është Partia Komuniste. Gjithashtu të parët e 28 Nëntorit si një fitore e papërfunduar dobëson polin “ata”, duke i quajtur “ata” shkaktarë të humbjes së kësaj fitoreje.

### **Forcimi i antagonizmit**

*Miqtë që behën armiq*

Përmes strategjisë së zbërthimit dhe shkatërrimit krijohen armiqtë e rinj, të cilët do t'i bashkëngjiten polit “ata”. Prishja e marrëdhënieve me shtetet mike, do të bëhet duke shembur identitetet e tyre ekzistuese përmes talljes dhe përçmimit. Gjithashtu do të përdoret strategjia e vazhdimësisë ku

do të shohim përherë e më shumë përdorimin e historisë në funksion të riprodhimit të identitetit specifik të polit “ne”, të cilit do t’i shtohet kërcënimi nga “ata”. Kërcënimet në këtë rast janë një tentativë ligjërimore që shërben për të ruajtur ekuivalencën brenda polit. Sepse kur “ne” do të ndihen të kërcënuar do të mblidhen më fort brenda vetes. Jugosllavët do të shihen si trockistë, Bashkimi Sovjetik do të shihet si revizionist, Kina do të shihet si bashkëpunëto e kapitalizmit. Zbërthimi do të ndodhë përmes termave “revizionistët modernë”, “kapitalistët”, “tradhtarë të marksizëm-leninizmi”, “të shiturit”. Elementi kryesor në këtë artikulum dhe emëruesi i përbashkët i zbërthimit do të jetë “devijimi nga marksizëm leninizmi”. Të gjitha këto shtete në periudha të ndryshme historike do të shihen si tradhtarë të ideologjisë. Gjatë kësaj periudhe do të dalë në pah gjithashtu edhe riprodhimi i identitetit të popullit përmes veçorive trim, liridashës dhe i pamposhtur. Duke iu referuar historisë ndryshe nga çfarë ndodh në vitet 1945, ku Bashkimi Sovjetik është arsyeja e fitores, shohim demitizimin e Bashkimit Sovjetik. Fitorja historike kundër fashizmit i atribuohet luftës së vetë popullit shqiptar. Hysni Kapo shprehet që populli shqiptar “*kreu revolucionin popullor pa qenë nevoja që në truallin shqiptar të vinte ushtria sovjetike.*” Me këtë citim shohim edhe strategjinë e legjitimitetit ku firmoset autoriteti i popullit, i cili është në një lidhje të vazhdueshme me partinë, sepse në të gjitha tekstet hasim togfjalëshin “uniteti parti-popull”. Kur ndodh prishja me miqësitë e vjetra, është e rëndësishme të përmendet se kjo gjë nuk ndodh me popujt e shteteve përkatëse, por vetëm me kastën udhëheqëse të tyre. Popujt mbesin gjithmonë miq. Kjo mund të jetë një strategji për të ruajtur idenë e sasisë në numër të polit “ne”.

Në vitin 1978, kur Shqipëria ka ndërprerë marrëdhëniet me të gjitha shtetet mike të asaj kohe, shohim një përforcim të polit “ne” përmes vetëreferencimit, ku çdo të mirë, fitore, sukses ia atribuojmë unitetit parti-popull, por gjithashtu dalin në pah edhe shqiptarët e tjerë jashtë trojeve shqiptare. Këtu kemi një përdorim të historisë për të kritikuar dhe përjashtuar të gjitha vendet deri atëherë mike. Sepse ata do të shihen si arsye e përçarjes së kufijve shqiptarë. Do të fillojnë të përmendet Kosova, Maqedonia, Mali i Zi. Në të njëjtën kohë përdorimi i popullit shqiptar në këto vende shërben për të rritur në numër kampin “ne”. Nga mesi i viteve 70-të do të hasim teste, si për shembull: “*28 Nëntorin e festojnë edhe shqiptarë të tjerë patriotë jashtë Shqipërisë, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi.*” (Zëri i Popullit, 28.11.1978)

#### *Atribuimi i suksesit*

Tekste të ngjashme me “... *kremtojnë me madhësi 29 Nëntorin, ditën e çlirimit, ditën më të madhe që ka parë ndonjëherë historia e vendit*

*t'onë gjatë shekujve*" ("Zëri i Popullit", 29.11.1949), do të jenë të pranishme në çdo kryeartikull ose editorial të datës 29 nëntor. Sepse data 29 nëntor do të shihet si data më e rëndësishme për historinë e popullit shqiptar. Poli "ata" do të mbesë jashtë historisë dhe poli "ne" do të fuqizohet përmes historisë.

*Data 29 nëntor brenda polit "ne"*

Kjo datë e rëndësishme shihet t'i përkasë vetëm polit "ne", dhe brenda polit "ne" kemi përsëri një ndarje hierarkike, ku Partia Komuniste pozicionohet si protagonistja kryesore e fitores. Ilustrimin e kësaj çfarë thamë e gjejmë tek citimi i mëposhtëm;

*"Partia jonë heroike, trashëgimtare e denjë e të gjitha traditave të lavdishme të popullit tonë, i bëri realitet me 29 nëntor 1944, idealet për të cilat luftuan patriotët shqiptarë ..."* (Zëri i Popullit, 28.11.1952)

*29 nëntori është revolucion-"ndarja mes dy botëve"*

29 nëntori nuk shihet si një fitore e thjeshtë, por në të njëjtën kohë si një revolucion shoqëror. Kjo datë historike merr emërtime të reja për të përforcuar fitoren, për të forcuar identitetin e polit "ne".

*"29 nëntori shënon në historinë tonë kufirin midis dy botëve, të asaj ku populli ish marrë tërë jetën nëpër këmbë nga 'të fuqishmit' e ku s'kish asnjë të drejtë dhe të asaj ku u ngrit në piedestalin e zotit të plotfuqishëm të fateve të tij."* ("Zëri i Popullit", 29.11.1964)

*Përdorimi i historisë për të krijuar imazhe të suksesit*

Ndonëse e kaluara e historisë shqiptare shihet si e zbehtë dhe e zymtë, ajo përdoret nga shtypi kur kampi "ne" kërkon të përforcojë imazhin e tij pozitiv. Ajo do të shihet në paragrafin e mëposhtëm edhe si trashëgimtare e rilindësve.

*"... Partia e Punës Shqiptare luan rol të rëndësishëm në lëvizjen komuniste ndërkombëtare- Partia është trashëgimtare e rilindasve."* ("Zëri i Popullit", 29.11.1959)

*29 nëntori historia e suksesit të unitetit Parti-popull*

Pas prishjes me Kinën do të fillojë periudha e izolimit, ku do të mbeten shumë pak miq që më shumë se realë janë miq ideologjik. Për të forcuar legjitimitetin e pushtetit, kësaj radhe historia do të shërbejë si mjet i drejtpërdrejtë në duart e politikëbërësve. Do të kemi prodhim të fakteve historike, përmes të cilave krijohet koncepti i vetëpërbushjes. Vetëpërbushja justifikon mungesën e të tjerëve. Teksti i mëposhtëm flet për një situatë ku kampi "ne", duhet të forcohet më shumë me elemente të brendshme.

“Askush s’na e dhuroi lirinë, por atë e fituam me gjak vetëm me forcat tona, pa qenë nevoja që në tokën shqiptare të na vinin për ndihmë direkte ushtritë e aleatëve të asaj kohe.” (“Zëri i Popullit”, 29.11.1979)

### **PËRFUNDIME:**

Për të ndërtuar identitetet media e shkruar përcakton fillimisht polet kundërshtare duke paraqitur elementet përkatëse të secilit pol, më pas ajo përdor strategjinë e forcimit të polit dhe më në fund ajo forcon antagonizmin mes poleve në mënyrë që të forcojë hegjemoninë e vetë sistemit. Në ndërtimin e identitetit të “njeriut të ri”, historia shërben për të treguar pozicionin e tij brenda kampit ku ai bën pjesë. Kampet janë krejtësisht të ndara dhe formimi i identitetit të tij do të bazohet në këtë ndarje të thellë. Historia do të luajë një rol të rëndësishëm, ku në një shoqëri pa klasa, do të vendosë njeriun e ri në klasën më të lartë hierarkike. Në një shoqëri ku luftohet burokratizimi, ku të gjithë janë të barabartë, “njeriu i ri” do të ndihet më i forti, më i suksesshmi dhe më fitimtari. Kjo përplasje mes ideologjisë së kohës dhe ndërtimit të identitetit përmes histories, do të hasë një përplasje tjetër, kur “njeriu i ri” do të ketë edhe një konkurrent tjetër të fortë brenda grupit të tij, partinë. Por pikërisht këto përplasje antagoniste brenda polit, do të ruajnë bashkekzistencën e polit “ne”. Identiteti i “njeriut të ri” qëndron mes të kaluarës problematike dhe të tashmes së suksesshme, duke punuar pandërprerë për një të ardhme të lavdishme.

### **REFERENCA:**

1. Bertrand (1997): Deontologjia e mediave, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë.
2. Chantal & Mouffe (1985): Hegemony & Socialist Strategy- Towards a radical democratic politics, Verso: London.
3. De Cillia, Reisigl & Wodak (1999): *The discursive construction of national identities*, In Discourse & Society, Vol. 10 (2).
4. Fuga (2010): Monolog, Dudaj, Tiranë.
5. Lloshi(1999): Stilisitika dhe Pragmatika, “Toena”, Tiranë.
6. Wodak et al (1999): *The Discursive Construction of National Identity*, Edinburgh University, Press, Edinburgh.

### **Anekse**

- Mesazhi i Kryetarit të qeverisë shokut Enver Hoxha drejtuar popullit shqiptar me rastin e 29 Nëntorit.(1948, Nëntor 29), “Zëri i Popullit”, f.1.
- Fjala e shokut Beqir Balluku. (1949, Nëntor 29), “Zëri i Popullit”, f. 2.
- Konferencë Solemne – Shefqet Peçi (anëtar i Komitetit Qendror të PPSH). (1951, Nëntor 29), “Zëri i Popullit”, f. 2.
- 40 –vjetori i shpalljes së pavarësisë. (1952, Nëntor 28), “Zëri i Popullit”, f. 1.
- 40 –vjetori i shpalljes së pavarësisë. (1952, Nëntor 28). “Zëri i popullit”, f.1.

- Fjala e shokut Beqir Balluku. (1956, Nëntor 29), “Zëri i Popullit”, f. 1.
- Fjalimi i shokut Mehmet Shehu. (1957, Nëntor 29), “Zëri i Popullit”, f. 3.
- Fjala e shokut Enver Hoxha. (1959, Nëntor 29), “Zëri i Popullit”, f. 2.
- Rrugë fitoresh. (1959, Nëntor 28), “Zëri i Popullit”, f. 1.
- Fjalimi i shokut Enver Hoxha. (1964, Nëntor 29), “Zëri i Popullit”, f. 3.
- Për beteja të reja, për fitore të reja në ndërtimin socialist. (1965, Nëntor 28), “Zëri i Popullit”, f. 1.
- Nëntori i kuq na frymëzon për fitore të reja. (1970, Nëntor 28). “Zëri i popullit”, f.
- Vepër e lavdishme historike që do të mbetet kurdoherë e paharruar. (1978, Nëntor 28), “Zëri i Popullit”, f. 1.
- Fjala e shokut Mehmet Shehu. (1979, Nëntor 28). “Zëri i Popullit”, f. 1.

### **Political discourse in communist Albania during national holidays**

#### ***SUMMARY***

To better understand today's political discourse we need to understand and analyze the yesterday's discourse. Nothing in a discourse is said by accident, and nothing happens by random. The language used in media has been analyzed through the critical and historical approach. Methodology used in this paper is Critical Discourse Analyses which is the theory and the method at the same time. Using critical discourse analyses the research was extended in the proper time and context. It was chosen the text that is produced in/by media because in the totalitarian systems media not only manufactures the discourse but also produces ideologies. Given the research questions; which are the elements that media uses to legitimate the power; it was aimed to create category of discourse. Antagonism was seen as one of the key elements where the legitimating of power is based on. National holidays are selected as key dates, because such as dates are important to spread the messages. The text chosen for study will rely on print media because the print media was one of the main tools that served for the construction of ideology, and the distribution of this ideology. Also the press included speeches during different events or gatherings.

***Keywords:*** *political discourse, media discourse, critical discourse analyses, antagonism*

David LUKA

**SHËNIME PËR NJË ARTIKULL\***

Duke lexuar “Buletinin e Shkencave Shoqërore” (nr. 63 të vitit 2013) të Universitetit të Shkodrës “L. Gurakuqi”, na tërhoqi vëmendjen artikulli me titull “Periudhat historike të shqipës”, shkruar nga prof. Xhevat Lloshi. Në okjelon, që e pasonte këtë shkrim, thuhej: “Një periodizim mbi baza bashkëkohore, në koherencë me gjuhët moderne të lëvruara të Europës Perëndimore.”

Për një studiues, që është marrë për një kohë të gjatë me këtë temë (të parashtruar nga Lloshi) e që ka botuar shumë e gjithashtu diskutuar e polemizuar shumë për çështjen në fjalë, të krijohej vetiu pyetja se çfarë do të sillte të re Xh. Lloshi, aq më tepër kur ky gjuhëtar i njohur, nuk qe marrë asnjëherë me historinë e gjuhës shqipe dhe në tërë veprimtarinë e vet shkencore nuk kishte shkruar qoftë edhe një rresht për këtë fushë të dijes.

Siç do ta trajtojmë me hollësi në vazhdim, me periodizimin e historisë së gjuhës shqipe, duke e bërë këtë objekt studimi të veçantë, janë marrë plot nëntë gjuhëtarë me emër, akademikë e profesorë të nderuar, të cilët kanë lënë gjurmë me ndihmesa të rëndësishme për gjuhën shqipe. E ajo që duhet shënuar këtu është puna që ata asnjëherë nuk e trajtojnë problemin e mësipërm, qoftë edhe nga larg, në ngjashmëri me njëri-tjetrin, përkundrazi, shtrojnë teza e kundërteza dhe përpiqen me argumente të kundërshtojnë njëri-tjetrin. Bile, tash së fundi, siç do ta trajtojmë në vazhdim, u shfaq edhe një tezë e re, që flet për pamundësinë e periodizimit të historisë së gjuhës shqipe.

Këndeje, para se të analizojmë artikullin, për të cilin po flasim, duhet doemos të sqarojmë paraprakisht çështjet në vazhdim:

1. Kur duhet të nisë periodizimi i historisë së gjuhës shqipe?
2. Mjetet me të cilat do të kryhet.
3. Koha e formimit të gjuhës shqipe.
4. Kush është marrë me periodizimin e historisë së gjuhës shqipe.
5. Kontestimet për:
  - pamundësinë e përcaktimit të kohës së formimit të gjuhës shqipe;
  - pamundësinë e periodizimit të historisë së gjuhës shqipe.

-----  
\* **Shënim:** Redaksia e revistës “Buletini shkencor” nr.64/2014, nuk ka ndërhyrë në opinionet personale të autorit të shkrimit.

\* \* \*

1. Sh. Demiraj është shprehur që "... periodizimi duhet të nisë qysh nga ajo periudhë, kur shqipja është formuar përfundimisht si një gjuhë cilësisht e ndryshme nga 'nëna' e saj ..." <sup>369</sup> Problemi, mendojmë ne, duhet trajtuar së pari në pikëpamje teorike, e më pastaj, duke u përcaktuar qartë e saktë termat që do të përdoren, të parashtrohet edhe metoda e punës që do të ndiqet në paraqitjen e argumenteve.

2. Sh. Demiraj e vendos studimin e kohës së formimit të gjuhës shqipe mbi të dhëna të strukturës së saj gramatikore. Ai mendon se "Për sqarimin e kësaj çështjeje një ndihmë të drejtpërdrejtë nuk mund të japin shkencat e tjera shoqërore, si arkeologjia dhe historia ..." <sup>370</sup> Autori i mësipërm, për të përcaktuar kohën e formimit të gjuhës shqipe nga "nëna" e saj ilirishtja, merr në konsideratë me përparësi "elementet e reja" (= dukuri gjuhësore që nuk ndeshen në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane dhe që duken qartë se janë zhvillim i brendshëm i shqipes) dhe "elementet e trashëguara" në strukturën gramatikore të shqipes, duke i vështruar këto si pjesë përbërëse të një njësie të vetme.

Në artikullin në fjalë Sh. Demiraj do të vendosë kohën e formimit të gjuhës shqipe "gjatë periudhës midis fazës së fundit të ndikimit latin dhe dyndjes së sllavëve ..." <sup>371</sup>

Autori i sipërm e rimerr problemin e kohës së formimit të gjuhës shqipe edhe në veprën e tij madhore *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* <sup>372</sup>, por tani do ta vështrijë problemin më gjerë e më thellë e duke saktësuar çështjet me dorë më të sigurt. Autori nuk niset nga konsiderata me karakter të përgjithshëm, por, pasi e shtron problemin teorikisht, ndalet në analizën e atyre dukurive të strukturës gramatikore që u bënë shkak për formimin e gjuhës shqipe, duke u munduar të përcaktojë në tërësinë e tyre edhe kohën e formimit të saj. E megjithëse këto dukuri i ndan metodikisht nga njëra-tjetra, ai gjithsesi i sheh të lidhura bashkë, në funksion të njëra-tjetrës dhe në zhvillimin e tyre të pandalshëm gjatë kohëve. Merita e autorit qëndron se ai përpiqet ta zgjidhë problemin jo me arsytetime të karakterit historik e me marrëdhënie probabiliteti, por me argumente gjuhësore, kryesisht të strukturës morfologjike, që përbëjnë themelin e një gjuhe. Për këtë punë autorit i është dashur të kalojë vështirësi të mëdha, veçanërisht për të

<sup>369</sup> Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 208.

<sup>370</sup> Sh. Demiraj *Koha SF 3*, 1982, f. 27.

<sup>371</sup> Po aty, 33.

<sup>372</sup> Sh. Demiraj *Gramatikë 44 v; Gjuha shqipe 197 v*.

përcaktuar marrëdhëniet e prejardhjes midis ilirishtes e shqipes, sepse dihet që nga struktura gjuhësore e ilirishtes dimë shumë pak, për të mos thënë asgjë. Këto marrëdhënie, që shprehen në takimet e pjeshme ndërmjet shqipes dhe ilirishtes në ato tipare që janë dalluese kryesisht e vetëm ndërmjet tyre, mund të bëjnë pjesë në gramatikën historike të shqipes vetëm në qoftë se pranohet përfundimisht prejardhja e shqipes nga ilirishtja. Sh. Demiraj problemin e prejardhjes së shqipes nga ilirishtja e konsideron të zgjidhur.<sup>373</sup>

Besim Bokshi periodizimin e historisë së gjuhës shqipe e kupton si periodizim i ndryshimeve morfologjike të shqipes, duke botuar për këtë një libër të tërë.<sup>374</sup>

3. Për kohën e formimit të gjuhës shqipe ka dy mendime. I pari i Sh. Demirajt: “Gjatë periudhës midis fazës së fundit të sundimit romak dhe të dyndjes së sllavëve, në gjuhën e banorëve të këtyre brigjeve lindore të Adriatikut dhe të Jonit janë përfutur edhe mjaft procese të tjera gjuhësore që bënë të mundur formimin e gjuhës shqipe. Pra, gjatë asaj periudhe, si rrjedhim i evolucionit të shkallëshkallshëm të njërës a të disa dialekteve të ilirishtes, që flitej në këto troje, erdhi e u formua gjuha shqipe, e cila në një fazë më të hershme njihej me emrin gjuhë *e arbëneshe* a *e arbëreshe*. Ky evolucion i shkallëshkallshëm, pas gjithë gjasash, duhet të jetë kryer jo më vonë se fundi i shek. VI të erës sonë. Dhe atëherë fillon edhe historia e mirëfilltë e gjuhës shqipe.”<sup>375</sup>

I dyti, i D. Lukës: “Shqipja u formua si gjuhë ‘bijë’ nga ‘nëna’ e saj ilirishtja në të njëjtat treva në shek. I-IV të erës sonë. Gjatë kësaj periudhe ajo përvijoi tipare gjuhësore, duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e nënës së saj ilirishte, por duke formuar në të njëjtën kohë edhe tipare të reja që e bënë të dallohet nga ajo. Kushtet historike të asaj kohe (pushtimi romak e në vazhdim dyndjet barbare) e përshpejtuan këtë formim. Në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj.”<sup>376</sup>

<sup>373</sup> Sh. Demiraj *Koha* 28, sh. 1.

<sup>374</sup> Besim Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010.

<sup>375</sup> Sh. Demiraj *Gjuha shqipe* 203. Këtë mendim ai e ka dhënë për herë të parë në rev. “Studime filologjike”, nr. 3, 1982 e më pas në veprën e vet madhore *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 44 v.

<sup>376</sup> D. Luka, *Rreth problemit të kohës së formimit të gjuhës shqipe*, në vëllimin “Studime gjuhësore V”, Shkodër, 1999, f. 176. (Khs. edhe SF 4, 1988, f. 147).



4. Për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe janë shprehur H. Pedersen<sup>377</sup>, E. Çabej<sup>378</sup>, S. Riza<sup>379</sup>, A. Desnickaja<sup>380</sup>, B. Bokshi<sup>381</sup>, Sh. Demiraj<sup>382</sup>, Gert Klingenschmid<sup>383</sup>, David Luka<sup>384</sup> e, së fundi, S. Mansaku.<sup>385</sup>

Në analizën e përpjekjeve të autorëve të mësipërm (pa Demirajn), ne vazhdojmë të mbetemi me mendimin e Demirajt se ata "... ose nuk janë mbështetur kryesisht apo sa duhet në kritere gjuhësore, ose nuk kanë arritur të argumentojnë bindshëm periodizimin e propozuar".<sup>386</sup>

Për Pedersenin, Çabejn e Rizën mund të themi se ata nuk e kanë bërë objekt studimi periodizimin e gjuhës shqipe. Pedersenin flet shkarazi për "periudhën II" e "periudhën III" të shqipes vetëm kur do të vendosë në kohë disa dukuri gjuhësore, por pa dhënë shpjegime të mëtejme.

E. Çabej "periodizimin" e përdor kryesisht si njësi metodike, që i shërben për të vendosur lëndën e parashtruar ndër kapitujt përkatës. Sipas tij kemi "periodën prehistorike" (nga "shqipja si gjuhë indoevropiane" deri te "huazimet"); "periodën historike përpara shkrimit" (nga "huazimet greke" deri te "shqipja gjuhë ballkanike"); "perioda e re, që kurse shkruhet gjuha."<sup>387</sup> Dhe asnjë hollësi tjetër.

S. Riza jep vetëm drejtime (përkat. "kritere") të përgjithshme për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe (khs. "... poshtë-lart historia e

<sup>377</sup> *Die Gutturale im Albanesischen*, KZ 36 (1900), f. 340.

<sup>378</sup> *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetikë historike*, "Studime gjuhësore" III, Prishtinë, 1976, f. 9 v.

<sup>379</sup> *Emrat në shqipe. Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit*, Tiranë, 1965, f. 7.

<sup>380</sup> Реконструкция элементов древнеалбанского языка и общепалканские лингвистические проблемы, Москва 1966, f. 8. Shiko edhe *Zur Erforschung der älteren Stufen des Albanischen*, në "Akten der internationalen albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Univ. -Prof. Dr. N. Jokl", Innsbruck, 1977, 213 v.

<sup>381</sup> *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980.

<sup>382</sup> *Gjuha shqipe* 208 v.

<sup>383</sup> Të botuar te Jens Rasmussen (Hg); *In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 1994 (f. 221-233).

<sup>384</sup> D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, në vëll. "Studime për historinë e gjuhës shqipe" (Vepër e zgjedhur), botim i QSA, Tiranë, 2010.

<sup>385</sup> S. Mansaku, *Periodizimi i historisë së gjuhës shqipe dhe pikëpamja e prof. Selman Rizës për të*, SF 1-2, 2000.

<sup>386</sup> *Gjuha shqipe* 207 v.

<sup>387</sup> SGJ III 9 v. Në tekst periodat janë: "A. Perioda prehistorike"; "B. Marrëdhëniet e shqipes në periodën e saj historike"; "C. Shqipja e re (e sotme)".

gjuhës s' onë duhet periodizuar paralelisht me historinë e popullit t' onë<sup>388</sup>), pa dhënë argumente (kryesisht gjuhësore) për këtë problem.

Të tre autorët e sipërm, së bashku edhe me Desnickajan, për të cilën do të flasim në vazhdim, kanë konceptin e vet për *evolucionin* e gjuhës shqipe. Ata e kuptojnë këtë zhvillim në mënyrë lineare, me shtesa e me bjerrje, por për asnjë çast me *ndërrime cilësore*, të shkaktuara nga tërësia e *ndërrimeve sasiore* në proces. Kjo shprehet qartë te Desnickaja, që e periodizon historinë e gjuhës shqipe në katër etapa thjesht kronologjike: 1. *protoshqipja* a *shqipja e lashtë* (që nis nga veçimi i shqipes prej trungut indoevropian e deri te takimet e para me latinishten); 2. *shqipja e vjetër* (mijëvjeçari i parë pas Krishtit); 3. *shqipja e mesme* (gjysma e mijëvjeçarit të dytë pas Krishtit); 4. *shqipja e re* (shek. XVI-XVII e shek. XIX deri më sot).

Këtij periodizimi mund t'i bëhen dy vërejtje thelbësore. Së pari, mungesa e argumentimit gjuhësor, fakt i vënë re së pari nga Sh. Demiraj. Së dyti, mijëvjeçari i parë, ku autorja vendos *shqipen e vjetër*, ka dy pamje, që nuk mund të përfshihen në një periudhë të vetme as historikisht dhe as gjuhësisht.

B. Bokshi përpiqet ta periodizojë historinë e gjuhës shqipe mbi bazën e rrugës së zhvillimit të temave emërore dhe të sistemit rasor të gjuhës shqipe. Përpjekja e Bokshit paraqet interes, sepse autori e mbështet këtë çështje në kritere gjuhësore. Po ndërkaq identifikimi i tyre është parë mjaft ngusht. Së pari, periodizimi që autori i bën sistemit të rasave dhe zhvillimit të temave emërore është gjithsesi subjektiv, ai ende s'ka zënë vend e nuk është bërë pronë e dijes së sotme gjuhësore. Së dyti, koncepti i zhvillimit të gjuhës është më i gjerë nga ç'paraqitet te Bokshi; aty duhen përcaktuar qartë shkaqet dhe pasojat e tyre më në thellësi e më të argumentuara historikisht. Në një gjuhë si shqipja, e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, duhet ecur me hapa tepër të matura; dukuritë gjuhësore të supozuara apo të rindërtuara duhet të përshkohen nga ideja e sistemit. Diakronia duhet konceptuar edhe si tërësi prerjesh sinkronike dhe jo vetëm si studim i dukurive të veçuara.

Sh.Demiraj është i pari që në bazën e periodizimit vë domosdoshmërisht "kriteret thjesht gjuhësore".<sup>389</sup> Fillimisht ai mendon për një ndarje të madhe (më tepër metodike): në prehistori dhe në histori.

<sup>388</sup> *Studime albanistike*, Prishtinë, 1979, f. 7. Ndarja e historisë së gjuhës shqipe në tri periudha (lashtësia, mesjeta, kohët e reja) bëhet sipas një kriteri, që Riza e quan "konvencional". Khs. edhe mendimin e dhënë për këtë problem nga S. Mansaku, SF 1-2, 2000, f. 120 v.

<sup>389</sup> *Gjuha shqipe* 208.

Historinë e ndan në katër periudha. *Periudha e parë* (sipas Demirajt) “... zgjat qysh nga koha e formimit të shqipes e deri në ndalimin e rotacizmit d. m. th. deri aty nga shekujt VII-VIII të erës së re.”<sup>390</sup> Ky kufizim, sipas nesh, mbetet i papërcaktuar sa e si duhet. Së pari, nuk thuhet qartë se kur pikërisht u formua gjuha shqipe, sepse, siç e kemi trajtuar më lart, për këtë problem ka mendime jo të njësuara. Së dyti, kufiri tjetër, ndalimi i rotacizmit (shek. VII-VIII), është tepër i diskutueshëm. Krahas pikëpamjeve të shprehura për dukurinë e rotacizmit të Meyer-Lübkes (miratuar edhe nga Sh. Demiraj) e të Joklit (miratuar edhe nga Çabej e Luka),<sup>391</sup> kemi tash së fundi kronologjinë e B. Jansonit që rotacizmi ngjan të ketë zënë fill nga viti 800 dhe të ketë përfunduar aty nga viti 1000 i erës sonë.<sup>392</sup> Kënde, kufijtë e periudhës së parë (*shqipja e vjetër*), të vendosura nga Demiraj, mbeten sërish problematikë e tërësisht subjektivë. Dukuritë gjuhësore, që sipas Demirajt përcaktojnë periudhën e dytë (shek. VIII-XV), janë vetëm hamendje, sepse nuk kemi asnjë bazë, as të shkruar e as të ndonjë natyre tjetër, për t’i vërtetuar në mënyrë shkencore të dokumentuar. Dy periudhat, që pasojnë, mund të pranohen si të tilla, sepse tanimë gjithçka paraqitet e dokumentuar.

Gert Klingenschmid në studimin e vet “*Das Albanische als Gliedder Indogermanischen Sprachfamilie*”, jep këtë ndarje: faza e parë emërtohet *Voruralbanisch* (paralashshqipja), koha romake. Faza e dytë *Uralbanisch* (lashtoshqipja). Më pastaj vijnë *Shqipja e vjetër* dhe *Shqipja e re*.<sup>393</sup> Fazat e dhëna ai mundohet t’i argumentojë kryesisht me mjete gjuhësore, gjithsesi të strukturës historike të gjuhës shqipe.

D. Luka do ta trajtojë periodizimin e historisë së gjuhës shqipe disa herë, duke përfunduar me studimin e gjatë, titulluar “*Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*”, botuar në vëllimin D. Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*<sup>394</sup>, Tiranë, 2010.

<sup>390</sup> Po aty, 209.

<sup>391</sup> Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, 242 v.

<sup>392</sup> B. Janson, *Etymologische und chronologische Untersuchungen zu den Bedingungen des Rhotazismus im Albanischen unter Berücksichtigung der griech und lat. Lehnwörter*, në “*Studien zur klassischen Philologie*”, v. 21, Frankfurt-am-Main, 1986. f. 211.

<sup>393</sup> Gert Klingenschmid, *Das Albanische als Gliedder Indogermanischen Sprachfamilie*, po aty.

<sup>394</sup> Khs. D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, “*Studime gjuhësore*” VII, Shkodër, 2002. D. Luka, *Sprovë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe*, “*Studime filologjike*”, nr. 1-2, 2010. D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, në vëll. “*Studime për historinë e gjuhës shqipe*” (Vepër e zgjedhur), botim i QSA, Tiranë, 2010.

D. Luka, përcakton tri periudha të mëdha, *prehistoria, koha e formimit, historia*.

*Prehistoria* i përket gjithsesi nënës së shqipes. Në këtë periudhë dukuritë dalin të përbashkëta me gjuhët e tjera simotra indoevropiane me të cilat grupohet.

*Koha e formimit* (shek. I-IV). Tipari i përgjithshëm: ndërrimet janë të veçanta e vetëm për gjuhën e re që po formohet në të njëjtat treva nga nëna e saj ilirishtja.

*Historia* nis në shek. V. Idioma e re tani mund të emërtohet *shqipja e vjetër*. Që këtu nis periodizimi i historisë së gjuhës shqipe.<sup>395</sup>

S. Mansaku shprehet se "... me mjete gjuhësore nuk mund të vendosen kufij, jo vetëm sepse mungojnë dëshmitë e shkruara, por edhe sepse zhvillimet gjuhësore janë të shkallëshkallshme, të pandërprera dhe të papërceptueshme në një çast të dhënë."<sup>396</sup>

5. Gjatë kohës që po punonim për të hartuar një kumtesë me rastin e 100-vjetorit të lindjes së prof. Selman Rizës, ndeshem në një shprehje që na tërhoqi menjëherë vëmendjen. Aty thuhej: "... me mjete gjuhësore nuk mund të vendosen kufij, jo vetëm sepse mungojnë dëshmitë e shkruara, por edhe sepse zhvillimet gjuhësore janë të shkallëshkallshme, të pandërprera dhe të papërceptueshme në një çast të dhënë."<sup>397</sup>

Vetëkuptohet, përfundimi i sipërm nuk do të më tërhiqte vëmendjen, nëse ai nuk do të lidhej me emrin e prof. Rizës. Sepse të krijohej përshtypja që autori i këtij përfundimi po përforconte e mbështeste pikërisht edhe mendimin e prof. Rizës për problemin e periodizimit të gjuhës shqipe, aq më tepër kur ky citonte Rizën: "Rrjedhimisht edhe periodizimi *kryesor* i historisë së një populli duhet poshtë-lart t'i përshtatet, periodizimit të historisë së vetë këtij populli ose e thënë disi ndryshe, historia e gjuhës sonë duhet periodizuar paralelisht me historinë e popullit."<sup>398</sup>

Fragmenti i mësipërm ndërkaq nuk përkon me atë të S. Rizës. Khs. "Rrjedhimisht edhe periodizimi *kryesor* i historisë së gjuhës së një populli

<sup>395</sup> D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, në vëllimin "Studime gjuhësore VII", Shkodër, 2002, f. 88.

<sup>396</sup> S. Mansaku, *Periodizimi ...*, po aty, f. 119. Khs. edhe kumtesën me titull: "*Disa çështje të studimit diakronik të gjuhës shqipe; rreth problemit të periodizimit të historisë së saj*", mbajtur në konferencën shkencore "*Çështje të diakronisë së shqipes*", Prishtinë, 2009.

<sup>397</sup> S. Mansaku, *Periodizimi i historisë së gjuhës shqipe dhe pikëpamja e prof. Selman Rizës për të*, SF 1-2, 2000, f. 119.

<sup>398</sup> Po aty, f. 121.

duhet poshtë-lart t'i përshtatet periodizimit të historisë së vetë këtij populli".<sup>399</sup>

Nga krahasimi i dy fragmenteve vëmë re se të parit i mungon pikërisht thelbi i problemit, sepse këtu flitet për "historinë e një populli", ndërsa te Riza për "historinë e gjuhës së një populli". Është harruar pra fjala "e gjuhës", pa të cilën gjithçka do të devijonte nga thelbi i çështjes. Besojmë se harresa e mësipërme e fjalës "e gjuhës" duhet të jetë *lapsus*, përndryshe diskutimi i mëtejshëm do të komprometohej tërësisht.

Në vazhdim të studimit, Riza do ta përsërisë edhe dy herë pohimin e tij "se poshtë-lart historia e gjuhës s'onë duhet periodizuar paralelisht me historinë e popullit t'onë"<sup>400</sup>; gjithashtu "... historia e gjuhës shqipe si gjuhë e folur poshtë-lart duhet periodizuar simbas periodizimit të historisë së popullit shqiptar."<sup>401</sup>

\* \* \*

Pas këtij parashtrimi, mbeten për t'u sqaruar dy probleme. Së pari, a mund të përceptohet një dukuri gjuhësore në një çast të dhënë të zhvillimit të saj? Sepse, në qoftë se pranohet që "... me mjete gjuhësore nuk mund të vendosen kufij, jo vetëm sepse mungojnë dëshmitë e shkruara, por edhe sepse zhvillimet gjuhësore janë të shkallëshkallshme, të pandërprera dhe të papërceptueshme në një çast të dhënë", atëherë vetvetiu çdo përpjekje për të përcaktuar kohën e formimit të gjuhës shqipe, së bashku me përpjekjen për ta periodizuar historinë e saj, do të paraqiteshin të pamundura.

Problemi tani do të kërkonte fillimisht një trajtim filozofik, duke u ndalur për të analizuar se si duhet konceptuar "procesi i njohjes" në lidhje me një dukuri gjuhësore (përkth. me gjuhën në përgjithësi). Ndërkaq duhet sqaruar se në procesin e njohjes së një dukurie gjuhësore, a mund të bëhen krahasime, qoftë edhe nga larg, me dukuritë e zhvillimit të dukurive të natyrës dhe, më pastaj, a mund të zbatohen edhe për zhvillimet gjuhësore në përgjithësi ligjet e dialektikës.

Së pari këtu duhet bërë një ndarje e saktë ndërmjet dukurive gjuhësore në zhvillimin e natyrshëm të tyre gjatë kohëve, me politikën gjuhësore që ndiqet për ta ndihmuar a deformuar një zhvillim të natyrshëm të saj.

---

<sup>399</sup> S. Riza, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009, f. 228.

<sup>400</sup> S. Riza, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009, f. 230.

<sup>401</sup> S. Riza, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009, f. 340.

Gjuha e folur zakonisht paraqet një idiomë që mund të krahasohet me dukuritë e natyrës, sepse të dyja lindin, zhvillohen, arrijnë pjekurinë e vet e, më pastaj, bien, plaken e vdesin. Natyrisht këtu nuk mund të bëhen krahasime për periudha kohore, sa zgjat njëra apo tjetra. Gjithashtu për mundësinë apo pamundësinë tonë për t'i njohur ato në zhvillimin e tyre dialektik. Sepse këto procese zakonisht zhvillohen jashtë ndërgjegjes sonë. Njeriu mund të ndikojë për t'i shpejtuar apo ngadalësuar këto zhvillime, por jo për t'i ndalur. Aftësia jonë për t'i përceptuar këto dukuri në zhvillim varet nga shkalla e njohjes. Njohja e një dukurie gjuhësore në proces, përkat. njohja e tërë këtyre dukurive, që përbëjnë në tërësinë e tyre vetë gjuhën e folur gjatë shekujve, varet nga *studimet* e thelluara të kryera për të. Në qoftë se *studimet* mungojnë, atëherë është e vetëkuptueshme që dukuria nuk përceptohet dot.

Këndeje duhet ndarë çështja: ne nuk mund ta periodizojmë historinë e gjuhës shqipe sepse nuk e njohim, apo sepse një veprim i tillë paraqitet shkencërisht i pamundur.

Tashmë dihet që procesi i njohjes është psikologjik.

Mirëpo, në rastin e shqipes kjo njohje pengohet që në fazën e përceptimit të drejtpërdrejtë të saj, sepse mungon objekti “një tekst (i hershëm), i shkruar a i folur i saj”. Dihet tashmë që kjo punë për shqipen mund të nisë shkencërisht vetëm nga shek. XVI me “Mesharin” e Buzukut. Këtë fakt ka pasur parasysh, ngjan, prof. Riza kur e nis arsyetimin e vet me “*poshtë-lart*”. Për një dijetar si prof. Riza shprehja “*poshtë-lart*” do të thotë “mungesë argumentimi”, mungesë faktesh për të nisur shkallën e njohjes. Të mos harrojmë se shkrimi “Simbas cilëve kritere duhet periodizuar historia e gjuhës shqipe” është botuar në vitin 1965. Që prej asaj kohe e deri më sot kanë kaluar plot 49 vjet. Gjatë kësaj kohe janë shtuar në mënyrë të ndjeshme studimet e monografitë për historinë e gjuhës shqipe në të gjitha nënsistemet e saj, e veçanërisht në strukturën e saj, e cila përbën themelin e një gjuhe.

Gjuha shqipe vërtet është e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, por ajo paraqet një përparësi në njohjen e historisë së gjuhës së vet para Buzukut. Këto janë burimet e tërthorta, ku vendin kryesor e zënë huazimet nga gjuhët e tjera. Krahasimi i këtyre huazimeve në momentin që kanë hyrë në gjuhën shqipe, pra i kanë shkëputur lidhjet me gjuhën dhënëse, me ndryshimet që kanë pësuar këto në gjuhën marrëse (përkat. me gjuhën shqipe), ndjekja e këtyre ndryshimeve tani në pajtim me ligjet e gjuhës shqipe, na jep dorë të përcaktojmë me siguri shumë kufij, që sjellin fakte të reja për njohjen e zhvillimit në kohë të dukurive të ndryshme gjuhësore, duke nisur tani edhe nga “përceptimi” direkt i tyre.

Për të argumentuar në vija të trasha sa thamë më lart, mjafton të përmendim se disa kufij mund të vendosen pa frikë se mund të jemi të pasaktë. Ardhja e sllavëve në Shqipëri p. sh. përbën një kufi që sot njihet e pranohet përgjithësisht nga dija e sotme gjuhësore. Kundër mund të jetë vetëm ndonjë dijetar që ka në themel të studimit të tij paragjykimet nacionale.

Një kufi i saktë dhe i përcaktuar mirë nga ana gjuhësore është edhe emërtimi i terminologjisë fetare kristiane (katolike) në gjuhën shqipe, i cili paraqitet krejtësisht latin (në krahasim p. sh. me rumanishten, ku kjo terminologji është kryesisht sllave). Në vija të trasha ky kufi mund të vendoset pas shek. I (pas Krishtit) deri në fund të shek. V (pas Krishtit). Tani në qoftë se marrim në konsideratë faktin që organizimi i rregullt kishtar në Shqipëri duhet të ketë nisur së paku nga fundi i shek. II a fillimi i shek. III, atëherë koha e vendosjes së kufijve të këtij fenomeni, saktësohet edhe më tej. Më këtë periudhë janë të lidhura një numër i madh dukurish gjuhësore në proces, që datojnë në shek. I-IV, të cilat ne i kemi quajtur “shtresa e dytë”<sup>402</sup> e huazimeve latine të shqipes, sepse gjejnë pasqyrim me shembuj të qartë pikërisht te emrat që lidhen me këtë terminologji kishtar.

Po kështu mund të flasim për periudha të mëvonshme, siç është rasti për përcaktimin kohor të huazimeve turke në gjuhën shqipe, të cilat nuk mund të jenë më të hershme se fundi i shek. XIV e fillimi i shek. XV.

Natyrisht përcaktimet kohore të deritanishme të parashtruara më lart, janë gjithsesi të lidhura në mënyra të tërthorta edhe me periudha historike. Ngjan këtë ka parasysh edhe prof. Riza kur barazon kufijtë e historisë së Shqipërisë me ato të historisë së gjuhës, po gjithsesi “*poshtë-lart*”, pra në copa të mëdha, pa u futur më tej në analizën e drejtpërdrejtë të dukurive gjuhësore në zhvillimin e tyre. Prandaj ai e quan periodizimin e bërë prej tij “konvencional”. Mirëpo, *konvencioni*, mbetet gjithnjë marrëveshje subjektive. Ai gjithnjë do të përdoret edhe në të ardhmen për të përcaktuar periudha të gjata kohore, të cilat ose nuk njihen fare gjuhësisht, ose njihen fare pak. Termi *prehistori* p. sh. do të përdoret gjithnjë edhe në të ardhmen duke mbetur i papërcaktuar saktësisht në kohë. Po kështu termi tjetër *protoshqipja* (përkth. parashqipja), së cilës nuk i dihet as fillimi e as mbarimi. Kështu duhen kuptuar tani edhe termat e përdorura nga S. Riza: *lashtësi, mesjeta, kohët e reja*.

Ne tani e kemi fjalën për mundësinë e vendosjes së kufijve kohorë të dukurive gjuhësore të mirëfillta. Pra, me dukuri të strukturës së gjuhës

---

<sup>402</sup> D. Luka, *Rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore” V, Shkodër, 1999, f. 167 v.

shqipe e, kryesisht me ato të nënsistemeve të saj, të cilat nuk kanë asnjë lidhje shkajkore me historinë e popullit tonë.

Pra, puna e parë që duhet kryer është përcaktimi i kohës së formimit të gjuhës sonë. Për këtë deri tani ka dy mendime, ai i prof. Sh. Demirajt<sup>403</sup>, dhe i D. Lukës.<sup>404</sup>

Për përcaktimet kohore të mësipërme, S. Mansaku ka shkruar: "... përcaktimi i kohës së formimit të gjuhës shqipe si një gjuhë e veçantë e dalë nga ilirishtja ... është një problem i vështirë dhe i pazgjidhur përfundimisht. Kudo që të vihet ky kufi, në shek. IV siç mendojnë disa (ky "*disa*" është D. Luka, të cilit, nuk di përse autori nuk ia përmend emrin, shën. im), apo në shek. VI të erës sonë, siç është përpjekur të vërtetojë me më shumë argumente Sh. Demiraj, ai do të jetë më tepër një kufi historik konvencional, sesa një kufi i mirëfilltë gjuhësor ..."<sup>405</sup>

Pavarësisht nga kundërshtimi i sipërm, përderisa nuk kemi përcaktim tjetër rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe, e përderisa ata nuk janë larg në kohë, ne do t'i marrim në konsideratë, duke u përpjekur të argumentojmë më tej me fakte gjuhësore kohën e formimit të gjuhës shqipe, nga nis edhe periodizimi i saj.

Në vështrimin dialektik *e reja* (e përftuar *cilësisht* nga tërësia e shndërrimeve sasiore në një moment të caktuar) i shkëput lidhjet me *të vjetrën* nga e cila ka zënë fill. Ajo tani e *mohon* atë, duke u zhvilluar mbi të tjera ligjësi. Një proces i tillë, krejt i qartë e i shpjegueshëm për *botën materiale*, bëhet jo krejt i qartë kur zbatohet në dukuritë e proceseve shoqërore. Bile te *gjuha* të krijohet bindja që ai zbatohet vetëm konvencionalisht. Gjuha vendoset dhe analizohet mbi bazën e nënsistemeve (struktura fonologjike, gramatikore, leksikore dhe fjalëformuese). Në këtë linjë e vetëm kështu mund të dallohen ndërrimet e mundshme sasiore në zhvillim, të cilat nuk mund të çojnë menjëherë në një hop cilësor. Dhe kur ndodh një fakt i tillë, atëherë kemi ndërrim gjuhe. Ky *ndërrim gjuhe* tani duhet kuptuar si *përfundim* i procesit. Në këtë situatë si mbështetje të proceseve gjuhësore, mund të merren në analizë edhe faktorët jashtëgjuhësorë, që në periudha të ndryshme mund të veprojnë fuqishëm mbi një gjuhë të caktuar, në njërën anë, si edhe nënshtresat, anështresat dhe mbishtresat, që historikisht mund të jenë të pranishme në evolucionin e një gjuhe.

<sup>403</sup> Sh. Demiraj, *Gramatikë* 56 "... gjatë periudhës midis fazës së fundit të sundimit romak dhe dyndjes së sllavëve ...", dmth nga shek. IV deri në shek. VI.

<sup>404</sup> D. Luka, *Rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe*, në rev. "Studime filologjike", nr. 4, 1988, f. 147.

<sup>405</sup> S. Mansaku, *Periodizimi*, po aty, f. 119.



Procesi i formimit të gjuhës shqipe na ngjan që nuk mund e nuk duhet të krahasohet me procesin e shndërrimit të shkallëshkallshëm të latinishtes vulgare në gjuhët e njohura romane, siç janë italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, portugalishtja, rumanishtja etj.<sup>406</sup> Te gjuhët e mësipërme kemi vërtet një *latinishte nënë* (përkat. *latinishte vulgare*), por që vendoset në krahina të ndryshme (të largëta nga njëra-tjetra), që flitet nga *veteranë* (të cilët nuk e kanë gjuhë amtare) dhe që shpesh gjen një nënshtresë jolatine, e cila gjithsesi vepron mbi *gjuhën e re* në formim e sipër (tani me nënsisteme të reja, të ndryshme nga latinishtja klasike).

Në qoftë se pranojmë që gjuha shqipe "... është formuar në përgjithësi në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor gjatë kohëve"<sup>407</sup> dhe se kjo gjuhë shqipe është "rrjedhim i evolucionit të shkallëshkallshëm të njërit a të disa dialekteve të ilirishtes"<sup>408</sup>, atëherë duhet pohuar se "... ajo përvijoi tiparet gjuhësore duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e *nënës* së saj ilirishte, por duke formuar në të njëjtën kohë edhe tipare të reja që e bënë të dallohej nga ..."<sup>409</sup>

Këtë formim e përshpejtuan edhe kushtet historike të asaj kohe si pushtimi romak e në vazhdim dyndjet barbare. Por ajo që i dha shkas këtij përshpejtimi që vendosja e kristianizmit edhe ndër trevat ilire të asaj kohe. Besimi i ri do të sillte edhe një mënyrë të re të menduarit, një kishë unike me terminologji krejt latine, një identitet të vendosur edhe mbi bazën e këtij besimi. Duke shtuar këtu edhe tiparet e reja në të gjitha nënsistemet e saj (për të cilat është folur në shkrimet e cituara të Demirajt e të Lukës), mund të themi se në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj.

Ne mendojmë se procesi i ngulitjes së theksit në një rrokje të caktuar të temës gjatë fleksionit është një ndër tiparet kryesore që u bënë shkak për formimin e gjuhës shqipe. Duke e lidhur këtë proces me metafoninë dhe me dukuritë e tjera që përbëjnë një ndryshim cilësor në tipin e përgjithshëm indoevropian, vendosja e tyre në kohë kap përafërsisht shek. I-IV të erës sonë. Kjo periudhë, sipas nesh, paraqitet më intensive në ndërrimet cilësore të kalimit nga "nëna" ilirishte te "bija" shqipe.<sup>410</sup> Është pikërisht kjo kohë kur apofonia pushoi së vepruari. Ajo (qoftë kualitative,

<sup>406</sup> Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe* 198.

<sup>407</sup> E. Çabej, në "Studime gjuhësore" V, Prishtinë, 1975, f. 29.

<sup>408</sup> Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe* 203.

<sup>409</sup> D. Luka SGJ V 176.

<sup>410</sup> D. Luka *Rreth problemit* SF 4, 1988, f. 142. Më gjerë te D. Luka *Rreth tri problemeve* SF 1, 1991.

qoftë tjetra kuantitative, tanimë të dyja në të njëjtën hullí) u trashëgua në shqipen, që po formohej, e ngurosur në reflekset e saj, duke mbetur si rast i përgjithshëm ndërrimi *-e- ~ -o-*, së bashku me të gjitha variantet e tij, gjithsesi të trashëguara nga koha kur që në veprim gjatësia e zanoreve dhe reflekset e vjetra indoevropiane. Sepse vetëm kështu mund të shpjegohet që një *-o-* (e dalë nga një *-e-*, përkat. *-ē-*, tanimë të dyja të përfaqësuara me të njëjtën fonemë *e*) të zhvillohej më tej në */a/* etj. Që të shprehemi më qartë, apofonia qoftë ajo kualitative, qoftë tjetra kuantitative (me të katër shkallët e saj), ka vepruar rregullisht në epokën pagane të shqipes (përkat. të "nënës" së saj). Në fillimet e epokës kristiane, duke rënë kushtet që e përftuan, ajo përfundon së vepruari si dukuri e plotë, mbetet fragmentare, derisa nguroset në ato forma që ne i trashëgojmë deri më sot.

Në artikullin me titull "*Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*"<sup>411</sup>, më pas në tjetrin "*Sprovë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe*"<sup>412</sup>, e së fundi në studimin e gjatë "*Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*"<sup>413</sup>, unë kam rreshtuar një numër të madh faktesh (përkat. dukurish) gjuhësore, për të përlegjur ndarjen e bërë aty. Këto fakte gjuhësore, nisin me strukturën fonologjike të shqipes (në sistemin zanor e bashkëtingëllor), më pastaj me nënsistemin morfologjik, fjalëformues etj., gjithsesi duke u shënuar me saktësi edhe burimi nga është marrë përcaktimi i kronologjisë së këtyre dukurive, gjithsesi të vështruara në sistem.

Dukuritë e sjella aty shpresoj të jenë të mjafta për t'i përceptuar ato me shembujt e autorëve nga janë marrë.

\* \* \*

Duke e përmbyllur problemin, që trajtova më lart, dëshiroj t'i përgjigjem shkurt tri çështjeve të shtruar nga S. Mansaku: "... zhvillimet gjuhësore janë të shkallëshkallshme, të pandërprera dhe të papërceptueshme në një çast të dhënë".<sup>414</sup>

Që dukuritë gjuhësore janë të shkallëshkallshme e të pandërprera këtë deri më sot nuk e ka mohuar kurrkush. Puna është, a mund të zbatohen ligjet e dialektikës ndër këto zhvillime. Sepse, sido që të konceptohet zhvillimi i një gjuhë: në trajtë *lineare* apo me shndërrime sasiore, të cilat në një moment të dhënë kthehen në cilësore, duke mohuar origjinën nga kanë

<sup>411</sup> D. Luka, SGJ VII, Shkodër, 2002.

<sup>412</sup> D. Luka, në rev. "Studime filologjike", nr. 1-2, 2010.

<sup>413</sup> D. Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*, po aty, Tiranë, 2010.

<sup>414</sup> S. Mansaku *Periodizimi*, po aty, 119.

dalë, ligjet dialektike këtu bëjnë punën e vet. Diçka veç mbetet e sigurt, shqipja mund të jetë vazhdim i ilirishtes, por nuk është ajo vetë. Sepse në strukturën e sotme të shqipes kanë ndodhur kaq shumë ndryshime (veçanërisht në paradigmat e lakimeve e zgjedhimeve), që, së bashku me ndërrimet e tjera fonetike e fonologjike, shoqëruar edhe me fondin e leksikut (që gjatë rrugës ka huazuar 9/10 e tij, sipas fjalorit të Meyerit), sa të lejojnë të nxjerrësh përfundimin që: Shqipja u formua si gjuhë "bijë" nga "nëna" e saj ilirishtja në të njëjtat treva në shek. I-IV të erës sonë. Gjatë kësaj periudhe ajo përvijoi tiparet gjuhësore, duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e nënës së saj ilirishte, por duke formuar në të njëjtën kohë edhe tipare të reja që e bënë të dallohet nga ajo. Kushtet historike të asaj kohe (pushtimi romak e në vazhdim dyndjet barbare) e përshpejtuan këtë formim. Në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj.

Për "*çastin*" e dhënë, duhet diskutuar se ç'kupton Mansaku me "*çast*"? Sepse ky term në gjuhë shpreh gjithsesi "marrëdhënie kohore", që duhet përcaktuar në zgjatjen e tyre. Pra, në praktikën e zhvillimeve të një dukurie gjuhësore, "*çasti*" mund të jetë mbase edhe një shekull, duke shënuar këtu kohën nga fillimi e deri në përfundimin e dukurisë. Koha gjithnjë është relative.

Kur pyetën një teolog të përmendur se ç'kupton me fjalën "*ditë*", në thënien që "*Perëndia e krijoi botën në 7 ditë*", ai u përgjegj: "me *ditë* unë kuptoj një epokë".

Ndërkaq nuk duhet ngatërruar qenia objektive e një dukurie në zhvillim, qoftë kjo edhe gjuhësore, me pamundësinë e njohjes së saj.

\* \* \*

Në një punim si ky i Xh. Lloshit, që priret të japë periudhat e historisë së shqipes, duhen sqaruar së pari në mënyrë të hollësishme parimet e kriteret e vendosura, të cilat do të zbatohen gjatë punës e më pas metoda që do të ndiqet për arritjen e këtij qëllimi. Elementi dytë po kaq i rëndësishëm është bibliografia e përdorur, e cila tregon jo vetëm hapësirën shkencore të marrë në analizë nga artikullshkruesi, por edhe atë që ai e quan *koherencë* në zhvillimin e temës. Duke i marrë një e nga një çështjet e shtruarra më lart, po përpiqemi të analizojmë shkrimin për të cilin po flasim.

\* \* \*

Për nevojën e ndarjes së shqipes ndër periudha (përkat. edhe ndër etapa) autori nis e flet që në hyrje të punimit të vet. Po kriteret, ku ai është mbështetur, si edhe parimet që e kanë udhëhequr në punën e tij, ai i jep në fund të punimit. Aty shkruhet: “Në paraqitjen e mësipërme është mbajtur parasysh, që evoluimi gjuhësor të shihet i lidhur me historinë e popullit në kuptimin e gjerë të fjalës, domethënë edhe me faktorët jashtëgjuhësorë, edhe me faktorët e jashtëm kundrejt historisë së shqiptarëve e gjuhës së tyre”. Me këtë mënyrë Lloshi zbythet rreth 200 vjet prapa, duke e shtjelluar problemin në një bazë tepër të gjerë, kjo në përputhje me përpjekjen për të gjurmuar formimin e popullit shqiptar e të kulturës së tij, ku lidhja e disiplinave në dobi të njëra-tjetrës a në mbështetje të njëra-tjetrës, janë gjithnjë dobiprurëse. Ndërkaq këtu po flasim për gjuhën. Dhe drejtimi i sotëm i saj është dhënë qartë nga prof. Demiraj: “Për sqarimin e kësaj çështjeje një ndihmë të drejtpërdrejtë nuk mund të japin shkencat e tjera shoqërore, si arkeologjia dhe historia ...”<sup>415</sup> Ky pohim është bërë më 1982. Mëpastaj, shumica e gjuhëtarëve, që e kanë trajtuar këtë problem, jo vetëm e kanë miratuar këtë pohim, por edhe e kanë zbatuar me rigorozitet, duke u munduar ta ngushtojnë problemin vetëm me mjetet e strukturës morfologjike të shqipes, të historisë së saj. Besim Bokshi, bile, e ka thelluar edhe më tej këtë fakt, duke shkruar një libër të tërë, titulluar “*Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*”<sup>416</sup> (botuar në vitin 2010). Duke folur për periodizimin e D. Lukës, Bokshi do të dallojë si tipar kryesor “... ky është periodizimi ku insistohet për të përcaktuar kohën e ndryshimeve fonetike e morfologjike”.<sup>417</sup>

Mirëpo, prof. Lloshi nuk e ndjek këtë rrugë. Përkundrazi, duke kujtuar që po hap shtigje të reja “për të qenë me koherent e më bashkëkohor”, siç thotë ai vetë, lundron kundër rrymës. Parimet dhe kriteret që ai ndjek, së bashku me metodën e punës, e kanë detyruar atë të hapet e natyrisht edhe të hallakatet degë më degë, duke u ndalur më shpesh ndër dukuri, elemente e ngjarje (shpesh anësore), që nuk kanë asnjë lidhje me strukturën e gjuhës. Veçanërisht e panevojshme është mbështetja tërësore te historia e arkeologjia. Duke i dhënë vendin kryesor kësaj të fundit në analizën e periodizimit të historisë së gjuhës shqipe, ka ndodhur shpërpjesëtimi i materialit që ai merr në shqyrtim. Kjo ka bërë që dy kapitujt e parë (I. Gjuhët indoevropiane dhe II. Gjuhët ilire) të zënë plot gjysmën e punimit. Do të ishte më e frytshme që këta dy kapituj

<sup>415</sup> Sh. Demiraj *Koha SF* 3, 1982, f. 27.

<sup>416</sup> B. Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010.

<sup>417</sup> Po aty, f. 20.

(veçanërisht ai i gjuhëve indoevropiane), të trajtoheshin tepër shkurt e vetëm si hyrje e punimit. Ndërsa për *Gjuhët ilire*, autori duhet të mbante parasysh dy çështje me rëndësi. Prejardhja e shqiptarëve të sotëm nga ilirët dhe e gjuhës së tyre nga ilirishtja, nuk është e dokumentuar historikisht. Ajo mbetet një ndër hipotezat më të pranueshme e më të argumentuara deri më sot. Po ndërkaq duhet thënë se nga ilirët nuk kemi asnjë dokument të shkruar a ndonjë shkrim bilingue (ilirisht-greqisht a ilirisht-latinisht) ku të mbështetemi për të bërë analiza e krahasime gjuhësore.

Ngjan që Lloshi nuk e ka kuptuar drejt pyetjen që shtron E. Çabej “*emri i natës në gjuhën shqipe vjen nga ilirishtja apo drejtpërdrejt nga trashëgimia indoevropiane?*” (Është për t’u shënuar këtu se nuk jepet numri i faqes se ku e ka dhënë këtë mendim prof. Çabej, pra nuk njohim kontekstin ku kjo shprehje është vendosur, për të nxjerrë kuptimin e vërtetë të saj). Fill pas, Lloshi jep komentin, sipas tij, të kësaj shprehjeje: “Me fjalë të tjera a është *nata* një fjalë ilire, apo ka pasur një fjalë tjetër për ilirishten dhe prej saj ka pësuar evoluimin deri në trajtën e sotme?” E shtruar me këtë mënyrë, gjithçka duket si kalambure, lojë fjalësh. Këtë e ndjen edhe vetë Lloshi, sepse shkruan: “Nuk është puna për një lojë të parëndësishme terminologjike ...?” Duke mos qenë i zanatit, Lloshi nuk e di, ngjan, se fjalët nuk fluturojnë nga njëra gjuhë në tjetrën. Për të vërtetuar që shqipja është gjuhë indoevropiane (e këtë kurrkush deri më sot nuk e ka vënë më në dyshim, pas traktatit të famshëm të Franz Boppit), të gjithë manualet shkollore marrin si shembull fjalën *natë*, duke bërë krahasimin e saj me gjuhët e tjera simotra indoevropiane. Tani, a ka hyrë kjo fjalë nga ilirishtja apo jo, ka të bëjë me prejardhjen e gjuhës shqipe. Sepse në këtë prejardhje pranohen vetëm ato glosa që janë të përbashkëta e kryesisht vetëm në këto dy gjuhë. Kjo çështje shtrohet edhe për dukuri të tjera morfologjike. Këtu është fjala p.sh. nëse ilirishtja i ka të vetat disa prapashtesa, apo i ka të huajtura nga të tjerët dhe si do të veprohet me ato prapashtesa që janë të burimit apo të trashëgimisë indoevropiane, një pjesë e të cilave dalin edhe në gjuhët e tjera fqinje, në latinishte, greqishte e sllavishte. Në qoftë se fjala *natë* nuk ka hyrë në shqipe nëpërmjet ilirishtes, kjo do të vërtetonte se shqipja e paska marrë nga një gjuhë tjetër. Në këtë rast ky argument do të vërtetonte se shqipja nuk rrjedh nga ilirishtja.

Pesha e madhe që Lloshi i ka dhënë arkeologjisë dhe historisë në trajtesën e tij, vihet re edhe në dy drejtime të tjera. Ai për tërë kohën, për të konkretizuar periudhat e veçanërisht etapat, jep një kronologji të pafund datash e ngjarjesh, që shpesh nuk kanë asnjë lidhje me temën e punimit. Khs. p. sh.

- 1400** - Fillon ndërtimi i xhamive, më 1434 xhamia e Sunkur Çaush beut...;  
**1548** - Përfundon teqeja Harabati në Tetovë;  
**Shek. XVIII** - Hasan Zyko Kamberi përmend fjalën *Shqipëri* etj. etj.

Këtë mënyrë pune ai do ta vazhdojë edhe me gjuhën ilire kur përmend si ngjarje me rëndësi “Ndërtohen teatrot në Butrint ...”, apo “Ndërtohet një bibliotekë publike në Dyrrah” etj., fakte që nuk ngrenë asnjë peshë e nuk thonë asgjë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe. Gjithashtu, kur me dëshirën për të shtuar njoftimet me karakter krejt enciklopedik, Lloshi jep edhe të dhëna krejtësisht të panevojshme, si “Dy fjalë për greqishten”, “Dy fjalë për latinishten”, “Dy fjalë për turqishten” etj. Është për t’u habitur që Lloshi nuk përmend gjëkund dy vëllimet e “Kuvendit të parë të studimeve ilire” (Tiranë, 1974), ku është përmbledhur dija për ilirët deri në kohën kur botohen këto dy vepra. Sepse me pohimet shpeshherë deklarative të N. Cekës, si dhe me objekte të kulturës materiale, nuk mund të zgjidhet problemi i periodizimit të historisë së gjuhës shqipe. Ndërkaq, punimet për të gërmuar, mbase edhe në mënyrë të tërthortë për gjurmët e ilirishtes, apo burimeve të tjera, nuk kanë munguar. Po ato, për fat të keq, nuk përmenden gjëkund në punimin e Lloshit.

Përpyekja për të përcaktuar kohën e formimit të gjuhës shqipe mund të kryhet vetëm duke e analizuar atë në të gjitha nënsistemet e saj (struktura fonetike, gramatikore, leksikore dhe fjalëformuese) në bashkëlidhje me "nënë" e saj ilirishten. Mirëpo, duke qenë se njëra madhësi nuk është e njohur aq sa duhet për t’iu nënshtuar krahasimit të nënsistemeve, këtë mund ta bëjmë në mënyrë të tërthortë duke u nisur nga elementi latin i gjuhës shqipe, i cili si për vëllim si për format e tij, na jep një kontribut të rëndësishëm qoftë për vendin, ashtu edhe për kohën e formimit të gjuhës shqipe.

Gjuha latine ka depërtuar në Evropën Juglindore pak e nga pak gjatë shumë shekujve dhe ka formuar disa zona gjuhësore në kohë të ndryshme duke nisur që te huazimet latine të të parët e shqiptarëve deri te huazimet latine të sllavët e Jugut gjatë shek. VII-VIII.<sup>418</sup> Një pamje kaq e gjerë e këtyre huazimeve qoftë në kohë, qoftë në hapësirë është bërë objekt studimi të shumë gjuhëtarë, më një anë duke u bërë krahasime edhe me fjalët analoge të rumanishtes e të gjuhëve të tjera e, më anë tjetër, duke u përpyekur për të përcaktuar aty ç’është më e vjetër dhe ç’është më e re.

<sup>418</sup> H. Mihăescu *Etnog.* SF 3, 1982, f. 59.

Përmendim këtu G. Meyerin, N. Joklin, C. Tagliavinin, H. Haarmannin, Pelegrinin etj. dhe në mënyrë të veçantë H. Mihăescun<sup>419</sup> dhe E. Çabejn.<sup>420</sup>

Në larminë mendimeve të ndryshme, të shprehura nga gjuhëtarët e mësipërm, mbetet për të përcaktuar më qartë: së pari, kur dhe ku janë marrë këto huazime të dyhershme dhe mbi ç'baza mbështeten për ta vërtetuar këtë fakt; së dyti, cili është shkaku i përfimit të kësaj dukurie dhe, së treti, ç'përfundime mund të nxirren këtu në dobi të kohës së formimit të gjuhës shqipe.

Takimet e para të ilirëve me Romën (të dokumentuara këto nëpërmjet numizmatikës<sup>421</sup>) kanë zënë fill rreth shek. IV para erës sonë. Ata kanë vazhduar pastaj gjatë luftrave iliro-romake dhe janë shpeshuar pas pushtimit të Ilirisë nga Roma. Veçse këtu duhen dalluar dy periudha. E para, që nis rreth shek. IV-I p. e. së re dhe tjetra nga shek. I-IV. Në ndihmë të këtij periodizimi vjen fonetika historike e shqipes. Dihet se te elementet latine dallohen dy palë reflekse: ato të trashëgimisë indoevropiane (pra huazimet latine pësojnë të njëjtat ndërrime si elementi i trashëguar) dhe, së dyti, ndërrime të reja që u përkasin vetëm huazimeve latine.

Refleksi i dyfishtë i *ō*-së së shkurtër te huazimet latine më një anë *vo-* *va-* si te elementi i trashëguar e, më anë tjetër, *ve-* (*opus operis* : *vepër*; *orbis* : */i/ verbër*) nuk është shpjeguar deri më sot bindshëm.<sup>422</sup> Në serinë e gjatë *a*-ja ka dhënë *o* te elementi i trashëguar dhe te huazimet nga greqishtja. Mirëpo, në këtë ndërrim nuk marrin pjesë huazimet latine. Po kështu ndërrimi *ē* (e gjatë) : *o* i periudhës prehistorike nuk prek huazimet latine (khs. lat. *valēre* shq. *vlej*).<sup>423</sup> Mbase këtu është vendi të përmendim konstatimin se gjatësia klasike e zanoreve në vetë latinishten ishte në shuarje e sipër në shekullin e parë të erës sonë dhe, së dyti, kronologjinë e vendosur nga B. Beci për refleksin e *ū*-së latine në *y* në shqipe.<sup>424</sup> Edhe grupi *au* i latinishtes është reflektuar në shqipe me dy mënyra; më një anë *au* ka dhënë *a* (*aurum* : *ār* etj.), ndërsa, në një shtresë më të vonë, *au* : *af*, *av* (khs. *causa* : *kafshë*, *laud/um/* : *lavd* etj.)

G. Meyeri ka vënë re se huazimet latine, që përmbajnë një velar, kanë hyrë shumë herët në gjuhën shqipe, meqë *c*-ja e tyre ka ruajtur karakterin gutural para një *e*-je. E.Çabej mendon se kjo dukuri mund të shërbejë për një shtresim diakronik. Në konsonantizëm një *j* është reflektuar

<sup>419</sup> H. Mihăescu *Lat.*, në *Revue* IV, 1966.

<sup>420</sup> E. Çabej *Zur Charakteristik*, në *Revue des études* IV, 1966.

<sup>421</sup> A. Stazio *Marrëdhëniet*, në *Kuvendi* I (v. I), f. 397.

<sup>422</sup> E. Çabej *SGJ* III 113.

<sup>423</sup> Po aty, 114.

<sup>424</sup> B. Beci *De l'origine*, në *Akten* I.

në vetë huazimet latine me dy mënyra  $d\bar{i} : z$  (*Diana : zana*) dhe  $d\bar{j} : dj$  (*djabolus : djall*). Me ndërrimet  $d\bar{i} : z$  e  $t\bar{i} : s$  gjuha shqipe piqet në mënyrë të veçantë me greqishten.<sup>425</sup> Okluzivet në trup të fjalës në një shtresë të vjetër të huazimeve latine bien (khs. *cubitus : kūt* etj.), ndërsa në më të renë ruhen (khs. *peganus : /i/ pëganë* etj.). I dyfishtë paraqitet refleksi i  $\bar{j}$  (përkat.  $j$ ) si  $j$  ndër elementet e vjetra e si  $gj$  ndër elementet latine (*jūdicare*

: *gjykoj*<sup>426</sup>). Po kështu grupi *kt* jep *t* si te elementi autokton, por edhe *jt* e *ft* ndër huazimet latine (lat. *directus : drejt; luca : luftë*). Edhe grupi *nd* nuk është reflektuar gjithkund njëllë. Në një shtresë më të vjetër *nt* nëpërmjet asimilimit të njohur *nt : nd : nn : n* ka dhënë *n* e në një më të re *nd*. Shihet qartë kjo te refleksi i fjalës latine *calandae* që ka dhënë në shqipe së pari *kullana* e pastaj *kalendar*.

Dallohen, pra, ndër huazime latine të shqipes dy shtresa. E para u nënshtrohet ndërrimeve fonetike të përbashkëta me elementet e trashëguara e me ato të huazuara nga greq. e vjetër. Këtë shtresë mund ta vështrojmë si të trashëguar nga ilirishtja. Së dyti, shtresa më e re, e cila nuk u nënshtrohet më ndërrimeve të lashta.

Për dy "shkallë" a dy "faza" huazimesh latine të dalluara kronologjikisht dhe gjeografikisht, ka folur edhe S. Pušcariu, pavarësisht nga interpretimi (për ne jo i drejtë) që njëra shtresë u mor në atdheun e vjetër (Daki) e tjetra nga ndikimi dalmato-roman.<sup>427</sup> Për një shtresë të moçme të huazimeve latine të shqipes është shprehur edhe Weigand.<sup>428</sup> Edhe H. Barić, duke përmbledhur mendimet e dijetarëve para tij, sheh një shtresim të dyfishtë të huazimeve latine të shqipes.<sup>429</sup> Tani, duke e quajtur të zgjidhur problemin e vendit të formimit të gjuhës shqipe, që "ky është formuar në përgjithësi në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor gjatë kohëve"<sup>430</sup>, vështrimi i dy shtresave ndër huazimet latine të shqipes merr një kuptim të ri, duke ndihmuar në përcaktimin e kohës së formimit të gjuhës shqipe.

Shkaku i këtyre dukurive të reja, mendojmë ne, është krijimi i një gjendjeje të re në gjuhën "nënë". Për ne kjo *gjendje e re* paraqet fillimet e gjuhës së vjetër shqipe, e cila ka nisur jetën e vet edhe me ligjësi të reja nga

<sup>425</sup> E. Çabej SGJ III 130.

<sup>426</sup> Po aty, 144.

<sup>427</sup> S. Pušcariu *Beiefte* 26, f. 62 v.

<sup>428</sup> G. Weigand *Balkan-Archiv* III 178, shën. 1.

<sup>429</sup> H. Barić *Hjmje* 62 v.

<sup>430</sup> E. Çabej SGJ V 29.



"nëna" e saj ilirishtja. Natyrisht në këtë fazë, që zë fill përafërsisht në kapërcyell të erës sonë dhe që përfundon rreth shek. IV, duhen përfshirë edhe elementet e përbashkëta të gjuhës "nënë" e "bijë"; më saktë, elementet që trashëgoohen nga njëra te tjetra. Shembull i qartë për ta vërtetuar këtë mendim është dukuria morfonologjike e metafonisë.

Duke përmyllur kapitullin për ilirët, Lloshi do t'u drejtohet fiseve ilire si edhe pohimit të Lajbnicit në letrën e tij të vitit 1712. Ngjan që Lloshi nuk është i informuar sa duhet për këtë çështje.

Që kur G.W. Leibniz shtroi për herë të parë mundësinë e prejardhjes së gjuhës shqipe nga ilirishtja, e më pastaj J. Thunmann shkroi se "Në historinë e tyre (= shqiptarëve) unë nuk kam gjetur gjurmë të ndonjë mërgimi të mëvonshëm ... këto më tregojnë ilirët e lashtë ..." <sup>431</sup> e deri tek libri i G. Schrammit *Anfänge des albanischen Christentums ...* <sup>432</sup> dhe, tjetri i I. Russu *Obârșia tracică a românilor și albanezilor ...* <sup>433</sup>, janë shkruar kaq shumë libra e artikuj për autoktoninë e shqiptarëve, sa është vështirë të merren nëpër duar e të analizohen hollësisht.

Ndërkaq, duhet theksuar se asgjë e re nuk është shtuar, materiali që kemi në dispozicion është po ai që patën edhe autorët e sipërm; punohet vetëm për përmirësimin e metodës së punës dhe për një analizë sa më racionale të materialit ekzistues. Gjithashtu për të vendosur disa parime e kritere, të cilat ndihmojnë për të qenë sa më objektivë në analizën e lëndës, që do të bëhet objekt studimi.

Një ndër çështjet kryesore në analizën e materialit që do të merret në shqyrtim për problemin që po trajtojmë është autenticiteti dhe leximi i saktë i tij. Më pastaj vjen interpretimi. Për këtë mund të sjellim si shembull *Letrat shqiptare (Albanerbriefe)* të Leibnizit, me të cilat nis qoftë trajtimi i idesë së origjinës ilire të gjuhës shqipe, qoftë mendimi se shqiptarët janë autoktonë në viset ku banojnë që së lashti.

Me parashtrimet e bëra nga Leibnizi nuk mund të arrihet në asnjë mënyrë në përfundimin: "Kështu në një mënyrë më shumë intuitive se sa shkencore, Lajbnici ishte i pari që arriti deri në një 'teori ilire' të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar". <sup>434</sup> Edhe te prof. Kastrati do të lexojmë një

<sup>431</sup> J. Thunmann, *Untersuchungen über die Geschichte östlichen europäischen Völker*, Leipzig, 1774, f. 245.

<sup>432</sup> Gottfried Schramm, *Anfänge des albanisches Christentums - Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*, Freiburg, 1994.

<sup>433</sup> Ion I. Russu, *Obârșia tracică românilor și albanezilor - Der thrakische Ursprung der Rumänen und Albanesen*, Cluj-Napoca, 1955.

<sup>434</sup> *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane* (përgatiti dhe përktheu nga origjinalet Nelson R. Çabej), Tiranë, 1990, f. 17.

përfundim pothuaj të njëjtë me të sipërmin: “... me një intuitë të jashtëzakonshme, arriti në një teori ilire të prejardhjes së gjuhës shqipe”.<sup>435</sup>

Qartë për këtë do të shprehet B. Demiraj kur shkruan: “Duke iu referuar përsëri shkrimeve të Lajbnicit, vështirë se mund të përcillet pa mëdyshje teza e tij mbi origjinën ilire të shqipes, të cilën ai e formulon me një rresht të vetëm, e që shpesh vetëm konstatohet si ‘intuitë e jashtëzakonshme’ e Lajbnicit në historinë e albanologjisë e iliologjisë”.<sup>436</sup>

Për sa u parashtua deri më tani, kërkesat që shtron B. Demiraj “... mbi nevojën e gjithëhershme për plotësimin e analeve të historisë së mendimit albanologjik: së pari, me të dhëna të sakta të karakterit filologjik e bibliografik për atë trashëgimi që disponojmë; e së dyti, me shkallën e njohjes, që përshkon debatin albanologjik në fazën e dokumentimit të tij”<sup>437</sup>, kthehen në nevoja imperative, aq më tepër kur deri më sot mungon një *antologji akademike* me mendimin albanologjik. Përndryshe, mundësia që të notojmë në ujëra të turbullta gjithnjë mbetet aktuale.

Duke përmendur diku se “Mizët flasin ilirisht”, Lloshi do të bënte mirë të merrte në analizë edhe ato teori që i bien shqiptarët e sotëm nga besët (trakas), e ndër to duhej doemos të sillej “teoria” e viteve të fundit të G. Schramm.

Teza e Gottfried Schramm (në veprën *Anfänge des albanischen Christentums*) për prejardhjen e shqiptarëve nga një fis malësor trakas i quajtur *bes*, i kthyer që herët në besimin kristian, banorët e të cilit rreth

Së pari duhet shënuar këtu që letrat e Lajbnicit nuk janë përkthyer nga origjinali, po janë marrë nga N. Raiter, *Leibnisen's Albanerbriege*, Zeitschrift für Balkanologie Jg. XVI, 1980, f. 92-93 (shiko *Autoktonia* f. 41, shën. 2).

Së dyti, në punimin tonë me titull “*Problemi i autoktonisë së shqiptarëve (Çështje parimesh dhe metode)*”, “Studime gjuhësore” VIII, Shkodër, 2003 (khs. edhe “*Studime për historinë e gjuhës shqipe*”, Tiranë, 2010), duke e ndjekur tani Lajbnicin sipas veprave origjinale (që ndodhen në bibliotekën e qytetit të Shkodrës), patëm arritur të ndreqim shumë gabime të kryera deri më tani për trashëgiminë e Lajbnicit, duke i dhënë nëpërmjet tabelave krahasuese qoftë *letrat*, qoftë *fjalët shqipe* (të cilave ai përpigjet t’u bëjë prejardhjen). Në atë shkrim ne patëm shkruar, ndërmjet të tjerash: “Duke vështruar tabelën e mësipërme, vërejmë se edhe te B. Demiraj, që është pa asnjë dyshim më i sakti dhe më i mirinformuari për sa shkruan, ka dy pasaktësi (përkata. lapsus): *Letra II* mban datën 25 janar, kur vetë autori, në shën. 8, shkruan: “N. Raiter shënon gabimisht datën 24 janar 1705, e pas tij edhe ndonjë gjuhëtar i mëvonshëm që është mbështetur në punimin e tij”. Duhej, pra, 24 qershor 1705. Te *Letra IV* shënohet gabim nr. i faqes së vëllimit V (497); duhej 495 etj. etj. (po aty, f. 148).

<sup>435</sup> *Historia e albanologjisë* 171.

<sup>436</sup> Bardhyl Demiraj, *Si ta lexojmë Lajbnicin?*, në rev. “Studime filologjike”, nr. 1-2, 2001, f. 164, së bashku me shën. nr. 2.

<sup>437</sup> Po aty, f. 163.

shek IX, për shkak të përndjekjeve të bullgarëve paganë, u vendosën prapa Durrësit, për afërsisht në krahinën e *Arbnisë*, është kundërshtuar nga tre studiues: I. Schütz<sup>438</sup>, K. Gostentschnigg<sup>439</sup> dhe R. Ködderitzsch.<sup>440</sup> Dy prej autorëve të sipërm (I. Schütz dhe K. Gostentschnigg) nuk merren drejtpërdrejt me analizën e hollësishme të veprës, por kryesisht me metodën e përdorur prej autorit, ndërsa R. Ködderitzsch merret edhe me analizën gjuhësore të saj.

I. Schütz, në artikullin e parë, tregohet më i ashpër në kundërshtimet e veta; ndërsa tek artikulli i dytë, më racional. Ai pasi i përmend Schrammit proverbin latin “*unus testis - nullus testis*”, citon vërejtjen që vetë Schrammi i bën përfundimeve të E. Çabejt: “Me sa përpikmëri dhe me sa kujdes argumentohet këtu? Sa në mënyrë të ndërgjegjshme ndahet e sigurtja prej gjasave dhe gjasa prej vetëm të mundshmes? ...”<sup>441</sup>, duke i kujtuar se këto fjalë i përshtaten më tepër se kurrkujt atij vetë.

Schrammi është historian që operon me mjete gjuhësore. Ai merr të gatshme përfundimet e atyre gjuhëtarëve që çojnë ujë drejt tezës që ky mbron, pa i shoshitur ato dhe, veçanërisht, pa i vështuar në përjasje edhe me përfundimet e dijetarëve shqiptarë dhe pa qenë i informuar sa duhet për fonologjinë historike të gjuhës shqipe. Për përfundimet e Schrammit mund të perifrazohet një nen i *Kanunit të Lekës*: “Ai që shkon në gjyq me këmbë të veta e me mend të tjetërkujt, paguen gjobën.”

Në qoftë se ka të drejtë K. Gostentschnigg kur shkruan se “Teza e Schrammit mbi prejardhjen bese të shqiptarëve - qoftë kjo vetëm një lëmsh hipotezash ose një e vërtetë e zbuluar historike - çon përsëri ujë në mullirin e variantit historik të shkruar nga serbët”<sup>442</sup>, atëherë qëllimet e kësaj vepre, shkruar në vitin 1994, ndihmojnë jo vetëm “teoritë” e serbëve, por në mënyrë të tërthorët edhe synimet e tyre në përpjekjet për ringjalljen e “Stara Srbija”.

---

<sup>438</sup> I. Schütz, *Shënime mbi monografinë e prof. dr. Gottfried Schramm-it “Anfänge des albanischen Christentums”*, në përmbledhjen “Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995. *Konvertimi i shqiptarëve dhe prejardhja e shqipes (Disa vërejtje rreth dy monografive të kohëve të fundit)*, në përmbledhjen “Krishterimi ndër shqiptarë”, po aty, f. 393 v.

<sup>439</sup> Kurt Gostentschnigg, *Rreth historisë së trajtimit të problemit të etnogjenezës së shqiptarëve*, në rev. “Studime filologjike”, nr. 1-2, 1999, f. 33 v.

<sup>440</sup> R. Ködderitzsch, *Shqipja dhe trakishtja*, botuar në “Përmbledhje me studime për Konstandin Kristoforidhin”, Elbasan, 2002,

<sup>441</sup> “Wie streng, wie sorgfältig wird hier argumentiert? Wie gewissenhaft wird das Gesicherte vom Wahrscheinlichen, das Wahrscheinliche vom bloß Möglichen geschieden? ...”

<sup>442</sup> *Rreth historisë ...* 35.

Zakonisht në hipotezën që i bie shqiptarët të ardhur në trojet e sotme, mungojnë të dhënat historike. Për t'i zëvendësuar ato, shpesh kundërshtarët e autoktonisë së shqiptarëve u sillen legjendave. Mirëpo, legjendat, po nuk patën bazë historike të dokumentuar, shërbejnë vetëm për t'i dhënë hov fantazisë. Si legjendë tani tingëllon edhe *Vepra Schrammit*, duke nisur te peshkopi Niketa e deri te mbijetesat e alfabetit të tij te Dhaskal Todri.<sup>443</sup>

Po nëse Schütz e Gostentschnigg vënë në dukje mungesën e bazës historike të veprës së Schrammit, R. Ködderitzsch e shkurorëzon edhe në pikën “më të fortë” të saj, në krahasimet gjuhësore ndërmjet besishtes (përkat. trakishtes) dhe shqipes (duke përfshirë këtu edhe dakishten), duke shkruar se “... në rrugën e krahasimit të këtyre gjuhëve qëndrojnë një sërë vështirësish”<sup>444</sup>, dhe duke përfunduar se “Unë jam i bindur se G. Schrammi nuk do të mund të provojë kurrë, që besishtja dhe trakishtja janë ‘gjuhë me dallime të mëdha’ dhe që shqipja është me prejardhje trake”<sup>445</sup>.

Schrammi punon mbi madhësi të panjohura (ose pak të njohura) dhe me këtë mënyrë argumentet gjuhësore që ai sjell për të vërtetuar qoftë prejardhjen e shqiptarëve nga fisi i besëve, qoftë lidhjen e trakishtes me dakishten (përkat. frigishten), qoftë dallimet që besishtja na paska me vetë trakishten, mbeten vetëm hamendje. Me krahasime gjuhësore të pjesshme (parciale) e krejt të diskutueshme, vështirë të nxirren përfundime të besueshme për lidhje birërie (filiacioni) ndërmjet dy gjuhëve, veçanërisht kur njëra prej tyre (shqipja) është e dokumentuar vonë, ndërsa tjetra (besishtja) pothuaj nuk njihet fare në sistemin (përkat. nënsistemet) e saj strukturore, aq sa për t'u bërë objekt krahasimi.

Nuk mund të jetë argument për të vërtetuar apo jo filiacionin ndërmjet dy gjuhëve p. sh. ndërkalja e një /t/ ndërmjet /s/ e /r/ te rrënja indoevropiane \**sreu* “rrjedh”, e cila gjen pasqyrim ose jo tek këto dy gjuhë. Shembull për këtë mund të sillet etimologjia e fjalës shqipe *gjarpër* në bashkëlidhje me *shtërpinj*. Në morfologjinë e *shtërpinj* dallojmë një bazë

<sup>443</sup> Ngjan bëhet fjalë për “Një nga sensacionet më të mëdha të shek. XIX për filologët e Evropës Juglindore, që interesoheshin për kulturën pellazgjike, qe lajmi që dha konsulli austriak për zbulimin e një alfabeti të vjetër në vilajetet shqiptare të Perandorisë Osmane. Vetë Hahni u entuziazhua shumë për këtë gjetje, mbasi mendoi se kishte rënë në gjurmët e gjuhës së lashtë pellazgjike, ide që solli diskutime për prejardhjen e këtij alfabeti, ku tezat dhe kundërtezat vazhduan edhe në shekullin tonë, derisa iu dha fund enigmës së Hahnit, duke përcaktuar se hartues i këtij sistemi shkrimor ishte Teodor Haxhifilipi, i njohur nga populli Dhaskal Todhri (Tomor Osmani, *Hahni për shkrimin e shqipes*, “Buletin shkencor” Shkodër, 2003, f. 39 v).

<sup>444</sup> *Shqipja dhe trakishtja* 113.

<sup>445</sup> Po aty, f. 121.

*shterp-* dhe një prap. *-inj*. Në të mirë të këtij mendimi flet edhe lidhja etimologjike që jep E. Çabej ndërmjet *shtrapër* “emër bime” me *gjarpër* e *shtërpinj*. Tani në qoftë se është i drejtë mendimi i E. Çabejt që *shtrapër* është zgjerim sekondar i *shtrap* (fjalë që e gjen te St. Manni), atëherë baza e *shtërpinj* duhet menduar një *shtërp-* a *shtrëp-*, ku *ë*-ja paravendon një zanore tjetër, që u errësua për punë të kalimit të theksit te prap. *-inj*. Në qoftë se pranojmë lidhjen etimologjike të *gjarpër* me *shtërpinj* atëherë duhet të pranojmë edhe se ato e kanë zanafillën te një bazë *\*serp-* (përkat. *\*srp* + *in-* a *\*serp* + *in-*). Në këtë rast nga një bazë (përkat. rrënjë) e njëjtë me origjinë indoevropiane (khs. sanskrit. *sárpati sarpa-*, lat. *serpens serpo serpula*, greq. *ἔρπω*) kemi dy reflekse të ndryshme, njëri *\*s/e/rp-* : *gjarp-*, tjetri *\*serp-* : *shtrep-*. I gjykuar kështu kalimi *\*s/e/rp-* : *shtrep-* (*s* : *sh*) është kushtëzuar tani nga bashkëtingëllorja /t/, që është futur në grupin *srp-*. Një ndërkallje e kësaj *t*-je në grupin përkatës paraqitet edhe në gjermanikishte, sllavishte, baltishte e trakishte (khs. gjerm. e lartë e vjetër *stroum* “rrymë, lumë”, sllav. e vjetër kishtare *struja*, lit. *strova* “rrjedh”, trak. *Στρύμων* “emër lumi”, të gjitha të afërta me ind. e vj. *sravati* “ai rrjedh”) dhe vetëm dalja e saj edhe ndër formime sekondare në gjuhën shqipe e detyron N. Joklin të mos e quajë pa dyshim izoglosë të përbashkët e këtyre gjuhëve.<sup>446</sup>

Po kaq i diskutueshëm paraqitet edhe zhvillimi i sonanteve përgjithësisht dhe i *\*r*-së veçanërisht. Në krahasimin ndërmjet shqipes e trakishtes duhet të jemi të kujdesshëm kur përdorim sonantet, të cilat nuk mund të vështrohen jashtë sistemit fonologjik të gjuhëve përkatëse. Dihet se në refleksat e likuidave sonante trakishtja takon me gjuhët baltike dhe sllave; khs. p.sh. /r/ > *ir*. R. Ködderitzsch mendon se shqipja dhe dakishtja këtë /r/ e reflekton *ri* njëlloj si keltishtja.<sup>447</sup> Për sonantet rrokjeformuese lëngëzore, ku edhe shembujt janë më të shumtë, refleksi i /r/-së me /ir/ e /ri/ në gjuhën shqipe është më i pranueshmi. K. Topalli vë re se “Refleksat /ir/ e /ri/ të sonantes rrokjeformuese dridhëse nuk mund të merren si reflekse të ndryshme, por një refleksi i vetëm, që shfaqet në kushte të ndryshme fonetike.”<sup>448</sup> Tani në qoftë se Topalli ka të drejtë<sup>449</sup>, krahasimi i sjellë nga

<sup>446</sup> Shpjegimi i sipërm është dhënë te D. Luka, *Rreth tri problemeve për historinë e theksit në gjuhën shqipe*, në “Studime gjuhësore” V, Shkodër, 1999, f. 6 v; aty edhe bibliografia përkatëse.

<sup>447</sup> *Shqipja dhe trakishtja* 119.

<sup>448</sup> K. Topalli, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 51 v.

<sup>449</sup> E ngjan që ka të drejtë, khs. edhe Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 157 v me gjithë bibliografi.

Ködderitzschi paraqitet tepër i diskutueshëm, dhe ngjan nuk i shërben atij qëllimi për të cilin është kryer.

Për të argumentuar mendimin se trakishtja dhe shqipja nuk kanë përputhje të dukshme as në leksik, Ködderitzschi sjell si shembull të vetmen fjalë bese, që është dëshmuar te mjeku Dioscurides (shek. I pas Krishtit) *asã* “thundërz”. Witzak mendon se *asã* e besëve vazhdon jetën e vet te shqipja *ashe* “dushk i egër”. Ky dijetar, për të vërtetuar karakterin indoevropian të kësaj fjale, sjell një numër krahasimesh: me greq. e vjetër, dakishten, armenishten etj.<sup>450</sup> Ndërkaq, duhej detyrimisht të sillej edhe mendimi i gjuhëtarëve shqiptarë për prejardhjen e fjalës *ashe*, qoftë edhe për ta bërë sa më të plotë krahasimin. Te E. Çabej gjejmë *ashe* “*Ilex aquifolium*, beronjë”, shkurre a dru i vogël, në Malësinë e Tiranës. Është një me *ashër* “gështenjë e egër”, e *ashër* “ashkël” etj. Kështu gjithë këto fjalë janë zhvillime fonetike e kuptimore të *ashkël-s*.<sup>451</sup> Me këtë shpjegim të Çabejt, vihet në dyshim të plotë barazimi dypalësh ndërmjet fjalës shqipe dhe asaj bese, që si e tillë nuk mund të sillet si provë për të vërtetuar prejardhjen e saj.

\* \* \*

Bibliografia e përdorur në artikullin e sipërpërmendur të Lloshit mungon. Kemi në fundin e punimit 19 citime, që duhet të ishin rreshtuar nën vijë te faqet përkatëse. Megjithëkëtë, kjo bibliografi flet qartë se Lloshi nuk është i informuar sa e si duhet, sepse nuk njeh çfarë është shkruar veçanërisht në vitet e fundit për problemin në fjalë. Prej 19 citimeve, 3 janë me autorë të përsëritur. Nga 16 që mbeten, 8 janë shqiptarë, të tjerët të huaj. Nga këta. 5 janë gjuhëtarë, ndërsa 11 të tjerë ose historianë, ose arkeologë.

Për të mos dhënë një listë të pafund autorësh që janë marrë me periodizimin e historisë së gjuhës shqipe, ato që e kanë bërë objekt studimi, si edhe ato që e kanë prekë në mënyrë anësore e vetëm këto vitet e fundit, unë po rreshtoj listën e mëposhtme, pa bërë asnjë koment.

1. **G. Stadtmüller**, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, 1966.
2. **Gottfried Schramm**, *Anfänge des albanisches Christentums - Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*, Freiburg, 1994.

<sup>450</sup> Cituar pas *Shqipja dhe trakishtja* 120.

<sup>451</sup> E. Çabej SE II 99. Khs. edhe D. Luka SGJ I 119 e SGJ V 87.

3. **A. G. Ramat** e **P. Ramat**, *La lingua indoeuropee*, II ed., Bologna, 1994.
4. **Seit Mansaku**, *Periodizimi i historisë së gjuhës shqipe dhe pikëpamja e prof. Selman Rizës për të*, SF 1-2, 2000.
5. **Kolec Topalli**, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
6. **Shaban Demiraj**, *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2008.
7. **Besim Bokshi**, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010.
8. **Bardhyl Demiraj**, *Shqiptar*, Tiranë, 2010.
9. **David Luka**, *Studime për historinë e gjuhës shqipe* (Vepër e zgjedhur, botim i QSA Tiranë, 2010).
10. **Kolec Topalli**, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.
11. **Oliver Jens Schmitt**, *Shqiptarët (Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit)*, Tiranë, 2012.

\* \* \*

Analizën e mirëfilltë të problemit që trajton, Lloshi e nis te kapitulli “C. GJUHA SHQIPE”.

Autori i sipërm e ndan historinë e gjuhës shqipe në tri periudha të mëdha: *Shqipja e vjetër* (shek. VI-XI), *Shqipja e mesme* ose arbërishtja (shek. XII-XVII) dhe *Shqipja e re* (shek. XVIII deri sot). Më pas secila periudhë e madhe ndahet në njësi më të vogla, në etapa. Për çdo etapë rreshtohen në mënyrë kronologjike sipas datave të caktuara ngjarje që në shumicën e rasteve nuk kanë asnjë lidhje me gjuhën shqipe. Khs. p.sh.

**Ringjallet** jeta qytetare prej dyndjeve barbare;

**1081** – Aleks Komneni thyhet nga mbreti i normanëve ...;

**1760** – Nezim Frakulla mëton se është i pari që shkruan vjersha shqip etj. etj.

Për vendosjen e shek. VI si pikënisje të “gjenezës së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij”, Lloshi mbështetet te një autor i huaj, K. Kaser. Ne, duke mos e pasur në dorë veprën e këtij autori, gjithsesi pak e aspak të dëgjuar deri më sot (përmendet në bibliografinë e dhënë në veprën “Shqiptarët” të Oliver Jens Schmitt, Tiranë, 2012), po japim formulimin sipas Lloshit: “Formimi përfundimtar i etnosit shqiptar është kryer në shek. VII-XII, kur mori fund dallimi i fiseve dhe dialekteve të ndryshme dhe ka

filluar një bashkësi territoriale e arbërve”. Sipas këtij formulimi (ku bëhet fjalë për “formimin përfundimtar të etnosit shqiptar” dhe jo të gjuhës shqipe), fillimi i formimit të plotë e përfundimtar të gjuhës shqipe, nga do të niste periodizimi i saj, duhet të ishte shek. XIII, sepse shekujt VII-XII, sipas Kaserit, do të mbeteshin si fazë kalimtare, në të cilat ngjizej shkallë-ahkallë gjuha shqipe, pra si fazë kalimtare nga ilirishtja në gjuhën e re shqipe. Këtë ide e përforcon vetë Lloshi kur shkruan: a. “Shek. VI. Fillimi i ndryshimeve që shënojnë kalimin nga ilirishtja te arbërishtja”. Mirëpo, nga fillimi e deri në përfundimin e një procesi, natyrisht duhet një kohë e caktuar.

Ndërsa Kaseri është më i përmbajtur kur shkruan për formimin e “etnosit” shqiptar, Lloshi e transplanton thënien e Kaserit në “formimin e gjuhës shqipe”, përcaktime që nuk janë njëlloj. Tjetër është etnosi e tjetër gjuha. Mjetet me të cilat përballohet studimi i tyre nuk janë të barabarta, sepse kemi të bëjmë me dy degë të shkencës që dallohen nga njëra-tjetra (përkat. etnologjia dhe gjuhësia). Shqiptarëve duhet t’u mbushet mendja që historia e gjuhës së shkruar shqipe nis në vitin 1555 me “Mesharin” e Buzukut, libri i parë i shkruar në shqip deri më sot. Më tej, historianët e gjuhës përpiqen të lidhin “fijet e këputura” (siç shprehet E. Çabej), punë që duhet të kryhet me shumë kujdes e gjithësi me argumente (megjithëse shpeshherë të tërthorta) sa më të sakta.

Dukuritë e strukturës së shqipes, që rreshtohen nga autori për të vendosur kufij për periodizimin e periudhave të mëdha (*Shqipja e vjetër* etj.), gjithashtu edhe të etapave të secilës periudhë, duhet të jenë detyruesisht të argumentuara bindshëm. Ato, ose duhet të merren nga studiues seriozë (e gjithësi të pranuar nga dija e sotme gjuhësore), duke u shënuar me saktësi vepra (përkat. burimi) nga është marrë, ose të jenë argumentime nga punimet e vetë autorit. Përndryshe, përfundimet pa adresë e të dhëna vetëm “me vesh”, mbeten gjithësi e në të gjitha rastet deklarative, duke ulur ndjeshëm (për të mos thënë tërësisht) vlerën dhe seriozitetin e studimit, duke e radhitur atë si punim diletant a, në mos, për përdorim shkollor.

Në shkrimin e Xh. Lloshit, sa thamë më lart, dhënia e argumenteve pa adresë është metodë pune. Për konkretizimin e këtij fakti po marr vetëm dy raste.

Shembulli i marrë për të përcaktuar si kufi, shënuar “ndërpritjet rotacizmi” (shek. VI), është tepër i diskutueshëm. Krahas pikëpamjeve të shprehura për dukurinë e rotacizmit të Meyer-Lübkes (miratuar edhe nga



Sh. Demiraj) e të Joklit (miratuar edhe nga Çabej e Luka)<sup>452</sup>, kemi tash së fundi kronologjinë e B. Jansonit që rotacizmi ngjan të ketë zënë fill nga viti 800 dhe të ketë përfunduar aty nga viti 1000 i erës sonë.<sup>453</sup>

Tani një dukuri, që paraqitet e diskutueshme veçanërisht për kohën e fillimit, për zgjatjen dhe për përfundimin e saj, nuk mund të merret në asnjë mënyrë si argument për të vendosur një kufi në periodizimin e historisë së gjuhës shqipe.

Shembulli tjetër, guturalet (përkat. tektalet), që Lloshi i përmend shpesh në punimin e vet, kërkojnë një trajtim të veçantë, veçanërisht për të përcaktuar ndarjen e madhe *Centum-Satem*, që kundërshtarët e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe e përdorin si argumentin kryesor, për të kundërshtuar prejardhjen e gjuhës shqipe nga ilirishtja, meqë njëra (ilirishtja) është e grupit *Centum*, ndërsa tjetra (shqipja) e grupit *Satem*.

Megjithëse studimi i zhvillimit të guturaleve indoevropiane në përgjithësi, si dhe reflekset e tyre në gjuhën shqipe janë shtrirë në tre shekuj<sup>454</sup>, prapëseprapë shumë çështje kanë mbetur pezull. Ata ose nuk janë shpjeguar e vërtetuar kënaqshëm, duke mbetur gjithsesi problematike dhe të papranuara nga dija e sotme gjuhësore, ose për dukuri të njëjta janë shprehur mendime të ndryshme, duke lënë shteg për vazhdimin e diskutimeve të nisura me kohë.

Tashmë dihet se problemi i zhvillimit të guturaleve është jo vetëm tepër i vështirë, por, siç është shprehur Sh. Demiraj<sup>455</sup>, edhe i “sëkëlldisur”. Ndërkohë K. Topalli shkruan se ky “është problemi më i mprehtë dhe më i diskutueshëm në fushën e konsonantizmit.”<sup>456</sup>

Problemi i grykoreve të gjuhës indoevropiane është ende i pazgjidhur përfundimisht dhe teori që ndryshojnë ndjeshëm nga njëra-tjetra kanë dalë që para më shumë se një shekulli e dalin edhe sot e kësaj dite.<sup>457</sup>

Ne mendojmë se rimarrja në analizë e ndonjëres prej tyre paraqet interes edhe për historinë e zhvillimit të guturaleve në gjuhën shqipe.

<sup>452</sup>Sh. Demiraj, *Fonologjia* 242 v.

<sup>453</sup>B. Janson, *Etymologische und cronologische Untersuchungen ...* 1986, f. 211.

<sup>454</sup>Një përmbledhje të mendimeve (përkat. teorive) për evolucionin e guturaleve indoevropiane në përgjithësi, si edhe për reflekset e tyre në gjuhën shqipe e ka dhënë K. Topalli në veprën *Mbylltoret e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002 (Kreu I *Grykoret indoevropiane në gjuhën shqipe*, f. 43-104, aty edhe bibliografia përkatëse). Khs. edhe K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 280-299.

<sup>455</sup>Ky epitët u përdor nga Sh. Demiraj në diskutimin e tij për këtë problem në Sesionin II Shkencor të Gramatikës dhe të Historisë së Gjuhës të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, mbajtur në Tiranë më 1-2 prill 1983.

<sup>456</sup>K. Topalli, *Mbylltoret e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 45.

<sup>457</sup>K. Topalli *Mbylltoret* 45.

Pohimi se gjuha indoevropiane në fillimet e veta ka pasur vetëm një seri grykoresh, velaret (prapaqiellzoret) e thjeshta, kurse dy seritë e tjera janë përfutur më vonë nëpërmjet rrugëve të ndryshme<sup>458</sup>, na duket më frytdhënësi në analizën e evoluimit të grykoreve gjatë kohëve. Mënyra e artikulimit të tingujve tek njerëzit, që jetojnë në grupe shoqërore të përbashkëta dhe në kushte të njëjta jetese e zhvillimi, ngjan të jetë në mos e njëjtë, tepër e përafërt. Degëzimet dhe dallimet e këtyre tingujve kushtëzohen tani nga lëvizjet e grupeve të veçanta, të cilët duke jetuar e punuar me lidhje të dobëta me njëri-tjetrin, ose edhe pa lidhje fare, përfutur me rrugë të ndryshme tinguj të rinj, ose modifikojnë ato të vjetrit, gjithsesi për të përballuar emërtimin e dukurive të reja po me fjalë të reja. Në latinishten p. sh. shkronja *y* dhe *z* iu kanë shtuar alfabetit latin në kohën e Ciceronit (shek. I para Krishtit), ndërsa *u*-ja u dallua nga *v* në mesjetë. Po kështu ka ngjarë edhe me shqipen, ku *y*-ja dhe *ë*-ja janë përfutime të brendshme të vetë gjuhës.<sup>459</sup>

Pra, fillimisht, kur popujt që emërtohen “indoevropiane” jetonin ende së bashku, për tingujt guturalë ngjan të kishin vetëm një seri, velaret e thjeshta *k* e *g*. Në vazhden e kohëve, duke qenë se këta tinguj tani për nevoja jetësore të ndryshme bashkoheshin me tinguj të tjerë në shqiptimin e fjalëve të reja, lindën seritë e tjera. Së pari, në takimin e *k* (*g*) me *h* u krijuan guturalet aspirative, që sipas nesh do të përfshijnë (përkat. do të përhapen) edhe ndër seritë e tjera, që do të krijohen në vazhdim. Megjithëse sot kjo tezë, që në fillimin e vet qe paraqitur së pari prej Brugmannit, është vënë në dyshim këto vitet e fundit, mbetet gjithnjë aktuale. Një pjesë e gjuhëtarëve, që janë marrë me këtë punë, pranojnë një sistem me tri seri burimore, duke përjashtuar në mbylltoret e aspiruara pikërisht ato të pazëshmet.<sup>460</sup> Mënjanimi i këtij çifti të aspiruar nga seritë përkatëse ka rrjedhë kryesisht për punën se në vazhden e kohëve, duke u pasuar fjala me zanore të ndryshme (të mbyllta dhe të hapta, të gjata dhe të shkurtra etj.), *h*-ja, që shkaktonte aspirimin, ka rënë ose është kontaminuar me tingujt e tjerë që e kanë pasuar atë. Shembull i qartë për këtë është italishtja, që për të dalluar një *ci*- nga tjetra *chi*- vendos aspirativën, që pengon shqiptimin e afrikatës. Shtrirja e aspirimit edhe në seritë e tjera bie në sy sidomos në

<sup>458</sup> Khs. O Szemerényi, *Einführung in die vergleichende Sprachwissenschaft*, Darmstadt, 1980, f. 130 v. M. Mayrhofer, *Indogermanische Grammatik I*, Heidelberg, 1986, f. 103 v. K. Topalli *Mbylltoret* 46.

<sup>459</sup> D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore” VII, f. 88, shën. nr. 41.

<sup>460</sup> Shiko për sa më sipër Sh. Demirajn, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 38 (shën. nr. 12) dhe f. 48 (shën. nr. 57 me gjithë bibliografi).

indishten e vjetër dhe në iranishten e vjetër (avestishten). Ndërkohë në greqishte dhe në latinishte bashkëtingëlloret mbylltore të zëshme të aspiruara janë shndërruar prej kohësh në bashkëtingëllore fërkuese.<sup>461</sup>

Një *kh-*, pasuar nga një zanore e mbyllët, në gjuhën e lashtë shqipe ka përfunduar në *k* velare të thjeshtë. Këtë e vërtetojnë dy shembuj, dy fjalë të shqipes të huazuara nga greq. e vjetër: *λάχανον* dhe *μάχανα*<sup>462</sup>, që në shqipe kanë dhënë “lakër” dhe “mokër”. Pra një *χ* e greqishtes së vjetër (përkth. dorishte, nga janë huazuar këto fjalë në shqipe) ka dhënë *k*. Kronologjikisht një *kh-* e pasuar nga një zanore e mbyllët /*a*/ ose /*o*/ në gjuhën shqipe të asaj kohe nuk dilte më e aspiruar. Ajo kishte përfunduar në velare të thjeshtë. Edhe në alfabetin etrusk, të përbërë prej 20 shkronjash (4 zanore e 16 bashkëtingëllore), dilte një *kh* (aspirative).<sup>463</sup>

Ndryshe ngjiste në rastin kur një *kh* (velare e thjeshtë e aspiruar) pasohej nga një zanore e hapët (veçanërisht nga një *i*). Në këtë rast kjo *kh<sup>i</sup>*-prirej drejt një shqiptimi të palatalizuar. Me gjasë këtu zënë fill tani palatalet e shqipes, të vjetrat e më të rejat (khs. *kh<sup>i</sup>* përballë *k<sup>i</sup>*), për të cilat kemi folur në një vend tjetër.<sup>464</sup> Edhe në alfabetin etrusk shënohen qartë bashkëtingëlloret aspirative e, ndërmjet tyre, edhe *khi* për /*g*/ e *phi* për /*b*/.<sup>465</sup>

Në rastin kur një *kh* velare e thjeshtë e aspiruar pasohej nga një *v* (*kh<sup>v</sup>*-) shqiptimi i saj ndryshonte nga një *k(h)*- e zakonshme, tani duke u mëvetësuar si bashkëtingëllore e re dhe duke u dalluar në alfabete të ndryshme. Shembull për këtë është alfabeti latin ku bashkëtingëllorja *q* shkruhet *qv*, me gjasë e huazuar nga një *q* etruske.

Jemi në atë fazë ku gjuhët e ndryshme plotësojnë e saktësojnë tingujt me grafema në alfabetet e tyre. Në protoshqipen ngjan që po krijohen nga velaret e thjeshta seritë e tjera, por gjithsesi duke u thjeshtëzuar ato aspirativet. Edhe në vazhden e kohëve bashkëtingëlloret e zanoret që pasojnë grykoret e të tri serive ndikojnë dukshëm në zhvillimin e tyre. Për këtë mjafton të sjellim si shembull depalatalizimin e grykoreve

<sup>461</sup> Shiko Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe* 48 v.

<sup>462</sup> Vocabolario greco-italiano, dal *Vocabolario greco-tedesco* del professore dott. Carlo Schenkl, tradotto di Francesco Ambrosoli, edizione ottava, Vienna, 1884, f. 561.

<sup>463</sup> E. Sedaj, *Shkrimi alfabetik – zbulim i madh i njerëzimit*, në vëll. “Shqipja arbërore”, Prishtinë, 2002, f. 32.

<sup>464</sup> D. Luka, *Shënime për guturalet në gjuhën shqipe* III, në vëllimin “Studime për historinë e gjuhës shqipe” (Vepër e zgjedhur), Tiranë, 2010.

<sup>465</sup> E. Sedaj, *Shkrimi alfabetik*, po aty, f. 33.

palatale kur ato pasohen nga një *r* (përkant. *r*) ose një *l* (përkant. *l*), për të cilat kemi shkruar diku tjetër.<sup>466</sup>

Për të pasur një ide të qartë për reflekset e grykoreve indoevropiane në gjuhë të ndryshme, po sjellim tabelat e mëposhtme:

### GRYKORE TË SHURDHTA

i.e.	het	sans	aves	greq	latin	os.u	got.	arm.	in.v.	sll.vj.	lit.	tok.	shq.
* <b>k</b>	k	k(c)	k(c)	κ	c	k	h	k'	c(ch)	k(čc)	k	k	<b>k(q)</b>
* <b>k̂</b>	k	ś	s	κ	c	k	h(g)	s	c(ch)	s	š	k(ś)	<b>th</b>
* <b>k<sup>v</sup></b>	ku	k(c)	k(c)	π(τ)	qu	p	hë	k'	c(ch)	k(čc)	k	k	<b>k(s)</b>

### GRYKORE TË ZËSHME

i.e.	het	sans	aves	greq	latin	os.u	got.	arm.	in.v.	sll.vj.	lit.	tok.	shq.
* <b>g</b>	g	g(j)	g(j)	γ	g	g	k	k	g	g	g	k	<b>g(gj)</b>
* <b>ġ</b>	g	j	z	γ	g	g	k	c	g	z	ž	k	<b>dh</b>
* <b>g<sup>v</sup></b>	gu	g(j)	g(j)	β(δ)	u(gu)	b	q	k	b	g(ž,dz)	g	k	<b>g/z-</b>

### GRYKORE ASPIRATIVE<sup>467</sup>

i.e.	het	sans	aves	greq	latin	os.u	got.	arm.	in.v.	sll.vj.	lit.	tok.	shq.
* <b>gh</b>	g	gh(h)	g(j)	χ	h	h	g	g	g	g	g	k	<b>g</b>
* <b>ġh</b>	g	h	z	χ	h(g)	h	g	j	g	z	ž	k	<b>d-</b>
* <b>g<sup>v</sup>h</b>	gu	gh(h)	g(j)	Φ(θ)	f(u)	f?	h?(ë)	j	g	g(ž,dz)	g	k	<b>g/z-</b>

Për nevojën vendosjen e saktë të kohës së zhvillimit të një dukurie, përkant. të fillimit dhe përfundimit të saj, Xh. Lloshi, në faqen e parë të punimit të vet, merr si shembull:

“... rastin e rënies së sonantes /N/ për të cilën K. Topalli diskuton kronologjinë dhe shkruan: ‘Kështu, më sa duket, rënia e sonantes /n/ ka zgjatur deri në periudhën e hershme të marrëdhënies të shqipes me sllavishten, domethënë deri në shek. VII, duke përfshirë krahas disa huazime sllave edhe një pjesë të huazimeve nga italishtja, si *kashû* nga ital. *casone*, *katallâ* nga ital. *catalano*, *barbû* nga ital. *barbone* etj.”

<sup>466</sup> D. Luka, *Shënime për guturalet*, po aty.

<sup>467</sup> Tabelat e mësipërme janë nxjerrë nga *Le lingue indoeuropee*, Bologna, 1994, f. 52-53 (aty edhe shënimet sqaruese përkantëse). Ne kemi shtuar për krahasim vetëm kolonën “shqip”.

Kolec Topalli është autor i dy veprave madhore të gjuhës shqipe, “Fonetika historike e gjuhës shqipe” si edhe “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, të cilat Xh. Lloshi nuk i përmend gjëkund në punimin e tij, megjithëse këto dy vepra kanë fituar edhe çmime, e gjithashtu janë vlerësuar si arritje për gjuhësinë historike shqiptare. Ndërkaq, Lloshi, merr në analizë një artikull të Topallit, botuar në revistën “Studime filologjike” (viti 2001), duke mos përmendur gjëkund veprën “Për historinë e hundorëzimit të zanoreve në gjuhën shqipe” (Tiranë, 1996), ku dukuria në fjalë rroket në tërë gjerësinë që paraqet, dhe përpiket “ta zërë në gabim”. Por, në të vetmen analizë që Lloshi bën në krejt punimin e vet, duke mos u mbështetur askund, e duke bërë zhvillime fonetike “me vesh”, nxjerr përfundime të gabuara. Nuk është vetëm Topalli, që ka shkruar për problemin në fjalë. Janë edhe të tjerë që e kanë rrahur e trajtuar në të gjitha anët, por Lloshi ose nuk i njih këta shkrime, ose nuk do t’i njohë.

Rruga e zhvillimit të hundorëzimit në huazimet latine të shqipes ngjan të jetë përafërsisht kjo. Fjala *solānum* p.sh. ngjan të ketë dalë në shqipe së pari *s/h/ullān*, duke ruajtur *a*-ja një kuantitet jo të barabartë ndër të dy dialektet. Ndërsa në gegërishten gjatësia e *a*-së duhet të jetë reflektuar e plotë, në toskërishte ajo duhet të ketë qenë më e zbehtë. Këtë e ka ndihmuar edhe *-n*-ja fundore, e cila në gegërishte duhet të ketë rënë që në këtë kohë, ndërsa të jetë ruajtur më gjatë në toskërishte. Intensiteti i hundorëzimit varet nga shumë faktorë, por një ndër kryesorët është rënia e *-n*-së fundore, e cila e lë rrokjen të hapur, pra gjithsesi më të gjatë se sa atë të mbyllur nga *-n*. Ngjan pra që të kemi patur këtë gjendje: në gegërishte *s/h/ullān/ > shullā* ndërsa në toskërishte (që ka nisur të zërë fill) *s/h/ullān > shulla/n/ > shulle > shullë*. Në ndryshimin e nyjetimit të zanores *a* në *e/ë*/ ka ndikuar edhe shqiptimi i labërguar i *-n*-së, tani jo më para *a*-së, po para *e*-së (përkate *ë*-së), gjithsesi me drejtimin për t’u kthyer në *-r*- në trajtën e shquar, që padyshim duhet të ketë ndikuar në tërë paradigmen e lakimit të kësaj fjale.

Në të mirë të këtij mendimi flasin dy fakte. Së pari, vija e zhvillimit të kësaj dukurie në gegërishte është konsekuente. Te emri *qen*, megjithëse mungon një *ë* hundore me intensitet të plotë, në ndonjë rast të rrallë në Gropën e Shkodrës dëgjohet *që* (khs. shprehjen *Ik he që!* Khs. edhe te Budi *tue thanë se mëjaft që*<sup>468</sup>). Po kështu fjalët *lavërdā*, *flakadā*<sup>469</sup>, *mballadātë*

<sup>468</sup> P. Budi, *Speculum Confessionis* (SC), Roma, 1621, f. 388. Khs. edhe K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1998, f. 273.

<sup>469</sup> Khs. te Lahuta e Fishtës *Ndezet zjarmi flakadā* (“Lahuta e Malcís”, botim i tetë, 1997, f. 414).

cilat dihen se përmbajnë një prapashtesë me burim nga turqishtja *-dan*<sup>470</sup>, dalin me *-ã* hundore me intensitet të plotë dhe me rënien e *-n*-së fundore, përballë huazimeve turke *havadan* e *kasabadan* (khs. këtu edhe *fidán* e *hajván*<sup>471</sup>), që natyrisht duhet të jenë krejt të vona e mbase tepër pak të përdorura në popull. Khs. gjithashtu edhe ndajfoljen *harû* në shprehjen *rri harû* “rri si hu gardhi”<sup>472</sup>, sipas G. Meyerit huazim nga turqishtja *harun*<sup>473</sup>, së bashku me *dumâ dumani* “shtyllë drunit, colonna di legno ...”, që e jep *Bashkimi* për gegërishten veriore, me rrjedhë nga turq. *dümen* (kjo vetë prej ital. *timone*)<sup>474</sup>. Në këtë vazhdë mund të përfshihen tani edhe huazimet nga italishtja *kashû*<sup>475</sup> (*cassone*), *katallã* (*catalane*)<sup>476</sup>, *barbû* (*barbone*), *kusî* (ven. *cusina*) etj., të cilat ngjajnë të njëfarë moshe (përk. ital. e vjetër).<sup>477</sup> Khs. këtu edhe fjalën e gegërishtes *balû* - *baluni* “thes i madh i mbushur me manufakturë”<sup>478</sup>, të cilën E. Çabej e bie me rrjedhë nga venecianishtja<sup>479</sup>, si edhe *fagû faguni* “zjarmishta, gjelltorja në anije” në të folët e Ulqinit, prej ven. *fagon*.<sup>480</sup> Mbase këtu mund të rreshtohen edhe *bibâ* (*bib/ë/ + an*), *breshkâ* (*breshk/ë/ + an*), *patâ* (*pat/ë/ + an*), *vidâ* (*vid/ë/ + an*), formime me prap. *-an* me gurrë sllave, por që u ngjitet edhe fjalëve që nuk janë sllave.<sup>481</sup> Po kështu edhe *vigã* “vigan”, huazim nga serbokroat. *viganj*<sup>482</sup>, si dhe */h/ostë* “osten” nga bullg. *osten*<sup>483</sup>, së bashku me *luterã* “luteran” (te Budi *luterâjt* RR 161<sup>484</sup>). Khs. këtu pranë *carã* “secili nga dy gurët e ngulur në dy anët e vatrës ...”, që ngjan si huazim i vjetër prej sllav. *čerěň* (përk. serbokroat.)<sup>485</sup>, tjetrën, më të re, *bërkî* “Sorbus torminalis,

<sup>470</sup> A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, te vëllimi “A. Xhuvani. Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 461. Khs. edhe E. Çabej SE IV 198.

<sup>471</sup> E. Çabej SE IV përk. 183, 347.

<sup>472</sup> *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954, f. 165.

<sup>473</sup> G. Meyer EW 148.

<sup>474</sup> E. Çabej SE III 373.

<sup>475</sup> Khs. te *Lahuta* e Fishtës *Kû po kishte ‘i kashû t’vjetër* (f. 414).

<sup>476</sup> G. Meyer EW 181.

<sup>477</sup> K. Topalli *Për historinë e hundorësisë* 52.

<sup>478</sup> *Fjalor* 1954, f. 26.

<sup>479</sup> E. Çabej SE II 143.

<sup>480</sup> E. Çabej SE IV 126.

<sup>481</sup> A. Xhuvani - E. Çabej *Prapashtesat* 437.

<sup>482</sup> G. Meyer EW 472.

<sup>483</sup> Po aty, f. 316.

<sup>484</sup> K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe* II, Tiranë, 1998, f. 230. Khs. edhe *Lahutën e Fishtës Zdap, lutrã edhe katallã e Si lutrãj, si katallãj* (përk. f. 355 e 354).

<sup>485</sup> E. Çabej SE III 11 v.

vodhviçe” (me variantet *berkî, përkî, bërgî* etj.), fjalë e gegërishtes veriore, huazim krahinor prej serbokroat. *brèkinja*.<sup>486</sup>

Në disa raste ndodhemi para huazimeve, të cilat duhen shpjeguar veç e veç, sepse ngjajnë të hyra në shqipe në kohë të ndryshme e nga burime të ndryshme, pavarësisht se herë-herë përballemi me të njëjtën fjalë, khs. *dumâ - dumani* me *timû - timuni* “timon-i” (it. *timone*). Khs. gjithashtu *capû* “sapun”, për të cilën G. Meyeri EW 378 v shprehet se *sapûn* vjen nga gr. e re *σαποῦνι*, ndërsa *sapua* nga ital. *sapone* e përballë saj *cibûn* (me variantet *cipûn, cipune, cibune*) nga ven. *zibone* (E. Çabej SE III 45 v. me gjithë bibliografi); gjithashtu *kanû* “kanun-i” (turq. *kanun*, gr. e re *κανών*) e *cifû* “sifon” (it. *sifone*) përballë *bastun-i* (ven. *bastone*, E. Çabej SE II 176 v; khs. gr. e re *μπαστούνι*, bullg. *bastûn*, arom. *băstûn*, shq. *bostî* “purtekë”, kjo e fundit e përdorur në Nikaj-Mërtur). Khs gjithashtu *drangû* (lat. *draconem*) me trajtën tjetër *drangue drangua* përballë *ftû* (por kurrkund *ftû*), e *ftue ftua* e po kështu *langû* (nga. gr. e re *λαγωνικόν*, EW 237) përballë *langue lingua*. Në këto raste nuk përjashtohet edhe roli rrafshues i analogjisë.

Edhe në toskërishte vërehet po e njëjta vijë, po tani në përshtatje me zhvillimin fonetik të këtij dialekti. Dëgjohet p.sh. *Osmën* (për *Osman*), *Sulejmën* (për *Sulejman*), *tamëm* (për *tamam*), *akshëm* (për *aksham*), *pishmën* (për *pishman*), fjalë të huazuara nga turqishtja, e po kështu *Grëmsh* (për *Gramsh*). Shembujt e sipërm, qoftë nga gegërishtja, qoftë nga toskërishtja, janë të vonë, po ngjan që ata të paraqesin atavizma<sup>487</sup>, që në

<sup>486</sup> E. Çabej SE II 210 v.

<sup>487</sup> Në të folmen e Çamërisë p.sh. zanorja *a* nuk është kthyer në *ë* në fjalë si *aj* (folje *ajtur* “ënjtur”), *mandër-a, vath-i* etj. si edhe te fjala *nanë* “nënë” (*Lum si nana që të ka*), Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë, “Dialektologjia shqiptare”* (DSH) I, Tiranë, 1971, f. 139. Në këtë të folme *ë*-të, që u përgjigjën *a*-ve përpara bashkëtingëlloreve hundore, në disa raste kanë marrë zhvillim të mëtejshëm, duke u kthyer në *i* (khs. *bën - bin, hëngra - hingra* etj., po aty, f. 139). Edhe në të folmen e Kurveleshit ruhet zanorja *a* te *âhen* “ënjtem” dhe *andërrim* “ëndërrim” (M. Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, DSH I 43). Në të folmen e Tomoricës dalin rregullisht *akshëm, tamëm, hamëm, llagëm, musëndër* etj. (H. Xhaferri, *E folmja e Tomoricës*, DSH VI 335).

Për trajtat me *a*- përballë atyre me *â*- E. Çabej do të shprehet: “Më anë tjetër forma - jashtë rregullës - me *a* në disa dialekte anësore të toskërishtes kryesisht jugore, ashtu si në gegërishten: në Gjirokastër *ajtem, m’u ajt dora*, çam. (Haxhihasani DS II 26) gjithashtu *ajtem*, atje në Filat *m’u ajtin glishhtërit ka të ftohtit*, dhe te Boçari (f. 81) *ajturë*. Edhe në Sofiko të Moresë *âhetë* “ënjtet”, *u â* “u ënjt”, përkundrejt *ëj ëhem* të Kalabrisë, te Bilotta edhe *yhem* (?), khs. Kamardën 1, 57 111; Giordanon 100, 560” (SE IV 122). Duke shtuar tani këtu se edhe Gropa e Shkodrës këtë *aj* e shqipton me *a* të hapët (pa as më të voglën shenjë hundorësie), duhet nxjerrë përfundimi që ose etimologjia e kësaj fjalë (në

mënyrë histerogjene tregojnë për një vazhdimësi të dukurisë. Këtu mbase mund të shtohen edhe reliktet (a mbase shenjat e fundit të vazhdimit të dukurisë), si p.sh. *lkê-n-i*<sup>488</sup> (khs. pseudonimin e atë Sh. Gjeçovit *Lkêni i Hasit*) përballë toskërishtes *liqeri a lëqeri* “liqeni”<sup>489</sup>.

Për sa u tha deri më tani, ne nxjerrim përfundimin e parë se historikisht toskërishtja që në zanafillën e vet nuk e ka patur dukurinë e hundorësisë, kjo ngjan të jetë vetëm tipar i gegërishtes, bile një tipar që e dallon njërin dialekt nga tjetri.

\* \* \*

Megithëse autori ka radhitur në mënyrë kronologjike fakte të të gjitha llojeve, që kanë të bëjnë më tepër me historinë e Shqipërisë, e shumë më pak me gjuhën shqipe e me historinë e saj, i kanë rrëshqitur pasaktësi, mungesa etj. Ai përmend p.sh. defterët e kadastrës osmane të vitit 1431 e 1485, po harron tjetrin e vitit 1467 (*Lufta shqiptaro-turke në shek. XV*, Burime osmane, Tiranë, 1968).

Po ajo që të lë të dyshosh se Lloshi i ka rënë lehtë rrugës për shkrimin e artikullit, për të cilin po flasim, është shënimi ku thuhet: “Në Kuvendin e Arbërit përmendet për herë të parë emri i sotëm i *shqiptarëve* dhe i gjuhës së tyre”. Ngjan që veç Xh. Lloshi nuk e paska marrë vesh ende se emri *shqiptar* përmendet për herë të parë te *Fjalori italisht-shqip* i Francesco Maria da Lecce në vitin 1702. Në veprën e vet *Shqiptar* (2010) Bardhyl Demiraj ka vënë si objelo të saj këtë thënie: “*Këtë ... o shqipëtar i*

përjasje me tjetrën *âj* përkat. *ënjtem*) nuk është e drejtë, ose duhet shpjeguar përse në të gjitha këto të folme, qoftë të gegërishtes, të toskërishtes dhe të diasporës, shqiptohet me *a*-të hapët johundore; pra del “jashtë rregullës” (siç!).

<sup>488</sup>Khs. *liqêth-i* “liqë i vogël” me përdorim në Malësi të Madhe (Gazulli, *Fjalorth i ri*, Tiranë, 1941, f. 493). Te “Meshari” i Buzukut brenda një faqeje shkruhet disa herë *liqê* (khs. *ndë liqê të luanjet; E ndë liqê ishnë gjashtë luanj; qi anshtë ndë liqê; e vu përmbi liqêt; mbë liqêt* LX/III 191. Te P. Mazrreku “*lago, lechee (= lëqê)*” (K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe* III, Shkodër, 2000, f. 24), që pas gjithë gjasësh duhet lexuar *lëkê*.

<sup>489</sup>Duke krahasuar *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 1954 me atë të vitit 1980 ndeshim në këto trajta:

<i>barbû - barbuni</i> f. 28	<i>barbû/n/,~i</i> f. 100	<i>hutî - hutini</i> f. 176	<i>hutî/n/,~i</i> f. 704
<i>bibâ - bibani</i> 36	<i>bibân,~i</i> 138	<i>kashû - ni</i> 205	<i>kashûn,~i</i> 796
<i>breshkâ - breshkani</i> 46	<i>breshkân,~i</i> 176	<i>lavërdâ-lavërda</i> 261	<i>lavërdân,~i</i> 956
<i>flakadâ - flakadani</i> 122	<i>flakadân,~i</i> 82	<i>vidâ - vidani</i> 610	<i>vidân,~i</i> 2162

Ndërkaq fjalët *hosten-i* (174), *liqen-i* (273), *vigan-i* (611) të *Fjalorit* 1954, dalin njëjloj me atë të vitit 1980: *hostên,~i* (693), *liqên,~i* (1003), *vigân,~i* (2163).



*dashun e shkrova jo për zotininë tande, qi di mâ fort se unaj vetë për vetëhe*” (Fr. M. da Lecce, 1702).

Po sjell këtu përfundimin e shkrimit të gjatë të Demirajt, për t’i kujtuar Lloshit se si duhen trajtuar këto çështje kaq delikate për historinë e gjuhës shqipe.

Pas një parashtrimi, analize dhe shqyrtimi të hollësishëm, Demiraj arrin në përfundimin se: “... përhapja dhe përgjithësimi i emrit tonë etnik *shqiptar* është konkretizimi gjuhësor i reagimit vetëmbrojtës që zhvilloi vetë etnosi *shqiptar* gjatë shek. XVII-XVIII, në të cilin besimi fetar (disallojësh, por aspak sipërfaqësor) dashur pa dashur i la vend gjuhës amtare, e cila krahas hapësirës jetike kompakte dhe traditave jetësore shqiptare – u shndërrua në identifaktorin themelor brenda matriksit të kulturës etnike shqiptare. Kemi të bëjmë pra me një proces sa të habitshëm, aq edhe të mahnitshëm etnogjenetik, sepse paraqitet jo vetëm një ndër më të hershmit në Europë, por mbetet edhe sot e kësaj dite i pashoq në bashkësinë e popujve ballkanikë.”<sup>490</sup>

Një parashtrim dhe një analizë të hollësishme të problemit të shtruar më lart për dokumentimin e prejardhjen e *shqip*, *shqiptar*, *Shqipëri* e gjejmë edhe në artikullin e gjatë të Lukës, titulluar *Alban, Arbën/r/, Arbën/r/i dhe shqip, shqiptar, Shqipëri*, botuar në vëll. “Studime gjuhësore” XV, Shkodër, 2013.

\* \* \*

Në etapat e fundit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe, Lloshi rreshton edhe ngjarje në të cilat ne gjuhëtarët kemi qenë jo vetëm pjesëmarrës, por edhe protagonistë të tyre. Për fat të keq, Lloshi, nuk mjaftohet me temën e ngjarjes, por nis komentet e veta, thellësisht politike e të shtrembëruara, duke treguar se i ka mbetur ora në vitin 1990 e, gjithashtu, duke dëshmuar se në trurin e tij ka të formatuar vetëm një program, atë të partisë së punës, duke qenë tërë kohën beniamin i saj. Sepse është pikërisht Xh. Lloshi ai që në SF 4, 1988, f. 27, duke folur për “Tipare

---

<sup>490</sup> B. Demiraj, *Shqiptar*, po aty, f. 73.

të gjuhës e të stilit në veprat e Enver Hoxhës”, ka shkruar se “... *gjuha e sotme shqipe ka vulën e Enver Hoxhës.*”

Për të konkretizuar mendimin e mësipërm po marr dy shembuj.  
Autori shkruan:

**“b) Etapa e kontestimit të gjuhës standarde nga viti 1992.** Përpjekje për ta përmbysur gjuhën standarde. Synimi i një grupi të ngushtë për të realizuar ndarjen në dy gjuhë të veçanta, siç ishte projekti serb për një gjuhë tjetër ‘shiftarski’, bashkë me krijimin e një kombi tjetër shqiptar ...” (f. 28)

Pak më poshtë:

“Përpjekje për të përpunuar një variant të përgjithësuar të gegërishtes së shkruar. Orvatje për ta cënuar standardin në disa pika, që të hapet rruga për ndryshime të mëvonshme rrënjësore.” (f. 28)

Siç shihet frazat e mësipërme të kujtojnë gjuhën e prokurorëve të partisë së punës, që shihnin kudo grupe armiqësore, që duheshin dënuar. Për të dy rastet unë do të sjell të vërtetën e zhvillimit të ngjarjeve.

1. Në vitin 1992 në Shkodër u zhvillua një tubim, që u emërtua “Tryezë e rrumbullakët”. Unë vetë kam qenë ideatori dhe drejtuesi i saj. Për këtë tubim të Shkodrës është shkruar shumë, mbarë e prapë, por unë po jap vetëm një pjesë të vogël të një artikulli, botuar në “Studime gjuhësore” VII (Shkodër, 2002) e që mban titullin “Gjuha letrare shqipe në rrjedhë të kohëve”:

Është folur, përfolur e shpërfolur shumë këto kohët e fundit në shtypin periodik për pikëpamjet e gjuhëtarëve shkodranë ndaj “gjuhës letrare kombëtare të njësuar”. Ndër këto shkrime, më tepër se një analizë të mirëfilltë shkencore, ka pasur “luftë llogoresh” e “vringëllim armësh”, natyrisht shoqëruar edhe me sharje, diku më të lehta e diku më të rënda. Po mbi të gjitha ka patur keqinterpretime të qëllimshme. Prandaj, para se të nis shtjellimin e mendimeve të mia, dua të rreshtoj “disa aksioma”, të cilat do të më përligjin për qëllimin tim të mirë.

Së *pari*, gjatë gjithë historisë së gjuhësisë shqiptare, gjuhëtarët gegë janë përpjekur në mënyrë të ndërgjegjshme për njësimin e gjuhës shqipe. Dhe jo vetëm kaq, po ata edhe kanë punuar me këmbëngulje në këtë drejtim. Tjetër, pastaj, është rruga që kanë ndjekur për ta realizuar këtë njësim.

Së *dyti*, asnjë gjuhëtar shkodran nuk e ka mohuar e as kundërshtuar gjuhën letrare kombëtare të njësuar, pavarësisht se ajo ka qenë për ta pa asnjë dyshim “toskërishtja letrare” e ngritur në standard. Shqetësimi i gjuhëtarëve shkodranë ka qenë e vazhdon të jetë edhe sot “mohimi” i kryedialektit gegë dhe - ajo që ka dëmtuar rëndë kulturën tonë kombëtare - ndalimi i shkrimit të tij pas vitit 1972.

Së *treti*, në të tre institucionet kryesore të Shkodrës: në Universitet, në teatër dhe në radio shkruhet dhe flitet toskërishtja letrare.

Së *katërti*, pothuaj të gjithë gjuhëtarët e Shkodrës shkruajnë në gjuhën letrare të njësuar tash më shumë se 20 vjet pa u ankuar, sepse toskërishtja është dialekt i gjuhës shqipe.

Faktet e mësipërme duhet të mbahen mirë parasysh para se të vihet gojë mbi gjuhëtarët e Shkodrës edhe kur ata kërkojnë “debat e diskutim”. Grekët e vjetër thonin se çdo njeri mund ta gjejë të vërtetën përmes diskutimit. Dhe ne pikërisht “të vërtetën” po kërkojmë. Në fund të fundit diskutimi i lirë e miqësor është gjithnjë shenjë qytetërimi.

.....

Tani edhe dy fjalë për *Deklaratën* e gjuhëtarëve të Shkodrës. Pikërisht kur ne morëm vesh se një pjesë e mirë e gjuhëtarëve të Shkodrës qenë mënjanuar qëllimisht nga konferenca e vitit 1992, vendosëm të bëjmë një tubim shkencor për të shpalosur mendimet tona. Këtë tubim, që u mbajt më 24 korrik 1992, ne e quajtëm “Tryezë e rumbullakët”. Tema e saj qe: “Probleme të gjuhës letrare kombëtare”. E organizonte Muzeu Historik dhe Katedra e Gjuhës Shqipe e Universitetit “L. Gurakuqi”. Përveç gjuhëtarëve shkodranë, merrnin pjesë edhe tre gjuhëtarë të ftuar nga Instituti i Gjuhësisë (B. Beci, S. Mansaku e E. Lafe). I ftuar qe edhe prof. Arshi Pipa, që ndodhej në Shkodër rastësisht. Ky tubim vazhdoi pandërprerje plot gjashtë

orë. Në fund u lexua një deklaratë. Të gjitha diskutimet dhe debatet janë incizuar. *Deklarata*, që paraqiste në mënyrë të koncentruar mendimet e gjuhëtarëve shkodranë për gjuhën letrare të njësuar, u botua në gazetën “Shkodra” (6 gusht 1992), në gazetën tjetër lokale “Besa” si edhe në një gazetë me emrin “Libertas” (vjeshtë, 1992).

Për këtë *Deklaratë* është folur e shkruar shumë, por gjithsesi a priori, sepse autorët e këtyre shkrimeve nuk e kanë njohur tekstin origjinal të botuar, siç thashë, në gazetën lokale “Shkodra”. Do të mjaftonte vetëm puna që *Deklarata* është botuar në gjuhën letrare të njësuar për të rrëzuar të gjitha “mallkimet” e lëshuara kundër saj.

2. Për akuzën e dytë, kemi tani si përgjigje një botim zyrtar, që titullohet: “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, botim i QSA (Qendrës së Studimeve Albanologjike) dhe Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ku janë regjistruar “Aktet e konferencës shkencore, Durrës, 15-17 dhjetor 2010”.

Konferenca u zhvillua në tri ditë (15-17 dhjetor) në 5 seanca ku u mbajtën 10 referate dhe 29 kumtesa që, së bashku me fjalën e hapjes, bëheshin plot 40 copë.

Në këtë konferencë kumtuam 7 akademikë dhe 28 profesorë. Të gjithë pjesëmarrësit ishin gjuhëtarë.

Të gjithë pjesëmarrësit në këtë konferencë jo vetëm mbajtën krejt lirshëm e pa asnjë kufizim kumtesat e tyre, por edhe i argumentuan ato më tej veçanërisht ndër diskutimet e lirshme e pa asnjë kufizim.

Çfarë t’i themi prof. Lloshit, t’i fusim në burg tërë këta njerëz të ditur, sepse kështu do ti?!

Sipas prof. Lloshit, edhe anëtarët e Komisionit Ndërkademiq, që po përpiqen ta përmirësojnë më tej standardin, do të kenë të njëjtin fat, sepse po “orvaten për ta cënuar standardin në disa pika, që të hapet rruga për ndryshime të mëvonshme rrënjësore.” (f. 28)

Në një diskutim të mbajtur në “Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare” (Tiranë, 1995, f. 748), unë kam thënë, ndërmjet të tjerash:

“Më vjen mirë që më jepet rasti për herë të parë të flas lirisht, të shpalos pikëpamjet e mia dhe të gjuhëtarëve shkodranë, që disa herë i kam përfaqësuar

në diskutimet për problemet e gjuhës letrare kombëtare të njësuar.

Them "më vjen mirë", për arsye se kohët e fundit, veçanërisht në shtyp, është folur, përfolur e shpërfolur mbarë e mbrapsht, kryesisht ndaj meje e ndaj gjuhëtarëve shkodranë. Unë po nisem nga një fakt themelor, mbi të cilin do të ndërtoj edhe diskutimin tim.

Në Shkodër, në të dy institucionet qendrore, në Universitet dhe në Radio-Shkodra, shkruhet e flitet "toskërishtja letrare", kurse në Radio, të gjitha emisionet jepen po në gjuhën letrare të njësuar.

Pikëpamjet tona, të cilat i kemi shprehur qartë në një "Deklaratë" (në korrik të vitit 1992), nuk janë ndikuar aspak nga ato të prof. Arshi Pipës. Prandaj nuk miratojmë aspak mllfet e fundit të një artikulli (interviste), botuar në "Aleanca", ku gjuhëtarët shkodranë quhen "donkishotër", pa moral dhe, mbi të gjitha, se po zbatojnë politikën serbe. Unë jam në gjendje t'i jap një përgjigje "shokut" Jorgo Bulo, po nuk është as vendi e as koha këtu për të bërë politikë. Besoj se kaq mjafton për këtë problem ..."

Do të më vinte mirë t'i rikujtoj prof. Lloshit, atë që i kam thënë prof. Rexhep Ismajlit për problemin në fjalë:

Në revistën "Studime filologjike" (nr. 1-2, 2003) lexuam me kënaqësi një shkrim të prof. Rexhep Ismajlit me titull *Rreth shqipës standarde, kodeve të tjera dhe kontestimeve*. Mirëpo, mbetem tejet të habitur kur lexuam sa më poshtë: "*Jehona e vërejtjeve të Pipës në Kosovë ka arritur drejtpërsëdrejti, në fillim përmes kritikave, më vonë përmes përkrahësve të ideve të tij në Tiranë, por me shpesh e përthyer përmes kontestimeve të grupit të Shkodrës, ose të tjerëve më vonë. Sa kam parë libri në terësi është lexuar shumë pak, ndërsa diskutimet janë bërë kryesisht në bazë të komentimeve të të tjerëve, kështu që jo gjithëherë janë hetuar të gjitha pasojat e idesë së tij për dy gjuhë letrare*".

Për fat të keq prof. Ismajli ishte krejtësisht i painformuar. Ai nuk njihte as zhvillimin e ngjarjeve këtu në Shqipëri e as literaturën e plotë, shkruar gjatë këtyre viteve. Mbështetej vetëm në literaturën zyrtare, e cila paraqiste vetëm pikëpamjet e njëjës palë.

Duke qenë pjesëmarrës në të tëra tubimet e kryera për këtë qëllim, duke qenë njëkohësisht nismëtari i tubimit të gjuhëtarëve shkodranë të vitit 1992 si edhe hartuesi i *Deklaratës së gjuhëtarëve të Shkodrës*, mund t'i them prof. Ismajlit se nuk ka pasur asnjë grup të *Shkodrës*. Prof. Pipa ka qenë vetëm i ftuar në këtë tubim si të gjithë të tjerët; ndërmjet tyre edhe tre gjuhëtarë të Institutit të Gjuhësisë, si edhe pedagogët e Universitetit të Shkodrës (me përkatësi të ndryshme partiake). Tubimin e kam drejtuar unë vetë dhe prof. Pipa ka folur vetëm si pjesëmarrës, duke respektuar kohën që kishte në dispozicion. Gjithashtu ai ka nënshkruar *Deklaratën* e dalë prej këtij tubimi njëloj si të tjerët.

Prof. Ismajli do të bënte mirë t'i risillej edhe një herë këtij problemi, për të mos e akuzuar në të ardhmen si anakronik. Ndërkaq, duke ndjekur një këshillë të vlefshme të tij<sup>491</sup>, unë do t'i rekomandoj literaturën e nevojshme, të cilën ai nuk e përmend gjëkund. Nuk bëhet fjalë këtu për interpretime, po për historinë e zhvillimit të ngjarjeve.<sup>492</sup> Historia ndërtohet me fakte e dokumente, aq më tepër kur këto ngjarje i përkasin dhjetë-pesëmbëdhjetë viteve të fundit.

Praktikat e sotme të përjashtimit të mendimit alternativ do të sjellin në të ardhmen vetëm pështjellim. E kjo do të jetë në dëm të kulturës kombëtare shqiptare.<sup>493</sup>

\* \* \*

Përfundimisht mund të themi se shkrimi i prof. Xhevat Lloshit me titull “Periudhat historike të shqipes”, vlerësohet si një punim diletant, deklarativ, pa një bibliografi serioze e pa një dokumentim të argumentuar. Ndarjet që ky i bën historisë së gjuhës shqipe, janë arbitrare, pa kurrfarë mbështetjeje gjuhësore, sepse autori, duke mos e njohur sa e si duhet historinë e gjuhës shqipe (përkant. strukturën e saj, me ndryshimet që ajo ka pësuar gjatë kohëve), punon e argumenton “me vesh”, pa na thënë se ku mbështetet në këto argumentime. Duke i dhënë përparësi kryesisht

<sup>491</sup> “Unë mendoj se gjëja e parë që do bërë me qëllim të pasurimit të shqipes është së pari të dëgjojmë mirë njëri-tjetrin ...”, gazeta “Java”, Prishtinë, 1 kallnor, 2002, f. 26.

<sup>492</sup> D. Luka, *Studime gjuhësore* VII, Shkodër, 2001, f. 11-43. *Studime gjuhësore* VIII, Shkodër, 2003, f. 7-59.

<sup>493</sup> D. Luka, *A mund të zgjerohet baza dialektore e shqipes standard*, botuar në përmbledhjen “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Tiranë, 2011, f. 409.

arkeologjisë e më pastaj historisë, e gjithashtu dukurive të tjera jashtëgjuhësore, punimi degjeneron në një renditje të rëndomtë datash e faktesh, që nuk japin asnjë ndihmesë për temën në fjalë. Punimi me këtë mënyrë merr karakter enciklopedik shkollor, ku mungon dokumentimi i saktë i çdo dukurie gjuhësore të marrë në shqyrtim, që në një punim shkencor të mirëfilltë është imperativ. Ndarja e historisë së gjuhës shqipe në tri periudha: *e vjetër, e mesme, e re* paraqitet jo vetëm naive, por edhe e thjeshtëzuar e tepër shkollore. Kjo ndarje, e kopjuar nga greq. e vjetër, në shqipe nuk zbatohet dot. Në greq. i kemi të dokumentuara të tria këto periudha, ndërsa në shqipe dokumentimi nis me “Mesharin” e Buzukut (viti 1555). Prof. Lloshi nuk përfill as traditën shqiptare në këtë fushë të dijes dhe as literaturën e shumë vendëse. Duke menduar, siç thotë edhe vetë ai, se po bën “Një periodizim mbi baza bashkëkohore në koherencë me gjuhët moderne të lëvruara të Europës Perëndimore”, ai na ka servitur një krahurë të vërtetë faktesh e datash, një amalgamë dukurish gjuhësore, të shumtën e rasteve të pakontrolluara e pa adresa të sakta.

Po të shtohen këtu edhe ndërhyrjet e koncepteve të tija politike, të cilat veçanërisht në shkencat shoqërore janë jo vetëm të papranueshme, por edhe të dëmshme, vlera e punimit të prof. Lloshit i afrohet zeros.

Po diçka nuk po e kam të qartë, përse e ka sjellë për ta botuar në “Buletin shkencor” të Universitetit të Shkodrës “L. Gurakuqi”?

## RECENSIONE

**MATTEO MANDALÀ: LEKË MATRANGA: NJERIU,  
KOHA DHE VEPRË.(ME BOTIMIN KRITIK TË  
VARIANTEVE DORËSHKRIM E TË SHTYPUR TË  
VEPRËS *E MBËSUAME E KRËSHTERË*, 1592.  
(BOTIME OMBRA GVG, TIRANË, 2013).**

Në një hapësirë kohore prej pak muajsh, pas botimit në gjuhën shqipe të një përmbledhjeje trajtesash mbi drejttime të afërta gjurmimesh në fushë të albanologjisë<sup>494</sup>, studimeve filologjike mbi tekstet e vjetra shqipe u shtohet botimi në një dimension të ri i një veprë të rëndësishme që realizon lidhjen mes veprave të autorëve të traditës veriore dhe shkrimeve të vjetra shqipe të botës arbëreshe të Italisë së Jugut. Studimi që e shoqëron atë përfaqëson gjithashtu një ndër arritjet më të rëndësishme në fushë të filologjisë së tekstit dhe të studiuesit që e solli në një fazë të re shkallën e kërkimit mbi autorin e shqipërimin të një katekizme që në kohën e vet shërbente dhe si doracak edukativ për moshat shkollore.<sup>495</sup>

Ekspozeja e detajuar me të cilën autori ka introduktuar paraqitjen e veprës së Matrangës na jep të kuptojmë mbi një rrugëtim kompleks që studiuesi ynë ka përshkuar shpesh dhe në bashkudhëtim me kërkues të tjerë dhe me vepra të tjera që mbështetën dhe që e çuan në burime që ndoshta dhe për një metodologji krejt të ndryshme u kishin munguar paraardhësve të tij.

Dhe në lidhje me Matrangën gjurmimet arkivore janë një orientim që sqarojnë një sërë çështjesh, përfshirë ndriçimin e rrethanave themelore jetësore të autorit, problematikë kjo që ndeshet pothuaj në çdo rast kur bëhet fjalë për autorët e letërsisë së vjetër shqipe. Autori i është kushtuar

<sup>494</sup> Mandalà M., *Studime filologjike mbi letërsinë romantike arbëreshe*, botime Naimi, Tiranë, 2012.

<sup>495</sup> Shih në veçanti Mandalà M., *Lekë Matranga: Njeriu, koha dhe vepra. (me botimin kritik të varianteve dorëshkrim e të shtypur të veprës *E Mbësuarë e krështerë*, 1592, Botime Ombra GVG, Tiranë, 2013, Parafjalë, f.5-10; Hyrje/Çështje paraprake, po aty, f.13-26.*



plotësisht kësaj çështjeje duke konsideruar objektivisht dhe kontributet paraardhëse të studiuesve shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë ndjekur platforma të ndryshme kërkimi, fakt ky që ka ndikuar dhe në rezultatet e gjurmimeve në lidhje me tekstet dhe personalitetin e autorit. Megjithatë, duhet theksuar fakti që studiuesi Mandalà ndoqi me shumë këmbëngulje çdo problem objektiv që një kërkim i tillë shtron, objektivitet ky që shënon dhe kthesën që morën gjurmimet në lidhje me këtë autor.

Puna me një autor si Matranga nuk presupozon vetëm kërkime arkivore që lidhen me jetën, formimin dhe veprimtarinë klerikale të tij. Mënyra e paraqitjes së veprës së tij, kërkimi, shqyrtimi dhe klasifikimi i bocave dhe i dorëshkrimeve origjinale, përcaktimi i ecurisë kronologjike përkatëse, janë kompetencë e mirëfilltë e filologut të tekstit që ndërkohë ndihmon çdo hulumtues të historisë së gjuhës dhe letërsisë.

Kontributi i Matrangës i parë dhe ai në një kontekst mjaft specifik historik lidhet me tekste natyra e të cilave paraqitet më e thjeshtë se ajo e librit të Gjon Buzikut. Por prirja e tij për arsye të ndryshme vijon të përqafohet vite më vonë dhe prej prelatëve të tjerë shqiptarë. Pjetër Budi operon me katekizmën e Bellarminos, shqipërim ky që i lejoi dhe të shprehte aftësitë e tij prej vjershëtori dhe shkrimtari. Doktrinat dhe manualet kateketike vijnë të shqipërohen dhe prej prelatëve pasardhës, gjithnjë në vazhden e një stafete që vjen e konsolidohet dhe me vetë rrugëtimin që ndërkohë ka marrë tradita e shkrimit shqip.<sup>496</sup>

Kontributi i profesor Mandalasë plotëson një panoramë që përfshin historinë e letërsisë së shkruar shqiptare, historinë e letërsisë arbëreshe, por dhe bën të mundur të shihen më së afërmi të dyja këto të fundit, me elemente që i afrojnë dhe kontribuojnë drejt një vështrimi gjithëpërfshirës. Në të vërtetë, mjaft studiues kanë kontribuar në drejtim të studimit dhe afrimit me periudhën në fjalë dhe kjo natyrshëm ka bërë të konkurrojnë njëherësh disiplina që përherë janë kufizuar por dhe janë ndihmuar në mënyrë reciproke.

Interesi për të është shfaqur në organet tona të shtypit dhe në botimet shkollore në një kohë kur duket se po përjetohej një zgjim i vrullshëm i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e gjurmimit por dhe hulumtimit të mirëfilltë shkencor të teksteve të vjetra shqipe. Në vitet '30 të shekullit të

---

<sup>496</sup> Për vetë periudhën në të cilën është realizuar vepra në fjalë ndër të tjera ofron mundësi shqyrtimi dhe për filologë të gjuhëve romane dhe pse jo për studiues të leksikut specifik që ngërthen çdo ndërmarrje e kësaj natyre. Në këtë kuptim, kontributet e gjuhëtarëve tanë, studiues të leksikut historik të gjuhës sonë, i kanë bërë një shërbim të vyer dhe zbërthimit të teksteve të Matrangës.

kaluar E.Çabej e introdukton natyrshëm në tekstet me destinacion shkollor por që dhe sot e kësaj dite përmbajnë më të mirin projekt për një sprovë të historisë së letërsisë së shkruar shqipe.<sup>497</sup> Justin Rrota e përfshin në trajtesat që më tej do të përmbahen dhe në përmbledhjet e realizuara nën stemën e Botimeve Françeskane me tematikë historinë e alfabetit shqip dhe studimin e teksteve të vjetra shqipe. Të një tjetër dimensionit dhe të lidhura drejtpërdrejt me tekstet e veprës janë vështrimet kritike që do të mbajë vite më vonë dhe Selman Riza ndërsa analizon dhe arritjet e paraardhësve të vet. Pavarësisht arritjeve konkrete të secilit në lidhje me gjurmimet mbi autorin dhe veprën, në këtë studim hyrës gjindet një evidentim i detajuar i një historiku kërkimesh që kontribuan gjithsesi dhe në drejtim të një metodologjie kërkimi që do të çonte studiuesin në arritjet e deritanishme. Vendosija e veprës së Matrangës pas librit të Buzukut në pikëpamje metodike dallon në veçanti filologun Mario Roques,<sup>498</sup> Gaetano Petrottën, Justin Rrotën<sup>499</sup>, E.Çabejn<sup>500</sup> e më tej në ditët tona dhe Robert Elsie në që i trajton autorin dhe veprën në studimet me vështrim historiografik dhe analitik mbi letërsinë e shkruar shqipe.<sup>501</sup> Por qasja mes këtyre dy veprave aq të rëndësishme si për përmbajtjen përkatëse, momentin e realizimit të tyre ashtu dhe për elemente të ndërtimit të gjithsecilës, risjell vëmendjen ndaj një këndvështrimi të orientuar nga rrethanat e fillimit të shkrimit shqip dhe përkimet e mundshme mes tyre.<sup>502</sup>

<sup>497</sup> Çabej E., *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe, (ribotim anastatik i pajisur me parathënie nga Ledi Shamku Shkreli)*, Botime Çabej, Tiranë, 2009, f. 26; f. 65.

<sup>498</sup> Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f.19-21.

<sup>499</sup> Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp (Pasqyra e shembuj për shkolla të mjesme)*, Shkodër, Shtypshkroja Françeskane, 1936, f.10-11.

<sup>500</sup> Çabej E., *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe, (ribotim anastatik i pajisur me parathënie nga Ledi Shamku Shkreli)*, Botime Çabej, Tiranë, 2009, f.26.

<sup>501</sup> Në një periudhë të afërt me sprovat e para në këtë fushë të rëndësishme gjurmimesh, studiuesi Filip Fishta, në proces të kërkimeve të tij në fushë të bibliofilisë, gjen rast të bëjë fjalë për një sërë personash që mbajnë këtë mbiemër dhe duket se kanë një orientim të përbashkët në drejtim të ushtrimit të skriptoratisë apo shkrimtarisë në lidhje me shkrimet fetare apo dhe janë misionarë që kanë shërbyer në kontekstin shqiptar. Një personazh të cilit i kushtohet një kapitull i tërë në përbërje të pjesës së dytë të studimit të hieromurgut Nilo Borgia mbi Misionin e murgjve bazilianë në jug të vendit tonë në shekujt XVI-XVIII është dhe Basilio Matranga. E gjithë kjo na bën të kuptojmë rreth një prirjeje a nxitjeje që kohë më parë dhe në një kontekst paraprak dhe autori i shqipërimit të kësaj katekizme pati që të jepte një kontribut modest, por që mbeti në themel të trajtesave me vështrim historiografik dhe analitik të historisë së shkrimit të këtyre viseve.

<sup>502</sup> Mandalà M., Tiranë, 2013, *botim i cituar, Kreu i njëmbëdhjetë: Lexuesit dhe qarkullimi i veprës E Mbësuarë e krështerë*, f.534: *Nga ana tjetër, megjithëse janë*

Studiuesit arbëreshë, pararojë e një iniciative për ta evidentuar më së miri promovimin e identitetit tonë kombëtar, lanë gjurmë të pashlyera në këtë drejtim duke qenë të pranishëm në revista evropiane dhe në të përkohshme shqiptare, dhe siç shihet akoma dhe sot, kanë lënë trashëgim dhe dorëshkrime të cilave në mënyrë të paevitueshme u ka ardhur koha të dalin në dritë për të thënë më shumë për atë kohë që për të gjithë ne mbetet në themel të sqarimit të rrethanave të inicimit të shkrimit shqip dhe traditës së lëvrimin të letërsisë së shkruar shqipe.

Me përmbajtjen e saj vepra e Matrangës dëshmon në veçanti dhe për zhvillime të arsimit në viset arbëreshe dhe për impaktin e teksteve të katekezës në ato vende pikërisht në një periudhë të rëndësishme dhe për historinë e kishës. Marrja në shqyrtim e problematikës së qarkullimit dhe fatit të mundshëm të teksteve të përmbajtura në të përbën një prej trajtesave më të rëndësishme që përmban botimi në fjalë, duke qenë se ngërthen njëherësh dhe momente të rëndësishme të historisë së librit dhe të traditës së transmetimit tradicional të këtyre teksteve në viset e Horës.<sup>503</sup>

Studimi aq i rëndësishëm i Matteo Mandalasë vjen këtë herë i shqipëruar në mënyrë mjeshtërore nga filologu Gëzim Gurga, një prej njohësve më të mirë të veprimtarisë së tij shkencore, ndër të tjera kujdesues i një veprë në themel leksikografike që i bashkohet këtij arsenali dokumentimesh të një tradite shkrimore që ceku disa fusha, përfshirë atë të qasjes mes tyre të gjuhëve që ishin në kontakt falë një konteksti jo vetëm gjeografik.

Përveç se afron lexuesin me maratonën e përshkuar në kërkim të një pasqyrimi më besnik të jetës dhe mbi të gjitha të veprës së Matrangës, të një dokumentimi më të saktë të çdo detaji që na lidh me këtë autor,

---

*përkthime tekstesh fetare, këto vepra kanë ngjallur interes edhe nga pikëpamja letrare. Në fakt të dyja trajtohen gjerësisht në të gjitha tekstet e historisë së letërsisë shqipe, pa përmendur studimet e shumta letrare që u janë kushtuar atyre. Do të ishte e tepërt të renditnim këtu të dhëna të hollësishme, të cilat do të kërkonin medoemos një aparat bibliografik që do të duhej të mbulonte më se një shekull studimesh ndërdisiplinore. Gjithsesi do theksuar se interesi për këto dy vepra jo vetëm që i ka ngritur ato në nivelin e veprave "klasike" të letërsisë së vjetër shqipe, krahas veprave të Budit, Bardhit e Bogdanit që u botuan një shekull më vonë, por u siguroi këtyre dy veprave dhe autorëve të tyre një sukses të gjithkrahshëm. Përshkrimi i këtij suksesi që mund të përbënte një temë me interes për një studim të ardhshëm me objekt njohjen e horizontit të pritjes së dy veprave, përgjithësisht nxjerr në pah fatin "e përbashkët" që ato kanë pasur, në kuptimin që janë bërë objekt interesi jo vetëm mirëfilli shkencor, por edhe thjesht divulgativ.*

<sup>503</sup> Mandalà M., *botim i cituar*, Tiranë, 2013, *Kreu i njëmbëdhjetë: Lexuesit dhe qarkullimi i veprës E Mbësuaame e krështerë*, f. 538-539.

shqipërimi në fjalë i përmbahet në mënyrë besnike një regjistri të plotë terminologjik dhe një nomenklature që lidhen me një botë vërtet të përtej Adriatikut, por që nuk mungoi të linte gjurmë dhe në viset tona, veçanërisht në shekujt XVI-XVIII.

Duke pasë arritur në këtë pikë me kërkimet dhe pasqyrimin e veprës së Matrangës, autori i këtij studimi afirmohet sërish si një ndër gjurmuesit më këmbëngulës të teksteve të vjetra shqipe të viseve arbëreshe, një evidentues skrupuloz i arsenalit të formave më të hershme të lutjeve më themelore të liturgjisë, të cilat përfaqësojnë dhe format më të arrira poetike të realizuara nga popullsitë e atjeshme që në shekuj më të hershëm por dhe përbëjnë një qasje që nxjerr në pah zhvillime paralele që në letërsinë tonë u diktuan nga kushte dhe rrethana historike vendimtare për ecurinë e saj.

Evalda Paci

**ARSHI PIPA DHE VEPRA E TIJ**  
**“TRIOLOGJIA ALBANIKA”**  
**(Shtypshkronja “West Print”, Tiranë, 2013)<sup>504</sup>**

Studiuesi dhe poeti Arshi Pipa (1920-1997), vite me radhë është njohur si i arratisur politik, kundërshtar i vendosur i regjimit komunist dhe kritik i kulturës shqiptare, sidomos i metodës krijuese të realizmit socialist dhe i politikës gjuhësore në Shqipëri.<sup>505</sup> Ai shquhet edhe si lëvrues i memuaristikës, me përmbledhjen “**Libri i burgut**” (1959). Pipa lindi në Shkodër, në një familje me origjinë libohovite; i ati diplomuar në Stamboll, ishte jurist i Drejtorisë së Drejtësisë në Shkodër; i vëllai, Myzaferi, u bë edhe ai jurist (avokat), arriti të botonte revistën “**Fryma**”, ku shprehu pikëpamjet e tij përparimtare politike e shoqërore. Mësimet e mesme i mori në Kolegjin Saveriane, në Liceun e Shtetit në Shkodër; kurse studimet e larta i ndoqi në Universitetin e Firencës, ku edhe doktoroi në filozofi me tezën “**Morali dhe feja tek Bergsoni**”. A.Pipa kthehet në Shqipëri në vitin 1941 dhe punon mësues filozofie në Liceun e Tiranës, ndërkohë që jepte mësim edhe në licetë shtetërore të Durrësit e të Shkodrës. Pas luftës, Pipa ishte mësues i italishtes dhe i gjuhës shqipe në Kolegjin e Mësuesve, ndihmoi në organizimin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë e bashkëpunoi me revistën “**Bota e Re**”, ku botoi artikuj e studime letrare, si shkrimi i njohur për Migjenin. Pipa arrestohet nga Sigurimi i Shtetit më 1946 dhe pas dënimit arrin të futet në arsim, deri në kohën e arratisjes, kur emigron në SHBA. Atje, Arshi Pipa nis një karrierë të mirëfilltë akademike: në fillim, në kolegjin Philander Smith, Little Rock, Arkansas, ku mban ligjërata për filozofinë; drejton departamentin e italishtes në City University të Georgia-s, në “Shkollën e Gjuhëve dhe të Gjuhësisë”, lektor filozofie në “Kolegjin e Arteve të Lira”. Ai u bë shpejt pedagog i gjuhës italiane në Universitetin e Kolumbias (1961-1962), profesor i asociuar në Universitetin e Delfit, Garden City, në Kolegjin e Adelphi Suffolk, ndërsa në vitet 1963-1966 është profesor i asociuar i italishtes, në Universitetin e

<sup>504</sup> Arshi Pipa, Titulli: **Trilogjia Albanika I, Vargu folklorik shqip, ndërtimi dhe gjinitë**; titulli në origjinal: *Trilogia Albanica I, Albanian folk verse: Structure and genre* (botohet më 1978 nga Dr. Trofenik, redaktuar nga Peter Bartl, pjesë e kolanës *Albanische Forschungen*, vol.17, München) (*Përktheu* nga origjinali në anglisht Primo Shllaku); Redaktor: Myftar Gjana.

<sup>505</sup> Arshi Pipa, **Politika e Gjuhës në Shqipëri Socialiste**, Botimet Princi/Albanologji, Përktheu nga origjinali në anglisht Primo Shllaku, në dy variantet shkrimore të shqipes: gegnisht dhe toskërisht, tetor 2010, Tiranë.

Kalifornia-s, drejtues i seminareve të kritikës letrare, po ashtu edhe në gjuhë shqipe (letërsi e folklor) si dhe filozofi romane. Karrierën më të lartë akademike Pipa e arrin në Universitetin e Minesoto-s dhe në Minneapolis-profesor i asociuar dhe profesor në departamentin e gjuhëve romane. Vdes në Washington.<sup>506</sup>

Emri i Pipës është pasqyruar në veprën “Leksikon i shkrimtarëve shqiptarë” (1501-2001) të studiuesit Hasan Hasani.<sup>507</sup>

Arshi Pipa shkroi jo vetëm në shqip, por edhe në italisht, frëngjisht dhe anglisht. Vepra në tri vëllime, që paraqesim në revistën tonë, është hartuar në anglisht dhe sheh dritën e botimit në gjuhën tonë pas **36 vjetësh**; megjithatë në analizë të saj ka çfarë të pohojmë si risi për dijen tonë në fushë të letërsisë, kritikës dhe trajtimit shkencor të mjaft dukurive të krijimtarisë popullore dhe për disa autorë të shënuar të traditës sonë letrare dhe të bashkëkohësisë. Ajo vjen në shqip me përkthimin e shqipëruarve të njohur Abdurrahim Myftiu, Myftar Gjana dhe Primo Shllaku.

Pjesa e parë e trilogjisë “**Vargu folklorik shqip: ndërtimi dhe gjinitë**” (me 183 faqe), përmban çështje teksture të krijimtarisë popullore, studime për vargun, proverbat, gjëegjëzat, disa lloje këngësh, si: këngët magjike, ato fëmijërisht, këngët korale e monodike, vajtimet, vargu epik, rapsodik dhe mbyllet me përfundimet teorike e një bibliografi të pasur, bashkë me treguesin e emrave. Që në parathënie, autori vë në dukje nga e ka burimin shtysa për t’u marrë me studime folklorike, nënvizon faktin se *radhitësit nuk dinin anglisht* dhe i jepet të kërkojë *zemërgjerësinë e lexuesit* për gabimet e kaluara në libër, ashtu siç kishte bërë në shek.XVIII Pjetër Bogdani, kur i kërkonte ndjesë *lektorit*, me një distik të Ovidit:

*Si qua videbuntur casu non dicta latine,*

<sup>506</sup> Disa të dhëna nga jeta dhe veprimtaria e A.Pipës, u morën prej Jonida Çabejt, nga gazeta “**Nacional**”, 15 qershor 2014, f. 3.

<sup>507</sup> Hasan Hasani, **Leksikon i shkrimtarëve shqiptarë** (1501-2001), Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2003, f. 348-349. Këtu autori rreshton këto vepra të A.Pipës: “**Lundërtari**, 1944, Tiranë; **Libri i burgut**, 1959, Romë; **Rusha**, 1968, Muni; **Montale and Dante** (Montale dhe Dante), 1968, Mineapolis; **Meridiana** (Meridiane), 1969, Muni; **Albanian Folk Verse: structure and grene** (Vargu popullor shqiptar: struktura dhe gjinia), 1978, Muni; **Hieronim de Rada** (Jeronim de Rada), 1978, Muni; **Albanian Literature: social perspectives** (Letërsia shqiptare: perspektivat shoqërore), 1978, Muni; **Studies of Kosova** (studime mbi Kosovën), 1984-Nju Jork (me Sami Repishtin); **The politics of Language in socialist Albania** (Politika e gjuhës në Shqipërinë Socialiste), 1988-Nju Jork; **Albanian Stalinism** (Stalinizmi shqiptar), 1990-Nju Jork; **Subversion drejt konformizmit**, 1999, **Veprat 1- 4** 2000, Tiranë.”

*In qua scribebam, barbara terra fuit.*<sup>508</sup>

Autori e nis kërkimin shkencor në mënyrë diakronike, duke u ndalur më së pari në përmbledhjet folklorike më të vjetra, që kanë bërë studiuesit arbëreshë, si: Figlia, Marchiano, Brancati, Camarda, De Rada, Crispi, Petrotta, Dorsa, folkloristët shqiptarë: Zef Jubani, Mitko, albanologët e huaj: Hahn-i, Reinhold-i, Dozon-i, Pedersen-i e G.Meyer-i. Ai njeh kontributin e një brezi tjetër folkloristësh, si: S.Dine, V.Prendushi, Z.Schiro, Scura, Jarni, Gjeçovi, Sirdani, Palaj, Kurti, Cordignano, Valentini, E.Çabej, W.Fiedler-i, R.Sokoli, Ernest Kolqi e Max Lamberci, Doris Stockmann, Stavro Skendi, A.Schmaus,<sup>509</sup> etj. Në disa sythe ndarëse, si *Teksti përballë melodisë, Gojorja përballë tekstit të shkruar, Drejtshkrimi përballë dialektologjisë*, gjejmë shtjellime teorike të nivelit shkencor, veçanërisht rreth rëndësisë së tekstit gojor dhe trajtimit të gjysmëzanores “ë”. Shkruan Pipa: “Ndërtimi i tekstit, detyrë paraprake për çdo hulumtim letrar, është kusht *sine qua non* (i domosdoshëm) për një studim metrik. Struktura e vargut zbulohet në skandim dhe skandimi korrekt hamendëson një lexim korrekt, i cili, nga ana e tij, nënkupton një tekst korrekt. Meqë vargu shqip është theksor-rrokjesor, dmth, i përcaktuar nga numri i theksave si dhe nga numri i rrokjeve në rresht, është e një rëndësie të madhe të dimë nëse ë-ja është fonetike apo vetëm fonematike, si dhe nëse një tog zanor është diftong apo jo. Çështja ndërlikohet edhe më tej po të marrim parasysh se tekstet gojore shqipe janë transkriptuar në tre alfabetë, latin, grek dhe arab.”<sup>510</sup> Më përtej, autori i *Trilogjisë* shpjegon se arbërishtja, si dialekt i toskërishtes, mbeti relativisht statike dhe mund të përbëjë një hallkë lidhëse mes gegnishtes dhe toskërishtes, ajo mban disa tipare “gege” fonetike edhe për rrafshin e metrikës, përndryshe në gjatësinë e zanoreve, kur toskërishtja nuk e përmban këtë dukuri. “Në anën tjetër, nënvizon autori, gegnishtja e ka humbur ë-në, që është tipar i toskërishtes dhe i arbërishtes. Humbja e ë-së kompensohet në gegnishte me anë të zgjatimit të rrokjeve, që i bie ndesh silabizmit. Shumë fjalë në toskërisht që

<sup>508</sup> Arshi Pipa, **Trilogjia Albanika I, Vargu folklorik shqip, ndërtimi dhe gjinitë**; titulli në origjinal: *Trilogia Albanica I, Albanian folk verse: Structure and genre* (botohet më 1978 nga Dr. Dr. Trofenik, redaktuar nga Peter Bartl, pjesë e kolanës *Albanische Forschungen*, vol.17, München) (*Përktheu* nga origjinali në anglisht Primo Shllaku); Redaktor: Myftar Gjana; f. 10. Vargjet latine: “Nëse këtu do të hasni ndonjë fjalë që unë ta kem shkruar e latinisht s’tingëllon, në dhe të huaj jetova.”

<sup>509</sup> Po ai, po aty, f. 13. (“Ein italo-albanisches Lied aus dem Skanderbeg-Zyklus”- Një këngë italo-shqiptare nga cikli i Skënderbeut, në bashkëpunim me M.Camajn.)

<sup>510</sup> Po ai, po aty, f. 15.

janë shumë rrokëshe dhe të theksuara në rrokjen e parafundit, në gegnisht janë një rrokëshe dhe me theks fundor. Të tilla dallime fonetike domosdo pasqyrohen në metrikë.”<sup>511</sup> Këto vërejtje prozodike vijnë e bëhen parakushte për studime të thelluara në metrikën popullore, të cilat do t’i zbatohet me përpikëri Pipa gjatë gjithë hulumtimeve të vargut folklorik apo të melosit shqiptar; bën klasifikimet përkatëse të gjinive në vargje, përndryshe vjershës si ligjëratë e meruar, bazuar në përqasjen **metrike/ametrike**, teksteve homometrike dhe heterometrike, dhe arrin në përfundimin se duhet bërë një dallim *midis sistemit metrik toskë dhe atij gegë, si pasojë e ndryshimeve të tyre fonetike*, skandimi varet nga mënyra se si recitohet teksti, nga mënyra si interpretohet teksti. *Metrika*, shprehet autori, *e ndjek hap pas hapi gjuhën në evolucion e ndryshim të vazhdueshëm*..<sup>512</sup> Kultura e autorit, në vështrimin shkencor, nga çështja në çështje, vjen e rritet, që nga trajtimi i metrikës vendase e të huaj, metrikës së natyralizuar (tërësi e rimave dhe e skemave metrike të huazuara), me të dhëna që qëndrojnë mes të dy metrave, mes **beyt**-ës turke dhe **desetarac**-it serbo-kroat.

Është interesante të vëmë në dukje se për poezinë shqipe ndër kohëra autori ka dalluar disa tradita metrike (siç i quan ai), ndër të cilat veçon: a). traditën metrike italo-shqiptare (arbëreshe), ku rreshton Varibobën, De Radën, Darën, Seremben, Schiroin; b). traditën geqe katolike, me Budin, De Martinon, deri te Fishta, që praktikoi metrikë të stilit italian edhe në kryeveprën e tij; c). metrikë të stilit klasik italian, si Mjeda; d). kurse nga fillimi i shek.XX, sipas Pipës, kristalizohet një traditë metrike katolike geqe (shkodrane), me Shirokën, Fishtën, Mjedën, Prennushin, Gurakuqin, i cili shkroi edhe të parin traktat metrik **Vargënimi n’ gjuhë shqipe**, 1906. Nga ana tjetër, autori i *Trilogjisë*, ndan me mjaft vlerë edhe traditën myslimane toske e geqe, metrikë që nis që në shek.XVI, kur poetë turq me origjinë shqiptare, si Lutfi Pasha (1550) dhe Jahjya Beg (1582), u veçuan si të tillë, për të kaluar në shek.XVIII, kur u shfaqen poemat e para shqiptare të hartuara sipas metrikës tradicionale islamike, me Nezimin († 1760) dhe Naimin. Ndërsa tradita metrike e kultivuar toske është e re, në fillimin e shek.XX, me Çajupin.<sup>513</sup> “Nëse i konsiderojmë poemat fetare të Budit (1614), shkruan Pipa, si gjysmën e rugës mes poezisë popullore dhe asaj të kultivuar, **poesia popolareggiante** (poezia që i ngjet folkut), dhe kësisoj i përfshijmë ato në studimin tonë historik të

<sup>511</sup> Po ai, po aty, f. 17.

<sup>512</sup> Po ai, po aty, f. 23.

<sup>513</sup> Po ai, po aty, f. 26.



teksteve gojore, *terminus a quo* (caku më i hershëm) mund të shtyhet prapa deri tek gjysma e shekullit XVI.”<sup>514</sup> Një hapësirë më vete zënë në pjesën e parë të Trilogjisë edhe konsideratat e autorit për rimën, ritmin, rrokjen në tekstet e këngëve popullore dhe ato të kultivuara, duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek krijimtaria e Budit, për të cilin shkruhet se malësori autodidakt nga Mati, që e kishte dëshirën për shkrime po aq të fortë sa edhe pasionin për politikën, duhet të ketë qenë joshur lehtë nga rima ekzotike gjatë qëndrimit të tij në Romë.<sup>515</sup> Gjatë leximit, krijon bindjen se A.Pipa, në kohën që jetonte dhe krijonte larg atdheut, kishte mundur të mbante lidhje sinkronike me nivelin e studimeve albanologjike shqiptare nga kërkues vendës e të huaj, gjë që vërtetohet nga kapitulli në kapitull, siç shohim tek kreu IV, ku shtjellohen disa analiza për vargun gnomik<sup>516</sup> tek proverbat dhe gjëegjëzat. Ai niset nga arsyetimi se çështja e parë është nëse shqipja përmban ose jo gjurmë të metrikës sasiore (kuantitative), gjë që ende sot vepron në serbo-kroatisht, por jo më në greqishten e re. Këtë e mbështet tek studiuesit tanë R.Sokoli dhe E.Çabej, edhe pse albanologu gjerman Fiedler, ka mendimin ndryshe për çështjen në fjalë.<sup>517</sup> Por argumenti do vërtetuar edhe më tej: me vepra dhe studiues të planit evropian, dhe autori gjen Meillet-in, që ngriti teorinë se vargërimi indoevropian në zanafillën e tij qe drejtuar prej disa parimeve, si:

- a. numri i qëndrueshëm i rrokjeve të vargut;
- b. thyerja e detyrueshme, me ndryshime të lehta në një varg të gjatë;
- c. segmenti sinor relativisht i lirë prej detyrimeve sasiore;
- d. kadenca sasiore (kuantitative) para ancepsit<sup>518</sup> fundor.<sup>519</sup>

Edhe mendimi teorik i Jakobsonit dhe i T.Bergk-ut, që thoshte se metri më i vjetër grek, ishte vargu-proverb, *të cilin e hasim në gnome dhe formulat*

<sup>514</sup> Po ai, po aty, f. 26.

<sup>515</sup> Po ai, po aty, f. 32.

<sup>516</sup> Gnomik- nga gnomë-a (gr. γνῶμη- mendim, gjykim), parim, gjykim i shprehur shkurt, në vargje a në prozë, fjalë e urtë. Gnomik-e, gjykim i shprehur shkurt, në formë këshille.(M.Ndreca, **Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja**, Rilindja, Prishtinë, 2000.)

<sup>517</sup> Po ai, po aty, f. 39, ku shkruhet: “Sokoli i përgjigjet me pohim kësaj pyetjeje, Fiedler-i me mohim. “Ne kemi poema dhe këngë të cilat qeverisen nga parime sasiore.” (Sokoli, fq. 50). Teza e sasiorsisë (kuantitativitetit) u lajmërua së pari nga E.Çabej në “**Për gjenezën e gjuhës shqipe**”. Nga ana tjetër, sipas Fiedler-it, “poezia folklorike çame bazohet vetëm mbi alternimin e rregullt të rrokjeve të theksuara dhe të patheksuara”. (Fiedler, fq. 185).

<sup>518</sup> Në metrikën klasike anceps quhej rrokja brenda një vargu që mund të ishte e gjatë por edhe e shkurtër.

<sup>519</sup> Kadenca mund të jetë katalektike. Barasvlera e një kadence akatalektike dhe e një jokatalektike merr kuptim te vjersha lirike, e cila shoqërohet me muzikë...(f. 39).

*rituale*.<sup>520</sup> Tek shqipja kjo dukuri zë fill me 113 proverbat e Frang Bardhit, mbledhur e botuar në shek.XVII. Tabelat e shumta që Pipa sjell për mbledhësit e hershëm të proverbave shqipe, nga Bardhi, Hahni, Mitko, Meyeri, japin bindshëm këtë dukuri të pranishme në prozodinë shqipe. Në vazhdim, autori nuk ka lënë jashtë analizës shkencore edhe këngët magjike, shitat e ritualet, për të cilat vëren se *mitet dhe besëtytnitë, praktikat magjike dhe besimet totemike hasen shpesh në përrallat dhe legjendat popullore në formën e gnomeve, të përqendruara në një rresht, në një distik, tripletë apo kuatrenë*.<sup>521</sup> Studiuesin tonë e kanë tërhequr edhe lojërat e fjalëve dhe këngët e fëmijëve për shiun, stinët dhe rite të shumta të jetës së tyre; ai i krahason ato me variante të disa gjuhëve ballkanike, si me versionin serbo-kroat, versionin bullgar, versionin rumun dhe atë grek, duke u ndalur tek variantet toskë e gegë. Deri në fund të pjesës së parë të Trilogjisë, Pipa trajton prozodinë e *Këngëve fëmijërishte* (f. 61), *Këngëve korale e monodike* (f. 72, për të cilat citon studimet shqiptare të Dungut, Trakos, Lorenc Antonit, Gjon Kujxhisë, R.Sokolit, N.Vasija e Gj.Komnino,<sup>522</sup> *Vajtimeve* (f. 89), prozodinë e *Vargut epik* (që zë një hapësirë të gjerë, f. 100), *Vargut rapsodik* (f. 123), e *Vargjeve burleske dhe satirike* (f. 135). Me interes të veçantë letrar dhe gjuhësor janë përfundimet, me të cilat e mbyll vëllimin autori, duke i ndarë ato në: *orientime, përshkrime të gjinive, sisteme metrike, gëgnishtja përballë toskërishtes, rima*. Bibliografia e pasur e bazuar, më së pari, në studimet shqiptare dhe ato të huaja ballkanike e evropiane, e paraqesin A.Pipën një studiues të nivelit të dijeve të kohës dhe gjithë përmbledhjen me mjaft risi në fushë të folkloristikës dhe hulumtimeve letrare.

Vëllimi II i trilogjisë u kushtohet studimeve deradiane,<sup>523</sup> ndarë në 3 kapituj:

**A.** Zanafilla e një poezie, me: në kërkim të dorëshkrimeve, lindja e Milosaos, shkrimet e hershme në italisht, amza e poezisë deradiane, romantizmi kalabro-shqiptar dhe kujtimet greke dhe trashëgimi religjiozo – ortodoks;

<sup>520</sup> Po ai, po aty, f. 39.

<sup>521</sup> Po ai, po aty, f. 50.

<sup>522</sup> Po ai, po aty, f. 72.

<sup>523</sup> Arshi Pipa, Titulli: **Trilogjia Albanika II, Jeronim De Rada**; titulli në origjinal: Trilogia Albanica II, Hieronymus De Rada; (botohet më 1978 nga Dr. Dr. Trofenik, redaktuar nga Peter Bartl, pjesë e kolanës Albanische Forschungen, vol.18, München) (*Përktheu* nga origjinali në anglisht Abdurrahim Myftiu); Redaktor: Primo Shllaku. Botimi i parë: Princi, Maj 2013; U shtyp në shtypshkronjën “West Print”, Tiranë, Shqipëri, 2013.(me 323 faqe)

**B.** Gjuha dhe prozodia, me: alfabetin, toparet fonetike, metrikën arbëreshe, mendime të studiuesve arbëreshë, krahasimin e teksteve, metrikën siciliane e shqiptare, njëmbëdhjetërokëshi i italianizuar, metrikën e De Radës e leksikon, morfologjinë e sintaksën;

**C.** Ideologjia dhe stili, me: poezinë e politikën, metamorfozën e Serafinës, një tragjedi vetjake dhe një epos, poema pa fytyrë të vetën, punimet teorike; gjuhësi, estetikë e politikë, Skanderbegu i pafat, Flamurtari dhe Profeti, Lulja hibride.

Parathënia e shkurtër e autorit na bën të qartë si nisën studimet deradiane nga Pipa, ku u mbështet ai dhe çfarë kërkoi dhe për çfarë u frymëzua prej studiuesve pararendës arbëreshë, si: Gualtieri, Markiano, nga Instituti i Gjuhësisë në Kopenhagë, Biblioteka e Kosencës, Biblioteka Mbretërore e Kopenhagës, nga profesori danez Louis Hjelmslev, profesori Ege, nga ndihma e shoqërisë “Vatra”, Arkivi i Shtetit, Tiranë, dhe të gjitha burimet italiane të bibliotekave në Romë, Vatikan, Firence dhe të gjitha të dhënat e vjela nga SHBA, në universitetet e Kalifornisë, New Yorkut, Minnesotës, etj. Pa këto, thekson poeti, libri nuk do të ishte shkruar. Lexuesi e ka të vështirë të dallojë cili prej këtyre krerëve të kësaj pjese të Trilogjisë është më i rëndësishmi, por ajo që mbetet gjatë njohjes me këtë monografi (nëse e quajmë kështu), është thellësia e trajtimit të çështjeve, nisur nga ana dokumentare, shtjellimi bashkëkohor i problemeve tematike dhe teorike që nga gjinitë letrare, personazhet, mjediset e ngjarjeve, rrymat dhe shkollat letrare që përthith autori, vështrimet gjuhësore- nga leksiku, morfologjia e në masë më të vogël-sintaksa deri te ***Gjuha dhe prozodia***, nga e cila shkëputet thënia kuptimplote:

*“Mirëpo fjala, tek e cila mendja dhe fryma shkrihen, nëse njëra anë nënkupton (mëton, kupton) idenë që mbisundon mallëngjimin shpirtëror, nga ana tjetër përbëhet nga zëri i shpirtit të mallëngjyer; dhe ahëre vetëm gjuha (e folura) njerëzore e pasqyron plotësisht gjendjen e brendshme, kur, pa i humbur shenjat mendore, fjalët e saj përfaqen në një fizionomi të përafërt të shpirtit të thellë.”<sup>524</sup>*

Vëllimi që mbyll përmbledhjen treshe Trilogjia Albanika titullohet **Letërsia shqipe: Perspektiva shoqërore.**<sup>525</sup> Libri i fundit i kësaj trilogjie

<sup>524</sup> J.De Rada, **Parimet e Estetikës**, f. 66. (Citohet sipas veprës së Pipës, Trilogjia II, f. 87.)

<sup>525</sup> Arshi Pipa, Titulli: **Trilogjia Albanika III, Letërsia shqipe: Perspektiva shoqërore**; titulli në origjinal: Trilogia Albanica III, Albanian Literature: Social Perspectives; (botohet më 1978 nga Dr. Dr. Trofenik, redaktuar nga Peter Bartl, pjesë e kolanës Albanische Forschungen, vol.19, München) (*Përktheu* nga origjinali në anglisht Myftar

ka 7 kapituj, të cilët fillojnë me studimet nga letërsia arbëreshe: Ethos-i dhe Etnos-i në traditën letrare arbëreshe, me: origjinën shqiptare të shpirtit helen në Italinë Jugore, Idola tribun, Kërkimi për origjinën, Gjeografia poetike, Italo-shqiptarët dhe greko-italo-shqiptarët, Vështrimi etnogjuhësor i poezisë shqiptaro-kalabreze, Simbioza Shqiptaro-Arumune dhe mbyllet me sythin Sinkretizmi etnik dhe ballkanologjia. Në të gjitha këto ndarje lexuesi do të gjejë të dhëna e risi të njohura e të panjohura, por të thelluara e të ridimensionuara në dritën e dijeve të kohës, bazuar në burime e dokumente të shfrytëzuara drejtpërdrejt nga burimi i tyre gjatë kërkimeve përgjatë viteve nëpër biblioteka e arkiva të ndryshme evropiane e amerikane. Jo rrallë, hulumtimet e A.Pipës shkojnë deri thellë në të dhënat historike. Ai shkruan: “Pasi shpjeguar gjenezën e poezisë gojore shqiptaro-kalabreze si mbivendosje e të paktën tri shtresave të qytetërimit: shqiptare pastorale, fshatare-shqiptare e Moresë dhe feudale kalabreze, tanimë kalojmë për të provuar atë përbërëse të *Rapsodie* që nuk është as shqiptare, as e Moresë, as kalabreze, por vjen nga një hapësirë tjetër gjeo-etnike, që mund të përshkruhet si Maqedono-rumune. Ushtria e Stefan Dushanit që pushtoi Thesalinë në vitin 1346 ishte e përbërë kryesisht nga ushtarë shqiptarë, prejardhja e vërtetë e të cilëve është e njohur për ne...”<sup>526</sup> Veç kësaj autori zbret në të dhënat e gjuhëve ballkanike, si një nga elementet përbashkuese të etnoseve të këtyre popujve. Ai shkon e gjen burime të këtij argumenti tek albanologë e ballkanologë të ndryshëm, të cilët e kanë vënë gjuhën në plan të parë për të shpjeguar identitetin e banorëve ballkanas, siç ka bërë Kopitar-i: “Bazuar në elementët e përbashkët të gjetur në këta shembuj dhe në disiplina të tjera, një shkencë krahasuese, Ballkanologjia, ka marrë formë gradualisht. Duke kufizuar diskutimin tonë te gjuhësia do të përmendim këtu punën pioniere të kryer nga Kopitar-i që i pari konceptoi se shqipja, bullgarishtja dhe rumanishtja kanë një “Sprachform” të përbashkët, ndërsa përbëhen prej “Sprachmaterien” të ndryshme. Miklosich dhe Sguhardi (Schuhardt-i) shtuan një gjuhë të katërt, greqishten e re.”<sup>527</sup>

Në pjesë të caktuara të këtij vëllimi përmblyllës i trilogjisë, gjejmë pasazhe studimore e komente letrare për mjaft krijues të njohur shqiptarë, si: Naimi, Çajupi, Fishta, Poradeci, Grameno, Postoli, Asdreni, Kuteli, Spasse, Migjeni (f. 114-147). Kreu IV trajton problemin e *Letërsisë përballë politikës dhe politikën e letërsisë* (f. 149), gjatë së cilës shtjellon në optikën e tij shkollën letrare të realizmit socialist në Shqipëri. Në fund të

Gjana); Redaktorë: Primo Shllaku dhe Sait Saiti. Botimi i parë: Princi, Maj 2013; U shtyp në shtypshkronjën “West Print”, Tiranë, Shqipëri, 2013.(me 271faqe)

<sup>526</sup> Po ai, po aty, f. 51.

<sup>527</sup> Po ai, po aty, f. 77.

kësaj pjese të Trilogjisë, autori bën përpjekje për një periodizim të letërsisë shqiptare dhe në Kap.VII, jep të plotë *Bibliografinë e studimeve shqiptare* (1504-1974) brenda faqeve 191 – 249, që ka vlerë të dukshme për studiues të shqipes përgjithësisht dhe veçanërisht, për hulumtues të letërsisë shqiptare brenda dhe jashtë kufijve politikë të vendit tonë.

Kemi bindjen se botimi i trashëgimisë letrare dhe gjuhësore e studimore i Arshi Pipës, me këtë Trilogji të gjerë, na bën të njohur një emër të shquar midis letrave shqipe, një stilist në poezi, një kritik të thellë dhe një polemik të politikës së planifikimit gjuhësor në diasporën shqiptare, i cili nuk rreshti së krijuari dhe së shkruari në fusha të ndryshme të studimeve shqiptare. Nga ana tjetër, vepra të tilla, si Trilogjia Albanika, e vë autorin në radhën e krijuesve më të shquar të mërgimtarëve shqiptarë, kudo në botë dhe e dallon njëherësh midis emrave të tillë, si: Martin Camaj, Namik Resuli, Mustafa Kruja, Ernest Koliqi, Sami Repishti, Karl Gurakuqi, etj. Gjuha e përkthyesve Myftiu, Shllaku dhe Gjana është në rrafshin më të zgjedhur të standardit të sotëm letrar dhe botimi i shtypshkronjës “**West Print**” duhet falënderuar për nivelin e tipografisë moderne të kohës. Prandaj dhe Trilogjia e Pipës, edhe pse na vjen vonë në gjuhën tonë, prapëseprapë bëhet një libër ku studiuesit tanë të rinj dhe ato me emër, mund të tërhiqen për burime të çmueshme në trajtimin e problemeve dhe argumenteve studimore që marrin përsipër.

Tefë Topalli

## ZËRI I WILLY KAMSIT NË NJË LIBËR ALBANOLOGJIE

Puna shumëvjeçare e historianit, studiuesit, përkthyesit dhe specialistit të Bibliotekës së Universitetit tonë, Willy Kamsi, është e njohur jo vetëm në masën e gjerë të hulumtuesve të qytetit të Shkodrës, qindra e mijëra studentëve, që kanë kaluar në auditoret e këtij institucioni të lartë arsimor përgjatë më se një gjysmë shekulli, por, në radhë të parë, puna e tij ka lënë gjurmë midis brezave të tërë pedagogësh, të cilëve Willy Kamsi u ka shërbyer me dashamirësi, kompetencë shkencore dhe kulturë prej specialisti me eksperiencë të gjatë pune, pa munguar edhe roli i tij prej këshilltari. Ndërkohë, duhet pohuar se veprimtaria e këtij specialist, shkon aq shumë në të mirë të veprave albanologjike, jo vetëm se ai mund të konsiderohet edhe si krijues e pasurues i këtij fondi të pasur, por edhe me punën e drejtpërdrejtë në këtë fushë, si përkthyes i veprave të albanologëve të shquar, për të cilën folën këtu e do të flasim edhe kolegët e tjerë ligjërues. Ky *background* dituror i këtij shkencëtari në fushë të filologjisë e kryesisht, të teksteve të vjetra të shqipes, ka bërë që ai të ketë zërin e tij në kursin e albanologjisë “**Leksikon: Gjuhëtare shqiptarë dhe Albanologë**”, te autorëve prof. dr. Artan Haxhi e prof. dr. Tefë Topalli. Ata kanë gjetur vendin që i takon W.Kamsit në radhën e gjuhëtarëve shqiptarë dhe, pikërisht, tek zëri i bibliografit të njohur francez, Emile Lëgrand, kur sjellin librin “**Bibliographie Albanaise**”, në ribotimin që iu bë kësaj përmbledhjeje nga Prokura Françeskane, Shkodër, 2011, me plotësime prej Lumo Skendos dhe Henri Guys (ribotim). Çdo lexuesi a studiuesi që ka parë tekstin, i bën përshtypje paraqitja që i ka bërë Willy Kamsi dy autorëve të shquar të kësaj bibliografie: për saktësinë e të dhënave, kohën kur u hartua dhe rëndësinë e punimeve. Ai fakton, ndër të tjera edhe vlerësimet e bëra nga studiues të traditës shqiptare, siç ishte Dhimitër Berati, i cili shkruante se “*Kjo vepër e Emile Legrandit, e plotësuar prej Henri Guys, ka një vlerë të pallogaritshme, mbasi ka qenë sprovë e parë e këtij lloji e njiheri një të nisun në shej që s’lype tjetër gja vecse që të plotësohet.*” Edhe studiuesit tanë, Haxhi e Topalli, kanë vënë në dukje se “*...Bibliografia e dijetarit francez Legrand, mik i kulturës dhe i historisë shekullore të popullit shqiptar, është pasqyrë enciklopedike e jetës dhe e përpjekjeve të njerëzve më të shquar të këtij kombi për t’u ngritur në identitetin e vet brenda qenies dhe psikës së tij, të dallueshme nga të tjerët, me të cilët ka dashur të jetojë në paqë e miqësi, por që fati e ka përplasur mes rrebeshesh e stuhish...*”

Willy Kamsi tregon më tej edhe për vështirësitë që ka hasur gjatë përgatitjes për botim të veprës së Legrandit, duke nënvizuar se “*nji problem i veçantë ka qenë riprodhimi, në këtë rasë anastatik, sikurse i kemi riprodhues bibliografitë në fjalë, i shenjimeve bibliografike të Lumo Skendos të botueme në numra të ndryshëm të Diturisë. Problemi rrjedh prej punës tejjet të dobët të shtypshkruesit e të shkrojave të lodhuna prej përdorimit, të cilat në shumë raste nuk lexohen. Mbas një kontrolli t’im të kemi bërë qortimet e zavendsimet e duhuna, përveç rasteve kur, tue mos pasë në dorë botimin e regjistruem, nuk kemi mujtë me ndërhy, sepse nuk mund të dihej në se kishim të bërë me një gabim shtypi apo ashtu e kishte origjinali. Përveç kësaj kemi shtue Treguesin e emrave dhe Treguesin e botuesve dhe të shtypshkronjave. Mendojmë se, tue përfshirë dy shtojcat, kemi plotësue edhe më bibliografinë, sidoqoftë të çmueshme, të prof. Émile Legrand.”*

Në librin “Leksikon”, që cituam më lart, autorët kanë pasur kujdes që në një hapësirë të paraqesin edhe profilin e ri të studiuesit W.Kamsi, profilin që na bën ta quajmë një ndër bibliografët me emër të filologjisë shqiptare.

Punonjësit e Universitetit dhe gjithë qytetarët e Shkodrës e njohin z. Willy Kamsi si përkthyes i Mario Rokut, botues i epistolarit të Imzot Pjetër Bogdanit, mjeshër i *pakundshoq* i sistemimit dhe klasifikimit të fondit të gjerë të bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe bibliotekës së pasur të etërve jezuitë; e dinë për historian, e njohin si veprimtar aktiv i ngjarjeve kulturore, fetare dhe shkencore të Shkodrës dhe më gjerë, si dinjitar i fisnikërisë qytetare shkodrane. Tani së fundi, dijetari W. Kamsi na paraqitet bibliograf i 4 organeve periodike shumë të njohura për më tepër se gjysmë shekulli, e ndonjë, “**Hylli i Dritës**, bie fjala, i ringjallur, si Phoenixi, nga hiri i tij. Ky specialist i palodhur të habit me kujtesën e rrallë për vendin e një dokumenti, rreth përmbajtjes së një arkivi, për titujt e librave shekullorë të fondit të Albanologjisë, për periodikët e shumtë që ka sistemuar vetë dhe të tregon se ka në kompjuter, të radhitur me dorën e vet, lëndën e plotë të revistës më të madhe të Rilindjes Kombëtare, **Albanisë** së Faik Konicës, që kishte qenë nxënës i etërve iluministë jezuitë, themeluesve të kësaj reviste zëmadhe, me titullin **L.E.K.A. = Lidhje – Edukatë – Kulturë – Argëtim**, që mbante të shkruar në anë të ballinës kredon morale “*Sendet e vogla rriten prej bashkimit*” (me 134 faqe). Dhe bibliograf ka qenë kardinali Ambrosini (pagëzuar me emrin e tij Biblioteka e famshme **Ambrosiane** e Milanos), bibliograf ka qenë albanologu vjenez **Norbert Jokli**, dijetarët **Palokë Daka** dhe **Jup Kastrati** kanë qenë bibliografë, përveç të tjerash. Do të flisnim më gjatë për intelektualin W. Kamsi, por është në të mirë të të pranishmëve të nderuar

që të tregojmë sado shkurt se kjo revistë ka lindur në vitin 1929 si organ i shoqatës “LEKA”, që u formua nga qytetarët shkodranë: Kolë Dema, Luigj Simoni, Tush Kakarriqi, dr. Zef Pashko Saraçi, ish-studentë të **Kolegjës Saveriane** dhe misionari italian Atë Zef Valentini, albanolog dhe bizantinist i përmendur. Qëllimi i vetëm i shoqatës (dhe më vonë i revistës së saj), ishte *bashkimi vëllaznuer në mes ish nxanësve të Kolegjës, për me vijue edukaten e kulturen e fitueme tuj u mundue me e përhapë në të gjithë popullin*.

Në revistën 15 vjeçare që kemi përpara kanë shkrimet e tyre klerikët e ditur: Zef Valentini, Anton Xanoni, Kordinjano, Ndre Mjeda, Lazer Shantoja, Mark Harapi, Aleksandër Sirdani, Prend Suli, Ndoc Sahatçija, Gasper Gurakuqi, Gjergj Fishta, Gjon Karma, Ndre Zadeja, Pjetër Meshkalla; kanë emrat e tyre edhe shkrimtarë, publicistë, përkthyes, filozofë dhe dijetarë laikë, vendës e të huaj, si: Gjon Çoba, Kolë Mjeda, Ernest Koliqi, Kolë Kamsi, Enriko Grassi, Filip Fishta, Kozmo Serembe, Nush Banda, Anton Logoreci, Hilë Mosi, Selahedin Bekteshi, Kolë Shtjefni, Namik Resuli, Hysen Korbi, Mihal Sherko, Mustafa Merlika, Hamdi Bushati, Diego Valeri, Selman Cerga, Ilo Mitkë Qafëzezi, Mati Logoreci, Sotir Paparisto, Krist Maloki, Kristo Floqi, Georg Stadmüller, Giusepe Guisti, Lluka Karafili, Injac Zamputi, Henrik Lacaj, Carlo Tagliavini, Mithat Frashëri, Ndoc Çoba, Francesco Bonasera, Kosmo Serembe, Kolë Ashta etj., të cilët, pa përmbledhje bibliografike do të kishin kaluar bashkë me veprat e tyre, në harresën e kombit e do të mbeteshin të pashfrytëzuar e gjithashtu, të paridimensionuar në formatin e duhur të kulturës shqiptare. Do të mjaftonte paraqitja e tryezës së lëndës së numrit VII, vitit VII, korrik, 1935, çfarë informacioni të rëndësishëm sjellin shkrimet e kësaj reviste nga jeta shoqërore civile e vendit, nga fusha e pedagogjisë, nga letërsia botërore, me një përkthim të shkëlqyer të elegjisë “Hermani e Dorothea” të Gëtes, nga Lazer Shantoja, bashkë me Kangën I të poemës së famshme *Kaljopeja*. Brenda saj gjejmë shkrime jurisprudence, thesare folklorike nga goja e popullit dhe një hapësirë kritike e polemizuese shumë të hollë dhe me stil të fuqishëm për çështje letërsie, sociologjie dhe filozofike.

Një punë shumë profesionale ka bërë W. Kamsi edhe për zbërthimin e shpjegimin e pseudonimeve të shumë autorëve, që marrin rëndësi aq të madhe për hulumtuesit e kërkimtarët shkencorë. Ai i shpjegon mjaft prej tyre, si janë formuar gjuhësisht, ose mbështetur në pararendës të tij bibliografë, siç vepron me emrin *Ales*, që e bie pseudonim të Aleksandër Sirdanit dhe jo të Injac Zamputit. Ata që e njohin gjendjen reale të bibliotekave të enteve e urdhrave fetarë, të shpërndara e të grabitura



individualisht a me dekrete shtetërore; e kuptojnë ç'punë të vështirë ripërtëritëse dhe kompletuese ka përballuar autori i kësaj bibliografie, në radhë të parë, për ta siguruar periodikun, ku të fshehur nga ndonjë klerik bashkëkohës, ku në ndonjë familje a individë bibliofilë zemërgjerë të këtij qyteti, që ruan ende thesare të çmuara, të panjohura deri më sot. Parathënia e thukët historike e autorit dhe shënimet e shfrytëzimit të bibliografisë LEKA, e njohin lexuesin me përmbajtjen, kohën e botimit, vijueshmërinë dhe ndërprerjen e përkohshme kryesisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, ashtu dhe japin njoftime mbi përdorimin praktik të kësaj bibliografie. Intelektuali i nderuar Willy Kamsi ka punuar gjithë jetën në heshtje, e falënderojmë kësaj radhe që pranoi të ishte midis nesh në këtë promovim të thjeshtë të punës së tij të madhe.

Zamira Shkreli

**NEKROLOGJI**  
**Mentor Quku**  
**1939-2014**

Kohë më parë u nda nga jeta studiuesi Mentor Quku. Ka lindur në Bilisht të Korçës më 20 janar 1939. Fëmijërinë dhe rininë e kaloi në qytetin e Shkodrës. Shfaqti një talent të veçantë në pikturë. Mori mësim nga ikonografja e njohur Viktori Puzanova, si dhe nga piktorët e shquar Simon Rrota dhe Vladimir Jani. Lufta e klasave ia ndërpreu të drejtën për të vazhduar në këtë fushë. Në qershor të vitit 1954 kreu shkëlqyeshëm shkollën pedagogjike “Shejnaze Juka” në Shkodër. Në vitin 1957 mbaroi Institutin e Lartë Pedagogjik në Tiranë, ndërsa në vitin 1963, Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Në vitet 1954-1957 ka shërbyer arsimtar në shkollat e Shtiqënit, Brutit dhe Kukësit. Ndërsa në vitet 1957-1961, ka shërbyer në shkollën e mesme “Hydajet Lezha”, Lezhë. Për dy vite shkollore, 1961-1963, ka qenë mësues në shkollën e mesme “Xheladin Fishta”, Shkodër. Pastaj, në vitet 1965-1991, ka qenë mësues në shkollën e Barbullushit. Më 1991-1992 ka punuar drejtor në shkollën e Bahçallekut. Më vitin 1992-2000 ka qenë drejtor i Muzeut Historik Shkodër. Ka qenë drejtor i revistës “Kumtari”, nr. 5,6,7, si dhe i gjashtë vëllimeve të *Seminari Ndërkombëtar*, “Shkodra në shekuj”, I, II/1, II/2, III/1, III/2, III/3. Ka drejtuar projektet dhe ka organizuar katër seminare ndërkombëtare *Shkodra në shekuj* (1, 2, 3, 4).

Është autor i shumë studimeve e botimeve, si në metodikë të dhënies së mësimit, pedagogji familjare, pedagogji shkollore, pedagogji sportive, tekstologji, psikologji e arteve figurative, psikologji sportive, psikologji e moshave. Gjithashtu në histori, histori arti, letërsi biografike, letërsi politike, letërsi për fëmijë, histori e letërsisë për fëmijë, mitologji, folklore, frazeologji, toponomastikë. Ka botuar në “Studime filologjike”, “Studime historike”, “Studime pedagogjike”, “Kultura popullore”, Buletin shkencor i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, “Kumtari i muzeut Historik Shkodër”, *Seminari Shkencor Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”*, “Nëntori”, “Les Lettres Albanaises”, “Shqipëria e Re”, “Ylli”, “Hylli i Dritës”, “Gjuha

e jonë”, “Albanica Ekskluzive”, “Lemba”, “Flaka”, “Illyria”, “Dielli”, “Koha Javore”.

Tema qendrore e studimeve të tij mbetet ajo e Ndre Mjedës, për të cilin ka organizuar kërkime në Shqipëri, Kosovë e në shumë vende jashtë shtetit. Në vitin 2004 botoi vëllimin e parë “Rinia”. Me këtë rast fondi *dr. Peters Mahringer - Fonds*, i bëri një vlerësim maksimal, duke i siguruar mundësitë për ekspedita kërkimore - shkencore në arkivat, bibliotekat dhe muzeumet e Vjenës. Më 2005-2006 punoi në Österreiche Haus-Hof-und Staatsarchiv, Österreiche Nationalbibliothek, Archiv der Universität Wien, Bibliothek des Ost-und Südost Europa Instituts, Muzeun Nacional të Vjenës, Meyerling Museum, Bibliotekën e Universitetit të Gracit. Bashkëpunoi me personalitete të shquara të kulturës dhe të shkencës, si: Arshi Pipa, Benard Stillfried Slavinski, Ivan Boserup, etj. Punoi në Arkivin e Propaganda Fides, Arkivin e Jezuitëve Romë, Arkivin Historik të Provincës Venet.-Met. Gallarate; bëri kërkime në Arkivin e Bibliotekës së Hamburgut, Chataue Aleux Laval, Bibliotekën Naukowa Ksiezy Jezuitów, Krakow; në The Royal Library, Manuscripts and Rare Books-Copenhagen; në Manastirin e Ara Christi, El Puig, Valencia, Kuvendin San Spirito, Porta Coeli.

Më 23 maj 1994, iu dha titulli “Mësues i Merituar” nga Presidenti i Republikës Z. Sali Berisha, dekret nr. 194, Tiranë.

Më 25 tetor 2008, iu dha çmimi letrar “Serembe”.

Më 1 gusht 2011, iu dha çmimi “Ndre Mjeda” (2011).

Më 22 prill 2011, iu dha titulli “Mirënjohja e qytetit” e qytetit të Shkodrës”.

Më 16 prill 2014, iu dha titulli “Profesr nderi” nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Ka botuar serinë eseistike me njëmbëdhjetë vëllime MJEDA: I. Mjeda -1 (1866 – 1888) Rinia II. –Mjeda -2 (1888-1899) Albanologu III. –Mjeda-3 libri i parë (1899-1912) Alfabeti IV. –Mjeda-3 libri i dytë (1899-1912) Liria V.-Mjeda-4 (1912-1925) Identitet VI. -Mjeda-5 (1925-1937) Gjuhëtari VII. –Mjeda-6 libri I parë (Bibliografia- e atij). VIII. –Mjeda-6 libri i dytë (Bibliografia- mbi atë) IX. –Mjeda-7 (Bashkëkohësit) X.-Mjeda-8 (Album). XI. – Mjeda-9 (Përmbledhje).

Më 31 maj 2014 ndahet nga jeta intelektual i dhe studiuesi i njohur Mentor Quku.

## PROFIL STUDIUESI

Për personalitete të pazakontë siç ishte Mentor Quku, jeta nuk matet me vite por me vepra dhe pasione që u blatojnë të tjerëve, në rastin tonë vlerave kombëtare.

I lindur në një familje të njohur, ku bashkohej fisnikëria intelektuale e Shkodrës me fisnikërinë e një familjeje me emër nga bregdeti ynë jugor, Mentor Quku do të fitonte tiparet e një nxënësi dhe studenti të shkëlqyer në pedagogjiken e mirënjohur të Shkodrës, më pas në Institutin Pedagogjik Tiranë ose parauniversitetin e parë shqiptar dhe më pas në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, çfarë do t'i jepte profilin e tij kulturor e dituror karakter shumëdimensional.

Natyra i fali me bollëk shumë dhunti si pasioni dhe prirja në pikturë që iu ndërpre për arsye politike, pasioni për dije dhe kulturë që nuk iu nda asnjë herë, por edhe një pasion i trashëguar nga familja, pasioni për filatelinë, një sferë multidisiplinare nga e cila nuk shmanget dhe ndrit edhe historia e filatelistë shqiptare, çfarë e tërhiqte më shumë Mentorin.

Krahas pasionit të tij të jetës për të ndriçuar dhe vlerësuar personalitetin e Mjedës, Mentor Quku ka spikatur si një intelektual i vërtetë klasi në shkollën shqiptare dhe në fushën e mendimit shkencor psikologjik dhe pedagogjik me një varg titujsh të botuar.

Ai do të dallohej edhe si qytetar i zotuar, teksa në kohët e lirisë përfshihet vullshëm në rrjedhat më të hershme të politikës së lirë, por kulmet në aktivitetin e tij, qytetar, atdhetar, social, kulturor dhe shkencor, ai do t'i shënonte me kthimin e Muzeut të qytetit të Shkodrës nga një arkiv relikesh jashtëzakonisht të pasura por të heshtura në qendër debati, polemike dhe afishimi të mendimit të lirë shkencor në aq disiplina, si: historia, gjeografia, gjuhësia, folklori, etnologjia, letërsia, arkeologjia, etnografia, ekonomia, pedagogjia, sportet, filatelia e të tjera.

E kush më mirë se personaliteti shumëprofilësh i drejtorit të Muzeut në fillim të viteve 90-të, do të dinte të projektonte e të realizonte veprimtari si Seminari “Shkodra në shekuj”, që në disa edicione periodike në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, do të tubonte dijetarë elitare nga bota akademike e gjithë hapësirës shqiptare dhe diaspora.

Modeli me të cilin e organizonte Mentor Quku mbi bazën e departamenteve, që nuk paragjykonte asnjë mendim, asnjë kërkues për asnjë rrethanë, do të jepte gjithë ato vëllimë të botuara që ruajnë aq pasuri dhe vlera të rralla që sollën ndërrimet e mëdha epokale nga diktatura në liri edhe në fushën e kërkimit shkencor.

Ata njerëz elitarë që i bënë realitet ato vlera zbehën në atë kohë institucione, akademi dhe dhanë një model të paparë e të papërsëritshëm të një qyteti, i cili edhe pse nuk qe metropol kishte rrënjë të forta që mezi prisnin të jepnin lastarë dhe vepra nga më të mirat të panjohura më parë.

Edicionet e Seminareve “Shkodra në shekuj”, vënë në sprovë të vështirë çdo tentative për enciklopedinë e Shkodrës dhe hinterlandin e saj, ato janë enciklopedia më e vërtetë, më e gjerë që prodhoi koha e ndryshimit të madh në ballë të të cilit ishin personalitete me vizion dhe tejpamje të habitshme si Mentor Quku, për çfarë Shkodra duhet të jetë mirënjohëse për jetë.

Por kurorën e përpjekjeve në të dy kohët, në atë të mungesës totale të lirisë dhe në kohën e lirisë mbi një argument që identifikohet me emrin dhe jetën e kërkuesit pasionant, të palodhur e këmbëngulës, të qartë në projektin e tij deri në detaje, që do të shquante mbi të tjera ishte studimi për personalitetin dhe veprën e Mjedës.

Siç e kemi thënë edhe më herët për këdo që ka ndjekur publikimet shkencore rreth gjysmë shekulli më parë, nuk përbënte ndonjë befasi projekti i shpallur prej tij dhjetë vite më parë kur botonte vëllimin Mjeda 1.

Aktualisht përbën befasi të rrallë rezultati. Ai ka arritur t’i japë lexuesit të gjerë dhe lexuesit studioz 10 vëllime dhe një vëllim me përmbledhje me rreth 6300 faqe shtypi, një shifër mrekulluese për një individ me aq vite në shpatulla e aq më shumë me një jetë plot privime e ndërprerje të papritura.

Ky mal me libra buron nga një kërkim rreth gjysmë shekullor në biblioteka, arkiva në të gjitha kontinentet, konsultim me qindra faqe të jetës dhe të veprës së Mjedës, me mijëra faqe literaturë të drejtpërdrejtë e të tërthortë, me dhjetëra letra autentike dhe qindra dëshmi, intervista të organizuara me një rregull strikt shkencor që kanë arritur të zbulojnë njeriun, atdhetarin, qytetarin, politikanin, vizionarin e lirisë dhe të drejtave, lëvruesin e gjuhës, gjuhëtarin, estetin, poetin, arkitektin, hartuesin e alfabetit, leksikografin, morfologun, tekstologun, përkthyesin, intransigjentin e konvergjentin, fjalëpaktin dhe të papërmbajturin, “*fenomenin Mjeda*”.

Fenomeni Mjeda do të mbetet i tillë madhështor edhe pa Mentor Qukun, por mjeshtri Quku e përjetësoi në një kolanë tejet të rrallë.

Nuk gjenden fjalët për të vlerësuar Mentor Qukun qytetar, intelektual e studiues.

Por këtë do ta bëjë koha, brezat që do të vijnë, atdheu i së ardhmes, për të cilin ai bëri shumë, shkriu të gjitha energjitë e tij të shumanshme.

Me serinë e vëllimeve të botuara dhe ato që së shpejti do të shohin dritën e shtypit, studiuesi Mentor Quku zë një vend të nderuar në radhën e studiuesve të Shkodrës dhe të gjithë botës shqiptare.

Trashëgimi i pasur shkencor voluminoz i ka dhënë prej kohe atributet e një studiuesi këmbëngulës, serioz, pasionant dhe produktiv.

Me shuarjen e tij, shkenca dhe bota shqiptare humbi një nga lëvruesit e zellshëm të mendimit dhe të kulturës shqiptare, një intelektual të shquar.

Fatbardha Hoxha

## JETA SHKENCORE

### AKADEMIA SHKENCORE “HYLLI I DRITËS”

Revista “Hylli i Dritës”, në 100 vjetorin e daljes së saj të parë, ka qenë në qendër të Akademisë Shkencore ndërkombëtare të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike, me mbështetjen e Konsullatës Austriake të Nderit. Aktiviteti shkencor u mbajt më 18 dhjetor 2013 dhe mblodhi emra të njohur të albanologjisë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, etj. Revista “Hylli i Dritës”, një ndër periodikët më të rëndësishëm kulturorë, filologjikë, letrarë, u bë zëri i intelektualëve jo vetëm shkodranë, por edhe më gjerë. Akademia Shkencore Ndërkombëtare, kishte si qëllim pikërisht nxjerrjen në pah të rolit të madh e që pati revista “Hylli i dritës”, për çështje gjuhësore, historike, letrare dhe sociale, që përshkonin realitetin shqiptar të fillim shekullit XX.

Akademia Shkencore u hap nga Dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, prof. as. dr. Mimoza Priku, e cila vuri theksin në rëndësinë e këtij aktiviteti ndërkombëtar dhe falënderoi Konsullatën Austriake të Nderit, konsullin Gjergj Liqejza për kontributin e dhënë në organizimin e kësaj Akademie Shkencore. Sipas saj është në nderin e Universitetit të Shkodrës të organizojë një veprimtari të tillë të nivelit ndërkombëtar, që ka për qëllim të shkundë pluhurin e viteve nga faqet e revistës “Hylli i Dritës” dhe t’i risjellë vlerat e pasurisë e saj në një dritë të re. Në qindra faqe të radhitura me aq mjeshtëri nga gdhendës të fjalës e të mendimit shqiptar, secili prej nesh sheh rrënjët e një identiteti të turbulluar nga rrjedha e viteve. Kolosët e diturisë e kulturës shqiptare në faqet e revistës na lanë dëshmitë autentike të përpjekjeve të mundimshme për krijimin e një tradite diturore shqiptare. Për gjuhëtarin, shkrimtarin, historianin, gjeografin, biologun, politikanin, ekonomistin, etj., faqet e “Hyllit të Dritës” janë një thesar, ku mund të gjejë informacione të vlefshme.

Rektori i Universitetit të Shkodrës, prof.dr Artan Haxhi, në fjalën e tij theksoi se *“Kur vendi ynë sapo kishte nisur të qeverisej si shtet i pavarur pas një robërie të gjatë, feksi drita e një reviste që u quajt në mënyrë emblematike “Hyll”, me shpresë në Providencën Hyjnore dhe në të ardhmen e atdheut, i cili do të rilindte si Feniksi nga hiri i tij. Mendjet më të ndritura të urdhrit françeskan, një urdhër aq popullor në Shqipëri, me nismën e poetit emërmadh, Fishtës, morën guximin të nxjerrin në ballë të*

*kulturës shqiptare një revistë të një niveli kulturor evropian, siç u bë shpejt “Hylli i Dritës”.*”

Akademia shkencore u përshendet dhe nga prof. dr. Hysni Matoshi, Drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, si dhe Gjergj Leqejza, Konsull Nderi i Austrisë.

Në këtë Akademi shkencore referuan të ndarë në tri seanca:

Programi, Seanca I (Auditori 3)

1. Fatbardha HOXHA (Shkodër): *“Profili poliedrik i të përkohshmes “Hylli i Dritës”.*”
2. Hysen MATOSHI (Prishtinë): *“Hylli fishtian i dritës”.*
3. Tomor OSMANI (Shkodër): *“Hylli i Dritës” për çështje gjuhësore dhe alfabetin e shqipes”.*
4. Emin KABASHI (Prishtinë): *“Koncepti kombëtar i Hyllit të Dritës”.*
5. Mark MARKU (Tiranë): *“Elitat kulturore françeskane dhe “Hylli i Dritës”.*”
6. Nikë UKGJINI (Shkodër): *“Lëvrimi i temave biblike në “Hyllin e Dritës”.*”
7. Willy KAMSI (Shkodër): *“Kontributi i revistës “Hylli i Dritës” për historinë e Shqipërisë (dokumente)”.*

Seanca II (Auditori 3)

1. Emil LAFE (Tiranë): *“Përjetime për Atë Justin Rrotën”.*
2. Gjovalin SHKURTAJ (Tiranë): *“Fillesa të mbara të etnografisë së komunikimit në shkrimet diturore të “Hyllit të Dritës”.*”
3. Tefë TOPALLI, Anisa KOSTERI (Shkodër): *“Hylli i Dritës 1913-1923 për drejtshkrimin e shqipes”.*
4. Shefkije ISLAMAJ (Prishtinë): *“Hylli i Dritës” dhe gjuha shqipe”.*
5. Mimoza Gjokutaj (Tiranë): *“Çështje të mësimi të gjuhëve përmes faqeve të “Hyllit të Dritës”.*”
6. Anila OMARI (Tiranë): *“Kontributi i “Hyllit të Dritës” në studimet filologjike shqiptare”.*
7. Thoma DHIMA (Gjirokastrë): *“Emri i Shqipërisë dhe shqiptarëve në revistën “Hylli i Dritës”.*”
8. Mustafa IBRAHIMI (Shkup): *“Rëndësia e botimit të frazeologjizmave në “Hyllin e Dritës”.*”
9. Evalda PACI (Tiranë): *“Shkrimet e vjetra shqipe në revistën “Hylli i Dritës” (1913-1944)”.*
10. Mimoza PRIKU (Shkodër): *“Revista “Hylli i Dritës” në shënimet bibliografike të Carlo Tagliavinit”.*
11. Ina ARAPI (Vjenë): *“Kolë Rrota dhe ngritja e lektoratit të shqipes në Universitetin e Vjenës”.*



12. Rrezarta DRAÇINI (Shkodër): *“Kontributi i Austrisë në botimet e “Hyllit të Dritës”*”.
  13. Orjeta BAJA - Merita HYSA (Shkodër): *“Elemente të rrafshit fonetik në shkrimet gjuhësore të “Hyllit të Dritës”*”.
  14. Rezearta MURATI (Shkodër): *““Hylli i Dritës” për një gjuhë letrare të përbashkët shqipe”*.
  15. Erzen KOPERAJ – Sereta KOPERAJ (Shkodër): *“Prejardhja e shqiptarëve përmes “Hyllit të Dritës”*”.
- Seanca III (Salla e Senatit)
1. Alfred ÇAPALIKU (Shkodër): *““Hylli i Dritës” nën drejtimin e Vinçens Prendushit”*.
  2. Dhurata SHEHRI (Tiranë): *“Shumësia e diskurseve të “Hyllit të Dritës”*”.
  3. Shaban SINANI (Tiranë): *“Fryma e Hyllit të Dritës në veprimin shkencor të Institutit të Studimeve Shqiptare”*.
  4. Paulina HOXHA (Shkodër): *“Traditat zakonore të Dukagjinit sipas Atë Benardin Palajt”*.
  5. Zeqirja NEZIRI (Shkup): *“Eposi heroik shqiptar nëpër faqet e “Hyllit të Dritës”*”.
  6. Naile IMAMI (Beograd): *“Përgënjeshtrimi i mistifikimeve në një libër antishqiptar nga ana e P. Marin Sirdanit OFM”*.
  7. Diana KASTRATI (Tiranë): *““Hylli i Dritës”, ikona e publicistikës shqiptare”*.
  8. Elindë DIBRA – Fatmir VADAHI (Shkodër): *“Çështje të arsimit në radhët e “Hyllit të Dritës”*”.
  9. Arben PRENDI (Shkodër): *“Kontributi i revistës “Hylli i Dritës” për mbledhjen e studimin e folklorit dhe letërsisë gojore shqiptare”*.
  10. Eduard NDRECA – Bendis KRAJA (Shkodër): *“Historia e Mirditës e pasqyruar nga faqet e “Hyllit të Dritës”*”.
  11. Gëzim Puka – Gjovalin Çuni (Shkodër): *“Kontribute për botimin e “Hyllit të Dritës” (personeli ndihmës)”*.

Rrezarta Draçini

## KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “200 VJET ME DE RADËN”

Me rastin e 200 - vjetorit të lindjes së De Radës, ditën e marte, më 3 qershor 2014, Departamenti i Letërsisë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Albanologjike, zhvilloi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “200 VJET ME DE RADËN”.

Hapja e Konferencës u shënua nga përgjegjësjë e Departamentit të Letërsisë dr. Elinda DIBRA, e cila i dha fjalën e përshëndetjes Dekanes së Fakultetit të Shkencave Shoqërore, prof. as. dr. Mimoza PRIKU. Dekania vlerësoi arritjen e konferencës dhe shprehu falënderimet për të gjithë studiuesit pjesëmarrës dhe në mënyrë të veçantë për studiuesit arbëreshë Françesko ALTIMARI dhe Mateo MANDALA, që kanë një kontribut të rëndësishëm specifik, mbi studimin kompleks të letërsisë arbëreshe në përgjithësi dhe të De Radës në veçanti.

Drejtorja e Institutit të Studimeve Albanologjike, prof. dr. Fatbardha HOXHA, e vlerësoi si sukses arritjen e një konference të tillë, që tubon studiues të rëndësishëm nga institucione dhe treva të ndryshme dhe kjo cilësoi ajo, i kushtohet dhe i shkon përshtat një personaliteti të madh siç ishte De Rada.

Pas fjalës përshëndetëse, filloi seanca e parë e konferencës, e cila u drejtua nga prof. dr. Fatbardha HOXHA, prof.dr. Matteo MANDALA dhe dr. Elindë DIBRA.

Akademiku Françesko ALTIMARI, pasi shprehu falënderimet e tij për organizimin e konferencës dhe për vëmendjen që Universiteti i Shkodrës i dha personalitetit të De Radës, referoi në kuadrin e një botimi kritik të “Këngëve të Milosaut”, për një përjasje të re shumështrësore midis oraliteteve dhe shkrimeve, gjë që solli një risi në interpretimin metrik të vargjeve.

Prof. dr. Fatbardha HOXHA, referoi mbi “*Kontributin e Jeronim De Radës në vlerësimet e Eqrem Çabejt dhe Ernest Koliqit*”.

Prof.as. dr. Ledri KURTI (KRAJA), referoi mbi temën: “*De Rada: Gjuha, kultura dhe qytetërimi i një Kombi*”.

Prof. dr. Miaser DIBRA, kishte objekt të studimit: “*Jeronim de Rada për folklorin shqiptar*”.

Prof. dr. Tomor OSMANI: “*Gramatika e De Radës (1870) e para gramatikë e shqipes e shek. XIX e botuar nga një arbëresh*”.

Prof. dr. Alfred ÇAPALIKU: “*Figura e motrës në një poemë mozaik të De Radës*”.

Prof. dr. Eleni KARAMITRI: “*Jeronim de Rada në “Trilogia Albanica” të Arshi Pipës*”.

Prof. dr. Shaban SINANI: “*Arbëreshi si karakter në letërsinë shqipe: “Karpa” dhe “Kurbani ballkanik”*”.

Prof. dr. Zeqirja NEZIRI: “*Rreth formave metatekstuale të poemës Serafina Topia*”.

Seanca e dytë e Konferencës, u drejtua nga prof. dr. Alfred ÇAPALIKU, prof. as. dr. Ledri KURTI dhe Akademik Françesko ALTIMARI.

Senacën e dytë, e hapi Matteo MANDALÀ me temën: “*Milosaos shkodrani*”: onomastika letrare e krijimi deradian i një bote narrative paralele”.

Punimet vazhduan me referimin e dr. Elindë DIBRËS: “*Revista “Shejzat” për personalitetin dhe veprën e De Radës*”; me referimin e dr. Tonin ÇOBANI & prof. dr. Tefë TOPALLIT: “*Shkodra*” (“*Scutari*”) në veprën e De Radës”; Nicola SCALDAFERRIT: “*Testi poetici e pratiche musicali nella tradizione arbëreshe: intrecci tra scrittura e oralità*”; dr. Arben PRENDIT: *Bota shqiptare në poemat e Jeronim de Radës*; dr. Vinçens MARKU & Doktorant Ndoj MHILLIT: “*Zgjidhja Deux ex machina tek “Këngët e Milosaos”*”; dr. Ermira ALIJA: “*Reflektime të letërsisë qëllimore në veprën e De Radës*”; dhe me referimin e dr. Gëzim PUKËS & Gjovalin ÇUNIT: “*Fiamuri Arbërit*” i De Radës për revistën “*Drita*” të Shoqërisë së Stambollit”.

Konferenca u zhvillua në sallën e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe u ndoq me interes nga të ftuar nga institucione të ndryshme arsimore e kulturore, studentë të letërsisë dhe fakulteteve të tjera.

Ermira Alija

## **PROMOVIM LIBRI NË GJUHË TË HUAJ “LEKSIKON I GJUHËTARËVE TË SHQUAR SHQIPTARË”**

Me datën 02. 10. 2013, në Bibliotekën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, u promovua libri “*Leksikon i gjuhëtarëve të shquar shqiptarë*”, hartuar nga prof. dr. Artan HAXHI dhe prof. dr. Tefë TOPALLI. Veprimtaria u organizua në mënyrë të përbashkët nga Instituti i Studimeve Albanologjike pranë USH-së dhe nga Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë Malazeze, Podgoricë. Vepra e botuar në dy gjuhë: shqip dhe malazezisht, është e para e këtij lloji në fushën e gjuhësisë, realizuar mes dy

qendrave tona shkencore, një nismë që duhet vijuar më tej edhe në të ardhmen.

Në këtë takim morën fjalën drejtori i Institutit të Gjuhës dhe të Letërsisë Malazeze, dr. Adnan ÇIRGIĆ, i cili vuri në dukje detyrat dhe planet e institucionit të tij shkencor në Podgoricë, me veprimtari të pasur botuese në fusha të ndryshme. Ai gjithashtu vlerësoi lart punën e bërë nga autorët e Leksikonit, A. HAXHI e T. TOPALLI, e cila duhet lavdëruar dhe përdorur si model për t'u ndjekur në këtë fushë, jo vetëm për njohjen e Albanologjisë shqiptare në botën shkencore sllave e më gjerë.

Pastaj u mbajtën kumtesat: nga Dekania e FSHSH, prof.as dr. Mimoza PRIKU, nga Drejtorja e Departamentit të Gjuhës Shqipe, prof.as.dr. Rrezarta DRAÇINI, dr. Orjeta BAJA dhe doktorant Erzen Koperaj, titullar i lëndës “Histori e gjuhës së shkruar”.

Veprimtaria u mbyll me falënderimet e Rektorit të USH, prof.dr. Artan HAXHI, i cili si bashkautor i librit, shprehu mirënjohjen për kolegun prof.dr. Tefë TOPALLI dhe falënderoi për publikimin në dy gjuhë, dr. Adnan ÇIRGIĆIN, Drejtor i Institutit të Gjuhës e Letërsisë Malazeze, si dhe përkthyesin e talentuar Danila BRAJEVIÇ.

E njëjta veprimtari shkencore u zhvillua pas një jave edhe në Bibliotekën e qytetit të Podgoricës (Mal i Zi)

Tefë Topalli

### **DHËNIE TITULLI “PROFESOR NDERI I UNIVERSITETIT TË SHKODRËS”**

Me dt. 26.04.2014, u organizua veprimtaria me titull “Mentor Quku dhe Mjedologjia”, në Bibliotekën e USH-së, nga Instituti i Studimeve Albanologjike dhe Famullia e fshatit Kukël. Mori pjesë drejtori i QSA, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë prof.dr.Ardian MARASHI, i cili theksoi në fjalën e tij vlerat letrare dhe gjuhësore që përmban vepra e poetit Ndre Mjeda në letërsinë shqiptare. Gjithashtu A. MARASHI ngriti lart studimet e mjedalogut Mentor Quku për figurën shumëplanëshe të kulturës shqiptare, siç është N. Mjeda. Pas tij e mori fjalën famullitari i Kuklit, historiani Dom Nikë UKGJINI, i cili është edhe nisiatori i publikimit të revistës “Mjedologji”.

Rektori i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, prof. dr. Artan Haxhi, nënvizoi punën e madhe të studiuesit M.Quku, për të ndriçuar veprimtarinë e gjerë të poetit e patriotit Mjeda. Me këtë rast Rektori HAXHI, në emër të Senatit të USH-së, i akordoi mjedalogut Quku titullin

“Profesor Nderi” me motivacionin: *“Për kontribute të veçanta në studimet mjedologjike dhe si nisiator i veprimtarisë shkencore disavjeçare “Shkodra në shekuj”*”, drejtuar në bashkëpunim edhe me USH-në. E bija e studiuesit të njohur, Valbona QUKU falënderoi për veprimtarinë, lexoi një mesazh të të atit dhe mori titullin e akorduar. Përshëndetën veprimtarinë zv.Ministri i Kulturës Z. Zef ÇUNI dhe Dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore M. PRIKU.

Në këtë veprimtari kumtuan: prof. dr. Fatbardha HOXHA, drejtore e ISA pranë USH-së; prof. as. dr. Rr. DRAÇINI e prof. dr. Tefë TOPALLI për gjuhën e përmbledhjes “Mjedologjia”, si dhe dr. Elindë DIBRA: “Studimet letrare dhe Mjedologjia”. Veprimtaria u mbyll me ndërhyrjen origjinale të prof. dr. Alfred ÇAPALIKUT, nëpërmjet gjashtë vargjeve lapidare, kushtuar N. Mjedës.

Aktorja M. SMAJA interpretoi disa poezi të poetit dhe pastaj të pranishmit ndoqën një dokumentar kushtuar veprës së shënuar të M.Qukut.

Tefë Topalli

## AKTIVITET NË BIBLIOTEKËN E UNIVERSITETIT

Me 22 prill 2014, në sallën “Walter Höflechner” të Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi”, në vijimësi të aktiviteteve të organizuara për Ditën Botërore të Librit, u zhvillua aktiviteti kushtuar studiuesit Willy Kamsi me temën: *“Një jetë me librin dhe për librin”*. Ky aktivitet u organizua me nismën e Bibliotekës Universitare, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës. Figura e Willy Kamsit, i pranishëm në aktivitet, u vlerësua për kontributin e vyer si bibliotekar, studiues, përkthyes, bibliograf si dhe etikë të lartë profesionale.

Drejtoresha e bibliotekës, znj. Alida LUKA në fjalën e hapjes së këtij aktiviteti, u shpreh me mirënjohje ndaj personalitetit të Willy KAMSIT. Ajo theksoi kontributin e tij të çmuar shumëvjeçar në bibliotekën e universitetit, në studimet albanologjike, në ndihmën dhe mbështetjen që u ofroi studiuesve, si dhe kontributin në trashëgiminë kulturore në tërësi.

Aktiviteti vijoi me referimet sipas programit. Punonjësja e bibliotekës Mimoza HOXHA me temën: *“Kujtime e përjetime nga puna me Willy Kamsin”*; prof.dr. Fatbardha HOXHA me *“Vepra ‘Saggi di Letteratura Albanese’ e Ernest Koliqit, përmes përkthimit të Willy Kamsit”*; prof.dr. Tefë TOPALLI / dr. Zamira SHKRELI me *“Zëri i Willy Kamsit në një libër Albanologjie”*; Gjovalin ÇUNI, drejtor i Bibliotekës “Marin Barleti” me *“Një vështrim mbi studimet filologjike të Willy Kamsit”*, si dhe

punonjësja e bibliotekës, Olimpia KAKARRIQI me “*Kontributi i Willy Kamsit në fushën bibliografike*”. Pas referimeve u shfaq për të pranishmit një montazh fotografik mbi jetën dhe veprimtarinë kulturore të Willy Kamsit, e përgatitur nga stafi organizues. E përshëndetën aktivitetin miq, dashamirës dhe bashkëpunëtorë ndër vite të Willy KAMSIT. Veçojmë fjalën e prof. dr. Tomor OSMANIT, i cili çmoi së tepërmi punën plot përkushtim dhe seriozitet të KAMSIT në fushën e bibliotekonomisë dhe të studimeve shqiptare.

Alida Luka, Olimpia Kakarriqi

### **VEPRIMTARI PROMOVUESE “FJALORI RIMOR I DRITËRO AGOLLIT”, MINA GERO**

Prof. as dr. Mino GERO, pedagog i Sintaksës së gjuhës shqipe në departamentin e Gjuhësisë për vite me radhë, larguar nga Shkodra që nga viti 2001, sot banon në SHBA, punon prej vitesh për krijimtarinë letrare-poetike të shkrimtarit të njohur Dritëro Agolli. Vitin e kaluar ai publikoi veprën gjuhësore për prodhimin letrar të poezive të Agollit, me titull “Fjalori i Dritëro Agollit” (Morfologjia e rimemave – Korkordanca - Fjalësi), Botimet “Toena”, Tiranë, 2013, me 743 faqe. Libri i gjuhëtarit Mina GERO është unikal, deri tani, në literaturën tonë, sa u takon studimeve të rimemave të një autori aq prodhimtar siç është D.Agolli.

Me dt. 08.11.2013, vepra e prof. Mina GERO, u promovua në Bibliotekën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në një veprimtari të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore.

Për vlerat e Fjalorit rimor të D. Agollit folën profesorët Tomor OSMANI, Tefë TOPALLI, Mimoza PRIKU, Alfred ÇAPALIKU, Mahir HOTI, ish-rektor i USH-së dhe përgjegjësja e departamentit të Gjuhës Shqipe, prof.as dr. Rrezarta DRAÇINI. Në fund prof. Mina GERO, autor i librit, falënderoi Fakultetin e Shkencave Shoqërore për organizimin e veprimtarisë, si dhe të gjithë kolegët e tij, për vlerësimet e bëra në drejtim të këtij botimi.

Tefë Topalli

## PJESËMARRJE NË KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE TË DEPARTAMENTIT TË GJEOGRAFISË

Gjatë vitit akademik 2013-1014, pedagogët e departamentit të Gjeografisë, kanë marrë pjesë në dy Konferenca Shkencore të organizuara brenda vendit, dhe një tjetër jashtë vendit, Graz – Austri.

Në maj të vitit 2013, pedagogët e departamentit të Gjeografisë, marrin pjesë në Konferencën Shkencore të organizuar nga departamenti i Gjeografisë i UT-së, me kumtesat si më poshtë:

- Flora GJONI, *“Koncepti teorik mbi sektorin terciar në aspektin gjeografik dhe politikat sektoriale në vendin tonë”*.
- Bresena DEMA, *“Roli i gjeografisë humane në studimin e migrimit, rasti i Shkodrës”*.
- Ervis KRYMBI, Dritan RRUSTJA, *“Proceset e zhvillimit të territorit dhe vlerësimi mjedisor. Rasti i qytetit të Shkodrës”*.
- Nertila HALLUNI, *“Oferta turistike në Komunën e Kelmendit”*.

Në nëntor të vitit 2013, pedagogët e departamentit të Gjeografisë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, morën pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare *“Gjeografia dhe territori”*, të organizuar nga Universiteti i Tiranës, me kumtesat e mëposhtme:

- Flora GJONI, Bresena DEMA, Nevila DIBRA, *“Zona suburbane e qytetit të Shkodrës dhe roli ekonomik i saj”*.
- Ervis KRYMBI, *“Zhvillimi urban dhe periferia informale - rasti i qytetit të Shkodrës”*.
- Dritan RRUSTJA, *“Përdorimi dhe rregullimi i territorit në hapësirën periurbane të Shkodrës”*, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare *“Gjeografia e territori”*, Tiranë, nëntor, 2013.

Më 22-24 maj 2014, në Institutin e Gjeografisë dhe të Studimeve Hapësinore – UNI Graz (Austri), zhvillohet Konferenca Shkencore *“Albanian-Austrian Science Talk: Albania in Transition”*. Pedagogët e departamentit të Gjeografisë morën pjesë me kumtesat si më poshtë:

- Prof. dr. Mahir HOTI: *Entwicklung von Studienplänen der Studienrichtung Geographie an den Universitäten Albaniens*
- Prof. as. dr. Mimoza PRIKU: *“Challenges of Higher Education in Albania”*.
- Dr. Djana BEJKO, prof. dr. Mahir HOTI: *“Integrated Management of Water Basins in Albania- Drin Core Group Initiative. Case Study”*.

- Dr. Nevila DIBRA: *“Tourism and transition in Albania - possibilities, trends and strategies”*.
- Dr. Flora GJONI: *“Changes in Albanian economic structure during transition”*.
- Dr. Bresena KOPLIKU: *“To the West – Migration in Albania after 1990”*.
- Dritan RRUSTJA, Msc (Phd Cand.): *“Periurbanization Process in Post-Socialist Albania: With Case Studies”*.
- Nertila DILAVERI, Msc (Phd Cand.): *“Industrial structure of Albania during the transition”*.

Nevila DIBRA

### **VEPRIMTARIA SHKENCORE “ADEM DEMAÇI DHE VEPRA E TIJ”**

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, organizuan ditën e mërkurë, më 30 tetor 2013, ora 13.00, në sallën e Bibliotekës Shkencore Universitare, veprimtarinë shkencore “Adem Demaçi dhe vepra e tij”.

Fjala e hapjes u bë nga Dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, prof.as.dr. Mimoza PRIKU. Gjithashtu kumtuan:

1. Prof. dr. Shyqri GALICA, *“Jeta dhe vepra e Adem Demaçit”*.
2. Dr. Arben PRENDI, *“Tematika, problematika dhe bota e personazheve në disa romane të Adem Demës (Me objekt romanet “Gjarpërinjtë e gjakut”, “AlbPrometeu”, “Dashuria kuantike e filanit”)”*.
3. Prof. dr. Tefë TOPALLI, dr. Anisa KOSTERI, *“Prurje gjuhësore nga të dy dialektet në prozën artistike të Adem Demaçit”*.
4. Dr. Elindë DIBRA, *“Adem Demaçi legjendë e gjallë”*.
5. Prof. as. dr. Rrezarta DRAÇINI, *“Një trajtim psikolinguistik i prozës së Adem Demaçit”*.
6. Dr. Flora BOROVINA, *“Figura e Adem Demaçit në letërsi”*.

Në fund të seancës fjalën përshëndetëse e mori vetë autori, shkrimtari Adem DEMAÇI, i cili shprehu kënaqësinë për mikpritjen e bërë nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Anisa Kosteri



**BOTIME TË PEDAGOGËVE JASHTË SHTETI**

Mahir HOTI, Konferencë V Shkencore Ndërkombëtare, Investimet në funksion të zhvillimit ekonomik dhe proceset integruese, “*Dukuri të shqetësimeve mjedisore në gjeohapësirën ndërkombëtare Shqipëri – Mal i Zi*”, Ulqin 05.04.2013, botuar në revistën shkencore ndërkombëtare “*Nançni bilten*”, vëllimi I, Ulqin Br./Nr.5 2013.

Mahir HOTI, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare në Detroit, Michigan (USA), 23 Nëntor 2013, “*Vështrim fiziko- gjeografik dhe social – ekonomik i trevës së Hotit*”.

Mimoza PRIKU (ba.), “*One approach for the role of rhyming dictionaries in developing children's language proficiency and the multimedia technologies*” European Scientific Journal, Vol 10, No 14 (2014), Impact Factor, f. 24-35.

Mimoza PRIKU, “*Challenges of Higher Education in Albania*” në Albanian – Austrian Science Talk, organizuar nga Universiteti i Grazit, 22 maj 2014.

Rokin DABERDAKU, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare në Detroit Michigan (USA), 23 Nëntor 2013, “*Hoti para okupimit otoman të shek XIV.(Andrea Hoti dhe roli i tij. Marrëdhëniet e tij me Balshajt dhe Venedikun)*”

Rokin DABERDAKU, “*Some moments and old church in Shkodra*”, revista “*ANGLISTICUM*” me faktor impakti.

Rrezarta DRAÇINI dhe Rezearta MURATI, prezantuan punimin: “*Multilingualism in Albania (Shkodra's area)*” “*The challenges of multilingual urban communities – the South East European perspective*”, organizuar më 11-12 September 2013, Varna Free University, nga LUCIDE – Languages in Urban Communities Integration and Diversity for Europe.

Orjeta BAJA, “*Literature and Language at Albanian High School*”, Revista “*Anglisticum*” (International Journal of Literature, Linguistics & Interdisciplinary Studies), nr. 5, Tetovë, tetor, 2013.

Dritan RRUSTJA, “*The geography of periurban landscapes in Albanian*”, konferencë ndërkombëtare - “*5 international symposium of Geography*”-Rumani, maj, 2013.

Ervis KRYMBI, A. HASA bashkautorë, “*Branding strategy for Non Profits in Developing Countries: case study - Albania*” -3 International conf. on Human and Social Sciences- Uni La Sapienza Romë, September, 2013.

Ervis KRYMBI, “*Enhancing the resilience of local Communities threated by natyral disasters: the experience of project Shkodër*”, Konferencë ndërkombëtare, EGu, prill, 2013, bashkautor Pazzi, Morelli, Krymbi.

Bresena DEMA, “*Interdisciplinary methods sustainable development in River Basin*”, Trainim Gorizia, Itali, prill 2013.

Ermira ALIA, “*Tema fetare nw letwrsinw shqiptare me shkrim arab*”, Beder Journal of Humanities, 2 Winter 2013, f. 146.

Ermira ALIA, “*Literariness in the beginnings of the Albanian Language*” European Scientific Journal , f. 278, online.

Arben PRENDI, “*Tematika, problematika dhe bota e personazheve në disa romane të Adem Demës*”, botuar në revistën Haemus Plus nr.II/ 2013 Supplement, f. 286-289.

Arben PRENDI, “*Këngët e epikës historike për Ismail Qemalin dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë*”. (49-23), botuar në revistën Haemus Plus nr.II / 2013, supplement of HAEMUS REVIEW – 2013.

ISSN 1454-1203

ISSN electric 2069-153X

Mahir HOTI, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare Graz/Austri, 22-23 qershor 2014, “*Shqipëria dhe tranzicioni*”, “*Ndryshime të rëndësishme në plan –programin e Gjeografisë në Universitet Shqiptare*”.

Bendis KRAJA, Konferencë Ndërkombëtare , “*Lufta e Parë Botërore dhe shqiptarët 1914-1918*”, Prishtinë, 28 qershor 2014.

Flora GJONI, “*Integrimi ekonomik rajonal i Shkodrës dhe përfitimet nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Malin e Zi*”, Konferencë Ndërkombëtare, Ulqin, 2013. Botuar në revistën shkencore për kërkim e zhvillim.

Fatbardha HOXHA, “*Afirmimi i identitetit etnokulturor dhe kombëtar të shqiptarëve*”, revista “Malësia”, Nr. 9, f. 125-138, Podgoricë, Mal i Zi, 2014.

Mimoza PRIKU, “*Gjuha shqipe dhe sfidat e saj përballë multilinguizmit*”, revista “Malësia”, Nr. 9, f. 163-166, Podgoricë, Mal i Zi, 2014.

Zamira SHKRELI, “*Faza të përvetësimit të leksikut nga të vegjëlit*”, revista “Malësia”, f. 181- 191, Nr.9, f. 163-166, Podgoricë, Mal i Zi, 2014.

## **MËSIMDHENIE JASHTË**

Prof. as. dr. Rrezarta DRAÇINI, pjesëmarrëse si lektore në shkollën verore doktorale të organizuar nga Ceepus Network, në bashkëpunim me Universitetin e Sofias “St Kliment Ohridski”, nga data 1 deri me 9

qershor 2014 me temën bosht “*Idea of Europe in European culture, history and politics*”.

Dr. Elindë DIBRA, Ma. Vjollca MESI: *Le jeu littéraire et le développement de l'imagination chez les enfants / “Loja“ letrare dhe zhvillimi i fantazisë tek fëmijët*. Revista Haemus Plus II. Prill, 2013. Bukuresht, Rumani.

Dr. Elindë Dibra : Journal "Shêjzat": *The Path to Free Albanian Intellectual Thought in the Years of Isolation*. ISSN 2281 3993(Print) ISSN 2281-4612(Online). Vol.3, nr 4.korrik 2014.Universiteti,La Sapienza Rome, fakulteti i shkencave Humane dhe Mediterranean Center of Social and Educational Research

ELINDË DIBRA – RAMADANI & VJOLLCA MESI, Mbi krijimtarinë letrare për fëmijë të Luigj Gurakuqit-Botimet e Konferencës shkencore - Java e shkencës” - 2013,organizuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës, Prishtinë 2014.

Prof. as. dr. Valbona KARAKAÇI, ka dhënë leksionet e mëposhtme pranë Matej Bel University Banska Bystrica të Sllovakisë, Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike, gjatë periudhës 04.11.2013- 04.12.2013.

- Iluminizmi dhe konteksti i tij
- Letërsia greke dhe konteksti kulturor
- Komunikimi mes kulturave

Angazhimi u mundësua në kuadër të Programit Evropian për Shkëmbime Universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS).

Zamira Shkreli

#### **BOTIME LIBRASH E TEKSTESH SHKOLLORE NGA**

#### **PEDAGOGËT E FAKULTETIT TË SHKENCAVE SHOQËRORE**

Alfred ÇAPALIKU, “*Luksi i kulturës*”, Shkodër, 2012, 112 f.

Fatbardha HOXHA, “*Letërsi e interpretuar*”, Shkodër, 2013, 391f.

Mahir HOTI - Dritan RRUSTJA, Tekst shkollor “*Gjeografi Fizike e Përgjithshme*” Pjesa I për studentët e degës së Gjeografisë, bashkautor, Shkodër , 2013, f.

Tomor OSMANI, “*Tradita dhe e sotmja 4*”, Shkodër, 2014, 379 f.

Njazi KAZAZI, Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (nga fillimet e tij deri në vitet ’20 të shek.XX), Shkodër , 2014, f.

Zamira Shkreli

**Marrje titujsh**

Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, miratoi dhënien e titullit “*Profesor i asociuar*” pedagogeve:

1. **Rrezarta DRAÇINI** me vendim të Ministrisë së Arsimit, nr.8 dt. 26.04.2013
2. **Valbona KARAKAÇI** me vendim të Ministrisë së Arsimit, nr.12. dt.12.02.2014.

Ndërsa gradën shkencore “**Doktor**”, morën gjatë vitit 2013-2014, këta pedagogë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore:

1. Medjon Hysenaj, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjeografi, me vendim të jurisë me nr.345, datë 08.07.2013.
2. Anisa Kosteri, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjuhësi, me vendim të jurisë me nr. 102, datë 25.07.2013.
3. Zamira Shkreli, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjuhësi, me vendim të jurisë me nr. 98, datë 25.07.2013.
4. Aida Uruçi, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjuhësi, me vendim të jurisë me nr. 115, datë 28.01.2014.
5. Bendis Kraja, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjuhësi, me vendim të jurisë me nr.20, datë 10.02.2014.
6. Brisena Dema, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjeografi, me vendim të jurisë me nr.124, datë 03.03.2014.
7. Flora Gjoni, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjeografi, me vendim të jurisë me nr.125, datë 12.03.2014.
8. Merita Hysa, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjuhësi, me vendim të jurisë me nr.331, datë 30.06.2013.
9. Ervis Krymi, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjeografi, me vendim të jurisë me nr.143 , datë 15.07. 2014
10. Dritan Rrustja, iu dha grada shkencore “*Doktor*” në gjeografi, me vendim të jurisë me nr.141, datë 17.07.2014.

Zamira Shkreli

**ISSN 2221-6855**

*Doli nga shtypi nëntor, 2014 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm.  
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”*